


PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA KORÇË



Shënim

Ky dokument përmban materialin kryesor të përdorur për Analizën dhe Vlerësimin e gjendjes ekzistuese të Bashkisë Korçë, reformuar sipas Ligjit nr. 115, datë 31.7.2014, për “Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Përmbajtja e këtij dokumenti është hartuar në përputhje me atë të parashikuar në termat e referencave sipas V.K.M. nr.670, datë 29.07.2015 "Për ngarkimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban për kryerjen e procedurave të prokurimit për realizimin e konkursit të projektimit për hartimin e planeve të përgjithshme vendore deri për 26 bashki”, për Lot 8 (Korçë, Pogradec) si dhe sipas V.K.M. nr. 671, datë 29.07.2015, për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit, shtojca 1.

Vlerësimi dhe Analiza e gjendjes ekzistuese janë strukturuar sipas Rregullores së Planifikimit dhe konsistojnë në *Analizë Metabolike të Flukseve* dhe *Analizë e Thelluar*, secila pjesë përbërëse dhe i paraprijnë përkatësisht e *Dokumentit të Strategjisë Territoriale dhe Planit të Zhvillimit të Territorit*.

Nisur nga njëtrajtësia e strukturës së tyre dhe integrimi në të njëjtin dokument, kapitujt në vijim paraqesin një panoramë të dhënash të cilat tentojnë të prekin çdo aspekt të mundshëm të kërkuar ose të parë si të nevojshëm për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor. Për të krijuar një panoramë sa më të qartë dhe për më shumë rrjedhshmëri në vlerësimin e detajuar të gjendjes ekzistuese, grupimi i të dhënave është bërë sipas 5 ndarjeve kryesore:

- Profili i Bashkisë
- Veçoritë Fizike dhe Mjedisore
- Përdorimi i Tokës dhe Infrastruktura
- Zhvillimi Sociale dhe Ekonomik
- Bujqësia dhe Blegtoria (*kapitull plus*)
- Platforma GIS

Shumë prej çështjeve mund të preken më shumë sesa në një seksion.

Pasqyra e Lëndës

A. Profili i Bashkisë	10
1. Karakteristikat e zhvillimit të bashkisë	10
1.1. Vështrim i përgjithshëm	11
1.2. Historik i përgjithshëm i zhvillimit të Korçës.....	17
2. Instrumentet dhe çështjet që influencojnë zhvillimin e territorit	24
2.1. STRATEGJITË DHE PROGRAMET NDËRKOMBËTARE	25
2.2 INSTRUMENTET KOMBËTARE DHE DETYRIMET QË RRJEDHIN PREJ TYRE	26
2.3. Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë	39
B. Veçoritë Fizike dhe Mjedisore.....	50
3. Topografia dhe Relievi	50
3.1. Topografia dhe ndikimi në zhvillim urban	51
4. Klima	56
4.1 PARAMETRAT KLIMATERIK.....	58
4.2. VLERËSIMI I NDRYSHIMIT DHE ADAPTIMIT.....	70
4.3. NGJARJE TË PAZAKONTA KLIMATIKE	71
5. Habitati dhe biodiversiteti.....	74
5.1. OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË NIVEL KOMBËTAR.....	74
5.2. Biodiversiteti	75
5.3. FLORA.....	77
5.4. FAUNA.....	78
6. Bujqësia dhe përdorimi i tokës.....	83
6.1 EVIDENTIMI I PROBLEMEVE QË LIDHEN ME BUJQËSINË DHE PËRDORIMIN E TOKËS	83
6.2 KLASIFIKIMI I TOKAVE SIPAS QËNDRUESHMËRISË NDAJ EROZIONIT.....	88
6.3 TOKAT BIMORE	89
6.4 NDOTJA E TOKES.....	89
6.5 PËRDORIMI I TOKES DHE STRUKTURA E ZHVILLIMIT	95
Të dhëna mbi bonitetin e tokës.....	99
7. Pyjet	150
7.1 STRUKTURA SHETËRORE PËR MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E PYJEVE.....	150
7.2 SITUATA E PYJEVE NE RAJONIN E KORÇËS	153
7.3 SITUATA NE RAJONIN E KORCES (me shembuj nga ZONAT E VITHKUQIT, VOSKOPIT DHE VRESHTAS).....	156
8. Peisazhi dhe turizmi.....	165
8.1. TURIZMI DHE POTENCIALI I TIJ NË QARKUN E KORÇËS	165
8.3. MONUMENTET ARKITEKTURORE	171

8.4. PAZARI, HANET E QYTETIT TË KORÇËS	173
8.5. MUZETË.....	174
8.6. DORËSHKRIMET	176
8.7. MONUMENTE TË KULTIT.....	177
8.8. MONUMENTET ARTISTIKE.....	182
PIKTURA MURALE.....	182
8.9. TRASHËGIMIA ETNOGRAFIKE	185
8.10. FOLKLORI (KËNGËT DHE VALLET)	188
8.11. FESTAT DHE FREKUENTIMI TURISTIK.....	191
8.12. TRADITAT	194
8.13. ZEJTARITË E NDRYSHME TRADICIONALE	195
8.14. KUZHINA TRADICIONALE DHE FREKUENTIMI TURISTIK.....	195
8.15. Zhvillimi turizmit kulturor në qarkun e Korçës	198
Tipet e turizmit kulturor	201
8.16. ITINERARET TURISTIKE-KULTURORE TË QARKUT TË KORÇËS	205
8.17. ZONAT/FSHATRAT KULTUROREË, AVANTAZHET DHE DIASAVANTAZHET.....	208
9. Ndërtimi Gjeologjik.....	209
9.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.....	209
9.2 SHITESAT DHE PËRBËRJA E TYRE.....	211
9.3. TEKTONIKA.....	214
10. Kushtet gjeologo-inxhinierike	217
10.1. FORMACIONET LITOLOGJIKE, INKUADrimi GJEOLGJIK I TYRE	217
10.2. ZONIMI I TERRITORIT MBI BAZËN E KUSHTEVE GJEOLGJO-	223
INXHINIERIKE.....	223
11. Veprimtaritë sizmike dhe veçoritë e tërmeteve	225
11.1. TEKTONIKA.....	225
11.2 AKTIVITETI SIZMIK	229
12. Aspektet Gjeomjedisore.....	232
12.1. Ndikimet mjedisore të Industrisë Minerare	232
12.2. Minierat e mbyllura dhe stoqet e tyre të sterileve dhe të mineraleve.....	232
12.3. Ndotja e ujërave.....	233
12.4. Minierat aktive, shfrytëzimet sipërfaqësore (karrierat) dhe stoqet e tyre.....	235
12.5. Hot Spotet.....	237
13. Pasuritë Minerale	239
13.1. STUDJUESHMËRIA E PASURIVE MINERALE.....	239
13.2 MINERALET JOMETALORË (SHKËMBINJTË INDUSTRIALË).....	245
14. Gjeomonumentet	251

14.1 KUADRI KOMBETAR PER RUAJTJEN E NATYRES	251
14.2. KATEGORITE MENAXHUESE TE IUCN-SE PER ZONAT E MBROJTURA ¹	253
14.3. TIPET E GJEOMONUMENTEVE TË BASHKISË SË KORÇËS.....	254
15. Fenomenet e Rrezikut Gjeologjik	266
15.1. RREZIQET NGA LËKUNDJET E TOKËS.....	266
15.2. Risku i lëngëzimit të truallit.....	271
15.3. Rreziqet nga subsidenca	271
15.4. Rreziqet nga përmbytjet.....	273
15.5. Rrëshqitjet.....	274
16. Burimet ujore	277
16.1. KUSHTET HIDROGJEOLGJIKE TË QARKUT KORÇË (UJËRAT NËNTOKËSORE)	277
16.2. AKUIFERËT ME POROZITET NDËRKOKRRIZOR	279
16.3. BURIMEVE UJORE DHE BURIMET UJORE SIPËRFAQËSORE(VLERËSIMI I TYRE)	284
16.4. Burimet ekzistuese të ndotjes.....	287
16.5. UJI I PIJSHËM	290
16.6. LUMENJTË.....	291
16.7. CILESA E UJERAVE SIPERFAQESORE/NENTOKESORE VITI 2014.....	291
16.8. MONITORIMI HIDRODINAMIK (REGJIMI NIVELOR)	300
17. Ajri	303
17.1. BURIMET E NDOTJES SË AJRIT	303
17.2 KONTROLLI I NDOTJES SË AJRIT	308
17.3. VLERAT KUFI PËR DIOKSIDIN E SQUFURIT E PLUMBIN DHE MASAT NE LIDHJE ME TO	308
17.4. Kontrolli i oksideve të azotit	309
17.5. OZONI NË AJRIN E AMBIENTIT DHE MASAT NË LIDHJE ME TË.....	310
18. Mbetjet.....	313
18.2. GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTI I MBETJEVE NË RAJONIN E KORÇËS.....	317
C. Përdorimi i Tokës dhe Infrastruktura	323
19. Sistemet territoriale dhe përdorimi i tokës.....	323
19.1. Përdorimi Ekzistues i Tokës; Aktivitetet dhe Impaktet.....	326
19.2. Elementët dominues në formimin e territorit	336
19.3. Transporti dhe Infrastruktura	337
Ç. Zhvillimi Social dhe Ekonomik.....	389
20. Demografia	389
20.1. Struktura e popullsisë	392

20.2. Lëvizjet e popullsisë	393
21. Aspektet Sociale	395
21.1. Strategjitë e mbrojtjes sociale.....	395
21.2. Aftësia e kufizuar	396
21.3. Shërbimet e Kujdesit Shoqëror. Shërbimet	397
21.4. Përfshirja dhe integrimi.....	398
22. Mbrojtja shoqërore dhe varfëria.....	399
23. Aksesueshmëria.....	402
23.1. Aksesimi në informacion.....	402
24. Arsimi	403
25. Kujdesi Social	405
26. Strehimi	409
27. Gjetjet për Korçën.....	412
28. KRIMINALITETI	414
28.1. Veprat penale	414
28.2. Dhuna në familje	415
28.3. Të burgosurit.....	415
28.4. Arsimi.....	418
29. Strategjia e punësimit profesional	422
30. Të dhëna kulturore.....	426
31. Aspektet ekonomike	98
32. Analizë e financave vendore	104
32.1. Çështje financiare	109
32.2. Analizë e të ardhurave	112
32.3. Asetet	113
32.4. TREGU I PUNËS.....	115
33. PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO (PBB).....	121
D. Bujqësia dhe Blegtoaria.....	122
34. POZITA GJEOGRAFIKE,RELIEVI DHE KLIMA	122
35. BUJQËSIA NË PERIUDHA HISTORIKE	124
36. PROBLEME PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË NË BASHKINË E KORÇËS.....	150
37. BUJQËSIA SIPA NJËSIVE ADMINISTRATIVE TË ZONËS RURALE.....	157
DH. Platforma GIS.....	186
38. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PLATFORMËS.....	186
39. MODELII MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT	187
40. KËRKESATTEKNIKE.....	191
Opsioni 1 - Stand-alone ëorkstation.....	192

Opsioni2- Arkitektura Klient/Server.....	193
41. Programi QGIS.....	195
Shkarkimi	195
Instalimi	196

A. Profili i Bashkisë

1. Karakteristikat e zhvillimit të bashkisë


Pas ndryshimeve të ndodhura nga reforma territoriale bashkitë nuk janë më veç qytetet, ku planifikimi nënkuptonte ofrimin e hapsirave të banimit sipas standarteve të legjislacionit përkatës, garantimi i zonave rekreative, sipërfaqeve të parkimit, zonat ekonomike, intensitetin e ndërtimit etj.; por tashmë kemi të bëjmë me territore, organizma kompleks, ku cikli i jetës ndodh i plotë. Territoret e njësisve vendore sot janë komplese, janë një miks funksionesh dhe përdorimesh të tokës, nga trualli urban me ndërtimet për banim dhe shërbime, në tokën bujqësore me kultivimin dhe vaditjen, pyjet dhe burimet natyrore; një sërë kategorish rrjetesh infrastrukturore si pjesë e akseve kombëtar që sot përshkojnë territoret e bashkive për të cilat do të jetë e nevojshme bashkërendimi vertikal. Bashkisë së Korçës i janë shtuar edhe 7 njësi të tjera vendore, ku sejcila mbart karakteristika territoriale, problematika, dhe vlera të veçanta nga njëra-tjetra, që kryesisht janë zona bujqësore fushore, malore ose të përziera, me pak zhvillim urban. Shpërndarja e zonave të urbanizuara ka si epiqendër qytetin e Korçës, që përbën dhe sipërfaqen më të madhe me 661 ha (referuar PPV-së së miratuar më parë), ndërsa territori i urbanizuar në total është 1735 ha (referuar bazës së të dhënave të AKPT).

Është e rëndësishme në analizën e territorit jo vetëm shpërndarja e zonave të urbanizuara (pra Sistemi urban referuar Vkm nr.671), po dhe lidhja e tyre dhe ndërthurja me sistemet e tjera (Natyror, Ujor, Bujqësor dhe Infrastrukturor). Pjesët ekstreme të territorit të Bashkisë Korçë, veçanërisht fshatrat e komunës Vithkuq (27 km larg nga qyteti i Korçës) dhe Lekas (38 km larg nga qyteti i Korçës) kanë komunikim të vështirë me qendrën e zonës (qytetin e Korçës) jo vetëm për shkak të distancës relativisht të madhe, por edhe për shkak të cilësisë së rrugës që lidh këto dy qendra me rrugët kryesore interurbane të qarkut të Korçës. Distanca mesatare nga qyteti i Korçës (qendra e Bashkisë) në qendrat e njësisve administrative përbërëse është 14,8 km; pika më e afërt me qytetin është 4,6 km (fshati Drenovë).

Plani i Përgjithshëm Vendor në fuqi i Qytetit të Korçës parashikon zhvillimin e qytetit të Korçës deri në vitin 2024, edhe pse nga bashkia konsiderohet një instrument i mirë, në kushtet e ndryshimit të territorit (nga 2143 ha në 80823 ha) ndyshimit të popullësisë që impakton (nga 89.000 banorë në 92.263 banorë), si dhe afatet afatet e jetgjatësisë së instrumentave të planifikimit vendor (nga 10 vjet me Ligjin 10119 në 15 vjet me Ligjin 107/2014), ky plan dhe të gjithë instrumentat e tjerë të hartuar dhe miratuar më parë do të merren në konsideratë, dhe sigurisht që do të zgjerohen për gjithë bashkinë e re.

Një nga detyrat e PPV në proces hartimi duhet të jetë përmirësimi i shërbimeve dhe aksesit të këtyre njësisve administrative (ish-komunat) me qendrën e bashkisë.

Gjithashtu PPV duhet të konsiderojë zhvillimin e dy sektorëve të rëndësishëm: Bujqësisë dhe Turizmit. Në bujqësi jo vetëm duke përmirësuar infrastrukturën e kullimit dhe vaditjes, por edhe duke ngritur dhe lokalizuar në territor funksionet e magazinimit dhe përpunimit të produkteve të zonës me qëllim edhe shfrytëzimin e afërsisë me kufirin për eksportin e tyre. Në strategjinë e zhvillimit territorial duhet të parashikohet ndërtimi dhe strukturimi i itinerareve turistike, me fokus: natyrën, kulturën, historinë dhe ushqimin, vlera për të cilat zona njihet në rajon, por që kanë ende nevojë të promovohen.



Shpërndarja e zonave të urbanizuara

1.1. Vështrim i përgjithshëm

Qyteti, rajoni dhe territori

Bashkia Korçë shtrihet në Rajonin Juglindor të Shqipërisë. Ajo ka një shtrirje veri – jug 32km dhe lindje – perëndim 40km, me një sipërfaqe territoriale prej 806 km². Kjo pozitë gjeografike ka luajtur një rol përcaktues në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të saj. Nëpërmjet rrjetit rrugor, Korça


lidhet me metropolin, Tiranën, në veri dhe qendrën e jugut, Gjirokastrën. Pozita gjeostrategjike në të cilën ndodhet Bashkia Korçë, në një zonë ndërkufitare me Greqinë dhe FYROM, ka bërë që në territorin e saj të kalojnë akse të rëndësishme të transportit, të cilët lidhin Shqipërinë me Ballkanin Juglindor e më gjerë.

Qyteti i Korçës konsiderohet një qendër urbane e rëndësishme kombëtare dhe një prej kryeqendrave të Shqipërisë. Pellgu i Korçës ka një lartësi mesatare prej 850m mbi nivelin e detit. Nga të gjitha anët e rrethojnë male të larta: në anën lindore ngrihet vargmali i Moravës, me lartësi 1800m, në verilindje Mali i Thatë, me lartësi 2262 m, nga perëndimi mbyllet me malet e Gorës, Voskopojës dhe Vithkuqit, në jug lartësohen malet e Qarrit, ndërsa nga veriu përfundon me kodrat shtufore të Grabovicës. Malet që e rrethojnë e zbutin rënien e tyre drejt fushës nëpërmjet një vargu kodrash, si kodrat e Shën Thanasit dhe Shëndëllisë mbi qytetin e Korçës, kodrat e Dvoranit dhe të Kamenicës etj. Nëpërmjet tyre dhe grykave që përshkojnë e ndajnë malet e vargmalet, pellgu i Korçës lidhet me pellgjet e tjera në afërsi. Gryka e Cangonjit, ndërmjet Malit të Thatë dhe vargmalit të Moravës, e lidh me pellgun e Devollit, pragu i Qarrit me atë të Kolonjës, ndërsa nëpërmjet sistemit kodrinor të Grabovicës kalon rruga për në pellgun e Pogradecit.

Fusha e Korçës ka një sipërfaqe përgjithësisht të rrafshët, me pjerrësi të lehtë në drejtim të veriut. Ajo përshkohet nga një rrjet përrenjsh që zbresin nga faqet e maleve, veçanërisht ato të Moravës. Përrenjtë derdhen ujërat e tyre në dy lumenjtë më të rëndësishëm të fushës, në lumin Devoll që e përshkon fushën nga lindja në perëndim dhe në atë të Dunavecit, që rrjedh nga jugu në veri dhe derdhet në Devoll. Fusha e Korçës është shumë pjellore. Kulturat më të përhapura janë gruri, elbi, misri, patatja, panxhari, fasulja etj. Prodhime të bollshme dhe të një cilësie të mirë japin perimet, sidomos qepët, lakrat, preshtë, domatet e specat, ndërsa në prodhimin e frutave dallohet për mollët, kumbullat, dardhat, por kultivohen gjithashtu dhe qershitë, ftonjtë, manat, arrat etj.

Një sipërfaqe të konsiderueshme zinin dhe vreshtat, të cilat vishnin shpatet e kodrave, si ato mbi qytetin e Korçës, mbi fshatrat Voskop e Vinçan etj. Nisur nga karakteristikat e relievit dhe lartësia mbi nivelin e detit, që i jep zonës karakter malor, vendbanimet janë vendosur në pjesën më të madhe në zonat me kushte natyrore të përshtatshme për të jetuar. Në varësi të vendosjes së tyre dallohen tre tipe vendbanimesh: Vendbanime fushore të vendosura në fushëgropa, gropa dhe luginat e lumenjve (qyteti i Korçës, fshati Bulgarec, etj); Vendbanime kodrinore, fshatrat Mborje, Drenovë, Boboshticë etj; Vendbanime malore, Voskopojë, Dardhë, Vithkuq etj., të cilat shtrihen mbi 1000 m mbi nivelin e detit¹.

¹ Relacioni i të dhënave për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë, 2016




Rajoni i Korçës në kuadrin kombëtar²

Me miratimin e Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative- territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia Korçë përbëhet nga tetë njësi administrative. Në

² Politika e Planifikimit të Territorit të Bashkisë Korçë, miratuar me vendim të KKT, Nr. 13 datë 07.03.2014

territorin e saj tashmë përfshihet jo vetëm territori i qytetit të Korçës, por dhe territori i 63 fshatrave. Në mënyrë analitike, përbërja e Bashkisë Korçë jepet në tabelën e mëposhtme:



Territori i Bashkisë Korçë

Ndarja administrative referuar relacionit të PPV Korçë

Qyteti i Korçës është qendra e Qarkut të Korçës dhe Rajonit të Korçës. Rajoni i Korçës është fqinj me Rajonin e Elbasanit në Veriperëndim, Rajonin e Beratit në Perëndim, Rajonin e Gjirokastrës në Jugperëndim, ndërsa ai ka kufinj shtetërore me Maqedoninë në verilindje dhe Greqinë në juglindje. Rajoni i Korçës përfshin katër nënprefektura; Korçën, Pogradecin, Devollin dhe Kolonjën.

Qyteti i Korçës është një qendër kryesore urbane e pjesës juglindore të Shqipërisë përse i përket madhësisë, popullsisë, administrimit, aktiviteteve ekonomike dhe kulturore. Qyteti është vendi ku ofrohet një numër i madh shërbimesh, aktiviteteve dhe lehtësirash që janë të lidhura jo vetëm me qytetin por edhe në pjesë të tjera të rajonit. Këtu përfshihen: shërbimet publike dhe administrative (Universitet, Spitali Rajonal, Gjykata e Apelit, Zyrat e Qarkut, Zyrat e Shërbimeve Publike, etj), aktivitetet ekonomike (aktivitete industriale dhe të shitjes me shumicë, pazari, bankat, aktivitete biznesi të mesme dhe të vogla); institucione kulturore (si: muzeume, libraria); disa aktivitete dhe ekspozita rajonale (karnevalet, festivali i birrës, etj). Roli thelbësor i Korçës në zhvillimin rajonal bazohet në tri kolona kryesore: (1) si një qendër e zhvillimit ekonomik rajonal, (2) si një qendër e zhvillimit të turizmit, dhe (3) si një qendër administrative dhe arsimimi.

Në nivelin ndër-rajonal, Korça është pjesë e një rrjeti më të gjerë të qyteteve Shqiptare me madhësi mesatare dhe të vogël si Pogradeci dhe Erseka (Kolonja), ndërsa në pikëpamje historike ajo ka qenë pjesë e një rrjeti ndër-rajonal të qendrave urbane në Maqedoni dhe Greqi, përfshirë këtu Ohrin, Manastirin, Kosturin, Follorinën, Shkupin dhe Selanikun. Prej vitit 1990, lidhjet ndër-rajonale janë rritur dukshëm dhe përbëjnë akse të rëndësishme potenciale për zhvillimin e ardhshëm të saj³.

Lista/harta e zonave të mbrojura natyrore

Lista/harta e monumenteve historike/kulturore të mbrojtura

Në vazhdim, Korça mbetet një qendër rajonale për artet dhe kulturën në Shqipërinë juglindore, duke ndjekur traditën e saj të gjatë. Qyteti i Korçës në vetvete është një vend tërheqës turistik, duke ofruar një imazh të veçantë dhe identitet urban, si edhe shumë asete kulturore, siç janë pazari i qytetit, një ansambël i ndërtuar në shekullin e 19^{të}, dhe disa muzeume. Në afërsi të Korçës gjendet një larmi unike e aseteve kulturore. Ndërmjet vendbanimeve që e rrethojnë ia vlen të përmendet Voskopoja, e cila ishte një qendër e madhe kulturore dhe tregtie e shekujve të 17^{të} dhe 18^{të}, dhe Dardha e cila është një vendbanim tradicional malor që ofron një mjedis kulturor dhe natyror të cilësisë së lartë dhe objekte për ushtrimin e sporteve dimërore. Rajoni i Korçës përmban shumë qendra arkeologjike, siç janë Tumat e Kamenicës, pranë Mollajt, e cila daton në Periudhën e Bronxit. Disa vendbanime siç janë Vithkuqi, Mborja and Boboshtica ofrojnë mjedis tradicional me shtëpi guri, oborre dhe rrugë të shtruara me gurë, si edhe monumente për tu vizituar nga periudha Bizantine dhe ajo Osmane. Së fundmi, rajoni i Korçës është i njohur për shumë produkte lokale si rakia dhe “Birra Korça”.


Thuajse 75% e tokës së rajonit në total mbulohet me kodra dhe male. Megjithatë, cilësia kryesore e mjedist natyror korçar është fusha e madhe e Korçës, që ndodhet në 850m mbi nivelin e detit. Kjo pllajë përbën sipërfaqen e dytë më të madhe bujqësore të Shqipërisë, ndërsa pjesa më e madhe e saj është një ish-kënetë, e bonifikuar mbas Çlirimit. Një përqindje e madhe e tokës bujqësore përreth Korçës aktualisht është jo plotësisht e shfrytëzueshme, për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe emigracionit të madh. Përreth Korçës ka shumë pyje. Një prej kërcënimeve kryesore mjedisore është aktualisht degradimi i pyjeve si rrjedhim i prerjes masive të tyre për ngrohje shtëpiake.

Nënprefektura	Sasia e tokës (ha)	Tokë e kultivuar	Tokë pyjore (ha)	Kullota & livadhe (ha)	Të tjera (ha)				
Korça	172,478	44,207	26%	54,900	32%	23,604	13%	49,767	29%
Pograde	71,541	17,506	24%	27,330	38%	5,364	7%	21,341	31%
Devolli	41,542	13,148	32%	15,165	37%	3,022	7%	10,207	24%

³ Politika e Planifikimit të Territorit të Bashkisë Korçë, miratuar me vendim të KKT, Nr. 13 datë 07.03.2014, f. 16

Kolonja	80,463	11,247	14%	34,680	43%	21,742	27%	12,794	16%
Totali (si Rajon)	366,024	86,108	24%	132,075	36%	53,732	14%	94,109	26%

Shpërndarja e përdorimit të tokës në rajonin e Korçës⁴




Qyteti i Korçës në Basenin e Korçës (Burimi: Dokumenti i Politikës së Planifikimit të Territorit)

Korça është pjesë e një rrjeti të gjerë vendbanimesh, zhvillimi i të cilëve është i lidhur ngushtë me zhvillimin e qytetit dhe anasjelltas. Tendencat e urbanizimit kanë ndjekur kryesisht zhvillimin informal prej fillimit të viteve '90 dhe janë të dukshme në qendrat kryesore urbane të Korçës dhe të Pogradecit. Dekadat e fundit kanë qenë dëshmitare të zhvillimit linear përgjatë akseve rrugore rajonale dhe kombëtare si çdo ndërtim informal ose jo në Shqipëri, si shkak i mungesës së zhvillimit të infrastrukturave kryesore në zona të reja urbanizimi. Prej fillimit të viteve '90, përgjatë aksit Korçë – Maliq (rruga në drejtim të Tiranës) dhe aksit Korçë – Bilisht (aksi në drejtim të Greqisë) janë vendosur shumë shërbime. Zhvillimi i Qytetit të Korçës në mënyrë specifike prek dhe ndikohet nga zhvillimi i zonave të banuara përreth, ish-Komunat që tashmë janë pjesë e Bashkisë së re. Kështu zonat e Drenovës dhe të Bulgarecit që ndodhen ngjitur me qytetin e

⁴ Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Rajoni i Korçës, referuar Politikën e Planifikimit të Territorit të Bashkisë Korçë, datë 07.03.2014, f. 18

Korçës dhe në veçanti fshatrat e Mborjes, Barçit, Ravonikut dhe Turanit, varen drejtpërdrejt nga Korça, si rezultat i përdorimit të tokës ujçësore, marrëdhënieve të pronësisë dhe pozicionit gjeografik.

1.2. Historik i përgjithshëm i zhvillimit të Korçës



Në periudhën e Antikitetit territoret e trevave të Korçës përfshiheshin në mbretërinë e parë ilire të udhëhequr nga Bardhyli. Në periudhën e Mesjetës treva e Korçës ka qenë nën zotërimin e familjes së Muzakajve, ndërsa nga viti 1391 deri më Shpalljen e Pavarësisë 1912, gjithë krahinat e Korçës u vunë nën qeverisjen e perandorisë turke. Në këtë periudhë këto krahina u përfshinë në sanxhakun e Manastirit dhe të Ohrit.


Në vitin 1827 Korça u bë nënprefekturë dhe më 1870 prefekturë, në të cilën përfshiheshin nënprefektura e Kosturit, Bilishtit, Kolonjës dhe krahina e Oparit. Në vitet 1916-1920, Korça përmendet si kryeqytet i republikës me qeverisje shqiptare, nën kujdesin e ushtrisë franceze. Pas vitit 1920 Korça dhe trevat e saj, përfshihen brenda territorit të Shqipërisë, nën organizimin administrativ të prefekturës. Nga viti 1958 deri në vitin 1990 ndarja administrative në të gjithë Shqipërinë, përfaqësohej nga rrethe, qytete, fshatra të bashkuar dhe fshatra. Është e mundshme që zanafilla e qytetit mesjetar të Korçës të ketë qenë kalaja, për të cilën bëhet fjalë në regjistrin e vitit 1431-1432.

Vendosja nga turqit e qendrës së krahinës nuk ishte e rastësishme. Këtu ata gjetën një qendër të formuar të rëndësishme ekonomike, në një pozitë të favorshme me kala e Pazar dhe me ekonomi të fuqishme pranë, siç ishin fshatrat e Mborjes e Peshkopisë. Këtu ishte gjithashtu dhe një qendër e rëndësishme shoqërore, si qendër peshkopate e krahinës. Fundi i shek. XV shënon një moment të rëndësishëm për historinë e Korçës. Në vitin 1484, sulltan Bajaziti II i dhuron Mirahor Iliaz Beut për merita shërbimi, fshatrat Leshnjë dhe Vithkuq, ndërsa në vitin 1486 edhe fshatin Boboshticë. Këtyre iu shtuan fshatrat Trebickë, Treskë, Vodice, Stratobërdhë dhe Panarit. Në vitin 1495, fshatrat Treskë e Panarit u shkëmbyen me fshatin Peshkopi.

Në Peshkopi, u krijua një qendër e re tregtare e shoqërore, e pajisur me treg, faltore, imaret e shkollë, pra një qendër me frekuentim të shpeshtë. Territori i Peshkopisë ishte tepër i gjerë dhe nga dokumente historike mësojmë se ai kufizohej nga Mborja, Barçi e Bulgareci, pra shtrihej në një territor, i cili përkonte me atë që përfshin qytetin e sotëm. Me stabilizimin e pushtetit qendror dhe me zhvillimin e përgjithshëm të qyteteve shqiptare, edhe Korça do të ketë pasur një rritje të qëndrueshme dhe do të ketë përfshirë në përmbajtjen e sa edhe fshatin Peshkopi, i cili në dokumentacionin e mëvonshëm nuk përmendet më.

Nga një dokument i viteve 1647-1648, mësojmë se tregtarët elbasanas për të shkuar në Venedik në kohën e luftës veneto-turke (1644-1669), kur siç duket porti i Durrësit ishte i mbyllur, ndiqnin rrugën shumë të gjatë Elbasan-Korçë-Sajadhë-Korfuz_Venedik. Gjatë rrugës, në tregun e Korçës ata blinin prodhime blegtorale, prodhime zejtarie dhe shisnin prodhime manufakture të sjella nga Venediku. Burim i rëndësishëm informacioni për jetë shoqërore, kulturore dhe ekonomike të qytetit gjatë shek. XVIII-XIX është sidomos Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit. Në fillim të shek. XIX, konsulli francez Pukëvil jep për Korçën këto të dhëna: ka pesë kisha, një xhami dhe 1300 familje, ndërsa anglezi Lik e çmon Korçën me 450 shtëpi. Në rastin e dytë, pak më sipër njoftimit për numrin e shtëpive, autori bën fjalë për një epidemi murtaje që kishte rënë në qytet 8 muaj përpara arritjes së tij. Kjo do të thotë se është shkaktuar ndonjë braktisje e qytetit. Megjithatë, nuk është për t'u habitur për ritmet e ulta të shtimit të popullsisë në atë kohë. Përveç sëmundjeve, qyteti vuante ende nga dhuna e feudalëve, bejlerëve dhe derebejve, të cilët caktonin haraçe të rënda dhe plaçkitnin herë pas here. Nga sulmet e tyre u shkatërruan qytete të fuqishme si Voskopoja.

Mesi i shek. XIX e gjeti Korçën në lulëzim e sipër, që tërhiqte gjithnjë e më tepër banorë të ardhur nga fshatrat përreth. Në vitin 1859 Korça numëronte 10000 banorë, më 1879 qyteti kishte 1500 shtëpi e 13000 banorë. Në fillim të shek. XX popullsia e këtij qyteti kishte arritur në 15000 banorë, kurse më 1923 arriti në 25598 banorë dhe të jetë qyteti më i madh i Shqipërisë. Por ky numër kaq i madh ka përfshirë dhe shtesën e popullsisë së fshatrave të djegur gjatë luftërave ballkanike e botërore që gjeti strehë në Korçë, sepse më 1927 qyteti numëronte 19491 banorë, numër të cilin, me ndryshime të pakta e ruajti deri në prag të Çlirimit. Popullsia erdhi duke u rritur pas çlirimit të vendit dhe në vitin 1968 qyteti kishte 46 300 banorë. Aktualisht me një popullsi prej 86.739 banorë, qyteti i Korçës është qendra e qarkut dhe një ndër qytetet më të rëndësishme të vendit, i dalluar tradicionalisht për rolin e saj në zhvillimin ekonomik, arsimor dhe kulturor kombëtar.



VOSKOPOJA

Voskopoja është një vendbanim mesjetar i hershëm, i cili daton që prej vitit 1330. Ajo ndodhet 21km larg qytetit të Korçës, e shtrirë mbi një pllajë 1160m mbi nivelin e detit. Lulëzimin më të madh Voskopoja e ka patur në vitin 1764, atëherë kur popullsia e saj arriti në 30000 banorë. Në këtë periudhë ajo kishte 25 kisha me afreske të veçanta, prej të cilave kanë mbetur vetëm shtatë. Në të njëjtën periudhë, në këtë qytetërim është ngritur Akademia, Biblioteka dhe Shtypshkronja. Koha e themelimit të Voskopojës rezulton në vitin 1330, sipas arkivave të gjetura në Manastirin e Shën Prodhromit. Legjendat mbi themelimin e qytetit janë të ndryshme, por nuk ka ende të dhëna të sakta. Voskopoja kishte artizanat të zhvilluar dhe kjo shërbeu si urë lidhëse, jo vetëm brenda

vendit, por edhe jashtë tij. Shkatërrimi i parë i saj ndodhi në vitin 1769, i dyti në vitin 1789 dhe i treti në vitin 1916. Kavalioti i përshkruan katastrofat e viteve 1769, 1789, si katastrofa ku u rrëmbyen vlera të panumërta kulturore e artistike.

Zhvillimi në Voskopojë i profesioneve dhe zejeve të kohës, u bë një nxitës real i konkurrencës në të gjithë Ballkanin, duke dhënë shenjat e para të një kulture paraindustriale, që do të sillte padyshim një zhvillim parakapitalist, të domosdoshëm për zhvillimin e rajonit. Mallrat që prodhoheshin në Voskopojë kanë qenë të famshme dhe ndonjëherë, për t'u dalluar, mbanin të gdhendur një stemë me shqiponjë. Lidhjet tregtare me Laipcigun, Vjenën, Budapestin, Bullgarinë, Kostandinopojën, ku voskopojarët themeluan shtëpitë tregtare, ndihmuan zhvillimin e tregtisë, industrisë dhe shtimin e mirëqenies së qytetit. Pronarët e këtyre shtëpive tregtare ishin njerëz të kulturuar dhe të pasur, që ishin vendosur prej kohësh në disa qendra evropiane.

Sipas Aurel Plasarit: "Në qytet kishte 14 korporata. Mund të themi pa e zmadhuar se, historia e qytetit është historia e korporatave të tij. Këto 14 korporata përfaqësonin kategoritë e mëdha industriale dhe tregtare. Elementi më i çuditshëm i Voskopojës është standarti demokratik i administrimit të saj. Ajo drejtohej nga borgjezia tregtare dhe zejtare, në mënyrë të pavarur nga Porta e Lartë, nëpërmjet parimit të votimit." Voskopoja ishte një qytet autonom brenda Perandorisë Otomane, i përbërë kryesisht nga popullsia vllahe dhe pakica greke dhe shqiptare. Analiza e vitit 1935, bazuar në eponimitë e familjeve voskopojare, tregon se pjesa më e madhe e popullsisë ishte vllahe. Akademia e Re, Biblioteka dhe e vetmja Shtypshkronjë e Perandorisë së asaj kohe, ka qenë një trekëndësh kulturor unikal në Ballkan në mesin e shek. XIX.

Për aq kohë sa Voskopoja lulëzoi, një numër shumë i madh të rinjsh u shkolluan dhe u formuan me një identitet evropian, të mbujtur me idetë iluministe. Arti dhe kultura në Voskopojë patën një zhvillim të paparashikuar duke e kthyer Shqipërinë në një far që ndriçonte gjithë Ballkanin otoman. Nga të dhënat e copëzuara që vijnë sot, rezulton se Voskopoja po përjetonte për të parën herë krijimin e një gjuhe të shkruar shqipe. Teodor Kavalioti ishte ai që kishte krijuar një alfabet, gërmat e të cilit mund të identifikoheshin si analoge me ato të glagolitishtes ilire. Ky alfabet, që është zhdukur në rrënojat e Voskopojës, u kurorëzua me aktin më të rëndësishëm të kohës, përkthimin e së parës Dhjatë të Re, nga gjuha greke në gjuhën shqipe.

Gjithashtu, ndër dijetarët që u morën me shqipërimin e dhjatave përmendim Grigor Voskopojarin (zv/rektori i Akademisë së Re), si dhe Dhaskal Todrin, i cili përdori një alfabet origjinal, që e shpiku vetë dhe që u përhap edhe në Elbasan. Kështu, Voskopoja e asaj kohe ishte kthyer në një qendër të lëvrimin të shqipes dhe pak nga pak ajo po bëhej një fanar ndriçues dhe orientues drejt pavarësisë shqiptare. Voskopoja zgjon interes të jashtëzakonshëm me kishat e mbijetuara. Këto janë: Manastiri i Shën Prodhromit, Kisha e shën Kollit, Kisha e shën Thanasit, Kisha e shën Mëhillit, Kisha e shën Marisë, Kisha e profetit Ilia dhe Kisha e shën e Premtes. Këto objekte fetare janë pjesë shumë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore, sepse përfaqësojnë vlera të çmuara të

besimit, historisë dhe qytetërimit. Në vitin 2002, këto objekte kulti janë renditur në Fondin e 100 Monumenteve Botërore në rrezik rrënimi.

Në sfondin e artit ikonografik të Voskopojës, më i shquari është Davidi nga Selenica, i cili ka pikturuar në vitin 1721 kishën e shën Kollit. David Selenica ka qenë artisti më me influencë i Rilindjes së gjithë artit ballkanin dhe ndikimi i tij u ndje në të gjithë artin ortodoks të Ballkanit, sepse ai dha shenjat e para të kapërcimit të klisheve të pikturës zyrtare të Malit Athos.

VITHKUQI

Vithkuqi daton si vendbanim që me kalatë e Boshanjit, Leshnjës, Bellovodës, (periudha e parë e hekurit). Në mesjetë përmendet si vendbanim në Principatën e Muzakajve. (shek.XV). Në kohën e lulëzimit të vet numëronte një sërë kishash dhe bazilikash disa prej të cilave ruhen edhe sot. Vithkuqi është një prej tre fshatrave malorë të rrethit të Korçës, krahas Voskopojës dhe Dardhës. Fshati ndodhet 27km larg qytetit të Korçës dhe është i vendosur midis maleve. Pika e tij më e lartë, 1750m mbi nivelin e detit, quhet Rungaja. Terreni i thyer kodrinor i fshatit Vithkuq, që shtrihet në tre lagje të mëdha, shpalo bukuri dhe vlerat e një natyre të mrekullueshme malore. Në shek. XVIII, në periudhën e lulëzimit të tij,

Vithkuqi ka patur 24 kisha, prej të cilave sot ruhen vetëm 4, në gjendje të mirë dhe të restauruara, që përfaqësojnë vlera të mëdha historike të artit bizantin. Përmendim ndër to kishën e shën Pjetrit, të pikturuar nga vëllezërit Zografi, së bashku me varrezat e lashta përbri, si dhe kishën e shën Mëhillit, e cila ka afreske në dy shtresa dhe mendohet se është pikturuar nga Kostandin Jeromonaku. Kisha e parë është ndërtuar në shek. e XII dhe në shek. e XVI fshati kishte 343 familje. Vithkuqi është vendlindja e Naum Panajot Bredhit (1767-1846), ideologut të Rilindjes Kombëtare, hartuesit të "Evetarit" (1814), abetares së parë shqipe, me 33 shkronja. Fshati ka tradita, zakone e folklor dallues nga fshatrat e tjerë. Nga ky fshat ky fshat kanë dalë figura të njohura si piktori i madh Vangjush Mio, i cili njihet si piktori i "njerëzve", i frymëzuar nga peizazhet e Korçës.

DARDHA

Dardha është një fshat turistik, që ndodhet 20km në juglindje të Korçës, në një lartësi prej 1334m mbi nivelin e detit. Prej kohësh, fshati i Dardhës bën pjesë në listën e gjatë të destinacioneve turistike të Shqipërisë. Emri Dardhë vjen nga një legjendë, sipas së cilës thuhet se të ikurit qëndronin në një fushë, rreth një peme dardhe dhe atë e quanin si "fusha poshtë dardhës". Dardharët njiheshin si druvarë të mirë, profesion ky nga më të përhapurit në atë kohë.

Studimi arkitektonik i fshatit dëshmon prezencën e një stili evropian, i cili ndeshet dhe në shumë fshatra të tjera të Shqipërisë lindore. Pamja që krijonin banesat, urbanistika e fshatit, ndërtimet e forta me gurë të skalitur, rrugicat me kalldrëm, burimet e shumta, punishtet e artizanëve si dhe dyqanet, i jepnin Dardhës imazhin e një qyteti të vogël ne rritje, pavarësisht se popullsia e saj zvogëlohej për shkak të emigracionit në masë. Dallohet tipi i banesës dardhare, dy-trekatëshe e

ndërtuar me gurë dhe çati me rrasa guri (ploça), i cili është ruajtur edhe në ndërtimet e reja. Disa prej shtëpive sot duken të braktisura, ose të lëna pas dore, por shumë banorë po kthehen dhe po rindërtojnë banesat e vjetra. Tashmë janë rikonstruktuar rreth 40 shtëpi, të cilat kanë për synim zhvillimin e turizmit familjar.

I vështirë në dimër, por i bukur në verë, ky fshat është bërë shumë i vizitueshëm. Të panumërta janë burimet me ujë të akullt, midis të cilëve veçohet burimi “Uji i qelbur”, që konsiderohet si kurativ. Specialiteti kulinar i këtij fshati është lakrori (një lloj byreku me dy petë i pjekur në saç) dhe rakia e kumbullës së egër. Dardha preferohet sidomos në dimër nga skiatorët, sepse në këtë zonë dëbora shkrin vonë.

TUMA E KAMENICËS

Tuma e Kamenicës është një zbulim unikal arkeologjik, dëshmi e qendrës së banuar që në prehistori. Kjo tumë, ka rëndësi jo vetëm pasi është e para në rajon, por edhe për pasurinë arkeologjike që disponon. Hapësira ku ngrihen strukturat e varreve është 3m nën nivelin e tokës. Tuma e Kamenicës bën pjesë në grupin e tumave të shkatërruara të kësaj zone gjatë punimeve të vazhdueshme bujqësore të viteve 1950-1960 të shekullit të kaluar. Megjithatë ajo u dëmtua rëndë gjatë viteve 1997-1999 nga punimet e thesarkërkuesve, të cilat nxitën Grupin e Arkeologjisë së Shpëtimit të QNASH, që në bashkëpunim me Institutin Arkeologjik Tiranë, Muzeun Arkeologjik Korçë dhe me disa institute kërkimore-shkencore ndërkombëtare, të financuar nga Instituti Packard për Shkencat Humane, të ndërmarrin punime me karakter ndërdisiplinor, që filluan në vitin 2000 e përfunduan në vjeshtën e vitit 2002.

Gjatë këtyre fushatave afatgjata gërmimesh, morën pjesë shumë studentë e arkeologë të sapodiplomuar, arkeologë me përvojë, një grup antropologësh nga Departamenti Antropologjik i Universitetit Shtetëror të Miçiganit në SHBA, specialistë konservimi, piktorë, skicografë, etj. vendas e të huaj. Tuma e Kamenicës është një nga tumat më të mëdha të njohura deri më tani, në të cilën u evidentuan 400 varre, mbetje skeletorë të 430 individëve dhe më shumë se 3500 objekte. Varret më të hershëm të saj i përkasin periudhës së bronzit të vonë rreth shek. XII p.e.s. Kjo tumë ka pushuar së funksionuari rreth mesit të shek VI p.e.s., pra ka një histori gati 700-vjeçare. Në këtë tumë gjenden të konservuara si, Unaza e varrit qendror të tumës, grupi i parë dhe i dytë i varreve me strukturë monumentale si dhe pjesa tjetër që është lënë e pa gërmuar, ku mendohet se në atë pjesë të tumës ekzistojnë edhe 400 varre të tjerë.

Gjithë veprimtaria kërkimore shkencore që u realizua sipas të gjitha kritereve bashkëkohore e me mjete moderne gjatë këtyre fushatave të gërmimeve në terren, u organizua dhe drejtua nga Lorenc Bejko, Maria Grazia Amore dhe Skënder Aliu. Në përfundim të këtyre gërmimeve u provua se tuma e Kamenicës përfaqëson monumentin mortor më të madh të llojit të vet në raport me 200 tumat e tjera të gërmuara në Shqipëri dhe në zonat e tjera fqinje të Ballkanit e më gjerë. Varri qendror me të cilën zë fill ndërtimi i kësaj tume, daton në Bronzin e vonë, shek. 13 të p.e.s.; i përket një burri, i cili ka vdekur rreth të dyzetave. Ky varr nuk kishte inventar, por poshtë tij

ndodhej një gropë e thjeshtë në të cilën u gjetën një grumbull kockash të djegura kafshësh (dele ose dhi), që tregojnë shenja të një ceremonie mortore.

Ndryshe nga tumat e tjera të këtij lloji të gërmuara në Shqipëri: Barç (Korçë); Rehovë (Kolonjë); Piskovë (Përmet); Vodhinë (Gjirokastrë); Vajzë (Vlorë); Pazhok (Elbasan); Cinamakë (Kukës); Shtoj (Shkodër), të cilat kanë patur varre qendrore - varri qëndror i tumës së Kamenicës është i kufizuar me dy rrrathë bashkëqendrore, me diametër 13m, të ndërtuar me gurë me përmasa mesatare. Në zonën brenda kësaj unaze janë vendosur gjatë periudhës së Bronzit të vonë (1200–1050 p. e. s) edhe 40 varre të tjerë. Në periudhën e dytë të përdorimit të tumës, gjatë periudhës së Hekurit të hershëm (1050 –750 p.e.s.), ajo u lartësua nëpërmjet 200 varrimeve të tjera të mbuluara me dhë, deri sa ajo mori formë gjysmësferike, me diametër 50 m, e lartësi rreth 3 m. Në periudhën e tretë të përdorimit të tumës, që përkon me gjysmën e dytë të shek. VII të p.e.s., në periferinë e pjesës jugore e verilindore të saj janë ndërtuar disa struktura monumentale rrethore ose gjysmë rrethore, brenda të cilave janë varrosur individë me lidhje gjinore. Gjatë një periudhe shumë të shkurtër kohe (625–540 p.e.s.), tuma e Kamenicës është zmadhuar, duke u shtrirë kryesisht drejt lindjes, nëpërmjet varrimeve intensive të realizuara vetëm me gurë, derisa ajo mori formën e një elipsi me përmasa 70m x50m. Në përfundim të fushatës 3 vjeçare të gërmimit, u zbuluan 400 varre, që përmbanin 440 skelete dhe më shumë se 3500 objekte arkeologjike si qeramikë, armë dhe stoli të ndryshme prej bronzi, hekuri, argjendi, ari, qelibari dhe kocke. Të gjitha strukturat e varreve monumentale të kësaj tume u zbuluan e u ruajtën me synimin për t'i kthyer ato, në një të ardhme të afërt, në një monument të vizitueshëm në natyrë.

DRENOVA

Pesë kilometra larg Korçës, në juglindje të saj, midis dy lumenjve të vegjël, në rrugën që të çon për në Kolonjë, gjendet Drenova, e cila qëndron në rrezë të Malit të Moravës dhe në ballë të Fushës së Korçës, një pozitë kjo mjaft e përshtatshme gjeografike. Drenova është vendlindja e poetit të njohur shqiptar Aleks Stavre Drenova (Asdreni). Pranë fshatit Drenovë ndodhet Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë, në anë të rrugës nacionale Korçë-Ersekë. Ky është një ndër institucionet e reja që është hapur gjatë vitit 2008. I EVP Korçë, është një investim i Komisionit Evropian me një vlerë prej 4.8 milion euro. Rrjeti inxhinierik është bërë me financim të Qeverisë Shqiptare ku u alokua një fond prej 21.284.560 lekë.

Institucioni Penal i Korçës në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë, është kategorizuar burg i sigurisë së lartë, me një seksion të sigurisë së zakonshme, një seksion paraburgimi dhe një seksion paraburgimi për të mitur. Kapaciteti i institucionit është parashikuar për 312 persona dhe është i pajisur me ambiente observimi, qendër spitalore, objekte kulti dhe ambiente të tjera edukuese. Drenova është e njohur për burimet e saj natyrore. Përmendim minierën e qymyrit të Mborje Drenovës, një nga më të vjetrat e vendit, por edhe pejsazhet e mrekullueshme dhe monumentet e natyrës, si psh. Parku Kombëtar “Bredhi i Drenovës”, Manat e zeza, Guri i Capit, Bozdoveci etj. MBORJA Mborja ndodhet 5km larg qytetit të Korçës në drejtimin juglindor të tij. Ai

është fshati më i afërt i Korçës, si një lagje periferike e saj, pasi banesat e ngritura kohët e fundit e kanë bashkuar Mborjen me qytetin. Përgjatë rrugës që lidh Korçën me fshatin Mborjes, janë të dukshëm objektet e ish minierës së njohur të qymyrgurit. Kisha e Ristozit, ndodhet në krye të fshatit Mborje. Ajo është një nga objektet më të hershme të kultit në Ballkan. Afresket e saj janë realizuar nga piktorë anonimë, në vitin 1390. Një shënim në gjuhën greke, që ndodhet në anën e djathtë të hyrjes e daton ndërtimin e kësaj kishe në vitin 898. Ky vend i shenjtë, vizitohet nga qindra besimtarë, 40 ditë pas Pashkës së Madhe.

BOBOSHTICA

Boboshtica është një fshat piktoresk, që ndodhet 10km larg qytetit të Korçës dhe i cili veçohet për manat e zeza dhe rakinë e famshme që prodhohet prej tyre, si dhe qilimave prej leshi, të endura nga duart e grave vendase. Ky fshat turistik, preferohet veçanërisht prej vizitorëve edhe për tavernat e njohura me gatime tradicionale. Boboshtica ka nxjerrë breza të tërë intelektualësh, që i kanë shërbyer vendit në të gjitha fushat, në art, kulturë, arsim etj.⁵

2. Instrumentet dhe çështjet që influencojnë zhvillimin e territorit

Bazuar në përcaktimet e rezultateve të pritshme në Termat e Referencës si dhe në zbatim të Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin e dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të tij, veçanërisht referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” një ndër analizat e para të cilat zhvillohen në kuadër të hartimit të një dokumenti planifikimi është analiza dhe studimi i planeve të hartuara më parë ose në proces që ndikojnë në zhvillimin e territorit të Bashkisë. Metodologjia e hartimit të analizës së planeve të mëparshme është bazuar në një studim të dokumenteve të planifikimit, që për strukturim të informacionit ato janë ndarë në dy kategori kryesore: 1) Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë, që përmban jo vetëm analizat e planeve të mëparshëm territorial të hartuar për Bashkinë Korçë por edhe një pasqyrë të stategjive ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale që ndikojnë në zhvillimin e Korçës; dhe 2) Dokumentimi dhe rishikimi i direktivave të planeve ekzistuese hapësinore kombëtare dhe sektoriale, standarteve dhe normave. Prej secilit dokument janë identifikuar objektivat dhe disa nga masat kryesore të cilat kanë implikime në hartimin e planit të ri të përgjithshëm vendor për Bashkinë Korçë.

⁵ Relacioni i të dhënave për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë, 2016, f. 7-12

2.1. STRATEGJITË DHE PROGRAMET NDËRKOMBËTARE

2.1.1. Strategjia 2020 e Evropës Jug-Lindore – Punësimi dhe prosperiteti në një këndvështrim Evropian (BE/ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal)

Ky dokument është hartuar në vitin 2011, si përgjigje ndaj kërkesës së qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor, nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal në bashkëpunim me qeveritë e vendeve të këtij rajoni, për përgatitjen e një dokumenti në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me konkurrencën rajonale dhe strategjitë e rritjes.

Ky dokument fokusohet në pesë shtylla të modelit të ri zhvillimor:

- **Rritje e Integruar** – me fokus Tregjet Rajonale, ekonominë e orientuar drejt eksportit dhe -investimeve të huaja, etj.
- **Rritje e Zgjuar** – me fokus rritjen e konkurrueshmërisë Rajonale, udhëheqjen nga njohuria dhe novacioni dhe bazuar në kapitalin njerëzor, teknologjitë moderne të komunikimit dhe industritë kreative
- **Rritje e Qëndrueshme** – me fokus në infrastrukturën dhe energjinë e qëndrueshme, në përdorimin me efikasitet dhe ndjeshmëri të burimeve, sidomos atyre natyrore
- **Rritje Gjithëpërfshirëse** – me fokus avancimin përtej një shoqërie përjashtuese drejt një situatë ku të gjithë përfitojnë nga zhvillimi në mënyrë të drejtë
- **Qeverisje në funksion të rritjes** - me fokus qeverisjen transparente, funksionale dhe efikase

2.1.2. Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri – Greqi 2014 – 2020



Programi Interreg II IPA i Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri – Greqi 2014 – 2020 është rezultat i një procesi të programimit të udhëhequr nga "Komiteti i Përbashkët i Programimit", i themeluar për përgatitjen e programit Interreg II IPA për bashkëpunimin ndërkufitar. Strategjia e këtij programi është:

"Për gjetjen e ekuilibrit mes zhvillimit të qëndrueshëm rajonal dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkufitar midis popullsisë dhe rajoneve, institucioneve vendore, në përputhje me BE-në dhe politikën kombëtare, me qëllim adresimin e sfidave të përbashkëta nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta"

Prioritetet e programit në bazë të Aneksit III të rregullores IPA II (BE) Nr 231/2014, përfshijnë:

- Promovimi i transportit të qëndrueshëm, informacionit dhe komunikimit (IC) rrjete dhe shërbime dhe investime në ujë, mbeturinave dhe energjisë sistemeve dhe pajisjeve ndërkufitare.
- Mbrojtja e mjedisit dhe promovimin e ndryshimeve klimatike përshtatjen & zbutjen, parandalimin e rrezikut dhe menaxhimit.
- Vlerësimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- Rritja e konkurrencës në mjedisin e biznesit dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, tregtisë dhe investimeve.

Zona përfituese ndërkufitar shtrihen nga Deti Jon në liqenet e Prespës, dhe përfshinë: Rajonet e Grevenës, Kosturit, Follorinës, Arta, Thesprotia, Janinë, Prevezë, Zakynthos, Kerkyra, Kefallinia dhe Lefkada në Greqi dhe rajonet e Vlorës, Qarku i Gjirokastrës, Qarku i Korçës dhe Qarku i Beratit në Shqipëri.

2.2 INSTRUMENTET KOMBËTARE DHE DETYRIMET QË RRJEDHIN PREJ TYRE

2.2.1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar (draft)

Plani i Përgjithshëm Kombëtar është një nismë e marrë nga qeveria me propozim të Ministres për Zhvillimin Urban dhe Turizmin. Ky plan duhej të ishte bërë më parë dhe vonesa e tij ka rënduar situatën në terren, duke degraduar panoramën e përgjithshme me ndërtime të realizuara në mungesë të një plani kombëtar, dhe për më tepër kanë shkaktuar dëm ekonomik kombëtar pasi ndërkohë është stimuluar hartimi i planeve vendore dhe rajonale, të gjitha hartuar dhe miratuar në mungesë të një kornize politike kombëtare të planifikimit. Zhvillimet kaotike dhe shpesh informale në territor, si dhe mungesa e planifikimit dhe e kontrollit të territorit nga njësitë vendore, kanë dëmtuar rëndë edhe peizazhin natyror.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar do të orientojë përdorimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve dhe potencialeve të Shqipërisë. Brenda këtij kuadri do të ketë një vëmendje të veçantë për rivlerësimin e aseteve të trashëgimisë kulturore dhe të burimeve natyrore.

Qëllimi i hartimit të një Plani të Përgjithshëm Kombëtar konsiston në krijimin e platformës drejtuese dhe të garancisë ligjore të nevojshme për një zhvillim të qëndrueshëm urban, ekonomik, social e mjedisor në territor.

Qëllimet specifike strategjike që synon të përmbushë Plani i Përgjithshëm Kombëtar, bazuar edhe në parimet e Ligjit të PT-së, janë:

- të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore,
- të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe
- interesave publike e private,
- të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit,
- të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjislacionin,
- të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë,
- të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit, të hartojnë e të përditësojnë rregullisht instrumente të planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale,
- të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit,
- të garantojë, sipas legjislacionit për ndërtimin, zbatimin e rregullave të sigurisë së ndërtimeve dhe të punimeve të ndërtimit për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Bazuar në draft Planin e Përgjithshëm Kombëtar të publikuar nga AKPT dhe MZHU disa nga direktivat kryesore të cilat rrjedhin për PPV e Bashkisë Korçë janë:

RAJONALIZIMI - Një nga kerkesat që ploteson Plani i Përgjithshëm Kombëtar është krijimi i bazave për zhvillim rajonal.


Tre janë tipet e Rajoneve të përcaktuara nga PPK:

- RAJONE NDËRKUFITARE
- RAJONE EKONOMIKE KOMBËTARE
- RAJONE TË SPECIALIZUARA

RAJONET NDËRKUFITARE burojnë drejtpërdrejt nga Programet IPA Crossborder (Vetëm për periudhën 2014-2020 Shqipëria do të sigurojë një mbështetje financiare prej 75 milion eurosh.)

Shqipëri – Greqi (Fondi IPA 42.312.029€) përfshin: *Rajonin Korçë – Selanik, Rajonin Gjirokastrë – Janinë, Rajonin Sarandë – Korfuz*

RAJONI KORÇË - SELANIK, ka bashkëpunim ekonomik, potencial për zhvillimin dhe nxitjen e bashkëpunimit në sektorin e turizmit, bujqësisë dhe të energjitikës.




Rajonet nderkufitare (Burimi PPK)

RAJONET EKONOMIKE KOMBËTARE: aktualisht si një rajon i tillë i mirëfilltë performon vetëm rajoni ekonomik Tiranë Durrës, por Plani Kombëtar deri në 2030 mundëson fuqizimin edhe të 6 rajoneve të tjera me rëndësi kombëtare.

Rajoni Ekonomik Elbasan - Pogradec - Korçë me avantazhe të larta për lidhje me rajonin Durrës-Tirane duke formuar një zinxhir të rajoneve ekonomike.

Profili këtij rajoni: Tregëti (shkëmbim & përpunim) – Energji – Turizëm – Bujqësi
Zhvillimet Strategjike:

1. Zona Kavajë – Rogozhinë, si nyje logjistike
2. Elbasani si qendër primare, qendër logjistike, qendër kërkimi e inovacioni në fushën e energjisë, industrisë, transportit.
- 3. Korca, qendër primare, turistike, bujqësore por edhe energjitike.**
4. Pogradeci qendër e specializuar, turizëm liqenor, natyror -bujqësi.



Rajonet motorike (Burimi PPK)

SISTEMI INFRASTRUKTUROR

Objektivi: Integrimi hapësor, rritja e aksesueshmërisë së vendit dhe shpërndarje e balancuar e flukseve.

Politikat: Organizimi i territorit në sistemin e hierarkizimit të qendrave urbane dhe zhvillimi i korridoreve të integruara të flukseve të infrastrukturës.

TRANSPORTI

Objektivi: Multimodal dhe miqësor ndaj ambientit konkurrues

Politika: Krijimi dhe konsolidimi i një sistemi të integruar multimodal mbarë Kombëtar, rritje dhe konsolidim i pikave të aksesit dhe të lidhjes së territorit.

Në sistemin e infrastrukturës së transportit, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Një sistem i integruar multimodal mbarë kombëtar
- Dy aeroporte të reja në Kukës dhe Delvinë
- Tre Stacione Intermodale Kombëtare në Fier, Elbasan, Berat, të cilat do të përmbushin nevojat e brendshme të lëvizjes dhe shkëmbimit të modaliteve të transportit.
- Pesë korridoret strategjike: Korridori i Gjelbër veri-jug, Korridori BluVeri-Jug, Korridori 8 Rruga e Arbrit, Korridori 10 segmenti Durrës- Kukës- Morinë, Boshti Qendror Jugor do të jenë të përfunduar dhe rehabilituar brenda vitit 2020 me sinjalistikë dhe masa mbrojtëse për uljen e numrit të aksidenteve.
- Gjashtë % do të rritet kontributi i sektorit të transportit në rritjen reale të PBB, brenda vitit 2030, me kompletimin e rrjetit rrugor kombëtar, i cili është tërësisht i përfshirë në Rrjetin Core (SETTO).

ENERGJIA

Objektivi: Zhvillimi i një rrjeti eficient energjistik

Politika: Diversifikimi drejt energjise së rinovueshme

Në sistemin e infrastrukturës energjitike, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

4 Korridore energjetike: TAP – IAP – WBR – Kosovë do të mundësojnë integrimin e sistemit energjistik të Shqipërisë në infrastrukturën energjitike të Ballkanit Perëndimor dhe Europës. Shqipëria përbën një korridor të rëndësishëm që lidh Greqinë me vendet e Bashkimit European dhe Kroacinë. Ky korridor siguron një mundësi për lidhje energjetike nëndetare mes

2.2.2. Plan i Integruar Ndërsektorial për bregdetin (PINS)

Pozicioni gjeografik i Shqipërisë në Basenin e Mesdheut dhe hapësira e gjerë në Detin Adriatik dhe Jon, ka krijuar mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit në Shqipëri. Ekosistemet tokësore dhe detare të Shqipërisë janë pjesë e zinxhirit mesdhetar dhe ballkanik të ekosistemeve natyrore. Pavarësisht kësaj, brezi bregdetar përbën terrenin më vulnerabël përsa i përket presionit që ushtrohet nga zhvillimim dhe si rrjedhojë menaxhimi i kësaj zone ngelet akoma një sfidë për

vendin tonë. Ndër problemet që kanë shkaktuar një zhvillim jo të qëndrueshëm dhe në disa raste kaotik mund të përmendim: strukturat e dobëta administrative, mungesa e politikave integruese, mungesa e burimeve financiare, zhvillimet e ndjeshme sociale e ekonomike gjatë periudhës së tranzicionit, lëvizja demografike, zënia e pakontrolluar e territorit, urbanizim pjesërisht i planifikuar dhe në disa zona kaotik dhe informal.

Problem madhor ka qënë se për këtë hapsirë kaq strategjike nuk ka ekzistuar një Plan i Integruar Ndërsektorial për bregdetin (PINS) që të shërbejë si sistem rregullues për të siguruar standarte në planifikim dhe garantimin e instrumentave që mundësojnë shërbime cilësore turistike. Këto mungesa kanë rënduar situatën në terren, duke degraduar panoramën e bregdetit me ndërtime të realizuara në mungesë të një planifikimi kombëtar e ndërsektorial. Mungesa e një PIS për bregdetin ka shkaktuar edhe parcelizimin e planifikimit, aty ku kompetencat dhe juridiksionet territoriale ndahen. Për më tepër të gjitha planet vendore dhe ato rajonale (të pakta në numër), si dhe zhvillimet deri më sot, janë jetësuar pa rakorduar një vision të qartë rajonal, e aq më pak kombëtar. Ndaj, hartimi i PIS është një nevojë urgjente për të ndaluar përkeqësimin e situatës në territorin e bregdetit dhe jo vetëm.

Vizioni që do të përcaktojë Plani i Integruar Ndërsektorial për bregdetin (PINS), do të vendosë një raport të drejtë dhe ekuilibra mes objektivave të zhvillimit sipas këndvështrimit të politikave të qeverisë, të drejtës për zhvillim dhe burimeve natyrore në territor. Ky proces do të ketë në fokus ndryshimin e gjendjes aktuale në zonën e bregdetit, duke ligjëruar e zbatuar një vision të ri, nëpërmjet aplikimit të instrumentave ligjore dhe urbane, që do të realizojnë sfidat, duke miradministruar potencialet e vendit dhe duke i dhënë hov të madh e cilësor zhvillimit të turizmit.

Në përputhje me objektivat dhe parimet e përcaktuara, palët e përfshira në proces do të përpiqen për të siguruar përdorimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare, në mënyrë që të ruajnë habitatet natyrore bregdetare, peisazhet, burimet natyrore dhe ekosistemet, në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe normat ligjore, duke:

- Identifikuar dhe eliminuar kufinj të jashtë zonave të mbrojtura dhe zonave të hapura
- Kufizuar shtrirjen lineare të zhvillimit urban dhe krijuar infrastrukturën e transportit përgjatë bregdetit
- Siguruar se problematikat mjedisore janë të integruara në rregullat për menaxhimin dhe përdorimin e domenit detar publik
- Siguruar për lirinë e aksesit të publikut në det dhe përgjatë bregut
- Kufizuar, ose kur është e nevojshme, duke ndaluar lëvizjen dhe parkimin e mjeteve tokësore, si dhe lëvizjen dhe ankorimin e anijeve detare në gjire të brishta natyrore.

2.2.3. Plani Tiranë-Durrës

Plani Tiranë-Durrës është pjesë integrale e Planit të Përgjithshëm Kombëtar. Tirana dhe Durrësi janë qytete që kanë patur një zgjerim në shtrirjen e tyre dhe tendenca është që këto qytete të takohen. Zona ndërmjet është një nga zonat që ka patur një zhvillim të vullshëm formal dhe krysisht informal. Zhvillimet kaotike dhe pa vizion kanë dëmtuar rëndë peisazhin natyror, prandaj lind nevoja për një plan të integruar dhe me një vizion të qartë.

Plani Tiranë-Durrës do të orientojë përdorimin dhe shfrytëzimin e kësaj zone si dhe do të krijojë infrastrukturën e përshtatshme për një zhvillim të qëndrueshëm. Qëllimet që synon të përmbushë Plani Tiranë-Durrës janë:

- të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore,
- të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e private,
- të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit,
- të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjislacionin,
- të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.

2.2.4. Legjislacion dhe dokumenta strategjik në nivel kombëtar

Një përmbledhje paraprake e dokumenteve strategjike është listuar në tabelën e mëposhtme, por duhet sqaruar se ky listim nuk është shterues pasi duhet të merren në konsideratë të gjitha strategjitë që janë në proces hartimi/draftimi dhe ende nuk janë miratuar nga organet kompetente (kjo për shkak se shumica e strategjive kombëtare kanë afat të përcaktuar deri në fund të vitit 2013):

Nr.	Akti miratues	Titulli i Strategjisë	Objekti/ qëllimi i strategjisë
1	VKM nr. 405, datë 27.6.2012	Strategjia ndërsektorale reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020	Trajton zgjidhjen e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave; integrimin e zonave dhe ndërtimeve informale të legalizuara; përfundimi i regjistrimit fillestar të të gjitha pasurive; digjitalizimi i sistemeve.
2	VKM Nr.797, datë 14.11.2007	Strategjia ndërsektorale për mbrojtjen e konsumatorëve	Të mbrojë interesat ekonomike të konsumatorëve dhe vetë konsumatorët

		dhe mbikëqyrjen e tregut	për ushqimet, produkte joushqimore dhe farmaceutikën/medikamente.
3	VKM Nr.773, datë.14.11.2007	Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rajonal	Të sigurojë që të gjitha qarqet të jenë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin dhe konkurrencën e qëndrueshme – dhe në këtë mënyrë të reduktojnë pabarazitë sociale dhe ekonomike në të gjithë vendin.
4	VKM Nr.1561, datë 3.10.2008	Strategjia ndërsektoriale e parandalimit, luftës kundër korrupsionit e qeverisjes transparente 2008-2013	Trajton reduktimin progresiv dhe të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimi i integritetit të institucioneve dhe promovimi i vlerave në qeverisje
5	Ligji Nr.9322, datë 25.11.2004	Strategjia e sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë	Trajton tërësinë e mjeteve dhe instrumenteve shtetërore që sigurojnë mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit shqiptar nga kërcënimet dhe rreziqet e jashtme e të brendshme.
6	VKM Nr. 658 , date 17.10.2005	Strategjia e shërbimeve shoqërore	Trajton situatën e nevojave shoqërore, nxit mirëqenien shoqërore dhe synon/lehtëson integrimin e familjeve që jetojnë në kushte varfërie, të grupeve vulnerabël dhe personave me nevoja të veçanta.
7	VKM Nr.643, datë 14.09.2011	Strategjia kombëtare sektoriale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve	Trajton hartimin e politikave të përshtatshme dhe angazhimin e fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e BE-së
8	VKM Nr.342, datë 12.3.2008	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013	Dokument i vetëm strategjik (axhenda) për zhvillim ekonomik e social të qëndrueshëm, të harmonizuar me axhendën e integritetit në BE dhe në strukturat e NATO-s, si dhe me atë të realizimit të Objektivave të Mijëvjeçarit.
9	VKM Nr.847,	Strategjia ndërsektoriale e	Trajtim modern dhe i integruar i sektorit

	datë 29.11.2007	mjedisit	mjedisor dhe i sektorëve të tjerë me ndikim të fortë në cilësinë e mjedisit si transporti, bujqësia, rregullimi i territorit etj.
10	VKM Nr. 751, datë 7.11.2007	Strategjia sektoriale e punësimit	Vendos bazat për përmirësimin e sistemit të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional, dhe zbatimit të programeve aktive dhe pasive të punësimit.
11	VKM Nr.924, datë 14.11.2007	Strategjia sektoriale e bujqësisë dhe e ushqimit	Orienton dhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe agropërpunimit
12	VKM Nr.774, datë 14.11.2007	Strategjia ndërsektoriale shqiptare e zhvillimit rural	Shërben si një bazë kombëtare, për zhvillim dhe më pas zbatimin e planeve për zhvillimin rural të rajoneve dhe nënrajoneve të Shqipërisë për të stimuluar qëndrimin dhe rikthimin e banorëve në zonat rurale.
13	VKM Nr.519, datë 20.7.2011	Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë	Trajton përsosjen e sistemit të drejtësisë në RSH, rritjen e aksesit në drejtësi, rritjen e besimit të publikut në drejtësinë shqiptare paralelisht me forcimin dhe rritjen e kontributit të këtij sektori në zhvillimin e shoqërisë shqiptare, si dhe nxitjen e përshejtimin e integritimit europian.
14	VKM Nr.80, datë 28.01.2008	Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale	Trajton orientimin e politikave horizontale për reduktimin e varfërisë dhe luftën kundër përjashtimit social.
15	VKM Nr.844, datë 11.06.2008	Strategjia sektoriale e turizmit 2007 - 2013	Merret me strukturimin dhe zhvillimin e turizmit dhe produkteve të tij si prioritet afatshkurtra dhe afatmesme.
16	VKM Nr.59, datë 21.01.2009	Strategjia ndërsektoriale e shoqërisë së informacionit	Progresin e Shqipërisë drejt një ekonomie të bazuar në njohuritë, përmes një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit që do të çojë në një shoqëri ku të gjithë qytetarët

			përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike.
17	VKM Nr.760, datë 01.09.2010	Strategjia për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	Garantimi dhe zhvillimi i një sistemi bashkëkohor të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri, në funksion të konsolidimit të një sistemi social ekonomik konkurrues me të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët shqiptarë, në përputhje me të gjitha kërkesat e detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritit të Shqipërisë në BE.
18	VKM Nr.863, datë 29.07.2009	Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009– 2015	Përqendrimin e burimeve financiare në grupe kryesore kërkuesish të aftë, për të arritur një nivel ndërkombëtar njohjeje dhe ekselence.
19		Strategjia Kombëtare e Energjisë	Zhvillimi i një sektori energjetik efektiv që garanton sigurinë e furnizimit me burime energjetike në përgjithësi dhe energji elektrike në veçanti, dhe nxit përdorimin eficient, ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis, në mënyrë të tillë që sektori energjetik të jetë një sektor mbështetës për një zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë sektorëve ekonomik dhe shoqëror.
20	VKM Nr.175, datë 19.1.2011	Strategjia kombëtare shqiptare mbi mbetjet	Zhvillimin e qëndrueshëm të vendit duke mbrojtur sa më shumë të jetë e mundur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi dhe duke promovuar vlerat mjedisore
21	VKM Nr.479, datë 29.6.2011	Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë 2010- 2025	Përcakton politikat dhe programet e veprimit të menaxhimit të burimeve minerare ekzistuese, si dhe zhvillimin e

			<p>tyre në perspektivë në përputhje me zhvillimet e reja të ekonomisë shqiptare, prioritetet e zhvillimit të kësaj industrie, me objektivat afatgjatë, objektivat afatmesëm dhe imediatë, vlerësimin e potencialit mineral sipas grup-mineraleve, bazë për vendimmarrjen, planifikimin territorial, zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe infrastrukturës, luftës kundër varfërisë, sidomos në zonat rurale, punësimin në vijimësi, përmirësimin e bilancit valutor të vendit, transparencës dhe luftën ndaj korrupsionit, ka si vizion të saj një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, duke marrë parasysh impaktet ekonomike, mjedisore dhe sociale, bazuar mbi parimet e ndarjes së të ardhurave midis të gjitha niveleve të qeverisjes, kompanive dhe komuniteteve konkurruese për tërheqjen e investitorëve dhe balancuese midis së drejtës së licencës minerare dhe taksimit të industrive përgjatë zinxhirit të vlerës.</p>
22	VKM Nr. 395, datë 21.6.2006	Strategjia dhe plani i veprimit për zhvillimin e turizmit kulturor dhe mjedisor	Perceptimin e Shqipërisë si destinacion i pasur kulturor dhe natyror (imazhi) dhe vlerësimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore shqiptare, kuptimi i vlerave nga industria turistike dhe komuniteti i gjerë
23	Ligji Nr. 9419, datë 20.5.2005	Strategjia ushtarake e Republikës së Shqipërisë	Vlerëson mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë, përparimet e bëra në transformimin dhe ristrukturimin.
24	VKM Nr.1214, datë 3.9.2008	Strategjia sektoriale e transportit	Zhvillimin e transportit rrugor në Shqipëri
25	Vendim i KKT	Planit Kombëtar Sektorial	Qëllimi i këtij dokumenti është të

	Nr. 1, datë 04.07.2013	për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)	reflektojë çështjet strategjike, social-ekonomike, mjedisore dhe territoriale që shoqërojnë procesin e planifikimit territorial të projektit TAP në territorin Shqiptar. Planifikimi i territorit është një kërkesë ligjore dhe një domosdoshmëri për zhvillimin e projektit; shtrirja në hapësirë e projektit TAP do të integrohet brenda planeve rajonale të zhvillimit dhe do të jetë pjesë e këtyre planifikimeve të territorit. Në datë 20 dhjetor 2012, Këshilli Kombëtar i Territorit, me iniciativën e AKPT dhe në përputhje me propozimin e METE-s, vendosi ta përcaktojë projektin TAP si një çështje me te rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit.
--	---------------------------	---	---

2.2.5. Çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare

Dokumentet që përcaktojnë zonat e rëndësisë kombëtare, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 16, të Ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, janë si më poshtë:


1. Vendimi nr. 2 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 20.12.2012, “Përcaktimi i projektit të Gazsjellësit Trans – Adriatik (TAP) si çështje e rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit”, i cili në pikën 2 vendos “Shpalljen “zonë kombëtare” të korridorit me gjerësi 500m të Projektit TAP [...]”
2. Vendimi nr. 5 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 18.10.2013, “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike”
3. Vendimi nr. 1 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 09.09.2015, “Përcaktimi si Zona të Rëndësisë Kombëtare në Planifikim, të 64 zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturës, të shpallura me urdhër të Ministrit të Kulturës, pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve për periudhën 2014-2015”. Në këtë listë përfshihet edhe “Banesa e Vangjush Mios”, monument kulture i kategorisë së I-rë.

Rregulloret për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore

Zhillimi i qendrës tradicionale të Korçës është rregulluar me anë të Vendimit 455/2005 “Rregullorja për Administrimin e Qendrës Historike dhe Urbane, Ansambli Arkitektural dhe Tradicional i Qytetit të Korçës”, në të cilin përcaktohen dy kategori mbrojtjeje:

Qendra Historike është një zonë absolutisht e mbrojtur që përfshin: Pazarin, pjesën e zonës përgjatë Bulevardit Republika, dhe disa grupime qendrash tradicionale. Ky vendim ngarkon Institutin e Monumenteve të Kulturës (IMK) të realizojë të gjithë projektet e restaurimit brenda Zonës Historike.

Ansambli Tradicional & Arkitektural Urban është një zonë me mbrojtje relative që përfshin pjesën e mbetur të qendrës tradicionale të qytetit; i njohur ndryshe si zonat e lagjeve rezidenciale të shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të. Për më tepër Vendimi i viti 2005 përfshin kategorizimin e Monumenteve të kategorisë së parë dhe të dytë dhe ndërhyrjet e lejuara, të vendosura nga Ligji mbi trashëgiminë Kulturore të vitit 2003.



Përcaktimi i zonës së trashëgimisë kulturore dhe kufijve të qendrës së qytetit të Korçës

Statusi Ligjor i kufijve të qendrës së qytetit të Korçës

Kufijtë e qendrës së qytetit u përcaktuan nga Vendimi 1 i 2003 “Për detyrimin e hartimit të Studimit Urban të qendrës së qytetit të Korçës”. Bazuar në këtë vendim e Bashkia ka patur mandatin që të përgatisë një plan të detajuar për këtë zonë. Kur VKM 238/2011 “ Per Shpalljen e Qendres Historike të Qytetit te Korces dhe Miratimin e Rregullores per administrimin e saj”.

2.3. Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë

Dokumentat e planifikimit të hartuara më parë për qytetin e Korçës dhe ish-komunat që i janë bashkuar, që analizohen në këtë pjesë janë dy planet e fundit të Korçës që kanë ndikuar më shumë në transformimin e zonës urbane: Plani Rregullues i Përgjithshëm i vitit 1994 dhe Plani i Përgjithshëm Vendor i vitit 2014, ende në fuqi, gjithashtu Plani Rregullues i Përgjithshëm i Komunës Voskopojë i miratuar në vitin 2007.

2.3.1 Plani Rregullues i Përgjithshëm i vitit 1994

Në historikun e zhvillimeve urbane në Shqipëri pas periudhës 1944 - 1990 të Shtetit Socialist, ku çdo gjë ishte e "shtetit" dhe çdo gjë e vendoste "shteti", dominonte stili i arkitekturës dhe urbanistikës sovietiko-lindore, në atë kohë datojnë dhe iniciativat e pajisjes së qyteteve dhe fshatrave me Plane Rregulluese të Përgjithshme. Pas viteve '90 ndryshimet politiko-ekonomiko-sociale, u pasqyruan në territor në trajtën e urbanizimit të pakontrolluar, në zaptimin e hapësirave publike, në ndërtime shumëkatëshe me dendësi të lartë në qendrat e qyteteve dhe informale në periferi. Në vitin 1993 miratohet Ligji 7693 "Për Urbanistikën", ku përcaktoheshin rregullat e përgjithshme të vendosjes dhe arkitekturës së objekteve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç tokave bujqësore. Në këtë periudhë daton dhe Plani Rregullues i Përgjithshëm i qytetit të Korçës nisi hartimin në vitin 1991 dhe u miratua zyrtarisht në vitin 1994. Ky dokument parashikonte zhvillimin vetëm për qytetin e Korçës dhe u referohej instrumentave ligjor të kohës së Regjimit Socialist, prandaj dhe ndiqte kriteret për rregullimin e një qyteti socialist në kuadrin e një ekonomie të planifikuar të centralizuar.

Versioni i parë i PRRP i vitit 1991 përfshinte analizat e përdorimit të tokave, zgjerimin historik, lartësitë e godinave, densitetin e popullsisë, kategorizimin e rrjetit rrugor, infrastrukturën urbane, si edhe hartat sizmiologjike, hidrologjike dhe gjeologjike. 'Vija e verdhë' e Korçës ishte dizenuar si një vijë abstrakte ekliptike përreth qytetit. Versioni përfundimtar i modifikuar fare pak u miratua në vitin 1994 ka qënë në fuqi deri vonë në lidhje me përdorimin e hapësirave dhe çështjet e dhënies së lejeve për ndërtim, edhe pse jetëgjatësia e këtij dokumenti referuar legjislacionit të atëhershëm ishte 10-15 vjet. Rekomandimet e këtij plani në një shkallë të gjerë korrespondojnë me gjendjen aktuale të ndërtimit brenda në qytet, edhe pse një pjesë e mirë e infrastrukturave që parashoikoheshin si: stacioni hekurudhor dhe disa akse rrugore nuk u realizuar asnjëherë. Për vet periudhën e ndryshimeve të rëndësishme në sistemin politik e social të vendit në periudhën e zbatimit të këtij plani, dhe mungesën e instrumenteve ligjore, duke mos marrë parasysh aspak ndryshimet e rëndësishme që po ndodhnin në atë periudhë në territor, dhe për më tepër duke injoruar fenomenin e ndërtimeve informale, dhe të problemeve që ekzistonin me ndryshimet e sistemit të pronësisë nga shtetërore në private, PRRP_1994 ju nënshtrua disa modifikimeve të rëndësishme, të cilat u referohen tre zonave ish-industriale që ndryshuan destinacion duke u transformuar në zona rezidenciale miks, një tjetër transformim ju bë një zonë rezidenciale që u

transformua në zonë rekreative, dhe modifikimi i fundit i takon zgjerimit të territorit të varrezave publike.

2.3.2. Plani i Përgjithshëm Vendor i vitit 2014 (PPV_2014)

Para ndryshimeve të ndodhura nga reforma administrativo-territoriale, nga njësitë vendore që sot përbjënë Bashkinë Korçë, që kanë patur një instrument planifikimi kanë qënë: Bashkia Korçë – një plan i hartuar nga TP DEVELOPMENT GROUP në kuadrin e projektit LAMP të Bankës Botërore dhe i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit, dhe Bashkia Voskopojë.

Plani i Përgjithshëm Vendor i miratuar me Vendimin nr.13 datë 07.03.2014 nga KKT, analizonte territorin e qytetit të Korçës, një sipërfaqe prej 2143 ha, me një popullësi prej 89.000 banorësh. Në propozimet e këtij plani territori i qytetit është ndarë në 16 njësi strukturore, dhe 75 nën-njësi, për të cilat janë përcatuar treguesit e zhvillimit, mbi bazën e konceptit të zhvillimit hapësinor të parashikuar. Ky plan është hartuar bazuar në Vizionin, Qëllimet dhe Objektivat e qytetit dhe përmban një Plan Hapësinor Struktural dhe një Plan Strategjik Investimesh Infrastrukturore. Gjithashtu, si pjesë e PPV-së është miratuar Plani i Përdorimit të Tokës dhe Rregullorja Vendore e Planifikimit.




Figure 1 - Skema e popozimit të zhvillimit sipas PPV së Bashkise Korçës


Në mënyrë të përmblendhur ky koncept mund të skematizohet në tre elementë:

Tre Unazat Koncentrike: Unaza e parë përbëhet nga baza historike e qytetit të shekullit të XIX, të zhvilluar në rrzë të Malit të Moravës, e cila është një zonë shumë e rëndësishme për identitetin e

qytetit dhe, si rezultat, duhet të konservohet dhe të rikualifikohet/përforcohet me aktivitete të reja të prezantuara në strukturat ekzistuese dhe në strukturat e reja, duke u harmonizuar me karakterin arkitekturor të zonës. Unaza e dytë është qyteti i shekullit të XX, i cili mban ende gjurmët e epokës socialiste dhe përfshihet brenda kufijve të unazës ekzistuese. Ndërhyrjet e planifikimit në këtë zonë duhet të synohen të arrijnë rigjenerimin dhe rizhvillimin e saj. Së fundmi, unaza e tretë formohet nga unaza e re e jashtme e propozuar, që përbën dhe kufirin e ri afatgjatë të zhvillimit. Kjo zonë duhet të zhvillohet si një zonë shumëfunktionale me zhvillim rezidencial të hapësirave të gjelbra të organizuar në sektorë të pavarur duke përfshirë grupe ekzistuese informale dhe të ndarë në përdorime të tjera, të tilla si zonat industriale ose infrastruktura sociale me shkallë të gjerë dhe në nivel qyteti. Zhvillimi duhet të kryhet sipas një plani të detajuar, ndërsa përparësitë duhet të përcaktohen sipas kërkesës ekzistuese.

Tre Akset e Zhvillimit: Aksi i parë i zhvillimit shpalohep përgjatë hyrjes kryesore në qytet kur vjen nga Tirana dhe karakterizohet nga aktivitete me ndikim të ulët, aktivitete të shitjes me shumicë dhe aktivitete ekonomike/tregtare mikse që përshkojnë të gjithë qytetin për të arritur në qendër të qytetit. Aksi i dytë formohet përgjatë hyrjes në qytet nga Bilishti dhe Kapshtica dhe do të mirëpresë aktivitete ekonomike/tregtare me ndikim produktiv të ulët dhe mikse. Një aks i tretë zhvillimi del nga Qendra e Qytetit përgjatë rrugës që të çon në hyrje të qytetit kur vjen nga Erseka dhe pritët të ketë një karakter më pak intensiv rezidencial dhe tregtar.

Tre Korridoret e Gjelbra: Korridori i parë përcaktohet nga Kodrat e Moravës në vendin ku gjendet Monumenti i Varrezave të Dëshmorëve, i cili futet në qytetin historik nga lindja. Korridori i dytë përcaktohet nga Parku Rinia, i cili vijon në zonën universitare dhe vijon më tej. Së fundmi, do të zhvillohet një aks i tretë i gjelbër rigjenerimi në drejtimin nga pazari në vend depozitimin aktual të mbetjeve, i cili duhet të rehabilitohet e të kthehet në një zonë çlodhëse.



Koncepti i zhvillimit hapësinor të PPV së Qytetit të Korçës

Një pjesë e rëndësishme e dokumentit të planit që vlen të merret në konsideratë është Plani Strategjik i Investimeve në Infrastrukturë, i cili nxit projektet e investimit me përparësi të lartë, si më poshtë:

Rehabilitimi i rrugëve - Pjesa më e madhe e rrugëve rajonale, kryesore dhe dytësore të qytetit janë në kushte relativisht të mira, por kanë nevojë për përmirësime të zakonshme. Me ndryshimet territoriale vlen të rishikohen këto propozitete duke ndërmarrë dy skenarë kryesor: Rigjenerimin e rrugëve në zonat urbane, si dhe plotësimin e infrastrukturave lidhëse të qendrave të fshtarave me qendrën e bashkisë. Duke ndjekur përpjekjet e bashkisë gjatë viteve të fundit, pritet të përfundohen hapat e mëposhtme nëpërmjet programit për **“Rigjenerimin e Rrugëve dhe të Hapësirave”**:

- Asfaltimi i rrugëve të dëmtuara/të paasfaltuara
- Restaurimi i rrugëve me kalldrëme
- Rigjenerimi i bulevardëve urbane
- Masa për qarkullimin e trafikut dhe sigurinë në rrugë (përmirësimi i kryqëzimeve, sinjalistikës rrugore)
- Përmirësime të trotuareve

- Përmirësim të aksesit të njerëzve me aftësi të kufizuara


Master plani i transportit – Korça, që tani ka probleme të dukshme me qarkullimin për shkak të transportit të pakontrolluar dhe të planifikuar të viteve të fundit. Kjo situatë ka të ngjarë të përkeqësohet më tej për shkak të rritjes së parashikuar të automjeteve. Është e qartë se sistemi i transportit të qytetit aktualisht është larg të qenit i përgatitur për të trajtuar zhvillimin dhe rritjen e pritur, si rezultat Master Planit i Transportit për Korçën do të duhet të:

- Krijojë një hierarki rrugësh (me ngarkesa të shoqëruara të trafikut dhe me karakteristikat fizike)
- Riforcojë sistemin e transportit publik
- Ofrojë mjete alternative dhe plotësuese për të udhëtuar rreth qytetit (korsi për biçikleta dhe për këmbësorë)
- Zhvillojë rrugë të reja dhe rrugë aksesi
- Krijojë zona këmbësorësh

Master plani i transportit duhet të marrë parasysh zhvillimin e rrugëve, transportin publik dhe parkimin; si dhe të sigurojë më shumë lidhje ndërmjet lagjeve; të rrisë aksesueshmërinë nga të gjithë. Për më tepër, duhet të nxis modelet alternative të transportit dhe të theksojë nocione specifike për transportin publik. Plani ka propozuar zhvillimin e një sistemi rrugësh këmbësorësh dhe biçikletash që duhet të përdorin topografinë e sheshtë të qytetit dhe traditën urbane të përdorimit të biçikletave. Rrjetet e këmbësorëve dhe të biçikletave synojnë të çojnë në ulje të varësisë nga makinat dhe në ulje të nivelit të ndotjes, e nga ana tjetër të sjellin një ndikim shumë pozitiv mbi shëndetin dhe cilësinë e jetës publike.

Zhvillimi i unazës së jashtme - Plani i miratuar në fuqi, ka parashikuar shtrirje të qytetit përtej kufirit të zhvillimit të unazës ekzistuese dhe shtimin e aktiviteteve të reja rezidenciale dhe ekonomike. Kjo gjë ka sjell nevojën e specifikimit të një kufiri të ri zhvillimi urban në kohën e miratimit të Planit në vitin 2014, çka me ndryshimet territoriale administrative nuk është më e nevojshme, pasi territori i atërshtëm ku kjo unazë propozohet tashmë është pjesë e bashkisë Korçë. Kjo unazë e jashtme ka qenë e pranishme që në Planin Rregullues të vitit 1994, dhe synon të përmirësojë ndjeshëm aksesin dhe qarkullimin brenda dhe rreth qytetit dhe mbështet zhvillimin e zonave të reja ekonomike, krijuese dhe të banimit, në përputhje me parimet e një planifikimi të qëndrueshëm. Gjithashtu i shërben dhe trafikut drejt dhe nga qytete të tjera (në drejtimet Tiranë-Ersekë dhe Bilisht-Ersekë) duke lehtësuar ngarkesat e trafikut brenda qytetit dhe në veçanti përgjatë unazës së brendshme.

Gjithësesi, sygjerohet të rishikohet ky element me shtrirjen e re territoriale, pasi do të jetë e nevojshme ridimensionimi i këtij aksi, si dhe i nyjeve lidhëse me akset që shkarkojnë nga zonat rurale.



Rrjeti i sipërfaqeve të hapura - Plani bën thirrje për zhvillimin e një rrjeti të integruar hapësire të hapur që i referohet të gjithë qytetit. Hapësirat e konsiderueshme të gjelbra të qytetit, të tilla si kodrat e Moravës, kompleksi sportiv “Skënderbeu”, parku “Rinia” krijojnë një tërësi të vazhdueshme natyrore dhe mjedisore. Plani synon të rrisë në maksimum aksesin në hapësirat e mëdha të gjelbra, duke ofruar një gamë të gjerë korridoresh të gjelbra dhe duke nxitur zonat për biçikletat dhe këmbësorët. Për më tepër, sipërfaqet e hapura në nivel lagjeje do të duhet të rehabilitohen si kopshte xhepa në zonat e banimit të periferi të qytetit dhe në komplekset kolektive të banimit. Ndikimi i pritshëm do të jetë rigjenerimi i mjedisit urban dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe i mikroklimës.

Më konkretisht në plan përfshihen:

- Krijimi i një rrjeti të integruar të sipërfaqeve të hapura brenda qytetit, duke përfshirë kodrat, parkun Rinia, Kompleksin Sportiv “Skënderbeu”.
- Rigjenerimi i kompleksit sportiv ekzistues si një park urban i gjallë dhe publik duke i kushtuar rëndësi sportive dhe aktiviteteve rekreative.
- Vijimin e programit bashkiak “Për rigjenerimin e rrugëve dhe sipërfaqeve të hapura”.

- Krijimin e parkut “Shetro Park”, duke e konsideruar atë si pikë kryesore kreative dhe kalimi kohe të lirë.
- Rritje e mbjelljes së pemëve përgjatë rrugëve të qytetit (duke i kushtuar rëndësi pemëve që rriten shpejt).
- Rehabilitimi i hapësirave të gjelbra të vogla (kopshtet xhepa).

Në kuadrin e ndryshmeve territoriale, vlen të rimerret në shqyrtim shfrytëzimi i parqeve natyrorë si: Parku Kombëtar i Liqenit të Prespës dhe Parku i Drenovës, duke ndërtuar intenerarë natyror turistik përgjatë gjithë vitit.

Rehabilitimi i vend depozitimit të mbetjeve - Vend depozitimi aktual i mbetjeve shtrihet në jugperëndim të qytetit dhe ka 20 vjet që përdoret, pavarësisht nga fakti që nën të shtrihet rezervuari i basenit ujqor. Vend depozitimi i mbetjeve paraqet një kërcënim të madh për ndotjen ujqore, gjë që përbën rrezik mjedisor dhe shëndetësor. Aktualisht po punohet për një projekt për heqjen e vend depozitimit dhe ndërtimit të një vend depozitimi rajonal mbetjesh në Maliq. Plani mbështet mbylljen e vend depozitimit aktual të mbetjeve dhe rehabilitim e tij në mënyrë që ky vend të transformohet në një **Park të Gjelbër dhe Kreativ** për qytetin. Kjo do të jetë zona më e rëndësishme e gjelbër në jug të qytetit që do të ketë kapacitet të mikpresë sporte të ndryshme, aktivitete që ushtrohen gjatë kohës së lirë, aktivitete kulturore dhe rekreative. Objektivat e këtij projekti strategjik investimesh të integruara janë:

- Eliminimi i një rreziku të madh shëndetësor
- Mbrojtja e burimeve ujqore për gjeneratat e ardhshme
- Krijimi i një zone për aktivitete rekreative dhe të kalimit të kohës së lirë në nivel qyteti, e ku do të mund të vijnë dhe banorë nga zonat përreth.
- Ofrimi i një burimi potencial të ardhurash për bashkinë nga objekte të ndryshme (të tilla si parku për kalimin e kohës së lirë, park për kurs golfi, etj.)
- Të vepruarit si katalizator për rigjenerimin gradual dhe përmirësimin e sektorit juglindor të qytetit, i cili aktualisht paraqet probleme të ndryshme.
- Ofrimi i një lidhje të re në formën e një korridori të gjelbër, duke lidhur qendrën e qytetit me këtë destinacion të ri, me regjenerimin e lagjeve të ndërmjetme.
- Rehabilitimi i vend depozitimit do të kërkojë hapat e mëposhtme:
- Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM) për kontaminimin e zonës
- Planifikimin e detajuar fizik (mundësisht sipas studimit të Institutit Kombëtar të Monumenteve të Mjedisit)
- Rehabilitimin e vend depozitimit aktual dhe projektimin e peizazhit
- Zhvillimin e aktiviteteve rekreative, sportive, kulturore dhe çlodhëse
- Zhvillimin e një korridori të gjelbër që do të lidhë parkun rekreativ me qendrën e qytetit.

Promovimi i Kodrave të Moravës - Projekti për rehabilitimin e Kodrave të Moravës si zonë e gjelbër dhe krijimin e një **zone natyrore dhe çlodhëse** në nivel qyteti është një ndër projektet më të rëndësishme për qytetin e Korçës dhe ka si synim të:

- kthejë peizazhin natyror dhe imazhin shumë tërheqës nëpërmjet pyllëzimit të zonave të vazhdueshme dhe në veçanti të pjesëve më të dukshme të tij.
- sigurojë vijimin e kodrave në parkun "Rinia" dhe në zonën sportive të universitetit.
- përdorë potencialin e kodrave si element kryesor tërheqës për vizitorët për nxitjen e zhvillimit të turizmit.

Ripyllëzimi në rrëpirat e kodrave do të rrisë ndjeshëm cilësinë e peizazhit viziv të qytetit. Po ashtu, ai do të kontribuojë për uljen e kërcënimit të rrëshqitjeve të tokës dhe mungesës së stabilitetit të tokës. Parku natyror dhe i aktiviteteve do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e jetës për banorët dhe atraktivitetin e imazhit të qytetit.

Menaxhimi i hedhjes së mbetjeve - Menaxhimi i hedhjes së mbetjeve në Korçë mbetet i kufizuar dhe i pamjaftueshëm. Mbetjet spitalore hidhen pa u trajtuar siç duhet, gjë e cila mund të çojë në rreziqe sanitare (kullime të mbetjeve sanitare në tokë, në ujëra nëntokësore ose në atmosferë). Në mënyrë që të arrihet zhvillim i qëndrueshëm, Korça do të duhet të bëhet një qytet i pastër, i shëndetshëm dhe i sigurt, i cili garanton cilësinë e jetës për të gjithë banorët dhe mbron mjedisin e saj natyror. Si rezultat, zhvillimi i qytetit kërkon një sistem mbledhje dhe menaxhimi mbetjesh.

Komponentë të projektit përfshijnë:

- Zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës për sistemin e mbledhjes dhe menaxhimit të mbetjeve
- Planifikimin e integruar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në nivel rajonal; zbatimin e studimit rajonal të vitit 2005 duke i kushtuar përparësi trajtimit të mbetjeve mjekësore
- Rehabilitimin e vend depozitimit ekzistues dhe zhvillimin e një parku rekreativ në nivel qyteti (shih edhe projektin për rehabilitimin e vend depozitimit të mbetjeve)
- Krijimin e një programi bashkiak riciklimi dhe zhvillimin e një qendre përzgjedhje manuale
- Fushata dhe iniciativa pastrimi për pastrimin e qytetit nga mbeturinat
- Plan për menaxhimin e materialeve inerte
- Studim fizibiliteti për zhvillimin e qendrës së riciklimit

Sistemi i kullimit - Qyteti i Korçës aktualisht është i lidhur me një sistem të integruar ujërash të zeza dhe kullimi nëpërmjet tubacioneve të konsoliduara, pa pasur sistem veçmas për ujërat e zeza dhe veçmas për kullimin. Sistemi i integruar konsiderohet si problematik pasi kërkon mbingarkesë të panevojshme të rrjetit të kanalizimeve dhe të impiantit të trajtimit të ujërave të mbetura. Pra, Korça duhet të vijojë me ndarjen e sistemit të kanalizimeve nga sistemi i kullimeve, duke ndërtuar një sistem të ri kullimi nën tokë. Tipografia unike e Korçës do të jetë faktori përcaktues i sistemit të

kullimit të qytetit. Në zonat që gjenden në rrëpirat kodrinore (baza tradicionale), forca e gravitetit dhe rrëshqitja natyrore do të përdoren për kullim dhe për furnizim me ujë. Në zonat e sheshta të qytetit, në veçanti në zonat që identifikohen si të prekshme ndaj përmytjeve, infrastruktura e kullimit do të integrohet në sipërfaqen e tokës për të parandaluar përmytjet e zonave të sheshta. Për kullimin e Kodrave të Moravës, plani nxit rindërtimin dhe funksionimin duhur të kanalit ujëmbledhës të Gjançit për mbledhjen e ujit të mbetur që rrëshqet nga faqet e kodrave. Në periudhën afatshkurtër do të bëhet një lidhje me sistemin e kanalizimeve në parkun "Shetro" në mënyrë që të shmangen përmytjet.

Ndarja e sistemit të kullimit nga sistemi i ujërave të zeza do të çojë në ofrim më të mirë të shërbimeve si dhe në një organizim racional dhe të qëndrueshëm të ndërmarrjeve publike brenda qytetit.

2.3.3 Plani rregullues i përgjithshëm i fshatit Voskopojë

Voskopoja si qendër historike zhvillohet sipas një Plani Rregullues të miratuar nga KRRTRSh me Vendimin nr. 6, datë 21.07.2009, plan në të cilin janë miratuar zonat e ndërtimit, zonat e gjelbra, rrugët etj. Lidhur me këtë është hartuar një rregullore nga Instituti i Monumenteve të Kulturës për përcaktimin e ndërtimeve me gur, çatitë gri, rrugët me kalldrëm etj.

Nga viti 2000 e në vazhdim, Voskopoja për shkak të vlerave dhe statusit që mbart, është vënë në qendër të projekteve qeveritare dhe atyre të financuara nga Komuniteti Europian. Interes në këtë drejtim kanë paraqitur organizmat dhe shoqatat e huaja jofitimprurëse, që operojnë në qarkun e Korçës. Ajo është regjistruar nga UNESCO, si një nga trashëgimitë botërore në rrezik dhe si e tillë është vënë në qendër të programeve dhe projekteve për ruajtjen e vlerave që mbart. Në bashkëpunim edhe me shoqatën franceze "Patrimoine sans Frontieres" (*Trashëgimia pa kufi*), u restaurua kisha e Shën Thanasit dhe lidhur me këtë u botua vepra "Sikstina e Ballkanit". Konkretisht, njësi administrative Voskopojë ka zbatuar "Planin Strategjik të Zhvillimit të Komunës Voskopojë 2005-2010", zbatimi i të cilit solli ndryshime të dukshme në zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit. U ndërtua rruga nacionale Voskopojë-Voskop me impakt të dukshëm në rritjen e numrit të vizitorëve, u krye rrjeti i kanalizimeve të ujërave, u ndërtua rezervuari i Gjonomadhit që ndikoi në rritjen e sipërfaqes së ujitur, u mbollën pemëtore të reja dhe u përmirësua mekanizmi i farave etj.

Në planin strategjik "Për zhvillimin afatgjatë e të integruar të Komunës Voskopojë", përveç infrastrukturës dhe mjedisit një vend të rëndësishëm zë ndërhyrja për zhvillimin e kulturës së saj. Në zbatim të këtij plani në Voskopojë, me financim të Komisionit Europian u ndërmor një program mbështetës zhvillimi nga dy shoqata (*FERT & ADAD*) me drejtime prioritare bujqësinë, turizmin dhe vlerësimin e trashëgimisë (2008-2012). Në këtë vlerësim përveç kishave, programi konsistoi edhe në zhvillimin e vlerave artistike, artizanatit etj. Një grup i trajnuar artizanësh të punimeve të

dorës, të leshit në vegël, shtija, grep, i promovon këto vlera në shërbim të kërkesave turistike. Programi bëri të mundur gjithashtu, ngritjen e një qendre të informacionit turistik, dhe pajisjen e hapësirës turistike me sinjalistikën e nevojshme turistike. Në fushën e turizmit u bënë promovime të vlerave nëpërmjet prodhimit të guidave dhe materialeve të tjera promovuese si edhe u trajnuan grupet e interesit që ofrojnë turizmin familjar. Është rikthyer tradita e hershme e organizimit të panairit në festën e Shën Prodhomit në 24 Qershor, në të cilin promovohen gjithë produktet tradicionale të Voskopojës.

Nisur nga ecuria e dukshme e zhvillimit të territorit si hapësirë turistike, përmirësimet e bëra në jetën social-ekonomike të komunitetit, rritja e numrit të vizitorëve në zonë, potencialet natyrore dhe kulturore që mbart si dhe nga interesi i institucioneve brenda dhe jashtë vendit, qendrore dhe lokale, për të investuar projekte zhvillimi në Voskopojë, është hartuar Plani Strategjik i Zhvillimit të Territorit 2012-2020. Ky plan përfshin të gjithë sektorët e zhvillimit, infrastrukturën dhe planin urbanistik trashëgiminë historike dhe kulturore, duke evidentuar potencialet dhe gjendjen aktuale për çdo njërin prej tyre. Gjithashtu janë përcaktuar nivelet e ndërhyrjes dhe aktorët bashkëpunues si dhe rezultatet që priten.

Voskopoja është një rast konkret zhvillimi që e bën më se të domosdoshme nevojën e investimeve nga qeverisja qendrore, kryesisht në infrastrukturën rrugore, ndërkohë që në të, janë duke u zbatuar projekte të rregullimit të territorit të brendshëm të saj nga organizma të huaja. Pra për një zhvillim të qëndrueshëm të territorit të saj, detyrimisht është i rëndësishëm koordinimi i projekteve lokale me projekte qeveritare në zonë, gjithashtu vlerësimi i aseteve kulturore e turistike të kësaj zone në tërësinë e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë.

Studimet e mërrparshme për Voskopojën

Plani rregullues për Voskopojën, i vitit 1930, është aprovuar me vendimin e Këshillit Ministrave Nr.231, datë 25.04 1931, por që për shkak të ndryshimeve të shumta ka vetëm vlera historike. Në bazën hartografike që disponohet nga ky plan në Arkivin Teknik të Ndërtimit, bie në sy një sistem rrugor i dendur dhe gjerësia e rrugëve: më të ngushtat 8 dhe më të gjerat 10m.

Një studim urbanistik, hartuar para viteve '90, pjesërisht i zbatuar. Fleta e studimit nuk përmban vijë kufizuese ndërtimesh edhe pse emërtimi i saj është : "Plan rregullues". Banesat janë të gjitha individuale, 1 Kat Guri me sipërfaqe mesatare 102 m² dhe sipërfaqe parcele mesatare 265 m². Koeficienti i shfrytëzimit të territorit 0.38.

Master Plani i "Zonës me përparësi zhvillimin e turizmit Voskopojë" miratuar me Vendimin e KRrTRSh nr. 8, datë 7.05.2003. Gjatë hartimit të Planit Rregullues të Përgjithshëm janë respektuar kondicionet dhe drejtimet kryesore për zhvillim të dhëna nga ky Master Plan.

Vendimi nr.558, datë 1.8.2003 i Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e Voskopojës "Qendër historike" dhe vënien e saj në mbrojtje të shtetit".

Vendim i KM nr.673, datë 10.10.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.558, datë 1.8.2003 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e Voskopojës “Qendër historike” dhe vënien e saj në mbrojtje të shtetit”.

2.3.4. Vendime të KKT-së dhe KRrTRSh-së 1993-2015 për gjithë territorin e Bashkisë Korçë

Vendim KRRTRSH nr. 3, datë 04.02.1994 “Për planin rregullues dhe vijën kufizuese të qytetit të Korçës”. Sqarim: Në parim VI. Vija periferike të përfshijë fshatrat: Plasë, Malavec, Çiflik, Bulgarec, Fusha e Avionëve, Lumalas, Ravonik, Boboshticë, Drenovë, Mborje, Barç, Kreshpat e maleve, Moravë si dhe zona gjatë rrugës nacionale deri në Libonik.

Vendim KRRTRSH nr. 26, datë 01.12.1998 “Për shesh ndërtimi për vend depozitimi dhe trajtimi të mbeturinave të ngurta urbane për qytetin e Korçës”. Sqarim: Miraton sheshin e ndërtimit me sip. 5ha në Qafën e Qarrit

Vendim KRRTRSH nr. 1, datë 11.08.1999 “Për studimin urbanistik për zhvillimin dhe mbrojtjen e zonës me përparësi zhvillimi të turizmit në Dardhë – rrethi Korçë”

Vendim KRRTRSH nr. 2, datë 11.08.1999 “Për studimin urbanistik për zhvillimin dhe mbrojtjen e Parkut Kombëtar “Bredhi i Drenovës”, rrethi Korçë”

Vendim KRRTRSH nr. 2, datë 26.01.2001 “Për studimin urbanistik dhe sheshin e ndërtimit për fshatin e ri në territorin midis fshatit Dishnicë dhe fshatit Barç në qarkun e Korçës, për spostimin e familjeve që rrezikohen nga rrëshqitjet e tokës në komunën Lekas të këtij qarku”. Sqarim: Miratohet sip. 8.36ha

Vendim KRRTRSH nr. 1, datë 19.02.2003 “Për detyrën e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Korçës dhe vijës kufizuese të kësaj qendre”

Vendim KRRTRSH nr. 1 datë 17.04.2004 “Për miratimin e sheshit të ndërtimit për fushën e depozitimit të mbeturinave urbane të rajonit të Korçës”. Sqarim: Miratohet sheshi me sip. 22ha

Vendim KRRTRSH nr. 7, datë 18.12.2004 “Për pezullimin e vendimeve të KRRT të bashkisë Korçë në qendrën historike të qytetit të Korçës”. Sqarim: Vendos pezullimin e ekzekutimet të vendimeve të KRRT Korçë sipas Vendimit.

Vendim KRRTRSH nr. 13, datë 15.06.2005 “Për miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujrave të përdorura të qytetit të Korçës”. Sqarim: Miratohet sip. 13.5ha.

Vendim KRRTRSH nr. 14, datë 15.06.2005 “Për miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit për rrjetin e kanalizimeve në qytetin e Korçës”.

Vendim KRRTRSH nr. 3, datë 07.02.2006 “Për miratimin e studimit urbanistik pjesor, sheshit dhe lejes së ndërtimit për objektin “Burg në fshatin Drenovë – Korçë ””.

Vendim KRRTRSH nr. 7, datë 22.05.2007 “Për miratimin e ndryshimit të Planit Rregullues të qytetit të Korçës, në lidhje me ndryshimin në zonimin funksional për disa zona të qytetit”. Sqarim: Miratohet në 5 zona dhe nuk miratohet në zonën nr. 6, sipas vendimit.

Vendim KRRTRSH nr. 1/5, datë 18.04.2008 “Për miratimin e vijave kufizuese të zonave/vendbanimeve informale në Qarkun e Korçës”.

Vendim KKT nr. 13, datë 07.03.2014 “Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Korçë”.

B. Veçoritë Fizike dhe Mjedisore

3. Topografia dhe Relievi

Bashkia e Korçës është njësi administrative vendore e cila shtrihet në Shqipërinë Juglindore. Ajo kufizohet më Veri me Bashkinë e Maliqit, në lindje me Bashkinë e Devollit në jug me Bashkinë e Kolonjës dhe në jugperëndim me Bashkinë e Skraparit. Në Lindje ka ndarje natyrore me kreshtin malor të Moravës, në Perëndim me kreshtin malor dhe kurrizin e Ostrovicës në veriperëndim. Rrafshnalta (pjesë e Fushëgropës së Korçës) është ulje që ruhet në perëndim nga Masivi i Voskopojës e në jug nga Malësia e Vithkuqit. Përmidis tyre janë luginat me relievin rënës dhe derdhje të ujqorëve për kah perëndimi. Fushëgropa e Korçës, është një gjeohapësirë fushore, ajo është konsideruar një gropore natyrore, të ruajtur nga të gjitha anët, në shtrirjen e saj. Daljet janë: në Grykë të Cangonjit që hap komunikimin me Bashkinë e Devollit, në rrjedhën e tij të mesme, qafa e Qarrit për në drejtim të Kolonjës.

Ka një sipërfaqe prej prej rreth 730 km²

Fushëgropa e Korçës 118 km²,

Reliev fushor: 18 %

Reliev malor: 82%

Topografia e Bashkisë së Korçës përbën veçori të ndërthurjes më të mirë të relievit gjeohapësirës malore gjeografike të Shqipërisë Juglindore. Në këtë reliev janë të pranishëm tiparet : tepërmalore, malore dhe rrafshnaltë (fushëgropë).

- Kurrizi i Ostrovicës është një barierë tepërmalore, në perëndim të Bashkisë së Korçës që pozicionohet në drejtimin jugver, duke nisur nga Qafa e Martës, majën e Faqekuqit, majën e Ostrovicës deri mbi Mazrek që është skaji veriperëndimor i bashkisë (Njësia Administrative vendore e Lekasit).

- Përfshirja e relievit tipik malor me: Malësinë e Voskopojës, Malësinë e Vithkuqit dhe Kurrizin e Moravës.
- Rrafshnalta e Korçës që lidhet me një pjesë të Fushëgropës së Korçës, ku lartësia mesatare është 820 metër.

3.1. Topografia dhe ndikimi në zhvillim urban

Bashkia e Korçës në pozicionimin e saj gjeografik paraqet një përpjestim tërheqës në kushte shumë të favorshme në aspektin zhvillimor të bujësisë, blegtorisë, turizmit, sporteve dimërore, shfrytëzimit të pasurive natyrore, transportit dhe komunikimit me shtetet fqinjë Greqinë dhe Maqedoninë. Në këtë gjeohapësirë dhe reliev kaq të ndryshëm janë të mpleksuara histori të kulturës së jetesës (Kultura e Maliqit), duke sjellë zhvillime, jo vetëm në brendësi të Fushëgropës por edhe rrotull saj, që nga Korça, Voskopoja, Vithkuqi në shtrirjet urbane, në prirje edhe drejt lartësive malore përgjatë gjithë vijimësisë e mbijetesës lliroshtëtare. Një ndërthurje e tillë topografike, nga kreshti tepërmalor Ostrovicës, në fushëgropë të Korçës, përfshirje të dy luginave të Devollit dhe Osumit, në platformat malore ku rrojnë gjurmë urbane historike si Voskopoja e Vithkuqi, gjer në shtegun e virgjër turistik të Dardhës, tradita historike zhvillimore gjen një larmi frymëmarrjeje urbane e cila kërkon rizgjim dhe rikonceptim.

Vështrimi i sotëm urban (qytetor) gjen në këtë topografi shtratin historik tradicional tërheqës, e zhvillimor, mbasi asnjë pjesë e kësaj gjeohapësire nuk mbetet e përhumbur, me gjithë shkatërrimin e ndodhur përgjatë luftërave e migracionit ndër shekuj. Jo vetëm Voskopoja e Vithkuqi, por shumë më tej, në skajin veriperëndimor të Njësisë së sotme Administrative të Lekasit janë gjurmë gjeneze e Muzakajve me rrënjë në Voskop e Lekas, në një zonë tepërmalore.

Ky reliev tërheq për një rizhvillim dhe rikonceptim çka nuk përbën pengesë në gjetjen e hapësirave zhvillimore ekonomike, të rrugëve përtëritëse të turizmit, të shfrytëzimit të pasurive natyrore jo vetëm në Voskopojë, por edhe në një konceptim e fryme rizgjimi në Vithkuq, deri në Dardhë, në juglindje.

Gazsjellësi Transadriatik (TAP) që po realizohet është një vepër që kryhet, në këtë reliev aq të larmishëm në një zonë në të cilën dhjetvjeçarët e fundit kanë ndodhur ndryshime si rrjedhojë e migracionit, gjer në një rrudhje të skajshme, por që por që dinamikat e fundit nuk janë vetëm një shpresë për Rilindjen Urbane edhe në skajet më fundore të strehëve jetësore që janë harruar.

Gjeohapësira e Bashkisë së Korçës përfshin:

- Fushëgropa pjesore e Korçës

- Malësia e Vithkuqit
- Krahina e Voskopojës
- Malësia e Oparit
- Shpatet perëndimore të Moravës.

Bashkia e Korçës ka këto ujëmbledhje:

- Faqet dhe luginat perëndimore të Moravës më rënie në fushëgropën e Korçës nga Gryka e Cangonjtit (Bashkia e Devollit) deri në Qafën e qafën e Qarrit (Bashkia e Kolonjës)
- Ujëmbledhja luginore e Vithkuqit e Gjançit.
- Ujëmbledhja e kreshtit të Voskopojës dhe luginat me rrjedhje për kah lindja në fushëgropën e Korçës.
- Ujëmbledhja e Oparit që lidhet më groporen e relievit të Çëmericës që bie në drejtimin e Devollit të Mesëm, si dhe ujrave që rrjedhin nga faqet malore të Voskopojës në drejtimin veriperëndimor.
- Ujëmbledhja jugperëndimore e Panaritit me rrjedhje në lumin Osum.



3.2. Relievi i bashkisë

Korça ka një sipërfaqe qytetore prej 15.3 km². Ajo është qendra më e madhe administrative e Shqipërisë juglindore , qyteti më i madh i rajonit i themeluar në shekullin 15-të. Megjithatë jeta qytetare lindi në mesjetën e hershme, Korça ka qënë e banuar shumë shekuj më parë. Pozicionimi i parë topografik, ka qënë një zgjedhje për ndërtimin e hershëm të strehëve njerëzore në këmbë të malit të Moravës, aty ku gjendet një kodrinë e butë që vijon për t'iu bashkuar lartësive të malit të kreshtit malor që e ruan nga lindja. Aty dikur ishte dhe skaji i fushëgropës që ko krijohesh.

3.2.1. FUSHËGROPA PJESORE E KORÇËS

Fushëgropa e Korçës si njësi relievi në Bashkinë e Korçës ka një sipërfaqe rrafshnaltë prej 108 km². Forma e fushës i përngjan një pëllëmbë dore e shtrirë në drejtimin veri-jug. Ajo është një prirje dhe futje relieve të rrafshët në drejtim të jugut.

Fushëgropa është për midis malesh. E futura përzgjatet në jug gjer në vinë Kamenicë e Pulahë, ku fillon ngritja e relievit dhe rruga automobilistike që ngjitet për në Qafë të Qarrit. Gjerësia më e madhe e rrafshnaltës është në vijën Korçë-Voskop deri në 7,9 km. Në drejtim të veriut fushëgropa shenjion një ndarje të saj me hapësirën që mbetet në veri për Bashkinë e Maliqit ku si kufij janë vijat fundore e njësisë administrative e Bulgarecit me fshtra periferike Shamoll e Çiflig deri tek Kuçi Zi në lindje ku largësia e rrafshnaltës lindje perëndim është 8,2 km.

Lartësia mesatare mbi nivelin e detit e fushës është: 859 metër. Ndër këto lartësi mund të përmendim; Lumalas: 839 metër, Goskovë: 845 metër, aeroport : 832 metër, Ravonik: 842 metër, Qatrom 853 metër, Dërsnik 866, Korçë 850 metër, Drenovë 897 metër. Brenda kësaj hapësire rrafshnaltë në lindje ndodhet Korça e ndërtuar në këmbë të Moravës, në kodrinën e butë e në përzgjatje të malit, ku takohet lartësia 1012 metër.

Kufizimi lindor i Fushëgropës ka qendrat e banuara : Floq, Kamenicë, Boboshticë, Mollaj, Drenovë, Mborje, Barç, Dëshnicë, Neviçisht, Belorta, Kuç i Zi.

Në Gjeohapësirën fushore të Bashkisë së Korçës përfshihen 29 fshatra : (Shamoll, Kuç i Zi, Belorta, Malavec, Bulgarec, Neviçisht, Melçan, Dishnicë, Lumalas, Çiflig, Porodinë, Barç, Goskovë e Poshtëme, Turan, Mborje, Ravonik, Voskop, Polenë, Drenovë, Mollaj, Dërsnik, Pulahë, Ujëbardhë, Kamenicë, Floq)

Fushëgropa vrojtitet nga tre drejtimet: jug, Lindje dhe Perëndim.

Rritja e relievit, në lindje është e menjëhreshme, drej kreshtit të Moravës. Ndërsa kjo rritje është e butë, në perëndim ku panorama lartësore i përngjan sistemit kodrinor. Për vlerësimin metabolik fushëgropa pjesore me Koçën dhe gjithë qendrat e banimit në fushë, bëhen nisje por edhe mbështetje për një frymëmarrje të re të zgjerimit të planëzimit urban edhe në periferi, për infrastrukturë dhe zhvillim sipas një rendi vlersues dhe krahasimor të mundësive. Në këtë vështrim, ndryshimi dhe shndërrimi që do të ndodhë, varet shumë nga topografia, relievi, përbërësit e largësitë nga qendra dhe midis tyre, nga lartësia e relievit, pozicionimi.

3.2.2. SHPATET PERËNDIMORE TË MALIT TË MORAVËS

Mali i Morëvës është kreshti kufizues në lindje si një ruajtës dhe një barrierë relievi që ngrihet nga gryka e Zëmlakut (832 metër mbi nivelin e detit).

Kjo njësi relievi zë një sipërfaqe prej 110 km². Prej Zëmlakut, fillon e ngrihet kreshti duke vijuar në drejtim të jugut, ku shfaqet maja e Qafëzës (1272 metër), maja e Strugarit në lindje të fshatit Belorta , maja e Lajthisë (1573 metër) maja e tabekit të Ahut (1690 metër), Pylli i Çardhakut dhe maja e Çardhakut (1808 metër) që është edhe maja më e lartë e Moravës.

Prej këtu kreshti fillon uljen e lartësive në pyllin e Lëndinave të Padinës (1684metër) shkëmbi i Gurit të Capit (1552 metër), maja e Bigllës (1762 metër) , maja e Gropës (1708 metër) deri në qafë të Dradhës (fshati Dardhë , vendbanim jugor vendor i bashkisë, një qytet turistik me tradita historiko- e kulturore). Në shpatet perëndimore të Moravës shtrihet edhe hapësira pyjore e Bredhit të Drenovës.

Në jug të Dardhës ngrihet lartësia e Gurit të Neçkës (1440 metër) me reliev që ngjitet më tej në Qafën e Kazanit. Kjo është edhe vija kufizuese ujëndarëse e Moravës.

Luginat kryesore që marrin rrjedhat ujore nga lindja janë : Lugina e Boboshticës , Lugina e Drenovës, Lugina e Mborjes, që në lindje të saj shfaq majën e Qytetit (1322 metër), Lugina e Biçkës që zgjatet në lindje të qendrës së qytetit të Korçës, lugina e Dishnicës dhe lugina e Belortasë .

3.2.3. MALËSIA E VOSKOPOJËS

Në veri malësia e Voskopojës kufizon me kreshtin malor ndarës me bashkinë Maliqit, që fillon me majën e Shëndëlliut (1474 metër) pastaj më tej vijon në veri të fshatit Shipckë, maja Mustaq (1549 metër) Ky kufizim kreshtor i lartësive të relievit vijon në harkimin për në jug, në majën e Lëmit të Gurasit, (1504 metër) kthehet në majën e Shipckës (1601 metër) duke përfshirë nga perëndimi lartësitë në ujërrjedhje për në lumin e Voskopojës. Nga maja e Shipckës, për në jug, përfshihet maja e Varvanës (1348 metër) maja e Buzmadhit (1439 metër) Fundi jugor i Malësisë së Voskopojës është në majën e Mustafallarit (1466 metër) që kufizon me malësinë e Vithkuqit. Këtu ujrë rrjedhin drejt veriut (përroi i Zhombroit) , (përroi i Shelgut) që derdhen në lumin e Lavdarit të Korçës e mandej në lumin e Voskopojës.

Në perëndim të malësisë së Voskopojës shtrihet Malësia e Oparit, maja e Çakës (1553 metër) , maja e Shullërit të Madh (1653 metër) e në veri : maja e Pasha Tepesë (1640 metër) lartësia 1367 në very duke u pirë për t'u takuar me përroin e Luadhes ku është edhe kufiri me Bashkinë e Maliqit.

3.2.4. MALESIA E VITHKUQIT

Malësia e Vithkuqit përkton me njësinë administrative të Vithkuqit. Si histori e kulturë lidhet me një krahinë të njohur: e cila zë një sipërfaqe rreth 102 km². Vendosja gjeografike, tiparet e relievit, historia e vendbanimit dhe kultura e bëjnë atë të veçantë. Në Bashkinë e Korçës është kjo krahinë ka qendër Vithkuqin i cili ka qënë në nivelin e një qyteti mesjetar, me 24 lagje me rreth 15 000 banorë.

Malësia e Vithkuqit është në jugperëndim të Bashkisë së Korçës. Ajo përfshin një reliev që në perëndim shenjon ndarjen nga Qafa e Martës (1823 metër) qafa e Bolës (1712 metër) qafa e Shekës (1854 metër) , kthim në verilindje për në majën e Shkëmbit të bardhë (1664 metër). Pastaj vija ndarëse drejtohet për tek maja e Lisies (1714 metër) dhe për gjatë kreshtit në perëndim për 7 km takon majen e Orenjit ku rrjedhin ujrat në jugperëndim. Më tej vijon një hark i relievit që zbret në majën e Vrenit të Gjançit(1424 metër)ndhe majën e Shullërit mbi fshatin Gjanç)

Vija e kreshtit malor ndan fshatrat e malësisë së Oparit (nj.a. LEKAS) : Gjergjevicës, Gurmujas, Gjonbabas, e Çemericë. Të gjitha këto lartësi ndajnë relievin dhe ujrat rrjedhëse në veri dhe në jug përmbledhin fshatrat Rehovë , Lubonjë, Stratobërdhë, Treskë , Trebickë, Panarit dhe Grabockë.

Në perëndim hapet maja e Tushit , maja e Çilgazit (1679 metër) , qafa e Bredhit duke vijuar deri në majën e Baravecit mbi Leshnje. Në jug të Vithkuqit zbresin ujrat rrjedhëse të lartësive : 1664 metër , 1750 metër, 1618 metër , 1330 metër dhe 1288 në jug të Leshnjes. Në Vithkuq dallon fusha e Markëzës , fusha dhe lugina e Leshnjes me ujra që rrjedhin në drejtim të fillimit të Osumit.

Duke filluar nga këto lartësi ujrat rrjedhëse bjenë në jug ku relievi ulet, duke na shfaqur njëri pas tjetrit fshatrat Rehovë, Lubonjë, Stratobërdhë, Treskë, Trebickë, Grabockë dhe Panarit. Grabocka dhe Panariti janë fshatrat më të largët jo vetëm nga Vithkuqi por edhe në këndin jugperëndimor të kufirit të Bashkisë së Koçës ku ndahet me bashkitë e Skraparit dhe të Kolonjës.

3.2.5. KRAHINA (MALËSIA) E OPARIT.

Malësia e Oparit shtrihet në hapësirën perëndimore të Bashkisë së Korçës e në jug të Bashkisë së Maliqit. Në vështrim gjeohistorik kjo është një krahinë e njohur Ka një sipërfaqe prej 115 km² (në të cilën është hequr pjesa veriore ku malësia e Oparit zbret në luginën e Devollit që i përket Bashkisë së Maliqit.) Kjo krahinë historike ka qënë qendra dhe rrënja e dikurshme e Muzakajve që që në shekullin e XIII e shtrinë zotërimin e tyre në perëndim te Arbërisë, Ultësirën Perëndimore të Arbërit.

Tiparet e relievit ku janë vendosur qëndrat e banuara janë shumë karakteristike. Brenda Bashkisë së Korçës si kufi brendavendor është Karahina e Voskopojës (malësia e Voskopojës)

Ajo i përngjan një gjethoreje ku dallojnë rëniet e ujrave rrjedhëse, në një gropore që mësyn në lumin e Çëmericës, duke zbritur në Xerje dhe Denas. Në perëndim vijon kurrizi i Ostrovicës (2363 metër), me një zbritje në majën e Faqekuqit (2352 metër) Pastaj radhiten në drejtim të lindjes qafa e Martës (1823 metër) qafa e Bolës (1712 metër) qafa e Shekës (1854 metër) duke u harkuar drejt majës së Shkëmbit të Bardhë (1664 metër) mbi fshatin Shtyllë.

Prej majës së Shkëmbit të Bardhë kreshti harkon në drejtimin verilindor tek maja e Lisies (1714 metër) Më tej përmbliidhen ujrat rrjedhëse të përroit të Kores që zbresin nga lartësia 1506 metër duke përfshire gjithë gjethen ujore të përroit të Gjergjevicës në perëndim të malësisë së Voskopojës (shiko : maja e Shullërit të Madh 1653 metër) Kjo vijë kreshtore jugore kufizon malësinë e Oparit e cila përfshin fshatrat që lagen nga lumi i Çëmericës dhe përroi i Gjergjevicës i cili takohet në Xerje e Denas me lumin e Çëmericës. Lumi i Çëmericës vijon në drejtimin veriperëndimor në Denas dhe Popovinë duke u bashkuar mandej me Lumin e Madh që zbret nga Brozdoveci e Misras Mazrek . Në takim të dy ujrave lartësia e relievit është 593 metër mbi nivelin e detit.

Në këtë gjeohapësirë të thyer malore ndodhen fshatrat: Lavdar (1150 metër), Xerje (920 metër) Lekas (1090 metër) Tudas (1115 metër) Punëmirë (1100 metër) Shkozanj (950 metër) Gjergjevicë (1350 metër) Gurmuja (1200 metër) Marjan (1200 metër) Gjonbabas (1250 metër).

4. Klima

Bazuar në rajonizimin gjeografik të Shqipërisë territori i bashkisë Korçë, bën pjesë në Gropat JL të Shqipërisë dhe në Krahinën Malore Qëndrore.

Teritori i Bashkisë së Korçës përbëhet nga këto njësi të mëdha morfologjike:

- *Fushëgropa e Korçës,*
- *Krahina pasmalore,*
- *Krahina Malore.*

Pozicioni gjeografik, mbizotërimi i kodrave dhe maleve bën që territori i bashkisë së Korçës të futet në zonën ku dimri është i ftohtë dhe vera e freskët. Reshjet e pakta bien kryesisht në formë bore.




Fig.-2 Harta e zonave klimatike (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)

Klima e rajonit është tipike kontinentale, me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër të ftohtë dhe me reshje jo të pakta dëbore.


Tab. 1 Karakteristikat kryesore të klimës në

rajonin e Pogradecit (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)

Nr	KARAKTERISTIKA	TIPI
1	Tipet kryesore te klimes	Mesdhetare kontinentale malore
2	Vendodhja e stacionit me te afert metereologjik	Korçe
3	Rreshjet mesatare vjetore	760 mm
4	Muaji me reshjet me te dendura	Dhjetori
5	Muaji me reshje debore me te medha	Janari
6	Fillimi dhe fundi i shirave te vjeshtes (p.sh heret ne shtator, mesi i tetorit, fundi i tetorit)	15 Shtator - 30 Nentor
7	Fillimi dhe mbarimi i reshjeve ne pranvere	15 Mars - 30 Prill
8	Fillimi dhe perfundimi i reshjeve te debores	5 Dhjetor - 15 Mars
9	Muaji I shkrirjes se plote te debores	Fillim muaji Maj

10	Fillimi dhe perfundimi i periudhes se thate	Korrik - Shtator
11	Data e ngrices se pare	Pas 10 Nentorit
12	Data e ngrices se fundit	10 diteshi i pare Prillit
13	Temperatura minimale mesatare afatgjate, muaji dhe zgjatja	Temp.mes.vjetore 6-12°C Temp.min.vjetore (-10°C) (-15°C)
14	Muajt e tokes se ngrire (lartesi 50 cm)	Janar-Shkurt deri 20 cm thellesi

Temperatura maksimale gjatë verës varjojnë 36-38 gradë, temperatura mesatare mujore luhet nga 20 grade deri në 24 gradë. Gjatë dimrit bien dhe reshje dëbore, ku në rajonin tonë e përreth trashësia shkon në mbi 0.5m ndërsa në lartësi të mëdha trashësia shkon deri në mbi 1m. Gjatë vitit në zonën tonë reshjet janë të shumta dhe sasia e tyre mesatare shkon nga 900-1300mm dhe më shumë reshje bien në mujin nëntor dhe dhjetor të vitit. Dëbora fillon të bjerë që në fundin e muajit Nëntor dhe vazhdon në mënyrë jo të qëndrueshme, deri në muajin Shkurt. Ky territor, pothuajse gjatë gjithë vitit, por veçanërisht në periudhën fundi i vjeshtës-fillimi i pranverës, rrihet nga erëra të ftohta. Bashkia e Korçës shtrihet në pjesën JL të Shqipërisë. Kryeqendër e bashkisë është qyteti i Korçës me rreth 100,000 banorë. Klima e territorit tokësor është e tipit kontinental lokal, me një temperaturë mesatare vjetore prej 11.4°C. Temperaturat mesatare mujore arrijnë rreth afërsisht 21.2 gradë në Korrik dhe Gusht, ku maksimumi arrihet në gusht me 34.4 gradë. Temperatura mesatare më e ulët është gjatë Janarit, rreth 1.5 °C, me një minimum prej -17.2°C.



4.1 PARAMETRAT KLIMATERIK

4.1.1. Era (drejtimi, shpejtësia)

Era më e shpeshtë është ajo që fryn nga veriu, sidomos në vjeshtë dhe dimër. Erërat që fryjnë nga jugu dhe juglindja dominojnë gjatë pranverës dhe verës. Erërat e juglindjes dhe lindjes janë të konsiderueshme. Periudhat e qeta dhe me erë ndryshojnë gjatë ditës, veçanërisht në verë. mëngjeset karakterizohen nga luhetjet mes erërave që fryjnë nga veriu dhe periudhave të qeta. Kushtet e motit ndryshojnë mjaft pasditeve, kur qetësia prishet nga erërat e jugut dhe juglindjes.

Fig. - 3 Harta fiziko gjeografike e shqipërisë (Burimi: Perikli qiriazi 1988)

Era percaktohet si levizje horizontale e ajrit,

ndersa levizja vertikale qyhet rryme ajri.

Karakteristikat

Shpejtësia mesatare vjetore e erës është rreth 2.1m/s. Shpejtësia më e madhe arrihet në stinën e pranverës me 2.5m/s, në dimër 2.2m/s, në verë 1.7m/s dhe në vjeshtë 2m/s. Erërat me shpejtësinë mesatare vjetore më të madhe janë ato me drejtim jug-perëndim (5m/s) dhe jug-lindje (4.8m/s), ndërsa ato me shpejtësi mesatare vjetore më të vogël janë ato me drejtim veri-lindje (2.8m/s). Përsa i përket drejtimimit të erërave:

Shpërndarja vjetore e drejtimeve të erës në % (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)

Stacioni	Q	N	NE	E	SE	S	SË	Ë	NË
Korçë	51.2	10.3	5.5	7.1	5.8	2.2	13.2	2.4	2.3

Shpërndarja gjatë dimrit e drejtimeve të erës në %

Stacioni	Q	N	NE	E	SE	S	SË	Ë	NË
Korçë	52.7	8.9	6.0	5.7	6.3	2.3	16.4	0.9	0.8

Rastisja e shpejtësisë së erës në %

Shpejtësia në m/sek	0-1	2-5	6-10	11-15	15
Korçë	56.9	27.1	14.1	1.4	0.5


Shpejtësia më e madhe e erës në m/sek

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Korçë	40	26	28	26	24	20	20	22	20	29	24	30

Siguria e shpejtësive të mëdha të erës në m/sek

Stacion	1	3	5	10	20	25	30	40	50	60	70	75	80	90	95	99
Korçë	42	37	35	32	29	28	27	25	24	22	21	20	19	17	16	14

Fig.- 4 Rajonizimi klimatik në Shqipëri (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)



kryesore te eres jane drejtimi dhe shpejtesia e eres. Drejtimi i eres eshte kahu nga fryn era dhe merr emrin e tij sipas nje prej 16 pikave te horizontit. Lugina sherben si nje drejtues per rrymat ajrore dhe po te gjykojme nga te dhenat e stacioneve meteorologjike drejtimi dominues, ne te gjithe stinet, jane VL (20% te rasteve) dhe JP (10.4% te rasteve). Rrymat ajrore jane nje nder faktoret kryesore te formimit te klimes. Ne territorin ne studim, drejtimi i eres gjate vitit eshte i ndryshueshem. Shpejtesite e eres ne territorin ne

studim jane ne vartesi te periudhes se vitit. Vlerat me te medha te shpejtesise se eres vrojtohen ne stinen e dimrit. Shpejtesite maksimale te eres me periudhe perseritje nje here ne 50, 20, 10 vjet jane respektivisht 30-33m/s, 28-30m/s, dhe 24-27m/s (sipas Kushteve teknike Hidrometeorologjike).





Fig.- 5 Shpërndarja territoriale e sasisë vjetore të orëve me erë (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)

4.1.2. Temperatura

Regjimi termik paraqet uniformitet te kenaqshem. Vleftat e temperatures mesatare vjetore pergjithesisht luhaten rreth 13.0⁰ C. Temperatura mesatare e janarit lekundet ne rreth 2.9⁰C. Ne figure paraqitet shperndarja e temperatures mesatare gjate vitit



Shpërndarja e temperaturës mesatare gjatë vitit

(Burimi: *Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia*)

Temperatura mesatare vjetore është 10.5°C. Rajoni dallohet për dimrin e ftohtë (temperatura mesatare e Janarit 0°C) dhe për verën e freskët (temperatura mesatare e Korrikut 18.3°C). Lidhur me temperaturën mesatare stinore, ajo është rreth 1.7°C në stinën e dimrit, 9.3°C në pranverë, 19.3°C në verë dhe 11.5°C në vjeshtë. Temperaturat skajore arrijnë: minimumi absolut -24.2°C dhe maksimumi absolut 35.5°C. Këto minime janë pasojë e depërtimit të masave ajrore të ftohta dhe fuqizimit të tij nga forma e luginës së Devollit.

Temperatura mesatare e ajrit sipas $\frac{1}{2} (max + min)T^{\circ}C$ (Burimi: *Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia*)

Stacion	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vj
Korçë	-2.8	1.7	4.7	7.0	11.1	16.1	19.5	20.1	16.4	11.6	7.5	1.5	9.5
Korçë	-2.3	1.9	4.6	7.2	11.4	16.8	20.1	20.8	17.1	12.2	8.3	1.8	10.0

Zgjatja e temperaturës mes. mbi disa kufij dhe shuma përkatëse e temperaturës efektive

Stacion	$\geq 10^{\circ}$	$\geq 13^{\circ}$

	Dt. Fill	Dt. mba	Zgjat Dit.	Shuma °C	Dt. Fill	Dt. mba	Zgjat Dit.	Shuma °C
Korçë	17 IV	25X	192	1307	8 V	7 X	153	792.6

Stacion	≥ 15°				≥ 20°			
	Dt. Fill	Dt. mba	Dt. Fill	Dt. mba	Dt. Fill	Dt. mba	Dt. Fill	Dt. mba
Korçë	23 V	28 IX	23 V	28 IX	23 V	28 IX	23 V	28 IX

Temperatura mesatare e ajrit në °C

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Mes	Ampl
Korçë	0.5	1.8	4.9	9.7	14.0	17.8	20.5	20.8	17.3	11.5	7.2	2.8	10.7	20.3

Variacioni mesatar ndër-mujor i temperaturës së ajrit

Mesatare 35-vjeçare (1931-1965)

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Korçë	1.3	3.1	4.8	4.3	3.8	2.7	0.3	3.5	5.8	4.3	4.4	2.3

Shmangiet mesatare mujore nga mesatarja vjetore

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Korçë	10	8.9	5.8	1.0	3.3	7.1	9.8	10	6.6	0.8	3.5	7.9

Maksimumet absolute të temperaturës së ajrit

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet	Data
Korçë	17.4	18.6	26.3	27.2	33.2	34.9	37.0	38.5	34.5	29.0	22.1	16.1	38.5	9/08/45

Minimumet absolute të temperaturës së ajrit

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet	Data
													.	

Korçë	20.9	17.5	15.0	10.5	0.0	2.6	6.4	5.6	1.6	3.2	9.5	23.0	23.0	30,31/12/41
--------------	------	------	------	------	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	------	------	-------------

Amplituda e temperaturave ekstreme absolute

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet
Korçë	38.3	36.1	41.3	37.7	33.2	32.3	30.6	32.9	32.9	32.2	31.6	39.1	61.5

Siguria në % e temperaturës maksimale vjetore

Stacioni	Siguria në %															
	1	3	5	10	20	25	30	40	50	60	70	75	80	90	95	99
Korçë	38.6	38.0	37.3	36.9	35.9	35.5	35.4	34.8	34.5	34.2	33.5	33.5	33.1	32.4	31.7	30.7

Siguria në % e temperaturës minimale vjetore

Stac.	Siguria në %															
	1	5	10	20	25	30	40	50	60	70	75	80	90	95	99	
Korçë	25.4	21.6	19.7	17.6	16.9	16.2	15.0	14.0	13.1	12.1	11.5	11.0	9.5	8.5	6.7	

Temperatura mesatare e maksimumeve mujore

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet
Korçë	11.0	14.1	18.5	22.5	27.3	30.1	33.0	33.8	29.0	23.8	18.2	13.8	34.4

Temperatura mesatare e minimumeve mujore

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.
Korçë	12.4	9.7	6.5	1.9	3.3	6.9	9.4	9.0	5.8	0.9	3.7	-8.8	14.7

Shmangia mesatare kuadratike e temperaturave ekstreme vjetore në °C

Stacioni	Maksimale σ	Minimale σ
Korçë	1.38	4.03

Amplituda mesatare e ekstremeve mujore

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.
----------	---	----	-----	----	---	----	-----	------	----	---	----	-----	-------

Korçë	23.4	23.8	25.0	24.4	24.0	23.2	23.6	24.8	23.2	22.9	21.9	22.6	49.1
--------------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------

Temperatura mesatare maksimumeve ditore

Mesatare 35-vjeçare (1931-1965)

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.
Korçë	4.8	5.8	9.8	14.6	19.4	23.7	27.2	27.5	23.3	16.4	11.0	6.4	15.7

Temperatura mesatare minimumeve ditore Mesatare 35-vjeçare (1931-1965)

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet
Korçë	-3.3	-2.2	0.5	4.8	8.7	11.8	13.8	14.2	11.3	6.7	3.3	0.8	5.7

Temperatura mesatare e ekstremeve ditore Mesatare 35-vjeçare (1931-1965)

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.
Korçë	7.6	8.0	8.8	9.8	10.7	11.9	13.4	13.3	12.0	9.7	7.7	7.2	10.0

Numri i ditëve me temperaturë max ≥ 25.0 °C

Stacioni	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	Σ Vjet	Nr dit
Korçë	-	-	0.3	4.4	14.6	25.7	24.4	12.5	2.0	-	83.9	33

Numri i ditëve me temperaturë maksimale ≥ 30.0 °C

Stacioni	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	Σ Vjet
Korçë			0.4	1.7	9.1	10.9	2.2	-	-	24.3

Temperatura maksimale absolute në sipërfaqen e tokës

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet	Data
Korçë	19.9	29.5	39.6	51.0	54.9	57.8	64.1	62.7	53.2	44.6	33.3	20.8	64.1	26/07/65

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet	Data
Korçë	-27.0	-	-	-13.5	-	-	4.4	1.	0.	-5.7	-10.0	-21.3	-	14/01/68
		22.	21.		4.3	2.4		6	6				28.5	

		7	1																
--	--	---	---	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Temperatura minimale absolute në sipërfaqen e tokës

Temperatura minimale absolute në 5 cm, mbi sipërfaqen e tokës

Staciono	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.	Data
Korçë	-26.6	-19.1	15.1	9.6	-2.8	-2.4	-0.5	0.9	-4.5	9.9	-14.7	-21.5	-26.6	20/01/67

4.1.3. DËBORA, RESHJET E SHIUT (MESATARET, VLERAT MAKSIMALE, VLERAT MINIMALE), PRECIPITIMI DHE AVULLIMI

Reshjet janë një prej faktorëve kryesorë që influencojnë regjimin klimaterik të zonës. Reshjet e shiut variojnë gjatë vitit dhe luajnë një rol të rëndësishëm në balancën e ujit të liqenit dhe pellgut të tij ujëmbledhës. Niveli më i lartë i reshjeve normalisht shënohet në Nëntor-Janar dhe në pranverën e vonë, zakonisht në maj. Reshjet arrijnë nivelin më të ulët gjatë Korrikut dhe Gushtit. Reshjet mesatare të shiut në vit në basenin e liqenit shkojnë afërsisht 759 mm. Termi *reshje*, i përdorur në hidrologji, përfshin të gjitha format e ujit që vijnë nga atmosfera në tokë. Format kryesore të reshjeve janë: shiu, bora, bresheri, vesa etj. Reshjet atmosferike janë nga elementet më të rëndësishme të motit dhe të klimes.




Fig.- 7 Harta e shpërndarjeve të reshjeve (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)

Faktorët kryesorë që kushtëzojnë sasinë, intensitetin, shpërndarjen vjetore, stinore e mujore të reshjeve, në zonën në studim janë: pozicioni gjeografik dhe veçoritë e relievit. Është e qartë se për një pellg, përgjithësisht, reshjet janë faktori kryesor i regjimit hidrologjik, sepse ato janë vetë edhe materiali kryesor që krijon rrjedhjen në hapësirë dhe kohë. Një karakteristike e përgjithshme e

shpërndarjes së reshjeve në pellgun e Shkumbinit është se lartësia e tyre rritet nga Perëndimi në Lindje deri në pellgjet e degëve Gostime e Rapun (inklusiv) dhe pastaj zbret nga Veriu në Jug. Reshjet atmosferike janë nga elementet më të rëndësishme të motit dhe të klimës.

Reshjet

Dalohet për sasinë mesatare vjetore shumë të ulët të reshjeve me rreth 700mm në vit. Ndikimi kontinental i klimës zbutët nga regjimi mesdhetar i reshjeve ku në verë bien 12.5% të reshjeve vjetore.

Lartësia e reshjeve R (mm) (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)

Stacion	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Korçë	43	4.9	47	29	108	54	11	31.6	19	127	87	105
Korçë	69	23.6	83	27	114	54	7.6	18.5	10	153	113	129

Stacion	Vjet	Max	Data	Nr.dit
Korçë	671.4	36.5	20. X	110
Korçë	805.0	28.5	20. X	134

Tensioni mesatar i avujve të ujit në mb.

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet
Korçë	5.3	5.5	6.0	7.4	10	12	12	12	11	9.5	8.0	6.3	9.0

Lagështia relative mesatare e ajrit në %

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.
Korçë	79	76	69	63	64	61	54	52	61	70	78	80	64

Defiçit mesatar i lagështirës së ajrit në mb.

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.
Korçë	1.4	2.0	3.3	6.3	6.9	9.3	13.1	14.1	9.2	5.0	2.6	1.7	6.2

Mesataret mujore e vjetore të reshjeve në mm

Mesatare 35- vjeçare (1931- 1965)

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.
Korçë	70	68	53	54	58	42	21	25	44	85	112	89	722

Vitet me reshje maksimale dhe minimale dhe raporti ndërmjet tyre

Stacioni	Reshjet më të mëdha		Reshjet më të vogla		Raporti ndërmjet rreshjeve më të pakta / më të mëdha
	Sasia në mm	Viti	Sasia në mm	Viti	
Korçë	1090.8	1963	432.7	1945	2.5

Maksimumi 24 orësh i reshjeve

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Korçë	50	40	32	53	50	60	29	43	62	46	85	77

Stacioni	Vjet.	Data
Korçë	85.0	13/11/1955




Fig. – 8 Harta e shpërndarjeve të reshjeve (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)


Tab.3 Vitet me reshje maksimale dhe minimale dhe raporti ndermjet tyre.

Stacionet	Reshjet me te medha		Reshjet me te pakta		Raporti ndermjet reshjeve me te medha e me te pakta.
	Sasia mm	Viti	Sasia mm	Viti	
Pogradec	1209	1947	351	1953	3.44

Shperndarja e reshjeve brenda vitit ne territorin ne studim eshte tipike mesdhetare, me reshje te shumta gjate gjysmes se ftohte te vitit dhe reshje te pakta gjate gjysmes se ngrohte me thatesire qe mund te zgjate disa muaj. Ndarja e vitit ne dy gjysma viti eshte bere duke ndjekur kriterin pluviometrik te muajve. Si gjysme e ftohte e vitit eshte marre inkluziv periodha **tetor...mars** ndersa ajo e ngrohte periodha **prill...shtator**.

Fig. – 9 Harta e shpërndarjeve të reshjeve (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)

Nga analiza e reshjeve, te dy periudhave, vihet re se reshjet e gjysmes se ftohte te vitit jane me te medha se ato te gjysmes se ngrohte, gje qe tregon karakterin mesdhetar te shperndarjes se reshjeve ne territorin ne studim. Po te shohim ecurine e sasise se reshjeve sipas renditjes kronologjike te muajve, do te veme re se kjo ecuri paraqet afersisht trajtat e nje kurbe paraboloidi me origjine te vendosur ne muajt me me pak reshje dhe me krahe ne te dy drejtimet qe ndjekin rritjen graduale te reshjeve sipas radhes se muajve Muajt me me shume reshje jane Nentori, Dhjetori e Janari, por reshjet me te shumta vrojtohen ne muajin Nentor. Muaji me me pak reshje eshte Korriku. Nga sasia e reshjeve mbizoteron stina e dimrit, megjithese vjeshta ne disa raste barazohet me te.



Dëbora

Në Shqipëri reshjet në forme bore bien kryesisht në muajt e dimrit dhe përfshijnë më tepër

zonat malore të vendit sidomos ato që shtrihen në brendi të territorit. Mesatarja e lartësive maksimale të dëborës, për teritorin në studim, është nga 15 deri 30 cm. Vlera mesatare e dendesise se bores merret 0.13 gr/cm^3 . Mesatarja e lartësive maksimale te bores ndryshon me ndryshimin e lartësise se vendit, mbi nivelin e detit sipas kesaj ligjesie (shiko Kushtet Meteorologjike te Projektimit) :

ku:

$$Y = 2.3(H/100) + 3.7$$

Y – mesatarja e lartësive maksimale ne cm, H- lartësia e vendit mbi nivelin e detit ne m.

P.sh. per lartesine 800 m mbi nivelin e detit, mesatarja e lartësive eshte 22.1 cm. Per zonen ne studim (ne lartesine 800 m) vlera e priteshme per periudhen e perseritjes nje here ne 50 vjet eshte $22.1 \times 3.4 = 75 \text{ cm}$. Ndryshimet klimatike nuk kanë më nevojë të paraqiten si një fenomen global që mund të ndikojë tek ekosistemet, si dhe tek sektorë të rëndësishëm të bujqësisë. Ndryshimet klimatike janë tashmë një kërcënim i njohur që, për t'u trajtuar siç duhet, duhet të merret në konsideratë në mënyrë të integruara, si pjesë e sfidave më të mëdha të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel global. Ndryshimet klimatike pritet që të rrisin frekuencën dhe madhësinë e ngjarjeve ekstreme si dëmet e shkaktuara nga përmytjet, thatësira, zjarret nëpër pyje, valë të nxehti dhe rreziqe të tjera klimatike. Pritet gjithashtu që të shkaktojnë reduktim të drithërave dhe të ujit.

Ndryshimet e shpejta dhe/ose të ashpra klimatike mund të kenë një ndikim të madh në inventarin biotik të liqenit. Për më tepër, eutrofikimi i Liqenit të Pogradecit pritet të përforcohet dukshëm nga ngrohja globale. Ndryshimet e temperaturës, anomalitë në reshje dhe shpeshtësia e rritur e ngjarjeve ekstreme mund të çojë në degradimin e burimeve ujore dhe mund të shkaktojë pasoja ekstreme në ekosistem. Ndryshimet në mesataren e reshjeve mund të ndikojnë ekosistemet, biodiversitetin, prodhimin e ushqimit, burimet ujore të disponueshme dhe rrjedhën e lumenjve. Ndryshimi klimatik ndikon biodiversitetin dhe modifikon kushtet rrethore: temperaturat mesatare dhe disponueshmërinë e ujit. Flora dhe fauna duhet t'i përshtaten kushteve të ndryshuara në mënyrë që struktura e ekosistemit të mund të ndryshojë. Mund të shfaqen specie të reja të huaja në këtë zonë dhe ta kolonizojnë duke shkaktuar zhdukjen e specieve të tjera dhe duke ndikuar negativisht në biodiversitetin vendor si dhe në bujqësi e në shëndetin e bimëve.

Ngricat janë të shpeshta, me mbi 80ditë në vit. Dëbora është dukuri e zakonshme dhe krijon shtresë për rreth 40 ditë në vit (kryesisht në muajin Janar – rreth 13 ditë), që nga Nëntori deri në fund të Marsit. Trashësia e shtresës arrin deri në mbi 40cm.

Numri i ditëve me shtresë dëbore

Stacioni	X	XI	XII	I	II	III	IV	V	ΣVjet
Korçë	-	0.7	6.3	12.3	11.4	3.8	8.3	-	34.8

4.2. VLERËSIMI I NDRYSHIMIT DHE ADAPTIMIT

Qëllimi i vlerësimit N & A përfshin si modelimin klimatik dhe vlerësimin e integruar të ndikimeve të ndryshimeve klimatike në sektorët kryesorë në zonat bregdetare të Shqipërisë. Këta sektorë kyçe janë bujqësia, shëndetësia, burimet ujore, fatkeqësitë natyrore, turizmi, dhe biodiversiteti.

Skenarët e ndryshimit të klimës


Skenarët e Ndryshimeve klimatike për temperaturë, reshje, do të thotë presion i nivelit të detit dhe rritja e nivelit të detit janë zhvilluar duke përdorur modelin MAGICC / SCENGEN (v. 5, 3, v 2).

4.2.1. Ndryshimet e parashikuara në regjimin e temperaturës

Për shkak të ndryshimit të mundshëm të temperaturës, Zona bregdetare shqiptare ka gjasa të bëhet më e ngrohtë. Të gjithë skenarët tregojnë një rritje të mundshme në temperatura vjetore që lidhen me 1990 për të gjitha horizontet kohore. Veçanërisht:

- A1F1MI parashikon rritjen mesatare më të lartë pas 2014, me një rrotje të mundshme deri në 4.8 në 2100 (skenari më i lartë/max),
- A1BAIM parashikon një rritje mesatare prej 1.7°C me 2050 dhe 3.2°C (skenari mesatar), dhe
- B1IMA parashikon rritjen më të vogël pas 2040 (skenari më i ulët/min).

Fig. – 10 Harta e temperaturës në thellësi 100 metra në tokë (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)



Shpërndarja territoriale e temperaturave në 100 m thellësi

4.2.2. Ndryshimet e parashikuara në regjimin e reshjeve

Të gjitha skenarët tregojnë një rënie të reshjeve vjetore në lidhje me 1990 për të gjitha horizontet kohore. Duke përgjithësuar rezultatet e tyre rezultojnë se reshjet vjetore kanë mundësi të ulen deri në -8,5% (nga -56,0 deri në 47,4%) në 2050; deri në -18,1% (nga -89,7% deri 94,0%) në 2100

Disa ndikime të përgjithshme

Si rezultat i ndryshimi të temperaturës dhe regjimit të reshjeve, janë parashikuar ndikimet e mëposhtme:

- Rritja e temperaturave minimale ditore më shumë se ato maksimale ka të ngjarë të ndodhë në të gjitha zonat e tokës
- Thatësira të shpeshta të gjata dhe me rrezik të madh zjarri janë të mundshme.
- Numri i ditëve me temperaturë mbi 35°C është parashikuar të rritet mesatarisht 10 ditë në vit deri 2100. Si pasojë e kësaj , numri i valëve të nxehta dhe i ditëve me temperaturë të ftohtë janë parashikuar gjithashtu të rriten.
- Ditët e freskëta dhe valët e ftohta janë shumë të mundshme të zvogëlohen. Dimërat e ngrohtë do të reduktojnë kërkesën e energjisë për ngrohje.
- Një rritje e numrit të ditëve me shira të rrëmbyeshëm që shkaktojnë përmbytje deri në 2100.
- Temperaturat e rritura të pranverës do të rrisin temperaturën e tokës, të mbjellat e verës në zonat e përshtatshme do të zgjasin periudhën e rritjes. Zgjatja e periudhës së rritjes është parashikuar të rritet me 26 ditë krahasuar me 1990.
- Si rezultat i reduktimit të reshjeve totale vjetore, zonat bregdetare mund të përjetojnë një rënie të përgjithshme. Kërkesa për ujë mund të rritet, veçanërisht në verë.
- Deri në vitin 2100 kushtet që do të jenë më të mira për turistët do të zgjerohen. Në verë kushtet do të ndryshojnë nga idealia në të shkëlqyeshme.

4.3. NGJARJE TË PAZAKONTA KLIMATIKE

Ndër dukuritë e pazakonta klimatike bëjnë pjesë edhe ato që lidhen me regjimin e reshjeve. Shqipëria, si vend me klimë tipike mesdhetare, karakterizohet nga një regjim i çrregullt i reshjeve nga pikëpamja e shpërndarjes vjetore. Kjo shpërndarje karakterizohet nga një maksimum në muajt e dimrit (30-40% e reshjeve vjetore) dhe një minimum në muajt e verës (10%). Çrregullsia e reshjeve vihet re edhe në shpërndarjen e tyre gjeografike. Kështu, në shkallë lokale herë pas here ndodhin me ngjarje jo të zakonata si reshjet intensive brenda 24 orëve të shoqëruara në disa raste me përmbytje apo mungesa e theksuar e reshjeve që sjell thatësira të zgjatura.

Si vite skajore në Shqipëri janë përcaktuar vitet hidrologjike 1949, 1954, 1957 e 1985 si vite ujëpakët dhe 1963, 1970, 1978 e 1986 si vite ujëshumë. Ndër ata ujëpakët, më i thati paraqitet viti 1949. Në krahasim me mesataren shumëvjeçare, në këtë vit sasia e reshjeve kanë qenë 1.6 herë më pak se norma. Gjatë këtij viti, thatësira ka qenë më e theksuar në Shqipërinë juglindore, si në Voskopojë, Korçë, Leskovik, etj. I dyti për nga thatësira është viti 1953-1954, me 1.4 herë më pak reshje se mesatarja shumëvjeçare. Viti me reshje më të shumta ka qenë viti 1963, me 1.6 herë më shumë reshje se mesatarja shumëvjeçare në shkallë vendi dhe veçanërisht në zonën jugore me 2 herë më shumë se mesatarja. Rajoni i studiuar karakterizohet nga një sasi tepër e vogël reshjesh, rreth 700mm/vit. Në vitet e ardhshme (sipas UNEP, 1994) pritet që deri në vitin 2100, si rezultat i

ngrohjes globale, të ndodhë një ndryshim i temperaturës mesatare vjetore me 0,7-2,5°C, pra luhatje e, gjë e cila do të pasqyrohet edhe në ciklin hidrologjik. Gjatë dimrit pritet që rritja e temperaturës të ndjekë ecurinë vjetore, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet deri me 5%. Gjatë pranverës temperaturat mesatare që ndryshojnë mes 13,8 dhe 15,7°C mendohet të ndryshojë në 15,2°C dhe 18,5°C, ndërsa sasia e reshjeve do të rritet me 0,18%. Gjatë verës temperaturat mesatare do të luhaten nga 23,2°C në 24,7°C, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet me 60%. Gjatë vjeshtës ndryshimi i temperaturës pritet të jetë më i madh se ai vjetor, për shkak të verës së zgjatur, ndërkohë që sasia e reshjeve pritet të rritet me 53%.

Këto ndryshime të klimës do të ndikojnë edhe në rezervat ujore duke shkaktuar:

- Zvogëlim të rrjedhjes së ujërave sipërfaqësorë gjatë thatësirës së verës, veçanërisht në zonat jugore të Shqipërisë me 2% deri në 2030 dhe 5% deri në 2100;
- Keqësim të problemeve të ujit, veçanërisht atij të pijshëm, si gjatë stinës së verës për shkak të pakësimit të reshjeve, ashtu edhe gjatë vjeshtës për shkak të rritjes së turbullirës së ujit;
- Rritje e evapotranspiracionit për shkak të rritjes së temperaturës duke sjellë dhe zvogëlim të sasisë totale të ujit;




Fig.- 11 Harta e diellëzimit të Shqipërisë (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri *Klimatologjia*)




Fig.12 - Shpërndarja territoriale e sasisë vjetore të orëve me diell (Burimi: *Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia*)




Fig. – 13 Harta e zonave dhe nenzonave klimatike (Burimi: Banka Boterore dhe UNDP, 2012)

5. Habitati dhe biodiversiteti

5.1. OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË NIVEL KOMBËTAR

Qeveria Shqiptare ka hartuar një Strategji Kombëtare për Mjedisin në kuadrin e Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim qeveria Shqiptare do të rrisë me 3,5 miliard lek gjatë periudhës 2011- 2013 nivelin e shpenzimeve kapitale totale për të evidentuar dhe rehabilituar “pikat e nxehta” dhe për ndërtimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të rrezikshme.

5.2. Biodiversiteti

Një ndër objektivat më të rëndësishëm është “Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, i zonave dhe llojeve të mbrojtura, si dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe mjedisit në përputhje me angazhimet evropiane dhe ndërkombëtare.

Mbrojtja e biodiversitetit është një ndër elementët kyç të zhvillimit të qëndrueshëm. Që nga viti 1999, është adoptuar Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin (SPVB). SPVB është një dokument kyç që përcakton qëllimet, objektivat dhe masat që duhen marrë lidhur me menaxhimin e biodiversitetit në Shqipëri për periudhën kohore 2000 – 2015, gjë e cila reflektohet edhe në Strategjinë Kombëtare të Mjedisit. Qëllimet themelore të ruajtjes së biodiversitetit janë:

- Përfaqësimi i të gjithë zonave të dallueshme natyrore në rrjetin e zonave të mbrojtura dhe në peizazhet e ruajtura;
- Mirëmbajtja e proceseve evolutive dhe ekologjike që mundësojnë një Biodiversitet të qëndrueshëm.
- Ruajtja e specieve të llojeve të qëndrueshëm;
- Ruajtja e grupeve të habitateve të mëdha natyrore aq sa mund të jenë elastike në një shkallë të gjerë nga shqetësimet rastësore dhe ato afatgjate.
- Përmirësimi i menaxhimit të zonave dhe llojeve të mbrojtura ekzistuese duke u siguruar që objektivat e zonave janë përmbushur;
- Zgjerimin e rrjetit të zonave të mbrojtura për të siguruar një mbulim të plotë të të gjithave habitateve të detit, bregdetit dhe atyre tokësore;
- Përmirësimi dhe përshtatja e ligjeve ekzistuese për mbrojtjen e mjedisit;
- Përmirësimi i informacionit dhe i të dhënave për menaxhimin e biodiversitetit.

Një game e gjerë aktiviteteve ndikojnë mbi biodiversitetin, për rrjedhojë një game po aq i gjerë masash duhet marrë. Për këtë arsye numri i masave që do të kontribuojë në arritjen e objektivave për mbrojtjen e biodiversitetit janë të përfshira në seksione të tjera të strategjisë ku bëjnë pjesë ndër të tjera edhe:

- Menaxhimi i integruar i peizazhi;
- Planifikimi i menaxhimit të shtratit të lumenjve- menaxhimi i burimeve ujore;
- Përdorimi dhe ndotja e ujit- menaxhimi i burimeve ujore;
- Planifikimi i kufizimeve të përdorimit të tokës dhe – peizazhit;
- Menaxhimi i vend grumbullimit të mbetjeve - Menaxhimi i mbetjeve urbane

Integrimi i konsideratave dhe i prioriteteve të biodiversitetit është i rëndësishëm për këto zona. Prandaj një vëmendje e veçantë është kushtuar azhurnimit dhe mbështetjes së iniciativave të

mëparshme të integritit të lëna pas dore. Janë të nevojshme të merren shtatë masat e mëposhtme në tabelë:

Tabela 3.3.1 -a Masat përparësore për mbrojtjen e Biodiversitetit		
Masat	Përshkrimi	Masat kryesore përparësore publike
1.	Forcimi i Kuadrit Ligjor për Mbrojtjen e Natyrës	Përmirësime afat-shkurtra të legjislacionit për mbrojtjen e natyrës; zbatim i Ligjit të Biodiversitetit duke përfshirë trajnimin e Qyteteve, Zbatim i Direktivës së Zogjve (2008-2009)
2	Forcimi i Menaxhimit të Administratave të Mbrojtjes së Natyrës	Forcimi i Llogorasë, Divjakës, Lurës, Dajt, Hotova. Menaxhimi i Zonave të mbrojtura (2009)
3	Zhvillimi i Planeve të Menaxhimit për të gjitha Zonat e Mbrojtura	Është menduar që të gjitha vendet të cilat janë përcaktuar para fundit të vitit 2012 do të kenë plane të menaxhimit të plotë deri në fund të 2015.
4	Rritja e Menaxhimit të Specieve të Mbrojtura	Forcimi i Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit (2010), Ndërmarrja e fushatës për të zvogëluar numrin e armëve të zjarrit pa leje
5	Zbatim i Planeve të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur dhe Specieve	Sigurimi i objektivave për menaxhimin e zonës së mbrojtur janë përfshirë si kritere kyç në udhëzuesin shëndetësor të MM.
6	Integrimi i objektivave të Strategjisë së Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit në politikën e Shtetit	Sigurimin që udhëzuesi përmbledhës i instruksioneve i MMP&AU për Ministrinë kryesore të asistojë për integrimin e objektivave të biodiversitetit në sektorët strategjik si pjesë e procesit të VSM-së.
7	Monitorimi i Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Informacionit	Krijimi i Njesisë së Mbrojtjes së Natyrës në kuadër të Agjencisë së Pyjeve dhe Mjedisit (2009).


Njësia e Mbrojtjes Natyrore vepron si një qendër ekspertize për biodiversitetin, e cila do të sigurojë mbështetje dhe këshillim si për Ministrinë ashtu edhe për autoritetet lokale. Detyra tjetër kryesore e saj është hartimi i fazës së parë të të dhënave GIS si dhe sistemi i menaxhimit të informacionit për biodiversitetin si pjesë e EIMS. Kjo përfshin:

- Krahasimin, vlerësimin cilësor dhe futjen e të dhënave për të kompletuar fazën

e parë të procesit të sistemimit të informacionit për biodiversitetin.

- Sigurimi i aksesit ne sistemit të informacionit për biodiversitetin për të mbështetur integrimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit- Prezantime nëpërmjet internetit dhe CD -së në dy nivele (publike dhe administrative).

Fig. – 1 Harta e habitateve kryesore të rajonit të Korçës (Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)



5.3. FLORA

Pyjet dhe shkorretat mesdhetare

Brezi I pyjeve dhe shkorretave mesdhetare perfaqeson formacionin baze dhe me perhapjen me te madhe. Shoqerimi i *Quercetum cocciferii* formon formacionin shkurren te dominuar nga pralli. Shoqerimi i *Arbuto-Ericetum*, i marse me shqopen, eshte formacioni bimor me I perhapur ne kete lugine. Formacione të pyjeve të *Quercus frainetto* e *Quercus cerris* si dhe stadeve të degradimit të tyre (*Carpinus orientalis*, *Ostrya carpinifolia*) takohen në një pjesë të konsiderueshme, derine 1200 m lartesi mbi nivelin e detit. Nga pikpamja fitosociologjike këto pyje i perkasin rendit *Quercetalia pubescentis* dhe aleancës *Quercion frainetto-cerris*, *Ostryo-Carpinion orientalis*. Pylli natyror dominohet kryesisht nga *Quercus cerris*, i shoqeruar nga *Quercus pubescens* apo *Quercus frainetto*.

5.4. FAUNA

5.4.1. AMFIBET DHE REPTILET (HERPETOFAUNA)

Herpetofauna e zones gezon nje pasuri llojore te rendesise mesatare.

Tab. – 1 *Amfibët e pranishëm në zonë (Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)*

Nr.	Llojet	Stat. Komb.
1	Bombina variegata	LRnt
2	Bufo bufo	LRt
3	Bufo viridis	LRnt
4	Rana balcanica	VU
5	Rana dalmatina	LRlc
6	Rana graeca	LRnt
7	Triturus vulgaris	LRlc

VU – te Perkeqesuara, **LRnt** – Rrezik i Ulet pothuajse te kercenuara, **LRcd** - Rrezik i Ulet ne varesit te masave mbrojtese, **LRlc** – Rrezik i Ulet pak te prekura.

Llojet më të zakonshme të amfibeve përfshijnë *Bombina variegata* dhe *Rana balcanica*. Midis reptileve vlen të përmendet prania e *Natrix natrix*, *Elaphe quatrolineata*, *Malpolon monspensulanum*, *Testudo hermanni* etj. Të gjithë amfibët e pranishëm në zonë vlerësohen si të

kërcënuar në kontekstin kombëtar. Vetëm *Rana balcanica* i përket kategorisë Vulnerabel. Statusi i llojeve të tjera i takon kategorisë Rrezik i Ulet. Pothuajse të gjithë reptilet e rajonit futen në listën e kuqe të vendit. Pjesa më e madhe i takon kategorisë Rrezik i Ulet, dy lloje (*Elaphe quatrolineata*, *Elaphe situla*) cilesohen si të Perkeqesuar (Vulnerabel).

Tab. – 2 Reptilet e pranishëm në zonën e projektit (Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)

Nr.	Llojet	Stat.
1	<i>Anguis fragilis</i>	NE
2	<i>Coluber caspius</i>	
3	<i>Coluber gemonensis</i>	LRnt
4	<i>Coluber jugularis</i>	LRlc
5	<i>Coronella austriaca</i>	LRnt
6	<i>Elaphe longissima</i>	LRnt
7	<i>Elaphe quatrolineata</i>	VU
8	<i>Elaphe situla</i>	VU
9	<i>Emys orbicularis</i>	LRnt
10	<i>Lacerta viridis</i>	LRlc
11	<i>Malpolon</i>	NE
12	<i>Natrix natrix</i>	LRlc
13	<i>Natrix tessellata</i>	LRnt
14	<i>Podarcis muralis</i>	NE
15	<i>Testudo hermanni</i>	LRnt
16	<i>Vipera ammodytes</i>	LRlc

CR- Teper e Rrezikuar, E – E Rrezikuar, VU – Vulnerabel, LRnt – Rrezik i Ulet thuajse të kercenuar, LRcd – Rrezik i Ulet ne varesi te konservimit, LRlc – Rrezik i Ulet pak te prekura.

5.4.2. SHPENDËT

Në zonë janë të pranishëm rreth 39 lloje shpendësh, të cilët jepen në tabelën e mëposhtme së bashku me statusin kombëtar të ruajtjes.

Tab. – 3 Shpendët e pranishëm në zonë (Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)

Nr.	Emertimi latin	Stat. Kom
-----	----------------	-----------

1	<i>Ixobrychus minutus</i>	
2	<i>Nycticorax nycticorax</i>	VU
3	<i>Ardeola ralloides</i>	VU
4	<i>Egretta garzetta</i>	VU
5	<i>Ardea cinerea</i>	VU
6	<i>Ciconia ciconia</i>	CR
7	<i>Anas penelope</i>	
8	<i>Anas crecca</i>	
9	<i>Anas platyrhynchos</i>	
10	<i>Pernis apivorus</i>	EN
11	<i>Circaetus gallicus</i>	
12	<i>Circus aeruginosus</i>	
13	<i>Circus cyaneus</i>	
14	<i>Circus pygargus</i>	
15	<i>Accipiter nisus</i>	EN
16	<i>Buteo buteo</i>	VU
17	<i>Falco naumanni</i>	VU
18	<i>Falco tinnunculus</i>	VU
19	<i>Falco columbarius</i>	VU
20	<i>Falco peregrinus</i>	VU
21	<i>Perdix perdix</i>	
22	<i>Coturnix coturnix</i>	
23	<i>Phasianus colchicus</i>	CR
24	<i>Rallus aquaticus</i>	

Nr.	Emertimi latin	Stat. Kom
25	<i>Tyto alba</i>	VU
26	<i>Strix aluco</i>	LRnt
27	<i>Asio otus</i>	LRnt
28	<i>Asio flammeus</i>	
29	<i>Upupa epops</i>	VU
30	<i>Jynx torquilla</i>	LRnt
31	<i>Picus viridis</i>	LRlc
32	<i>Dendrocopos major</i>	
33	<i>Dendrocopos syriacus</i>	
34	<i>Dendrocopos minor</i>	
35	<i>Acrocephalus scirpaceus</i>	LRnt
	<i>Acrocephalus</i>	
36	<i>arundinaceus</i>	
37	<i>Sitta europaea</i>	LRnt
38	<i>Remiz pendulinus</i>	VU
39	<i>Corvus frugilegus</i>	

CR- Teper e Rrezikuar, E – E Rrezikuar, VU – Vulnerabel, DD – Mungese te Dhenash, LRnt – Rrezik i Ulet thuajse te kercenuar, LRcd – Rrezik i Ulet ne varesi te konservimit, LRlc –

Ne baze te tabelës verejme se prej 39 llojeve te shpendeve te pranishem ne zone 22 prej tyre jane te rrezikuar ne shkalle kombetare. Prej ketyre 17 lloje i perkasin kategorive te larta te rrezikimit (CR, EN,VU).

5.4.3. GJITARËT

Në zonë numërohen rreth 20 gjitarë nga të cilët 6 janë të rrezikuar në shkallë kombëtare. Prej këtyre 3 lloje bien në kategoritë e larta të rrezikimit (CR,EN,VU).Nga mishngrënësit takohen dhelpra (*Vulpes vulpes*), baldosa (*Meles meles*), dhe nuselalja (*Mustela nivalis*). Në mjediset ujore të zonës takohet rrallë edhe lunderza (*Lutra lutra*). Pyjet dhe mjediset ujore të zonës janë zona me rëndësi të vecantë për lakuriqet e natës (lloje te gjinive *Rhinolophus*, *Myotis*, dhe *Pipistrellus*) të cilët i vizitojnë ato për ushqim dhe pirje uji. Gjitarët e pranishëm në zonë së bashku me statusin e tyre kombetar të ruajtjes janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Tab. – 4 Llojet e gjitarëve (Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)

Speciet	Emri shqip	Statusi kombetar i ruajtjes
Erinaceus concolor	Iriqi	
Talpa sp.	Urithi	
Crocidura sp.	Hundegjati	
Rhinolophus ferrum-equinum	Lakuriqnate hundpatkua i madh	LRcd
Rhinolophus blasii	Lakuriqnate hundpatkua i Blasius-it	LRnt
Rhinolophus euryale	Lakuriqnate hundpatkua i	VU
	Mesdheut	
Myotis myotis	Lakuriqnate veshmiu i madh	
Myotis blythi	Lakuriqnate veshmiu i vogël	
Pipistrellus pipistrellus	Pipistreli i zakonshëm	
Pipistrellus savii	Pipistreli i Savi-it	
Pipistrellus kuhli	Pipistreli i Kuhl-it	
Lepus capensis	Lepuri	
Microtus epiroticus	Miu i Ondrias-it	

Microtus thomasi	Miu i Thomasit	LRnt
Apodemus sylvaticus	Miu i pyllit	
Mus spicilegus	Miu i maqedonise	
Vulpes vulpes	Dhelpra	
Lutra lutra	Lutra, lunderza	VU
Meles meles	Baldosa	EN
Mustela nivalis	Nuse lalja	

5.4.5. Fauna në habitatet tokësore

Tokat kullosore, arat dhe arat e braktisura që të shndërruara në toka barishtore në afërsi të vendbanimeve dhe fshatrave, sigurojnë mbajtje të një numri të lartë specimesh zogjsh, më së shumti zogjve të vegjël (Rendi: *Passeriformes/Harabelorët*). Në dimër, fushat e hapura përdoren nga tufa trishtilash shoqëruar nga harabela të tjerë të vegjël. Në verë, fushat e hapura sigurojnë terrene shumëzimi për Shkurtën - *Coturnix coturnix*. Gardhet dhe pemët e ndryshme frutore në vendet e hapura vizitohen nga Gushëkuqi - *Erithacus rubecula*, Cerla e zakonshme - *Miliaria calandra*, Harabeli - *Passer domesticus*, Cerri - *Troglodytes troglodytes*, lauresha (*Alaudidae*) dhe shumë lloje trishtilash.

2	Dersnik	1186.8	-	1186.8	-
3	Polenë	435.5	-	435.5	-
4	Vincan	84.6	-	84.6	-

5	Goskove Lart		-		-
6	Goskove Poshte	288.7	-	288.7	-
7	Damjanec	84.2	-	84.2	-
omuna		2282.6	-	2282.6	-

Burimi: Bashkia Korçë. IDRA

Sic shihet, e gjithë sipërfaqja e fondit pyjor është me funksion prodhues. Megjithatë, banorët e kanë kuptuar tashmë, se për pyllin nuk ka funksionë të ndara. Pylli kryen njëkohësisht edhe funksionin prodhues (prodhon lëndë, dru zjarri, dhe siguron kullotje), kryen edhe funksionin mbrojtës (mbron tokën nga rrëshqitja, gërryerja, degradimi), ka edhe funksion rekreativ për njeriun, por siguron edhe jetën e faunës së egër. Pra në tërësinë e vet, pylli i kryen të gjitha funksionet njëkohësisht.

Po ashtu ne **VRESHTAS**, pas viteve '90 shume siperfaqe bujqesore (ish livadhe) kane filluar te kthehen perseri ne livadhe, ndersa ne shume ngastra te tjera dukshem vihet re zhvillimi intensiv i pyjeve te rinj cungishte e shkurre. Ky fenomen shpjegohet se ne kete komune, gjate ketyre viteve ka patur nje levizje te populisise drejt zonave te ulta per pasoje eshte zvogeluar dhe numuri i bagetive dhe presioni ndaj pyjeve. Ky fenomen ka sjelle dhe permiresimin e pyjeve te lisit te degraduar si pasoje e mbikullotjes dhe krasitjes se vazhdueshme gjate 40 viteve te shkuara. Keto si dhe shume faktore te tjere diktuan si domosdoshmeri hartimin/rishikimin e planit te menaxhimit te pyjeve e kullotave per te njohur me mire situaten e pyjeve e kullotave te komunes si dhe per te percaktuar menytrat me te mira per perdorimin dhe trajtimin e tyre ne te ardhmen duke u bazuar ne traditat e hershme te perdorirnit te tyre dhe pjesemarrjen aktive te popullates lokale nepermjet perfaqesimit te tyre nga komisioni i fshatit.

Tab.7 Te dhena per fondin pyjor dhe kullor sipas fshatrave

Fshati	Siperfaq. pyjore ha	E ndare sipas llojeve (ha)				Kullota	Sip.(Ha) Pyje + Kullota
		Halore	Fletore	Cungishte	Shkurre		
Vreshtas	0	0	0	0	0	0	0
Podgorie	71.5	0	0	71.5	0	0	71.5
Bregas	199.5	0	0	0	199.5	0	199.5
Sheqeras	0	0	0	0	0	0	0
KOMUNA	271	0	0	71.5	199.5	0	271

Burimi: Bashkia Korçë. IDRA

Tab.8 Shpërndarja e sipërfaqes pyjore për cdo fshat dhe mënyra e përdorimit të saj.

Fshati	Sip. pyjore ha	Trungishte (Ha)	Menyra përdorimit ha			Cungishte (Ha)	Menyra përdorimit ha			Shkurre (Ha)	Shkurre	Menyra përdorimit ha		
			Perbshket	Grup	Familje		Perbshket	Grup	Familje			Perbshket	Grup	Familje
Vreshtas	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Podgorie	71.5	0	0	0	0	71.5	71.	0	0	0	0	0	0	
Bregas	199.5	0	0	0	0	0	0	0	0	199.5	199.5	0	0	
Shqeras	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
KOMUNA	271	0	0	0	0	71.5	71.5	0	0	199.5	199.5	0	0	

Burimi: Bashkia Korçë, IDRA

Tab.9 Tabela e shpërndarjes së sipërfaqes së kullotave për cdo fshat dhe mënyra e përdorimit

Nr	Fshati	Kullota (Ha)	Menyra e përdorimit		
			Perbshket (Ha)	Grup (Ha)	Familje (Ha)
1	Vreshtas	0	0	0	0
2	Podgorie	0	0	0	0
3	Bregas	0	0	0	0
4	Sheqeras	0	0	0	0
	KOMUNA	0	0	0	0

Burimi: Bashkia Korçë, IDRA

7.3.2 PRODHIMET PYJORE QE PERDOREN ZAKONISHT (DRUTE E ZJARRIT)

Gjëndja aktuale e pyjeve, nuk mundëson plotësimin e nevojave të popullatës për dru zjarri por ato blihen në tregun e lirë ose prodhohen kontrabandë në pyjet përreth fshatit duke e përkeqësuar vazhdimisht gjëndjen e tyre gjë e cila tashmë duhet të marrë fund ose prodhohen po kontrabandë në fshatrat kufitare. Kërkohej një vëmendje më e madhe në mirë administrimin e pyjeve të marra në përdorim për rritjen e kapaciteteve të tyre prodhuese në ndihmë të komunitetit. Komuniteti në përgjithësi për tu ngrohur përdorin material drusorë. Kjo ka qënë traditë e këtyre zonave pasi dhe dimiri është i ashpër. Nga anketimet rrezulton se nevoja për dru zjarri gjatë perjudhës varjon deri

në 6800m³.Duke patur si synim dhe ruajtjen dhe rigjenerimin e pasurive natyrore dhe atyre pyjore sygjerohet dhe është me e lehtë që kjo sasi të merret në treg duke marrë parasysh dhe të ardhurat që kanë këto zona që vinë nga emigracioni.Gjithashtu duhet të merrën masa për të siguruar të gjitha këto sipërfaqe nga prejet ilegale në sipërfaqet e komunës.

Tab.10 Të dhënat për Vithkuqin

Nr	Fshati	Nr. Familjeve	Burimi sigurime te drureve ne mst				
			Nevojat mst	Pyjet kamunal	L. ndertimi (m3)	Pyjet shteteror	-
1	Vithkuq	210	2100	1000	120	1100	-
2	Lubonje	117	1170	500	60	670	-
3	Rehove	27	270	-	15	270	-
4	Roshanj	9	90	-	10	90	-
5	Gjanc	15	150	-	10	150	-
6	Leshnje	47	470	300	25	170	-
7	Shtylle	30	300	100	20	200	-
8	Panarit	185	1850	800	100	1050	
9	Trebicke	8	80	40	10	40	-
10	Grabocke	8	80	30	10	50	-
11	Treske	5	50	50	10	-	-
12	Katund	19	190	-	15	190	-
TOTAL			6800	2550	405	3800	-

Burimi: Bashkia Korçë, IDRA

Tab.11 Të dhëna për Voskopin

Nr	Fshati	Numuri familjeve	Nëvojat për dru zjarri (m ³)		Grumbulluar (m ³) nga		Burime të tjera		
			Për familje	Total m ³	Pyjet komunu n.	Blihen në treg të lirë	Qymyr	Elektrik (kë/h)	Gaz(I)
1	Voskop	545	12	6540	-	6540	-	-	-
2	Dersnik	304	12	3648	-	3648	-	-	-
3	Polene	172	12	2064	-	2064	-	-	-
4	Vincan	131	12	1572	-	1572	-	-	-
5	Goskove Lart	106	12	1272	-	1272	-	-	-
6	Goskove Poshte	237	12	2844	-	2844	-	-	-
7	Damjanec	55	12	660	-	660	-	-	-
Komuna		1550	12	18600	-	18600	-	-	-

Burimi: Bashkia Korçë, IDRA

Tab.12 Te dhena për komunën Vreshtas

Nr	Fshati	Nr.i familjeve	Nevoja per dru zjarri per familje	Tolali m3	Sigurohen ne pyjet komunale (%)	Sigurohen ne pyjet shtetore (%)
1.	Vreshtas	581	6	3486	0	3486
2.	Podgorie	939	6	5634	0	5634
3.	Bregas	372	6	2232	0	2232
4.	Sheqeras	736	6	4416	0	4416
	KOMUNA	2628		15768	0	15768

Burimi: Bashkia Korçë, IDRA

8. Peisazhi dhe turizmi

8.1. TURIZMI DHE POTENCIALI I TIJ NË QARKUN E KORÇËS

Studimet dhe zhvillimet e kohëve të fundit në mbarë botën, po dëshmojnë tashmë se turizmi me fokus trashëgiminë kulturore, është një segment me zhvillim të shpejtë në industrinë e turizmit. Orientimi i turistëve të huaj dhe rritja e tendencës së lëvizjes turistike drejt vendeve me trashëgimi kulturore, ka nxjerr në pah nevojën e analizës së lidhjeve midis destinacioneve dhe potencialeve që ato ofrojnë, me kënaqësinë e turistëve. Qarku i Korçës ka një potencial të lartë të trashëgimisë kulturore e cila përbën një element të rëndësishëm në tërheqjen turistike. Ndonëse zhvillimi i turizmit është në fillimet e tij, është për t'u vlerësuar fakti dhe mundësia, se rritja e turizmit në drejtim të trashëgimisë kulturore, mund të sjellë përfitime të shumta ekonomike dhe sociale për destinacionin si rritjen e punësimit, rritjen e të ardhurave, zbutjen e problemeve sociale dhe rritjen e interesit për mbrojtjen e mjedisit.

Duke marrë shkas nga potencialet kulturore të zonës si dhe përfitimet e zhvillimit të turizmit kulturor ky kapitull është konceptuar në disa çështje dhe nënçështje. *Çështja e parë* e kapitullit lidhet me trashëgiminë kulturore të qarkut Korçë, e cila është konceptuar në dy nënçështje kryesore: trashëgimia kulturore materiale dhe trashëgimia kulturore shpirtërore. *Në çështjen e dytë* të kapitullit trajtohet zhvillimi i turizmit kulturor në qarkun e Korçës. Në këtë çështje jepen aspekte të zhvillimit të turizmit kulturor në rang kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe gjendja aktuale e zhvillimit të turizmit kulturor në qarkun e Korçës. Dy çështjet e fundit të kapitullit të tretë lidhen me zonat apo fshatrat turistike të qarkut të Korçës, avantazhet dhe disavantazhet që ofron zona në funksion të zhvillimit të këtij lloji turizmi si dhe roli i imazhit në zhvillimin e turizmit. Kapitulli përmbyllet me konkluzionet përkatëse të tij. Evidentimi dhe vlerësimi i trashëgimisë kulturore është bërë në bashkëpunim të ngushtë me literaturën e gjerë të studiuesve shqiptarë, brenda këndvështrimit gjeografik të realizimit të objektit të studimit.

Trashëgimia kulturore e qarkut Korçë

Qarku i Korçës ka një potencial të lartë të trashëgimisë kulturore. Ajo përfaqësohet nga trashëgimia kulturore materiale (monumentet arkeologjike, arkitektonike, të kultit, etnografike, etj) dhe trashëgimia kulturore shpirtërore (folklori, këngët, vallet, zejet, festat, gastronomia, etj).

Vlerat e trashëgimisë kulturore materiale

Trashëgimia kulturore materiale përfaqëson një bashkësi vlerash kulturore dhe historike të trashëguara, të shprehura përmes tipologjive të ndryshme arkeologjike arkitekturore, historike, artistike etj. Në qarkun e Korçës, si pjesë e trashëgimise kombëtare ndodhen 158 objekte kulturore, që për nga vlerat e tyre gëzojnë statusin ligjor të monumentit të kulturës. Këto evidentohen si vendbanime arkeologjike, kala, varre monumentale, banesa, ura, objekte kulti etj. Krahas këtyre, ndodhen edhe objekte të tjera, që ndonëse kanë vlera kulturore me rëndësi

kombëtare, nuk mbrohen me status të veçantë. Sipas përcaktimeve të dhëna për trashëgimisë kulturore materiale, monumentet e kulturës në qarkun e Korçës klasifikohen në:

Monumente arkeologjike

Në monumentet arkeologjike përfshihen vendbanimet arkeologjike të llojeve të ndryshme, objekte, dhe elementë të tjerë ndërtimesh me vlera arkeologjike, arkitekturore, historike dhe kulturore që janë rezultat i gërmimeve arkeologjike. Gërmimet arkeologjike të shoqëruara me vëzhgimet në terren, kanë provuar se territoret e Shqipërisë Juglindore (Korça, Kolonja, Pogradeci dhe Devolli), kanë patur një kulturë shumë të zhvilluar në të gjitha epokat historike (prehistori, antikitet dhe mesjetë). Megjithë praninë e një numri të madh të objekteve arkeologjike, kryesisht rrënoja, do të ndalemi në veçanti, në ato të cilat përbëjnë ose ofrojnë mundësi për t'u shndërruar në atraksione turistike; vendbanime, fortifikime (kala) dhe vendvarrime, që krahas vlerave arkeologjike, shkencore, edukative mbartin vlera të rëndësishme turistike.

8.2. VENDBANIMET (KALATË, KËSHTJELLAT, SHPELLAT)

Vendbanimi i Kamnikut në rrethin e Kolonjës përbën vendbanimin më të hershëm të fortifikuar, i ndërtuar me ledhe guri. Rëndësia e vendbanimit të datuar nga studjuesit rreth viteve 2800-2700 p.e.s.¹⁰⁸ evidentohet më së miri nëpërmjet gjetjeve arkeologjike me vlera të rëndësishme shkencore, kulturore dhe turistike të ekspozuara në muzeun e qytetit të Ersekës.

Vendbanimi prehistorik i Maliqit (palafit) i zbuluar pranë qytetit të Maliqit, përfaqëson kulturën më të zhvilluar të vendbanimeve prehistorike shqiptare të periudhave të Neolitit të vonë, Bakrit dhe Bronxit. Banesat në këtë vendbanim kanë qenë ndërtuar në një platformë druri, të vendosura mbi trarë të ngulur në tokë. Ky vendbanim i përket periudhës së neolitit rreth viteve 2600 p.e.s. Qeramika që lidhet me epokën e bronxit dhe që është pagëzuar nga studjuesit me emrin "devollite", përfaqëson një nga arritjet më të mira të artit dekorativ të epokës së bronxit. Materialet e gjetura (enë të ndryshme, vegla pune prej bakri dhe bronxi) paraqesin vlera shkencore, arkeologjike, kulturore, historike, edukative dhe turistike dhe së bashku me maketin e vendbanimit ndodhen të ekspozuara në Muzeun Arkeologjik të qytetit të Korçës. Megjithëse aktualisht i pa vizitueshëm, përshtatja dhe improvizimi i banesave prej druri në këtë vendbanim, do t'a shndërronin atë në një zonë arkeologjike turistike me mjaft interes për turistët e huaj.



Fig. – 1 Harta E Kalave Të Qarkut Korçë, Sipas Periudhave Kohore

Një rast jo aq i ngjashëm nga vlerat dhe rëndësia me vendbanimin prehistorik të Maliqit, por që është shndërruar në një atraksion turistik, është muzeu i vendbanimit palafit, Bay of Bones Museum (1200-700 p.e.s) i ngritur në liqenin e Ohrit, pranë qytetit të Ohrit në FYROM. Po kështu një atraksion turistik përbën edhe vendbanimi neolitik bregliqenor, në fshatin Dispilio 8 km larg nga qyteti i Kosturit në Greqi, i vizitueshëm nga turistët ndërkombëtarë. Vlerat e trashëgimisë arkeologjike dëshmojnë gjithashtu me praninë e vendbanimeve të fortifikura që i përkasin fazës së parë të epokës së hekurit. Kësaj periudhe i përkasin fortifikimet e Gradishtës së Shuecit, Trenit, Ventroikut, Bilishtit, Kakaçit, Gjonomadhit, Lumalasit, Bellovodës, Trajanit, muri pengues i Zvezdës, Podgorisë në Korçë dhe kalaja e Gradecit, Bejkovës, Hollmit, Barmashit, Gradecit i Vrepckës dhe muri pengues porta e hekurit (Kolonjë). Në vështrimin e përgjithshëm, ndonëse

këto fortifikime ruhen në formë pirqje gurësh, nëpërmjet gjetjeve në to, nxjerrin në pah aspekte të zhvillimit social-ekonomik që ka karakterizuar gjithë zonën. Një zonë të rëndësishme ku ndërthuren vlerat natyrore me vlerat arkeologjike përbën zona e liqenit të Prespës së Vogël, e cila për nga interesi që paraqet për turistët e huaj mund të konsiderohet si zonë turistike. Disa nga objektet arkeologjike që ndodhen këtu përmendim:

Gradishtën e Shuecit në trajtën e një ledhi gurësh në kodrën buzë liqenit dhe *kalanë e Ventrokut* mbi shpellën e Trenit, të përcaktuara nga arkeologët, si të vetmet fortifikime të këtij lloji të zbuluara në vendin tonë, të ndërtuara në pika me karakter mbrojtës dhe strategjik.

Kalaja e Trajanit, më e madhja ndër të gjitha kalatë e njohura brenda vendit tonë, rrethon një sipërfaqe 22 ha, në lartësinë 1245 m mbi nivelin e detit¹¹⁴. Ndodhet në trajtë linje muresh taracimi dhe ndonëse në të nuk janë kryer gjurmime arkeologjike, ajo paraqet një qendër të rëndësishme paraurbane për pellgun e Korçës e më gjerë¹¹⁵. Nëpërmjeturvejimeve sipërfaqësore shumëvjeçare është bërë e njohur gjithashtu *piktura shkëmbore e Spilesë*, e ndodhur 500 m larg shpellës së Trenit¹¹⁶, në faqen shkëmbore të masivit që zbret në bregun e liqenit të Prespës së Vogël. Vlerat kulturore dhe artistike trasmetohen në pikturën e gdhendur në shkëmb, nëpërmjet një skene gjuetie me figura kalorësish mbi kuaj, drerë dhe zagarë.

Shpella e Trenit ndodhet në vendin që njihet si “gryka e ujkut”, buzë liqenit të Prespës së Vogël dhe është një kombinim i rrallë i vlerave natyrore me vlerat materialo-shpirtërore¹¹⁷. Është formuar nga procesi i karstit, nga tretja në ujë e shkëmbinjve gëlqerorë mesozoikë, tepër të copëtuar nga shkëputje tektonike të plio-

Sipas spelologëve që eksploran shpellën ajo ka dy hyrje, hyrjen kryesore me lartësi 30 m dhe një hyrjen dytësore rreth 4 m mbi kryesoren. Gjatësia e përgjithshme e saj është 293 m dhe përbëhet nga pesë “salla”, me përmasa të ndryshme. Vlerave natyrore u bashkangjiten edhe vlerat kulturore, pasi shpella ka shërbyer si vendbanim për njerëzit e lashtë që kanë jetuar në zonën juglindore të Shqipërisë. Nga gjetjet e zbuluara prej arkeologëve (prej guri, stralli, kocke, bronxi, hekuri e argjendi) veçanërisht të atyre prej qeramike dëshmohet se banorët e kësaj shpelle krahas bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit kanë qenë mjeshtër në punimin dhe zbukurimin e qeramikës. Në brendësi të saj ndodhen konkelacione stalaktitesh dhe stalakmitesh mjaft interesante. Gjithashtu shpella është vendbanimi i një kolonie lakuriqësh që ndodhen në të. Megjithëse me vlera të rëndësishme shkencore dhe turistike, është e rrezikuar për shkak të dëmtimeve nga mosnjohja e vlerave të saj nga banorët, por edhe nga prania e aktiviteteve të guroreve që kërcënojnë shembjen e pjesëve të brendshme.

Të gjitha këto vendbanime të fortifikuara e shpellore, së bashku me “Goricat e Trenit”, “Pavliqet”

etj., të cilat ndodhen pranë Shpellës së Trenit, përbëjnë një kompleks kulturor, që ruan mbetje sipërfaqësore i ndërthurur me mjedise gjeografike me bukuri të rrallë natyrore¹²⁰ (brenda parkut ndërkufitar të Prespës). Ato kanë nevojë të eksplorojnë, studiohen dhe integrohen realisht në planet e menaxhimit të parkut dhe projektet konkrete, që po ndërmerren nga organizmat shtetërore dhe ndërkombëtare. Kjo do ndikonte në rritjen e numrit të turistëve dhe nëpërmjet kësaj do të krijoheshin mundësitë për zhvillimin e komunitetit që jeton në këtë zonë. Ideja e shndërrimit të shpellës së Trenit në një muze të vizitueshëm, megjithëse kërkon investime të shumta, mbetet një mundësi reale. Po kështu, kthimi i zonës në park arkeologjik do të ndihmonte në ruajtjen e këtyre vlerave, por njëkohësisht do të rriste interesin e vizitorëve e huaj në zonë Treva e Kolonjës përmban gjithashtu potenciale të shumta arkeologjike si *kalaja e Luarasis* (periudha e Bronzit të vonë); *kalaja e Hollmit* në trajtë rrethimesh guri, që e datojnë në fazën e dytë të epokës së hekurit dhe në vijimësi gjatë periudhës Qytetare Romake shek.I-III, pas Krishtit; *kalaja e Bejkovës* ndodhet mbi njërën nga majat e vargut kodrinor (1080 m mbi nivelin e detit) që datohet në fundin e epokës së bronzit deri në periudhën e hekurit të hershëm (shek.XI-IX, parakrishtit); *kalaja e Gradecit (Vrëpckë)* me tipare krejt të veçanta e cila daton në periudhën qytetare ilire (shek.V- IV para Krishtit).




Fig. – 2 Harta E Monumenteve Të Kultit Të Rrethit Korçe

Treva e Kolonjës përmban gjithashtu potenciale të shumta arkeologjike si *kalaja e Luarasit* (periudha e Bronzit të vonë); *kalaja e Hollmit* në trajtë rrethimesh guri, që e datojnë në fazën e dytë të epokës së hekurit dhe në vijimësi gjatë periudhës Qytetare Romake shek.I-III, pas Krishtit; *kalaja e Bejkovës* ndodhet mbi njërin nga majat e vargut kodrinor (1080 m mbi nivelin e detit) që datohet në fundin e epokës së bronzit deri në periudhën e hekurit të hershëm (shek.XI-IX, parakrishtit); *kalaja e Gradecit (Vrëpckë)* me tipare krejt të veçanta e cila daton në periudhën qytetare ilire (shek.V- IV para Krishtit). Përveç fortifikimeve të përmendura më sipër nga viti 600-1400, në Shqipëri janë ndërtuar edhe kështjella të vogla mbi maja kodrash me shpate të thepisura, me karakter mbrojtës apo që mbikqyrnin rrugë e vendkalime të rëndësishme, siç ishte *kalaja e Mborjes* dhe *Podgories* në rrethin e Korçës. Përveç fortifikimeve të përmendura më sipër nga viti 600-1400, në Shqipëri janë ndërtuar edhe kështjella të vogla mbi maja kodrash me shpate të thepisura, me karakter mbrojtës apo që mbikqyrnin rrugë e vendkalime të rëndësishme, siç ishte *kalaja e Mborjes* dhe *Podgories* në rrethin e Korçës.

Vendvarrimet (tumat)

Tumat, (vendvarrimet) ashtu sikurse vendbanimet dhe fortifikimet janë elementë të rëndësishëm të trashëgimisë arkeologjike me mjaft interes në aspektin turistik. Nga studimet e bëra nga arkeologët rezulton se zona e Korçës dhe Kolonjës është e pasur me këtë lloj trashëgimie (tumat e Barçit dhe Kuçit të zi, tumat e Prodanit, Rehovës, Shtikës dhe tuma e Kamenicës). Me studimet e tyre arkeologët, krahas të tjerave eidentojnë edhe një pjesë e rëndësishme e organizmit social të komuniteteve prehistorike, që lidhet me zakonet mortore dhe ritet e varrimit.

Tuma e Kamenicës, ndodhet në ekstremin juglindor të fushëgropës së Korçës, në territorin e komunës Mollaj. Gërmimet e bëra nga arkeologët në vitin 2002, kanë zbuluar një vendvarrim me përmasa më të mëdha se vendvarrimet e zbuluara më parë. Fillimet e saj datojnë në fazën fundore të periudhës së Bronzit të vonë .Aty janë zbuluar rreth 400 varre dhe mbetje skeletore të më shumë se 430 individëve. Interes paraqet mënyra në trajtimin e të vdekurve dhe rasti i vendosjes së dy individëve në të njëjtin varr. Interesante paraqitet gjithashtu gjetja e skeletit të trupit të një gruaje dhe një fëmije në barkun e saj. Kjo tumë është shëndërruar në një atraksion turistik të vizituar nga grupe të ndryshme vizitorësh. Vendvarrimi prehistorik është i përshtatur sipas kriterëve bashkohore të zonave arkeologjike dhe është transformuar në një qendër të rëndësishme të informimit dhe edukimit arkeologjik. Në muzeun e tumës janë të ekspozuara larmi enësh qeramike të pikturuara dhe objekte të tjera metalike (prej bronxi, hekuri, ari, kocke, qelqi apo guri, të cilat dëshmojnë qartë për organizimit social-ekonomik dhe kulturor të komunitetit prehistorik të zonës. Ajo vizitohet në mënyrë të organizuar nga nxënës të shkollave, studentë, vizitorë vendas dhe të huaj. Vizitat janë kundlejt pagesës prej 50 lekë për studentët dhe nxënësit dhe 200 lekë për vizitorët e tjerë. Me mjaft interes për t'u vlerësuar paraqiten grupet e

studentëve të huaj nga gjithë bota, të apasionuar në këtë kategori të trashëgimisë kulturore.

Tuma e Rehovës e zbuluar nga gërmimet arkeologjike (1979-1980) në rrethin e Kolonjës, përbën një tjetër objekt arkeologjik me vlera të rëndësishme edukative dhe turistike. Nga gërmimet arkeologjike krahas 285 varre janë zbuluar 650 objekte me përkatësi kohore të ndryshme (Bronxi i vonë deri Mesjetën e hershme)¹³⁰. Gjetjet e objekte në varre përbëhen nga: qeramikë, armë bronxi e hekuri dhe disa stoli prej bronxi, hekuri, argjendi, floriri, kocke, guri, qelibari etj. Këto objekte iliro-arbërore janë ekspozuar në muzeun e Rehovës.

8.3. MONUMENTET ARKITEKTURORE

Monumentet arkitekturore janë pjesë e pasurisë kulturore që ruajnë vlera të veçanta të konceptimit dhe realizimit arkitekturor dhe artistik. Vendbanimet lakustre apo palafite të zbuluara në Maliq dhe Dunavec, janë monumentet më të hershme, që shënojnë fillimet e arkitekturës në vendin tonë. Larmia e ndërtesave të trashëguara është një element i rëndësishëm, që pasqyron zhvillimin social-ekonomik të komunitetit dhe zonës në periudha të ndryshme kohore.

Varret monumentale

Shprehjen e kësaj kategorie të trashëgimisë e përbëjnë **Varret monumentale të Selcës** si element karakteristik i qytetit ilir në Selcën e Poshtme. Nga gërmimet e bëra në vitet 1970-1972 u zbuluan 4 varre monumentale të grupuara në dy zona, 100 m larg nga njëra-tjetra, që datojnë si kohë ndërtimi shek.III p.e.s. Duke ju referuar të dhënave të hershme historike, kjo zonë ka qenë e banuar nga fiset ilire të dasaretëve dhe Selca e Poshtme ose Pelioni ka qenë qyteti kryesor i Dasaretisë. Në një prej varreve mendohet të jetë varrosur Kliti, mbreti ilir i Pelionit. Përveç varrezave të cilat janë unikale në Evropë për nga mënyra e ndërtimit në shkëmb, ndodhen edhe disa shkallë, një mur dhe amfiteatri. Për vlerat e larta kulturore që ato përmbajnë janë shpallur monumente kulture në vitin 1971 dhe “Zonë Arkeologjike” në vitin 2010.

Varret monumentale të Selcës, të ndodhura në largësi dhe në vështirësi arritjeje nga qyteti i Pogradecit, (46 km) vizitohen spontanisht nga turistët e tërhequr nga monumentet kulturore apo dhe turistët shëtitës në natyrë.

Në rrethin e Kolonjës, ndodhen dy varre monumentale të gdhendur në shkëmb (varri i Sëndyqit-Shtikë dhe varri i Krajlit), që nuk janë monumente kulture, por janë pjesë e vlerave të trashëgimisë prehistorike të saj. *Guri i Sëndyqit – Shtikë*, ka tipin e një varri “sargofag” dhe ndodhet në një kodër të vogël, 1.5 km para se të shkosh në fshatin Shtikë, komuna Mollas. *Varri i Krajlit*, është vendosur mbi një masiv gëlqeor që njihet nga banorët si “Çaushko”, 3 km larg qytetit të Leskovikut. Të dy varret ruhen të hapura, pasi u mungojnë kapakët. Ato kanë vlera shkencore, arkitekturore dhe turistike.

Banesat

Banesa është një tjetër element i rëndësishëm dhe spikatës i trashëgimisë arkitekturore të qytetit por edhe fshatit. Zhvillimet social-ekonomike në Shqipëri, pas viteve 1990 e kanë

transformuar hapësirën e vendbanimeve rurale dhe urbane duke cënuar karakterin identifikues të tyre. Ndonëse në qytetin e Korçës, banesat e vjetra kanë ardhur duke u pakësuar dhe në mjaft raste zëvendësuar me tipe të reja, qendra historike e qytetit ka ruajtur disa elementë të hershëm të banesës tradicionale. Në mënyrë të veçantë në qytetin e Korçës, mori një zhvillim të dukshëm banesa e hapur me hajat dhe çardak, e cila shoqëroi zhvillimin social-ekonomik të zonës në fundin e shek.XIX dhe fillimin e shek.XX. Disa nga tipet më karakteristike të banesës qytetare në zonën historike të qytetit, paraqesin vlera të veçanta në aspektin arkitekturor dhe turistik. Disa prej këtyre banesave janë godina e Mësonjëtores së Parë Shqipe, banesa e Pandeli Rados, banesa e Zengove, banesa e Vangjush Mios, banesa e Ilo Kotes, etj.

Godina e Mësonjëtores së Parë Shqipe, është një shtëpi dykatëshe, me dritare mbi rrugë dhe oborr të rrethuar me kangjella që ndodhet në bulevardin Shën Gjergji të qytetit të Korçës. Skema planimetrike e saj është konceptuar sipas dobisë funksionale të banesës korçare. Në vitin 1887 kjo banesë u dhurua nga Mandi Tërpo (i zoti i shtëpisë) për mësimin e gjuhës shqipe. Ajo shërbeu si shkollë deri më 7 mars të vitit 1958, kur u shndërrua në muze të arsimit kombëtar. Arkitektura e banesës ku është vendosur muzeu, ekspozimi i dokumentave shkollore të periudhës së çeljes së shkollës së parë shqipe dhe historiku i saj janë elementë tërheqës për vizitorët. Në stendat e Muzeut ekziston fotokopja e Abetares së parë shqipe, e shkruar nga patrioti Kostandin Kristoforidhi. Hyrja është e lirë dhe muzeu shërben gjithashtu për kryrjen e aktiviteteve kulturore si ekspozita piktorësh dhe promovime të tjera në fushën e kulturës.

Banesa e Piktorit të Popullit Vangjush Mio, është shembulli më tipik i banesës së hapur, me vlera të veçanta arkitekturore. Ndërtesa ka pamjen e një banesë dykatëshe, me elemente të tillë si çardaku, hajati dhe qilaret. Karakteristikë është prania e musendrave, ku mbaheshin shtrojet dhe qilimat, si edhe elementet dekorues të drurit në secilën nga dhomat. Në një nga dhomat tyre është shënuar një datë 1841 ndërkohë që një tjetër dhomë, është përdorur si studio nga piktori rreth viteve 30 të shek.XX. Brenda oborrit ngrihet një ndërtesë tjetër që ka shërbyer si "mysafirane". Banesa ka vlera arkitektonike, kulturore, artistike, turistike etj. dhe shërben si muze i piktorit të mirënjohur kombëtar.

Banesa e Ilo Kotes është tepër e veçantë në pamjen e jashtme, të pasur me elementë arkitekturorë. Sipas datës të shënuar në mur mendohet të jetë ndërtuar në vitin 1842. Banesa është dykatëshe dhe në hyrje të saj prezantohet me tre harqe. Trajtimi arkitektonik e dekorativ i tyre është i thjeshtë dhe i pangarkuar me elemente druri. Skema planimetrike i korespondon variantit të banesave me çardak në qendër, të përhapura në qytetet e tjera të vendit, por shënon edhe futjen e tipareve të reja në arkitekturë. Banesa ndodhet në oborrin e muzeut arkeologjik dhe tërheq vëmendjen e vizitorëve vendas dhe të huaj. Megjithëse ka vlera të rëndësishme kulturore, artistike, arkitekturore dhe turistike, ndërtesa vuan mungesën e

ndërhyrjeve për mirëmbajtjen e saj. Rijetëzimi i banesës nëpërmjet një rikonstruksioni të përgjithshëm dhe përshtatjes për funksion turistik, do tërhiqte jo vetëm vizitorë por do të ruante edhe vlerat e saj.

Godina e Liceut të vjetër është ndërtuar në fund të shek.XIX dhe fillim të shek.XX. Është një godinë dy katëshe, e pajisur me bodrume. E gjithë godina është e ndërtuar prej guri, me fashaturë dhe dysheme prej druri. Nisur nga vlerat e larta arkitekturore dhe kulturore që ajo përmban është shpallur monument kulture në vitin 1973. Aktualisht kjo godinë kryen funksion arsimor (shkollë e mesme pedagogjike). Zhvillimi social- ekonomik i qytetit të Korçës në fillim të shek. të XX, gjendet i pasqyruar në prezencën dhe huazimin e disa elementëve të veçanta të arkitekturës, të sjella nga vende të tjera. Shembull tipik paraqet *banesa rumune*, që për sa i përket aspektit arkitekturor ka elementë të ndryshëm nga banesa tradicionale korçare, e mbingarkuar me kolona, harqe, relieve me suva etj. E njëjta pamje vërehet edhe në ndërtesën e bibliotekës "*Thoma Turtulli*", ku ndeshemi me zbukurime të stilit antik, jo fort të zakonata për banesën tipike korçare.

Krahas banesës qytetare, me tipare të veçanta arkitekturore, të trasmetuara deri në ditët tona, janë dhe *banesat e fshatit*. Në zonën e Korçës dallohet tipi i banesës dardhare, dy-trekatëshe e ndërtuar me gurë dhe çati me rrasa guri (plloça), i cili është ruajtur edhe në ndërtimet e reja. Po kështu, banesat në fshatin Voskopojë janë të ndërtuara me gurë, sipas traditës së ndërtimit të shtëpive të vjetra voskopojare. Fakti që Voskopoja është shpallur "Qendër Historike", nga Instituti Monumenteve të Kulturës, ka kushtëzuar respektimin e fizionomisë urbanistike të saj dhe karakteristikave të ndërtimeve të reja. Elementë të tilla si hajati, çardaku, çatia me rrasa guri, oxhaku, vatra, oda e miqëve, qilari, portat e gdhëndura, sofatet janë gjithashtu karakteristika të banesës së Rehovës, Borovës, Qafëzezit, Vodicsës, Postenanit etj., në trevat e Kolonjës dhe Leskovikut. Përveç kuptimit material këto elementë mbartin kuptim figurativ shpirtëror. Fjala "oxhak", "portë" dhe "derë", (familje me oxhak; është prej dere;) nënkuptonin gjendjen ekonomike të familjes, pozitën shoqërore dhe emrin e mirë në fshat dhe jashtë tij.

Tipi kullë i banesës krahas funksionit të banimit ka edhe karakter mbrojtës. Në qarkun e Korçës kulla haset në fshatrat Turan, Malavec dhe Dishnicë. Sipas studiuesve ndërtimi i kullave lidhet me një periudhë historike të veçantë, atë të sistemit të çifligut në Shqipëri (XVII-XVIII).

8.4. PAZARI, HANET E QYTETIT TË KORÇËS

Në organizimin hapësinor të një qyteti, *tregu apo pazari* luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik të tij, nëpërmjet lëvizjes së njerëzve, shkëmbimit të mallrave dhe kulturës. Korça dhe pazari me arkitekturën e tyre shprehin qartë natyrën zejtaro-tregtare të zhvilluar të këtij qyteti. Pazari arriti kulmin e fuqisë së tij gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, që përkon edhe me zhvillimin e vrullshëm të qytetit. Në gjendjen e sotme pazari ruan ato pjesë që u rindërtuan pas zjarrit që e dogji në vitin 1879. Për sa i përket organizimit hapësinor të tij, fizionomia e pazarit dallohet për elementë të pasur arkitekturorë. Po të shikojmë

hapësirën e zonimit të pazarit vihet re një ndarje funksionale e njësive prodhuese dhe tregtuese, nga ndërtesat që shërbenin për pushim (hanet). Sipas dëshmive dyqanet dhe aktivitetet prodhuese e tregtare kanë qenë të përqendruara sipas zejeve (kovaçinjeve, kallajxhinjeve, tregtarëve të mishit, tregtarëve e bulmetit, këpucarët, rrobaqepësit, etj). Në pamjen e sotme dyqanet dykatëshe, në arkitekturën e jashtme dhe të brendshëm, ruajnë elementët dekorative si qemerët, harqet, kangjellat, qepenat etj.

Pazari i qytetit të Korçës tërheq vëmendjen e vizitorëve për arsye të funksionit të tij, vlerave arkitekturore dhe organizimin hapësinor të tij. Ka vite që i është nënshtruar procesit të rikonstruksionit, për t'a shndërruar në një qendër tregtare tradicionale. Megjithëse i vjetër dhe me vlera të rëndësishme, po aq sa pazaret e vendeve fqinje, Strugës, Shkupit, Prizrenit, Gjakovës, ndonëse ato me kohë funksionojnë si qendra tradicionale tregtare dhe turistike, pazari i qytetit të Korçës ende vuan nga mungesa e vizionit dhe mirëmenaxhimit nga ana e institucioneve përkatëse.

Përveç dyqaneve dhe ndërtesave të tjera, vlera të rëndësishme paraqet edhe prania e haneve. Ato ndodhen brenda pazarit dhe shërbenin si vende takimi për tregtarët dhe vend çlodhës dhe fjetës për njerëzit që vinin nga larg në pazar, për të tregtuar apo për të blerë. Sipas studiuesve mendohet të kenë qenë 15-16 hane, kurse sot më tipikët dhe më me interes paraqiten hani i Elbasanit, hani i Gjellit dhe hani i Manastirit, të cilët për vlerat e tyre arkitekturore, janë shpallur monumente kulture.

Hani i Manastirit ndodhet pranë hanit të Elbasanit me hyrje nga pjesa kryesore e pazarit. Nga ana ndërtimore ai përfaqëson një periudhë më të vonë, e cila ka sjellë të reja kryesisht në teknikë e në material ndërtimi si dhe në mbylljen e njësive të hapura, por ka trashëguar skemat e vjetra kompozicionale. *Po ti kthehemi funksionit të haneve, ato kanë shërbyer si bujtëse për të gjithë ata që vinin në qytet dhe zonën e Korçës, për tregëti apo edhe për qëllime të tjera. Tashmë megjithë rikonstruksionin e pazarit, ato duken larg përshtatjes së tyre për këtë funksion.*

Urat janë objekte me vlera arkitekturore që janë trashëguar nga shekujt e kaluar. Disa prej këtyre urave janë shpallur monumente kulture si ura e Golikut në Pogradec, ura e Kovaçit në Voskopojë, ura e Zotos në Vithkuq etj. Monumente historike Zona e Korçës trashëgon objekte me vlera të rëndësishme kombëtare e më gjerë, dorëshkrime, libra dhe periodikë, që ruhen në muzetë e qytetit të Korçës, Pogradecit dhe Ersekës. Ato mund të konsiderohen si institucionet edukative, që udhëheqin promovimin e trashëgimisë kulturore por njëkohësisht edhe institucionet e konservimit të saj.

8.5. MUZETË

Trashëgimia historike e qarkut të Korçës ruhet në muzetë e ndërtuar në qytetin e Korçës,

Pogradecit, Ersekës, ndër të cilët do të përmendim për vlerat e tyre:

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar është hapur në vitin 1980 dhe ndodhet në qendën historike të qytetit të Korçës. Ekspонатet dhe fondet e pasura të tij me objekte historike, kulturore e artistike, që lidhen kryesisht me trashëgiminë e krishtere bizantine dhe pasbizantine, janë shembuj të një pasurie e larmie vlerash të paçmuara. Ekspozimi i tyre është realizuar pjesërisht në sallën e ekspozitës me rreth 200 objekte arti, çka paraqesin vetëm një pjesë të veprave më të mira mesjetare, nga autorë anonime apo të identifikuar. Kështu midis tyre dallohen ikonat e shek.XIII- XIV, duke vijuar më pas me kryemjeshtrat si Oufri, Nikolla, Onufër Qiprioti, Simoni i Ardenicës, Kostandin Jeromanaku, vellezërit Zografi, David Selenicasi etj. Në mes të këtij koleksioni janë rreth 150 autorë ikonografë shqiptare dhe të huaj të zbuluar deri më sot.

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar është nga objektet më të vizitueshëm në qytetin e Korçës, veçanërisht nga turistët ndërkombëtarë. Ekspozita e muzeut është vizituar nga ekspertë të fushës së artit mesjetar dhe restaurimit, nga një numër i konsiderueshëm artdashësish, pelegrinësh, studentësh, nxënësish vendas dhe të huaj. Në vitin 2009 muzeu u vizitua nga 3180 vizitorë vendas dhe të huaj, ndërkohë që në vitin 2012 numri i vizitorë ishte 4652, prej të cilëve 1534 vizitorë vendas dhe 3118 vizitorë të huaj. Prezantimi i vlerave për vizitorët e huaj bëhet nga dy specialistë të muzeut, kryesisht në anglisht dhe italisht, por nuk mungon edhe në gjuhë të tjera.

Muzeu Arkeologjik, u krijua në vitin 1985, por formë të plotë mori pas vitit 1990. I vendosur në një ndërtesë karakteristike korçare, të fillimit të shek XIX, muzeu Arkeologjik i përket prehistorisë së zonës juglindore dhe është i veçantë në llojin e vet. Këtu janë të ekspozuar 1200 objekte autentike të zbuluara nga gërmimet arkeologjike në shumë vendbanime prehistorike, që tregojnë zhvillimin e kulturës në Shqipërinë Juglindore, që nga mijëvjeçari i gjashtë para Krishtit deri në shek.VI. Me mjaft interes paraqiten maketet e disa vendbanimeve të rëndësishme prehistorike si: Maliqi, Dunavec, Trajani, etj. Ky muze vizitohet nga nxënës, vizitorë vendas dhe të huaj. Në vitin 2012 muzeu u vizitua nga 3760 vizitorë vendas dhe të huaj. Hyrja në muze është kundrejt biletës prej 200 lekë. *Megjithë interesin e konstatuar të vizitorëve të huaj, gjendja dhe mirëmbajtja e tij, lë për të dëshiruar dhe nuk i përgjigjet vlerave arkeologjike dhe arkitekturore që ky muze posedon.*

Muzeu Kombëtar i Arsimit, është ngritur në godinën ku më 7 mars 1887 u hap Shkolla e Parë Shqipe ose "Mësënjtorja". Arkitektura e banesës ku është vendosur muzeu, ekspozimi i dokumentave shkollorë të periudhës së çeljes së shkollës së parë shqipe dhe historiku i saj janë elementë tërheqës për vizitorët. Në stendat e Muzeut ekziston fotokopja e Abetares së parë shqipe, e shkruar nga patrioti Kostandin Kristoforidhi. Vizitohet nga nxënës, student, vizitorë vendas dhe të huaj.

Muzeu Historik i rrethit të Kolonjës, në qendër të qytetit e Ersekës, është një ndër muzetë e parë të hapur në shkallë republike (shkurt 1962), që e ruan fizionominë e tij edhe në ditët e sotme duke i shpëtuar shkatërrimeve të viteve të tranzicionit. Triptiku në fasadën e tij, vepër e skulptorit Vasiliev Nini, pasqyron etapat e zhvillimit historik të trevës së Kolonjës, që në prehistori dhe deri në fund të periudhës së diktaturës. Në katin e parë, është pozicionuar në një mjedis të veçantë “oda e miqve” ose “oda kolonjare”, ku shpalosen traditat e kësaj treve. Kjo pëlqehet shumë nga turistët vendas dhe të huaj që e vizitojnë atë. Muzeu mbart vlera të rëndësishme arkeologjike, kulturore, artistike dhe turistike, por vizitohet shumë pak. Në vitin 2012 ai u vizitua nga 110 vizitorë, kryesisht ndërkombëtarë, të cilët janë pjesë e itinerarit Korçë- Ersekë-Leskovic-Përmet-Gjirokastër.

Muzeu “Bratko”, është çelur në vitin 2003, si dhuratë e një shqiptari, Dhimitër Borja, artist, fotograf dhe mbledhës i artit aziatik dhe të antikitetëve. Muzeu Bratko është një muze oriental, kryesisht me vepra arti nga vendet në të cilat ka qenë vetë dhuruesi. Veprat e artit që ndodhen në muze janë vepra (rreth 430) si piano, altar kinez, veshje për gra japoneze, rripa kineze, shpate indoneziane, piktura japoze, fotografi të ndryshme të bëra nga dhuruesi gjatë misionëve të tij. Ndonëse i vendosur në një ndërtesë tërësisht të ndryshme nga ndërtimet tradicionale, pëlqehet të vizitohet për shkak të natyrës së tij të veçantë.

Shtëpia muze e piktorit Vangjush Mio, përbën një tjetër atraksion turistik (monument kulture) me një fond pikturash të ekspozuara me larmi peisazhes, natyrë të qetë si dhe shumë vizatime, të cilat janë të njohura për stilin e veçantë të realizimit. Vangjush Mio është piktori i parë shqiptar i peisazhit që ka hapur ekspozitën e parë në Tiranë në 1920. Vizitohet nga të apasionuarit e peisazhit dhe pikturës.

8.6. DORËSHKRIMET

Krahas monumenteve arkeologjike dhe arkitekturore, ekzistenca e burimeve dokumentare të shkruara, janë një element i rëndësishëm i trashëgimisë sonë, që dëshmojnë për zhvillimin shoqëror, historik dhe kulturor të trevave të veçanta dhe gjithë Shqipërisë. Një vend të veçantë dhe një pasuri të çmuar përbëjnë dorëshkrimet bizantine dhe postbizantine të njohur si *Kodikët e Shqipërisë*. Janë një fond prej 100 kodikësh, të cilët ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror, si një pasaportë kulturore e padiskutueshme e identitetit dhe krenarisë sonë kombëtare. Në këtë pasuri një vend të rëndësishëm krahas Kodikëve të Beratit, zenë edhe kodikët e Korçës.

Kodiku i Metropolisë së Korçës dhe Sefalosforit i vitit 1676, i hulumtuar nga mjaft studiues brenda dhe jashtë vendit, ka hedhur dritë mbi veprimtarinë ekonomike, shoqërore dhe kulturore të trevës së Korçës në shekujt XVIII-XIX¹⁵¹. Po kështu më vlera paraqiten gjithashtu *kodiku i*

Voskopojës si dhe *kodiku i Korçës 93* (Katërunjillëshi i shek.X), i cili dëshmon për lidhjen në përgjithësi të mjedisit të Shqipërisë së sotme me kryeqendrën kulturore të Bizantit¹⁵². Promovimi së fundmi në qytetin e Korçës, i botimit të parë faksimile i Kodikut të Korçës 93, bëri të njohur vlerat shkencore, artistike, historike dhe fetare të kësaj trashëgimie.

8.7. MONUMENTE TË KULTIT

Në qarkun e Korçës rrethanat historike kanë bërë të mundur të kultivohen dhe bashkëjetojnë tre komunitete fetare kryesore: të krishterë, myslymane dhe bektashinj. Gjurmët kulturore të këtyre besimeve janë pasqyruar në ndërtesat e kultit si edhe në objektet e ndryshme fetare të cilat, përveç se janë dëshmi e kultivimit të besimit fetar përfaqësojnë edhe vlera të jashtëzakonshme artistike dhe kulturore për qarkun dhe për gjithë trashëgiminë kulturore. Nisur nga vlerat që ato përmbajnë një pjesë e tyre janë shpallur monumente kulture të kategorisë së parë (njëzet e shtatë kisha, një xhami, 3 teqe dhe një tyrbe).

OBJEKTET E KULTIT KRISTIAN (KISHAT)

Materiale dokumentare të kodikëve si edhe burimeve të tjera të shkruara, shprehin zhvillimin e jetës kulturore të Korçës dhe trevave të saj edhe nëpërmjet ngritjes së një morie veprash kulti me vlera arkitekturore dhe artistike¹⁵³. Përveç rëndësisë që paraqesin në aspektin religjioz (fetar), objektet e kultit janë në qendër të interesit të vizitorëve vendas dhe të huaj. Disa nga objektet e kultit kristian të shpallura monumente kulture janë:

Kisha trekonshe e Linit (Bazilika) Pogradec, është një nga ndërtimet e kultit që ruhen në Shqipëri, e rëndësishme për nga vlerat që mbart. I gjithë kompleksi i ka dyshemetë të shtruar me mozaikë, gjurmët e të cilëve flasin qartë për vlerat artistike të monumentit. Në mozaikët e kësaj bazilike motivi më i përdorur është ai i pjergullës¹⁵⁴, krahas luleve, shpendëve si edhe disa motiveve më pak të përdorura në mozaikët e tjerë të Shqipërisë si, lepujt dhe bletët. Ngjyrat mbizotëruese të tyre janë: e bardha, e zeza dhe e kuqja, por janë përdorur edhe ngjyra të tjera si kafja, jeshilja, e verdha dhe portokallia. Duke patur parasysh afërsinë planimetrike, vendodhjen e tyre, ngjashmërinë stilistike të mozaikëve dhe të përmbajtjes së skenave të tyre, mendohet se kisha trikonshe e Linit duhet të jetë ndërtuar në fillim të shek.VI¹⁵⁵ dhe është restauruar në vitet 2008-2009. Ajo përbën një objekt të vizitueshëm nga turistët e huaj.



Fig. – 3 Harta E Monumenteve Të Kultit Të Qarkut Korçë

Kisha e Shën Jovanit (Boboshticë) Korçë, dallohet për pamjen e jashtme të ndërtimit të saj dhe vlerat artistike të veçanta në mjediset e brendshme, ku të bien në sy muret e veshura me piktura murale. Nisur nga teknika dhe materialet e ndërtimit, studiuesit mendojnë se kisha daton në gjysmën e dytë të shek.XIV.

Kisha e Shën Mitrit në Bezmisht, ndodhet veri të fshatit me të njëjtin emër, buzë liqenit të Prespës, në të cilin ndodhen gjithashtu shpella eremite, që ruajnë piktura të periudhës së parapushtimit turk. Mbi bazën e teknikës së ndërtimit kualsonazh, sipas studiuesve mendohet se kisha është ndërtuar gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV.

Kisha e Shën Mërisë në ishullin e Maligradit, ndodhet në ishullin e vogël me të njëjtin emër, në Liqenin e Prespës së Madhe. Është ndërtuar në një shpellë të shkëmbore e hapur nga liqeni. Në kishë hyhet nëpërmjet një porte dykanatëshe druri të gdhendur. Sipas mbishkrimeve kisha i është nënshtruar ndryshimeve. Mendohet që fillimisht data e ndërtimit të kishës të jetë viti 1345¹⁵⁸, ndërkohë që në vitin 1369 kishën e rindërton Kesar Novaku¹⁵⁹. Pikturat murale kanë vlera artistike, fetare dhe turistike.

Kisha e Ristozit në Mborje, është ndërtuar në fshatin Mborje në juglindje të qytetit të Korçës. Në arkitekturën e saj kisha paraqitet mjaft kompakte, ndërsa muratura e kishës është e përbërë nga gurë të papunuar, me copëra tjegullash të vendosura njëra mbi tjetrën ndërmjet gurëve, po jo gjithandej. Sipas burimeve të shkruara mendohet që kisha të jetë ndërtuar gjatë shekullit të XIV. Vizitohet nga mijëra vizitorë në rastet e festave fetare, por edhe nga turistë të huaj. Ndonëse monument me vlera të rëndësishme kulturore, aktualisht vuan mungesën e ndërhyrjeve për restaurimin e saj.

Kisha e Shën Triadhës në Lavdar të Oparit, ndodhet në fshatin Lavdar të komunës Lekas në rrethin e Korçës. Kisha është ndërtuar në shek.XV nga Ana, e bija e sundimtarit të Gjirokastrës, Gjin Zenevisit, e ëma e Gjin Muzakës dhe gruaja e II Muzakës Andre. Dallohet për një arkitekturë të veçantë, por ishte krejtësisht e dëmtuar nga ndryshimet në kohë. Në vitin 2013 kisha u restaurua nga Drejtoria e Kulturës Kombëtare Korçë, duke nxjerr në pah një monument kulture me vlera të jashtëzakonshme.

KISHAT E VOSKOPOJËS

Voskopoja që përmendet në kohën e lulëzimit të saj për shkolla dhe institucione kulturore, (shek.XVIII) përmendet midis të tjerave për numrin e bazilikave, me elementë arkitekturorë dhe artistikë me vlera unike, që përbëjnë sot dëshminë e qytetërimit mesjetar. Manastiri Shën Prodhomit, Bazilika e Shën Kollit, Bazilika e Shën Thanasit, Bazilika e Shën Mërisë, Bazilika e Shën Mëhillit dhe Shën Dëllisë.

Manastiri i Shën Prodhomit është ndërtuar në shekullin e XVII, në vitin 1632, kur fshati i Voskopojës po merrte fizionominë e një qendre të rëndësishme zejtaro- tregtare. Këtu ndodhet edhe kisha trekonëshe, e dallueshme nga stili bizantin në formë kryqi. Muret janë të veshura me piktura murale dhe ndonëse aktualisht rezultojnë të dëmtuara dallojnë qartë elementët e gdhendur me vlera të veçanta artistike. *Bazilika e Shën Kollit* është një nga pesë bazilikat më madhështore të ndërtuara në Voskopojë dhe që ruhet fare mirë edhe në ditët tona. Nga mbishkrimi që ndodhet në pjesën perëndimore të saj, studiuesit dëshmojnë se kishën e ka pikturuar D.Selenicasi me dy ndihmësit e tij¹⁶⁴. Kisha është ndërtuar në vitin 1721 dhe është pikturuar në vitin 1726. Pikturat murale mbartin vlera të pakrahasueshme artistike, fetare dhe turistike.

Bazilika e Shën Thanasit i përket periudhës pasbizantine dhe sipas mbishkrimeve rezultojnë, që

kisha të jetë ndërtuar në vitin 1724. Pikturat murale në këtë kishë ndonëse të dëmtuara, ruhen më mirë se në kishat e tjera. *Kisha e Shën Gjergjit në SShipskë*, gjendet në hyrje të fshatit, rreth 5 km larg Voskopojës. Nga arkitektura dhe teknika e ndërtimit, mendohet të jetë ndërtuar në mesin e shek. XVII, çka e bën atë një nga shembujt më të hershëm të këtij tipi bazilikal, gjatë periudhës post- bizantike. Restaurimi tërësor dhe pastrimi i pikturave ka nxjerr në pah vlerat kulturore, fetare, artistike dhe turistike të kishës. Prej disa vitesh kishat e Voskopojës me vlerat e tyre kanë zgjuar interesin e turistëve të huaj dhe vizitorëve vendas. Vizitat në këto objekte kulti bëhet me bileta kundrejt një pagese modeste. Në kishën e Shën Kollit në qendër të fshatit, kryhen ritet dhe ceremonitë fetare të komunitetit të zonës dhe prifti kryen gjithashtu rolin e shpjeguesit të vlerave të kishës për vizitorët. Kishat janë monumente kulturore dhe mbrohen me legjislacion të veçantë, ashtu sikurse menaxhohen nga institucionet përkatëse, puna e të cilave në këtë drejtim nuk paraqitet në nivelin e duhur.

Vithkuqi radhitet krahas Voskopojës për praninë e kishave dhe madhësinë e vlerave të tyre. *Kisha e Shën Mëhillit Vithkuq*, gjendet në veriperëndim të Vithkuqit, në anën e djathtë të rrugës që të çon në fshatin Shtyllë, pranë varrezave të vjetra, jo shumë larg nga qendra. Nga mbishkrimet që gjenden në të, mendohet të jetë ndërtuar në fund të shek.XVII dhe fillim i shek.XVIII. Brenda saj muret janë të veshura me piktura murale me vlera të çmuara artistike. *Manastiri i Shën Pjetrit dhe kisha e Shën Kozmait (qimitiri)* gjendet në një një kodër të pjerrët, pa arritur në fshatin Vithkuq. Është ndërtuar në vitin 1709 dhe është pikturuar nga brenda në 18 Maj 1750. Arkitektura dhe urbanistika e ndërtimit është e veçantë. Edhe këtu të bien në sy pikturat e vëllezërve Zografi, të cilët pikturuan kishën e manastirit. Është një asambël kishtar me kupolë ndriçimi me fanare dhe oborr të brendshëm. Në krah të Shën Pjetrit është edhe kisha e Shën Kozmait dhe Damianit, e cila është e një natyre të veçantë. Emërtohet ndryshe dhe qimitir, pasi në të ruhen eshtrat e të vdekurve. Ka vlera shkencore, kulturore, fetare, turistike etj. *Kisha e Shën Mërisë dhe kisha e Shën Gjergjit* (monumente kulture) ndodhen gjithashtu në fshatin Vithkuq dhe mbartin vlera të rëndësishme arkitekturore, artistike, fetare dhe turistike.

Kisha e Shën Marenës, ndodhet në veri të fshatit Llëngë, në rrethin e Pogradecit. Ndonëse është ndërtuar e re, vendodhja e saj në një zonë me bukuri dhe monumente natyrore i jep krahas të tjerave vlera kulturore dhe turistike.

Katedralja Ringjallja e Krishtit është ndërtuar në vitin 1994 dhe shërben për kryerjen e të gjitha riteve fetare të besimtarëve të krishterë ortodoks. Ndonëse e re dhe nuk gëzon statusin e monumentit të kulturës, ajo përbën një nga simbolet kulturore të qytetit të Korçës me vlera artistike në arkitekturën e jashtme dhe zbukurimet e brendshme murale të saj. Në vazhdim të traditës së pikturimit të kishave, është për t'u evidentuar fakti se besimtarët ortodoksë janë duke kontribuar në veshjen e brendshme me piktura murale. *E ndodhur në qendër të qytetit katedralja*

është objekti kulturor që vizitohet dhe vlerësohet nga të gjithë turistët e huaj dhe vizitorët që vijnë në qytetin e Korçës.

OBJEKTET E KULTIT MYSLIMAN

Objektet e kultit mysliman përfaqësohen nga xhami apo teqe, të cilat për vlerat arkitektonike dhe artistike që mbartin, janë të shpallura monumente kulture. Disa nga këto objekte mund të rendisim:

Xhamia e Iliaz Bej Mirahorit në qytetin e Korçës është më e vjetra e këtij tipi në vendin tonë (xhami me sallë të mbuluar me kupolë). Sipas mbishkrimit të vonë (1872- 1873) mbi portën e hyrjes, xhamia është ndërtuar në vitin 1495-6, (901 H) nga Iliaz Beu, me origjinë nga Panariti, Mirahor, komandant i stallave të Sulltan Bajazitit të II . Xhamia përbëhet nga salla e lutjeve, portiku tri pjesësh dhe minarja dhe mendohet të jetë ndërtuar mbi rrënojat e kishës së Shën e Premtes në fshatin Peshkëpi, fare pranë qytetit të Korçës. Për nga arkitektura është vlerësuar si ndërtim nga më të arriturit, që ndonëse e vogël është një ndërtesë monumentale. Studiuesit e krahasojnë atë me mjaft xhami bashkëkohore të Stambollit. Por teknika e ndërtimit të mureve, ndryshon tërësisht nga ndërtimet turke, gjë që flet për një traditë ndërtimore vendase.




Fig.- 4 Monumentet E Kulturës Të Qarkut Korçë

Gjendja e mirë arkitekturore pas restaurimit e ka kthyer në një objekt atraktiv për vizitorët e huaj.

Teqeja e Qesarakës-Kolonjë, ndodhet rreth 50 km larg nga qyteti i Korçës dhe rreth 30 km nga qyteti i Ersekës në fshatin me të njëjtin emër. Kjo teqe mendohet se është ndërtuar në vitin 1600 dhe themelues i saj ka qenë Haxhi Babai nga Irani. Teqeja e Qesarakës është një kompleks i përbërë nga dy ndërtime: varri monumental (mauzoleu) që quhet tyrbe dhe konaku, që është banesa apo rezidenca ku jeton Babai. Ndërhyrjet restauruese kthyen tipologjinë dhe arkitekturën e kohës, duke i dhënë autoritetin që i kishte munguar dhe njëkohësisht, duke e bërë më interesante dhe më tërheqëse për besimtarët dhe vizitorët. Me restaurimin e teqesë, Urdhëri i Dervishëve Bektashi në Shqipëri, ka një monument historik të konservuar me të gjitha vlerat e tij shkencore, arkitektonike, fetare dhe turistike. *Teqeja e Turanit* e ngritur në vitin 1827 përbën gjithashtu, një monument kulture të rëndësishëm për besimtarët myslimanë por edhe për vizitorë të ndryshëm.

8.8. MONUMENTET ARTISTIKE

Gjurmët e artit figurativ në Shqipëri janë të hershme, që në periudhën e neolitit me zbulimin e qeramikave, terrakotave, zbukurimeve me metal etj. Lulëzimi i qyteteve ilire solli edhe zhvillimin e artit ilir me pikturimin e qeramikës, skulpturën, mozaikët dhe afreskët. Në qarkun e Korçës trashëgohen një mori veprash arti si mozaikë, afreske, ikona, piktura, skulptura, fotografi artistike etj, vlerat e të cilave nuk mund të kuptohen jashtë ambjenteve të cilave u përkasin. Këto në pjesën më të madhe të tyre ruhen në muzetë e qytetit të Korçës, Ersekës dhe Pogradecit.

PIKTURA MURALE

Në periudhën e mesjetës arti i pikturës gjeti shprehjen më të lartë artistike. Piktorë të shquar të shekullit të XVIII si David Selenicasi, Kostandin Shpataraku, Vëllezërit Kostandin dhe Athanas Zografi, familja Katro, pikturuan kishat në Shqipëri dhe vendet fqinje. Përveç vlerave arkitekturore dhe fetare kishat e Voskopojës, Vithkuqit, Boboshticës, Prespës dhe gjithë kishat e tjera në qarkun e Korçës, dallohen edhe për vlerat artistike të pikturave murale, ikonostaseve dhe ikonave. Pikturat paraqesin tema të shumta të trajtuara me kontekst fetar. Veprat më të çmuara të këtij fondi pikturash të artit bizantin dhe pasbizantin ruhen në Muzeun e Artit Mesjetar në qytetin e Korçës. Disa prej këtyre pikturave murale do të përmendim: "*Ava Shëruesi*", "*Lindja e Krishtit*", "*Shërimi i barinjve të vjetër*" piktura të shek.XVIII, nga David Selenicasi në kishën e Shën Kollit. Në manastirin e Shën Prodhomit në narteksin e kishës gjejmë piktura murale shënjtore të piktorit vendas Andon Shipska (Jeromonaku) ashtu sikurse afreske shënjtore në kishën e Shën Mëhillit. Në kishën e Shën Gjergjit në Shpëskë, gjatë restaurimit u zbulua vazhdimi i pikturës murale "*Gjyqi i fundit*". Tradita e pikturës murale vazhdon ende edhe në kishat e ndërtuara kohët e fundit. Kështu katedralja "Ringjallja e Krishtit", kisha e Shën Thanasit dhe kishat e tjera në qytetin e Korçës vazhdojnë të zbukurohen me piktura murale.

Përveç pikturave murale vlera artistike përbëjnë edhe *ikonat dhe ikonostaset* të cilat i gjejmë të pranishme në pothuajse të gjitha kishat (Voskopojës, Maligradit, Vithkuqit, Boboshticës, Mborjes

etj). Ikonat më të çmura ruhen në Muzeun e Artit Mesjetar (veprat e ikonografit të shquar Jeromonak Kostandini). Veshja e tipareve të shënjtoreve në skenat e spiritualizmit fetar, me pamje që i afrohej jetës reale, është një element i pasqyrimin të zhvillimit social-ekonomik të kohës në art. Një pasqyrim të tillë e gjejmë tek skena e “mbjellësit të farës” e piktorit David Selenicasi.

Krahas monumenteve më karakter religjuz, **skulptura** është një gjini artistike që ka gjetur mishërimin e vet edhe në qarkun e Korçës me vepra të realizuara nga mjeshtrat e skulpturës kombëtare. Në gjithë fondin e kësaj gjinie, vetëm dy prej tyre që ndodhen në qytetin e Korçës kanë statusin e “Monumentit të Kulturës”: *Monumenti i Luftëtarit Kombëtar* ose siç njihet ndryshe “Ushtari i panjohur”, që ndodhet në zonën këmbësore të qytetit, i ndërtuar me mjeshtëri nga Odhise Paskali në vitin 1932. Monumenti mishëron vlerat atdhetare të një krijimi realist por edhe vlera artistike dhe turistike. *Monumenti i Themistokli Gërmenjit* gjithashtu monument kulture, ndodhet brenda lulishtes me të njëjtin emër dhe është ndërtuar në 1932, përsëri nga mjeshtri Odise Paskali.

Me vlera kulturore paraqiten edhe disa monumente të tjera si: *Monumenti “Koci Bako”* ndërtuar nga Dhimitër Çani (1950); *monumenti “Naim Frashëri”*, në rrugën “28 Nëntori” ndërtuar nga Avni Bilbili më 1956; *monumenti “Partizani”* pranë varrezave të dëshmorëve ndërtuar (1969) nga Avni Bilbili, Piro Dollaku e Ilia Xhano; *monumenti “Mihal Grameno”* (1969) nga Montas Dhrami; *monumenti “Naum Veqilarxhi”* (1974); *Obelisku ABC* në oborrin e muzeut “Mësonjëtorja e Parë Shqipe” ndërtuar nga Naumaq Mara (1987); busti *“Tre kokat”* (Naum Veqilarxhi, Thimi Mitko dhe Asdreni) ndërtuar nga Vladimir Topi, Avni Bilbili dhe Vladimir Kaçaku (2002); monumenti *“Mitrush Kuteli”* dhe *“Lasgush Poradeci”*

FOTOGRAFIA

Krahas gjinive të përmendura më sipër, fotografia është një gjini tjetër artistike që përmendet në trevën e Korçës, në gjysmën e dytë të shekullit të XIX. Në fillim të shekullit të XX (1923) në Korçë u çel studioja e fotografit Kristaq Sotiri, ndërkohë që në qytet kishte edhe studio të tjera fotografësh të njohur. Tradita e fotografisë dëshmohet në organizimin e herëpashershëm të ekzpozitave të fotografive dhe ekzistencën e disa studiove fotografike në qytetin e Korçës dhe të Pogradecit.

Me veshjet popullore, prodhimet e artizanatit në dru, gur, tekstile, qëndisje dhe thurje si dhe punimet prej metali, trashëgimia etnografike përbën një pjesë të trashëgimisë kulturore shqiptare, me vlera të pazëvendësueshme. Është për t'u vlerësuar ekzistenca e disa krahinave me etnografi të pasur si: Korça, Opari, Prespa, Devolli, Kolonja, brenda hapësirës sonë të

studimit, çka e bëjnë të larmishme jo vetëm në aspektin studimor por edhe turistik.

VESHJET POPULLORE

Veshjet popullore në përgjithësi dhe kostumet popullore në veçanti, vlerësohen të jenë një thesar i traditave të kulturës popullore shqiptare. Uniteti ekonomik dhe shoqëror i një zone, ka sjellë afrime edhe në veshjen e krahinave, që bëjnë pjesë në këtë unitet. Ato konsiderohen si objekte etnografike të përdorimit të përditshëm ose në raste festash, të përbëra prej materialeve të tilla si liri, leshi, lëkura, pambuku, mëndafshi, etj. Nëpërmjet studimit të veshjeve popullore shqiptare, ne njihemi jo vetëm me një aspekt shumë të rëndësishëm të mënyrës së jetesës, por edhe me aspekte të tjera si zhvillimi ekonomik, shoqëror, kulturor e artistik i fshatrave e qyteteve në zonat e ndryshme, ku këto veshje janë mbajtur. Trashëgimia dhe ruajtja e kostumeve popullore të zonave të veçanta të trevave të Korçës, fshatit dhe qytetit, është një element mjaft i rëndësishëm për t'u vlerësuar.




Fig. – 5 Veshjet Popullore, Të Qarkut Korçë

Referuar morisë së studimeve arkeologjike, historike dhe kulturore studiuësja dhe etnografia Andromaqi Gjergji ka bërë klasifikimin e veshjeve popullore shqiptare të burrave dhe grave, nga ku do të prezantohet tipet kryesore të tyre në zonën e Korçës.

8.9. TRASHËGIMIA ETNOGRAFIKE

Veshja e burrave me fustanellë, ku *fustani* është elementi më karakteristik i këtij tipi veshjeje, i përmendur në disa dokumente të shekullit të XIV. Fustanella është e bardhë, me material prej pëlhure të pambuktë, që punohej në shtëpi ose ishte e fabrikuar. Shoqërimi me elementë të tjerë si: këmisha, jeleku, brezi, kalçet e shajakut dhe opingat prej lëkure, plotësonin më së miri prezencën e saj në disa zona të qarkut, në veçanti në zonën malore të Korçës (Dardhë), Kolonjës dhe Devollit. Në shkrime të ndryshme dëshmohet të ketë qenë e pranishme deri në vitet 1920, kryesisht në raste festash. Prania e kësaj veshje tipike shqiptare tek grekët apo popuj të tjerë ballkanas, dëshmon për rolin aktivdhënës të kulturës sonë materiale, në elementin kulturor të veshjes së fqinjëve tanë. *Kostumi me këmishë të gjatë e dollama (cibun)* krahas këmishës së gjatë, që ishte elementi kryesor, cibuni, mëngorja dhe kalçet ishin mjaft të pranishme dhe të përdorshme. Kjo veshje e burrave ishte karakteristike për zonën e Korçës, të Kolonjës dhe fshatrat e Prespës dhe ndryshe nga veshja e përditshme në ditët e festave karakterizohej nga prania e qendismave dhe stolive. *Veshja me poture* ndonëse në përhapje të kufizuar, u përdor pas veshjes me fustanellë¹⁸³ në malësitë e Korçës dhe Kolonjës. Festja e bardhë, e zezë ose e kuqe ishte një element i rëndësishëm që shoqëronte veshjen e burrave të fshatit dhe të qytetit.

Veshja e grave me këmishë të gjatë dhe një përparje, është një tip mjaft i përhapur veshjeje në disa zona të qarkut të Korçës, Dardhës, Gorës, Oparit në Korçë dhe Kolonjës. Një vend më vete në këtë tip veshje zë veshja e grave ish ortodokse të Mokrës¹⁸⁴(Pogradec). E gjendur në disa variante, në pamjen e jashme këmisha e gjatë shtrëngohej pas belit me një brez të zbukuruar. Përsipër veshja shoqërohej me një lloj dollmaje e zbukuruar në fund me qëndisje. Kjo veshje shfaqet me elemente më të zhvilluar në veshjen e gruas dardhare në rrethin e Korçës¹⁸⁵. Karakteristikë për trevat e Korçës janë edhe *veshjet e modës qytetare* për burra dhe gra, të pranishme atje ku kushtet e zhvillimit ekonomik ishin pjekur për një asimilim të tillë. Përmendet *veshja me dollma të gjatë e xhybe me gëzof*, që mbanin burrat ortodokse të qytetit të Korçës, të Voskopojës që nga shekulli i XVIII deri në shpalljen e Pavarësisë. *Veshja me origjinë qytetare* ishte ajo që mbanin gratë ortodokse të qytetit të Korçës në çerekun e fundit të shek.XIX,

e përfaqësuar nga fustane të gjera të shoqëruara me një xhybe cohe të zezë, me gëzof te qafa e me shami të zezë në kokë. Veshjet ndryshonin nga fshati në qytet. Burrat e fshatit në zonat malore e plotësonin veshjen e tyre me guna me kapuç kryesisht në stinën e dimrit.

*Veshjet popullore të burrave dhe grave dallohen për kryerjen e funksioneve të ndryshme siç janë: veshjet e përditshme ose për punë, kryesisht praktike dhe të punuara me materiale të lira; veshje sipas moshës, seksit e gjendjes civile; veshje të mira ose për të dalë. Veshjet e grave ishin të zbukurura me qëndisma dhe stoli metalesh të çmuara dhe shoqëroheshin me byzylykë, breza metalikë, kollanë, unaza etj. kryesisht të përdorshme në raste të veçanta dhe festash. Krahas elementeve të përmendur më sipër, një element po aq i rëndësishëm që shoqërojnë këto veshje janë *opingat e lëkurës me ose pa xhufka*, të cilat paraqiten në variante të ndryshme si tek burrat dhe tek gratë. Të gjithë elementët e përmendur më sipër ruhen në mënyrë individuale në shtëpi apo janë pjesë dekorative e restoranteve apo bareve kryesisht të fshatit por edhe qytetit. Është për t'u evidentuar mungesa e muzeve etnografik në zonat përkatëse, që dikur kanë ekzistuar. *Nisur nga vlerat e rëndësishme që mbart kjo pjesë ë trashëgimisë, mendojmë se ngritja e një muzeu etnografik rajonal me veshjet popullore dhe objekte të mbledhura nga të gjitha krahinat e Korçës, do të zgjeronte ofertën turistike të trashëgimisë kulturore dhe njëkohësisht do t'a ruante këtë nga dëmtimet e kohës.**

ARTIZANATI DHE PUNIMET TEKSTILE

Populli shqiptar krahas veshjeve popullore ka trashëguar edhe një art popullor të zhvilluar dhe të larmishëm me elementë të arrirë në disa fusha si, qeramika, punimi i gurit dhe drurit, tekstilet dhe qëndisjet popullor, si dhe punimin e metalit dhe të argjendit. Në zonat e Korçës, kjo krijimtari është trasmetuar brez pas brezi dhe ruhet ende në ditët tona, si pjesë e pandarë e gjithë trashëgimisë kulturore materiale.

Artizanati në këtë zonë ka origjinë të hershme, që me prodhimin e sendeve të domosdoshme për jetesë, gjë të cilën e njohim nëpërmjet gjetjeve të shumta të objekteve arkeologjike (vegla pune, enë prej balte, stoli dhe byzylykë). Këto spikatin për shumëllojshmëri elementesh, forma dhe paraqitje estetike, që gjenden të ekspozuara në muzeun Arkeologjik dhe muzeun e rrethit të Kolonjës. Duke vazhduar në mënyrë të pandërprerë gjatë gjithë kohërave, artizanati përbën një nga pikat e forta të ruajtjes së identitetit dhe mundësi reale të integritit të kësaj tradite në zhvillimin e turizmit. *Qeramika dhe punimet e baltës* kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mënyrën e jetës së banorëve të lashtë. Përveç funksionit dhe teknikës së tyre të prodhimit, ato mbartin edhe elemente artistikë zbukurues, si shprehje të nivelit kulturor. Enët e ujit, bardhakët, shtamat me forma të larmishme dhe me ndonjë zbukurim, që prodhoheshin në Bradvicë të Korçës, furnizonin pellgun e Devollit, fshatra të ish Rep. Maqedonisë dhe Greqisë Veriore. Tradita vazhdon nëpërmjet ekzistencës së punishteve të qeramikës në qytetin e Korçës dhe në zona të tjera të qarkut.

Punimet e drurit kanë zënë një vend të rëndësishëm në shek.XVIII-XIX, ku u përdorën gjerësisht në ndërtimet e jashtme dhe të brendshme të banesave qytetare dhe fshatare. Motivet e përdorura në gjininë e artit të thandrimin në dru dhe ekzekutimi i tyre, për dekoracione të ndryshme të brendshme në objektet e kultit dhe banesat dëshmojnë qartë, për nivelin artistik të këtyre punimeve të artit popullor. Dritaret,kanapet, dollapët në mur, shkallët e brendshme, tavanë të skalitur me shije dhe orendi të tjera prej druri janë ende dëshmi e tipit të banesës së vjetër. Perfeksionimi i punimeve të drurit e gjen shprehjen e tij në objektet dhe punimet e brendshme të kishave ortodokse si ikonostaset dhe ikonat. Krahas atyre që gjenden në Muzeun e Artit Mesjetar, kishat e Voskopojës, por edhe kishat e tjera janë të pasura me këto objekte me vlera artistike.

Gdhendja dhe *punimi i gurit* është një traditë e hershme shekullore. Qyteti i Korçës dhe shumë fshatra kanë trashëguar rrugicat e shtruara me kalldrëm dhe shtëpitë e ndërtura me gur. Mund të përmendim gjithashtu gdhendjen e kolonave në banesat e qytetit, sofateve e çezmave nga mjeshtrit polenakë në fshatin Polenë, Progër të rrethit të Devollit, mjeshtërit kolonjarë të përpunimit të gurit të njohur edhe jashtë vendit etj. Po kështu vazhdon tradita e ndërtimit të oxhakëve, në pjesën më të madhe për përdorim funksional por edhe për dekorim të ambjenteve të brendshme.

Punimi i metalit të hekurit është gjithashtu një traditë shekullore. Rrethimi i banesave me kangjella prej metali të zbukuruar me elemente, është element i rëndësishëm tradicional dhe qytetarie. Mjeshtërat e punimit të hekurit realizojnë punime të atij niveli që po gjejnë përdorim jo vetëm në mjediset rrethuese por edhe brenda ambjenteve të banesave apo lokaleve. Në përpunimin e metalit një vend të rëndësishëm ka zënë edhe *punimi i argjendit*. Argjendarët e Voskopojës dalloheshin për punimet cilësore. Po kështu zbukurimet e argjendit si pafta, breza, gjerdanë dhe stoli të tjera zbukuronin veshjen e gruas në krahina të ndryshme të qarkut të Korçës.

Fondi i artit tonë mesjetar tërheq vëmendjen edhe për punimin e kapakëve që shërbenin për mbështjelljen e librave, disa të tillë i disponon muzeu i Artit Mesjetar. Karakteristikë për trevën e Korçës është dhe *punimi i mermerit*, me të cilin zbukurohen fasadat e ndërtimeve të veçanta me elemente të arkitekturës moderne.

Punimi i lëkurës ka qenë dhe është traditë për qytetin e Korçës dhe rrethinat. Ka një fabrikë të prodhimit të këpucëve që punon për tregun vendas. Ekzistojnë edhe një sërë *punimesh tekstile* artizanate dhe specialitetesh lokale karakteristike, si për shembull qilimat e punuara me dorë, batanijet karakteristike, punimet me thurrje (punimet me shtiza), qëndistaria në zonat e Pogradecit, Kolonjës etj. Niveli artistik i qilimave të punuara në qarkun e Korçës (sidomos i qytetit të Korçës) është nga më të arrirët. Skemat e përdorura në tekstilet e kësaj zone kanë një

kulture e sens artistik më të zhvilluar përsa i përket kompozimit të ngjyrave, gjë që i dallon menjëherë tekstilet e Korçës nga ato të zonave të tjera. Dallohen sidomos qilimat dhe velenxat, me motive dhe ngjyra të larmishme. Përdorimi i ngjyrave veç funksionit estetik, shprehte edhe momentet e jetës, gëzimet dhe hidhërimet, gjendjen shoqërore etj. Kjo gjë duket qartë edhe në veshjet, sidomos ato të grave dhe vajzave. Pothuajse në çdo shtëpi të qytetit të Korçës, Ersekës, Devollit, Pogradecit, por edhe fshatrat hasen “qilimat me rrotë”, “me xhami”, “me dhisk me trëndafila”, “me simite” si dhe shkorsat, udhkat si dhe kuvertat me thekë. Velenxat dallohen për ngjyrat e ndezura, në veçanti përdorimi i të kuqes. Këto shtrohen në raste festash, gëzimesh dhe hidhërimesh.

Qëndisjet, tantellat, copat e thurura, mbulesat e krevatëve dhe qëndisje të tjera dekorative të bardha apo me ngjyra, të punuara me mjeshtëri artistike janë pjesë e çmuar e trashëgimisë së komunitetit të zonës. Qëndistaret zbukuronin krahas të tjerave edhe veshjet e burrave dhe të grave si këmisha, jelekë, përparje etj. Veglat e prodhimit artizanal si furka, druga, motovila, qerthulli, shtijat, tezgjahu ishin baza e artizanatit familjar. Ato ruhen ende kryesisht në fshatrat kulturore. *Megjithatë, sektori i artizanatit në tërësi dhe i punimeve tekstile në veçanti nuk është edhe aq i mirëorganizuar dhe nuk ekzistojnë shumë mundësi për turistët, për të blerë punimet e dorës karakteristike dhe tradicionale të zonës.*

VLERAT E TRASHËGIMISË KULTURORE SHPIRTËRORE

Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (UNESCO,2003) e përcakton trashëgiminë kulturore jomateriale (shpirtërore) si: *“Praktikat, përfaqësimet, shprehjet, gjuhën, njohuritë, aftësitë si dhe instrumentet, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore që lidhen me to, të cilat komunitetet, grupet dhe në disa raste individët i njohin si pjesë të trashëgimisë së tyre kulturore. Kjo trashëgimi shpirtërore e trasmetuar brez pas brezi është e rikrijuar në vazhdimësi nga komunitetet dhe grupet, në harmoni me mjediset dhe historinë e tyre dhe u jep atyre ndjenjën e identitetit dhe vazhdimësisë ashtu sikurse promovon respekt për diversitetin kulturor dhe krijimtarinë njerëzore. Kjo përfshin traditat gojore dhe shprehjet, gjuhën, artet performuese, praktikat sociale, ritualet, ngjarjet festive dhe punimet tradicionale”.*

Shqipëria është e përfaqësuar në trashëgiminë kulturore botërore, krahas asaj materiale, edhe me trashëgiminë kulturore shpirtërore. Në vitin 2005 “Iso-polifonia popullore shqiptare shpallet “Kryevepër e Trashëgimisë Gojore të Njerëzimit”, e mbrojtur nga UNESCO. Ndonëse në kulturën shpirtërore të qarkut Korçë, nuk ka elementë të mirëfilltë të trashëgimisë shpirtërore të mbrojtur me statusin e trashëgimisë shpirtërore kombëtare, këtu gjejmë vlera të cilat janë trasmetuar brez pas brezi deri në ditët tona dhe kanë nevojë të vlerësohen dhe të mbrohen.

8.10. FOLKLORI (KËNGËT DHE VALLET)

“Kultura popullore e një kombi është një element i rëndësishëm, i cili bën të mundur përcaktimin e karakteristikave zakonore, gjuhësore të tij, e mëndësisë dhe prirjes për ruajtjen e identitetit si

bashkësi e qëndrueshme historike, ekonomike e shoqërore". Vendodhja gjeografike, ekzistenca dhe prania e kulturës së hershme materiale, (veçanërisht etnografia e pasur), zhvillimi social ekonomik, shkëmbimet kulturore me zonat përreth, mund të cilësohen si faktorë që kanë ndikuar në formësimin e një identiteti dhe kulture shpirtërore të përbashkët. Nga ky këndvështrim trevat e qarkut të Korçës, së bashku me trevat e tjera në jug të Shkumbinit janë pjesë përbërëse e krahinës së toskërisë dhe e *folmja e Korçës* dhe krahinave të saj i përket nëndialektit të toskërishtes veriore të dialektit toskë. *Gjuha e folkorit* si themel i trashëgimisë shpirtërore të kombit tonë, në këtë hapësirë i ka qëndruar besnike gjuhës së folur popullore, duke ruajtur veçoritë e veta në kuadër të gjuhës letrare shqipe. Në qoftë se do të bënim një përjasje të shtrirjes së izoergeve (të dhënave etnografike) dhe izoglosave¹⁹⁷, në ekuivalentimit e këtyre arealeve, evidentohen areale të vogla që krahas ngjashmërive, kanë tipare të veçanta në të folmen e tyre si Strelca¹⁹⁸ brenda krahinës së Gorës, fshatra në krahinën e Devollit, etj. Në të folmen e Korçës, Kolonjës dhe Pogradecit, për të gjitha kategoritë e foljeve më të përhapura janë format “-nja”, “-nje”, “-te” për vetat e njëjësit: *qepnja, qepnje, qepte*. Ndërkohë që në të folmen e Devollit folja e zgjedhimit të tretë shoqërohet me bashtingëlloren “nj” si mbaresë: *lironj, dëgjonj, kallëzonj, gdhinj, thyenj*, etj. Po kështu karakteristikë është edhe përdorimi i ndajfoljeve dhe parafjalëve: *këtuckë (këtu), njëdizaj (një ditë), javash (avash), tashti, prëmë, ndënë, gjende (përsëri)* etj. Ndërkohë që përdoren shprehjet: *ardhmë de Korçë (në), dë mëngjes (në), pe asaj që thua ti (prej), de vinj (po vij)*, etj.

Afërsia kufitare me fqinjët grekë dhe sllavë dhe marrëdhëniet ekonomike, sociale dhe kulturore me ta, kanë patur ndikimin e tyre edhe në të folmen e këtyre zonave çka dëshmohet nga përdorimi i prapashtesave me origjinë sllave (*djalkë, dyshkë, kulaçka, petka, shamiçkë, rosnicka, doçka*, etj). Në të folmen e Kolonjës dhe Leskovikut foljet ndihmëse *kam* dhe *jam* në vetën e tretë njëjës bëjnë *keshe, jeshë*, por mungojnë prapashtesat sllave. Gjuha e folur e krahinave të Korçës, Devollit, Kolonjës është shumë e pasur me frazeologji dhe shprehje të tjera gjuhësore.

Omonimia e Korçës si hapësirë studimi është e lidhur ngushtë krahas të tjerave edhe me përkatësinë fetare të banorëve të saj. Emrat e besimtarëve ortodoksë të fshatit dhe qytetit janë ndikuar edhe nga emrat ortodoksë grekë: Jorgo, Jorgji, Dhimitër, Vasillaq, Stavri, Soriraq, Panajot, Kostaq, Anesti, Sofia, Maria, Limjadhë, Eleni etj. Emrat myslimanë kanë patur ndikim nga emrat me prejardhje myslimane si: Bujar, Pëllumb, Bashkim, Fatmir, Arben, Esmë, Hatixhe, etj.

Për sa i përket termit “*folklor*” është një term që sot përdoret në të gjithë botën për të treguar thesarin e traditave të një populli. Si shprehje e ndjenjave, mendimeve, folklori nëpërmjet gjuhës së goditur të krijimtarisë popullore, kërkon të trasmetojë mbresa dhe emocione tek dëgjuesit. Në trashëgiminë shpirtërore përfshihen këto tipologji të folklorit: *folklori gojor* (tekst i krijimit popullor, i pashoqëruar me muzikë që lexohet ose tregohet); *folklori instrumental* (krijim muzikor popullor i

luajtur me vegla muzikore popullore); *folklori vokal* (krijime popullore të kënduara ose të interpretuara me teks dhe muzikë); *folklori koreografik* (valle apo krijime që kërcëhen me ose pa muzikë).

Ruajtja e tipareve autentike të gjuhës së folklorit, në zonat e qarkut të Korçës ka gjetur format e shprehjes së vet artistike, në elementet e pasur të folklorit popullor. Gojëdhënat, përrallat, lodrat e këngët e fëmijëve, gjëegjëzat, anekdotat, këngët e dashurisë (serenadat), këngët lirike, ritet e lindjeve, dasmave, vdekjeve, nofkat apo llagapet, fjalët fluturake, festat pagane, festat fetare, vallet, instrumentat popullore, janë thesare të ruajtura dhe trasmetuara me fanatizëm deri na ditët e sotme. *Anekdotat* (barxeleta) janë pjesë e krijimtarisë popullore të zonës²⁰⁶, ku spikatin humori dhe satira e hollë. Të mbushura me karaktere dhe personazhe të shumëllojshëm ato mbahen mend gjatë dhe vazhdojnë të tregohen edhe sot e kësaj dite. Një element i folklorit janë nofkat ose "*llagapet*"²⁰⁷, të njohura ndryshe edhe si emri i dytë. Ajo vendoset në formën e shakasë, për ndonjë mangësi apo tipareve të veçanta fizike, sjelljes, mënyrës së të folurit, të të ecurit, të të veshurit, profesionit, pozicionit shoqëror të personit të cilit i përket nofka. Emri i personit shoqërohet me një nofkë si: këpucari, mullixhiu (mbi punën që bënte), qorri (kur nuk shikonte mirë nga sytë), buti (kur ishte i shëndoshë), topalli (kur çalonte), por edhe epitete kafshësh si: pula (karakter i butë), ujku (karakter i fortë), gallofi (për nga tiparet) etj. Fjalët e urta popullore apo *fjalët fluturake*, janë të përhapura dhe të përdorshme në të gjithë zonën në trajtë proverbash, idiomash dhe aforizmash. Disa prej tyre janë: "*Bjeri derës që të dëgjojë deriçka*"; "*e ka ujin në misër, e ka kripën e thatë (e ka vënë në terezi)*"; "*si fle karari*", "*sikur ka gëlltitur okllainë*", "*erdhi duarthatë*" etj.

Këngët folkloristike lindin njëherësh si tekst dhe si melodi duke përbërë një unitet, të cilat kur ekzekutohen bashkarisht trasmetojnë një forcë estetike dhe emocionale të këngës²⁰⁹. *Muzika popullore* qytetare korçare dhe e rrethinave bën pjesë në *iso-polifoninë* toske dhe është pjesë e *iso-polifonisë shqiptare*. Kjo muzikë arriti kulmin e saj në gjysmën e dytë të shekullit të XX, ku spikatën folklori vokal, instrumental dhe koreografik. *Veglat muzikore* shoqëruese të muzikës popullore janë sazeja, klarineta, firzamonika, lahuta, violina dhe dajreja. Këngët i këndohen kryesisht punës dhe dashurisë. Ato përfshijnë këngët e dasmave, këngë të burrave, këngë të grave, këngë të fshati dhe të qytetit. Shumica e këngëve popullore janë polifonike për nga natyra dhe karakterizohen nga i kënduari me zë melodios dhe shprehës. Përveç, Korçës dhe Devollit, Leskoviku ka qenë qendra kryesore e zhvillimit të sazeve dhe muzikës me saze në gjithë Shqipërinë e Jugut.

Serenata korçare me kitarën dhe mandolinën, i ka fillimet e saj në gjysmën e dytë të shek.XIX dhe përbën një pasuri me vlera për gjithë muzikën qytetare. Ajo ka kultivuar një kulturë të re, një moral të ri qytetar, një etikë të re të ndjenjave intime; ajo hapi dyert e emancipimit shoqëror e

afrimit me botën e qytetëruar europiane. Ky simbol kulturor shpirtëror këndohet sot jo vetëm në Korçë por në gjithë Shqipërinë.

Në qershor të vitit 1928 u formua shoqëria “Lyra”, e cila në bazë të saj kishte dy formacione muzikore: korin dhe orkestrën. Në qoftë se do ta quanim trashëgimi shpirtërore, korin Lira, do të thoshim trashëgimi shpirtërore me këngëtarë që këndojnë prej katër brezash. “Kori Lira”, numëron në gjithë repertorin e tij mbi 200 këngë patriotike, lirike e satirike, të cilat interpretohen brenda dhe jashtë vendit. Disa nga këngët e njohura si: “Këto shkronja janë të arta ne i duamë”, “Sot lipset me flamurë malit të dalimë”, “o Trima luftëtarë, ju bijtë e Skëndërbeut, kërkoni, ju shqiptarë lirinë e mëmëdheut”, “Duam më shumë Shqipërinë, që t’i vejë puna mbarë e përjetë ta ketë lirinë”, janë krenaria dhe pasuria jo vetëm e një treve apo komuniteti, por e gjithë vendit dhe kombit. Serenada Korçare dhe Kori Lira janë pjesë e trashëgimisë kulturore shpirtërore me vlera lokale, rajonale dhe kombëtare, prandaj meritojnë të vlerësohen dhe mbrohen me statusin “Kryevepër e Trashëgimisë Shpirtërore Kombëtare”, krahas Eposit të Kreshnikëve, Ahengut Shkodran etj.

Vallet janë fusha e ndërthurja së muzikës me koreografinë popullore. Secila nga krahinat e hapësirës së studimit, përfaqësohet me muzikën dhe vallen e vet që e karakterizon. Vallet luhen me trup, me këmbë, duar dhe me shprehjen e fytyrës sipas karakterit të saj. Vallet luhen nga gratë dhe nga burrat, por ato mund luhen edhe vetëm nga gratë ose vetëm nga burrat sipas llojit të tyre. Në trevat e Korçës gjejmë të mishëruara vallet lirike të dashurisë, dasmave dhe vallet epike të burrave. Përmenden vallja leskoviçare, vallja devolliçe e burrave, vallja kolonjare e grave, vallja dardhare e vajzave etj. Interpretimi i tyre në rastet e festave dhe eventeve, me kostumet popullore të trevave përkatëse, nxjerr më së miri në pah vlerat e tyre artistike dhe plotëson tërësisht ofertën turistike kulturore.

8.11. FESTAT DHE FREKUENTIMI TURISTIK

*Festat janë elementi më popullor i atraksioneve shpirtërore dhe zakonisht janë në formën e festimeve apo të ngjarjeve historike, që banorët lokalë dëshirojnë t’i ndajnë me komunitetit e zonës në tërësi dhe me vizitorët, qofshin vendas apo të huaj. Nisur edhe nga traditat në këtë gjini të trashëgimisë, qarku i Korçës po gëzon një reputacion si rajoni i festivaleve dhe i ngjarjeve – veçanërisht qyteti i Korçës i njohur ndryshe edhe si “**Qyteti i Festave**”.*

Disa nga festimet e trashëguara, përfaqësojnë traditat e hershme në kulturën e zonës, të cilat e identifikojnë dhe dallojnë nga zonat e tjera të Shqipërisë, por edhe të rajonit. Nëpërmjet tyre komuniteti promovon vlerat e trashëguara shpirtërore dhe njëkohësisht siguron vazhdimësinë e trasmetimit të tyre për brezat e ardhshëm. E veçanta e gjithë qarkut qëndron në praninë e festimeve të shumta fetare (religjioze), çka mund të shërbejë si një mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit religjioz. Pjesëmarrja në ditët e organizimit të festave është e larmishme, ku krahas

banorëve vendas edhe vizitorëve nga vende të tjera të Shqipërisë, është ngjallur interesi i vizitorëve të huaj që vizitojnë Shqipërinë në këtë periudhë. Pavarësisht përmasave të këtyre eventeve dhe festimeve, ndër më të rëndësishmet për nga impakti social-ekonomik që ato kanë, do të përmendim:

Festa e Karnavaleve (28-29 Maj), me paraqitje teatrale dhe muzikore, e zhvilluar që para viteve '40, është kthyer tashmë në një traditë të përvitshme festimi në qytetin e Korçës. Përfshirja në të e grupeve nga Shqipëria, Maqedonia, Italia, Mali i Zi dhe Greqia, me trupat e tyre të zbuluara me ngjyra të larmishme, maska dhe kapele, e bëjnë të larmishme performancën, në rrugët e qytetit në prani të mijëra banorëve dhe vizitorëve të ardhur për këtë event. Rreth 20.000 vizitorë (e përlogaritur nga bashkia) ishte numri i pjesëmarrësve në këtë festë në vitin 2012. Në vazhdimësi të traditës së tyre, karnavalet festohen me origjinalitetin e tyre, njëkohësisht edhe në fshatin Polenë në prani të qindra vizitorëve.

Festa e Birrës, (14-18 Gusht) që prej vitit 2007 është kthyer në një traditë të përvitshme të organizimit të eventeve në sezonin turistik të verës. Festa përbën eventin me impaktin më të madh social, ekonomik dhe kulturor në qarkun e Korçës. Gjatë ditëve festive sipas të dhënave të bashkisë, qyteti vizitohet nga dhjetëra mijëra (60-80 000) vizitorë jo vetëm nga Shqipëria por edhe vizitorë të huaj nga rajoni dhe bota. Në vlerësim të promovimit të vlerave kulturore, në vitin 2010 Festa e birrës u nderua me çmimin e "Turizmit Shqiptar 2010", akorduar nga Ministria e Turizmit, Rinisë dhe Sporteve. Në këtë event së bashku me "Birra Korça" dhe firmat e tjera të produkteve të zonës marrin pjesë edhe marka të tjera produktesh, të cilat përveç shitjeve promovojnë edhe produktet e tyre. Në vitin 2013, festa u organizua për pesë ditë me radhë dhe e drejta e promovimit ju dha gjithashtu, një firme nga Serbia.

Festa e lakrorit, (7 shtator) mbështetur në traditën e një prej produkteve të gatimit tradicional të zonës, është kthyer në një organizim të përvitshëm të tërheqjes së vizitorëve në qytetin e Korçës. Duke respektuar gjithashtu traditën e "amvisave", një grup grash korçare në mënyrë të organizuar përgatisin në natyrë lakrorë (piqen në saç) me gjellë të ndryshme, të cilët porositen dhe u serviren vizitorëve kundrejt pagesës.

Panairi i poçerisë organizohet në qendër të qytetit të Korçës, gjatë gjithë javës së Pashkës Ortodokse. Panairi lidhet me traditën e vjetër të punimit të baltës si edhe traditën e hershme të besimtarëve ortodoksë për "blerjen e baltës" gjatë javës së pashkës, veçanërisht ditën e premtë të ashtëquajtur "e premtja e zezë". Artizanë dhe tregtarë të ndryshëm jo vetëm të zonës, ekspozojnë dhe tregëtojnë produktet e tyre, që blihen jo vetëm nga besimtarët por edhe vizitorët e tjerë.

Festa e liqenit, dhe festa e verës (dhjetor) në qytetin e Pogradecit janë shndërruar në tradita të festimeve që shoqërohen më pjesëmarrjen e një numri të madh vizitorësh nga Shqipëria dhe rajoni. Festa shoqërohet me panairë të produkteve tradicionale të gjithë zonës së Pogradecit.

Festivali Folklorik i Prespës (11 Tetori) dhe Java verore kulturore e Prespës (02-10 Gusht), Dita

e Verës në Prespë (Dhjetor), janë festa të organizuara nga minoriteti maqedonas në komunën e Liqenasit që mbledhin në këto ditë mijëra vizitorë. Atmosfera festive shoqërohet me shprehjen e traditave, zakoneve dhe promovimin e produkteve origjinale të komunitetit maqedonas.

Krahas festave pagane qarku i Korçës dallohet dhe për numrin e madh të festave fetare, sidomos atyre të krishtera. Disa nga këto festa janë: Festa e Shën Prodhomit më 24 Qershor, në Voskopojë; Festa e Shën Mërisë më 15 Gusht, në Boboshticë dhe në Voskopojë; Festa e Shën Mërisë më 16 Gusht, në fshatin Dardhë; Festa e Satrivaçit më 1 Korrik, në fshatin Hoçisht të rrethit Devoll; Festa e Ristozit dyzetë ditë pas pashkëve, në Mborje të Korçës; Festa e Shën Thanasit më 18 Janar, në qytetin e Korçës; Festa e Shën Gjergjit në Dardhë, pas festimit të pashkës sipas kalendarit ortodoks; Festa e Shën Pjetrit në Vithkuq; Festa e Pashkëve në qytetin e Korçës, sipas kalendarit ortodoks; Festa e Krishtlindjeve më 25 Dhjetor.

Dita e verës festohet në 1 Mars, për besimtarët ortodoksë dhe 14 Mars për besimtarët myslimanë. Ndezja e zjarreve, veroret dyngjyrëshe (kuqe dhe të bardhë), përgatitja e kulaçit me sheqer, fiqtë e thatë, vera e kuqe, vezët e kuqe (për besimin mysliman), degët e këputura me sythet e porsaçelura, janë elementë që shoqërojnë këtë festë. *Rosicat* është festë e besimtarëve ortodoksë tradicionale për fshatin Boboshticë. Festohet ditën e tretë pas fluturimit në qiell të Krishtit, “kur Shën Maria thirri shoqet dhe gatuan një drekë për të festuar”. Gratë e fshatit të vjetra dhe të reja, të veshura me kostumet tradicionale të zonës, pasi kanë kryer ritet fetare në kishën e Shën Mërisë, nisen drejt rrugicave të fshatit. Me këngë në gojë dhe me kërcime ato trokasin shtëpi më shtëpi duke uruar shëndet dhe mbarësi si dhe duke mbledhur ushqime (miell, vezë, gjalpë, sheqer), me të cilat përgatisin një drekë të madhe ku do të ftojnë gjithë fshatin dhe vizitorët. Është festë sa e krishterë aq edhe pagane, sepse lidhet edhe me ardhjen e verës, çeljen e luleve dhe gatuhet vetëm brumë, pasi fshati e ka jetën të lidhur me grurin dhe blegtorinë.

Nisur nga numri i madh i produktit kulturor, në qarkun e Korçës organizohen disa festivale apo konkurse siç janë: *Festivali i Ushqimit* organizohet gjatë sezonit turistik të verës (Qershor-Shtator). Çdo ditë të mërkurë hahet ushqim tradicional i mirë dhe më çmim të lirë në restorantet dhe tavernat që janë pjesë e këtij eventit; *Konkursa Ndërkombëtar i Fotografisë “Sotir”*, organizohet për nder të fotografit të madh korçar Kristaq Sotir dhe traditës së fotografisë së ndërtuar prej tij. Konkursi mbledh në qytetin e Korçës fotografë nga vende të ndryshme të botës të cilët ekspozojnë dhe konkurojnë me punimet e tyre që ekspozohen në galerinë “Guri Madhi”; *Kolonia Ndërkombëtare e Piktorëve “Ditët e Mios”*, zhvillohet çdo vit në qytetin e Korçës nën emrin e piktorit të madh Vangjush Mio. Prania e piktorëve nga Shqipëria dhe vende të tjera jashtë saj vendos jo vetëm lidhje të komunikimit midis artistëve, por njëkohësisht promovon dhe vlerat e qytetit dhe gjithë qarkut të Korçës; *Panairi i fundvitit* përbën një lloj festimi në ditët e fundit të vitit, i shoqëruar me panair të produkteve të zonës. *Simpoziumi Ndërkombëtar*

“Skulptura e Parkut” është një event në kuadër të traditës së hershme të punimit të gurit dhe mirëpret çdo vit në qytetin e Korçës, skulptorë nga vende të ndryshme të botës të cilët marrin pjesë me skulpturat e tyre si simbolikë për qytetin.

Nëse do të bënim një analizë të asaj çka evidentuam më sipër, mund të themi se organizimi i eventeve kulturore dhe festave fetare në qarkun e Korçës, pavarësisht përmasave të tyre, kanë një impakt të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik dhe kulturor të të gjithë zonës. Krahas promovimit të vlerave kulturore, angazhimi i disa komponentëve të sektorit turistik (njësitë akomoduese, transporti, shërbimet, ushqimi etj.) bën të mundur që e gjithë ekonomia lokale të mund të sigurojë përfitime ekonomike. *Nga survejimi që kemi bërë në ditët festive të festës së birrës, dy vitet e fundit kapacitetet akomoduese të qytetit të Korçës dhe rrethinave kanë qenë të rezervuara krejtësisht që më parë, madje në këtë sezon kërkesat kanë qenë mbi këto kapacitete.* Konsumi i sasive të birrës dhe produkteve të tjera tradicionale ka sjellë përfitim të konsiderueshëm ekonomik për bizneset që marrin pjesë në këtë event. Të ardhurat financiare të siguruara nga këto, por edhe festime të tjera, qarkullojnë në të gjithë hapësirën e qarkut të Korçës dhe më gjerë, duke sjellë kështu përfitime direkte dhe indirekte në komunitetin e zonës.

Në ditët e panairëve (poçerisë, ushqimit, panairit të fundvitit (dhjetor) dhe në ditët e festave fetare, banorët vendas vetëpunësohen duke shitur produkte tradicionale të zonës. Ky është një kontribut, që pak a shumë ndikon në rritjen e të ardhurave dhe mirëqënies së tyre.

Po kështu përfitimet llogariten edhe në aspekte të tjera si ato të promovimit të destinacionit turistik përmirësimin e infrastrukturës, veçanërisht asaj që lidhet me shërbimet turistike. *I rëndësishëm është aspekti i forcimit të identitetit dhe krenarisë lokale të vetë komunitetit, por edhe komunitetit karshi vizitorëve.* Kjo ndjenjë për shkak edhe historisë dhe vlerave që i kemi përmendur, është shumë e kultivuar në qytetin e Korçës.

Aktualisht nuk është bërë ndonjë studim apo kërkim, për të parë realisht efektet social-ekonomike të festave apo eventeve të tjera në këtë destinacion. Kjo kërkon angazhim dhe do të ishte një fushë studimi me mjaft interes për hartuesit e politikave të zhvillimit apo studiuesit që paraqesin interesin e tyre në fushën e trashëgimisë kulturore dhe të turizmit të lidhur me të. *(Prioriteti i punës kërkimore të autores në të ardhmen.)*

8.12. TRADITAT

Trashëgimia shpirtërore është e pasur edhe me tradita dhe zakone, rite dhe ceremoni që kanë të bëjnë me lindjet, martesat dhe vdekjet. Një aspekt të rëndësishëm kulturor, përbën mënyra e jetesës brenda dhe jashtë ambientit të banimit. Mobilimi i banesës dallohet në fshat dhe në qytet, për orendi të veçanta, sipas funksioneve që kryenin mjediset përkatëse të banimit. “Oda e miqve”, dallohet për përdorimin e elementëve tradicionalë të zbukurimit, si sixhadet, velencat që mbulonin minderët, jastëkët, mobiljet e vjetëra, në disa raste të sjella nga vendet fqinje, enë metalesh të zbukuruara, porcelane dhe tantella e mbulesa të punuara me dorë. Disa prej këtyre

elementeve i gjejmë edhe sot të ruajtura në banesën dhe mënyrën e jetesës së qytetit.

E krahasuar me të njëjtin ambjent të banesave të qytetit të Gjirokastrës, Beratit dhe Shkodrës, në këto të fundit elementët dekorues janë më të pasur në orendi dhe në ngjyra. Karakteristike këtu janë gdhëndjet dhe daltimet e shumta të drurit në tavane si edhe dekorimi i oxhakëve, madje këta të fundit ndryshojnë edhe nga forma. Një nga traditat që vlen për t'u përmendur janë *mikpritja dhe qytetaria* korçare. Të vlerësuara pozitivisht në opinionet e turistëve të huaj, mund të themi se janë dy pika të forta të tërheqjes turistike në qarkun e Korçës.

8.13. ZEJTARITË E NDRYSHME TRADICIONALE

Artizanati dhe zejet tradicionale janë gjithashtu pjesë e trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare. Ato dëshmojnë për botën dhe krijimtarinë e pasur shpirtërore të komunitetit i cili i ka krijuar, i ka ruajtur me dashuri dhe krenari dhe përpiqet t'i trasmetojë ato në brezat e ardhshëm. Voskopoja dallohej për prodhimin e shajakut për eksport, Dardha për punimin e drurit, Bradvica për punimin e enëve prej balte, Progri për ndërtimin e banesave dhe Opari për punimin e gurit e për shtrimin me kalldrëm etj. *Veglat e punës* kanë qënë të shumëllojshme në varësi të natyrës së punës. Pothuajse në të gjithë zonën rurale përdorehin të njëjtat vegla të ndërtuara kryesisht prej druri dhe metali. *Parmenda* ishte mjete kryesor që lëronte tokën, ndërkohë që përdorehin edhe mjete të tjera si shati, kazma, lopata, qylyku, piroi, kosa etj. Tashmë ato ruhen si sende relike në banesat rurale.

Veglat muzikore përbëjnë një zeje të veçantë në pamjen e përgjithshme të zejtarisë shqiptare. Në rrugë artizanale kanë qënë prodhuar dhe ende prodhohen vegla si gajde, fyelli, dajre, lauri, buzuk, mandolinë, etj. *Fyelli* është vegël e përdorur nga barinjtë në të gjithë Shqipërinë. Ka gjetur përdorim të gjerë në të gjithë zonën malore të Korçës. Ai është i ndërtuar nga një gyp druri apo dhe metali me vrima për të krijuar melodinë. *Klarineta* është një instrument si klarineta që përdoret në ditët e sotme dhe një nga instrumentat më të rëndësishëm të muzikës popullore. *Buzuku* është një lloj mandoline me 6-10 tela të cilës i bihet me pendë. Është i përhapur në trevat e zonës së Korçës dhe Leskovikut. *Gajdja* është e ndërtuar me lëkurë keci, qengji etj. që mbushet me ajër. Ka një tytë druri për t'a fryrë, një tytë tjetër me vrima që lëvizin gishtat dhe një të tretë pa vrima që shërben për të krijuar ison. Luhet në zonën e Pogradecit, Korçës dhe Kolonjës. *Lahuta* përbëhet prej druri, me bisht të gjatë dhe me tela. Ka qënë mjaft e përhapur në trevën e Korçës dhe vazhdon edhe sot të jetë pjesë e sazeve të muzikës popullore. Po kështu *kitara* është e ndërtuar prej druri dhe është instrument i përhapur në të gjitha zonat e qarkut të Korçës. Ajo përbën simbolin e këngës qytetare korçare dhe është pjesë e trashëgimisë së saj.

8.14. KUZHINA TRADICIONALE DHE FREKUENTIMI TURISTIK

Gastronomia gjithashtu, është pjesë e trashëgimisë kulturore dhe shumë pak njerëz mund ta

pranojnë si të tillë. Gastronomia franceze, meksikane, mesdhetare janë pranuar tashmë si trashëgimi kulturore botërore. Si pjesë e jetës dhe traditave sociale ajo konsiderohet si resurs dhe element vital i gjithë komponentëve turistikë. Në pothuajse çdo destinacion, sot shërbimi i ushqimit është i rëndësishëm po aq sa akomodimi. Është një pritshmëri e përgjithshme për pjesën më të madhe të turistëve të kenë mundësi të provojnë gatimet tradicionale të kuzhinës lokale. Pa dyshim që trashëgimia kulturore e qarkut të Korçës nuk do të mund të kuptohej pa gastronominë e veçantë dhe të shumëllojshme. Si pjesë e traditës mbarë shqiptare në fushën e trashëgimisë kulturore ajo është e lidhur ngushtë me elementët etnografik, traditat, zakonet dhe mjedisin karakteristik të vetë zonës. Përgatitja e zahireve është traditë e hershme e gjithë trevës së Korçës, fshatit dhe qytetit. Zgjatja e periudhës së dimrit shtron domosdoshmërinë e grumbullimit të ushqimeve dhe përgatitjes së tyre, që në fund të stinës së verës dhe fillimit të vjeshtës. Në këtë periudhë përgatiten petkat, trahani i ëmbël dhe i thartë, oshafkat, reçelrat, turshitë nga më të thjeshtat deri tek të mbushurat. Nga fundi i vjeshtës përgatitet pastërmaja, llukanikët e kollofacet. Nxjerrja e verës dhe rakisë shoqëron përgatitjen e zahireve, të cilat ruhen në ambiente të posaçme (bodrome apo qilare) të shtëpive private të fshatit por edhe qytetit. Guzhina tradicionale pëlqehet dhe preferohet në të gjithë vendin për freskinë dhe cilësitë e veta organike. Çdo trevë e qarkut përmendet për specialitetin dhe llojshmërinë e gatimeve.




Fig. – 6 Gastronomia E Qarkut Korçë

Në Voskopojë mjedisi gërshetohet me gatimet tradicionale, si një nga produktet lokale të frekuentura nga turistët. Ofrohet mishi i qengjit në hell, i veçantë në shijen e tij, lakrorët në saç, turshitë dhe rakia e kumbullës. Fshati i Dardhës dallohet për specialitetin e tij, lakrorin me dy petë në saç, i përgatitur me gjellë të ndryshme. Veç kësaj përmenden piperkat me gjizë, gatimi e ligavecëve (kërmijëve) dhe rakia e kumbullës së Dardhës. *Boboshtica* është një fshat që dallohet në tërësi për gatime tradicionale të mishit dhe të brumërave. Veçanërisht e spikatur është nxjerrja e rakisë së manit me vlera të shëndetshme, traditë e favorizuar edhe nga prania e

drurëve të manit. Treva e *Kolonjës* përmendet për rritjen natyrale të gjedhit dhe të dhenve, produktet e mishit të të cilëve janë të pëlqyera dhe të kërkueshme nga konsumatorët. Përmendim gjithashtu verën e Leskovikut e cila nxirret në punishte tradicionale, duke mos i humbur vlerat ushqyese.

Megjithëse këto gatime nuk përgatiten në mënyrë të veçantë për turistët, ato përbëjnë një produkt turistik të kërkuar dhe mjaft të pëlqyer. Frekuentuesit e tyre në pjesën më të madhe janë vizitorët vendas nga zonave të ndryshme të Shqipërisë. Nuk mungon frekuentimi nga turistët e huaj që vijnë në destinacion. Nga anketimi i bërë, në opinionet e tyre rreth ushqimit, vlerësohet shija e veçantë dhe çmimet e mira të produkteve. Nëse nisemi nga frekuentimi gjithëvjetor i restoranteve me gatime tradicionale, në qarkun e Korçës do të përmendim disa nga më rëndësishmit: taverna "*Voskopoja*", restorant "*Akademia*", në fshatin Voskopojë; taverna "*Antoneta*", taverna "*Vila Melko*", taverna "*Tomas*", në Boboshticë; taverna "*Mihallari*" dhe restorant "*Dardha*", në Dardhë; taverna "*Ilo*", taverna "*Aleksandër*", taverna "*Vangjell*" në Zaroshkë; restorant "*Milenium*", restorant "*Kashta*"; Vila "*Art*"; restorant "*Paradise*" në Tushemisht; taverna "*Sidheri*"; taverna "*Vasili*"; taverna "*Antel*" në Korçë; restorant "*Ylli*"; restorant "*Teo*" në Kamenicë etj. Është për t'u evidentuar fakti, që në përgjithësi restorantet e fshatrave ofrojnë gatime tradicionale, ashtu sikurse mund të evidentojmë në disa raste tendencën e përfshirjes së gatimeve ndërkombëtare, ku në restorantet e qytetit të Korçës, kjo është mëse e pranishme. Cilësia e shërbimit që ofrohet në ambientet e ngrënies, cilësia e përgatitjes dhe sevirja e gatimeve në përgjithësi vlerësohet e kënaqshme.

8.15. Zhvillimi turizmit kulturor në qarkun e Korçës

Udhëtimi dhe lëvizja e njerëzve ka filluar që me ekzistencën e tyre dhe lindjen e qytetërimeve. Me kalimin e shekujve motivet e udhëtimit të tyre ndryshuan; tregëti, luftra, qëllime ekonomike, fetare dhe studimi. Me të ashtëquajturin "Grand Tour" në shekullin e XVII, lindi edhe "turisti", i cili do të gjente përdorim të gjerë në shekullin e XIX, ku udhëtimet u bënë më të organizuara. Sipas Deklaratës së të Drejtave të Njeriut e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 10 Dhjetor 1948, Neni 24 "*...çdo njeri ka të drejtë të pushojë, të argëtohet, duke përfshirë një limitim të arsyeshëm të kohës së punës dhe pushime të paguara*".

Lidhur me këtë përkufizimi i dhënë nga Organizata Botërore e Turizmit (ËTO) është gjerësisht më e pranuar sipas të cilit, "*...turizmi është aktiviteti i personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë në vende jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm, për jo më shumë se një vit, për kalimin e kohës së lirë, biznes apo qëllime të tjera*". Turizmi është cilësuar si "*si çelësi i zhvillimit, prosperitetit dhe mirëqenies*", të shumë vendeve dhe rajoneve në Europë e më gjerë, "*...rrallë mund të gjendet ndonjë sektor i ekonomisë i tillë si turizmi, ku mund të krijohet mjaft shpejt vlera e shtuar e*

produkteve, ku mund të hapen mjaft vende të reja pune, ku mund të thithet shpejt valuta e huaj përballë një kostoje relativisht të ulët”.

I cilësuar si *“si çelësi i zhvillimit, prosperitetit dhe mirëqenies.”*, të shumë vendeve dhe rajoneve në Europë e më gjerë, *“...rrallë mund të gjendet ndonjë sektor i ekonomisë i tillë si turizmi, ku mund të krijohet mjaft shpejt vlera e shtuar e produkteve, ku mund të hapen mjaft vende të reja pune, ku mund të thithet shpejt valuta e huaj përballë një kostoje relativisht të ulët”.*

Duke reflektuar rëndësinë ekonomike të turizmit në përgjithësi dhe turizmit kulturor në veçanti një sërë organizmash kombëtare dhe ndërkombëtare si UNËTO, USAID, UN, UNDP, FMN, UNESCO, ËB, TTC, GIZ, SNV etj. ofrojnë ekspertizë dhe mbështetje financiare për këto aktivitete në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Turistët ndërkombëtarë, (vizitorë me mbi një natë qëndrimi) u rritën me 4 % në vitin 2012 duke arritur në 1 miliard, për herë të parë në histori, ndërkohë që të ardhurat u rritën në 4 % duke shënuar rekord me 1.075 miliard \$ ose 837 miliard € në të gjithë botën. *“Në vitet e para të shekullit të 21-të, pavarësisht një mjedisi ndërkombëtar që përfshiu performancën e turizmit global, Europa i konsolidoi pozitat e saj si destinacioni turistik numër 1 në botë”.* Në vitin 2000 numri i turistëve ndërkombëtarë në Europë ishte 385 milion, duke u rritur në 439 milion në 2005 dhe 477 milion në 2010, ndërkohë që të ardhurat nga turizmi u rritën me respektivisht me 230 miliard \$ në 2000, me 378 miliard \$ në 2005 dhe 407 miliard \$ në 2010. Duke llogaritur 52 % të turistëve ndërkombëtarë nga e gjithë bota, Europa arriti të tërheqë 534 milion turistë në vitin 2012, 18 milion më shumë se në 2011. Ndërkohë që të ardhurat nga turizmi u rritën me 2 % në terma realë, llogaritur në 458 miliard \$ (356 miliard €), duke përbërë 43 % të totalit të ardhurave botërore. Sipas të dhënave të ËTO-së, që nga viti 2001 numri i turistëve në Shqipëri ka ardhur duke u rritur. Në vitin 2010, Shqipëria (rajoni jugor mesdhetar) u arrit nga 2.347 milion turistë ndërkombëtarë dhe në 2011 nga 2.865 milion. Të ardhurat nga ky sektor llogariteshin nga 1 626 milion \$ në 2011, në 1 628 milion \$ në 2011 dhe 1 471 milion \$ në 2012.

Vizioni i ËTO-së për vitin 2020, parashikon se turistët ndërkombëtarë priten të rriten në 1.56 miliard, nga të cilët 1.18 miliard do të jenë ndërrajonalë dhe 0.8 miliard do të jenë turistë të largësive të mëdha. Në arritjet totale të rajoneve në 2020, në top listë do të jenë Europa (717 milion turistë), Azia Lindore dhe Paqësorit (397 milion) dhe Amerika me 282 milion turistë. Për periudhën e parashikuar Europa Perëndimore do të mbetet nënrajoni me tërheqjen më të madhe, ndërkohë që tërheqja do të rritet në nënrajonin e Mesdheut Lindor. Po sipas këtij parashikimi dhjetë vendet e ballkanit, do të kenë arritjen e 79 milion turistëve ndërkombëtarë, ndërkohë që destinacionet kryesore turistike si Greqia, Turqia, Bullgaria, Rumania dhe Kroacia do të kenë mbi 92 % të totalit të turistëve. Duke vlerësuar tendencën dhe parashikimet e rritjes së lëvizjes dhe numrit të turistëve ndërkombëtarë në Europë, Mesdhe dhe Ballkan, si edhe duke patur në konsideratë ofertën e pasur të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, mendojmë se është një mundësi mjaft e mirë për Shqipërinë për t'u përfshirë ndër këto destinacione. Sigurisht, që

këtu është i nevojshëm mirëorganizimi dhe angazhimi gjithëpërfshirës i aktorëve të sektorit turistik.

Nga vëzhgimet dhe analizat e shumta që po i bëhen turizmit si dukuri ekonomike, sociale dhe kulturore, **turizmi me synim kulturën dhe trashëgiminë kulturore** po konsiderohet, veçanërisht në shekullin e ri, si një nga aktivitetet me impaktin më të madh në industrinë botërore të turizmit.

Duke iu referuar ecurisë së zhvillimit, industria e turizmit kulturor tashmë ka avancuar në të gjitha vendet dhe rajonet europiane, duke zënë hapësirat e lëna bosh nga industria prodhuese. Sipas përcaktimit të bërë nga Komisionit Europian, turizmi tipik kulturor në Europë përfshin festivale dhe evente, vizita në muze, interes për arkitekturën tradicionale, rrënojat arkeologjike, vizita te objekteve të kultit, kisha, interes për fshatin dhe jetën rurale, eksperiencat e jetuara, muzikë, gatimet tradicionale, njerëz të shquar të rajoneve". Në drejtim të turizmit kulturor Shqipëria ka shumë pasuri të trashëgimisë kulturore me vlera kombëtare dhe ndërkombëtare, që kanë ngjallur tashmë interesin e vizitorëve, veçanërisht atyre ndërkombëtarë. Përmendim këtu Parkun Kombëtar të Butrintit (Trashëgimi Botërore e mbrojtur nga UNESCO), i cili gjatë vitit 2012 u vizitua nga 76 488 vizitorë, ndërkohë që numuri u rrit në 84 633 vizitorë vendas dhe të huaj, në vitin 2013. Po kështu të ardhurat e siguruara nga Parku i Butrintit u rritën përkatësisht nga 30.2 milion në vitin 2012, në 34.02 milion lekë në vitin 2013. Të ardhurat e siguruara shkojnë në buxhetin e shtetit dhe nëpërmjet ministrisë përkatëse alokohen fondet për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e parkut.

Zhvillimi i turizmit kulturor në rajonin e Korçës i ka fillimet e para mjaft të hershme.

N.q.s do t'i referoheshim përkufizimeve të ndryshme për turizmin dhe fillimet e tij në botë, me drejtë do të shtronim pyetjen: *A përbënte Voskopoja, qendra e qytetërimit në shek. XVIII, një vend tërheqës dhe argëtues për ata që e vizitonin atë?*

Tipet e turizmit kulturor

Tipet e turizmit kulturor	Vendet tipike/ aktivitetet e interes
Turizmi i trashëgimisë	Vizita në kështjella, pallate dhe shtëpi vendase Site/vende arkeologjike Monument e
Turizmi i artit	Vizita në teatro Koncerte Galeri
Turizmi kreativ	Fotograf i Pikturë Gatim Zejtari
Turizmi kulturor urban	Qytete historike Qytetet e rilindur industrial Atraksionet e artit dhe të trashëgimisë Dyqanet
Turizmi kulturor rural	Fshati, ferma apo agroturizmi Ekomuzetë Peisazhet kulturore, Bazar
Turizmi kulturor indigjen	Ekoturizmin Vizita në qendra kulturore Arte dhe artizanet
Turizmi kulturor popullor	Parqe dhe atraksione Dyqane komplekse Ngjarje sportive

Tab. – 1 Tipet e turizmit kulturor (Burimi: Përshtatur sipas tipologjisë së turistit kulturor Melanie K.)

Krahas zhvillimit të dukshëm social-ekonomik, pranisë së objekteve kulturore mjaft të rëndësishme për kohën, organizimi i panairëve tregtare (panairi i Shën Prodhomit) si dhe kremtimi i festave të shumta fetare, sillte në qytet udhëtarë dhe vizitorë nga vendet përreth, si dhe nga ato më të largët lindor dhe jugor. Prania e numrit të madh të haneve në qytet dhe përgjatë rrugës së karvaneve, është një tregues i lëvizjeve të Studiuesit dëshmojnë se jeta sociale dhe kulturore këtu, dallohej për një nivel të lartë zhvillimi. Pas rënies së Voskopojës, ishte qyteti i Korçës që mori një zhvillim të shpejtë social- ekonomik, funksioni tregtar i të cilit, e

bënte atë të frekuentuar. Ndërkohë në fillimet e shek. XX, në qytetin e Pogradecit filloi të kultivohej tradita e kalimit të kohës së lirë dhe e pushimeve. Kjo gjeti shprehjen e vet në vitet 1920-1930, kur klasa e pasur nga qytetet më të afërta ndërtoi këtu shtëpitë e para të verimit (kultura e të priturit të miqëve të verës).

Përsa i përket infrastrukturës turistike, (strukturat akomoduese) në qarkun e Korçës funksiononin:

Në qytetin e Korçës - Hotel "Turizmi" (77 dhoma me 200 shtretër, 27 dhoma për të huaj); Kampi i punëtorëve (68 dhoma me 140 shtretër); hotel "Valbona" (20 dhoma me 40 shtretër); hotel "Borova"; hotel "Krimea" dhe hotel "Elbasani" në pazarin e Korçës. Hotelet funksiononin me kapacitet të plotë në sezonin e verës por frekuentoheshin edhe në sezonin e dimrit.

Voskopoja kishte dy kampe; kampin e punëtorëve dhe kampin e pionierëve me kapacitete të plota në sezonin e verës por të frekuentuara edhe gjatë të dimrit.

Dardha kishte një kamp për punëtorët dhe kamp për pionierët.

Hotelet administroheshin nga shteti dhe gjatë periudhës së sezonit të frekuentimit të tyre angazhoheshin disa struktura shërbimesh shtetërore²⁴⁶.

Pas viteve '90, me ndryshimet e gjithanshme të vendit, në qarkun e Korçës u rrit numrin i vizitorëve vendas dhe njëkohësisht interesi i turistëve të huaj që vizitonin Shqipërinë. Klima e shëndetshme kurative, arkitektura e veçantë dhe potencialet kulturore të qytetit të Korçës dhe vendbanimeve rreth tij, janë disa nga atraksionet tërheqëse për turistët. Numri i vizitorëve vendas dhe të huaj ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Është për t'u evidentuar fakti i mungesës së të dhënave të sakta zyrtare mbi llogaritjen e prurjeve turistike në qarkun e Korçës dhe në zona të veçanta të tij. Për të krijuar një ide lidhur me këtë, po paraqesim të dhënat e mëposhme.

Nga të dhënat statistikore nuk mund të llogaritet një numër i saktë i turistëve të huaj që vizitojnë qarkun e Korçës, pasi në një pjesë të mirë të rasteve vizitorët që vizitojnë qytetin e Korçës, vizitojnë edhe zonat përreth. Sipas këtyre të dhënave të bëra prezent nga njësitë e qeverisjes vendore, *Korça* është qyteti më i frekuentuar nga turistët vendas. Numri vizitorëve vendas ka ardhur duke u rritur nga 43 000 në vitin 2009 në 115 000 në vitin 2012. Sipas të dhënave të bashkisë Korçë numri i vizitorëve në njësitë e akomodimit në qytetin e Korçës gjatë periudhës 2009-2011 ka qënë 32 295 vizitorë. (Raport përmbledhës për numrin e vizitorëve 2009-2011) Nga anketimi i bërë me turistët e huaj tërheqja e tyre kundrejt destinacionit, bazohet kryesisht në motivet kulturore. Qyteti i *Pogradecit* është zona e dytë e frekuentuar për nga numri i turistëve vendas, numri i të cilëve ka ardhur duke u rritur në 57 000 vizitorë, çka lidhet me turizmin e banjave dhe të liqenit që ofron Pogradeci në stinën e verës.

Voskopoja është fshati turistik që dallohet për numrin e lartë të turistëve vendas dhe të huaj që e vizitojnë. Nga 28 000 vizitorë vendas në vitin 2009 është rritur në 48 000 në vitin 2012. Në këtë

rritje rol të rëndësishëm luan edhe organizimi i festës së Shën Prodhomit, që sjell në zonë mijëra vizitorë. Numri më i madh i turistëve të huaj është regjistruar në Vos kopojë, që në vitin 2012 llogaritet 24 400 nga 1 700 në vitin 2009

Rrethi	Korçë		Pogradec		Liqenas		Voskopojë		Tushemish		Drenovë		Vithkuq	
	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj
2009	43 000	2 300	35 200	2 300	1 100	110	28 000	1 700	30 200	410	5 700	160	80	50
2010	92 000	8 000	48 600	2 700	2 000	100	32 300	20 000	35 000	460	6 200	200	70	60
2011	98 000	8 200	55 200	4 300	3 300	400	42 300	22 900	35 000	1 200	17 600	600	530	120
2012	115 000	9 000	57 000	7 000	6 000	800	48 000	24 400	35 400	2 500	18 500	1 200	2 800	1 700
Total	348 500	27 500	196 000	16 300	12 400	1 410	150 600	69 000	155 600	4 570	48 000	2 160	3 480	1 930

Tab. – 2 Numri i vizitorëve vëndas dhe të huaj në zonat turistike të qarkut (Burimi: Institucioni Prefektit të qarkut Korçë)

Nga anketimi në terren rezulton se motivacioni kryesor i turistëve të huaj që kanë vizituar Voskopojën është ai kulturor, i cili lidhet me vizitat në kishat, arkitekturën tradicionale, mënyrën e jetesës së banorëve, gatimet tradicionale etj. Po kështu rritje të numrit të vizitorëve vihet re edhe në zonën e Drenovës, ku përmendim tërheqjen ndaj pikave turistike të Dardhës dhe Boboshticës. Njësitë e akomodimit, si një ndër komponentët më të rëndësishëm të sektorit turistik, ofrohen nëpërmjet strukturave akomoduese të tipit të hoteleve, shtëpive private, bujtinave dhe shtëpive të fshatit (turizëm familjar). Sipas studimit të bërë nga SNV-ja në Strategjinë e marketingut dhe zhvillimit të produktit turistik për rajonin e Korçës, evidentohen 49 njësi akomodimi apo hotele dhe 81 shtëpi pushimi. Nga statistikat e mësipërme rezulton se numri më i madh i njësive të akomodimit, ndodhet në rrethin e Pogradecit, e lidhur kjo me faktin që Pogradeci ofron turizmin e liqenit dhe banjave të diellit, por edhe me kohën e qëndrimit më të gjatë që kërkon ky lloj turizmi. Një pjesë e mirë e hoteleve janë të lokalizuara jashtë qytetit, në Tushemisht dhe përgjatë rrugës nacionale Lin –Pogradec.

Vendndodhjet	Hotele	Shtretër	Shtëpi pushimi
Korça	9	600	
Pogradeci	27	900	10
Voskopoja	5	300	15
Dardha	2	95	10
Prespa	2	30	30
Vithkuqi	1	20	4
Boboshtica			5
Erseka	3	57	7
Total	49	2002	81

Tab. – 2 Struktura akomoduese e turistëve në qarkun e Korçës (Burimi : Zyra e SNV- Korçë , 2009)

Një survejim tjetër i GIZ mbi njësitë e akomodimit në fshatrat turistike në Korçë, evidenton se në fshatin Dardhë ndodhen 6 hotele, 61 dhoma dhe 130 shtretër. Po këtu, ndodhen 6 shtëpi miqësh me 12 dhoma dhe 24 shtretër. Në fshatin Voskopojë ndodhen 7 hotele, 90 dhoma me 205 shtretër, 11 vila alpine me 35 shtretër. Këtu ndodhen gjithashtu 11 shtëpi miqësh (guest house) me 33 dhoma dhe 70 shtretër. Në fshatin Vithkuq 2 hotele, 12 dhoma me 26 shtretër. Në Drejtorinë e Tatim-Taksave në Korçë, rezultojnë të regjistruara 58 njësi akomodimi hoteleri në qarkun e Korçës. Nga sa mund të konstatojmë nga të dhënat e mësipërme disa biznese të tipit njësi akomodimi (hotel), nuk figurojnë të regjistruara si të tilla edhe pse kryejnë këtë aktivitet. (Për shërbimet që ofrojnë njësitë e akomodimit në zonat e frekuentura nga turistët, do të referohemi të dhënave të anketimit tonë të bërë në to). Pothuajse të gjitha njësitë e akomodimit të regjistruara si të tilla, ofrojnë edhe shërbimin e ushqimit (restorant) dhe shërbimin bar-kafene. Shërbimi i informacionit turistik ofrohet nëpërmjet Zyrave të Informacionit Turistik në qytetin Korçës, Pogradecit, në fshatrat Voskopojë, Dardhë dhe në Parkun Kombëtar të Prespës (Goricë e Madhe) dhe Zagradec pranë liqenit të Prespës së Vogël.

Krahas elementëve të infrastrukturës speciale në shërbim të turizmit, elementë të tjerë të infrastrukturës në tërësi kanë ndikimin e tyre direkt dhe indirekt në shërbim të turizmit. Në këtë këndvështrim i gjithë qarku i Korçës ka një rrjet të zhvilluar transporti që e lidh me pjesën veriore dhe jugore të Shqipërisë. Shërbimi i transportit ofrohet rregullisht nëpërmjet mjeteve të transportit të tipit autobus, furgon dhe taksi për komunikimin nacional dhe mjetin furgon për lidhjen e qyteteve me zonat rurale të qarkut. Linja të rregullta të transportit të udhëtarëve me autobus dhe taksi lidhin Korçën si qëndër qarku me Selanikun dhe Athinën në Greqi. Lidhja me qytetet Ohër, Strugë, Shkup në FYROM realizohet me shërbim taksi, nëpërmjet doganave të

Tushemishtit, Goricës dhe Qafë Thanës.

Shërbimi shëndetësor mundësohet nëpërmjet spitalit rajonal në qytetin e Korçës dhe shërbimit spitalor në qytetet Pogradec, Bilisht, Ersekë. Për sa i përket furnizimit me ujë të qarkut, qyteti i Korçës ka më se 10 vjet që furnizohet me ujë të pijshëm 24 orë (projekti i Bankës Gjermane KfË në vitin 2002) dhe përmirësime në furnizimin me ujë të pijshëm kanë edhe zonat e tjera urbane dhe rurale të qarkut. Po kështu Korça si qytet, ka një rrjet funksional të kanalizimeve të ujërave të zeza, të cilat trajtohen në impiantin e pastrimit të ujërave të zeza. Ndërkohë situata paraqitet problematike në zonat rurale, në veçanti në ato zona, që frekuentohen nga turistët. Për largimin e mbeturinave të ngurta urbane situata mbetet problematike në gjithë zonat e qarkut të Korçës. Problem shqetësues përbëjnë gjithashtu për mjedisin në zonat rurale, mbetjet shtazore.

8.16. ITINERARET TURISTIKE-KULTURORE TË QARKUT TË KORÇËS

Transformimet e thella me karakter politik, social-ekonomik dhe shoqëror, që kanë ndodhur vitet e fundit në vendin tonë, janë shoqëruar edhe me ndryshime të ndjeshme në fushën e infrastrukturës. Ndërtimi dhe përmirësimi i rrjeteve kryesore të transportit dhe komunikimit, kanë favorizuar lidhjen e destinacionit me zona të tjera brenda Shqipërisë si edhe me vendet ndërkufitare Greqinë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Po kështu një rrjet komunikimi rrugësh dytësore, lidhin qytetet me zonat rurale dhe pranë tyre edhe qendrat e vizitueshme. Mbi bazën e këtyre rrjeteve të komunikacionit, për të vizituar atraksionet dhe zonat kulturore të përmendura më sipër, mund të organizohen disa itinerare turistiko-kulturore. Këto mund të jenë në grupe apo individuale, me kohëzgjatje të kufizuar (ditore), një ditore por edhe më gjatë. Si të tillë do të përcaktonim:

8.16.1. ITINERARE BRENDA VENDIT

Ky itinerar mund të fillojë që nga aeroporti i Rinasit (për turistët e huaj) duke vazhduar në *Tiranë-Elbasan-Pogradec-Korçë-Ersekë-Leskovik-Përmet-Gjirokastër-Sarandë-Vlorë* dhe të përfundojë përsëri në Tiranë. Në kuadrin e njohjes së Shqipërisë Jugore ky itinerar mund të zhvillohet kryesisht në grupe turistësh ose ture të ndërmarra nga agjensitë turistike, por edhe nga ture turistësh të pavarur. Distanca nga Tirana në Korçë (159 km) mund të përshkohet në intervalin prej 3 orësh, ndërsa distanca Korçë-Sarandë (247 km) për shkak infrastrukturës jo të mirë rrugore, mund të përshkohet për 8-9 orë udhëtim. Një itinerar i dytë mund të nisë gjithashtu nga porti i Durrësit, në qytetin e *Durrësit-Elbasan-Pogradec-Korçë-Ersekë-Leskovik-Përmet-Gjirokastrë-Sarandë-Vlorë* dhe përfundojë përsëri në Durrës. Distanca Korçë-porti i Durrësit 200 km. Në të dy itineraret hyrja në territorin e qarkut të Korçës bëhet në majën e Qafë Thanës (Qafë Thanë-Korçë, 57 km). Në se akomodimi do të bëhet në qytetin e Korçës, ndalesa e parë

është në fshatin Lin, (në fund të zbritjes së qafë Thanës) ku mund të vizitohet Bazilika dhe Mozaikët e Linit. Ndalesa e dytë është në qytetin e Pogradecit, ku mund të vizitohet Muzeu Historik i qytetit, ndërkohë që vizitorët mund të soditin qytetin dhe pamjen e mrekullueshme të liqenit. Ndalesa tjetër mund të bëhet në fshatin Tushemisht. Këtu mund të vizitohet pika turistike të Drilonit, Mozaikët e Tushemishtit si dhe qendra e punimeve artizanale të grave të Tushemishtit. Gjithashtu, mund të provohen peshku i koranit dhe gatimet e tjera tradicionale në restorantet e fshatit. Në qytetin e Korçës, mund të vizitohet Muzeu i Artit Mesjetar, Muzeu Arkeologjik, Mësonjëtorja e Parë Shqipe, Katedralja “Ringjallja e Krishtit”, Muzeu “Bratko” si edhe të vizitohet pamja arkitekturore e qytetit në qendrën historike të tij.

8.16.2. ITINERARE BRENDA RAJONIT:

Mund të jenë njëditore ose brenda ditës. Këtu mund të përfshihen grupe studentësh apo nxënësish, të cilët mund të njihen me objektet e trashëgimisë kulturore dhe mjedisin natyror që i shoqëron ato. Gjithashtu këto itinerare preferohen nga vizitorët vendas dhe të huaj. Nisja mund të bëhet nga vendodhja më e afët.

Kështu një itinerar i brendshëm mund të nisë *Korçë-Pogradec-Tushemisht-Korçë; Korçë-Voskop-Voskopojë-Korçë; Korçë-Vithkuq-Korçë; Korçë-Boboshticë-Dardhë- Korçë; Korçë-Qafë Zvezdë-Pustec-Korçë; Korçë-Qarrit-Ersekë-Leskovik-Korçë; Brenda qarkut distancat nga qendra e qarkut janë: Korçë-Voskopojë 18 km, Korçë- Vithkuq 25 km, Korçë-Dardhë 20 km, Korçë-Boboshticë 7 km.*

8.16.3. ITINERARE NDËRKUFITARE:

Zonat dhe atraksionet kulturore të qarkut, mund jenë gjithashtu pjesë të rëndësishme të itinerareve ndërkufitare me zona kulturore përkatëse në Greqi dhe FYROM. Lidhja dhe komunikimi ndërkufitar i udhëtarëve, realizohet nëpërmjet doganave të Qafë Thanës, Tushemishtit dhe Goricës me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe doganave të Kapshticës dhe Tre Urat me Greqinë. Prania e pikave doganore me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare dhe afërsia me to, kanë favorizuar hyrjet dhe daljet e turistëve ndërkombëtarë si në drejtim të Shqipërisë, ashtu edhe drejtim të destinacionit të Korçës.

Largësia e qendrës së qarkut nga pikat doganore shprehet sipas distancave:

Kufiri me Greqinë (km)	Kufiri me R. Maqedonisë (km)
Kapshtica 37	Tushemisht 49
Tre Urat 100	Qafthana 57
Gorica 45	Gorica 45

Për turistët e pavarur që vijnë në qytetin e Korçës me kohë qëndrimi një natë fjetje në qytetin e

Korçës dhe vazhdimi i udhëtimit në FYROM, itinerari mund të përfshijë: Nisja nga *Tirana-Elbasan-Pogradec-Korçë*, në vazhdim *Korçë-Goricë e Vogël-Bitola (63 km)* apo *Korçë- Goricë e Vogël – Ohër (65 Km)*




Fig. – 7 Itineraret Turistike Të Qarkut Korçë

Po kështu itinerare të tjera mund të jetë Korçë-Goricë e Vogël-Resnjë (66,5 km); Pogradec-Tushemisht-Ohër (55 km); Korçë-Qafë Thanë-Strugë (62.2 km) e në vazhdim Shkup. Gjatësia e itinerarit Korçë-Shkup është 264 km dhe kohëzgjatja e udhëtimit rreth 4 orë. Një itinerar tjetër në drejtim të Greqisë do të përfshinte: Tiranë-Elbasan-Pogradec- Korçë-Bilisht-Kapshticë-Kostur-Kozan-Selanik. Po kështu nga qyteti i Korçës nëpërmjet doganës së Kapshticës mund të shkohet në Follorinë (57 km), Selanik (250 km), Janinë (130 km), Igumenicë dhe Athinë. Ndërkohë nga qyteti i Korçës për të kaluar në Janinë mund të shfrytëzohet dogana e Tre Urave në

Leskovik. Ndonëse aktualisht jo shumë e frekuentuar, përmirësimi i infrastrukturës rrugore mund ta kthejë në një pikë të rëndësishme kalimi kufitar për hyrjen dhe daljen e turistëve nga destinacionet turistike të Greqisë. Krahas itinerareve të përmendura ekzistojnë itinerare që lidhin qytetin e Korçës me disa nga qendrat e vizitueshme si: Korçë- shpellë e Trenit, Korçë-Tuma e Kamenicës si edhe Kolonjë–Tuma e Rehovës. Itineraret këmbësore janë një tjetër mundësi që mund t'u ofrohen vizitorëve të apasionuar pas mjedisit apo dukurive të veçanta që lidhen me të.

8.17. ZONAT/FSHATRAT KULTURORE, AVANTAZHET DHE DIASAVANTAZHET

Tendencat e fundit të lëvizjeve turistike janë të orientuara drejt qyteteve të vjetra apo fshatrave që mbartin element të së kaluarës. Objektet e kulturës tradicionale që ndodhen në to, muzetë, objektet e kultit, organizimi eventeve, i bëjnë këto vende të preferuarat e turizmit të trashëgimisë kulturore. Veçanërisht tërheqëse paraqiten “fshatrat kulturore” me larminë e tyre folkloristike, traditat dhe mënyrën e jetës, që prodhojnë eksperiencë të kërkuara nga turistët. Banesat tradicionale janë lehtësisht më të përshtatshme për t'u akomoduar në rastin e një fshati të banuar, ndërkohë që këtu turistët apo vizitorët nuk presin gjatë për të dëgjuar një këngë, shijuar një valle të artitshpirtëror apo një gatim të kuzhinës lokale. Si shembull të tillë përmendim rrjetin ndërkombëtar të “*fshatrave kulturore*” të Europës, si: Eijk aan Zee në Holandë, Mellionec në Francë, Bystre në Cezch, Pergine Vardarno në Itali, Paxos në Greqi, Kilingi-Nömme në Estoni, Ströbek në Gjermani etj. Njëpërmjet udhëtimeve nëpër Europë, duke vizituar dhe promovuar kulturat tek njëri tjetri, këto fshatra kanë zbuluar vlerat e harruara të nivelit lokal. Gjithashtu ky rrjet synon t'i japë shtysë zhvillimit social ekonomik në këtë nivel.

Nëse do t'i referohemi disa prej kriterëve që e bëjnë një qytet apo *fshat tradicional kulturor*, (arkitektura e banesave dhe materiali vendas i përdorur për ndërtimin e tyre; artizanati dhe objekte të tjera të bëra në vend; akomodimi; servirja e ushqimit tradicional; ekzistenca e guidave ose broshurave; prania e rrëfimitarëve ose rrëfyesve; qendra të informacionit turistik, vizitorë vendas dhe të huaj;) në qarkun e Korçës do të përmendim si të tilla:

Qyteti i Korçës, qendra e qarkut, dallohet për vlerat e mëdha kulturore dhe arsimdashëse, arkitekturën tradicionale të banesave, rrugët me kalldëm, monumentet historike, objektet e kultit, festimet e shumta, stilin e jetesës, figura të shquara patriotike dhe artistike etj.




Fig. – 8 Fshatrat Me Trashëgimi Kulturore

9. Ndërtimi Gjeologjik

9.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Në ndërtimin gjeologjik të Qarkut të Korçës, marrin pjesë të tre llojet shkëmbore, sedimentarë, magmatikë dhe metamorfikë, të formuara në kohë e hapësira të ndryshme. Në kuadrin krahinor marrin pjesë, tre zona të ndryshme gjeologo-tektonike e facialo-strukturale, zona tektonike e Mirditës, Krasta-Cukalit dhe ajo e Krujës. Territori i këtij Qarku është interpretuar, si një nga territoret me ndërtim gjeologjik, strukturor e tektonik mjaft të koklavitur. Në ndërtimin gjeologjik, veçohen një shumëllojshmëri e madhe shkëmbinjsh, me mosha të ndryshme formimi, duke

filluar nga ato më të vjetër Silurian-Devonian, e deri në depozitimet e formimet Kuaternare të sotme.

Kjo analizë ka për qëllim t'i sigurojë qeverisjes lokale e qendrore informacionin bazë gjeologjik, të pasurive minerale, të pasurive ujore, të rreziqeve gjeologjike, të aspekteve gjeomjedisore dhe të gjeomonumenteve, i cili do të ndihmojë për ndertimin e politikave me të qarta në drejtim të administrimit të territorit, të zhvillimit ekonomik dhe social të Qarkut. Ky informacion do të ndihmojë Qeverisjen lokale të ndertojë raporte më të drejta me komunitetin, biznesin dhe vizitorët e huaj në drejtim të orientimit të tyre në shfrytëzimin e potencialeve natyrore që ofron qarku i Korçës.

Në ndërtimin gjeologjik të Qarkut të Korçës, me një gjatësi prej 110km e gjerësi 60km, si dhe brenda saj, marrin pjesë të tre llojet shkëmbore, si sedimentarë, magmatikë ashtu dhe metamorfikë, të formuara në kohë e hapësira të ndryshme. Në kuadrin krahinor marrin pjesë, tre zona të ndryshme gjeologo-tektonike e facialo-strukturale, zona tektonike e Mirditës, Krasta-Cukalit dhe ajo e Krujës, të cilat janë pjesë përbërëse e gjeologjisë së Shqipërisë. Në kuadrin e zhvillimit dhe ndërtimit gjeologjik, pjesën më të madhe, gati 80% të sipërfaqes, të territorit të Qarkut të Korçës, e zë zona gjeologo-tektonike e facialo-strukturale e Mirditës, ku nga pikëpamja e zhvillimit gjeologjik, trashëgon të gjitha karakteristikat e saj. Ajo përfshin tërësisht rrethet e Pogradecit dhe Devollit, si dhe 2/3 e sipërfaqes së rretheve të Korçës dhe Kolonjës (pjesën P të tyre). Dy zonat e tjera përfshijnë vetëm rrethet e Korçës dhe Kolonjës duke u përhapur, në kufijtë P, JL e J të Qarkut. Këto zona kontaktojnë midis tyre, me kontakte tektonike mbihipëse e mbulesorë. Ky Qark është interpretuar, si një nga territoret me ndërtim gjeologjik, strukturor e tektonik mjaft të koklavitur.

Depozitimet e Pliocen-Pleistocenit të poshtëm - Në hartën gjeologjike, dallohen nga ngjyra e verdhë në bezhë. Janë formime tipike liqenore. Nga anarfolgjike, këto depozitime përfaqësojnë zona kodrinore. Nga pikëpamja e përbërje litologjike ato përfaqësohen nga ndërthurje pakosh konglomeratesh, kongloranorësh me çimentim shumë të dobët deri të shkriфт (zhuro zhavorore) me ndryshime faciale si në trashësi dhe në shtrirje me kalime në kongloranorë të shkriфт, si dhe nivele argjilash e suargjilash apo argjilorërash. Trashësia e këtyre depozitimeve arrin 40-50m.




Fig - 2 Depozitimet e Pleistocenit (Qp, Rajoni Korçë – Pogradec)

(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Depozitime aluviale të Pleistocenit (Qp) - Depozitimet aluviale përfaqësohen kryesisht nga tërecat akumulative dhe erozionalo-akumulative. Litologjikisht përbëhen nga zhavore, rrallë konglomeratë. Aluvionet kanë trashësi deri 7-8 m. Në fushën e Bilishtit, karakteristike janë 3-4 tëraca.

Depozitime proluviale-aluviale-të Pleistocenit (Qp) - Depozitimet aluviale-proluviale janë të lidhura me ekzistencën dhe veprimtarinë e rrjeteve hidrografike të shkurtër dhe me prurje të përkohëshme. Përfaqësohen nga ndërthurje e depozitimeve të vjetra aluviale, me ato proluviale dhe të konuseve të vjetër të derdhjeve dhe përbëhen nga përzierje kaotike të materialit rënor alevritor e zhavoror me material të imët argjilor.

Depozitime aluviale-proluviale liqenore të Pleistocenit (Qp) - Këto depozitime janë formuar në liqenë të brendshme, të cilët përshkoheshin nga lumenjtë, si dhe derdheshin përrenjt, duke formuar kështu formacionë liqenore të ndërthurura me ato aluviale dhe proluviale. Trashësia e këtyre depozitimeve, sipas të dhënave gjeofizike dhe shpimeve hidrogeologjike është në Korçë rreth 100m.




Fig. - 3 Harta Gjeologjike e rajonit Korçë, shk. 1:200,000 (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Depozitimet e fundit të shpateve (deluvione-koluvione) të Pleistocen-Holocenit (Qp-h)- Këto lloj depozitimesh takohen në fundin e shpateve (koluvionet) të Pleistocenit, takohen gjerësisht, përgjatë vargmaleve gëlqerorë, dhe në fundin e shpateve malore ofiolitike. Ato përfaqësohen nga brekçie shpatësh dhe formacionë të shkriфта, me trashësi relativisht të mëdha.

Depozitime proluviale të Pleistocen-Holocenit (Qp-h). Këto lloj depozitimesh lidhen me periudhat ndërakullnajore, me natyrën e përrenjëve të rrëmbyeshëm dhe të përkohshëm, të cilët kanë formuar konë të fuqishme të përbërë nga konglomeratë dhe zhavorë të pa diferencuar.

Depozitimet akullnajore të Pleistocen-Holocenit (Qp-h) - Këto depozitimeve akullnajore përfaqësohen nga morena fundore e ballore, të përbërë nga materiali i trashë copëzor, me shkallë të keqe përpunimi, rallë mesatare, të përzierë me material të imët ranoro-argjilor.

Depozitimet e aluviale të Holocenit (Qh)- Këto depozitime lidhen me formimet dhe depozitimet e të racave të ish shtratit të lumenjve, si dhe depozitimeve të sotme të shtratit të lumenjve Devoll e Dunavec, në rrjedhjet e mesme dhe të sipërme të tyre. Kanë përhapje të madhe në fushën e Korçës dhe Bilishtit.

Depozitimet eluviale, deluviale dhe koluviale të Holocenit (Qh)- Formimet koluviale, eluviale dhe deluviale, në mjaft raste i përkasin një diapazoni më të gjërë (së paku nga Pleistoceni i vonshëm deri më sot). Ato i takojmë pothuaj në të gjitha këmbët e shpateve të kodrave dhe maleve. Ato

janë formuar nga veprimi i agjentëve atmosferikë në formacionet shkëmbore relativisht të pa qëndrueshëm.

Depozitimet aluviale-kënetore të Holocenit (Qh)- Këto depozitime takohen kryesisht, në zonat fushore, që janë përshkuar dhe përshkohen nga lumi i Devollit apo Dunavecit, pra këto lloj depozitimesh i gjejmë mjaft të përhapura në Maliq të Korçës. Ato i takojnë kryesisht Holocenit të vonshëm, kur me sa duket, këto zona përmyteshin vazhdimisht nga lumenjtë, duke u kthyer kështu në kënetë. Litologjikisht këto depozitime përfaqësohen nga ndërthurje alevritesh, rërash të imta, llum argjilor me material më të trashë, zhure e zhavore.

Depozitimet kënetore dhe liqenore-kënetore të Holocenit (Qh)- Këto depozitime janë tipike në fushën e Maliqit të Korçës. Karakteristike e këtyre formacioneve është, prania në to e torfave dhe një materiali të bollshëm organik, si dhe ndërthurja e shtresave të argjilave, alevriteve, rërave e zhureve.

Shkëmbinjtë magmatikë - Në formacionin vullkanogjen mbizotërojnë bazaltet në formën e llavave jastëkore, rrymave llavore e më rrallë shkëmbinj piroklastikë. Përbërës të tjerë të formacionit vullkanogjeno sedimentar janë dhe silicorët radiolaritik e shistet argjilore-silicore, etj që zënë volum më të vogël.

Shkëmbinjtë metamorfikë₂(μJ) - Në këta shkëmbinj futen shkëmbinjtë metamorfikë subofiolitik dhe serpentinitet, si sequenca shkëmbinjsh sedimentarë të dinamometamorfizuar. Shtroja metamorfike subofiolitike takohet në pjesët periferike të brezit ofiolitik, në formën e një brezi të ngushtë, në zonën e kontaktit në buzën kontinentale. Këta shkëmbinj përfaqësohen nga amfibolitet, paragnejset, rreshpet amfibolitike, mika dhe shiste granitmbajtëse, shiste të gjelbra, ofiolite, rreshpe kuarcure dhe gëlqerorë të mermerizuar. Nga pikëpamja petrokimike kemi të bëjmë me bazalte, të cilat kanë përmbajtje të ulët silici, por përmbajnë të lartë titani dhe granate.

9.3. TEKTONIKA

Qarku i Korçës ndodhet në skajin JL të Shqipërisë (Albanideve). Albanidet i përkasin sistemit të rrudhosur alpin-mesdhetar. Në kuadrin krahinor marrin pjesë, tre zona të ndryshme gjeologjiko-tektonike e facialo- strukturale, të cilat janë pjesë përbërëse e gjeologjisë së Shqipërisë. Ato janë: 1-zona e Mirditës, 2-zona e Krasta-Cukalit dhe 3-zona e Krujës (Grup autoresh 1999; Aliaj 1987; Tagari etj. 1993). Përhapjen më të madhe e ka zona Mirdita, që karakterizohet nga një zhvillim i fuqishëm i magmatizmit ofiolitik, si dhe i sedimenteve të fuqishme terrigjene, që mbushin ultësirat ndërmallore të territorit të këtij Qarku, që janë ajo e Korçës, Devollit, Kolonjës dhe Pogradecit. Zona tektonike Mirdita, bën pjesë në zonat e brendshme tektonike të Albanideve. Në skajin JP, P e JL të territorit, janë gjerësisht të përhapura, depozitimet flishore terrigjenë e karbonatike të zonës të Krasta- Cukalit, Krujës. Këto dy zona, në të cilën mungojnë shkëmbinjtë magmatikë, bëjnë pjesë në zonat e jashtme tektonike të Albanideve. Ato paraqiten me formacione shkëmbore sedimentare, të moshave nga Kretaku në Eocen-Oligocen i

poshtëm. Në këtë sipërfaqe të këtij territori, dalin në pah një sërë rrudhash të rendeve të ndryshme. Në bërthamat e strukturave antiklinalë më shpesh takohen shkëmbinjtë e serisë karbonatike Triasiko-Jurasike, ndërsa bërthamat e strukturave sinklinalë janë ndërtuar nga depozitimet flishore e flihoodale.

Krahas këtyre prishjeve tektonike kryesore kemi dhe prishje të tjera të një rendi më të ulët, të cilat shoqërojnë thyerjet kryesore të mësipërme, të karakterit mbihipës po drejt P. Si rezultat i zhvillimit të fuqishëm të tektonikës regjionale mbulesore kemi zhytjen e njëra tjetrës (shoqëruar dhe me ngushtim apo pykëzim) të zonës tektonike Krasta Cukali nën zonën tektonike të Mirditës dhe zhytjen e zonës së Krujës nën zonën e Krasta Cukalit.

Lëvizjet neotektonike aktuale sot, kanë diferencuar relievin e sotëm. Prania e lëvizjeve neotektonike vihet re në ekzistencën e formimit të tarracave lumore të lumenjve, që takohen në këtë territor, në fund të grykave depërtuese të lumenjve. Dhe vetë ekzistenca, forma e grykave depërtuese flet për praninë e lëvizjeve neotektonike. Gjithashtu një shprehje e saj janë dhe lëkundjet e tërmeteve të rëna në vite. Zhvillimet e mëvonshme neotektonike të periudhës Plio-Kuaternare kanë ravijëzuar në vija të përgjithshme afërsisht konfiguracionin e sotëm gjeologjik. Me këtë fizionomi të relievit të sotëm gjeografik, që në shohim veprimtaria e rrjetit hidrografik dhe agjentëve atmosferik i kanë dhënë dorën e fundit kësaj paleogjeografie, duke lënë gjurmë të dukshme në ndërtimin gjeologjik të këtij Qarku.




Fig. – 5 Hartë e njësive tektono-struktureore rajonit korçë-Pogradec e më gjerë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

10. Kushtet gjeologo-inxhinierike

10.1. FORMACIONET LITOLOGJIKE, INKUADRIMI GJEOLOGJIK I TYRE

10.1.1. Vështrim i përgjithshëm

Në territorin e bashkisë Korçë, gjejnë përhapje shkëmbinj dhe dhera me litologji të ndryshme, të moshave nga Triasiku e deri në Kuaternar. Këto shkëmbinj dhe dhera i përkasin zonave tektoniko-faciale të "Mirditës", "Krasta-Cukalit" dhe Kruja. Kufijtë moshore litostratigra-fike, në hartat gjeologjike, shpesh janë të hedhura duke u mbështetur si në përbërjen litologjike, ashtu edhe në argumenta faunistike. Ato shpesh nuk përfaqësojnë domosdoshmerisht përbërjen litologjike të bazamenteve shkëmbore. Për këtë arsye, për qëllime gjeologo-inxhinierike, në kemi bërë një rivlerësim dhe rigrupim të kufijve moshore litostratigrafike, kriteri vlerësues i së cilit ka qënë evidentimi i përbërjeve litologjike me veti të përafërta gjeoteknike dhe sjellje afërsisht të njëjtë ndaj strukturave inxhinierike. Në territorin e bashkisë, në sipërfaqe shfaqen shkëmbinj rrënjësorë si dhe dhera të Kuaternarit të tipit mbulesor. Dherat e Kuaternarit, në fushëpërhapjen e tyre, kanë trashësi të tillë që nuk mund të neglizhohen gjatë kryerjes së ndërtimeve. Sipas Konomi, N. (2001, 2002), është adoptuar klasifikimi gjeologo-litologo-inxhinierik i shkëmbinjve dhe dherave. Në këtë klasifikim shkëmbinjtë ndahen në tre grupe:

- 1- Shkëmbinj të fortë
- 2- Shkëmbinj mesatare
- 3- Shkëmbinj të butë

Kriteri i ndarjes së tyre është rezistenca në shtypje një boshtore (Rsh), e cila për shkëmbinjtë e fortë ka vlera me të mëdha se 500 bar (ose kg/cm^2), për shkëmbinjtë mesatare 50-500 bar dhe për shkëmbinjtë e butë < 50 bar.

10.1.2. Kushtet gjeologo - inxhinierike të trojeve të ndërtimit

Për vlerësimin e kushteve gjeologo-inxhinierike të trojeve të ndërtimit, rolin kryesor e luajnë vetitë fiziko mekanike (ose gjeoteknike) të tyre. Gjithashtu rol të madh ka edhe pozicioni i gjeografik dhe gjeomorfologjik i tyre. Për këtë arsye për trojet e ndërtimit të bashkisë Korçë do të trajtohen dy çështje:

- A- Kushtet gjeomorfologjike
- B- Vetite fiziko- mekanike (gjeoteknike)




Fig. – 1 Harta gjeologjiko-inxhinierike Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Kushtet gjeomorfologjike

Territori i bashkisë Korçë shtrihet në një hapësirë me kontraste të mëdha përsa i përket morfologjisë së relievit. Ai fillon që nga male të larta, veri, në lindje, perëndim, jug e deri në bregun e liqenit të Ohrit, Prespave dhe luginën e lumenjve Shkumbin, Devoll, Osum apo degë të lumit Vjosa. Brenda këtij territori gjenden zona fushore të sheshta, ose gati të sheshta, pllaja, shpate kodrash të buta deri mesatare, shpate malore të pjerreta deri të thikëta, shpate të luginave lumore të formave të ndryshme, deri në kanione, si dhe liqenet artificiali si ai i Gjançit etj. Për lehtësi vlerësimi të gjithë territorin e bashkisë e kemi ndarë në 3 njësi kryesore morfologjike:

- 1-Njësia morfologjike fushore
- 2-Njësia morfologjike kodrinore
- 3-Njësia morfologjike malore

Njësia morfologjike fushore (janë trajtuar si gropa të brendshme) ze një pjesë të konsiderueshme të territorit. Ajo në vetvete ndahet në një nën njësi:

Nënnjësia fushore Devoll-Korçë-Maliq, ka përhapje në fushëgropën e Korçës dhe pikërisht fushat Devollit, Korçës dhe Maliqit. Janë fusha të sheshta me kuota nga 813,0 m mbi nivelin e detit (m.n.d.) në veri të Maliqit deri në 950 m.n.d në pjesët jugore. Fushëgropa e Korçës ka formë të përzgatur që ngushtohet në jug e zgjerohet në veri. Copëtimi horizontal i relievit merr vlera të vogla nga 0.1-0.5km/km² në 3km/km². Vlerat më të larta takohen në rrethina, lidhen me përbërjen e depozitimevetë shkripta (shpatore) si dhe përrenjtë që vijnë nga malet e kësaj rrethine. Energjia e relievit merr vlera të vogla nga 0.0m/km² arrin deri në 50m/km² në rrethina. Këto vlera dëshmojnë për një proces akumulimi në këtë fushëgropë. Aktualisht janë zona me përparësi të zhvillimit bujqësor, agrokultural, blektoral. Hidrografia është e pasur me ujra nëntokësore dhe të tipit artezian. Përgjatë fushës së Devollit dhe në pjesa veriore e fushës së Korçës përshkohen nga lumi i Devollit. Nga jugu në veri fushën e Korçës e përshkon lumi i Dunavecit. Përshkohen nga një sistem i dëndur kanalizimesh që përdoren për kultivim të kulturave bujqësore.

Njesia morfologjike kodrinore zhvillohet në rrethinat e fushëgropave dhe rrethina të territorit të bashkisë. Menjëherë sapo përfundon njësia fushore (fushëgropave) shfaqen format e kodrave të cilat kanë kuota nga 900 m.n.d. deri në 1200 m.n.d. Në vartësi të strukturave gjeologjike, ku ato gjenden, shfaqen edhe forma relievi tipike, si p.sh. relievet kodrinore të strukturave monoklinale dhe relievet kodrinore të strukturave të rrudhosura. Rajon tipik ku shfaqen format morfologjike të strukturave monoklinale, është brezi i kodrave nga Floqi, në Boboshticë, në Drenovë, në Plasë, e deri në Cangonj në perëndim të Vargmalit të Moravës. Forma të tilla shfaqen dhe në perëndim nga Pulaha, Polena, Dërsniku, Voskopi e deri në Pocestë. Në këtë brez të kodrave shfaqen forma morfologjike të dhembëzuara, ose kuestet, për shkak të prezencës në to të pakove litologjike me fortësi të ndryshme dhe për pasojë proceset e erozionit mbi to ndikojnë në shkallë të ndryshme. Shpatet e kodrave e kodrinave të kësaj njësie morfologjike, kanë pjerrësi nga 5 deri në 35⁰ dhe drejtime rënie të ndryshueshme. Shpatet shpesh janë të rumbullakosur nga modelimi i shkaktuar nga rrjedhjet ujore sipërfaqesore. Në vitet '70 deri '80 të shekullit të kaluar, ky sistem kodrash ju nënshtrua procesit të tarracimit, proces i cili i ka hequr pamjen natyrale të tyre. Në të shumtën e rasteve këto kodra janë të mbjella me pemë frutore, por nuk përjashtohen rastet edhe kur ato përmbajnë pyjet natyrale. Është pikërisht kjo njësi morfologjike e prekur së tepërmi nga erozioni dhe fenomene shpati të tipit rrëshqitjessë dherave dhe të shkëmbinjve. Në lidhje me ndërtimet, kjo njësi morfologjike është tepër e lakmueshme, sepse ato janë ballkone natyrore me pamje piktoreske në drejtim të fushave dhe qendarve kryesore të bashkisë.

Njësia morfologjike malore ze pjesën verilindore, lindore, juglindore, jugperendimore, të territorit të bashkisë. Ajo fillon me shpatet malore të Malit të Thatë vargmalit të Moravës, malit të Ostrovicës, malit të Zi, Rungajës, malit të Omit etj. Kuotat e kësaj njësie variojnë nga 1000 deri

në 2000 m.n.d., ecila gjendet në malin e Kuq dhe që përfaqëson kuotën më të lartë të bashkisë Korçës. Format morfologjike të kësaj njësie varen shumë nga përbërja litologjike e shkëmbinjve rrënjësore dhe në përgjithësi janë të dy llojeve: forma morfologjike të përcaktuara nga shkëputjet tektonike dhe format morfologjike karstike. Format karstike të relievit shfaqen, në fushëpërhapjen e shkëmbinjve gëlqerore në Lavdar-Voskopojë, Makerz-Rugajë. Shfaqen të gjithë tipet morfologjike karstike, duke filluar që nga gropat karstike, hinkat karstike, puset karstike, fushat karstike, luginat karstike, shpellat karstike etj. Kurse format morfologjike të përcaktuara nga shkëputjet tektonike janë kudo prezente. Në vartësi të numrit të tektonikave të njëpasnjëshme dallohen forma të ndryshme të relievit. Në rastet kur tektonikat janë të vetme shfaqen përargjet tektonikës me lartësi shkëputje të shkallëve deri në disa qindra metra (mali Kuq). Në rastet kur tektonikat janë të njëpasnjëshme, atëhere shfaqen forma morfologjike e shkallëve tektonike (Makërz-Rungajë etj.). Në këtë njësi morfologjike shpatet kanë pjerrësi nga 20^0 deri në vertikale. Në këto shpate shfaqen më së shumti fenomeni i rrëzimeve, por edhe ai i rrëshqitjeve shkëmbore. Shpatet përshkohen nga përrenj e perroska, të cilat në përgjithësi kanë karakter sezonal, drejtimi i lëvizjes së ujrave në to është kryq shtrirjes së shpateve. Janë pikërisht këta përrenj e prroska të cilët bëjnë modelimet e shpateve ku kalojnë, duke i errodur ata dhe shpesh duke i rrumbullakosur dhe për pasojë, duke u ndrruar edhe drejtimet e rënies së shpateve. Në përgjithësi kjo njësi morfologjike është e pyllëzuar dhe pjesa më e madhe e saj edhe zonë e mbrojtur në të cilën nuk lejohen ndërtimet.

Vetitë fiziko - mekanike (gjeoteknike)

Të dhënat gjeoteknike janë nxjerrë nga literatura e studimeve gjeologo-inxhinierike të realizuara në territorin e bashkisë Korçë. Sikurse është thënë në kapitullin e inkuadrimit gjeologjik të formacioneve litologjike, në territorin e bashkisë shfaqen 5 tipe të ndryshme litologjike:

- Shkëmbinj të fortë;
- Shkëmbinj mesatar;
- Shkëmbinj të dobët;
- Dhera pa kohezion;
- Dhera me kohezion.

Shkëmbinjte e fortë kanë rezistencë në shtypje $> 500 \text{ kg/cm}^2$. Këta shkëmbinj, në shumë raste janë të shkatëruar nga fenomenet e ndrydhjeve tektonike dhe paraqiten me shumë çarje. Në këtë grup bëjnë pjesë:

Gëlqerorët (G): Janë shkëmbinj kompakte masive deri pllakore. Në ta është prezent fenomeni i karstëzimit, kryesisht është i përhapur karsti i çarjeve i drejtimit vertikal dhe të kombinuar me fenomenin e mbushjeve të tyre me material kryesisht çimento karbonatike që vjen nga tretja

kimike e gëlqerorëve dhe me pak material argjiloro-humusor që vjen nga shpatet duke lëvizur nën veprimin e ujrave rrjedhës sipërfaqësor e nëntokësore. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

- Pesha volumore $\Delta = 2,4 - 2,7 \text{ gr/cm}^3$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh 500 - 1100 kg/cm²
- Moduli i elasticitetit $E = 10^5 - 3 \times 10^5 \text{ bar}$

Gëlqerorët silicore (Gsi): Edhe këta, si gëlqerorët, janë shkëmbinj kompakte, kryesisht pllakore, por nuk mungojnë rastet kur kemi ndërthurje të shtresave gëlqerore me ato silicore, ose kur shkëmbinjtë me pamje silicore shfaqen brenda gëlqerorëve në formë të linxave. Në këta shkëmbinj, në përgjithësi nuk gjen përhapje fenomeni i karstëzimit. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

- Pesha volumore $\Delta = 2,6 - 2,75 \text{ gr/cm}^3$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh 500 - 1100 kg/cm²
- Moduli i elasticitetit $E = 10^5 - 3 \times 10^5 \text{ bar}$

Shkëmbinjtë metamorfike rreshpore (Rm): Janë shkëmbinj të përbërjeve litologjike të larmishme. Brenda tyre ekzistojnë shkëmbinj shumë të fortë dhe të fortë, por që shpesh të coptuar dhe të ndrydhur tektonikisht. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

- Pesha volumore $\Delta = 2,3 - 2,6 \text{ gr/cm}^3$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh 500 - 700 kg/cm²
- Moduli i elasticitetit $E = 10^5 - 5 \times 10^5 \text{ bar}$

Shkëmbinjtë mesatare kanë rezistence në shtypje 50-500 kg/cm². Mund të jenë masive ose kombinime shtresash me veti gjeoteknike krejt të ndryshme. Për këtë arsye vetite e tyre janë jo stabile dhe të ndryshueshme në sipërfaqe edhe në distanca shume të vogla. Njëkëtë grup bëjnë pjesë:

Shkëmbinjtë efuzive sedimentare (Es). Formacioni vullkanogjeno -sedimentar i përket ofioliteve të Triasikut të mesëm-Jurasikut të poshtëm ($\beta T_2 - J_1$), është i ndërlikuar për shkak të tektonikës. Përbehet nga bazaltet, radiolarite si dhe shiste argjilo-silicore. Kontaktojnë tektonikisht me shkëmbinjtë ofiolitikë. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

- Pesha volumore $\Delta = 2,2 - 2,6 \text{ gr/cm}^3$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh 50 - 500 kg/cm²
- Moduli i elasticitetit $E = 10^3 - 10^4 \text{ bar}$

Shkëmbinjtë flishore dhe me pamje flishore (Fl): Në fushëpërhapjen e tyre kemi kombinime të shtresave argjilore, ranore, alevrolitore e mergelore dhe më rrallë edhe gëlqerorë dhe qymyre, të cilat kanë trashësi nga disa cm deri në dhjetra cm. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

- Pesha volumore $\Delta = 2,3 - 2,6 \text{ gr/cm}^3$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh 100 - 500 kg/cm^2
- Moduli i elasticitetit $E = 10^4 - 10^5 \text{ bar}$

Mollasat argjilore (Ma): Janë shkëmbinj argjilorë me veti plastike, të cilat në shumë raste ndërthuren edhe me shkëmbinj alevrolitore e shtresa qymyri. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

- Pesha volumore $\Delta = 1,8 - 2,0 \text{ gr/cm}^3$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh 50 - 100 kg/cm^2
- Moduli i elasticitetit $E = 10^3 - 5 \times 10^3 \text{ bar}$

Mollasat ranoro konglomeratike (Mrk): Janë shkëmbinj me predominim të fraksionit ranorik e më pak të atij konglomeratik, me shkallë çimentimi të ndryshueshme. Është pikërisht kjo shkallë çimentimi e cila përcakton edhe vetite gjeoteknike të këtyre shkëmbinjve. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

- Pesha volumore $\Delta = 2,2 - 2,5 \text{ gr/cm}^3$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh 50 - 500 kg/cm^2
- Moduli i elasticitetit $E = 10^3 - 10^4 \text{ bar}$

Shkëmbinjtë e dobët kanë rezistence në shtypje $<50 \text{ kg/cm}^2$. Janë depozitime copëzore të pa diagjenizuara, ose me shkallë diagjenizimi të ulët. Njëkëtë grup bëjnë pjesë:

Depozitime të vjetra Kuaternare të pa diagjenizuara (De): Janë shkëmbinj me vendosje hapësinore dhe përberje granulometrike kaotike. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

- Pesha volumore $\Delta = 1,7 - 1,9 \text{ gr/cm}^3$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh $<50 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i elasticitetit $E = 100 - 10^3 \text{ bar}$

Dherat pa kohezion (c=0). Karakterizohen nga mungesa e lidhjeve kohezionale midis coprave përbërës të tyre, duke i dhënë pamjen e shtresave të përbëra nga copra të palidhur me njëra -tjetrën. Ndahen në bazë të madhësisë së coprave përbërëse.

Zhavorre e popla me origjinë aluviale dhe proluviale (P): Kanë veti të larta filtruese duke formuar pellgje të fuqishme të ujrave nëntokësore. Madhësia e coprave të tyre është tepër heterogjene. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

- Pesha volumore në gjendje natyrale $\Delta = 1,6 - 2,1 \text{ gr/cm}^3$
- Këndi i fërkimit të brendshëm $\phi = 28 - 42^\circ$
- Kohezioni $c = 0.0 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i deformacionit $E = 150 - 250 \text{ kg/cm}^2$

Dherat me kohezion

Suargjila të vendosura mbi zhavorre (Szh): Janë dhera të përbërjeve nga surëra deri tek suargjilat, të cilat mund të jenë edhe pluhurore, të cilat kanë veti plastike të ndryshueshme. Preken shumë nga prezenca e ujrave rrjedhës sipërfaqësore dhe nëntokësore, të cilët në njëfarë mase determinojnë edhe vetitë gjeoteknike të tyre. Në përgjithësi këto dhera gjenden në pjesën e sipërme të prerjes së dherave të Kuaternarit me origjinë aluviale dhe deluviale. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

- Pesha volumore në gjendje natyrale $\Delta = 1,75 - 1,95 \text{ gr/cm}^3$
- Këndi i fërkimit të brendshëm $\phi = 12 - 22^\circ$
- Kohezioni $c = 0.15 - 0,35 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i deformacionit $E = 50 - 200 \text{ kg/cm}^2$

10.2. ZONIMI I TERRITORIT MBI BAZËN E KUSHTEVE GJEOLOGO-

INXHINIERIKE

Për kryerjen e zonimit të territorit të bashkisë Korçë, është patur parasysh që në përputhje me shkallën e hartës, të jepen të dhëna të trojeve të ndryshme dhe përshtatshmërisë së tyre ndaj ndërtimeve që kryhen mbi to, nëpërmjet vetive të tyre gjeoteknike, si dhe të dhëna për ekspozimin e këtyre trojeve ndaj elementeve të rrezikut gjeologjik. Pra bëhet një kombinim i të dhënave që disponohen për territorin, duke e ndarë atë në zona, nënzona dhe sektore, të cilët në vetvete kanë kushte të përafërta gjeologo-inxhinierike dhe që janë të ekspozuar ndaj rrezikut gjeologjik në shkallë të caktuar. Për ndërtimin e hartës së zonimit të territorit për përshtatshmërinë ndërtuese që kanë trojet në të, janë marrë në konsideratë 3 kritere (Konomi, N. (2015):

- Kriteri litologo-gjeologo-inxhinierik
- Kriteri i ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik
- Kriteri morfologjik




Fig. – 2 Harta e zonimit për përshtatshmërinë ndërtuese të trojeve, Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Kriteri litologo-gjeologjiko-inxhinierik ka qenë kriter bazë mbi të cilin është ndarë territori në zona që karakterizohen nga një farë shkalle homogjeniteti i kushteve ndërtuese të trojeve që gjenden në to. Me këtë kihen parasysh kryesisht vetitë fiziko- mekanike (granulometria, peshat specifike, volumore dhe skeletit, poroziteti, rezistenca, koeficientët e deformimit, përjajrimi, çarshmëria, etj), vetitë ujore (ujëmbajtja, ujëdhënia, përshkueshmëria, konsistenca, etj) dhe shkalla e ndryshimeve që ndodhin në trojet e ndërtimit nga prezenca e ujrave. Duke u bazuar në këtë kriter, territori ndahet në 5 zona:

1. Zona e përhapjes së shkëmbinjve të fortë, në hartë paraqitet me vija horizontale.
2. Zona e përhapjes së shkëmbinjve mesatare, në hartë paraqitet me vija vertikale.
3. Zona e përhapjes së shkëmbinjve të dobët, në hartë paraqitet me kombinim të vijave horizontale dhe atyre vertikale.
4. Zona e përhapjes së dherave pa kohezion, në hartë paraqitet me vija të pjerrëta majtas.
5. Zona e përhapjes së dherave me kohezion, në hartë paraqitet me vija të pjerrëta djathtas.

Kriteri i ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik mund të jetë i lidhur me kriterin morfologjik, dhe lidhja e tyre është organike dhe e pandashme, ose mund të mos jetë i lidhur me të.


11. Veprimtaritë sizmike dhe veçoritë e tërmeteve

11.1. TEKTONIKA

Nga pikëpamja tektonike kemi të bëjmë me zonë tektono-strukturore Gropa e Korçë. Rajoni në studim preket nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputjet tektonike janë shumë aktive, dhe në relief shprehen me kontraste të theksuara. Pasojë e tyre janë dhe lëvizjet e shpeshta sizmike, që trondisin zonën. Si pjesë përbërëse e një strukture neogenike në zhvillim, zona në studim preket nga forcat tektonike orogjenike dhe sidomos nga ato neotektonike. Epiqendrat e tërmeteve përqëndrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive. Përcaktimi i zonave sizmogjene ose zonave të burimeve sizmike, siç quhen ndryshe, përbën hapin e parë fundamental në analizën probabiliste të rrezikut tërmetor. Zonat e burimeve sizmike paraqesin terrene me tipare të perbashkëta sizmologjike dhe neotektonike; kjo nënkupton që sizmiciteti në një zonë të burimeve sizmike të jetë uniformisht i shpërndarë në të gjithë zonën dhe tërmetet e ardhshëm mund të ndodhin kudo në zonë. Kështu, zonat e burimeve sizmike përcaktohen nga dy instrumenta fundamentalë: nga profili i sizmicitetit dhe nga regjimi tektonik i sotëm i rajonit në shqyrtim.

Fig. – 1 Harta e zonave sizmogjene me potencial sizmik të pritsëm (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Nga studimet e kryera këto 20 vitet e fundit janë përcaktuar 4 modele sizmotektonike, ndër të cilët modeli sizmotektonik nga Sulstarova, Aliaj e Muço (2005b) i përfaqësuar me 9 zona të burimeve sizmike është pranuar bazë për llogaritjen e rrezikut sizmik të Shqipërisë që paraqitet në këtë studim. Nga konsideratat e regjimit tektonik të sotëm dhe të dhënat e katalogut të tërmeteve (Sulstarova etj., 2005a), sizmiciteti rajonal është ndarë në 9 zona të burimeve sizmike (Sulstarova etj., 2005b), që përfshijnë njëfarë ripërcaktim të 8 zonave të trajtuara për Shqipërinë (Aliaj, 2003) së toku me një zonë që modelon tërmetet në rajonin e Shkupit (Talaganov etj., 2003), si dhe në modelin sizmotektonik të vitit 2004 (Aliaj etj., 2004), të cilat janë:




1. Zona Lezhë-Ulqin (LU) me $M_{max}=7.2$;
2. Zona e Ultësirës Pranadriatike (PL) me $M_{max}=7.0$;
3. Zona e Bregdetit Jonian (IC) me $M_{max}=7.0$;
4. Zona Korçë-Ohër (KO) me $M_{max}=6.9$;
5. Zona Elbasan-Dibër-Tetovë (EDT) me $M_{max}=6.9$;

Fig. – 2 Harta Neo-Tektonike e Shqipërisë

(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

6. Zona Kukës-Peshkopi (KP) me $M_{max}=6.5$;
7. Zona Shkodër-Tropojë (ST) me $M_{max}=6.5$;
8. Zona Pejë-Prizren (PP) me $M_{max}=6.8$;
9. Zona e Shkupit (SK) me $M_{max}=6.5$.



Vlerësimet e magnitudës më të lartë janë bërë për çdo zonë të burimeve tërmetore, duke marrë në konsideratë tërmetin më të madh të vërtetuar në zonën në shqyrtim, madhësinë e tërmeteve të ndodhur në brezat sizmike përkatës, dhe logjikën tektonike të ndodhjes së tërmeteve të mëdhej. Vlerësimet më të mira të M_{max} janë bërë duke marrë në konsideratë tërmetet më të mëdhej të njohur në mjedise tektonike të ngjashme. Vatrast e tërmeteve të Shqipërisë përqëndrohen kryesisht përgjatë shkëputjeve aktive, të cilat janë 3 zona shkëputje aktive gjatësore dhe 2 tërthore si më poshtë: Shkëputje me mbihijje joniane-adriatike, me shtrirje në drejtim VP-VVP;

- Zona e shkëputjes graben Shkodër-Mat-Librazhd (drejtimi VP);
- Zona e shkëputjes graben Peshkopi-Korçë (drejtimi VJ);
- Zona e shkëputjes normale Shkodër- Tropojë (drejtimi VL);
- Zona e shkëputjes normale Elbasan-Dibër (drejtimi VL).





Fig. –3 Harta sizmiologjike e rajonit (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Karakteristikat sizmotektonike të zonës

Një lidhje e ngushtë ekziston midis tërmeteve dhe shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive, që herë pas here gjenerojnë tërmete. Analizës dhe sintezës sizmotektonike të vendit tonë u është kushtuar vëmendje e veçantë (Aliaj,1979; 1988; Aliaj & Sulstarova,1994; Sulstarova et al.,1980).

Fig. - 4 Harta aktive e shkëputjeve në Shqipëri (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)



Lidhja e ngushtë midis tërmeteve dhe zonave të shkëputjeve aktive është evidentuar për secilën prej këtyre të fundit, duke përcaktuar edhe potencialin sizmik maksimal të pritshëm, bazuar në të dhënat e deri sotme për sizmicitetin (Aliaj, 1988). Sinteza sizmotektonike ka evidentuar në Shqipëri tre zona sizmogjene

gjatësore dhe tre zona sizmogjene tërthore, (shih hartën përkatëse). Kjo hartë (Fig. e mëposhtme) përfaqëson intensitetet e pritshme për kushtet e tokës mesatare për 100 vitet e ardhshme, me një normë probabilitet 70%. Në bazë të përpunimit statistikor për të gjitha të dhënat e tërmeteve të ndodhur në vendin tonë, duke marrë për truall mesatar shkëmbinj të shkrifët si ranor, argjila e suargjila, siç ndodhen në këtë zonë studimi, mendojmë se kemi të bëjmë me intesitet tërmetesh të paktën deri në 8,5-9 ballë ose me magnitudë 6,0-6,5. Drejtime kryesore të punës duhet të jenë dhe përcaktimi i:

- Dukurive të lëngëzimit të rërave të vrojuara nga tërmetet e së kaluarës;
- Tërmeteve maksimal të mundshëm;
- Vetive fiziko mekanike të rërave.




Fig. - 5 Harta e shpejtiveve maksimale referencë në truall të fortë (tipi A sipas EN 1998), për periudhë rikthimi 475 vjet (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Veçori këtu është se sektorë të ndryshëm kërkojnë masa dhe kushte gjeoteknike të ndryshme. Nisur nga kërkesat e kohës, janë ndërtuar edhe harta të shpejtiveve maksimale referencë të trojeve. E tillë është edhe harta e paraqitur me poshtë, e përpiluar në vitin 2003 në kuadër të projektit “Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri” – PNUD. Sipas kësaj hartë, shpejtimi maksimal referencë në truall të fortë për periudhë rikthimi 475 vjet për zonën Shirokë është 0.275g. Harta të reja sizmike, që plotësojnë kërkesat e Eurokodit 8 (EN1998, “Projektimi i strukturave për rezistencë ndaj tërmetit”) pritet të jenë në të ardhmen e afërt pjesë e praktikës së

projektimit në Shqipëri. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, ka paraqitur në botimin “Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri” – 2010 një studim të detajuar mbi vlerësimin e rrezikut sizmik. Përveç hartave të shpejtiveve referencë në truall shkëmbor, studimi i lartpërmendur paraqet të dhëna mbi rrezikun sizmik, të shprehur në terma të shpejtiveve maksimale (PGA) si dhe si vlera spektrale për periode 0.1, 0.5, 1.0 dhe 2.0 sekonda (shih hartën)

11.2 AKTIVITETI SIZMIK

Të dhënat historike për aktivitetin sizmik, janë relativisht të mangëta. Rajoni është prekur nga tërmete historike me intensitet deri në 8 ballë (MSK-64) dhe gjatë shekullit të kaluar, nga tërmete me magnitudë 5.3 deri 5.6. Nisur nga kërkesat e kohës, janë ndertuar edhe harta të shpejtimit të referencës maksimale të trojeve. E tillë është edhe harta e paraqitur më poshtë, e përpiluar në vitin 2003 në kuadër të projektit “Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri” – PNUD. Sipas kësaj




Fig. – 6 Harta e shpejtimit të referencës maksimale në truall shkëmbor, për periudhë përsëritje 475 vjet, sipas botimit “Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri” – 2010 (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

harte, shpejtimi maksimal referencë në truall të fortë për periudhë rikthimi 475 vjet për Qarkun Korçë është 0.25g. Harta e reja sizmike, që plotësojnë kërkesat e Eurokodit 8 (EN 1998, “Projektimi i strukturave për rezistencë ndaj tërmetit”) pritet të jenë në të ardhmen e afert pjesë e praktikës së projektimit në Shqipëri. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, ka paraqitur në botimin “Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri” – 2010 një studim të detajuar mbi vlerësimin e rrezikut sizmik. Përveç hartave të shpejtimit të referencës maksimale në truall shkëmbor, studimi i lartpërmendur paraqet në formë tabelare të dhëna mbi rrezikun sizmik për 370 komuna e bashki të Republikës së Shqipërisë, të shprehur në terma të shpejtimit të referencës maksimale (PGA) si dhe si vlera spektrale për periudha 0.1, 0.5, 1.0 dhe 2.0 sekonda.




Fig. - 7 Harta e shpejtimit të referencës maksimale në truall shkëmbor, për periudhë përsëritje 475 vjet, sipas botimit “Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri” – 2010

(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Per Qarkun Korçë, është ndertuar spektri elastik për truall të forte (tipi A) sipas Eurokodit 8, për shpejtim reference të truallit $agR=0.267g$. Gjithashtu, me vlerat spektrale të propozuara në botimin e Akademise së Shkencave është ndertuar spektri i rrezikut sizmik. Këta dy spektra të shpejtimeve paraqiten në figuren vijuese në të njëjtat boshte periode (sekonda) – shpejtim (g). Nisur nga aktiviteti sizmik historik, ndërtimi gjeologjik si dhe nga studimet e lartpermendura, mund të thuhet se rajoni ndodhet në një zonë aktive nga pikëpamja sizmike.




Fig. - 8 Harta e intensiteteve sizmike sipas MSK 1964(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)




Fig. - 9 Spektrat e shpejtimeve (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Risku sizmik për rajonin

Referuar rrezikut sizmik (që është i konsiderueshëm), vulnerabilitetit të veprave të ndërtimit ekzistuese (që është relativisht i ulët) si dhe shkallës së ekspozimit të këtyre veprave ndaj rreziqeve sizmike (që është e ulët, nisur nga dendësia e popullsisë së komunës), mund të thuhet paraprakisht se risku sizmik nuk është i lartë. Megjithatë, shkalla e ekspozimit të strukturave ndaj rreziqeve sizmike ka ardhur duke u rritur, sidomos pas viteve '90 me rritjen e intensitetit të ndërtimeve në zona të. Sipas hartës së mëposhtme të rajonizimit sizmik të përpiluar në fund të viteve '70, rajoni përfshihet në një zonë ku mund të priten tërmete me intensitet $I_0=7-8$ ballë (sipas MSK-64) për kushte mesatare trualli.




Fig. - 10 Harta e Intesiteteve maksimale të vrojtuar për periudhën 1800-2005
(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)




Fig. - 11 Risku sizmik për rajonin Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

12. Aspektet Gjeomjedisore

12.1. Ndikimet mjedisore të Industrisë Minerare

Bashkia e Korçës, e përbërë nga 8 njësi administrative, (Qyteti i Korçës, Qëndër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë), disponon një gamë mineralesh si: krom, bakër, qymyre, argjila, gurë dekorativ, gëlqeror, gëlqeror pllakor, inerte lumi etj, shfrytëzimi i të cilave, krahas rëndësisë ekonomike sjell edhe impakte negative në ndotjen e mjedisit. Përveç shfrytëzimit të këtyre mineraleve me punime nëntokësore apo në qiell të hapur, (me karriera), burime ndotjesh janë edhe stoqet e mineraleve përkatëse apo të sterileve të tyre, si fabrikat e pasurimit të mineraleve, me dampat e tyre përkatëse, (sidomos të bakrit), për vet përbërjen e tyre lëndore (kimizmin), granulometrinë e imët të tyre, (0,074mm), sasinë e madhe të materialit të tyre si dhe mos mbajtjen nën kontroll rigoroz, paraqesin një rrezik potencial për mjedisin. Jonet e metaleve të rëndë që vazhdimisht kalojnë në tretje, sjellin rrisqe serioze në bimësinë dhe gjallesat që jetojnë në ambiente tokësore dhe ujore të ndotura nga këto jone.

12.2. Minierat e mbyllura dhe stoqet e tyre të sterileve dhe të mineraleve

Në Bashkinë e Korçës, përpara dhe gjatë viteve '90, industria minerare ka qënë ndër degët e zhvilluara, e cila krahas zhvillimit ekonomik, ka sjellë rrisqe negative mjedisore, si në toka, në

ujëra dhe në ajër. Aktiviteti minerar kalon në tre stade: ndërtimi i minierës; nxjerrja e mineralit; mbyllja e minierës, ku pothuajse në të gjithë rajonin faza e mbylljes së minierave nuk është realizuar në mënyrë të plotë. Kryerja e këtyre punimeve të shfrytëzimit, si me miniera ashtu edhe me karriera, me stoqet e tyre, sjellin rrisqe të theksuara negative në ekosistemet natyrore ku ato veprojnë, duke krijuar mjaft probleme në ndotjen e ambientit dhe në prishjen e ekuilibrave ekologjike të mjedisit. Gjatë kësaj periudhe janë krijuar mjaft stoqe minerale, sterile si dhe mbetjesh teknologjike, të cilat duke qënë në qiell të hapur dhe në relieve kodrinore, kanë dhënë mjaft efekte negative në sektorët përreth, deri edhe me pasoja për njerëzit, florën dhe faunën e rajonit, sidomos minierat e bakrit. Konkretisht për këtë Bashki probleme gjeomjedisore sjellin kryesisht minierat dhe karrierat e bakrit, të kromit, karrierat për materiale ndërtimore, inertet lumore etj, (me stoqet e sterileve të tyre) si në: Kanisqel, Dushku i trashë, Voskopojë, Lozhan, Drenovë etj. Këto me tretësirat që krijojnë nëpërmes agjentëve atmosferik, sjellin pasoja në ekosisteme, dhe bëhet shumë pak për rehabilitimin e ambienteve të ndotura. Ka damba që janë rehabilituar dhe mbuluar me bimësi spontane. Nga aktiviteti minerar i minierave të mbyllura, i atyre aktuale si dhe i karriera, (shfrytëzimi me punime sipërfaqësore), janë shkaktuar dhe shkaktohen transformime gjeomekanike dhe ndotje të tokave si nga:

- Gërmimet sipërfaqësore;
- Shembjet, rrëshqitjet, vidhisjet;
- depozitimet (stoqet) e mëdha të sterileve, (shpesh edhe të mineraleve përkatëse), në afërsi të vendburimit, të transportuara nëpër përrenj, lumenj dhe liqene si dhe në tokat përreth, duke ndikuar kështu në strukturën e tokave dhe në përbërjen e tyre litologjike, dëmtim të kullotave dhe të bimësisë, dalje të hinkave në sipërfaqe nga shembja e punimeve nëntokësore dhe dëmtime shtëpishë.

Stoqet e sterileve të mineralizimeve të bakrit përmbajnë copra minerali sulfur si dhe vet rreshpet dhe bazaltet përmbajnë pikëzime sulfuresh. Në kushtet e agjentëve atmosferik si lagështia e oksigjeni, ndodhë procesi i oksidimit dhe elementet e çliruar shpërndahen nga rrjedhjet ujore sipërfaqësore si dhe me ane të vaditjes, në tokat poshtë minierës, duke shkaktuar ndotje të tyre, ku ndikojnë edhe ndotjet që vijnë nga pluhurat që ngrihen nga dherat e karriera dhe stoqeve të sterileve, si pasojë e të cilave rrjedh degradimi i florës dhe faunës së këtyre zonave. Përveç kësaj nga pusët e shfrytëzimit, grykat e galerive, gropat e karriera (shfrytëzimi sipërfaqësor), ngashembjet dhe rrëshqitjet e krijuara, rrezikohet jeta e njerëzve dhe e kafshëve.

12.3. Ndotja e ujërave

Në ndotjen e ujërave sipërfaqësore, rol luajnë edhe shkarkimet e lëngëta urbane, industriale dhe bujqësore, që janë dukuri të cilat në mënyrë progresive ndikojnë në uljen e cilësisë së ujërave të lumenjëve, të liqeneve dhe të mjedisit në përgjithësi. Shkarkimet e lëngëta urbane, që përmbajnë

lëndë organike, komponime të tretëshme të fosforit dhe të azotit, (të cilat favorizojnë procesin e eutrofikimit), bakterie dhe viruse patogjene, metale të rëndë si dhe lëndë që prishin pamjen e ujërave dhe u japin atyre erë të keqe. Cilësia e rënduar e ujrave, është një kërcënim si për shëndetin e njerëzve ashtu edhe për ekosistemin në përgjithësi. Substancat ndotëse pasi kalojnë në ujrë e lumenjëve ose të liqeneve, sillen në mënyra të ndryshme: disa treten dhe pësojnë zhvendosje për shkak të rrymave ujore, disa të tjera përthithen nga grimcat e ngurta pezull dhe sedimentojnë, ndërsa të tjerat mund të hyjnë në cikle biokimike të ndryshme, duke kaluar nga njëri organizëm në tjetrin. Nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve në përgjithësi, por i mineralit të bakrit në veçanti, shoqërohet me grumbullim sterilesht në sipërfaqe, shkarkime të ujërave të përzier me squfur dhe gaze, si dhe me shkarkime të gazrave në atmosferë. Pra nga minierat dhe fabrikat e bakrit shkarkohen në sipërfaqe vazhdimisht ujra me përmbajtje të lartë acide, (të ashtuquajturat shpërlarje acide, me vlera të ulta të pH-shit, deri në 2-3), si dhe gazra SO₂, që ndikojnë në florën, faunën dhe tek njerëzit që banojnë rreth e rrotull.




Fig. – 1 Harta Gjeomjedisore, Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

12.4. Minierat aktive, shfrytëzimet sipërfaqësore (karriera) dhe stoqet e tyre

Në Bashkinë e Korçës janë aktive disa punime minerare si për krom, bakër, qymyr, argjila, gurë dekorativ, gëlqeror, gëlqeror pllakor, inerte lumi etj. Aktiviteti minerar privat në rrethin e Korçës ka filluar në vitin 2000 dhe janë efektive rreth 25 leje minerare shfrytëzimi të cilat kanë një shpërndarje jouniforme, nga të cilat 15 janë për shfrytëzimin e gurëve gëlqeror, nga 2 leje janë për qymyr guri dhe për ranor silicor dhe nga 1 leje për gëlqeror të mermerizuar, krom, bakër, argjilë dhe gëlqeror pllakor.




Fig. – 2 Bllok diagrama e lejeve të shfrytëzimit në Bashkinë e Korçës (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)




Fig. - 3 Minierat e bakrit në Rehoë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Fabrikat e Tullave

Fabrikat e tullave kanë patur aktivitete të madhe për vite të tëra dhe vazhdojnë të kenë kudo në vendin tonë. Këto fabrika janë burim ndotje si nga aktiviteti i tyre por edhe nga karrierat e argjilave që shfrytëzohen për lëndë të parë për prodhimin e tullave. Këto në përgjithësi janë të ngritura afër zonave të populluara, duke sjellë gjithnjë shqetësime dhe dëmtime të ambientit rrethues, me pluhura dhe ndotje të ujërave dhe të tokave si dhe shqetësime të tjera të përditëshme nga transporti i argjilës, i tullave të prodhuara etj. Në Bashkinë e Korçës ka patur një fabrikë tullash në Qatrom ku njëkohësisht ka qënë dhe vendburimi, (kariera e argjilave), që furnizonte këtë Fabrikë. Vendburim argjilash ka edhe në Mollas. Këto fabrika janë burim ndotje si nga aktiviteti i tyre por edhe nga karrierat e argjilave që shfrytëzohen për lëndë të parë për prodhimin e tullave. Këto në përgjithësi janë të ngritura afër zonave të populluara, duke sjellë gjithnjë shqetësime dhe dëmtime

të ambientit rrethues, me pluhura dhe ndotje të ujërave dhe të tokave, çlirimin e gazrave nga lëndët djegëse që përdorin si dhe shqetësimet të përditëshme nga transporti i argjilës, i tullave të prodhuara etj.

Industria Kimike dhe mekanike


Uzinat dhe fabrikat e ndryshme, megjithëse e kanë mbyllur aktivitetin e tyre me vite, ekzistojnë ende pasojat e ndotjeve në shkallë të ndryshme, nga mbetjet e tyre kimike dhe teknologjike. Në Bashkinë e Korçës, siç thamë, ka qenë e zhvilluar një industri e përbërë kryesisht nga miniera dhe fabrika, si dhe mund të përmendim edhe uzinat mekanike, parqet e automjeteve me ofiçinat, me torneritë dhe repartet e ndryshme mekanike të tyre, nëpër ndërmarrje, ferma bujqësore, etj. Këto fabrika, ndërmarrje e reparte, me veprimtarinë e tyre shumë vjeçare dhe me një teknologji të vjetruar dhe me prodhime mbetjesh jo të pakta, padyshim kanë sjellë, dhe shumë prej tyre vazhdojnë të sjellin ndotje të ambientit me mbetjet e tyre, (si ndotje të ajrit, të ujrave dhe të tokave), aty ku ndodhen dhe me gjërë, duke patur parasyshtë mos marrjen e masave për shmangjen e tyre. Studimet e bëra arrijnë në konkluzionin se: "sidomos stoqet e sterileve të minierave të bakrit, paraqesin rrisqe të theksuara për ndotjen e ambientit me metale të rëndë. Përsa i përket industrisë kimike mund të përmendim edhe Fabrikën e përpunimit të lëkurëve dhe Fabrikën e prodhimit të birrës në qytetin e Korçës, etj. Të gjitha këto me lëndët e para dhe preparatet kimike që përdorin dhe me mbetjet teknologjike që prodhojnë, sjellin impakte negative në ndotjen e mjedisit, për eliminimin e të cilave kërkohet disiplinë dhe kontroll i vazhdueshëm nga ARM e kësaj Bashkie. Në Korçë ka patur edhe një TEC që ka punuar me qymyr, i cili edhe pse aktualisht nuk punon më, mbetjet teknologjike të depozituara në Maliq, përbëjnë një objekt të predispozuar për ndotje mjedisore.

12.5. Hot Spotet

Të ashtuquajturat "Pika të nxehta" ose "Hot Spote", krijohen nga mbetjet e rrezikshme, (MbRr), të cilat kanë karakteristika kimike e fizike toksike, gërryese, kancerogjene dhe që sjellin efekte të dëmshme, (këtu bëjnë pjesë edhe mbetjet spitalore si dhe mbetjet radioaktive, të cilat janë tejet toksike dhe ekspozimi ndaj tyre mund të shkaktojë sëmundje nga më të ndryshmet, madje edhe të shkaktojnë vdekje). Menaxhimi i situatës së mbetjeve të rrezikshme (MbRr) në vend, e shprehur me anë të "Hot Spoteve", është përcaktuar qartë nga projektet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Konkretisht si lloje prioritare të MbRr, në 35 sheshet e përcaktuara (UNEP, (2008); UNDP, 2010), janë konsideruar mbetjet që dalin nga:

- minierat dhe proceset minerare; - mbetjet e naftës dhe mbetje të tjera të hidrokarbureve;

Fig. - 5 Hot Spotet ngaminierat e Shqipërisë, (UNEP, 2007) (Burimi: Shërbimi Gjeologjik



Shqiptar)

- mbetjet acide apo solucionet bazike; - mbetjet nga rrëshirat, adesivet (ngjitësit);
- mbetjet nga bojërat, ngjyrosjet, pigmentet etj; - mbetjet e arsenikut;
- mbetjet nga lëkurat, gëzofët dhe industria tekstile etj;
- mbetjet nga trajtimet e sipërfaqeve të metaleve;

Siç e kemi thënë më sipër, për Bashkinë e Korçës, si "Pika të nxehta" ose "Hot Spote", janë cilësuar: Minierat e bakrit në Rehovë.

13. Pasurite Minerale

13.1. STUDJUESHMËRIA E PASURIVE MINERALE

Më poshtë po japim në mënyrë të përmbledhur numrin e vendburime dhe objekteve sipas mineraleve të evidentuar në qarkun e Korçës:

- Kromi mbi 25 vendburime dhe objekte
- Bakri- mbi 15 vendburime dhe objekte
- Hekur- Nikeli mbi 3 vendburime
- Boksiti mbi 2objekte
- Gëlqerorë mbi 10 vendburime
- Argjila – mbi 3 vendburime
- Qymyre mbi 10 vendburime
- Gurë dekorative mbi 6 vendburime
- Vendburim Azbesti -1
- Objekte Talku-1
- Rëra kuarcore- 2 vendburime.

Duhet theksuar se interes të veçantë kanë shkëmbinjtë dhe mineralet industriale si troktolitët, gëlqerorët konglomeratikë, ranorët kompakte, gëlqerorët bezhë, të cilët kanë përhapje të konsiderueshme në qarkun e Korçës.

HARTË E VENDNDODHJES SË MINIERAVE




Fig. – 1 Harta e Vendndodhjes se Mineraleve (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Minerali Bakër

Vendburimet kryesore të mineralit të bakrit janë në rrethin e Korçës, Rajoni Rehovë-Vithkuq. Në rrethin e Pogradecit kemi vetëm objektin “Guri i Topit, Mineralizimi i bakrit është i tipit hidrotermal duke u vendosur në nivele të caktuara të prerjes petrologjike.




Fig. –2 Harte Metalogjenike (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Vendburimi Bregu i Gështenjës - Është vendburimi me i madh i bakrit në qarkun e Korçës me vendndodhje në Rehovë. Trupi xeheror është i tipit piritoz (kalkopirit, pirit, markazit).

Vendburimi Kanisqeli - Vendndodhja: Rehovë. Morfologjia e trupit është thjerrëzore deri në poplore me përmbajtje mesatare të Cu-1.71%, tekstore masive deri në pikëzore të shfrytëzuara nga sipërfaqja.

Vendburimi Dushku i Trashë:

Vendndodhja: Rehovë. Trupi xeheror është i tipit piritoz (kalkopirit, pirit, markazit, me pak kalkozinë). Morfologjia e trupit është thjerrëzore dhe vendoset brenda bazalteve në një zonë me çarje.




Fig. – 3 Prerja e Vendburimit Bregu i Gështenjë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Objekti Lubonjë - Vendndodhja: Lubonjë: Trupi xeheror është i tipit piritoz (kalkopirit, pirit, markazit, me pak kalkozinë). Morfologjia e trupit është thjerrëzore dhe vendoset brenda bazalteve në një zonë me çarje .

Objekti Kuqesh - Vendndodhja: Kuqesh Lubonjë: Trupi është konturuar nga punimet e kryera në shtrirje:500 ml, në rënie 300ml dhe trashësi mesatare 10 ml.

Objekti Orenje - Vendndodhja: Orenje (Lubonjë). Mineralizimi ka mbushur dhe përpunuar kontaktin petrologjik diabaz-aglomerate. Rezervat e llogaritura për këtë objekt janë: 27.000 ton (C + C) me përmbajtje mesatare të Cu-1.97% me teksturë masive deri në pikëzore.




Fig. – 4 Harta gjeologjike ku pasqyrohen vb e bakrit në zonën e Rehovë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Vendburimet e Hekur-Nikelit

Vendburimet e Hekur-Nikelit në qarkun e Korçës i përkasin tipit lateritik të ngelura në vend ose pak të transportuara, duke u përqendruar në dy rajone atë të Pogradecit si dhe atë të Bitinckës. Një pjesë e mirë e këtyre vendburimeve kanë qenë në shfrytëzim deri në vitet 1990. Në mënyrë të shkurtuar po përshkruajmë vendburimet si më poshtë:




Fig. – 6 Harta e Prerjes Terthore ne Vendburimin Guri i Kuq (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

1	85	Obj. Voskopoje	Korçë	30,	24				E hapur
2	72	Obj. Ura e	Korçë	20	20.56				E hapur
3	91	Obj.Dersnik	Korçë	3	18.56				E hapur
4	90	P.Min. Maja e	Korçë	3	18.56				E hapur
5	104	P.Min.Mali i	Korçë	2	26-28				E hapur
6	94	P.Min Maja e	Korçë	-	27				E hapur
7	11	P.MinVrepcke	Kolonje	0.5	-	28			E hapur

Tab. – 1 Tabele Shpjeguese !!! (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)




Fig. – 7 Harta e Zonave Minerale, Korçë ((Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar))

13.2 MINERALET JOMETALORË (SHKËMBINJTË INDUSTRIALË)

Argjilat

Argjilat në qarkun e Korçës kanë rezerva dhe përhapje të konsiderueshme. I përkasin tipit lagunor, lagunore-ndërmalorë si dhe liqenor-detar. Mbi bazën e këtyre resurseve dhe kushteve të përshtatshme për shfrytëzim në rajonin e Pogradecit si dhe atë të Korçës prej kohësh janë ndërtuar fabrika tullash, tjegullash për industrinë e ndërtimit. Në mënyrë të përmbledhur po japim vendburimet e argjilave në qarkun e Korçës dhe mundësitë e përdorimit të tyre.

Vendburimi Troktoliteve Treste - Bashkia Korçë, Janë pjesë të sipërme të kompleksit ofiolitik të përbërë nga minerali i plagjioklazit dhe olivinës. Kombinimi i këtyre dy ngjyrave jep veti dekorative këtyre shkëmbinjve. Janë vlerësuar nga ana e ndërmarrjes gjeologjike të Korçës, por nuk janë kryer punime shpimi për të vlerësuar bllokshmërinë e tyre. Rezervat llogariten mbi 1 000 000 m³.

Rërat kuarcore Ziçisht-Hoçisht - Vendndodhja administrative: Fshati Ziçisht. Depozitime tipike aluviale të Pliocen-kuaternarit të vendosura në gropat ndërmalorë. Burimi i ushqimit vjen nga masivi i Vardarit. Ranorët kuarcore janë të çimentuar.

Gëlqerorët - Gëlqerorët zënë sipërfaqe të konsiderueshme në Qarkun e Korçës. Një pjesë e mirë e tyre janë studiuar për tu përdorur si material ndërtimi dhe një pjesë për veti dekorative.

Nr.	Nr. i vendburimit në ose	Vendburimi	Bashkia	Rezerva Gjeologjike	Përmbajtja e komponentëve			Perspektiva
					CaO	MgO	Fe ₂ O	
1	96	Shtyllë	Korçë	12000	53			Hapur
2	100	Obj.Vithkuq	Korçë	61	52			Hapur

Tab. – 2 Vendburimet dhe objektet për gurët gëlqeror

Gëlqerorëve konglomeratike të Polenës - I përkasin Bashkisë së Korçës. Këta gëlqerorë kanë gjetur përdorim të gjere si materiale ndërtimi (prodhim qoshesh, kolonash për ndërtesat private) ashtu edhe si lëndë e parë që kanë përdorur artizanet e vjetër e të rinj për prodhimin e objekteve artistike si shatërvanë, kolona, skulptura të ndryshme, fale kjo vetive fiziko-mekanike të shtresave gëlqerorë-konglomeratike të kretakut të poshtëm (Cr).

Lëndët e para energjetike Qymyret

Qymyrbajtja e Qarkut, siç thamë me lartë lidhet me depozitimet molasike të ultësirave të mbivendosura mbi zonat e brendshme dhe ato të jashtme si dhe janë të moshave.

- I. Pellgjet qymyrore të moshës Oligocen-Miocenit të poshtëm
- II. Pellgjet qymyrore të moshës së Tortonianit
- III. Pellgjet qymyrore të moshës së Pliocenit

Pellgu qymyrbajtës i Mborje-Drenovës:

Vendndodhja administrative: Fshati Mborje-Drenovë. Shtrihet nga përroi i Boboshticës në jug, deri në përroin e Mborjes në veri.

Vendburimi i qymyreve Dardhas-Vërdovë Vendburimi ndodhet rreth 14 km larg qytetit të Pogradecit, nen juridiksionin e Komunës Dardhas e Buçimas dhe ka këto koordinata të sektorëve të ngritur për shfrytëzim:

Vendburimi i qymyreve Grunjas - Vendndodhja administrative. Vendburimi i qymyrit Grunjas ndodhet në perëndim e jugperëndim të qytetit të Pogradecit, rreth 18-20 km larg tij. Rajoni ku vendoset ky vendburim nga ana gjeografike është kodrinoro- malor.




Fig. 8 - Profil Skematik v.b Qymyreve të Mborje-Drenovës (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Nr	Nr. Hartë	Vendburimi ose objekti.	Bashkia	Rezervat 000/ton	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm					Perspektiva
					Fuqia	H ₂ O	Hirit	Volative %	Sqfur %	
1	77	Vb Kuçi i Zi	Korçë	2552	2800	2,14	57.5	26,42	3.	E hapur
2	92	Vb. Mborje-Drenovë	Korçë	4420	2864	1,77	53.58	23,79	3.94	E hapur

Tab. – 3 Vendburimet dhe objektet per mineralin qymyre

Rezervat. Totali i rezervave të llogaritura për vb. Malinj-Podgozhan janë: B+C +C =11108225 t

Vendburimi i qymyreve Bezhan - Vendndodhja administrative: Fshati: Bezhan, Bashkia Kolonjë, largësia nga rruga automobilistike nacionale Korçë-Ersekë 34 km b) sekondare Mollas-Bezhan 6 Km. Vendburimi i Bezhanit merr pjesë në ndërtimin gjeologjik të ultësirës ndërmallore të Kolonjës megjithë tiparet e saj molasike, me ndershtresa qymyrore brune.




Fig. 9 - Perspektiva e naftëgazmbajtjes në qarkun Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Territori i Qarkut Korçë ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen për kërkimin e naftës dhe gazit. Ky rajone është mbuluar nga punime të ndryshme gjeologjike si rilevime në shkallë 1:50 000 dhe 1:25 000. në vitet 1968,1972,1976, punime tematike përgjithësuese në vitin 1973, etj.

Në Qarkun e Korçës ushtrojnë aktivitetin e tyre disa kompani e subjektet private të pajisura me leje minerare në fushën e kërkim- zbulimit dhe të shfrytëzimit të pasurive minerare, përkatësisht 48 leje minerare shfrytëzimi dhe 1 leje minerare kërkim-zbulimi. Për mineralet metalore kemi 19 leje shfrytëzimi (11 për mineralin e Fe-Ni, 1 për mineralin bakrit, 7 për mineralin e kromit) dhe 29 leje minerare shfrytëzimi për mineralet jometalore (industriale), përkatësisht kemi 22 leje shfrytëzimi për gëlqerorë; 2 leje shfrytëzimi për qymyre; 1 leje shfrytëzimi për konglomerate, 1 për ranorë, 2 për kuarc, 1 për argjile. Kemi 1 leje minerare kërkim-zbulimit për mineralin e Fe-Ni.




Fig. - 10 Harta e rajonizimit naftëgazmbajtëse në Shqipëri (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)




Fig. 11 – Harta e Pasurive Minerale (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

14. Gjeomonumentet

14.1 KUADRI KOMBETAR PER RUAJTJEN E NATYRES

Rrjeti i sotem i Zonave të Mbrojtura në Shqipëri, mbulon një sipërfaqe prej 165,455 hektare e barazvlefshme me 5.8 % të sipërfaqes së përgjithshme të vendit. Sipas Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin, planifikohet që deri më 2020, ZM-të të mbulojnë 25 % të territorit shqiptar. Në vitin 2002, Parlamenti Shqiptar aprovoi dy ligje të rëndësishme (Ligji Nr. 8934 i datës 05.09.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” dhe Ligji Nr. 8906 i datës 06.06.2002, “për Zonat e Mbrojtura”, (i amenduar me Ligjin nr. 9868, datë 4.02.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”) që së bashku krijuan një strukturë të re ligjore për Zonat e Mbrojtura. Ligji jep gjithashtu parimet e zhvillimit të turizmit mjedisor, të perfitimeve të tjera ekonomike si dhe ato të percjelljes së informacionit dhe edukimit në drejtim të publikut.




Fig. – 1 Harta e zonave ekzistuese të mbrojtura në Shqipëri (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Rezervë “strikte” natyrore - rezervat shkencor (Kategoria I) zbatohet shkalla më e lartë e mbrojtjes, ku ndalohen: Prerja e drurëve dhe e shkurreve; Përdorimi i kimikateve dhe plehrave kimikë; Ndërtime të çdo lloji; Nxjerrja e mineraleve dhe e torfave; Gjuetia dhe peshkimi; Ngritja e objekteve çlodhëse, argëtuese dhe sportive; Lëvizja me mjete motorike të çdo lloji, me përjashtim të makinave të administratës së ruajtjes së rezervatit dhe të zjarrfikësve. Zonë buferike e rezervatit strikt natyror mund të shpallet territori rreth rezervatit, me gjerësi rreth 100m nga kufiri i tij. Veprimtaritë e tjera, që kërkohen të ushtrohen në rezervat ose në zonën e tij buferike, duhet të pajisen me leje mjedisi.

Park Kombëtar (Kategoria II) - zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, ku ndalohen: Shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive; Neutralizimi i mbetjeve me origjinë jashtë territorit të parkut kombëtar; Ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, linjave të tensionit të

lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë; Larja dhe shpëlarja e rrugëve me kimikate; Nxjerrja e mineraleve, gurëve dhe torfave me përjashtim të gurëve të rërës për mirëmbajtjen e parkut; Veprimtari masive sportive, turistike, jashtë pikave të caktuara; Organizimi i garave me automjete e motoçikleta; Ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të lagura; Ngritjen dhe funksionimin e objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje; Programe kërkimore-shkencore dhe monitoruese; Veprimtari kërkimore-shkencore, arkeologjike, paleontologjike dhe për mbartjen e gjetjeve të tilla; Përdorimin ose magazinimin e përkohshëm të agro-kimikateve. Kur administrata e ruajtjes së parkut vëren se cenohet qëllimi për të cilin ky park është shpallur park kombëtar, mund të kufizojë ose të ndalojë përkohësisht lëvizjen e mjeteve të transportit, gjuetinë e peshkimin dhe veprimtari të tjera të lejuara. Zona buferike e parkut kombëtar mund të shpallet territori rreth parkut, me gjerësi rreth 50m nga kufiri i tij.

Monument natyror Kat –III, Në një monument natyror zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

Shpellat si monument natyror. Shpellat, kanionet dhe ujëvarat natyrore nuk rrethohen me zonë buferike.

Rezervat natyror i menaxhuar – Kat – IV- Në zonën e menaxhimit të habitateve dhe llojeve zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, ku ndalohen: ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura; depozitimi i kimikateve; lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve; mbledhja e bimëve, mineraleve, ngritja dhe funksionimi i objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje, vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave,

Peizazhi i mbrojtur – Kat.V. Në një peizazh të mbrojtur zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, ku ndalohen: mbjellja e pyjeve monokulturë; neutralizimi i mbetjeve dhe ndezja e zjarreve, ndërtimi i autostradave, i kanaleve lundruese dhe i zonave urbane; lëvizja me mjete transporti jashtë rrugëve dhe vendeve të caktuara, organizimi i garave me automjete, motoçikleta e biçikleta. Veprimtaritë që ndryshojnë përdorimin e territorit, ndërtimet, përdorimi i kimikateve e pesticideve, trajtimi i ujërave të zeza në ferma, për zona më të mëdha se 2 ha dhe veprimtaritë e tjera, që nuk ndalohen shprehimisht nga pika 2 e këtij neni, mund të ushtrohen vetëm pasi të jenë pajisur me leje mjedisi dhe të miratohen në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara – Kat.VI - Zonat që përfshijnë territore të gjëra e relativisht të izoluar dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara. Kjo kategori mund të përdoret dhe për ato zona që janë të mbrojtura me legjislacion, por që nuk janë përdorur për ndonjë arsye. Në një zonë të mbrojtur të burimeve të menaxhuara zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

Pyjet, ujërat dhe pasuri të tjera natyrore brenda zonave të mbrojtura - Pyjet në zonat e mbrojtura përjashtohen nga klasifikimi si pyje për shfrytëzim. Kur këto pasuri janë pronë private,

ato menaxhohen e përdoren nga pronari ose përdoruesi i ligjshëm vetëm në përputhje me planin e menaxhimit të zonës, të miratuar nga Ministria e Mjedisit.

14.2. KATEGORITE MENAXHUESE TE IUCN-SE PER ZONAT E MBROJTURA¹

I. Mbrojtje Strikte (Rezervat Strikt Natyror)

Siperfaqe tokesore ose detare me ekosisteme te vecante ose perfaqesues, karakteristika gjeologjike me/ose lloje te rendesishem. Karakteristika te vlefshme per kerkim shkencor dhe monitorim mjedisor.

II. Konservim i ekosistemeve dhe rikrijim (Parqet Kombetare)

Zona Natyrore tokesore ose/dhe detare, te krijuara per (a) mbrojtjen e teresise ekologjike te nje apo me shume ekosistemeve per brezat e sotem dhe te ardhem, (b) perjashtimin e shfrytezimit per qellime te kunderta me ato te ZM-se dhe (c) dhenien e e nje baze te zhvillimit shpirtor, shkencor, edukues dhe vizitues, ku gjithesecila duhet te jete pro-mjedisore dhe pro-kulturore.

III. Konservimi i veçorive natyrore (Monumentet e Natures)

Zona qe permbajne nje, ose me shume, vecori natyrore/kulturore me vlera te jashtezakonshme ose unikale per shkak te rallesise se pazakonte, cilesive perfaqesuese, estetike ose kulturore.

IV. Konservim me ane te menaxhimit aktiv (Rezervat Natyror i Menaxhuar)

Siperfaqe tokesore ose detare subjekt i nderhyrjeve aktive me qellime manaxhimi per te siguruar mirembajtjen e habitateve dhe/ose permbushjen e kerkesave te llojve te vecanta.

V. Konservim i Pejsazheve Tokesore/Detare (Pejsazh Tokesor/Detar i Mbrojtur)

Siperfaqe tokesore ose/dhe detare ku nderveprimi shumevjecar i njeriut me natyren ka dhene nje hapësire me karakter te theksuar estetik, ekologjik dhe/ose kulturor me larmi te larte biologjike ne shume raste. Sigurimi i teresise se ketij nderveprimi tradicional eshte jetik per mbrojtjen, mirembajtjen dhe evolimin e nje zone te tille.

VI. Perdorim i qendrueshem i ekosistemeve natyrore (Zone e Perdorimit te Shumefishte)

Zona ku dominojne sistemet natyrore te pamodifikuara, te menaxhuara per te siguruar mbrojtjen dhe ruajtjen afat-gjate te larmise biologjike. Njeherazi, ato mbeshtesin nje perdorim te qendrueshem te prodhimeve dhe sherbimeve natyrore per te siguruar nevojat e komunitetit.

BURIM: IUCN (1994b)

¹ Kategori te vendosura ne Sesionin e 19-te te Asamblese se Pergjithshme te IUCN-se, Buenos Aires, Janar 1994.

14.3. TIPET E GJEOMONUMENTEVE TË BASHKISË SË KORÇËS

Sipas klasifikimit të bërë dhe të cituar më sipër, gjeomonumentet e takuara në Bashkinë e Korçës janë të rëndësisë ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale. Për nga origjina e tyre, dominojnë gjeomonumentet me origjinë: stratigrafike, mineralogjike-ekonomike, gjeomorfologjike (erozionale-lumore, karstike, atmosferike), tektono-strukturore, paleontologjike-paleoambientale, hidrogjeolo-gjike-termominerale etj. Konkretisht, kemi gjeomonumentet e klasifikuara si më poshtë:

I-Gjeoparqet

1. Bredhi i Drenovës (Bozdovec), *Park Kombëtar*
2. Krastafillaku, *Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror*

II-Gjeomonumentet

a) Gjeomonumente me vlera ndërkombëtare:

1. Prerja e Moravës (I.-13), *Gjeomonument strtatigrafik*

b) Gjeomonumente me vlera kombëtare:

1. Miniera e qymyrgurit Mborje-Drenovë *Gjeomonument mineralogjik ekonomik*
2. Burim uji dhe gazi të djegshëm në thyerjen tektonike të Polenës, Pulahë, *Gjeomonument hidrogjeologjik-termomineral*
3. Prerja me makrofaunë Gjonmadh (VIII-16), *Gjeomonument paleontologjik-paleoambiental*
4. Mospërputhje këndore e Polenës së Vjetër, *Gjeomonument tektono-strukturor*

c) Gjeomonumente me vlera lokale:

1. Guri i Capit, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik*
2. Gryka e Zemblakut (Cangonjit) *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks,*

erozional lumor.

3. Varrezë fosilesh të Kretës së poshtme (Lavdar), *Gjeomonument paleontologjik-paleoambiental*
4. Qafa e Qytetit (V.-a-15), *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik*
5. Qafa e Shëndellisë (V.-a-29), *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik*
6. Kanioni i Voskopojës, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional lumor*
7. Kanioni i Vithkuqit, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional lumor*
8. Tre Gurët ose tri Kokonat, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik*
9. Mospërputhja këndore në fshatin Voskop, *Gjeomonument tektono-strukturor*
10. Varrezë fosilesh në Lumalas-Teqeja Melçan, *Gjeomonument paleontologjik-paleoambiental*




Fig. – 2 Harta e Gjeomonumenteve, Bashkia Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

14.3.1 Gjeoparqet

1. Bredhi i Drenovës (Bozdovec)

Parku kombëtar “Bredhi i Drenovës” ndodhet në Qarkun e Korçës dhe në Bashkinë e Korçës, 10 km larg në juglindje të qytetit të Korçës dhe shtrihet në kurrizin dhe shpatet perëndimore të Malit të Moravës. Parku ka një sipërfaqe prej 1380 ha dhe lartësi maksimale 1808.4 m. Bozdoveci, Guri i Capit, Çardhaku janë pikat më atraktive të tij. Konsiderohet zonë e peisazheve tërheqës me potenciale të mëdha për turizëm natyror e kulturor dhe zhvillim të qëndrueshëm. Ky është mjaft i frekuentuar nga banorët e qytetit të Korçës dhe fshatrave përreth. Vlerat atraktive të këtij parku ia shton edhe prania e shumë burimeve, të cilët kanë ujë të pijshëm gjatë gjithë vitit si ai i Shën Gjergjit, Plakës, Pllicës etj.



Foto – 1 Pamje nga Parku Kombëtar “Bredhi i Drenovës” (Foto L. Moisiu)



Foto – 2 Parku pas djegieve të ndodhura në gusht 2012

2. Krastafillaku (Koordinatat: 40°41'45" Veri, 20°41'42" Lindje)

Rezervat Natyror i Menaxhuar/Parku Natyror Krastafillaku ndodhet në Qarkun e Korçës dhe në Bashkinë e Korçës. Sipërfaqja aktuale e parkut është 2500 ha. Është zonë tipike me pyje të llojeve të dushkajave. Ka pësuar dëmtime dhe gjëndja është në përmirësim. Ka vlera për komunitetin. Parku nuk ka plan menaxhimi.



Foto – 3 Parku Natyror I Krastafillakut

14.3.2. Gjeomonumentet

Prerja e Moravës Kjo prerje, me trashësi rreth 2 km, ndodhet në lindje të Korçës dhe Malit të Moravës, në pjesën lindore të gropës mollasike të Korçës. Ajo përfaqëson prerjen e plotë të formacioneve mollasike të kësaj grope, të vendosur transgresivisht mbi ultrabazikët e Mirditës.




Fig. – 3 Suita litogjike nga miniera e Drenoves deri ne suiten e Bradices (*Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar*)

Ajo është prerja unike për Miocenin në Shqipëri dhe në rajon dhe ndërtohet nga shkëmbinjtë argjilorë, ranorë, konglomerate, alevrolite etj... si dhe nga gëlqerorë koralorë. Ajo përbën krahun perëndimor të sinklinalit të madh të Devollit. Në prerje gjendet miniera e vjetër qymyrgurore e

Drenovës, ku është përcaktuar për herë të parë (viti 1896) specia *Barbatia Albanica oppenheim* nga Oppenheim. Kjo prerje përbën një gjeomonument me rëndësi ndërkombëtare, të grupit stratigrafik dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, ekonomike dhe didaktike.

a) Gjeomonumente Me Vlera Kombëtare:

1. Miniera e qymyrgurit Mborje-Drenovë (Koordinatat: 40°36'11" Veri, 20°49'09" Lindje) Kjo minierë ndodhet në gropën e Brendshme të Korçës, afër, në jug të qytetit, në Malin e Moravës. Qymyret e Mborje-Drenovës kanë qënë të njohura qysh në kohrat e mesjetës, kurse shfrytëzimi dhe studimet kanë filluar qysh në fillimet e shekullit XX. Me hulumtimet e para paleontologjike është përcaktuar për herë të parë (viti 1896) specia *Barbatia Albanica oppenheim* nga Oppenheim. Vendburimi përbën një monoklinal me rënie lindore. Ai përbëhet nga disa shtresa qymyrguri, por vetëm dy janë industriale me fuqim kalorifike maksimale 4000 kkal. Ajo është shfrytëzuar edhe në kohën e pushtimit otoman dhe sidomos pas luftës (1960-1990). Kjo minierë përbën një gjeomonument me rëndësi kombëtare, të grupit historik dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, ekonomike, historike dhe didaktike.



Foto – 4 Horizont faunistik, si reper udhëzues “varreze fosilesh” me molusqe, korale, gastropodë, foraminiferë



Foto – 5 Pamje të ndryshme nga Prerja e Moravës

2. Burim uji dhe gazi të djegshëm në thyerjen tektonike të Polenës, Pulahë

Bëhet fjalë për dy burime në thyerjen tektonike të Polenës që ndodhen pranë fshatit Pulahë (Bellovodë) të ish rrethit të Korçës, që ndodhen rreth 500 m në të djathtë të rrugës automobilistike Korçë-Floq, pranë depos së ujit të fshatit Pulahë dhe dalin në përplasjen e thyerjes të thellë gjatësore tektonike regjionale Gjergjevicë-Gjanç-Floq me drejtim shtrirje veriperëndim-juglindje (pjesa më jugore e saj) me thyerjen grabenore perëndimore të ultësirës së Korçës (në buzën lindore të grabenit të Korçës), që sjell në kontakt formimet mollasike të gropës së Korçës me shkëmbinjtë ultrabazikë të masivit të Voskopojës, 930 m mbi nivelin e detit, në shkëmbinjtë ultrabazikë, në tavanin e kontaktit të magneziteve me serpentinitet. Njëri është burim uji me përzierje gazi natyror. Jo shumë larg prej këtyre burimeve, rreth 350 m, në veri të fshatit Floq, rreth 50 m në të djathtë të rrjedhjes së lumit të Floqit, po në përplasjen e thyerjes të thellë gjatësore tektonike regjionale Gjergjevicë-Gjanç-Floq me drejtim shtrirje veriperëndim-juglindje (pjesa më jugore e saj) që sjell në kontakt formimet mollasike të gropës së Korçës me shkëmbinjtë ultrabazikë të masivit ultrabazik të Moravës del edhe një burim uji dhe gazi, ai i Floqit me koordinata: X= 44 86 400, Y=44 76 050 Z= 975 m





Foto – 5 Burimet e Pulahës (Foto L. Moisiu, A. Avxhi)

3. Prerja me makrofaunë Gjonomadh (Koordinatat: 40°37'33" Veri, 20°38'46" Lindje) Kjo prerje ndodhet në fshatin Gjonomadh të zonës së Voskopojës, ku dalin gëlqerorët e Kretës së sipërme, në të cilët takohen konodontë të shumta. Në antiklinalin e Vithkuqit, prerja e depozitimeve kretake fillon me një pako terrigjene konglomeratike (20-30 m), transgresive mbi shkëmbinj të magantikë, efuzivë, ultrabazikë. Sipër, me mospajtim, vijojnë gëlqerorët konglomeratikë me gastropodë e korale të shumta. Takohet edhe një horizont i pasur me orbitolina. Mosha mendohet cenomaniane. Kjo prerje përbën një gjeomonument me rëndësi lokale, të grupit paleoambiental dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, paleontologjike, didaktike dhe gjeoturistike.



Foto- 6 Makrofauna Gjonomadh (Foto L. Moisiu majtas dhe Gj. Stoja djathtas)

4. Mospërputhje këndore e Polenës së Vjetër (Koordinata: X= 44 96 000, Y=44 73 600, Z= 980 m) Mospërputhja këndore e Polenës së Vjetër gjëndet rreth 500 m në veri të fshatit Polenë e Vjetër, të ish Komunës së Rrëzës të ish rrethit të Korçës, rreth 980 m lartësi mbi nivelin e detit. Mospërputhja këndore shfaqet midis depozitimve terrigjene të Kretakut të sipërm (Cr2), të përfaqësuar litologjikisht nga gëlqerorë turbididikë, organogjenë, të kuqërremtë, gëlqerorë me rudiste dhe gastropodë dhe depozitimeve mollasike të Oligocenit të mesëm

b) Gjeomonumente Me Vlera Lokale

1. Guri i Capit (Sfinski shqiptar) (Koordinatat: 40°35'23" Veri, 20°50'53" Lindje)

Guri i Capit ndodhet në brëndësi të parkut të Bozdovecit, në ish Komunën Drenovë të rrethit të Korçës. Ai përfaqëson një bllok shkëmbor konglemeratik dhe ranor të Akuitanianit, me formë të veçantë dhe ngjan me një deve të ulur "për të pushuar pas një udhëtimi të gjatë në shkretëtirë". Emrin e ka marrë pasi ai ngjason edhe me kokën e capit. Rreth tij, ka edhe mbetje të tjera erozionale më të vogla dhe me forma të ndryshme si shtylla, kërpudha etj. Ky përbën një gjeomonument me rëndësi ndërkombëtare, të grupit gjeomorfologjik-kompleks dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, didaktike dhe gjeoturistike.




Foto – 7 Pamje të ndryshme nga Guri i Capit (Foto Zh. Misha A. Fezollari etj.)

2. Gryka e Zemblakut (Cangonjit) (Koordinatat: 40°42'00" Veri, 20°53'31" Lindje)

Kjo grykë ndodhet midis Gropës së Korçës dhe asaj të Devollit. Ajo ka një gjatësi prej 3km dhe një gjërësi rreth 100-200 m në pjesën më të ngushtë të saj. Terracat e Devollit dëshmojnë se ai ka rrjedhur gjithmonë nga kjo grykë dhe se liqenet e Korçës dhe Devollit kanë qënë të lidhur me njëri tjetrin. Në formimin e kësaj gryke kanë ndikuar edhe lëvizjet tektonike të Miocenit. Ajo është e vetmja nje komunikimi midis krahinave të Korçës dhe Devollit. Ky përbën një gjeomonument me rëndësi kombëtare, të grupit gjeomorfologjik-kompleks dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeografike, didaktike dhe gjeoturistike.

3. Varrezë fosilesh të Kretës së poshtme (Lavdar)

Kjo varrezë fosilesh gjëndet në fshatin Voskopojë të rrethit të Korçës, rreth 1000m mbi nivelin e detit. Ajo ka sipërfaqe 1000m² (gjatësi mesatare 200m dhe gjërësi rreth 50m). Fosilet dalin në

një kodër. Kjo varrezë përbën një gjeomonument me rëndësi lokale, të grupit paleoambiental dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, paleontologjike dhe didaktike. Ai është shpallur shesh në mbrojtje me VKM nr. 676, datë 20.12.2002 dhe vizitohet sipas rrugës Korçë-Lavdar.

4. Qafa e Qytetit (Koordinatat: 40°35'53" Veri, 20°48'42" Lindje)

Kjo qafë ndodhet në Malet e Moravës, në kufi me grabenin e Korçës, në krahun perëndimor të sinklinalit të Devollit, në lartësinë 1200 m. Ajo është një qafë e formuar si rezultat i erozionit natyror nga agjentë atmosferikë. Ky përbën një gjeomonument me rëndësi lokale, të grupit gjeomorfologjik-kompleks dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike dhe gjeoturistike.



Foto – 8 Dalje e shkëmbinjve ultrabazikë (σJ_2), të ofioliteve lindore, të cilat dalin në sipërfaqe në masivin e vargmalit të Moravës. Në horizont, Qafa e Qytetit, Qafa e Shëndëllisë dhe Maja e Çardhak (Foto Zh. Misha)

5. Qafa e Shëndëllisë (V.-a-29), (Koordinatat: 40°36'50" Veri, 20°48'55" Lindje) Kjo qafë ndodhet në lindje të Korçës, në lartësinë 1385 m dhe përbën një formacion erozionale me formë të rregullt "U"-je. Qafa shërben si nyje komunikimi. Ky përbën një gjeomonument me rëndësi lokale, të grupit gjeomorfologjik-kompleks dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, gjeoturistike dhe komunikimi.

6. Kanioni i Voskopojës (Koordinatat: 40°37'42" Veri, 20°36'21" Lindje). Kanioni i Voskopojës ndodhet në Malësinë e Voskopojës, pranë Voskopojës. Ai ka pamjen e një groporje, në kontaktin e mollasave me shkëmbinjtë ultrabazikë. Ai është i gjatë 4 km, i gjërë 1 km dhe zgjerohet në vendin e bashkimit të Lumit të Zhombrit me Përroin e Mustafallarit që përfundon në Gropën e Korçës. Ky përbën një gjeomonument me rëndësi lokale, të grupit gjeomorfologjik-

kompleks dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, gjeografike, didaktike dhe gjeoturistike.

7. Kanioni i Vithkuqit (Koordinatat: 40°31'39" Veri, 20°35'58" Lindje). Kanioni i Vithkuqit është formuar nga Lumi i Osumit, në rrjedhjen më të sipërme të tij. Ai është formuar në kurrizoren Vithkuq-Shtyllë-Maja e Bardhë, e cila është shumë e thyer dhe me kontraste të shumta të relievit. Po këtu, në faqen veriore, dallohet qartë kontakti normal i gëlqerorëve me melanzhin ofiolitik. Ky kanion përbën një gjeomonument me rëndësi lokale, të grupit gjeomorfologjik-kompleks dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, gjeografike, didaktike dhe gjeoturistike. Vendndodhja e tij në fshatin Vithkuq i jep atij edhe vlera historike dhe kurative.

8. Tre Gurët ose tri Kokonat (Koordinatat: 40°36'43" Veri, 20°50'52" Lindje). Ky gjeomonument gjëndet në kurrizoren e tretë të vargmalit të Moravës (kurrizorja më e lartë e këtij vargmali), Maja e Çardhakut (1808.4 m). Lartësia e tyre është rreth 10-15 m. Ka formë prizmatike gati të rregullt dhe pothuajse vertikale është me ngjyrë portokalli të zbardhur në kafe. Dallohet në gjithë peisazhin përreth. Ky gjeomonument ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike dhe gjeoturistike.



Foto – 9 Pamje e gjeomonumentit “Tre gurët ose Tri Kokonat” në malin e Moravës

Shumë afër me “Tre gurët ose Tri Kokonat”, gjënden gëlqerorët litotamnikë të Majës së Çardhakut. Kufiri i poshtëm i depozitimeve të Burdigalianit, në këto zona, zakonisht, korrespondon me shfaqjen në prerje të një niveli me gëlqerorë litotamnikë, shoqëruar me foraminiferë të mëdhënj dhe makrofaunë. Ky formacion, i emërtuar “Morava”, me trashësi 50–80 m, përveç gëlqerorëve litotamnikë, përmban dhe shtresa ranorësh, alevrolitesh dhe argjila mergelore. Kanë formë shtresore ose brezore, pothuajse horizontale me ngjyrë portokalli të zbardhur në kafe.

9. Mospërputhja këndore në fshatin Voskop (Koordinatat: X=44 98 000, Y=44 73 400, Z=900 m) Mospërputhja këndore në fshatin Voskop ndodhet rreth 350m në veriperëndim të fshatit, në të djathtë të rrugës automobilistike Voskop-Voskopjë, mbi këtë rrugë dhe shumë afër saj, si dhe në të majtë të rrjedhjes së lumit të Stenës, që zbret në fshatin Voskop.

10. Varrezë fosilesh në Lumalas-Teqeja Melçan (Koordinatat: E 44 77 496; N 45 01 747) Rreth 2.2 km nga kryqëzimi i rrugës Korçë-Pogradec me kthesën e fshatit Lumalas në drejtim të Teqesë së Melçanit, si rezultat i hapjes së rrugës për në këtë të fundit takohet qartazi nje varrezë makrofosilesh në gëlqerorët mergelore organogjenë të Burdigalianit. Ky gjeomonument ka vlera shkencore, gjeologjike, paleontologjike dhe didaktike. Ai vizitohet me rrugën automobilistike Lumalas-Teqeja e Melçanit. Është konstatuar, përshkruar dhe fotografuar nga Ing. Gjergji Stoja



Foto -10 Foto satelitore Teqeja e Melçanit, Varreza e fosileve dhe Pamje e Varrezës së fosileve pranë kësaj teqeje (Foto Gj. Stoja)

15. Fenomenet e Rrezikut Gjeologjik

15.1. RREZIQUET NGA LËKUNDJET E TOKËS

Risku sizmik

Në bazë të hartës sizmotektonike të Shqipërisë, (Sh. Aliaj, 1988) rajoni në fjalë bën pjesë në zonën sizmogjene Shkodër-Mat-Librazhd-Korçë me aktivitet sizmik deri në 8 ballë ose me

magnitudë 5.5 deri në 6.0.

Në kuadrin rajonal, linja sizmogjene Shkodër - Peja është një prej epiqendrave më të forta të tërmeteve, që përshkojnë këtë




Fig.– 1 Harta Sizmologjike (Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

segment. Kjo linjë është më shumë se 100km e gjatë dhe vetëm në shekullin e kaluar kanë ndodhur një sërë tërmetesh të forta me aktivitet sizmik deri në 6,6

ballë. Në bazë të përpunimit statistikor për të gjithë të dhënat e tërmeteve të ndodhur në vendin tonë, duke marrë për truell mesatar shkëmbinj të shkriфт si ranor, argjila e suargjila, siç ndodhen në këtë zonë studimi, mendojmë se kemi të bëjmë me intensitet tërmetesh të paktën deri në 7-8 ballë ose me magnitudë 6.0 deri në 6.9. Mbështetur në hartat e rrezikut sizmik në formë propabilitare qyteti i Tiranës dhe rrethinat e tij përfshihen në zonen ku, lëkundjet e truallit me intensitet $I_0=8$ ballë ($PGA=0.2$ g) ndodhin çdo 200-250 vjet.

Tërmetet - Janë rreziqe permanente ndaj veprave inxhinierike, për faktin se janë goditje dhe lëvizje të menjehershme dhe me energji të lartë të tokës mbi themelet e objekteve inxhinierike. Zona në studim bën pjesë në zonën neotektonike kontinentale të vendit tonë, në treven e brendshme me regjim në tërheqje. Kjo zonë karakterizohet nga lëvizje diferenciale të fuqishme gjatë etapës neotektonike me regjim në tërheqje horizontale. Struktura e kësaj zone paraqitet me vargje malore në trajtë horsti të ndara me ultësira në trajtë grabeni. Zona bën pjesë në sektorin jugor, në vargun

lindor që fillon me bllokun e malit të Thatë dhe vijon në jug me blloqet malore të Moravës, Gramozit e Gërmenjit. Në këtë varg vendoset grabeni i gropës së Korçës i rindërtuar në Pliocen-Kuaternar. Në hartën e elementeve të rrezikut të bashkisë, janë hedhur vatrat e termeteve kryesore, të cilat mund të jenë brenda territorit të qarkut, ose në afërsi të tij, por që ka ndikuar në territorin e bashkisë Korçë. Këto tërmete janë klasifikuar si historike (tërmete të rëna që nga lashtësia deri në vitin 1900) dhe tërmete të matur instrumentalisht (tërmete të rëna nga viti 1900 deri sot). Në këtë zonë janë gjeneruar tërmete të forta, si me 18 Shkurt 1911 në liqenin e Ohrit me $M(\text{magnitudo}) = 6.7$ shkallë rihter dhe intensitet $I_0=9$ ballë, më 28 Janar 1931 $M=5.8$ shkallë rihter dhe $I_0= 8-9$ ballë, tërmet tjetër është regjistruar me 26 Maj 1960 me $M=6.4$ shkallë rihter dhe $I_0=8-9$ ballë në Korçë. Me 18 Janar 1958 është regjistruar tërmeti me $M= 4.7$ shkallë rihter




Fig. 2 –Harta e rrezikut gjeologjik, Korçe (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

dhe $I_0=6-7$ ballë. Më 12 Qershor 1995 me $M=3.0$ dhe thellësi 10 km (Koçiaj, S. 1976; Muço, B. 1996).

Duke patur parasysh lidhjen ose jo të elementeve të rrezikut gjeologjik me kriterin morfologjik, elementet e rrezikut gjeologjik i kemi ndarë në dy grupe:

1) Rrezikun që vjen nga aktiviteti tektonik në rajonin e studimit, gjë që reflektohet me sasinë dhe intensitetin e tërmeteve që ndodhin në territor, pavarësisht nga kushtet gjeologo-inxhinierike të trojeve të ndërtimit. Bazuar në këtë kriteri territori është ndarë në 4 nënzona:

- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VI ballë
- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VII ballë
- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VIII ballë
- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet IX ballë

2) Rrezikun që vjen nga fenomenet gjeodinamike të shpateve. Është gama tjetër e fenomeneve të rrezikut gjeologjik të mara në konsiderate, të cilat lidhen ngushtësisht me ndarjet e sektoreve me bazë kriterin morfologjik. Duke patur parasysh edhe shkallën e hartës 1:50.000, dhe për pasojë edhe detajimet që mundëson kjo shkallë, territori është ndarë në tre sektorë, pavarësisht ndarjes në zona dhe nënzona të përshkruara më lart. Këta sektorë janë:

- a. Sektori pa zhvillim të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili përputhet me njësinë fushore. Në hartë, ky sektor paraqitet me ngjyrë jeshile. Pjerrësia e trojeve të këtij sektori nuk i kalon 2^0 . Këtu futet fusha e Korçës, Devollit, Voskopojës, Lubonjës, fushat ndërkodrinore të luginave të rretit të lumenjve Devoll, Osum. Në këtë sektor, me përjashtim të brigjeve të shtreterve aktuale të lumenjve dhe përrenjve, nuk priten as në të ardhmen zhvillime të elementeve të rrezikut gjeologjik. Për këtë arsye, ai konsiderohet si një sektor i qetë dhe jo kërcënues ndaj ndërtimeve që kryhen në të. Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen për ndërtimet e këtij sektori, duhet të jenë të thjeshta dhe të marin në konsiderate vlerësimin e parametrave gjeoteknike të shtresave të tokës.
- b. Sektori me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili i përket njësisë kodrinore dhe malore, por që në të nuk gjejnë përhapje të madhe fenomenet e rrezikut gjeologjik. Në hartë ky sektor paraqitet me ngjyrë të verdhë, duke zënë pjesën më të madhe të territorit të bashkisë. Ndërtimet që bëhen në këtë sektor për momentin janë të pa cenuara, por që në të ardhmen, si rezultat i prishjes së ekuilibrit të shpatit, apo avancimit të zonave nën erozion, pjesë të këtij sektori mund të klasifikohen si sektori me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik. Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen për ndërtimet e këtij sektori, përveç vlerësimit të parametrave gjeoteknike të shtresave të tokës, duhet të japi të dhëna të plota për fenomenet e rrezikut gjeologjik që mund ti kërcënojë këto ndërtime, si dhe të rekomandojë edhe masat mbrojtëse perkatëse, me qëllim eliminimin apo mosaktivizimin e fenomeneve të rrezikut.

- c. Sektori me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili i përket njësisë kodrinore dhe malore, por që në të gjejnë përhapje të madhe fenomenet e rrezikut gjeologjik. Në hartë ky sektor paraqitet me ngjyrë të kuqe. Në hartë, pjesë e këtij sektori, janë konturuar sipërfaqet e rrëshqitjeve të ndodhura e të njohura deri tani, zonat e shëmbjeve




Fig.
- 3
Harta
Aktiv
e e
Shke
putje
ve ne
Shqi
peri
(Buri
mi:
Shër
bimi
Gjeol
ogjik
Shqip
tar)
 (sub
 side
 ncav
 e)
 në
 fush
 at
 mine
 rare
 të

shfrytezuara, si dhe sipërfaqet e zonave nën erozion. Duke patur parasysh dinamikën e shpateve, ky sektor tenton të rritet dhe të fitojë sipërfaqe të reja nga sektori b (Sektori me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, me ngjyrë të verdhë). Në këta sektorë parimi i përgjithshëm është se nuk duhet të ndërtohet, por nëse është e nevojshme, atëherë studimi gjeologo-inxhinierik duhet të jetë shumë i thelluar, ku të jepen të dhëna për

atë çka ka ndodhur dhe të llogariten mirë efikasiteti i masave mbrojtëse që mund të rekomandohen.

Rreziqet nga tektonikat dhe neotektonikat aktive

Nga pikëpamja tektonike, kemi të bëjmë njëherësh me disa zona tektonike të mëdha, që përbëjnë element të madh strukturor në Albanide. Si pjesë përbërëse e saj, rajoni në studim preket nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputjet tektonike janë shume aktive dhe në relief shprehen me kontraste të theksuara. Pasojë e tyre janë dhe levizjet, megjithëse jo të shpeshta sizmike, që trondisin zonën. Si pjesë përbërëse e një strukture neogenike në zhvillim, zona në studim është e prekur nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputja tektonike vepron në kuadrin e regjimit aktiv ngjeshës, por në kohët e sotme Holocenike paraqitet me ritme më të ulta të aktivitetit. Theksojme se, shkëputja origjinet nga thellësia dhe në vetvete shpreh njëherësh dhe aktivitetin sizmik të rajonit.

Linjat tektonike aktive - Krijojnë zona të paqendrueshme në hapësira të gjera, paqendrueshmëri e cila vjen si rezultat i jonjëtrajshmërisë së lëvizjes së blloqeve të ndryshëm të tokës dhe për pasojë ndodhin çedime të diferencuara të trojeve. Edhe pse këto levizje janë shumë të ngadalta, ato mund të bëhen tepër kërcënuese në rastet e ndodhjes së tërmeteve. Tipike janë rrafshi mbihypës i zonës Mirdita mbi depozitimet e zonës së Krasta Cukalit me kënde të butë- mesatarë deri të forte, tektonika rregjionale Gjergjevicë-Gjanç-Floq-maja e Furkës etj. Linja tektonike të cilat janë tepër aktive dhe kërcënojnë një zonë të gjerë rreth saj veprat inxhinierike si banesa, rrugë, tunele, linja tensioni, etj.

Risqe nga lëkundjet e tjera të tokës

Duke u bazuar në ballafaqimin sizmotektonik të mësipërm rezulton se zona e shkëputjeve sizmogjene ka gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojë edhe në të ardhmen tërmete me potencial sizmik të pritshëm $M_{max}=6.0-6.9$.

- Zona në studim ndodhet jo larg nga thyerjet tektonike, që mund të gjenerojnë lëkundje të tokës në formën e tërmeteve;
- Zona në studim ndodhet pranë rezervuarëve e liqeneve ujorë, që mund të shkaktojë lëkundje të tokës;
- Zonat në studim përgjithsisht ndodhen në, mbi dhe pranë tokave të mbushura me dherra të hedhura, që mund të shkaktojë lëkundje të tokës;
- Zonat në studim ndodhen edhe mbi formacione me shkëmbinj magmatik, ku nuk është e mundur të shkarkojnë ujëra nëntokësorë, dhe bëjnë që të mos shkaktohen lëkundje të tokës;

Megjithatë, parimi më i mirë për një investitor është të ndërtojë një godinë të mirë edhe

pranë qendrës së tërmeteve sesa një godinë të dobët larg tij.

15.2. Risku i lëngëzimit të truallit

Procesi i lëngëzimit të truallit ndodh, si në rastet kur formacioni përbëhet ose ndërtohet prej ranorëve ose rërave, dhe në rastet kur ai përbëhet prej argjilave, të cilat në rastet e tërmeteve ose të lëkundjeve të tokës për shkaqet e sipërmendura bëhen shkak për lëvizje të reja subsidente ose lëvizje të tokës në formë rrjedhjeje. Shpesh këto procese lidhen me mungesën e një migrimi anësor të ujërave, duke bërë që të ushtrohet presion për të dalë lart, duke lëngëzuar në këtë mënyrë rërat. Tërmeti i ndihmon akoma më shumë këto procese. Lëngëzimi i argjilave ndodh, kur zëvendësohen porët me ujëra të kripura me ujëra të ëmbla, kur struktura argjilore dobësohet shumë dhe gjatë tërmeteve ose vibrimeve transformohet në masë viskoze, që rrjedh në drejtimin poshtë.

Në rastin tonë përqasen raste nga këto probabilitete, duke i dhënë vlera pozitive ndikimeve prej këtyre parametrave. Megjithatë, investitori duhet të jetë i kujdesshëm në këqyrjen dhe marrjen e masave pararendëse, si në vlerësimin e ngjarjeve të vogla sizmike, çlirimin e gazit radon, ndryshimi i nivelit të ujërave nëntokësorë, sjelljen dhe reagimin e kafshëve, fryrjen e pjerrësive, fryrjen e sipërfaqeve etj.

15.3. Rreziqet nga subsidenca

Subsidenca është e pranishme në rastet kur kemi shfrytëzim të ujërave nëntokësorë ose të trupave të tjerë të lëngët në thellësi të tokës si hidrokarbure etj. Në rastin tonë nuk do të kemi të bëjmë me shfrytëzim të ujërave nëntokësorë, pasi e gjithë zona, ku do të ndërtohet rruga është ujë mbështetëse. Pra, subsidenca nga shfrytëzimi i ujërave do të jetë pothuajse e papërfillshëm dhe nuk do të mund të formohet hinka depressive, për shkak të shfrytëzimit irracional të ujit. Subsidenca do të formohet edhe në rastin nëse do të kishim një formacion:




Fig. 4 – Rreziqet nga ndërhyrjet antropogjene dhe natyrale të brigjeve (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

- mbi sedimente të ngjeshëshme kokrrizimi në argjila, që rrudhen dhe fryhen, të cilat ndryshojnë përbërjen e ujit;
- në dekompozimin e lëndëve organike;
- në nxjerrjen e ujërave të naftës, në miniera, në shembjen e minierave, që shtrihet mbi gëlqerorët që treten me shumë çarje, pranë sipërfaqeve, duke u shfaqur nëpërmjet çarjeve strukturale, çarjeve të sipërfaqeve, prishjeve, shkëputjeve, etj.

Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Zonat që prodhojnë ujëra nëntokësorë ose ato që ndodhen mbi sipërfaqe të shfrytëzuara minerare lidhet me këto mundësi, duke bërë që të mund të preken nga këto ndikime negative.

Rreziqet nga vullkanet

Në rajonin në studim nuk njihen raste të shpërthimit apo të rreziqeve të kanosura prej vullkaneve ose hiri të tyre. Nuk njihen gjithashtu, as ndikimet e tyre, si rrjedhjet argjilore apo gazi helmues etj.

Rreziqet nga tokat

Përhapja e vogël e formacioneve të sotme të Kuarternarit, bimësia e varfër dhe shumë e varfër, relievi pothuajse i coptuar dhe reshjet tipike të zonës favorizojnë siç duhet proceset pedogjenike, për pasojë krijohen mundësi për mosformimin e shtresës së dhéut.

Rreziqet nga Radoni

5-10% e ndërtimeve kanë përqëndrime të rrezikshme të radonit. Ajri i brendshëm në ndërtesa ka 1-2 pci/l. (piko/curie për 1 litër ajër). Ajri i tokës ka 20-100 pci/l. dhe i ujërave nëntokësorë që çlirohet nga toka ka 100-3000 pci/l. Gjysma e zbërthimit të radonit është rreth 4 ditë. 40% e ndotjes me radon përthithet nga toka me shkëmbinjë magmatik ose shiste argjilore, që janë të pasura në silica dhe alumin, si dhe argjilat e zeza të pasura me fosfor që çlirojnë në sasi radonin. Shkëmbinjë të tjerë që çlirojnë radonin janë dhe ata metamorfikë si shiste, gnejse etj. Sa më të mbyllura të jenë ndërtimet aq më përqëndrohet edhe radoni. Përqëndrime më të mëdha janë në dimër se sa në verë për shkak të avullimeve. Përqëndrimet e larta mbi normën e lejuar shkaktojnë kancer në mushkëri. Bazuar në interpretimet e bëra mendojmë se ndotja nga radoni është e shumë e përfillshme, për shkak se treguesit e sipërmendur rezultojnë të jenë pjesëmarrës në formacionin tonë në sipërfaqe e në thellësi, ose në zonat përreth saj. Investitorët duhet të marrin masa, duke bërë zbutjen e saj me anë të izolimit të themeleve, ventilimit të përshtatshëm për raste zyrash apo ndërtimesh, etj.

Rreziqet nga estuaret dhe tokat e lagëta

Zona jonë e studimit nuk ndodhet larg tokave apo brigjeve në kontakt me estuaret dhe tokat e lagura, për pasojë mund të vuajë efektet negativë, që shoqërojnë këto elementë ekologjikë.

Rreziqet nga ndërhyrjet antropogjene dhe natyrale të brigjeve

Zona jonë e studimit ndodhet afër tokave apo brigjeve në kontakt me lumenj e përrrenj, për pasojë mund të vuajnë efektet negativë, që shoqërojnë këtë element ekologjik.

15.4. Rreziqet nga përmbytjet


Brenda sektorit të kërkuar ndodhen me shumicë burime uji, edhe pse sipërfaqja ujëmbledhëse është e madhe. Vetë konfiguracioni i terrenit dhe përbërja formacionale krijon premisa për depozitime uji. Në shumë sektorë të zonës në studim shtrihet formacioni magmatik, me prurje ujore dhe

Fig. – 5 Harta e Rrezikut nga përmbytjet (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

depozitime të kuaternarit me ujë, por që fryhen disi për pellgun ujëmbajtës në rastet e reshjeve të bollshme dhe ndodh që fryhen edhe më. Duke llogaritur përmbytjet për njëzet vitet e fundit mund të ndërtohet harta e rrezikut të përmbytjeve, që sipas shpërndarjes së reshjeve me probabilitet

1% siguri **Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar**

rajoni në studim ndodhet në rasisjen me bollshmëri reshjesh deri në 110mm. Për të gjetur më ekzakhtësisht kalimin e plloteve të lumit që kalon pranë duhet të përdoret metoda e karbonit C-14 në materialet organike, si dhe duke dalluar mbulesat vegetative. Në territorin e bashkisë Korçë gjejnë përhapje shumë elemente të rrezikut gjeologjik, të cilat krijojnë shqetësime dhe dëmtime të veprave inxhinierike që kryhen në këtë territor. Më poshtë po përshkruajmë këto rreziqe, duke dhënë edhe fushëpërhapjen e tyre.



15.5. Rrëshqitjet

Janë një fenomen i përhapur në bashki Në hartën e përhapjes së rreziqeve gjeologjike, janë hedhur rreth 147 rrëshqitje të njojtura, por kjo nuk do të thotë se në këtë territor nuk ekzistojnë rrëshqitje të tjera. Gjithashtu duhet theksuar se territore të ngjashme me ato ku kemi konturuar rrëshqitjet e njohura, janë po aq të rrezikshme sa ato në të cilat ende nuk ka ndodhur rreshqitje, por me krijimin e kushteve edhe ato shpate rrezikohen nga i njeiti fenomen. Nga nje analizë e kryer për të gjitha rreshqitjet e ndodhura deri tani në bashkinë e Korçës, rezulton se 60% e rrëshqitjeve bien në formacionet argjilore, 65% e rrëshqitjeve ndodhen në shpatet me pjerësi 10°-20°, 35% e rrëshqitjeve bien në shpatet e ekspozuar në drejtim nga më të ndryshmet. Rrëshqitjet kanë prekur si shkëmbinj të bazamentit ashtu edhe mbulesën e dherave të Kuaternarit.



Foto -1 Rrëshqitja e Lekas, Korçë.



Foto - 2 Rrëshqitje rruga Korçë- Ersekë.

Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Faktoret kryesore të ndodhjes së tyre janë pasive (ndërtimi gjeologjik, litologjia, struktura, tektonika, etj) dhe aktive (errozioni, përmbajtja e lartë e ujrave nëntokësore, rreshjet e dendura të shiut, ndërhyrjet e njeriut me ndërtime të ndryshme, etj.)


Rrëzimet - Ndodhin në zonën malore atje ku pjerrësia e shpatit i kalon 40 gradë, dhe ku kemi vendosje të shkëmbinjve më të fortë mbi ata më të butë në profilin e shpatit. Situata të tilla janë të shumta në zonat "Mirdita" dhe Krasta-Cukali". Ky fenomen ndihmohet edhe nga zhvillimi i madh i tektonikave bllokore dhe ndrydhëse, të cilat e kanë coptuar së tepërmi bazamentin shkëmbor.

Shembjet - (Ose të ashtuquajturat subsidenca). Përputhen me zonat minerare të braktisura. Klasifikohen si fenomene rreziku më kërcënuese se të gjithë elementet e tjerë të rrezikut gjeologjik. Kanë ndodhur dhe rrezikojnë të ndodhin në fushat minerare qymyrgurore, tashmë të mbyllura të Mborje-Drenove, të bakrit në Rehovë, në guoret e braktisura, punimet ushtarake (strehime, tylene të braktisura) etj. Shfrytëzimi i shtresave të qymyrit dhe xheroreve në thellësi, ka krijuar hapësira boshe nëntokë, të cilat rrezikojnë shembjen e materialit të sipërndodhur dhe për pasojë deformimin e sipërfaqes së tokës nga ai real. Këto janë zona tepër të rrezikshme për

objektet inxhinierike, sepse shembja ndodh në mënyre të menjëhershme dhe vertikalisht. Për pasojë ndodhin çedime nga disa mm deri në disa metra të cilat mund të rezultojnë katastrofike si për veprat inxhinierike, ashtu edhe për banorët. Fenomene të tilla janë evidentuar me kohe në minierën e Mborje Drenovës. Këto zona janë pasqyruar në hartë dhe në asnjë menyrë nuk duhen lejuar ndërtimet mbi to. Edhe në rastet kur ndërtimet janë kryer, duhet të merren masa për largimin e banorëve prej tyre dhe prishjen e këtyre objekteve inxhinierike.

Vatrat e erozionit - Është fenomeni më i perhapur në territorin e bashkisë Korçë. Zona të tëra, kryesisht në fushëpërhapjen e formacioneve argjilore e flishore, janë të prekura nga ky fenomen, i cili nga ana e tij është ndihmuar në një masë shumë të madhe nga shpyllëzimet e shumta që u bënë gjatë viteve 80-90 të shekullit të kaluar. Erozioni shfaqet në formën e dy tipeve kryesore: erozion sipërfaqësor dhe erozion fundor. Erozioni sipërfaqësor prek zona të mëdha të fshatrave të rëzës së fushëgropës së Korçës në luginën e I.Dunavec e I.Devoll. Në këtë territor ndeshen dalje të fuqishme të formacioneve litologjike molasike e flishore argjilore. Ekspozimi ndaj faktoreve ekzogjene të alterimit, si rezultat i mungesës së pyjeve natyrale, bën që sipërfaqe shumë të gjera të

Fig. – 6 Harta e Vulave te Erozionit (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)



denudohen me shpejtësi të frikshme. Si rezultat i rënies së shirave me intensitet të lartë, bëhet largimi i menjëhershëm i materialit të shkatëruar dhe krijimi i kushteve për avancimin në thellësi të proceseve alteruese të shkëmbinjve rrënjësorë. Erozioni fundor zhvillohet më së shumti në

Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

fushëpërhapjen e flisheve të zonës “Krasta-Cukali” mekanizmi në këtë rast është krejt i ndryshëm nga ai i përshkruar për erozionin sipërfaqësor. Në rastin e erozionit fundor ndodh që pakot litologjike me fortësi të lartë (gëlqerore e ranore) të vendosen në kuota hipsometrike më të larta se ato më të buta (argjilat). Për këtë shkak në rast rreshjesh të bollshme coprat e shkëmbinjve të fortë lëvizin nëpër shpate dhe sidomos në shtretërit e përrrenjve e perroskave që kalojnë në shkëmbinj argjilo-alevrolitore, duke punuar mbi ta sikurse gurët zmerile. Në këtë mënyre ata bëjnë thellim të shtretërve të tyre me shpejtësi të madhe dhe i bëjnë të paqëndrueshëm shpatet anësore të tyre. Në këtë rast krijohet një proces zinxhir midis erozionit dhe fenomeneve të rreshqitjeve duke u kombinuar me njeri - tjetrin dhe duke qënë shkaktare të njeri- tjetrit.

Shtretërit e lumenjve - Janë trajtuar si fenomene rreziku gjeologjik për vetë natyrën e tyre të paqendrueshme. Kjo natyrë rrjedh nga dy aspekte:

1. përberja litologjike, e cila në shumicën e rasteve është e tipit dhera pa kohezion; dhe
2. prezenca e lartë e ujrave rrjedhës sipërfaqësore, të cilët kanë energji e cila varet nga stadi i zhvillimit të lumit dhe nga sasia e rreshjeve që bie në territor.

Këto zona (shtretërit e lumenjve) përbëjnë rrezik për veprat inxhinierike të ndërtuara mbi to, por në raste të veprave rrugore ato kalohen me ura, vitet e fundit janë ndërtuar dhe duke u ndërtuar disa H/C, ato ndodhen nën kërcënim të vazhdueshëm të këtij elementi rreziku.

Kone depozitimi - Janë trajtuar si fenomene rreziku dhe janë konturuar në territorin bashkisë dy tipe konesh depozitimi: deluviale dhe proluviale. E përbashkëta e tyre është grumbullimi në territore jo shumë të gjera i coprave me rrumbullakim të keq, të cilat shpesh ndodhen në kufijte e ekuilibrit natyror, i cili mund të prishet nga çasti në çast. Konet e depozitimit me origjinë deluviale (Fig. IV.3) lokalizohen në fundet e shpateve të ndërtuara nga shkëmbinj të fortë dhe mund të kenë pamje të brekçieve të shpatit apo të koluvioneve. Këto formime përbejnë një rrezik të vazhdueshëm për objektet inxhinierike të ngritura përgjatë, sipër apo poshtë tyre. Rreziku rritet edhe më tepër kur ato janë relativisht me moshe të re (lëvizjet e reja neotektonike) dhe të pa çimentuara me llumra gëlqerore apo argjilore. Konet e depozitimit me origjinë proluviale janë bazamente shumë të mira për ndërtimet (përberja e tyre litologjike gëlqerore apo shkëmbinj të tjere me fortësi të madhe), por që janë pre e rrezikut të madh të shkatërrimit të tyre si rezultat i prurjeve të menjehershme dhe të bollshme në kohe rrebeshesh. Këto prurje duke qënë të përbërë nga shkëmbinj të fortë dhe duke patur energji shumë të lartë, shkatërrojnë çdo gjë që gjejnë përpara duke përfshirë edhe objektet inxhinierike që gjenden aty.

Zonat karstike - Këto zona rreziku gjeologjik shfaqen në fushepërhapjen e shkëmbinjve gëlqerore. Tipik është masivi gëlqeror Vithkuq-Rehove (Rungajë), mali i Kuq, mali i Bardhe, në të cilin shfaqen në mënyrë të theksuar pasojat e një procesi karstik që ka prekur shkëmbinj të si në sipërfaqe ashtu edhe në thellësi. Në sipërfaqe shfaqet një relief tipik karstik me gropa, hinka, puse dhe fusha karstike, të cilat shpesh kamuflohen nga mbushje deluvionesh me përberje dherash të shkëmbinjve. Në brendësi të masivit zhvillohen hapësira karstike të fshehta, të cilat e bëjnë të paqendrueshëm truallin që reflektohet në sipërfaqe dhe nga çasti në çast ky truall mund të pësojë levizje vertikale nga lart- poshtë.



Foto – 3 Kon depozitimi Gryka e Boboshticës
Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar



Foto - 4 Errozioni sipërfaqësor

16. Burimet ujore

16.1. KUSHTET HIDROGJEOLOGJIKE TË QARKUT KORÇË

(UJËRAT NËNTOKËSORE)

Në qarkun e Korçës kanë përhapjen akuiferë të llojeve të ndryshme. Sipërfaqen më të madhe në shkallë qarku e zënë, jo akuiferët në masën 31% të gjithë sipërfaqes së tij. Akuiferët karbonatik karstik zënë rreth 19% të gjithë sipërfaqes së tij. Ato ndërtojnë pjesët më të larta malore si mali i Thatë, Rakickës, etj. Akuiferët karbonatikë karstikë përmbajnë burime ujore nëntokësore të mëdha. Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor, kanë përhapje më të kufizuar dhe shtrihen në zonat fushore, si fushë-gropa e Korçës me një lartësi mesatare 820-850m mbi nivel të detit. Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri mesatare përhapen në rreth 9.4% të territorit të qarkut. Edhe këto akuiferë përmbajnë burime ujore nëntokësore të rëndësishme. Në figurën e mëposhtme jepen sipërfaqet e tipeve të ndryshme akuiferë në qarkun të Korçës.




Fig. 1 - Sipërfaqet e akuiferëve sipas llojeve (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

1. Akuiferë me porozitet ndërkorrizor e ujëmbajtje mesatare (13%),
2. akuifer me porozitet poro/çarje dhe ujëmbajtje mesatare deri të ulët (25%),
3. akuifer me porozitet çarje me ujëmbajtje mesatare deri të ulët (12%)
4. akuifer me porozitet çarje-karst me ujëmbajtje shumë të ndryshueshme-shumë e lartë-e ulët (19%) dhe
5. joakuifer me porozitet të pamjaftueshëm për të lejuar qarkullimin e ujit nëntokësorë në sasi të shfrytëzueshme (31%).




Fig. 2 – Hartë hidrogeologjike e rajonit Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

16.2. AKUIFERËT ME POROZITET NDËRKOKRRIZOR

Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor (të shkrifët) me ujëpërcjellshmëri mesatare deri të ulët, lidhen me depozitimet kuaternare aluviale, liqenore të formuara nga depozitimet e lumenjve si Devolli dhe Dunaveci, depozitime të cilat ushqehen si nga lumenjtë e sipërpërmendur, ashtu edhe nga akuiferët karstik dhe me çarje. Ata janë njëstresorë dhe me ujëpërcjellshmëri të ulët si në Pogradec. Vetëm në fushën e Devollit janë me nivel të lirë, kurse i gjithë akuiferi i Korçës është me presion me vetëderdhje. Ky akuiferë është i pasur me burime ujore nëntokësore, dhe shërben për furnizim me ujë të pijshëm të Bashkive Korçë, Maliq dhe të shumë komunave. Ujërat nëntokësore shfrytëzohen me anë të shpimeve, prurjet e të cilave variojnë nga 1 në 12-45 l/s. Vetitë fiziko-kimike të tyre në përgjithësi janë të mira, ato janë të ëmbla e me fortësi mesatare. Shtimi i rezervave të shfrytëzueshme mund të bëhet, mbështetur në menaxhimin e integruar të tyre në zonën Turan- Bulgarecit.

Akuiferi i Korçës

Akuiferi i Korçës bën pjesë në gropat e brendshme të Shqipërisë dhe quhet ndryshe fusha e Korçës dhe Devollit, dhe është klasifikuar me ujëmbajtje mesatare. Ai përbëhet nga depozitimet aluviale të lumit Devoll dhe Dunavec, ku lumi Devoll ka një gjatësi të përgjithshme (196 km)




Fig. 3 - Profili gjatësor i akuiferit me porozitet ndërkokrrizor me ujëpërcjellshmëri mesatare i Korçës (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

dhe prurje mesatare shumëvjeçare në derdhje në lumin Seman rreth $49.5\text{m}^3/\text{s}$. Trashësia e aluvioneve e përqendruar në 4-8 nënakuiferë shkon nga 5-20m sipas të dhënave të shpimeve (Gelaj, A, Mamaj, A etj, 2003). Ujërat që lidhen me këtë akuifer, janë ato që kanë përhapje pothuajse në të gjithë ultësinë e Korçës. Ky akuifer përbëhet nga disa nën akuiferë.




Fig. 4 – Hartë hidrogjeologjike e rajonit Korçë në shk. 1:200,000 (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Ujrat nëntokësor përqëndrohen në 4 - 8 horizonte zhavorore-zhuresh (me përzjerje të vogël rëre) në jug deri në qendër të strukturës dhe rërash (me përzjerje zhuri) në sektorin verior dhe veriperëndimor. Kolektor i këtyre ujërave është vetë ultësira e Korçës. Rreth 80 % e shpimeve japin ujë me vetëderdhje, prurjet e të cilave arrijnë deri në 10-57 l/sek. Në sektorët jugor koeficientët e ltrimit, prurjet specifike, kanë respektivisht këto vlera esatare: 4 m/ ditë dhe 0,3 l/sek/m. Duke u larguar për në qendër të ultësirës parametrat e mësipërm pësojnë një rritje të theksuar duke pasur vlerat 15-64 m/ditë dhe 2-5 l/sek/m. Në pjesën veriore vërehen përsëri ulje të këtyre parametrave duke arritur 3-28 m/ditë dhe 0.3-1.4 l/sek/m. Ujëdhënia e puseve me vetëderdhje luhetet në vlerat 0.5-5 l/sek deri në 20-57 l/sek. Gradienti hidraulik (I) për horizontin I-IV ka vlerën 0.02. Rryma natyrale nëntokësore jugore rezultojnë 520m³/dite. Drejtimi kryesor i lëvizjes së rrymës ujore nëntokësore, rezultojnë të bëhet nga jugu në veri. Ushqimi i ujërave nëntokësore në ultësirën e Korçës bëhet për llogari të infiltrimit të reshjeve atmosferike, në sektorët jugor të ultësirës dhe në ato sektorë ku horizontet ujëmbajtëse dalin pothuajse në sipërfaqe dhe akuiferët e tjerë në verilindje.

Ujërat nëntokësore artezianë kanë veti fiziko-kimike të mira. Në këtë akuifer janë llogaritur shtim i kapaciteteve ujore nëpërmjet burimeve dinamike $Q_d=430-512$ l/s

Akuiferët e shkrifët me ujëpërcjellshmëri të ulët

Në këtë akuifer me ujëpërcjellshmëri të ulët janë klasifikuar akuiferi i Fushës së Korçës dhe një pjesë e fushës së Devollit. Këto akuiferë lidhen me depozitimet Kuaternare të përbëra nga zhure, brekçie shpatore, etj. Lidhja hidraulike e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nuk është e mirë. Rezervat e shfrytëzueshme në këto akuiferë janë të pakta. Ata shërbejnë për furnizim me ujë të pijshëm të komuniteteve të vegjël. Shfrytëzimi realizohet me anë të burimeve dhe në depozitimet lumore e konuset e derdhjes edhe me anë të shpimeve. Vetitë fiziko-kimike të tyre në përgjithësi janë të mira, ato janë të ëmbël e me fortësi të ulët. Prurjet e puseve me vetëderdhje janë $0.2-1$ l/sek, prurjet specifike variojnë $q=0.06-1.9$ l/sek/m. Koeficienti i filtrimit varion vlerat $0.5-1$ m/dite. Rezervat e shfrytëzueshme në këto akuiferë bëhen nëpërmjet burimeve dhe shpimeve. Akuiferët janë me presion dhe në disa zona kanë karakter artezian. Përdoren për furnizim me ujë të pijshëm të komuniteteve të vegjël. Deri në thellësi 300 m ujërat nëntokësore janë të ëmbla e me fortësi mesatare deri të madhe. Më në thellësi ato kalojnë në ujëra të kripura. Ujërat nëntokësore të këtij akuiferi nga ana e vetive fiziko – kimike përgjithësisht janë të mira, pa ngjyre, pa ere, pa shije dhe me një temperaturë deri me 16°C , mineralizimi i përgjithshëm ka vlera $0.445 - 0.55$ gr/litër, ndërsa fortësia e përgjithshme luhatet në vlerat $14 - 18^{\circ}$ gjermane. Në baze të përbërjes kimike, ujërat e mësipërme janë të tipit hidrokarbomat kalciumi me përzierje hidrokabonat – kalçium – magneziumi. Ushqimi kryesor i këtyre ujërave behet për llogari të infiltrimit të reshjeve atmosferike duke patur këtu një përputhje të zonës së ushqimit me zonën e shtrirjes së akuiferit që po përshkruajmë. Rëndësia e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore të akuiferit, duke pasur për bazë shkallën e vogël të ujëmbajtje së tij nuk e kalojnë rëndësinë me karakter lokal.


Akuiferi Morave etj. Ky akuifer ka shtrirjen e vet në sektorët lindore të ultësirës në malin e Moravës, me disa vende në jug të ultësirës dhe në disa sektorë shumë të kufizuar në Malin e Thate. Depozitimet ujëmbajtëse këtu janë konglomeratet bazale ranorët etj. Pjesa më e madhe e burimeve të këtij horizonti që dalin në malin e Moravës kanë prurjet e tyre që luhaten nga $0.1 - 1.5$ l/sek. Në sektorin e minierës së qymyrit të Mborje – Drenovës nga ranorët dalin burime me prurje $0.03 - 0.1$ l/sek, por duhet theksuar që takohen edhe burime me prurje deri në 6 l/sek. si burimi i Dishnicës. Nga pikëpamja e vetive fiziko – kimike këto ujëra janë të freskëta, pa ngjyre, pa ere, me një temperaturë $11 - 13^{\circ}\text{C}$, mineralizimi i përgjithshëm luhatet nga $0.345 - 0.482$ gr/litër. Fortësia e përgjithshme ka vlera $11 - 14^{\circ}$ gjermane. Ushqimi i horizontit ujëmbajtës që po përshkruajmë bëhet për llogari të infiltrimit të reshjeve atmosferike, në vende ku horizonti ujëmbajtës del në sipërfaqe dhe nga ujërat nëntokësore të formimeve rrënjësore të tjera. Pra në këtë akuifer kemi burime Dinamike rreth $Q=150$ l/s.

Akuiferët me porozitet çarje

Në këtë akuifer kemi klasifikuar shkëmbinjtë magmatik dhe metamorfikë, por kryesisht ultrabazikët. Shkëmbinjtë ujëmbajtës të këtij kompleksi janë serpentinitet, peridotitet nëpër çarjet e të cilëve qarkullojnë ujëra nëntokësorë nga kuotat e larta në kuotat më të ulta. Shkalla ujëmbajtje së shtresave të këtyre shkëmbinjve është jo uniforme dhe në vartësi të çarshmërisë së tyre. Pothuajse gjatë të gjithë kontaktit të shkëmbinjve ultrabazike në ultësirën e Korçës takohen burime me prurje që luhaten në vlerat nga 0.1-3l/sek.

Fig. 5 – Hartë e përshkueshmërisë së ujërave nëntokësorë (Burimi: UNDP, S. GUR⁶)


Ujërat nëntokësorë të shkëmbinjve ultrabazike nga ana e vetive fiziko – kimike janë të freskëta, pa ngjyre, pa ere, transparentë, me një temperaturë që luhatet nga 11 – 14°C. Mineralizimi i përgjithshëm luhatet nga 0.176 – 0.436 gr/litër. Fortësia e përgjithshme ka vlera 11 – 15°gjermane. Ujërat nëntokësorë të depozitimeve janë të tipit hidrokarbonat – magneziumi. Ushqimi i këtij kompleksi bëhet kryesisht për llogari të reshjeve atmosferike në sipërfaqen e shtrirjes së tij. Në periudhën me reshje të shumta prurjet e burimeve shtohen, ndërsa në periudhën e thatë si pasojë e mungesës së reshjeve, debiti i burimeve ulet në mënyrë të ndjeshme. Ky akuifer ka një përhapje që nga Luarasi, Stratobërdha, Masivi i Orenit dhe në një pjesë e Vallamarës. Ujërat nëntokësorë të shkëmbinjve ultrabazike kanë rëndësi vetëm për furnizim me ujëra nëntokësorë të qendrave të vogla të banimit deri komuna. Pra në këtë akuifer kemi burime Dinamike Q=150 l/s.



⁶ S. GURI, UNDP, Vlerësimi Mjedisor dhe Rehabilitimi I 'Hot Spoteve' Shqiptarë, 2012

Akuiferët me porozitet çarje- karst

Akuiferët e çarë e karstikë me ujëpërcjellshmëri² që ndryshon në kufij shumë të gjerë, vende-vende me vlera shumë të larta të saj, lidhen me shkëmbinjtë karbonatikë të Triasikut. Tipi i këtij akuiferi ka përhapjen të konsiderueshme në qarkun e Korçës dhe shtrihen në një sipërfaqe prej 666.15km², e përkthyer në përqindje për sipërfaqen që zë ky akuifer në qark rreth 19% e sipërfaqes së tij. Në këto akuiferë fenomeni i karstit është shumë i zhvilluar, e për rrjedhojë ata mbajnë burime ujore të mëdha. Në zonat karstike koeficienti mesatar i infiltrimit të dobishëm shkon deri në 0.6 - 0.7. Sasitë më të mëdha të burimeve ujore nëntokësore drenojnë kryesisht në kuota të ulta me burime sipërfaqësore. Ujërat nëntokësore në këto akuiferë kanë cilësi të mirë dhe përdoren gjerësisht edhe për furnizim me ujë të pijshëm. Nga këto akuiferë furnizohet me ujë të pijshëm shumë njësi, si dhe një pjesë të Korçës me rreth 0.5m³/s. Sasi të tjera të rëndësishme përdoren në industri e në bujqësi.



Ky akuifer ka një prurje dinamike $Q_d=4 \text{ m}^3/\text{s}$. Akuiferët janë shumë vulnerabël ndaj ndotjes njerëzore.

Fig. 6 - Shpërndarja hapësinore e fenomenit karstik (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Nga pikëpamja hidrogjeologjike zonat karstike që rrethojnë ultësirën e Korçës dallohen nga këto veçori: nga infiltrimi shumë i lartë i reshjeve atmosferike dhe nga një ujëpërcjellshmëri e madhe. Ujërat nëntokësore karstike drenojnë drejt kuotave më të ulta duke krijuar dalje natyrore në formën e burimeve me një regjim shumë të ndryshueshëm. Përveç këtij antiklinali të madhe kemi në formë njollash edhe disa akuiferë të vegjël si i Barmashit, Guri i Kuq, Vithkuqit, Vodice etj ku nga secili kemi nga

një burim të konsiderueshëm me prurje $Q=30-100 \text{ l/s}$. Ujërat e këtij akuiferi janë të freskëta, pa ere, pa ngjyre dhe shije me një temperaturë 9-15 °C, mineralizimi i përgjithshëm i ujërave nëntokësore të këtij akuiferi ndryshon nga 0.205 – 0.423 gr/litër, fortësia e përgjithshme luhatet në vlerat 6-14 ° gjermane. Ujërat janë të tipit hidrokarbonat – kalçium dhe me rralle hidrokarbonat – kalçium – magneziumi. Ushqimi i ujërave nëntokësore karstike që lidhen me gëlqerorët masivë të Kretakut dhe të Triasikut në përgjithësi bëhet për llogari të reshjeve atmosferike dhe infiltrimit të ujërave të liqenit të Prespës. Regjimi i prurjes së këtyre burimeve kushtëzohet nga faktorët klimatike dhe hidrogjeologjike. Në periudhat me lagështire kemi një rritje të theksuar të prurjeve të burimeve si rezultat i intensifikimit të rënies së reshjeve dhe të ngritjes së nivelit të liqenit të Prespës, nëpërmjet çarjeve tektonike që përshkojnë këtë zonë. Duke patur për baze shkallën e madhe ujëmbajtëse të këtij akuiferi, rëndësia e ujërave nëntokësore të tyre për qëllime furnizimi është mjaft e madhe.


16.3. BURIMEVE UJORE DHE BURIMET UJORE SIPËRFAQËSORE(VLERËSIMI I TYRE)

Përveç liqeneve si pasuri ujore e rëndësishme në këtë qark janë edhe lumenjtë si ai i Devollit, i cili përshkon në drejtim tërthor pjesën veriore të ultësirës, prej grykës së Cangonjit në lindje deri në Maliq në perëndim. Lumi i Devollit rreshtohet i dyti për nga gjatësia me 295 km. Ky lumë buron nga malet e Gramozit (jashtë

kufijve të vendit tonë) dhe prej andej futet në luginën e Bilishtit, duke formuar tre terraca. Në bazë të të dhënave të stacionit hidrometrik të Orman – Pojanit, nivelet dhe prurjet minimale të lumit Devoll, në ultësirën e Korçës takohen në muajt Gusht – Shtator dhe kanë respektivisht vlerat 6-2cm dhe 1.88 – 3.11m³/sek, ndërsa vlerat maksimale takohen në muajt

Fig. 7 – Hartë e potencialeve të pritshme ujore

(Burimi :S. GURI, UNDP, Vlerësimi Mjedisor dhe Rehabilitimi I ‘Hot Spoteve’ Shqiptarë, 2012)



Nëntor – Prill dhe kanë vlerat 339 p-416cm dhe 22.9m³/sek. Nga pikëpamja hidrokimike ujërat e lumit Devoll janë të tipit Hidrokarbonat – Kalçium – Magneziumi me një mineralizim të përgjithshëm Mp= 0.3 gr/litër dhe një fortësi të përgjithshme Fp = 11°Gjermane. Lumi i Dunavecit buron në jug të ultësirës së Korçës, në pjesën malore të saj të përbërë nga shkëmbinj ultrabazike dhe gëlqerorë. Tani Lumi i Dunavecit kalon nëpër një

shtrat të ri. Gjatë rrjedhjes së tij nga Jugu në Veri në këtë lumë derdhen degë të vogla të tij si lumi i Kamenicës, i Dersnikut, Voskopit, Drenovës, Dvoranit etj. Regjimi hidrologjik i lumit Dunavec ashtu si dhe lumi Devoll, është në vartësi të plotë të reshjeve atmosferike nivelet dhe prurjet maksimale të këtij lumi takohen në muajin Mars, duke arritur respektivisht vlerat 393-448 cm dhe 6.96m³/sek. Nga pikëpamja hidrokimike ujërat e këtij lumi janë të tipit Hidrokarbonat - Magnezium – Kalciumi me Mineralizim të përgjithshëm M.

Burimet ujore nëntokësore (Vlerësimi i burimeve dinamike të U.N. dhe shfrytëzimi i tyre)

Qarku Korçë është i njohur për burime të Konsiderueshme dinamike të ujërave nëntokësore. Akuiferët karstikë dhe ato ndërkorrizor vlerësohen me ujëmbajtje shumë të lartë-mesatare, dhe paraqesin rëndësi të madhe në furnizimin e qendrave të mëdha të banuara me ujë të pijshëm. Nga burimet karstike furnizohen gjithashtu edhe qytetet e tjera si ai i Devollit, Ersekës dhe një pjesë e Korçës. Nga akuiferët Kuaternare furnizohet me ujë qyteti i Korçës nga pusët e Turanit në sasinë Q=300 l/s dhe të gjitha komunat që e rrethojnë fushë-gropën e Korçës. Në këto akuiferë janë kryer edhe një numër i madh shpimesh “ilegalë” që shfrytëzohet nga persona privatë. Sasitë e tyre nuk janë të evidentuara. Burimet ujore shfrytëzohen gjerësisht dhe në bujqësi për vaditje. Disa nga kaptazhet, kryesore që përdoren për furnizim me ujë të pijshëm në mënyrë të përqëndruar janë dhënë në tabelën (Tab. III.c.2.1

Vendndodhja	Sasia	që Pika ujore
Emërtimi	l/s	Burim


Tab. Turan-Korçë	300	shpim
Vreshtas-Podgorie	8	shpim
Sheqeras-Korçë	4.5	shpim
Bulgarec-Korçë	100	shpim
Vloçisht-Korçë	3	shpim
2km në P.të lagjes Greluos-Vithkuq- Korçë	30-40	burim
Në qender të fshatit Kapshtice	10-14	burim

Shfrytëzimi kryesor i burimet dinamike për furnizim me ujë të pijshëm

Akuiferi	Burimet dinamike të UN,	Shfrytëzimi i UN	Përdorimi
Akuiferi i poroz i Korçës	0.51	0.	Furnizim me ujë të
Akuiferi poro-çarje i Gorë-	0.1	0.0	Furnizim me ujë të
Akuiferi çarjesh i Valamare-	0.1	0.	Furnizim me ujë të
Jo akuifere	0.0	0.0	Furnizim me ujë të
Shuma	4.83	1.1	

Tab. – 2 Burimet dinamike të UN dhe përdorimi i tyre për furnizim me ujë të pijshëm

Siç shihet edhe nga tabela burimet e përgjithshme dinamike në qarkun e Korçës vlerësohen minimalisht m^3/s (pasi burimet janë marre me prurjet minimale). Rezerva që mund të përdoren për furnizim me ujë të pijshëm janë edhe rreth $3.712m^3/s$, kryesisht nga akuiferi **Fig. 8 – Hartë e përshkueshmërisë ujore të shkëmbinjëve sipërfaqësore (Burimi : S. GURI, UNDP, Vlerësimi Mjedisor dhe Rehabilitimi I ‘Hot Spoteve’ Shqiptarë, 2012)**



4.832

karstik.

në:

Presionet mbi akuiferët

Presionet mbi akuiferët e qarkut Korçë janë përqëndruar

- Kërkesën më të madhe për burimet ujore (bujqësia dhe turizmi) në periudhën e thatë (qershor-shtator), kur disponibiliteti i burimeve të ujërave nëtokësore është më i ulëti;
- Rritjen e vazhdueshme e të pa pakontrolluar të një numri të madh shpimesh privatë për furnizim me ujë pijshëm dhe industri;
- Shfrytëzimi pa kriter i shumë shpimeve të vjetër e të rinj të kryer në akuiferë me presion;
- Ritmet e larta të urbanizimit në zonën fushore, sidomos në dy dekadat e fundit.




Fig. – 9

Hartë hidrografike e rajonit të Pogradecit (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

16.4. Burimet ekzistuese të ndotjes

Karakteristikat e përgjithshme të këtyre ujrave janë paraqitur këtu poshtë:

- Turbiditet i lartë, meqënëse regjimi i rrjedhjes është i rrëmbyer, ujrato transportojnë sasi të mëdha lëndësh në suspension.
- Ndotje bakteriale e lartë. Ndotja e shkaktuar nga njeriu ose industria është praktikisht ekzistente.
- Temperatura e ulët. Këto ujra e kanë origjinën nga burime ose nga shkrrja e borës ose e akullnajave.
- Tregues ngjyrë të ulët. Këto ngjyra nuk kanë kohë të tresin lëndët vegjetale, të cilat janë burimi kryesor i ngjyrës.

Ndotja e ujit të pijshëm

Në rajonin në studim, në adresë të sigurimit të shëndetit publik, mjaft e rëndësishme është cilësia e ujit të pijshëm. Por, ky ujë nuk shfaq probleme higjieno-sanitare, sepse kemi:

- Furnizimi me orar të pakufizuar, duke siguruar presion konstant të ujit;
- Jo Amortizim të rrjetit ujësjellës;
- Ndërhyrjet nuk janë pa kriter në tubacionet e ujësjellësve;

Por nga ana tjetër mund të shfaq së shpejti problem sanitare për shkak se:

- kemi ruajtje të dobët të brezave të mbrojtjes sanitare të vendburimeve ujore për shkak të ngritjes mbi to të ndërtesave apo mbjelljes së tokës fare pranë burimit, duke përdorur edhe shumë kimikate;
- klorinimi më shumë seç duhet i ujit;

Të gjithë këta faktorë bëjnë që shëndeti publik të jetë nën kërcënimin e vazhdueshëm të përhapjes së sëmundjeve me rrugë hidrike. Nga ana tjetër, në rajonin në studim mungojnë pjesërisht ose tërësisht të dhënat nga ekzaminimet bakteriologjike të ujit, për shkak të mungesës së laboratorëve dhe personelit.

Kriteret e vlerësimit global të cilësisë së ujrave sipërfaqësorë

Këto kriteret jepen në pasqyrën përmbledhëse e cila fikson 5 klasa cilësie sipas përdorimit që duhet të kënaqin ujrat sipërfaqësorë. Çdo klasë përmbledh vlerat e shumë parametrave.

- **Klasa 1A** - Ajo karakterizon ujrat të konsideruara të paprekura nga ndotjet, të afta të kënaqin përdorimet më ekzigjente. Zakonisht këto ujra kanë ngjyrë blu.
- **Klasa 1B** - Të një kualiteti pak më të ulët këto ujra gjithashtu mund të kënaqin të gjitha përdorimet. Ngjyra e tyre është e gjelbër.
- **Klasa 2** - Kualiteti i këtyre ujrave mund të konsiderohet i pranueshëm për ujitje, përdorime industriale si dhe për prodhimin e ujit të pijshëm pas një trajtimi shumë të avancuar. Pirja për kafshët në përgjithësi është e lejuar. Peshqit aty jetojnë normalisht por riprodhimi i tyre nuk është gjithmonë i garantuar. Aktivitetet çlodhëse janë të mundura vetëm në qoftë se kontakti me ujin ndodh për arsye të jashtë zakonshme. Ngjyra e tyre është e verdhë.
- **Klasa 3** - Cilësia e këtyre ujrave është mediokre; e aftë vetëm për ujitje, për ftohje dhe për lundrim. Në këto ujra mund të ekzistojë jeta e peshqve por ajo mund të zhduket në periudhat e prurjeve të vogla dhe të temperaturave të larta. Ngjyra e tyre është e kuqe.
- **Jashtë klase** - Këto ujra i kalojnë vlerat maksimale të lejuar në klasën 3 të aftë për një ose disa parametra. Ato konsiderohen të papërshtatshme për pjesën më të madhe të përdorimeve dhe mund të përbëjnë një rrezik për shëndetin e njerëzve dhe për mjedisin. Ngjyra e tyre është e zezë.

	PARAMETRAT	1A	1B	2	3
OX	Konduktiviteti $\mu\text{s}/\text{cm}$ në 20°C	≤ 400	400-750	750-1500	1500-3000
	Temperatura	≤ 20	20-22	22-25	25-30
	ph	6.5-	6.5-8.5	6-9	5.5-9.5
	LS ($\mu\text{g}/\text{l}$)	8.5	≤ 30	≤ 30	30-70
	O ₂ i tretur ($\mu\text{g}/\text{l}$)	≤ 30	5-7	3-5	Të ruhet
	O ₂ i tretur në % të ngopjes	> 7	70-90	50-70	gjithmonë
		$> 90\%$			mjedis aerobik
	DBO ₅ ($\mu\text{g}/\text{l}$)		3-5	5-10	10-25
Oksidueshmëria ($\mu\text{g}/\text{l}$)	≤ 3	3-5	5-8	40-80	

	DCO (µg/l)	≤3 ≤20	20-25	25-40	
N	NH ₄ (µg/l)	≤0.1	0.1-0.5	0.5-2	2-8
	NO ₃ (µg/l)			<44	44-100
	N _{total} (Kjedahl)	≤1	1-2	2-3	
T	Fe (µg/l)	≤0.5	0.5-1	1-1.15	
	Mn (µg/l)	≤0.1	0.1-0.25	0.25-0.50	>1.7
	F (µg/l)	≤0.7	0.7-1.7	0.7-1.7	>1
	Cu (µg/l)	≤0.02	0.02-0.05	0.05-1	
	Zn (µg/l)	≤0.5	0.5-1	1-5	>5
	As (µg/l)	≤0.01	≤0.01	0.01-0.05	>0.05
	Cd (µg/l)	≤0.00	≤0.001	≤0.001	>0.001
	Cr (µg/l)	1	≤0.05	≤0.05	>0.05
	CN (µg/l)	≤0.05	≤0.05	≤0.05	>0.05
	Pb (µg/l)	≤0.05	≤0.05	≤0.05	>0.05
	Se (µg/l)	≤0.05	≤0.01	≤0.01	>0.01
	Hg (µg/l)	≤0.01	≤0.0005	≤0.0005	>0.0005
	Fenolët (µg/l)	≤0.00	≤0.001	0.001-0.05	0.05-0.5
	Detergjente (µg/l)	05	≤0.2	0.2-0.5	>0.5
S.E.C. (µg/l)	≤0.2 <0.2	0.2-0.5	0.5-1	>1	
B	Koliformët (të numëruar për 100ml)	≤50	50-5000	5000-50000	
	Esch.Coli (të numëruar për 100ml)	≤20	20-2000	2000-20000	
	Strep.fek (të numëruar për 100ml)	<20	20-1000	1000-10000	
1B	Ndryshimi midis treguesit biotik në raport me treguesin normal	1	2 ose 3	4 ose 5	6 ose 7

Tab. – 3 Parametrat dhe klasifikimi i ujërave sipërfaqësor (Burimi: Standardet dhe normat e shkarkimit të lëngjeve në mjediset e jashtme)

Pasqyra përmbledhëse

- Cilësia e një uji varet nga një sërë parametrash (temperatura, amoniaku NH₄, mercuri Hg).
- Zakonisht cilësia e një uji përcaktohet nga parametri i matur më i disfavorshem.
- Kjo cilësi, sipas vlerave të përcaktuara në pasqyrë, arrihet në jo më pak se 10% të matjeve më të këqija të këtij parametri.

16.5. UJI I PIJSHËM

Qyteti i Korçës ka një furnizim me ujë të pijshëm nga më të mirët në Shqipëri si përse i përket burimeve, kohëzgjatjes (24 orë) ashtu edhe për rrjetin e shpërndarjes dhe sasisë për banorë (direktiva 11 evropiane për ujin është 200l/d/b). Gjatësia e këtij rrjeti arrin në rreth 120km ka mundësuar uljen e humbjeve në rrjet, përmirësimin e stacionit të pompave si dhe sasinë e depozitimit. Ky furnizim me ujë i qytetit të Korçës realizohet nga ujësjellësi qytetit i ndodhur në fshatin Turan ku është ngritur dhe stacioni i pompave. Në tërësi janë 4 puse arteziane të cilët janë rreth 150 m të thellë, nga të cilët një ndodhet në fshatin Turan, ndërsa tre të tjerët poshtë fshatit Porodinë. Puset janë të rrethuar dhe hermetikë. Nga këta puse për arsye shfrytëzimi sa më racional, dy janë në shfrytëzim ndërsa dy të tjerët janë lënë rezervë. Në puset e qytetit merren mostra 2-3 herë në vit direkt në pus. Uji kalon nga këto puse nga stacioni i pompave të Turanit ku bëhet dhe klorinimi i ujit. Që atje me pompa ngjitet në depot e ujit në kodrat e qytetit dhe me anë të rrjetit, i cili është brenda çdo parametri, hermetik me tubacione që janë shtrirë në të gjithë qytetin e Korçës nga ku shpërndahet uji. Tubacionet janë të reja bashkëkohore dhe përveç qytetit të Korçës kanë shtrirje dhe në 2 fshatrat përreth si Turani dhe Cifligu të cilët furnizohen nga rrjeti i qytetit të Korçës. Ujësjellësi monitorohet çdo dite nga ana e drejtorisë duke marrë mostra uji në 16 pika, nga të cilat 15 pika janë fikse dhe 1 pikë është e lëvizshme sipas problemeve që paraqesin qytetaret. Ky monitorim bëhet paradite dhe pasdite. Përqindja e klorit del në të gjithë qytetin njësoj pas analizave të përditshme në laboratorin tonë. Në Direktivën Evropiane për Ujin e Pijshëm thuhet që duhen monitoruar përditë dhe në mënyrë të rregullt rreth 48 parametra kimik dhe mikrobiologjik, ndërkohë që aktualisht këtu bëhet një kontroll periodik për një numër më të vogël elementësh. Përveç ujësjellësit, qyteti i Korçës ka edhe 11 çezma me vetërrjedhje, nga të cilat një pjesë janë me një origjinë qindra vjeçare. Edhe atyre ju bëhet analiza çdo tre muaj. Emrat e tyre janë: 1. Shetro 2. Cezma E Amzes 3. Ish Fabrika E Çorapeve 4. Ish-Fabrika E Miellit 5. Papallambro 6. Radamec 7. Lulishtja Shën Mëria 8. Partizani 9. Rr. Pano Xhamballo 10. Rr. Niko Kovaci 11. Rr. Petraç Shamo.

Tabela e ujit të pijshëm –Qyteti i Korçës		
Parametri	Vlerat aktuale (mg/l)	Norma kombëtare (mg/l)
pH	7,9	6,5-8,5
Cl i mbetur	0,1-0,3	>1 mg/l
NH ₄ ⁺	0	Maks 0,05
NO ₂ ⁻	0	>50
NO ₃ ⁻²	1,4	>5
CO ₂ ⁻²	12,2	>500
HCO ₃ ⁻²	267,3	>500

O ₃	1,7	
Fortësia gjermane	13,8°	>20°

Tab. – 4 Tabela e ujit të pijshëm, Qyteti i Korçës (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Po ashtu nga monitorimi dhe analizat, uji i Korçës rezulton pa ndotje bakteriologjike

Pavarësisht që momentalisht situata hidrike dhe pastërtia e ujit të kësaj zonë është e brenda standardeve, sipas UKKO zona ujëmbajtëse kërcënohet nga ndërtimet dhe nga aktivitetet e pakontrolluara në zonë. Kjo ndodh pasi në këto zona të mbrojtura nuk ka masa efektive lidhur me kanalizimet e ujërave, llojin e ndërtimeve dhe destinacionin e tyre dhe për pasojë janë shtuar mbetjet industriale dhe ato urbane duke e kërcënuar pastërtinë e kësaj zone. PPV i qytetit të Korçës duhet të marrë në konsideratë zbatimin e kriterëve lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare dukë kërkuar zbatimin e kriterëve shumë të forta lidhur me llojin e aktivitetëve (depo karburantesh, industri kimike, blegtori, magazina si dhe për shërbime të tjera), lejet e ndërtimit etj. Është e domosdoshme, në bazë edhe të ligjit, që të gjitha këto aktivitete përpara se të marrin lejet dhe të lidhen me rrjetin e ujërave të zeza duhet të paraqesin një projekt lidhur me trajtimin paraprak të mbetjeve dhe të ujërave. Zbatimi i propozuar për zonat e mbrojtura do të ishte një zgjidhje përfundimtare për këtë çështje.

16.6. LUMENJTË

Lumenjtë në qytetin e Korçës janë ai i Drenicës dhe i Dunavecit. Lumi Drenicë, i cili vite më parë kalonte në qytetin e Korçës tani shtrati i tij është devijuar dhe lumi rrjedh në unazën e qytetit. Lumi Dunavec kalon në fund të qytetit të Korçës në pjesën Jug-Perëndimore të qytetit dhe aty ai bashkohet me lumin e Drenicës. Përpara shumë vitesh këta lumenj kanë qenë problematik pasi gjatë vërshimit përmybnin zonat përreth, ndërsa në kohën e sotme niveli i ujërave të tyre ka rënë dhe nuk paraqesin asnjë problem në këtë drejtim për qytetin e Korçës. Gjendja aktuale e këtyre lumenjve paraqitet e kërcënuar nga zhvillimi i aktivitetëve industriale dhe nga hedhja e mbetjeve të ndryshme. Mjaft banorë janë ankuar pasi kanalet ujitëse, që ushqehen me ujë nga këta lumenj janë ndotur dhe për pasojë edhe tokat e tyre, se bagëtia u ka ngordhur si dhe një aromë e keqe pushton zonën në orët e natës. Kjo është më e dukshme sidomos në lagjet 15, 16 dhe 17 të Korçës. Aktivitetet industriale derdhen mbetjet dhe ujërat e tyre të patrajuara në ujërat e lumit të Drenicës si dhe në një kanal tjetër që shkon drejt fshatit Turan. Edhe banorë të Turanit ankohen se përveç erës së keqe, u janë ndotur rrugët dhe tokat dhe për më keq, u kanë ngordhur bagëtia. Në fushën e Turanit ndodhet dhe pellgu ujëmbajtës i ujësjellësit të qytetit të Korçës, ku janë shpuar katër puse që furnizojnë me ujë të pijshëm këtë qytet. Ekspertë të shoqërisë së Ujësjellës-Kanalizimeve Korçë (UKO) shprehin dyshimin se nga infiltrimi i mbetjeve toksike mund të ndotet edhe pellgu ujëmbajtës. Një vit më parë organet e pushtetit vendor dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit kanë pezulluar veprimtaritë industriale në këtë zonë por pezullimi ka qenë i përkohshëm. Gjithashtu një Plan Veprimi për menaxhimin e këtyre lumenjve duhet të merret në konsideratë nga bashkia.

16.7. CILESIA E UJERAVE SIPERFAQESORE/NENTOKESORE VITI 2014

Akuiferi ujëmbajtës Korçë

Monitorohet me 4 shpime në akuiferin zhavoror të Kuaternarit dhe një burim në akuiferin karbonatik: në shpimin nr.3Turan, nr.1v I.Terova, nr.108 Bulgarec, nr.173/1 Sheqeras dhe burimi Mancurisht. Janë kryer tre provemarrje në Qershor, Shtator dhe Nëntor për analiza kimike e mikroelemente.

- Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet është rreth 465 - 500 L/sek, rezervat më të mëdha shfrytëzohen në Turan. **Koeficienti i shfrytezimit varion $K=0.3-0.5$**

Risku i ndotjes është mesatar, favorizuese janë kushtet natyrore të shtrirjes së disa horizonteve ujëmbajtëse në thellësi të ekranizuar ndërmjet tyre me shtresa argjilore. I vetmi burim sipërfaqësor ndotjeje mund të jetë lumi i Dunavecit nga krahu juglindor i akuiferit, kryesisht për horizontin e parë ujëmbajtës i cili si rregull nuk shfrytëzohet.





Foto – 1
Akuiferi Ujëmbajtës, Korce
Rezultatet e monitorimit cilësisë së UN në këtë

akuifer u krye me 4 shpime: Turan, ish-ferma I. Terova, Bulgarec dhe Sheqeras. Janë kryer 15 analiza kimike dhe 3 analiza për mikroelemente. Rezultatet e analizave paraqiten në tabelën nr.8. Duke parë rezultatet e analizave të kryera gjatë vitit 2014 rezulton se UN në

këto zona kanë veti fiziko-kimike e kushteve higjieno-sanitare të mira. Ujrat janë pa erë, pa ngjyrë, pa shije.


Temperatura e ujit T - Temperatura e ujit në tre fazat e monitorimit varion $T= 11.61-14.03^{\circ}$ Celsius, tregues brenda normes (norma 8-15, deri 20°C). **PH i UN** - pH i UN në tre fazat e monitorimit varion 7.04 – 7.89, në vitin 2013 varion nga 7.1 - 8.21, sipas normës së lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është brenda normës së lejuar ($\text{pH} = 6,5-8,5$). Sipas vlerës së pH (përqëndrimi i jonit të hidrogjenit) janë ujra të tipit alkaline të dobët me $\text{pH} = 7 - 9$. Ndryshimet në fazat e monitorimit të vlerave të pH janë të vogla, ato variojnë 0.01-0.17. Vlerat mesatare 5 vjeçare të pH variojnë 7.3 - 7.97 dhe rezultojnë brenda normës. Vlerat e pH për vitet 2010 - 2014 jepen në fig. 85 krahasuar me normat e STASH dhe BE (STASH 6.5 - 8.5, 5 - 9.5, BE 6.5 - 8.5).



Varia në vite e parametrevë të akuaferëve në Korçë
(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Në bazë të raportit në % ekuivalent të anioneve të forta (d) me kationet e forta (a) dhe të dobëta (b) për vleresimin e alkalinitetit, uji i këtij akuiferi është i klases II, janë ujra neutrale, në ujë mbizotëron joni hidrokarbonat.


Fortësia e Përgjithshme Fp - Fortësia e Përgjithshme në tre fazat e monitorimit në shpimet nr.108 Bulgarec, nr.3 Turan, nr.173/1 Sheqeras varion Fp = 13.74 - 16.21 °gj, ndërsa në vitin 2013 varion Fp = 13.58 - 16.6 °gj, tregues brenda normës së lejuar, janë ujra me fortësi mesatare. Në shpimin nr.1v I.Terova fortësia e përgjithshme varion Fp = 20.1 - 20.66 °gj, në vitin 2013 varion Fp = 20.16 - 20.58 °gj, uji është i fortë. Në burimin e Mancurishtit në tre fazat e monitorimit Fp varion Fp = 16.35 - 18.2 °gj, në vitin 2013 varion Fp = 16.38 - 17 °gj, është ujë i fortë. Norma e ujit të pijshëm është 10 - 20 °gj dhe maksimale e lejuar 25 °gj. Ndryshime e Fp në fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë nga 0 - 0.03 - 2.57 °gj. Vlerat e Fp për vitet 2010 - 2014 krahasuar me standartin STASH (10 - 20, 25 °gj PML), trendi i Fp nuk ka rritje të konsiderueshme, vërehen ndryshime stinore më të theksuara te shpimi nr.173 Sheqeras. Fortësia mesatare varion Fp = 13.99 - 20.45 °gj.



Tab. – 6 Diagrama e ecurise në vite e parametrut fortësi Gjermane të ujërave të akuaferëve në Korçë
(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Mineralizimi i përgjithshëm Mp - Mineralizimi i përgjithshëm në tre fazat e monitorimit varion Mp = 394.35 – 566.05 mg/l, në vitin e kaluar ai varion Mp = 402.74 - 539.16 mg/l, janë tregues brenda normës së lejuar. Mineralizimi i përgjithshëm ka luhatje në fazat e monitorimit që variojnë nga 0.02 – 18.42 mg/l deri


76.11 mg/l në shpimin nr.173 Sheqeras. Uji është i tipit hidrokarbonat - magnez - kalciumi në Turan dhe hidrokarbonat - kalcium - magnezi në Sheqeras, burimi Mancurisht është i tipit hidrokarbonat - kalciumi. Mineralizimi i përgjithshëm është paraqitur grafikisht për vitet 2010 - 2014, trendi i përgjithshëm nuk ka rritje të madhe. Vlerat mesatare të mineralizimit të përgjithshëm variojnë Mp = 414.45 – 531.32 mg/l.



Tab. -7 *Diagrama e ecurise në vite per përmbajtjen e parametrin te mineralizimit te përgjithshëm të ujërave të akuaferëve në Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Mbetja e thatë Mth- Mbetja e thatë në tre fazat e monitorimit varion varion Mth = 256 - 390 mg/l, ndersa ne vitin 2012 varion Mth = 256 – 390 mg/l, permbajtje mbrenda normës së lejuar (500-1000mg/l). Ndryshimet në tre fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë 4 - 11mg/l deri 43 mg/l në shpimin nr.173/1 Sheqeras.

Përmbajtja e Natriumit Na- Përmbajtja e Natriumit në tre fazat e monitorimit varion Na varion nga 1.15 - 16.33 mg/l, ndërsa në vitin 2013 përmbajtja e Na varion 1.15 - 16.33 mg/l, përmbajtja është brenda STASH R dhe STASH PML. Ndryshimet e Na në fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë 0.02 – 4.32 mg/l. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 1.49 - 18.81 mg/l. Përmbajtja e Na në vite jepet në fig. nr.88 e krahasuar me standartet e STASH dhe BE (20-100, 20-150). Trendi i përgjithshëm i Na është rreth 15-20 mg/l. Vihen re ndryshime të karakterit stinor, më i dukshëm në shpimin nr.3 Turan dhe nr.173/1 Sheqeras. Në shpimin nr.3 Turan vihet re një ulje e vogël e përmbajtjes së Na nga viti 2010 në vitin 2014.




Tab - 8

Diagrama dhe ecuria në vite e përmbajtjes së parametrin Na të ujërave të akuaferëve në Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)


Përmbajtja e Kalciumit Ca - Përmbajtja e Kalciumit Ca në tre fazat e monitorimit varion 35.72 -82.04 mg/l, ndërsa në vitin 2013 varion nga 37.07 – 82.16 mg/l. Përmbajtja më e lartë e Ca në burimin Mancurisht varion 98.8 - 114.23 mg/l, ndërsa në vitin e kaluar varion 98.2 – 104.5 mg/l. Përmbajtja e Ca është brenda

përmbajtjes së rekomanduar dhe PML. Ndryshimet e Ca në fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë 0.38 – 15.34 mg/l. Përmbajtja mesatare 5 vjecare e kalciumit në shpimet varion 34.55 - 68.32 mg/l. Në burimin e Mancurishtit përmbajtja mesatare e Ca është 103.18 mg/l. Përmbajtja e Ca në vite jepet në fig. nr.89 e krahasuar me standartet e STASH dhe BE (75-200, 100). Ndryshimet e përmbajtjes së kalciumit në vite janë të vogla, ato janë të karakterit stinor.



Tab. – 9 *Diagrama dhe ecuria në vite e përmbajtjes së parametrin Ca të ujërave të akuaferëve në Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*


Përmbajtja e Magnezit Mg - Përmbajtja e Magnezit Mg në tre fazat e monitorimit në shpimet nr.108 Bulgarec, nr.3 Turan, nr.1v I.Terova, nr.173/1 Sheqeras varion 21.28 - 57.15 mg/l, ndersa ne vitin 2013 permbajtja e magnezit varion nga 21.28 - 57.15 mg/l, përmbajtja është në përmbajten e rekomanduar deri mbi PML në shpimin nr.1^v I.Terova. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 23.09 - 57.27 mg/l. Në burimin e Mancurishtit përmbajtja e Mg varion 9.78 – 11.12 mg/l, ndërsa në vitin e kaluar varion 11.5-13.38 mg/l, përmbajtja mesatare është 11.55 mg/l, është brenda përmbajtjes së rekomanduar. Ndryshimet e Mg në fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë 0.1-3.32 mg/l. Përmbajtja e Mg në vitet 2010 - 2014 jepet në fig. nr.90 e krahasuar me standartet e STASH dhe BE (20-50, 30-50). Në shpimin nr.173/1 Sheqeras ka luhajtje stinore më të madhe se në shpimet tjera, vlerat e së cilës kane cuar në ndryshime - luhajtje të fortësisë së përgjithshme Fp .



Tab. – 10 *Foto dhe ecuria në vite e përmbajtjes së parametrin Mg të ujërave të akuaferëve në Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Përmbajtja e Hekurit Fe - Përmbajtja e Hekurit Fe në tre fazat e monitorimit varion 0.01 - 0.012 mg/l dhe në vitin 2013 varion nga 0.01 - 0.08 mg/l. Takohet përmbajtje në normën e rekomanduar deri mbi PML në shpimin nr.108 Bulgarec, nr.3 Turan, në burimin Mancurisht. Ndryshimet në fazat e monitorimit variojne 0. 01-


04 mg/l deri 0.11 mg/l në burimin Mancurisht. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 0.02 - 0.052 mg/l. Përmbajtja e Fe në vitet 2010 - 2014 jepet në fig.nr.91 e krahasuar me standartet e STASH dhe BE (0.05-0.3 (0.8) dhe 0.05-0.2). Takohet përmbajtje mbi normë në shpimin nr.173/1 Sheqeras, nr.108 Bulgarec, nr.3 Turan dhe në burimin Mancurisht. Nga grafiku vërehen luhajtje të vogla stinore, tendenca është nën përmbajtjen maksimale të lejuar PML.



Tab. – 11

Foto dhe ecuria në vite e përmbajtjes së parametrit Fe të ujërave të akuaferëve në Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)


Përmbajtja e Amonjakut NH₄ – Në tre fazat e monitorimit takohet përmbajtje NH₄. Në shpimin nr.3Turan në fazën e parë takohet përmbajtje në sasinë nën 0.01mg/l, në fazën e dytë 0.03 mg/l dhe në fazën e tretë 0.01mg/l. Në shpimin nr. 108 Bulgarec takohet përmbajtje në sasinë nën 0.01 mg/l në fazën e dytë, 0.04 mg/l në fazën e parë dhe përmbajtje mbi normë 0.09 mg/l në fazën e tretë. Në shpimin nr.1v I.Terova gjithashtu shfaqja e amonjakut është në 3 analiza në sasinë 0.09 -0.02 - 0.01mg/l, përmbajtje mbi normë në fazën e parë (0.09 mg/l). Në shpimin nr.173/1 Sheqeras përmbajtja në tre fazat e monitorimit është në sasinë 0.01 - 0.01 - 0.04 mg/l nën përmbajtjen maksimale të lejuar PML (norma STASH nuk lejohet, përmbajtja maksimale e lejuar 0.05mg/l, norma BE, përmbajtja maksimale e lejuar 0.1mg/l). Në burimin e Mancurishtit takohet përmbajtje NH₄ në sasinë nën 0.01 mg/l në tre fazat e monitorimit. Përmbajtja e Amonjakut NH₄ jepet në fig. nr.92 e krahasuar me standartet e STASH dhe BE (0-0.05, 0-0.5). Përmbajtja mesatare 5 vjecare e Amonjakut NH₄, varion 0.005 - 0.13 mg/l, përmbajtje më e lartë është në shpimin nr.108 Bulgarec. Në vite vihet re shfaqje e ndotjeve me amonjak në shpimin nr.3 Turan, në shpimin nr.173/1 Sheqeras, në shpimin nr.108 Bulgarec takohet përmbajtje amonjaku në disa analiza në vite deri përmbajtje mbi normë në një analize në vitin 2010 në sasinë 0.98 mg/l dhe përmbajtje 0.01-0.09 mg/l. Në shpimin nr.1v I.Terova gjithashtu shfaqja e amonjakut është në sasinë 0.01 - 0.07 – 0.9 mg/l. Prezenca e amonjakut në analiza vjen nga ndotjet siperfaqesore dhe lidhet me moszbatimin e zonave të mbrojtjes sanitare.



Tab.

– 12 Diagrama dhe ecuria në vite e përmbajtjes së parametrin NH₄ të ujërave të akuaferëve në Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)


Përmbajtja e Klorit Cl -Përmbajtja e Klorit Cl në tre fazat e monitorimit në shpimet nr.108 Bulgarec, nr.3 Turan, nr.1v I.Terova, nr.173/1 Sheqeras varion varion 7.4 -35.36 mg/l, në vitin 2013 përmbajtja e Cl varion nga 12.43 -39.05 mg/l. Përmbajtja e Cl në burimin Mancurisht varion 1.66 – 2.06 mg/l, ndërsa në vitin e kaluar varion 1.78 - 3.55mg/l dhe mesatarja është 2.66 mg/l. Përmbajtja e Cl është në përmbajtjen e rekomanduar në shpimet nr.108 Bulgarec e nr.173/1 Sheqeras dhe pak mbi përmbajtjen rekomanduar por nën PML në shpimet nr.3 Turan e nr.1v I.Terova. Ndryshimet e Mg në fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë nga 0.12 – 9.74 mg/l. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 10.48 – 34.14 mg/l. Përmbajtja e Cl në vitet 2010 - 2014 jepet në fig. nr.93 e krahasuar me standartet e STASH dhe BE (25 -200 mg/l). Sic shihet nga grafiku përmbajtja e Cl është pak mbi STASH R në shpimin nr. 3 Turan e 1v I.Terova, por nën sasinë maksimale të lejuar dhe pothuajse ruhet nje trend pa ndryshime të mëdha, vërehen vetëm ndryshime të vogla stinore.



Tab. –

13 Foto dhe ecuria në vite e përmbajtjes së parametrin Cl të ujërave të akuafereve në Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)


Përmbajtja e Sulfateve SO₄ - Përmbajtja e Sulfateve SO₄ në tre fazat e monitorimit varion 2.49 -12.88 mg/l në shpimet nr.3 Turan, nr.108 bulgarec, nr.173/1 Sheqeras dhe në burimin Mancurisht. Në vitin 2013 përmbajtja e SO₄ në ka variuar nga 2.49 -12.88 mg/l, përmbajtje është brenda normës së rekomanduar. Në shpimin nr. 1v I.Terova përmbajtja e Sulfateve SO₄ varion 110.06 - 124.08 mg/l, në vitin 2013 nga 103.04 - 109.87 mg/l, sasi kjo mbi përmbajtjen e rekomanduar por nën PML. Ndryshimet e SO₄ në fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë 0.1- 14.04 mg/l. Përmbajtja mesatare 5 vjecare e Sulfateve SO₄ varion nga 3.3- 15.43 mg/l dhe 111.73 mg/l në shpimin nr.1^v I.Terova. Përmbajtja e SO₄ në vite jepet në fig. nr.94 e krahasuar me standartet e STASH dhe BE (25-250). Trendi në vite ka tendencë rritje në shpimin nr.1^v I.Terova. Në shpimet e tjere dhe burimi i Mancurishtit kanë vetëm ndryshime të vogla stinore .



Tab. –

13 Foto dhe ecuria në vite e përmbajtjes së parametrin SO₄ të ujërave të akuafereve në Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Përmbajtja e Nitrateve NO₃ -Përmbajtja e Nitrateve NO₃ në tre fazat e monitorimit është e vogël, ajo varion nga 1.86 - 25.36 mg/l, në vitin 2013 varion nga 1.8 - 20.16 mg/l, ka pak rritje në shpimin nr.1^v I.Terova. Përmbajtja është brenda normës së lejuar (norma STASH 25 - 50 mg/l, BE 25 - 50mg/l).Ndryshimet e NO₃ në fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë 0.12 – 9.34 mg/l. Përmbajtja e NO₃ në vitet 2010 - 2014 jepet në fig. nr.95 e krahasuar me standartet e STASH dhe BE (25-50), përmbajtja është e vogël dhe brenda standartit të rekomanduar. Përmbajtja mesatare e Nitrateve NO₃ varion nga 2.75 – 19.45 mg/l. Vërehen luhajtje stinore të përmbajtjes së nitrateve në shpimet që lidhet me plehërimin e tokave bujqësore.




Tab. –

14 Diagrama dhe ecuria në vite e përmbajtjes së parametrin N)3 të ujërave të akuafeve në Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Përmbajtja e Nitriteve NO₂ : Në fazat e monitorimit takohet përmbajtje e nitriteve në sasinë nën 0.01 mg/l deri në sasinë 0.01 – 0.02 mg/l. Në shpimin nr.3a Turan takohet përmbajtje e nitriteve në tre fazat e monitorimit në sasinë nën 0.01 mg/l. Në shpimin nr.173 Sheqeras takohet përmbajtje e nitriteve në tre fazat e monitorimit në sasinë 0.01 mg/l. Në shpimin nr.1^V I.Terova takohet përmbajtje e nitriteve në tre fazat e monitorimit në sasinë nën 0.01 mg/l. Ka përmbajtje të NO₂ në shpimin nr.108 Bulgarec në sasinë nën 0.01mg/l deri 0.01 -0.02 mg/l. Në burimin e Mancurisht takohet përmbajtje e nitriteve në sasinë 0.01 mg/l në fazën e parë të monitorimit dhe nën 0.01 mg/l ne fazën e dytë e të tretë të monitorimit. Cfaqja e nitriteve lidhet me moszbatimin e zonave të mbrojtjes sanitare. Në gr. nr. 96 jepet përmbajtja e NO₂ në vitet 2010 - 2014; ajo varion rreth vlerave 0 - 0.05mg/l dhe në disa analiza nga 0.05 mg/l deri 0.27 mg/l, përmbajtje deri mbi normë. Përmbajtja e nitriteve në ujë te pijshëm nuk lejohet ndërsa përmbajtja maksimale e lejuar është sipas standartit Shqiptar 0.05 mg/l (Norma BE është 0.1 mg/l). Përmbajtja mesatare e NO₂ varion 0.0036 - 0.055 mg/l. Shfaqjet e herëpashërshme të përmbajtjes së nitriteve lidhet me moszbatimin e zonave të mbrojtjes sanitare, burimi i ndotjes është i afërt dhe lidhet me pleherimet e tokave bujqesore. Në vite vërehen raste ndotje dhe përmbajtje mbi normë në shpimin nr.108 Bulgarec.

Përmbajtja e O₂ - Përmbajtja e O₂ në tre fazat e monitorimit varion 0.8 -15 mg/l, në vitin 2013 ajo varion 1.86-7.67 mg/l përmbajtja është më vogël se norma deri në normë (norma:- jo më pak se 8).

Analizat për mikroelemente - Analizat për mikroelemente janë kryer në shpimin nr.3 Turan për Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd. Në këto analiza ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni = 0.004 -0.007 mg/l, Mn = 0.003 - 0.005 mg/l, Zn = 0.01 - 0.025 mg/l, Pb = 0.011 - 0.013 mg/l, Cu = 0.002 mg/l, Co = 0.007 - 0.009 mg/l, Cr = 0.009 - 0.14 mg/l, Cd = 0.001 - 0.002 mg/l. Përmbajtja e mikroelementeve është në përmbajtjen e rekomanduar deri në PML (Tab. Nr.8).



Tab. –

14 Foto dhe ecuria në vite e përmbajtjes së parametrit N)2 të ujërave të akuaferëve në Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

16.8. MONITORIMI HIDRODINAMIK (REGJIMI NIVELOR)

Ujërat nëntokësore të akuiferit Kuarternar Korçë janë me presion deri me vetëderdhje në sipërfaqe. Monitorimi hidrodinamik i ujërave nëntokësore të këtij akuiferi është kryer në një shpim në Bulgarec. Në zonën Sheqeras, I.Terova shpimet janë me vetëderdhje, pra niveli pjezometrik është mbi 1m nga sipërfaqja e tokës. Në zonën e Turanit ku është shfrytëzimi më intensiv nivelet dinamike janë nën 10 m nga sipërfaqja e tokës. Luhatja e nivelit të ujërave nëntokësore lidhet me ndryshimet stinore dhe me ndryshimet për efekt shfrytëzimi. Në Bulgarec janë kryer 3 matje niveli në shpimin nr.108 në vitin 2014 dhe 2 matje në vitin 2013. Në vitin 2014 të dhënat e monitorimit janë:

- Niveli statik në Qershor është $H_s = +1.0$ m
- Niveli statik në Shtaor është $H_s = + 0.67$ m
- Niveli statik në Nëntor është $H_s = + 0.78$ m

Amplituda e luhatjes është $A= 33$ m

Në vitin 2013 të dhënat e monitorimit janë:

- Niveli statik në Qershor është $H_s = 0.0$ m
- Niveli statik në Tetor është $H_s = + 0.5$ m.

Amplituda e luhatjes është $A= 0.5$

16.9. UJERAT NENTOKESORE

Nr. Shpimi	Vendndodhja	Muaji	REZULTATET E ANALIZAVE MG/L										
			Ph	Kimike e plotë									
				K	Na	Ca	Mg	Fe ²⁺ ₃	NH ₄	HCO ₃	CO ₃	Cl	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	
3a	Turan	Qershor	7.7			39.1	37.5		<0.0				
		r	9	1.22	15.38	8	2	0.01	1	256.2	9	31.8	
		Shtator	7.7	1.04	15.56	38.0	36.7	0.03	0.03	268.4	6	35.36	

			5			4						
			7.8			35.7	38.1			271.4		
		<i>Nentor</i>	2	1.06	16.36	2	8	0.02	0.01	5	3	29.76
108	Bulgarec	<i>Qershor</i>	7.6			39.5						
			6	1.18	13.08	6	38.7	0.05	0.04	268.4	9	27.1
		<i>Qershor</i>	7.7		132.1	39.4	38.6					
			6	1.22	2	6	6	0.05	0.04	268.4	9	26.12
		<i>Shtator</i>	7.8			39.9	37.0		<0.0			
			7	0.88	8.76	4	8	0.02	1	256.2	12	19.36
		<i>Nentor</i>	7.8			37.4				265.3		
			2	0.9	9.46	8	38.8	0.03	0.09	5	6	17.36
173/1	Sheqeras	<i>Qershor</i>	7.2			82.0	20.6					
			3	1.32	16.4	4	6	0.06	0.01	366	0	9.7
		<i>Shtator</i>	7.0				17.3				301.9	
			5	1.18	14.34	69.7	4	0.03	0.01	5	0	7.72
		<i>Nentor</i>	7.0			71.4				308.0		
			4	1.2	14.88	6	18.6	0.07	0.04	5	0	7.4
1v	Irakli Terova	<i>Qershor</i>	7.7			56.7	55.3					
			3	1.7	9.48	2	2	0.04	0.09	256.2	9	21.96
		<i>Shtator</i>	7.7			55.1	53.8					
			7	1.44	9.3	2	8	0.04	0.02	262.3	6	26.62
		<i>Nentor</i>	7.8			54.4	56.2		<0.0	271.4		
			9	1.58	9.88	8	6	0.02	1	5	3	19.86
STASH 3904-88(P.M.L)			6,5-8,5	10-12,0	20-100	75-200	20-50	0.05-0.3	nl-0,05			25-200
E.C. 80/778 (P.M.L.)			6,5-8,5		20-150	100	30-50	0.05-0.2	0,05-0.5			25

Tab.- 15 *Akuiferi i Korces, Viti 2014 (Burimi : Agjensia Kombetare e Mjedisit)*




Fig. – 10 Rrjeti Hidrografik i Rajonit Te Korçës (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Watersheds maps of Albania hydrographic network





Fig. – 11 Rrjeti pellgjeve ujr (Burimi: Niko Pano, Burimet hidrike, 2014)

17. Ajri

17.1. BURIMET E NDOTJES SË AJRIT

Numri i ditëve të tejkaluara nga 35 ditë të lejuara është 102 ditë.



Organizata Botërore e Shëndetësisë vlerëson se 80% e vdekjeve të parakohshme nga infarkti dhe sëmundjet e zemrës, 14% të vdekjeve nga sëmundjet kronike obstructive pulmonare ose sëmundjeve akute pulmonare, dhe 6% të vdekjeve nga kanceri i mushkërive, lidhet me ndotjen e ajrit urban. Përqendrimet e ozonit tejkalojnë vlerat kufi për shkak të sasive të tepërta të përbërësve organike të paqëndrueshme (VOC) dhe oksideve të azotit të emetuar. Inputet azotit nga amoniakut (NH₃) dhe oksidet e azotit dëmtojnë tokën, dëmtojnë cilësinë e ujit, destabilizojnë pyjet dhe kanë një ndikim negativ në biodiversitetin. Ka

shumë burime të ndotjes së ajrit në Shqipëri; sektorët kryesorë kontribues janë ai i transportit, industria, bujqësia, përdorimi shtëpiak i produkteve si dhe ngrohja.

Fig. 1 – Elementët ndotës të ajrit (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Të gjithë këto sektorë çlirojnë një shumëllojshmëri ndotësash si dioksid squfuri, okside të azotit, nga druri (PM₁₀), bujqësia (NH₃, PM₁₀), dhe industria (VOC, NO_x, PM₁₀). Gjatë vitit 2014-2015 janë ndërmarrë disa nisma ligjore që lidhen me cilësinë e ajrit të mjedisit dhe me sistemin e taksave për lëndët djegëse.

Dhjetëra mijëra produkte të tjera kimike përdoren nga njeriu në aktivitetin industrial dhe në jetën e përditshme. Hidrokarburet, aromatikët, polinuklearët (PAH) si (etileni, acetileni, tolueni, xilleni) metalet e rënda, pesticidet dhe herbicidet, poliklorodifenili (PCB), tretësira organike dhe metale në formë gjurmësh, përfaqësojnë faktorë të ndotjes lokale që vijnë nga burime të ndryshme. Burimet mund të jenë:

- Burime në temperatura të larta, që lëshojnë kryesisht substancë organike volatile (hidrokarbure, PAH) dhe metale (Fig. - 1);
- Burime në temperatura të ulta, që përbëjnë të gjitha format e burimeve, që përcaktohen nga cilësitë volatile të substancave në presione të ulta të avullit gjatë përdorimit të tyre.

Ndotja e ajrit duhet të luftohet qysh në burimin e krijimit të saj:

- duke përmirësuar proceset e djegies së industrisë;
- duke ngritur impiante të rinj pastrimi;
- duke marrë masa që oxhaqet shkarkues të jenë në përputhje me kriteret sanitare të mbrojtjes së ajrit.

Burimet e ndotjes së ajrit klasifikohen në 4 kategori:

- burime të lëvizshme, ku futen automjetet, trenat dhe aeroplanë. Lëndët djegëse më të rëndësishme të përdorura janë benzina dhe nafta për automjetet, nafta dhe qymyri për lokomotivat. Në këtë kategori përmendim si ndotës CO, NO_x, hidrokarburet, grimcat e ngurta;

- burime të palëvizshme, ku futen të gjithë impiantet që përdorin lëndë djegëse, e cila shërben për ngrohje ose për procese të ndryshme. Të gjitha lëndët djegëse si qymyri, koksi, nafta, gazi dhe druri kontribuojnë në masa të ndryshme në shkarkimet ndotëse. Djegia në këto impiante shkakton ndotjen me SO₂, hi dhe blozë;
- proceset e prodhimit industrial ku përfshihen të tërë impiantet, fabrikat, uzinat që çlirojnë ndotës të ajrit gjatë prodhimit ose transportit të produkteve të tyre. Kjo në rastin e zonave industriale është kategoria më e rëndësishme;
- avullimi i substancave organike që përmbledh avullimin e benzinës, bojërave dhe solventeve, të përdorur për pastrime të ndryshme. Ky burim ka rëndësi të dorës së dytë.

Ndër ndotësit kryesorë të atmosferës përmendim:

- Oksidet e squfurit (SO₂, SO₃);
- Gazi sulfhidrik (H₂S);
- Oksidet e azotit (NO, NO₂ - NO_x);
- Anhidriti karbonik (CO₂) dhe oksidi i karbonit (CO);
- Komponimet e fluorit;
- Ozoni O₃ ;
- Hidrokarburet (C_nH_m);
- Kancerogjenet (3-4 Benzopireni);
- Acidi klorhidrik;
- Bloza e pluhurat.

Burimet e ndotësve toksikë në ajër

Industria: metale të rëndë (Zn, Cd, Cu, Pb, Cr, Hg) tretësa (benzenë, toluenë, kloroalkeni, kloroalkani) PCB.

Derdhjet: Hidrokarbure, fenoli, metale të rëndë (Cd, Cr, Ni, Pb, Zn) PCB.

Transporti: PAH(17 substanca organike) quhen edhe polinuklearët, hidrokarbure (etilen, acetilen, toluen, xilen) metale të rëndë Pb.

Djegje: Hidrokarbure (pentani, ezani, etj.) metale të rëndë (V, Ni, Mn, Pb) PAH, poliklorodibenzodioksina, poliklorodibenzofierani;

Bujqësia: Hekzaklorocikloheksani, DDT₁, endosulfani, klodani, dieldrina, oksofeni, metoksiklori, eptakloroeporidi.

Tab.1 Shkarkuesit kryesorë

	Faktori i shkarkimit	Prodhimi Total kg/vit	Shkarkim i	Besueshmëria mikrogram/kg
Djegja e plehrave	109kg	87	90%	450
Djegja e biomasës	13	8700	1130	140
Prodhimi i metaleve ferore	0.04	700	350	140
Furrat e çimentos (të	0,5	260	350	280

rrezikshme)				
Furrat e çimentos (të parrezikshme)	2,6	1600	680	130
Shkrirje sekondare e bakrit	0,2	2	320	31
Djegje e mbetjeve spitalore	39	4	78	35
Djegje të karburantit pa plumb	22	3800a	84	0,4
Djegje e karburantit me plumb	320a	3800a	11	5
Total (kg PCDD\PCFvit)	2800a	3000	600	
Total (g I-TEQvit)		50000	10000	

Shirat acidë

Shi acid është çdo precipitim me pH më të ulët se 5,6. Precipitimi ndodh kur avujt e ujit të atmosferës kondensojnë lëng apo pjesëza të ngurta dhe bien në tokë. Shiu acid është shkaktari kryesor i dëmtimeve të objekteve historikë dhe kulturorë. Ai ç'ngjyros dhe shformon gurin e punuar. Oksidet e azotit dhe squfurit (gazet acidë) mund të shërbejnë si bërthamë për formimin e shiut acid. Kur shumë prej këtyre bërthamave ndeshen së bashku për të formuar një pikël precipitimi (reshje), ajo ka mjaft jone për të formuar acidin e dobët nitrik apo sulfurik, të ciat bien në tokë në formën e shiut acid. Në ajër ndodhen grimca në gjendje të ngurtë ose të lëngët me përmasa, që ndryshojnë në një interval të gjerë. Grimcat më të mëdha nuk qëndrojnë gjatë në atmosferë dhe depozitohen. Grimcat më të vogla qëndrojnë në atmosferë për një kohë të gjatë dhe mbarten në distanca të mëdha. Grimcat e imëta të suspenduara (me diametër mes 0,1 dhe 10 μ) quhen të tilla, pasi mund të mbeten pezull në ajër si pluhur, tym, aerosol ose përzierje e tyre.

PH dhe aciditeti atmosferik

Ne e përshkruajmë aciditetin në terma pH (logaritmi negativ i përqendrimit të jonit të hidrogjenit në një solucion). Shkalla e pH shkon nga 0 deri në 14, me pikë të mesme 7 që është neutrale. Vlerat poshtë 7 tregojnë aciditet progresivisht më të madh, ndërsa ato sipër 7 janë progresivisht më tepër alkaline. Meqenëse, shkalla është logaritmike, ekziston një diferencë 10-fishë në përqendrimin e joneve të hidrogjenit për çdo njësi pH. Për shembull, pH-6 është 10 herë më acid sesa pH 7; në të njëjtën mënyrë, pH-5 është 100 herë më acid dhe pH-4 është 1000 herë më acid se sa pH-7. Shiu normal, i pa ndotur në përgjithësi ka një pH rreth 5.6, për shkak të acidit karbonik të krijuar nga CO₂ në ajër. Lëshimi vullkanik, dekompozimi biologjik, klorina dhe sulfatet nga uji i oqeanit mund ta ulin pH poshtë 5.6, ndërsa pluhuri alkalik mund ta ngrejë sipër 7. Në zonat e industrializuara, acidet antropogjenike në ajër, zakonisht i kapërcejnë ato nga burimet natyrore. Shiu acid është vetëm një nga format, në të cilat shfaqen depozitimet e acidit. Mjegulla, bora dhe vesa, gjithashtu kapin dhe depozitojnë helmet atmosferike. Për më tepër, mbeturinat e sulfatit të thatë, nitratit dhe copëza të kloridit mund të llogariten rreth gjysma e depozitave të acidit në disa zona. Këto grimca kthehen në acide, kur ato shpërhapen në sipërfaqen e ujit ose kontaktojnë me inde të lagështa (si ato në sy dhe në mushkëri). Prova të konsiderueshme sugjerojnë se aerosolet e acideve janë një rrezik për shëndetin.

Kërkime të shumta janë bërë mbi mekanizmat e dëmtimit të acidifikimit. Në përgjithësi, riprodhimi është faza më e ndjeshme në ciklin jetësor. Vezët dhe larvat e shumë peshqëve vriten, kur pH zbrit në rreth 5.0. Ky nivel acidifikimi gjithashtu mund të ndërpresë zinxhirin ushqimor, duke vlarë bimë ujore, insekte dhe jovvertebrorë, nga të cilët peshqit varen për ushqim. Në nivele pH më të ulëta se 5.0 vdesin gjithashtu edhe peshqit e rritur. (Fig. - 18.6) Trofta, salmoni dhe peshq të tjerë të gjuetisë janë zakonisht më të ndjeshmit. Krapa, gari dhe peshq të tjerë më pak të dëshirueshëm janë më rezistent. Ka disa mënyra, në të cilat acidi vret peshqit. Aciditeti ndryshon kiminë trupore, shkatërron gushën dhe pengon marrjen e oksigjenit, shkakton dekalifikimin e kockave dhe ndërpret kontraktimin e muskujve. Një tjetër efekt i rrezikshëm (si për njerëzit edhe për peshqit) është se uji acid kullon (shplan) metale toksikë, të tilla si merkuri dhe alumini jashtë nga toka dhe shkëmbinjtë. Cili nga këta mekanizma është më i rëndësishmi? Ky është një debat i hapur, por është e qartë se depozitimi i acidit ka pasur pasoja katastrofike në ekosistemet ujore të ndjeshme.

Metalet e rëndë

Plumbi është një metal i rëndë, që ndodhet në përbërjen e kores së tokës. Përqendrimit natyrore të plumbit janë të ulët, por shfrytëzimi i plumbit nga njeriu ka rritur nivelet e përmbajtjes së këtij ndotësi në atmosferë. Burimi kryesor i plumbit në ajrin urban është djegia e benzinës me plumb nga motorët e automjeteve.

Imisioni

Termi imision përmbledh në mënyrë të përgjithshme ndotësit e përzier dhe të holluar në ajër, në vendin, ku ato tashmë veprojnë. Njerëzit, kafshët dhe bimët i absorbojnë ato në mënyrë të pavullnetshme. Shpesh, imisioni rezulton shumë larg vendit origjinë, burimit të shkarkimit. Përqendrimit maksimale të lejuara (PML) për ndotjen atmosferike janë fiksuar në mënyrë të tillë që, në përputhje me arritjet e shkencës dhe eksperiencës, imisionet më të ulëta se këto vlera:

- nuk kërcënojnë njeriun, kafshët dhe bimët;
- nuk shkaktojnë shqetësime të ndjeshme në popullsi dhe në mirëqenien e saj;
- nuk dëmtojnë ndërtesat;
- nuk sjellin probleme për pjellorinë e tokës,
- bimësinë ose pastërtinë e ujërave.

Vendi ynë p.sh., në lartësitë 0-100m vuan nga ndotjet e veta të emetuara apo të çliruara nga burimet e sipërmendura, por mbi këtë lartësi vuan më tepër ndotjen e ardhur si imision (çlirim atje dhe zhvendosje drejt nesh nga erërat) nga TEC-cet e Brindizit të Italisë.

Burime të lëvizshme të ndotjes

Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit të Mjedisit miraton edhe burime të tjera të ndotjes, që mund të shfaqen. Në bazë të sasisë së prodhimit të nxehtësisë ose të përmbajtjes së ndotësve, burimet e ndotjes klasifikohen në:

- burime të mëdha ndotjeje, që janë burimet e palëvizshme në impiante teknologjike, prodhimi termik i të cilave është më i madh se 5 Megavat (MË);
- burime mesatare ndotjeje që janë burimet e palëvizshme në impiante teknologjike, prodhimi termik i të cilave është nga 0,2 deri në 5 Megavat (MË);
- burime të vogla ndotjeje që janë burimet e palëvizshme në impiante teknologjike, prodhimi termik i të cilave është më i vogël se 0,2 Megavat (MË).

- Burime të vogla ndotjeje cilësohen edhe pajisjet për procese teknologjike, që nuk përfshihen në burimet e mëdha dhe të mesme të ndotjes, veprimtaritë që shkaktojnë ndotjen e ajrit, magazinimet e karburanteve, të lëndëve të djegshme, të lëndëve të para për produkte, të mbetjeve dhe ndotësve të grumbulluar, si dhe teknikat, pajisjet dhe veprimtaritë, të cilat ndotin ajrin.

17.2 KONTROLLI I NDOTJES SË AJRIT

Monitorimi i cilësisë së ajrit duhet të siguroj të dhëna për nivelin e ndotjes së ajrit, për të dhënat meteorologjike, ndikimet në shëndetin e popullatës, bazuar në *Ligjin Nr.10431, datë 09.06.2013 "Për mbrojtjen e mjedisit"* në *Ligjin Nr.10 266, datë 15.04.2010 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"*, në *VKM Nr.1189 datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe Proçedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar për monitorimin e mjedisit"*.

Rrjeti ekzistues i monitorimit të cilësisë së ajrit në Korçë është i kufizuar në aspektin e numrit të stacioneve monitoruese po ashtu edhe në tipin e stacioneve. Për të paraqitur një tablo të qartë të situatës së cilësisë së ajrit dhe burimit të ndotjes bazuar dhe në studimet paraprake për shtrirjen e rrjetit të mirëfilltë të monitorimit të cilësisë së ajrit në territorin e Korçës nevojitet rritja e numrit të stacioneve dhe sidomos në qytetet e mëdha të përfaqësohen tre tipet e stacioneve, trafik, urban dhe stacione sfond.

17.3. VLERAT KUFË PËR DIOKSIDIN E SQUFURIT E PLUMBIN DHE MASAT NE LIDHJE ME TO

Vlerësimi i situatës nga SO_2 (dioksid squfuri)

SO_2 është formuar nga oksidimi i sqfurit dhe kryesisht nga djegia e lëndës djegëse me përmbajtje sqfuri. Sektori i prodhimit të energjisë elektrike është burimi kryesor i SO_2 . SO_2 gjithashtu mund të ndihmojë në formimin e grimcave dytësore sulfate dhe formimin e shiut acid. SO_2 është një ndotës që shkakton probleme serioze në shëndetin e popullatës si përkeqësimin e astmës si dhe redukton funksionin e mushërive dhe irriton aparatit respiratorar. Kjo mund të shkaktojë dhimbje koke, shqetësim dhe ankth. SO_2 ndihmon në formimin e shiut acid, impakti i të cilit mund të jetë i dukshëm duke shkaktuar dëmtimin e pyjeve dhe ekosistemin e liqeneve dhe lumenjve.

Në grafikun nr ... janë dhënë vlerat mesatare vjetore të SO_2 në qytetet kryesore të vendit tonë. Siç vihet re dhe nga grafiku vlerat e monitoruara në Korçë të SO_2 janë të ulta. Po ti referohemi vlerave ditore dhe orare të monitoruara vërejmë se nivelet e tyre janë më të ulta në krahasim me standartin orar dhe ditë të BE-së. (Standarti orar është $350\mu g/m^3$ dhe standarti ditë është $125\mu g/m^3$). Siç është përmendur dhe më lart SO_2 kalon në formën e shiut acid dhe në ormën e grimcave të pluhurit duke ndikuar në mënyrë indirekte në shëndetin e popullatës dhe në ekosistem. Po ti referohemi dhe vlerave orare dhe ditore në asnjë nga stacionet nuk kemi tejkalim të standartit të BE-së. Kjo është paraqitur dhe në tabelën e mëposhtme ku janë dhënë numri i orëve dhe ditëve të lejuara në vit.

Dioksidi i sqfurit

Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme që përqendrimit e dyoksidit të sqfurit në ajrin e ambientit, të vlerësohen në përputhje me Nenin 7 dhe të mos tejkalojnë vlerat kufi. Kufijtë e tolerancës të përcaktuar në Seksionin I të Shtojcës I do të zbatohen në përputhje me Nenin 8 të Direktivës 96/62/EC.




Fig. 4 – Paraqitja grafike e përqendrimit të SO₂(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Plumbi

Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që përqendrimet e plumbit në ajrin e ambientit, të vlerësuara në përputhje me Nenin 7, të mos tejkalojnë vlerat kufi të parashtuara në Seksionin I të Shtojcës IV, që nga datat e specifikuar në të. Kufijtë e tolerancës, të parashtuar në Seksionin I të Shtojcës IV do të zbatohen në përputhje me Nenin 8 të Direktivës 96/62/EC.

Vlerësimi i përqendrimeve

Pragjet e sipërme dhe të poshtme të vlerësimit për dyoksidin e squfurit, dyoksidin e azotit dhe oksidet e azotit, lëndëve grimcor edhe plumbit për qëllime të Nenit 6 të Direktivës 96/62/EC do të jenë ato të parashtuara në Seksionin I të Shtojcës V.

17.4. Kontrolli i oksideve të azotit

Pa dyshim, rruga më e mirë e parandalimit të ndotjes nga oksideve të azotit është duke shmangur krijimin e tij. Një pjesë e konsiderueshme, e cila shoqërohet me minierat, industrinë dhe prodhimin e energjisë mund të eliminohet me anë të konservimit. Djegësit skenikë, në të cilët rryma e ajrit dhe e karburantit janë të kontrolluara me kujdes, mund të reduktojnë formimin e oksidit të azotit, pothuaj 50%. Kjo është e vërtetë edhe për motorët me djegie të brendshme dhe distilierët industrialë. Karburanti fillimisht digjet në temperatura të larta në një ambient me oksigjen të varfëruar, ku NO_x nuk mund të formohet. Gazet e mbetura, pastaj kalojnë nëpër një pasdjegës, ku shtohet më tepër gaz dhe djegia finale zhvillohet në një vend të pasur me ajër, të varfër me karburant dhe me temperaturë të ulët, që gjithashtu redukton formimin e NO_x. Motorët me ngarkesë të shkallëzuar dhe motorët orbitalë të automobilave të rinj përdorin këtë parim për të arritur standartet e

lëshimit pa konvertues katalitik. Përjasja e adaptuar nga matësit e makinave për reduktimin e NO_x ka qenë përdorimi i katalizatorëve zgjedhës për të ndryshuar ndotësit në substanca të padëmshme. Konvertuesit katalitikë tre-rrugësh përdorin katalizator platinum-paladium dhe rodium për të hequr mbi 90% të NO_x , hidrokarbure dhe monoksid karboni në të njëjtën kohë. Fatkeqësisht, kjo përjasje nuk funksionon në motorët diesel, në impiantet e energjisë, shkëmborët dhe burime të tjera ndotëse, për shkak të problemeve me shtytjen mbrojtëse, jetën katalitike, gjërryerjen dhe prodhimin e produkteve shoqëruese të padëshiruara, si sulfati i amonit, që prish sistemin. Lëvizja e shpejtë e oksideve të azotit është një teknikë e re për të larguar oksidet e azotit. Gazet e skrapamentos kalohen nëpër një depozitë acide cianurike jo helmuese, të zakonshme. Kur nxehet në 3500°C , acidi cianurik lëshon gaz acidi izocianik, i cili vepron me NO_x për të prodhuar CO_2 , CO , H_2O dhe N_2 . Në një test motori diesel me shkallë të ulët, ky sistem eliminon 99% të NO_x . Nëse do të punohej në aplikimet me shkallë të plotë, veçanërisht në gypat e gazit të ndotur me hi fluturues, mbetet për të parë.

17.5. OZONI NË AJRIN E AMBIENTIT DHE MASAT NË LIDHJE ME TË

Vlerësimi i situatës nga ozoni (O_3)

Ozoni i nivelit të ulët të troposferës nuk emetohet direkt në atmosferë, ai formohet si rezultat e zinxhirit të reaksioneve kimike me gazet pararendëse të emetuara në atmosferë si NO_x , CO , NMVOC dhe CH_4 në praninë dhe të rrezatimit diellor. Niveli i lartë i ozonit mund të shkaktojë problem të shëndetit respirator duke zvogëluar funksionimin e mushkërive, përkeqësimin e astmës dhe sëmundje të tjera të mushkërive deri në vdekje të parakohshme. Ozoni gjithashtu është gaz me efekt serë duke kontribuar në ngrohjen e atmosferës.

Niveli i lartë i O_3

Ozoni (O_3) është një gaz mjaft reaktiv, që ekziston në pjesën e poshtme të atmosferës (nivelin e tokës) por edhe në troposferë. Ai nuk shkarkohet direkt nga njeriu, por formohet nga reaksionet kimike mes ndotësish të tjerë, shpesh të iniciuar prej dritës së fortë të diellit. Niveli i kuq i O_3 tregon vlerën e lartë mbi 90 ppb e cila është mbi normat evropiane.




Fig. 17 – Paraqitja grafike për O_3 (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Ky nivel mund të shpjegohet

- me prani të ndotësve të tjerë, të cilët së bashku me dritën e fortë të diellit rrisin përqendrimin e ozonit në atmosferë.
- me prani të klorinave (tetrakloridi i karbonit, kloroformi metilen) të prodhuara nga njeriu si dhe
- ato klorfluorkarbonet (CFC) e prodhuara nga kondicionerët, halonet ose gazet e prodhuara nga frigoriferet,
- me një sasi të lart të djegies së vegjetacionit për qëllime bujqësore ose dhe urbane;
- me sasi të lart të emisioneve të oksidit të nitrogjenit dhe e përbërsëve organik volatil (motorrët e automobilëve si burimi kryesor i këtyre ndotësve).
- me prani të avujve të ujit.
- me përqëndrim të lart të sulfateve dhe nitrateve, të cilat bien nëformë shiu acid;
- me përqëndrim të lart të pluhurit, e blözës nga djegiet njerëzore, si komponente të formimit të smogut, ku zvogëlohet gradienti vertikal i temperaturës, sepse është prezent mbulesa konjektive e resë, që rezulton në një ndriçim më të madh dhe në një ngrohje të sipërfaqes.

17.6. NDOTJA E AJRIT DHE SHËNDETI NJERËZOR

Si i shkakton efektet në shëndet ndotja e ajrit? Rruga më e zakonshme e ekspozimit ndaj ndotësve të ajrit është nëpërmjet frymëmarrjes, por përthithja direkte nëpërmjet lëkurës ose helmimi i ushqimit apo i ujit janë rrugë të rëndësishme. Meqenëse, ata janë oksidues të fuqishëm, sulfatet, SO₂, NO_x dhe O₃ veprojnë si ngacmues, të cilët dëmtojnë indet delikate në sy dhe rrugët e frymëmarrjes.

Materialet e imëta, që gjenden në ajër (më të vogla se 10µm) depërtojnë thellë në mushkri dhe janë edhe ngacmues (irritantë) edhe agjentë fibriotikë. Një pjesë e tyre mbahet në organin hundë, por ja që është një grimcë tjetër pluhuri prej 2,5mikron, e cila nuk ndalet deh vazhdon drejt e në gupin e frymëmarrjes, madhje sedimentohet atje. Kësisoj, përgjigjet inflamatore të vëna në lëvizje nga këta irritantë dobësojnë funksionimin e mushkërive, duke bërë që të kemi rrugë të shkurtër të frymëmarrjes, për pasojë ajo bëhet e vështirë dhe çojnë në probleme kardiovaskulare, ndërsa zemra përpiqet të kompensojë mungesën e oksigjenit, duke pompuar gjithnjë e më tepër. Nëse iritimi është tepër i ashpër, një sasi e madhe lëngu shkon në mushkëri nëpërmjet indeve të dëmtuara sa që viktima mund të mbytet. Por ja që nuk mbaron këtu efekti i grimcave të pluhurit. Nga reaksioni kimik i pluhurit, me diellin, me smogun, me lëshimet hidrokarbure nga marmitat e automjeteve formohet një grimcë tjetër e madhësisë 1mikron, e cila përshkon si hundën dhe mushkëritë dhe e ndal rrugën kur prehet në gjak. Kjo është arsyeja që sot kërkohen përmbajtje të sqfurit të nivelit zero në karburante.

Monoksidi i karbonit lidhet me hemoglobinën dhe ul aftësinë e ruazave të kuqe për të transportuar oksigjen. Asfiksues të tillë shkaktojnë dhimbje koke, marramendje, stres të zemrës dhe mund të jetë edhe vdekjeprurës nëse përqendrimi është mjaftueshëm i lartë. Monoksidi i Karbonit (CO) emetohet në atmosferë për shkak të djegies jo të plotë të lëndës djegëse. Burimet kryesor të shkarkimit të CO në ajër janë transporti rrugor, biznesi, shtëpitë dhe industria. CO hyn në reaksion me ndotësit e tjerë duke prodhuar ozonin e niveleve të ulta të atmosferës. Monoksidi i Karbonit (CO) është një ndotës që në nivele të larta mund të shkaktojë probleme në zemër dhe të dëmtojë sistemin nervor. Ky gjithashtu mund të shkaktojë dhimbje koke, marramendje dhe lodhje. Ndërsa në stacionin e Korçës niveli i lartë i CO është për shkak të përdorimit të druve të zjarrit si lëndë djegëse për ngrohjen e banesave.

Plumbi, gjithashtu lidhet me hemoglobinën dhe redukton aftësinë oksigjen- mbajtëse në nivele të larta. Në nivele më të ulta, plumbi shkakton dëmtime afatgjata në neurone të rëndësishëm në tru, që sjell si rezultat dëmtime fizike dhe mendore dhe zhvillim të vonuar. Bronkiti është një inflamacion i vazhduar i bronkeve dhe bronkeolave, që shkakton një kollë të dhimbshme dhe spazma muskulore të pavullnetshme, që kufizojnë rrugët e ajrit. Bronkitet e rënda mund të çojnë në emfizemë, një sëmundje e pakthyeshme, shkatërruese e mushkërisë, në të cilën rrugët e ajrit ngushtohen në mënyrë të përhershme dhe alveolat dëmtohen ose/edhe shkatërrohen. Ajri i ndenjur i bllokuar në rrugët e ajrit fryn qeskat e vockla në mushkri (alveolat), duke bllokuar qarkullimin e gjakut. Ndërsa qelizat vdesin nga mungesa e oksigjenit dhe ushqyeseve, muret e alveolave prishen, duke krijuar hapësira të mëdha boshe të pa afta për shkumimin e gazeve. Muret e trashura të bronkeolave humbasin elasticitetin, dhe frymëmarrja bëhet më e vështirë. Viktimat e emfizemave shpesh nxjerrin një tingull karakteristik, që i ngjan fishkëllimës, kur marrin frymë. Shpesh, ata kanë nevojë për oksigjen shtesë për të zëvendësuar mungesën nga dëmtimi.

Irritantët në ajër janë aq të përhapur, sa gjysma e të gjitha mushkërive të egzaminuara në autopsi kanë njëfarë shkalle dëmtimi alveolar. Zyra e Vlerësimit të Teknologjisë (OTA) vlerëson se 250,000 njerëz vuajnë nga bronkiet dhe emfizema të lidhura me ndotjen në SHBA dhe rreth 50,000 vdekje në vit i atribuohen komplikimeve të këtyre sëmundjeve, të cilat ka mundësi të jenë të dytat, pas atakeve të zemrës, si shkaqe të vdekjeve.

Ndikimi i ndotësve të ajrit tek njeriu vërehet kryesisht mbi lëkurën dhe mukozat. Grimcat dhe molekulat e ndotësve depërtojnë në organizmin e njeriut nëpërmjet:

- inhalimit (rruga respiratore);
- absorbimit (me anë të aparatit tretës) ose ;
- prekjes, kontaktit (nëpërmjet lëkurës dhe mukozave).

Si rezultat i ekspozimit ndaj ndotësve të ndryshëm, edhe shenjat që shfaqen në organizmin e njeriut janë të ndryshme të renditura sipas rëndësisë së tyre ato kanë pamjen e mëposhtme.

1. Erë e pakëndshme ;
2. Irritim i syve, hundës e grykës;
3. Prekje e rrugës të sipërme të frymëmarrjes;
4. Frymëmarrje e rëndë kollë ;
5. Dëmtim i funksioneve pulmonare ;
6. Sëmundje bronko-pulmonare kronike ;
7. Infeksion i rrugëve të frymëmarrjes ;
8. Kriza të astmës ;
9. Kancer.

Tab.17 Burimet e ndotjes

Ndotësi	Burimi	Efkti mbi shëndetin
Monoksidi i karbonit	Djegje e qymyrit e gazit, emisionet nga motorët e automjeteve	Asfiksi, dëmtime të zemrës e të Sistemit

		nervor, vdekje.
Ozoni	Emisionet nga motorët e automjeteve	Të njëjta me ato të NO _x
Alergentet	Poleni, kafshët, Brenda , Pluhuri i shtëpive	Astmë, rhinitis
Asbesi	Minierat e mullinjve e asbetit, brenda, Materialet e ndërtimit, izolantet	Asbestoze, kancer i mushkërive, (mezotelioma)
Radoni	Toka, brenda, materialet e ndërtimit	Kancer i mushkërive

Efektet e ndotësve atmosferikë mbi shëndetin e njeriut nuk shfaqen menjëherë. Pas një periudhe të grumbullimit të tyre në organizëm vërehen shenja të ndryshme në varësi të sasisë së tyre dhe të gjendjes së përgjithshme të organizmit.

Plumbi, ja pasojat te shëndeti

Saturnizmi është sëmundja, nga e cila vuajnë pothuajse gjysma e punonjësve të ish-poligrafikut. Ata kanë përqindje të lartë plumbi në gjak. Dhimbje koke të shpeshta, dhimbje kyçesh, çrregullime tensioni, dobësim të theksuar dhe dridhje trupi. Këto janë simptomat, që shfaqen tek meshkujt me përqindje të lartë të plumbit në gjak. Ndërsa, tek femrat, simptomat dyfishohen. Lindje të parakohshme dhe barrë jashtë mitre, çrregullim total i organizmit, dridhje trupi dhe infeksione në mitër.

Tab.18 Veprimi tek njeriu nga efekti i SO₂

Koncentrimi	Koha e ekspozimit	Efektet e SO₂ në organizëm
0.03 - 0.05	Vazhdimisht	Keqësim i gjendjes së pacientëve me bronshit
0.3 - 1.0	20 sekonda	Shqetësim i aktivitetit cerebral
0.5 – 1.4	1 minute	Perceptim i erës
0.3 – 1.5	15 minuta	Zvogëlim i ndjeshmërisë okulare
1- 5	30 minuta	Rritje e rezistencës në ventilimin pulmonare, humbet nuhatja
5 – 20	Mbi 6 ore	Dëmtime pulmonare, të kthyeshme nqs. ndërpritet ekspozimi.
Mbi 20	Mbi 6 ore	Ngopje e rrugës dhe indeve mushkërore që mund të çojnë në paralizë ose dhe në vdekje

18. Mbetjet

18.1 PERFORMANCA E MBETJEVE SI KONCEPT

Bazuar në Ligjin Nr.9010, datë 13.2.2003 “PËR ADMINISTRIMIN MJEDISOR TË MBETJEVE TË NGURTA”, neni 1, mbi Qëllimin e ligjit, i cili synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi

prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme. Për këtë arsye, duhet vendosur që të bëhen hapat e parë për përmirësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, duke përdorur “Standardin e Shërbimit të Pastrimit”, si masë e cilësisë dhe efektivitetit të këtij shërbimi, në mënyrë që të gjithë qytetarët të përfitojnë sa më shumë prej tij, të optimizojmë kostot dhe të përmbushen standardet e menaxhimit të mjedisit sipas Bashkimit Europian. Pesë parimet që duhen zbatuar për të zgjidhur krizën e mbetjeve në një mënyrë sa më të mirë mjedisore, si dhe nga ana e kostove ekonomike, janë:

- Zgjidhja duhet të jetë sa më e thjeshtë;
- Zgjidhja duhet të jetë lokale;
- Njihësimi i zgjidhjes me ekonominë lokale;
- Njihësimi i zgjidhjes me zhvillimin e komunitetit lokal;
- Zgjidhja e bazuar në metodat inxhinierike.

Situata në Administrimin e Mbetjeve

Administrimi i mbetjeve urbane në vendin tonë është i decentralizuar, ku në qytete menaxhohen nga bashkitë ndërsa zonat rurale nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa më e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër shpatet e përrenjëve dhe të lumenjëve ose në anë të rrugëve, ose grumbullohen në venddepozita të hapura në natyrë, pa asnjë lloj përpunimi; vendosen në depozitime të shkrifta, toka bujqësore (kuaternare), digjen në gjendje të lirë etj. (Guri, S., etj., 2013). Duke patur parasysh numrin e popullsisë sipas INSTAT dhe shumën totale vjetore të mbetjeve të ngurta urbane, rezulton se sasia mesatare është 332 kg për banor në vit. Probleme serioze sjell mungesa e ndarjes së mbetjeve që në burim, kështu që grumbulluesit dhe kompanitë hasin vështirësi në gjetjen e mbetjeve të pastra dhe të ndara. Mbetjet bashkiake kanë një përqindje të lartë të mbetjeve organike dhe nuk përdoret ndonjë metodë riciklimi për të reduktuar sasinë e këtyre mbetjeve organike që hidhen në venddepozita. Mbetjet organike në venddepozita janë burimi kryesor i emetimit të CH në ajër. Gjithashtu si pasojë e shkarkimeve të lëngëta urbane rritet përmbajtja e NH₄, ndërsa nga shkarkimet e ujrave të zeza rritet përmbajtja e NO₂ dhe NO₃

Tab. - 1 Shkarkimet e mbetjeve

Rryma e Mbetjeve	% Mesatare në Hedhjen e Mbetjeve Bashkiake	Pesha e Mbetjeve Bashkiake të Shqipërisë/ditë (0.7kg/person/ditë)	Pesha e Mbetjeve Bashkiake të Shqipërisë/vit (266kg/person/vit)
		2,335 T/Ditë	852,360 T/vit
Organike	47.36	1,106	403,690
Dru	1.43	33	12,045
Letre	5.37	125	45,625
Kartoni	8.13	190	69,350
Total te Biodegradueshme	62.3	1,454	530,710
Plastike me densitet të ulët	8.46	198	72,270
Plastike me densitet të lartë	4.75	111	40,515
Qelq	5.75	134	48,910
Tekstile	5.27	123	44,895
Metale - Ferroze	0.56	13	4,745
Metale - Me Ngjyra	0.57	13	4,745
Mbetjet Spitalore	0.17	4	1,460
Produkte Gome	0.2	5	1,825
Mbetje Inerte	7.2	168	61,320
Mbetje nga produkte sanitare	3.25	76	27,740
MPEE	0.31	7	2,555
Bateritë	0.02	1	365
Prodhime të Mbetjeve nga Kafshët	1.08	25	9,125

Burimi: Agjencia Evropiane e Mjedisit

Menaxhimi i mbetjeve - viti 2014

Nga monitorimet ka rezultuar:

- gjenerimi i mbetjeve urbane ka pasur tendencë rritje ndërsa gjenerimi i mbetjeve inerte ka pasur luhatje. Pavarësisht përmirësimeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, ai mbetet ende një problem shumë i rëndësishëm.
- mbetjet depozitohen në venddepozitime të përkohëshme të miratuara nga vetë njësitë e qeverisjes vendore.
- organizimi i grumbullimit, transportimit, depozitimit dhe asgjësimit të mbetjeve paraqet vështirësi të mëdha dhe një kosto të lartë financiare që përballohet nga buxheti i shtetit, mbasi NJQV nuk kanë patur mundësi financiare.
- vazhdojnë depozitime të mbetjeve në vende të pa autorizuara dhe brigjeve të rrjedhave ujore.
- ka djegje të mbetjeve urbane nuk bëhet ndarja e mbetjeve me origjinë ndërtimore me ato urbane dhe organike
- ka probleme me teknikën e përdorur për pastrimin dhe transportimin e mbetjeve. Teknika është e vjetër dhe nuk plotëson standarte minimale për këtë shërbim.
- sasitë e mbetjeve të gjeneruara gjatë vitit 2014 në bashkinë Korçë ka qënë mbetje urbane 29.200 ton/vit.
- për mbetjet spitalore krahas ndryshimeve pozitive ka probleme të cilat duhen trajtuar sipas nenit 21, pika 5 dh 6 , te ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- Mbetjet spitalore(mjekesore) 16364 kg/vit
- Nga keto 16411 kg eshte sasia qe digjet ne impjante inceneratore (Autokllave)

Mbështetur në Vendimin Nr. 687, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”. Për këtë rrymë nuk ka shërbim të dedikuar. Nuk ka pika të posaçme për grumbullimin dhe largimi i tyre bëhet në baza sporadike dhe jo sipas një planifikimi të rregullt. Mbetjet inerte

raportohen si një problem në rritje nga të gjitha bashkitë e qarkut për shkak të kostove të larta që kërkon shërbimi për grumbullimin dhe transportimin e tyre. Per mbetjet inerte nga NJQV nuk kemi asnjë informacion por per mbetjet urbane ne bashkine e Korces kemi shifren prej:

Tab.2 Gjenerimi i mbetjeve inerteve

Nr.	Tipi mbetjeve	Sasia e prodhuar	Sasia qe digjet ne impiante incenerator	Teknologjia e perdorur (temp °C)	Sasia qe digjet ne ambiente te hapura
1	Mbetje urbane (organike)	29.200 ton/vit	Nga informacioni i marre nga Bashkia Korce mbetjet depozitohen ne fushen e perpunimit te mbeturinave, dhe ne kete vend keto mbeturina shtypen dhe shtyhen me traktor.		
2	Mbetje spitalore (mjekesore/farmaceutike)	16364 kg/vit	16411	Autokllave	0 qelqe dhe 410 kg e jane mbetje te shme

Burimi: Bashkia Korçë

Të dhëna për mbetjet spitalore

Gjate muajit Shkurt 2014 ARM Korce ka hartuar nje relacion mbeshtetur ne te dhenat e marra mbi mbetjet spitalore gjate kontrolleve te vazhduara tek Spitalet, Klinikat dhe qendrat Shendetsore. Nga inspektimi i ARM-së, spitali rajonal i Korces në bashkinë Korçë është edhe gjeneruesi më i madh i kësaj rryme. Po ashtu spitali së bashku me disa njësi të tjera farmaceutike, labororë apo klinika dentare kanë nënshkruar një kontratë me kompaninë MEDI-TEL Sh.p.k në Tiranë për trajtimin e mbetjeve spitalore.

Të dhëna për menaxhimin e vajrave lubrifikantë:

Nga verifikimet e kryera nga ARM-ja ka rezultuar: *GJENERUESIT E VAJRAVE LUBRIFIKANTË* - 1210 Litra vaj per vitin 2014

15.1.4 Zonat Urbane, vend depozitat e mbetjeve urbane

Mbetjet klasifikohen si: mbetje organike; mbetje të ngurta; mbetje patologjike dhe spitalore; mbetje industriale dhe mbetjet agrokulturore. Mbetjet klasifikohen në:

- Mbetje jo të rrezikëshme, të cilat quhen ndryshe mbetje urbane ose “plehra” në gjuhën e përditëshme, të cilat edhe pse quhen si jo të rrezikshme mund të rezultojne shumë të dëmshme për popullsinë dhe mjedisin.
- Mbetje të rrezikëshme, të cilat kanë karakteristika kimike e fizike toksike, gërryese, kancerogjene dhe që mund të kenë efekte të dëmshme, (këtu bëjnë pjesë edhe mbetjet spitalore si dhe mbetjet radioaktive, të cilat janë tejet toksike dhe ekspozimi ndaj tyre mund të shkaktojë sëmundje nga më të ndryshmet, madje dhe të shkaktojë vdekjen).

Rëndësia

Miratimi i strategjisë kombëtare të administrimit të mbetjeve dhe ligjit për administrimin e integruar të tyre do të sigurojë një menaxhim të mbetjeve duke ruajtur mjedisin, si ajrin, tokat dhe ujrat sipërfaqësore e nëntokësore; zvogëlon ndikimin negativ në shëndetin e popullsisë dhe ndihmon për një zhvillim të qëndrueshëm. Synimi kryesor është zbatimi i plotë i tyre duke filluar me parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve, riciklimin, trajtimin e tyre për shfrytëzimin e nxehtësisë apo Energjisë për qëllime industriale, shtëpiake etj, dhe depozitimi i tyre në landfille. Një vend të rëndësishëm në zbatimin e këtij legjislacioni dhe direktivave të Bashkimit Europian, ka trajtimi dhe shfrytëzimi i mbetjeve industriale. Këto mbetje përveç nevojës dhe rëndësisë së riciklimit dhe përdorimit të tyre, kanë vlera ekonomike në shfrytëzimin e Energjisë termike, të gjeneruar gjatë procesit të incinerimit (djegjes), (Ministria e Mjedisit, 2012&2013).

Paradokset e menaxhimit të mbetjeve

- Grumbullohen në venddepozita të hapura në natyrë;
- Nuk kryhet asnjë lloj përpunimi;
- Vendosen në depozitime të shkriфта, toka buke;
- Hidhen pranë sistemeve ujore (lumenj, perrenj);
- Digjen jo rallë në gjendje të lirë;
- Jashtë kushteve të kontrollit mjedisor;

Studimi mbi mbetjet, nga njëra anë informon shoqërinë civile dhe publikun, nga ana tjetër jep gjendjen e menaxhimit të mbetjeve urbane, përta i përket grumbullimit të tyre, trajtimit, reduktimit, riciklimit, kompostimit dhe grosposjes, me qëllim përmirësimin e këtyre proceseve në të ardhmen, të cilat ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në mjedisin përreth dhe në shëndetin e popullsisë. Secila Bashki duhet të zhvillojë strategjinë e vet të depozitimit të mbetjeve, ku rindarja në shesh grumbullimi dhe më pas vendgrosja, pa dyshim luajnë rolin më të rëndësishëm. Strategjia duhet të mbështetet mbi:

- Vlerësimin e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbanë në shesh grumbullim;
- Pastrimin dhe disefektimin e vendeve përreth kontenierëve;
- Larjen dhe disifektimin e kontenierëve;
- Mirëmbajtjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve urbane gjatë ditës; dhe
- Pajtueshmëria me kërkesat ligjore si cilësia e ajrit, zhurmat, dridhjet, rrjedhjet ujore dhe të lëngshme.

Më tej, duhet të fokusohet në vlerësimin e zgjedhjes së metodave dhe teknologjive për trajtimin e integruar të mbetjeve urbane apo të ndikimeve pozitive dhe negative në mjedis dhe shëndetin njerëzor. Gjithashtu, ai duhet të vlerësojë sesi janë zbatuar masat zbutëse në rastin e ndikimeve negative dhe të masave të kontrollit dhe montorimit, si nga kompania dhe autoriteti mjedisor.

18.2. GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTI I MBETJEVE NË RAJONIN E KORÇËS

Mënyrat e grumbullimit

Në rajonin e Korçës, ushtrohet një aktivitet i ulët teknologjik, që nuk arrijnë të ndikojnë dukshëm në mjedisin përreth me mbetjet e tyre. Gjithsesi, i vetmi burim ndotje mendohet se është dampa minerare si ajo aktuale,

por më tepër ajo historike pa lënë mënjanë dhe ato antropogjene. Që nga viti 1994, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve si dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve vendore, duke i bërë plotësisht përgjegjëse për manaxhimin e tyre. Sistemet që trashëguan dhe sot operojnë, konsistojnë në grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane në një rrymë të vetme dhe transportimin e tyre në vendet lokale të depozitimit të tyre. Procesi i delegimit të kompetencave, pavarësisht përmirësimeve graduale të vërejtura është kthyer në një sfidë për autoritetet vendore. Ato janë ballafaquar me mungesën e instrumenteve të nevojshme për manaxhimin mjedisor të mbetjeve, mungesën e teknologjive dhe të investimeve, si dhe të kapaciteteve të mjaftueshme të burimeve njerëzore dhe financiare.

Tab. 3 Llojet e ndotjeve në Bashkinë e Korçës

Nr. në	Emërtimi	X	Y	Lloji	Simboli i ndoties	Shënia
1-Qy	Lozhan	4511320	4463360	Qymyr guri	Qy	17
2-GI	Zvesdë	4510690	4490060	Gëlqeror	GI	17
3-GI	Lumolas	4502232	4477660	Gëlqeror	GI	17
4-GI	Korçë	4499596	4482413	Gurore	GI	17
5-GI-pl	Gjonomadhi	4498779	4470336	Gëlqeror	GI-PI	17
6-Cr	Voskopojë	4498100	4462900	Krom	Cr	29
7-P.K.	Korçë	4497825	4481650	Pikë	P.K.	31
8-Lf	Korçë	4497060	4479910	Landfill	Lf	19
9-Lf	Drenovë	4495650	4482770	Landfill	Lf	19
10-A	Mollas	4494740	4476806	Argjila	A	22
11-A	Qatrom	4494470	4479170	Karrierë	A	22
12-F.Tu.	Qatrom	4493946	4479886	Fabrikë	F.Tu.	12
13-Qy	Mborje-Drenovë	4493000	4484000	Qymyr guri	Qy	2
14-GI	Shtylla	4489264	4462478	Gëlqeror	GI	17
15-GI	Shkëmbi i Mjaltit	4488175	4471995	Gëlqeror	GI	17
16-GI	Bellovodë	4487918	4474220	Gëlqeror	GI	17
17-GI	Ujëbardhë	4487158	4474303	Gëlqeror	GI	17
18-Cu	Kanisqel,	4484250	4468200	Bakër	Cu	15
19-GI	Vithkuq	4484065	4460670	Gëlqeror	GI	17
20-Cu	Dushku i Trashë	4483350	4467850	Bakër	Cu	1
-U.zeza	Korçë	4482413	4481700	Ujëra të zeza	U.zeza	30

Shërbimi i ofruar

deri më tani ka qënë mjaft i kufizuar dhe larg realizimit të standardeve dhe kërkesave të kohës. Ai konsiston thjesht në largimin e mbetjeve urbane nga disa rrugë kryesore, një herë në javë, me anë të një kamionçini, por pa patur mjetet e nevojshme për menaxhimin e duhur të tyre. Aktualisht, situata është akoma dhe më e rëndomtë, sepse ky shërbim, prej rreth një viti mungon krejtësisht dhe koshat për depozitimin e këtyre mbetjeve nuk ekzistojnë në asnjë rrugë të fshatrave që përbëjnë këto Komuna. Kjo situatë është paradoksale, përderisa rajoni në fjalë ka nën funksionet e tyre edhe shërbimin e pastrimit të mbetjeve urbane përcaktuar në Ligjin Nr. 8652 datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" (i

ndryshuar). Çdo ditë e më tepër këto mbetje urbane përbëjnë një shqetësim të vazhdueshëm për banorët e këtyre zonave, të cilët e perceptojnë kërcënimin real që po iu ushtrohet. Gjithashtu, një mjedis i papërshtatshëm është krijuar edhe për zhvillimin e bizneseve lokale ekzistues apo të rinj.

Nga këqyrjet tona në terren, konstatojmë që në çdo anë të rrugëve, në kanalet kullues dhe në kanalet vaditës gjenden grumbuj mbeturinash, të cilat hidhen kryesisht nga familjarët dhe bizneset private që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këto njesi administrative. Kjo situatë ishte edhe më alarmante gjatë rrugës nacionale, madje dhe në rrugët e rrëpirat brenda e midis lagjeve të fshtatrave. Megjithatë, edhe banorët e tjerë nuk janë më shumë të kënaqur të grumbullojnë mbetjet brenda oborreve të shtëpive të tyre - me rrezikun, që mace dhe qen të vijnë dhe të shpërbëjnë të gjitha mbetjet në kërkim të ushqimit. Pavarësisht nga kjo, komuniteti vazhdon të depozitojë mbetje nga më të ndryshmet në këtë zonë. Për t'i gjetur një zgjidhje alternative këtij problemi, një pjesë e banorëve i vënë flakën mbetjeve, duke përkeqësuar edhe më shumë nivelin e ndotjes së ajrit në këtë zonë. Ajo çfarë e përkeqëson edhe më tepër situatën është mungesa e ndërgjegjësimit publik lidhur me mbrojtjen e mjedisit, ashtu si dhe një mungesë e përgjithshme e dëshirës qytetare për të kërkuar të drejtat e tyre mjedisore pranë autoriteteve përgjegjëse. Banorët e rajonit të Korçës, fëmijët, gratë, institucionet, bizneset duken të dorëzuar dhe të mësuar me këtë gjëndje ambientale, duke mos i bërë përshtypje që në çdo kënd të fshatit ata bashkëveprojnë me mbetjet dhe me rrezikun e lartë për shëndetin e tyre dhe më gjërë. Për sa më sipër, mbetjet e ngurta urbane përbëjnë një shqetësim për komunat në fjalë. Nuk ekziston një vend depozitimi, grumbullimi, përpunimi apo shërbim me rrjet kazanesh për hedhjen e mbetjeve urbane.

Sasitë vjetore aktuale dhe në perspektivë

Nga përlllogaritjet e përafërta të bëra nga grupi studimor rezultoi se në këtë zonë mund të formohen jo më tepër se 4 ton mbetje urbane në ditë ose rreth 60ton në muaj, që po ti shpërndajmë në njësinë e madhe, nga njëra anë nuk përbën ndonjë ndotje të madhe, por nga ana tjetër paraqet vështirësi për grumbullim dhe sistemim të tyre. Edhe në perspektivë duke qenë se lëvizjet demografike tashmë paraqiten në ekuilibër mendohet se gjenerimi i mbetjeve urbane apo familjare për banorë do të jetë jo më shumë se shifrat e mësipërme. Aktualisht, mbetjet mblidhen sipas një norme të thjeshtë civile dhe depozitohen në fushë të hapur, e cila ndodhet 4km nga qendra e qytetit. Nga aktiviteti i depozitimit të mbetjeve në ndodh ndotja e ajrit nga emetimet në formë gazrash të dëmshëm dhe era të rënda, që përbëjnë kërcënim për punonjësit e fushës së mbetjeve dhe banorët përreth zonës, si edhe ndotja e tokës dhe ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga precipitimi i leksiviatit të mbetjeve. Prania e kafshëve dhe shpendëve përbëjnë shqetësim për përhapjen e sëmundjeve infektuese. Ajo që është më paradoksale, ato, hidhen në/dhe pranë sistemeve lumore, si në kanalet kullues që çojnë ujërat në hidrovor. Nëpërmjet proceseve të komplikuar kimike dhe fizike, substancat e rrezikshme depërtojnë në zinxhirin ushqimor të njerzve, bimëve dhe kafshëve. Gjenerimi aktual i mbetjeve urbane nuk mund të klasifikohet për momentin, por pritet të jenë në vlera jo të vogla dhe të shumëllojshme, duke filluar nga mbetjet solide, familjare, spitalore, industriale deri në ato bujqësore. Nga studimet rezultoi se jo të gjitha mbetjet urbane thjesht mund të groposen.

Tab. 4 Përbërja e mbeturinave në rajonin në studim

Materiali	Përbërja në %	Sasia ton/vit	Sasia ton/vit	Potenciali per Kompostim
		2009	2015	
Organik	53,70	17248	18860	18860
Letër dhe karton	10,54	3385	3702	3702
Plastikë e riciklueshme	13,70	4400	4812	
Qelq	5,25	1686	1844	
Metale	0,70	225	246	
Lëndë Drusore	0,62	199	218	218
Tjeter	15,50	20,80	5444	
Totali i vleresuar	100,00	100,00	100,00	22780

Në bazë të kësaj kostoje të re specifike për çdo kategori ne mund të llogarisim tarifën për çdo familje, biznes dhe institucion që duhet të paguajnë për mbulimin e koston operative për kryerjen e këtij shërbimi: Tarifa për një familje/vit=2 055 lekë /vit Tarifa për një biznes (mes) =9,102 lekë /vit Tarifa për institucionet= 20 804 lekë /vit. Nga të dhënat paraqitet qartë se llogaritja e tarifës nuk duket se është e lartë si për qytetarët, ashtu dhe për bizneset, por e llogaritur me ndikimet indirekte që sjell mosmenaxhimi i mbetjeve, këto kosto të bëjnë të mendosh se janë të ulta ose të përbalueshme. Gjithësesi ka nevojë për rishikime të një plani të ri, ku njëkohësisht të analizohen mundësitë për uljen e shpenzime për këtë shërbim.

Sistemi aktual i menaxhimit të mbetjeve, dobësitë, problemet

Mungesa e menaxhimit të Trajtimit të Integruar të Mbetjeve Urbane ka shkaktuar një shpërndarje të pakontrolluar të plehrave, të cilat shkaktojnë ndotje të mëdha që lidhen me tokën, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajrin dhe erën (aromat). Në rajonin e Korçës, për shkak të terrenit dhe zonës së varfër që vjen nga mungesa e investimeve nuk gjenerohen në sasi problemore mbetje të ngurta. Kështu, sasi të vjetore janë jo të larta dhe nuk paraqiten problematika shumë serioze lidhur me to. Gjithësesi, shihet i nevojshëm një plan menaxhimi për mbeturinat. Sistemimi i Mbetjeve Bashkiake është kryer dhe vazhdon të kryhet, në mënyrë primitive. Aktualisht nuk bëhet asnjë lloj ndarje dhe trajtimi.

Dobësitë, problemet

Aktualisht, ato jo vetëm nuk sistemohen diku, në një vendgroposje të kontrolluar, madje as nuk mbledhen sipas një norme të thjeshtë civile. Ajo që është më paradoksale, ato, si në çdo Komunë tjetër hidhen në dhe pranë sistemeve të përrrenjve dhe ato lumore. Aq sa, nëpërmjet proceseve të komplikuara kimike dhe fizike, substancat e rrezikshme depërtojnë në zinxhirin ushqimor të njerëzve, bimëve dhe kafshëve. Në të gjitha

rastet, ato komunikojnë me thellësinë, (tokën e shkriçet, ujin, etj.) për shkak të sedimenteve të shkriçta, që ka formacioni mbulesor i Kuarternarit.

Plani i menaxhimit të mbetjeve urbane

Zgjidhjet teknike për eliminimin e mbetjeve të ngurta me një kosto efektive duhet të jenë gjithashtu të pranueshme edhe nga ana sociale. Menaxhimi i mbeturinave urbane është më kompleks se thjesht vend depozitimi i tyre në vend groposje të kontrolluar inxhinierike (landfill). Administrimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane përfshijnë:

- Reduktim të mbeturinave që në burim;
- Ndarje, vend depozitime familjare;
- Ripërdorim të mbeturinave;
- Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave;
- Riciklim jashtë vendit të grumbullimit;
- Trajtim primar i mbeturinave (biologjik, kimik/trajtim fizik, kompostim);
- Verifikim i sistemit për transportin dhe venddepozitimin e mbeturinave urbane;
- Vend depozitim përfundimtar (landfill).

Përveç mungesës së informacionit dhe të një tradite, e cila vjen dhe si pasojë e kohës së shkurtër të bashkëjetesës së banorëve, prejardhjet e ndryshme kulturore, mungesat e koshave të ndarë, ndikojnë dhe bëjnë të pa realizueshme zhvillimin e Reduktimit, Ripërdorimit dhe Riciklimit. Këto metoda janë zgjidhje mjedisore të integruara me zgjidhjen ekonomike, duke ju përmbajtur parimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane, uljen e sasisë së mbetjeve dhe njohjes së praktikës më të mirë. KRR ka bërë diçka për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të ngurta të komunës. Mbetjet familiare, si dhe ato të rrezikshme, shpesh përzihen me mbetjet e ngurta urbane. Përgjithësisht mbledhja e mbeturinave të ngurta dhe pastrimi i rrugëve rezulton të jetë jo efektiv në zonën e KRR.

Problemet kryesore kanë të bëjnë me riciklimin informal, ku ata persona që kërkojnë nëpër plehra flakin jashtë kazanëve të rrugës mbetje të pa riciklueshme, siç mund të shihet edhe në foton e mëposhtme, dhe ku sasi të mëdha mbetjesh komerciale dhe të tregjeve hidhen nëpër kazanë, të cilët nuk kanë përmasa për t'i përballuar. Kjo nuk do të thotë që duhet të dekurajohet riciklimi, por ai duhet të menaxhohet më mirë. Kjo situatë përkeqësohet edhe nga mungesa e pajisjeve në zonat informale, ku vetëm 10% e kazanëve të mbeturinave i shërbejnë më shumë se 40% të popullsisë. Edhe pamundësia e aksesit në rrugët e zonave informale shërben si pengesë për mbledhjen e mbeturinave. Taksat e pastrimit paguhen, por nuk kryhet asnjë lloj shërbimi nga komuna. Gjëja më e thjeshtë është që këto mbetje urbane të flaken pa të keq në ara, lumë apo në anë të rrugës. Këto mbetje vijnë nga restorantet e ndryshme që ka kjo zonë por dhe nga popullsia, të cilët duke mos pasur kosha ju gjejnë vendin në ndonjë kanal apo në cep të rrugës. Duke qenë se politikat kombëtare për zgjidhjen e shërbimeve të tilla publike i referohen skemave rajonale, edhe komunat në fjalë kanë për detyrë që në një kontekst afatgjatë të marrin në konsideratë zgjidhjen dhe lidhjen e këtij



shërbimi në territorin e vet me zgjidhjet rajonale të propozuara. Ndërkohë, situata aktuale e këtij shërbimi në këtë njësi vendore imponon gjetjen e zgjidhjeve provizore nga ana e autoriteteve.

Studimi ynë e mori në konsiderate rastin e një grupi të caktuar nga Këshilli i Komunës, ku analizoi se vendi i propozuar nga Komuna i plotëson kushtet teknike për të qenë i përshtatshëm për këtë qëllim, por përkohësisht. Duke u bazuar në shtrirjen e fshatrave që përbëjnë këtë komunë, një nga problemet që lidhet me funksionimin, grumbullimin e depozitimin e mbetjeve ka të bëjë me koston e transportit. Kjo kosto, e cila më pas reflektohet në tarifën e shërbimit për subjektet, e cila rritet akoma më shumë nëse marrim në konsideratë lidhjen e këtij shërbimi me skemën rajonale. Në aspektin operacional, kjo strategji propozon hartimin e një plani të grumbullimit dhe ndarjes deri në gatitjen e mbetjeve si lëndë të parë për Kompanitë e riciklimit, plan që duhet të trajtojë alternativat e mundshme për reduktimin e sasive të mbetjeve të riciklimin, etj. Komponenti i reduktimit të mbetjeve mund të ketë tepër sukses në rastin e këtyre komunave, për shkak të natyrës rurale të zonës së fshatrave, ku hapësirat e lira dhe oborret shtëpiake ofrojnë mundësi për dekompozimin e mbetjeve organike, të cilat zënë afërsisht 40-50% të sasisë së përgjithshme të mbeturinave që prodhohen. Mbledhja e mbetjeve të ngurta dhe depozitimi i tyre është përgjegjësi e Komunës në fjalë. Në zonat që përfshin Komuna, ky është ndoshta një nga problemet mjedisore më të dukshme për të. Ndaj theksojmë nevojën e trajtimit të këtij shërbimi në grumbullimin, largimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta urbane e cila konsiston në:

- Zbrazen e kontenerëve me makinën e përshtatshme teknologjike vetshkarkuese;
- Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10m nga çdo kontener;
- Pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30m² rreth çdo pike grumbullimi;
- Dezifektimi i brendësisë së konteniervë dhe sipërfaqes përreth, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori;
- Rivendosja e kontenerëve të sistemuar në vendin e caktuar;
- Transportin e mbeturinave në fushën e përpunimit të tyre me makinat teknologjike vetshkarkuese.
- Kontenerët të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike në mjedisin urban të paracaktuar nga njësi vendore përkatëse. Dezifektimi bëhet pas zbrazjes së çdo konteneri, duke përdorur sistemin e dezifektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

C. Përdorimi i Tokës dhe Infrastruktura

19. Sistemet territoriale dhe përdorimi i tokës



PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR PËR PLANIFIKIMIN E BASHKISË KORÇË
HARTA E SISTEMIT UJOR



REPUBLICA E SHqipërisë
 KOMUNA KOSOVËR E TETINORË

MINISTRI
 BASHKICET
 BASHKICET
 Z. EDI RAMA

MINISTRIA E SHALLART UJOR
 ZH. EGJANITA GJEREMIN

KOMUNA BASHKISË KORÇË
 MINISTRI I SHALLART UJOR
 Z. KURBAJOS

MINISTRIA E SHALLART UJOR
 Z. KURBAJOS

MINISTRIA E SHALLART UJOR
 Z. KURBAJOS

MINISTRIA E SHALLART UJOR
 Z. KURBAJOS

PLANI PËRGJITHSHËM VENDOR
 PËR PLANIFIKIMIN E BASHKISË KORÇË


PU 10
 BASHKICET TERRITORIALE
 BASHKICET

ANALIZË E SHALLART UJOR
 BASHKICET

LEGJENDA

- Kujë administrative shpirtërore
- Kujë administrative komunale
- Kujë administrative bashkisë
- Kujë administrative bashkisë
- Kujë administrative bashkisë
- Kujë administrative bashkisë

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR PËR PLANIFIKIMIN E BASHKISË KORÇË
HARTA E SISTEMIT NATYJOR



REPUBLICA E SHqipërisë
 KOMUNA KOSOVËR E TETINORË

MINISTRI
 BASHKICET
 BASHKICET
 Z. EDI RAMA

MINISTRIA E SHALLART UJOR
 ZH. EGJANITA GJEREMIN

KOMUNA BASHKISË KORÇË
 MINISTRI I SHALLART UJOR
 Z. KURBAJOS

MINISTRIA E SHALLART UJOR
 Z. KURBAJOS

MINISTRIA E SHALLART UJOR
 Z. KURBAJOS

MINISTRIA E SHALLART UJOR
 Z. KURBAJOS

PLANI PËRGJITHSHËM VENDOR
 PËR PLANIFIKIMIN E BASHKISË KORÇË


PU 17
 BASHKICET TERRITORIALE
 BASHKICET

ANALIZË E SHALLART UJOR
 BASHKICET

LEGJENDA

- Kujë administrative shpirtërore
- Kujë administrative komunale
- Kujë administrative bashkisë
- Kujë administrative bashkisë
- Kujë administrative bashkisë
- Kujë administrative bashkisë

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR PËR PLANIFIKIMIN E BASHKISË KORÇË
HARTA E SISTEMIT INFRASTRUKTUROR



REPUBLICA E SHqipërisë
KOMUNA KOSOVËRIA E FIERËVIT

MPROJECTI
KOSOVËRIT
Z. EDI RAMA

INSTRUKTE DOKUMENTI I PLANIT
ZIL GJANTRIA GJENJINI

KOSOVËRIT BASHKISË KORÇË
KOSOVËRIT BASHKISË KORÇË
Z. KURBAJOS

MPROJECTI BASHKISË KORÇË
Z. BASHKISË KORÇË

MPROJECTI BASHKISË KORÇË
Z. BASHKISË KORÇË

MPROJECTI BASHKISË KORÇË
Z. BASHKISË KORÇË


PLANI PËRGJITHSHËM VENDOR
Z. BASHKISË KORÇË

PLI 10
KOSOVËRIT BASHKISË KORÇË
Z. BASHKISË KORÇË

LEGJENDA

- Kosovë e Bashkisë Korçë
- Kosovë e Bashkisë Korçë
- Kosovë e Bashkisë Korçë
- Kosovë e Bashkisë Korçë

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR PËR PLANIFIKIMIN E BASHKISË KORÇË
HARTA E SISTEMIT BUJQËSOR



REPUBLICA E SHqipërisë
KOMUNA KOSOVËRIA E FIERËVIT

MPROJECTI
KOSOVËRIT
Z. EDI RAMA

INSTRUKTE DOKUMENTI I PLANIT
ZIL GJANTRIA GJENJINI

KOSOVËRIT BASHKISË KORÇË
KOSOVËRIT BASHKISË KORÇË
Z. KURBAJOS

MPROJECTI BASHKISË KORÇË
Z. BASHKISË KORÇË

MPROJECTI BASHKISË KORÇË
Z. BASHKISË KORÇË

MPROJECTI BASHKISË KORÇË
Z. BASHKISË KORÇË

PLANI PËRGJITHSHËM VENDOR
Z. BASHKISË KORÇË

PLI 10
KOSOVËRIT BASHKISË KORÇË
Z. BASHKISË KORÇË

LEGJENDA

- Kosovë e Bashkisë Korçë
- Kosovë e Bashkisë Korçë
- Kosovë e Bashkisë Korçë
- Kosovë e Bashkisë Korçë

19.1. Përdorimi Ekzistues i Tokës; Aktivitetet dhe Impaktet




Komponentët kryesorë të strukturës urbane. Struktura urbane e Korçës reflekton evolucionin e saj historik përgjatë dy shekujve të fundit. Tipologjitë e ndryshme urbane i referohen periudhave të ndryshme historike dhe që ende bashkëjetojnë, duke krijuar një mjedis ndërtimesh veçanërisht interesantë. Një cilësi kryesore e strukturës urbane të Korçës është natyra e saj kompakte. Pjesa kompakte është një zonë e projektuar rrethore (D=1.5-2.5km), e rrethuar nga Parku Rinia dhe Kompleksi Sportiv në veri, unaza në perëndim dhe jug dhe kodrat e Moravës në lindje. Zona ka një karakter të qartë urban dhe përfshin lagjet kryesore urbane dhe Qendrën e Qytetit, me të gjitha objektet publike kryesore.

Komponentet tematike të mëposhtme të strukturës urbane ndihmojnë për të krijuar një panoramë të qartë të sistemit urban, kushteve të zhvillimit dhe funksionimit të tij:



Qyteti historik

- Qendra tradicionale, i shekullit të 19të dhe fillimit të shekullit 20 të është një zonë e lidhur, që përbën zemrën e qytetit dhe në ngjitje të Kodrave të Moravës. Ajo karakterizohet nga banesa një ose dykatëshe me kopështe, ngastra të vogla toke dhe rrugë të ngushta të shtruara me kalldrëm. Qendra tradicionale është zhvilluar historikisht përreth dypoleve: Kishës Ortodokse dhe polit të Xhamisë dhe Pazarit.
- Pazarit është një monument unik me vlerë të vecantë kulturore që ka vazhduar funksionin e tij në të njëjtin vend përgjatë kohës dhe është ende në operim si tregu kryesor i qytetit. Në veri, ndërtimet tradicionale urbane të Pazarit ndërthuren me ndërtesat prej betoni, në të cilat ndodhet edhe supermarketa e ushqimeve.
- Qendra e Qytetit qëndron sot ndërmjet entiteteve tradicionale të spikatura. Ajo u ndërtua mbas vitit 1950 dhe karakterizohet nga rrugë dhe bulevarde të gjera, sheshe të hapura si edhe ndërtesa të kohës së socializmit të vendosura përgjatë akseve kryesore të rrugëve. Edhe qendra e qytetit shtrihet në qendrën tradicionale, përgjatë Bulevardit Republika.

	<ul style="list-style-type: none"> – Korça është një qytet tipik monocentrik; pjesa më e madhe e objekteve tregtare, kulturore dhe argëtuese së bashku me ndërtesat administrative të qytetit janë të përqendruara në qendër të qytetit. Nuk ka nënqendra të tjera pavarësisht nga disa dyqane të vegjël për plotësim të nevojave të përditëshme dhe objekteve publike të shërbimit. Kjo mund të vërehet nga vëzhgimi i qytetit kompakt dhe bëhet më e qartë kur lëvizet në drejtim të periferisë.
	<p>Zonat Rezidenciale</p> <ul style="list-style-type: none"> – Lagjet tradicionale, me rrugica të ngushta, ndërtesa tip vilë një-familjare me oborre. Ndodhen pranë zonës së qendrës dhe mbartin vlera historike për zhvillimin karakteristik që ka struktura e banimit.
	<ul style="list-style-type: none"> – Lagjet rezidenciale nga koha e socializmit, me shtëpi një-familjare me oborr të ndërtuara mbas viteve '50 përreth qendrës tradicionale. Kjo zonë është e karakterizuar nga ngastra të vogla, rrugë të drejta dhe të ngushta dhe pak hapësira të lira.
	<ul style="list-style-type: none"> – Lagjet rezidenciale nga koha socialiste me ndërtesa kolektive apartamentesh janë kryesisht të lokalizuara në pjesën jugore të qytetit. Ato janë të karakterizuara nga blloqe të mëdha banimi (4-5 kate) të organizuara me hapësira të kufizuara, rrugë të gjera dhe hapësira të përbashkëta të gjera.



- Zonat rezidenciale nga periudha e fundit e socializmit ('80-'90) janë të lokalizuara në pjesën verilindore të qytetit me blloqe apartamentesh 6 katëshe të larta.
- Periudha e pas '90 karakterizohet nga ndërtimi i ndërtesave shumëkatëshe dhe shumë-funksionale (8-9 kate të lartë). Ato janë të lokalizuara kryesisht në zonën ish-industriale në hyrje të qytetit (pranë aksit rrugor në drejtim të Tiranës) si edhe përgjatë Shëtitores Fan S. Noli dhe Rrugës 28 Nëntori.



- Zona banimi 1-2 kat në periferi të qytetit, me ndërtimi shpesh informale, por që kanë ruajtur një rrijet kuadratik rrugor të rregullt.



- Banime lineare përgjatë akseve rrugore, qofshin kombëtare apo lokale.



- Qendra të banuara të ish-komunave që tashmë janë pjesë e Bashkisë së Korçës. Në këto zona kryesisht nevojitet përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturave nëpërmjet projekteve të rivitatizimit dhe konsolidimit urban.

Prej fillimit të viteve 1990, kolapsi i sistemit të centralizuar ekonomik çoi në ndërtimin e grumbujve të banesave informale në periferi të qytetit, kryesisht përgjatë rrugëve që çojnë në vendbanime të afërta (Voskopoja, Erseka, Polena). Rrjedhoja e zhvillimit informal është ndërtimi i një mjedisi me cilësi të ulët. Një përjashtim është zona e zhvilluar në lindje të Korçës në drejtim të fshatrave Barç dhe Mborje, si zona peri-urbane me ndërtime me cilësi rekativisht të lartë.

Zonat Ekonomike - Korça zotëron një zonë industriale të madhe të zhvilluar në periudhën e Regjimit Socialist në pjesën veriperëndimore të qytetit përgjatë aksit hyrës nga Tirana. Zona shtesë me aktivitete ekonomike janë zhvilluar përgjatë aksit rrugor të Bilishtit (verilindje), pas Varrezave (juglindje) dhe përgjatë rrugës së Polenës (jugperëndim). Prej vitit 1990, aktiviteti industrial ka degraduar shumë, duke lënë sipërfaqe të mëdha të tokës dhe objekte të braktisura. Në të dy anët e aksit në drejtim të Tiranës, zona ish-industriale është degraduar dhe për rrjedhojë ka tërhequr zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me ndërtimet, si edhe aktivitete të tjera komerciale.


Hapësirat e Lira dhe të Gjelbërta - Në qytetin e Korçës ka një kërkesë të fortë lokale për përmirësimin e hapësirave të ndryshme publike. Bashkia është shumë e përgjegjshme për rëndësinë e hapësirave të lira të mirëmbajtura dhe gjatë viteve të fundit, janë realizuar shumë projekte reabilitimi në kuadrin e projektit “Rigjenerimi i Hapësirave të Gjelbërta”. Sot në Korçë ekziston një mori hapësirash të lira me përmasa të ndryshme dhe e përdorur për qëllime të ndryshme: Më specifikisht ato janë:

Rrugë dhe sheshe: shumë rrugë, shëtitore dhe bulevarde në Korçë të cilat karakterizohen nga një bimësi e lartë e pemëve të reja dhe të rritura. Të kombinuara me trotualet e gjera, disa prej tyre mund të karakterizohen si “akse pedestriane të gjelbërta”.

Parqet e lagjeve dhe “kopshtet xhepa” janë hapësira të gjelbërta të madhësisë së vogël dhe mesatare me distanca të afërta me zonat e banimit. Vendi më i rëndësishëm i identifikuar për këtë zhvillim është Parku Shetro, i lokalizuar në zonën ku rridhte në të kaluarën lumi i qytetit, në perëndim të Birra Korça. Veç kësaj është i nevojshëm reabilitimi i hapësirave të lira në hapësirat e degraduara ndërmjet blloqeve kolektive të banimit, në lagjet jugore të qytetit.

Parqet e bashkisë janë të vendosur në pjesën periferike më veriore urbane të qytetit, duke ofruar një larmi aktivitete për banorët e zonës:

Parku *Rinia* është parku urban më i madh i qytetit, i përdorur gjerësisht nga banorët për shëtitje dhe argëtim. Parku është i vendosur pranë hyrjes veriore të qytetit dhe ndodhet pranë Universitetit Fan S. Noli dhe Kompleksit Sportiv Skënderbeu. Hapësirat e lira përreth Kompleksit Sportiv Skënderbeu përbëjnë një park urban intensiv me fokus në sportet e ndryshme. Bashkia është e ndërgjegjshme për potencialet e kësaj qendre dhe kohët e fundit ka përgatitur një studim për zhvillimin e një kompleksi modern sportiv shumë-funksional.



Kodrat e Moravës - Kodrat, shkëmbinjtë dhe vendet e pjerrëta të Moravës rrëzë së cilës shtrihet qyteti, në të kaluarën kanë qenë publike dhe të pyllëzuara. Duke pasuar procesin e kthimit të pronave mbas viteve '90 pjesët kodrinore u janë rikthyer ish-pronarëve. Ndërkohë një prerje masive dhe e paorganizuar e drurëve ka shërbyer për ngrohje rezidenciale të banorëve lokalë në dekadat e fundit. Pylli në të kaluarën shërbente për banorët e Korçës me një mori aktivitete të orientuara nga natyra dhe argëtimet dhe në mënyrë të ngjashme zotëronte një diversitet të florës dhe faunës. Pavarësisht procesit të shpyllëzimit, këto zona vazhdojnë të shërbejnë si një zonë aktivitete sportive dhe ecjesh të lira, duke ofruar pamje panoramike të qytetit dhe një lidhje natyrore ndërmjet parqeve bashkiake në veri dhe zonave rezidenciale në jug.

19.3. Transporti dhe Infrastruktura

19.3.1. Detyrat specifike ku mbeshtetet ky vlersim në mënyrë të përmbledhur është realizuar sipas kësaj radhitje :

- Mbledhja e projekteve dhe informacionit për sistemin lokal te transportit ,
- Kalifikimi i informacionit pershtat kategorizimit të mënyrave të transportit sipas KRR ,
- Infrastruktura Rrugore e Bashkis Korçë,
- Organizimi i infrastrukturës rrugore në njësitë e pushtetit vendor Korçë,
- Te dhena mbi transportin,
- Verifikimi i cilesisë të infrastrukturës rrugore,
- Tipologjia e rrugeve ,
- Kategorizimi dhe modelimi i sistemit urban të qarkullimit brënda njesive te reja administrative per transportin publik dhe privat në Bashkin Korçë,
- Analiza e flukseve ,
- Zhvillimi i rrjetit rrugor të qytetit me një sistem rrezor-unazor ,
- Studimi i lidhjeve lokale me rrjetin kombëtar dhe ndërkombëtar të transportit,
- Analiza dhe vlersimi i kapaciteteve egzistuese te qarkullimit,
- Materiale të tjera që kemi shfrytëzuar për analizën
- Disa përcaktime bazë për PlaninUrban te Bashkis Korçë me te gjitha kategorite e rrugeve
- Mbledhja e projekteve dhe informacionit për sistemin lokal te transportit ,

Natyrisht kur flasim **për projektet dhe informacionet e sistemit lokal te transportit kishim në konsiderat** qe duhet të mbledhnim projekte dhe të dhëna që kanë të bëjnë me ato projekte dhe të dhëna që lidhen me elementet kryesor që studjojn .projektojn dhe zhvillojn transportin si një “çelës” i zhvillimit për bashkit në vecanti dhe gjithë vëndin në tërësi , dhe këto lidhen me :

- Infrastrukturën rrugore (si element bazë të “**ofertës**” në transport] ,
- Inventari i mjeteve të transportit (shkallën e motorizimit) , që përcaktoj “**kërkesën**” për mobilitet,
- Problemet e naxhimit që lidhen me legjislacionin dhe organizimin administrative .

Në këtë kuadër kërkuam nga bashkia dhe njësit e reja administrative , por dhe organet dhe institucionet qëndrore :

- projekte të infrastruktures te transporti,
- të dhena per mjetet e transportit, dhe
- mënyrës të manaxhimit të ketij transporti perkundrejt “**ofertës**” që siguron rrjeti rrugor egzistues dhe shkalla e motorizimit, që jepet si raport i automjeteve të regjistruara per 1000 banor te bashkis, në funksion të të cilit duhet të plotesohen nevojat për mobilitet të qytetarëve të kësaj Bashkie , që pasqyron “**kërkesën**” për të plotësuar nevojat e tyre jetësore të përditëshne

Përsa i përket projekte të infrastruktures te transporti ,këto praktikisht mungojne, ndonse sipas KRR, siç do e anilizojmë më poshtë duhet të ishin bërë në vijimësi që mbas aprovimit të tij . Planet Urbane të Trafikut (PUT) dhe Planet Kombëtare të Trafikut (PKT) apo dhe Planet Urbane të Transportit (PUTr) , nga të cilat mund të

trasahigonim një “**Kadastër të Rrjetit Rrugor**” urban dhe kombëtar . mbi bazën e të cilave mund të planifikonim më mirë “**Land use**” duke përdorur në çdo rast standartet e duhura .

Lista e automjeteve te ndara sipas Kategorive ne drejtorin rajonale Korce

Rrethi	Motomjete	Automjete	Autobus	ATP	Kamjon	ATV	APV	Rimorkio	MakBujq	MakTek	Kamping	MRV	Total	%
Korçë	459	12507	200	1467	724	192	295	325	30	16	0	0	16215	3.1086

Mjetet qe kane kryer veprime deri me 31 12 2011

Rrethi	Motomjete	Automjete	Autobus	ATP	Kamjon	ATV	APV	Rimorkio	MakBujq	MakTek	Kam	MRV	Total	%
Korçë	428	10823	248	1457	953	168	321	350	33	22	0	2	14805	3.11

Lista e automjeteve te ndara sipas Kategorive ne drejtorin rajonale Korçë 2012

Rrethi	Motomjete	Automjete	Autobus	ATP	Kamjon	ATV	APV	Rimorkio	MakBujq	MakTek	Kamping	MRV	Total
Korçë	420	11283	186	1381	775	165	277	315	24	14	0	0	14775

Lista e automjeteve te ndara sipas Kategorive ne drejtorin rajonale Korçë me 31 12 2013

Rrethi	Motomjete	Automjete	Autobus	ATP	Kamjon	ATV	APV	Rimorkio	MakBujq	MakTek	Kamping	MRV	Total
Korçë	458	13588	213	1615	808	185	311	345	26	21	0	0	17570

Lista e automjeteve te ndara sipas Kategorive ne drejtorin rajonale Korçë me 31 12 2014

Rrethi	Motomjete	Automjete	Autobus	ATP	Kamjon	ATV	APV	Rimorkio	MakBujq	MakTek	Kamping	MRV	Total
Korçë	511	14954	224	1728	819	195	328	363	37	21	0	0	19180

Mjete 2010 – 2015 Qarku Korçë

Nr	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Qarku
----	------	------	------	------	------	------	-------

							Korçë
6	22597	21770	20778	22291	24897	26239	Total
6	100	96.3402	91.9502	98.6458	110.1783	116.1171	%
Ndryshimi %	0	-3.6598	-4.3900	+6.6956	+11.5325	+5.9388	16.1171
Ndryshimimjete	0	-827	-992	+1513	+2606	+1342	+3642

Nga analiza e mësipërme rezulton se në vitet 2011 dhe 2012 na rezulton se kemi patur një rënie të shkallës të motorizimit në Korçë respektivisht me – 827 mjete (ose -3.66 %) dhe - 992 mjete (ose – 4.39 %) fenomen që shpjegohet me vendimin për të siguruar çregjistrimin e mjeteve jasht përdorimi pa paguar taksat e prapambetura , dhe mbas keti viti 2013 , 2014 dhe 2015 kemi patur një rritje me +1513 (ose 6.69 %) ,+2606 (ose 11.53%) dhe 3642 mjete (ose 16.12 %) të dhëna këto që do na shërbejnë për të parashikuar rritjen e shkallës të motorizimit dhe të flukseve të trafikut , krahas ndryshimeve demografike , social ekonomike dhe legislative e administrative dhe për perjudhën horizont të PPV .

19.3.2. Kalasifikimi i informacionit pershtat kategorizimit të mënyrave të transportit sipas KRr

Nënyrat e transportit që përdoren aktualisht sipas kategorizimit të bazuar në KRr në Bashkin Korçë janë:

- lëvizja në këmbë ,
- lëvizja me mjete private (autovetura),
- lëvizje me biciklete që (e kufizuar),
- shërbimi public qytetas me autobus ,
- transporti me autobus ndërmjet qytetit te Korçës dhe ishkomunave
- dhe transpori me autobus ndërqytetas





Figura 1

Nga analiza e treguesve të mësipërm na rezulton se nga zonat e reja administrative mobiliteti për punë në total në ditë l përmbledhur sipas menyrave të udhëtimit tregon se 12 634 udhetime/ditë , ose 59 % e mobilitetit realizohet me këmbë ose bicikleta , 6 802 udhetime /ditë ose 31 % realizohen me autovetura ose motor dhe vetëm 2 195 ose 10% udhëtime/ditë realizohen me mënyrat e tjera të mundëshme të udhëtimit në këtë 340ons si minibus , taksi ose tren.Për nivelin e zhvillimit ekonomik dhe varfëris që kemi në këto zona justifikohet % e larte e udhëtimit në këmbë dhe me bicikleta , tregues ky l favorshëm përsa l përket “**mënyrës të sjelljes**” të banorve që janë të prirur për të përdorur mënyrat e transporteve “**pa karbon**” , por nga ana tjetër përdorja në një masë vetëm prej 10 % e transporteve publike me autobus , tregon shkallën e ulët të ofërës që l ofrohet këtyre zonave për përdorimin e këtyre mënyrave për efekt të largësis nga qendra (periferialiteti),gjëndja e keqe e rrugëve që lidhin këto njësi , por dhe organizimi l dobët l shërbimeve nga bashkia , që jo në çdo rast merr në 340onsiderate një nga parimet themelore të organizimit të shërbimeve të transportit siç është parimi bazë përzgjidhjet që duhet të realizojmë kur bejmë PPV “**parimi l zgjidhjeve të qëndrueshme**” të cilat në kuadrin e mobilitetit urban duhet të marrin në 340onsiderate siç del e qartë dhe nga skema e mëposhtme kur studjohet dhe vendoser nga ekuilibrat në fushat e “**ekonomisë**” , “**mjedisit**” dhe “**barazin sociale**” për gjithë zonën në studim të bashkisë , duke patur në 340onsiderate për sejcilin fushat e lartë përmëndura komponentet përbërës të tyre siç jepet në figurën 2.

Natyrisht këto zgjidhje mund të jenë të suksesëshme kur për këtë qëllim mbështetemi në tre shtyllat bazë të realizimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe balancuar trafiku (figura 3) që janë mbështetur në

- Planifikimi l Land Use ,
- Kufizimi l përdorimit të autoveturave private ,
- Promovimi l transportit public dhe mënyrave të qëndrueshme të transportit



Zgjidhjet e qëndrueshme për mobilitetin urban duhet të marrin në konsideratë: ekonominë, mjedisin dhe barazinë sociale

Figura 2



Vetëm një Kombinim Zgjidhjesh është i suksesshëm

Figura 3

Në tabelën më poshtë po rëndisim nësit e reja administrative të Bashkisë Korçë përse I përket numrit të përgjithshëm të udhëtimeve/ditë për punë

Renditja	Njësia	Udhëtime /ditë gjithësej	Renditja sipas %
Shqipëria ka një pozicion konkurrues në tregun ndërkombëtar të turizmit në bregdetin e Mesdheut, dhe duke zbatuar misionin e partneritetit në sektorin e turizmit do të arrihen që :

- **Të krijohet mikpritja e turistëve duke e lutuar mikpritjen si cilësi e lartë të**
- **shërbimit si element i rëndësishëm brenda produktit turistik**
- **Mbron dhe zhvillon mjedisin në mënyre aktive**
- **Përmirëson cilësinë e produkteve dhe shërbimeve**
- **Krijimi i produktit të pronovueshëm me çmim të leverdishëm**
- **Krijimi i një imazhi pozitiv**
- **Po ti hedhim një vështrim qarkut të Korçës, turizmi është ende në nivele të ulëta, por ka potenciale për zhvillimin e tij si rezultat i pozitës së mirë gjeostrategjike, shtrirja e zonës liqenore (liqeni i Ohrit, Prespës) si dhe në zonat e virgjëra malore në Dardhë, Voskopojë, Gorricë, Gërmenj, si dhe arkeologjia, monumentet kulturore dhe vendet piktoreske e bëjnë zonën e Korçës një vend mjaft interesant. Gjithashtu turizmi i plazhit dhe i diellit mund të realizohet më së miri në dy liqenet natyrore si :**
- **Liqeni i Ohrit , liqen natyror me sipërfaqe prej 362.6 km² ndodhet në një lartësi mbi nivelin e detit 695 m dhe ka një thellësimaksimale prej 287 m.**
- **Liqeni i Prespës edhe ky liqen natyror me sipërfaqe prej 285 km² dhe ndodhet në një lartësi mbi nivelin e detit 853 m dhe me thellësi maksimale 35 m.**
- **Korçës, është një pasqyrë traditash, ku së bashku, sjelljet materiale dhe shpirtërore kanë mbetur të paprekura për gjenerata me radhë Potencialet për zhvillimin e turizmit në Korçë janë shumë të mëdha për arsye të pasurive historike, kulturore dhe natyrore. Tiparet e një qendre urbane të zonës janë shfaqur pas vitit 1484 kur qyteti i Korçës filloi të zgjerohej e zhvillohej. Qyteti ka qenë pjesë e shkëmbimeve kulturore dhe tregtare me perandorinë bizantine dhe civilizimin grek. Zona përreth ka qenë banuar që në kohët e hershme, e mbetjet neolitike tregojnë popullimin rreth 600 vjet më parë.**

- Korça është e njohur për cilësinë e natyrës në zonat përreth, duke e bërë atë një vend ideal për ekskursionistët, botanistët e zoologët. Në perëndim të qytetit të Korçës ndodhet qyteza e mirënjohur e Voskopojës, një vend tërheqës për turistët, për natyrën e virgjër dhe klimën e saj të pastër dhe kuruese që frekuentohet gjatë gjithë vitit nga shumë vizitorë vendas dhe të huaj. Në Voskopojë ndodhen shumë kisha dhe manastire bizantine duke i dhënë shumë vlera historike – kulturore këtij vendi. Gjithashtu pika të njohura turistike janë ato të Dardhës dhe Liqenasit që frekuentohen shumë gjatë periudhës së verës, të cilat janë duke tërhequr mjaft investitorë të ndryshëm për zhvillimin e turizmit.
- Fshati Boboshticë, i shquar për ambientin çlodhës dhe cilësinë e ushqimit që ofron, i kthyer tashmë në një pikë të rëndësishme turistike.
- Në fshatin Mborje (pranë qytetit) ndodhet një nga kishat më të vjetra që daton vitin 1390, por që është ngritur mbi rrënojat e një kisha akoma më të vjetër të shekullit IV. Dy fshatra të tjerë të afërt, Kamenica dhe Barçi, strehojnë gjetje të rëndësishme arkeologjike të Epokës të Bronzit. Sasia dhe cilësia e ambienteve dhe kapaciteteve akomodues në Korçë ka arritur standarde të larta tanimë dhe agjencitë turistike ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh. Një pjesë e rëndësishme e turizmit kulturor janë edhe muzeumet e qytetit si Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar (me një koleksion 7.000 vepra arti), Muzeu i Artit Oriental “Bratko” dhe Muzeu Arkeologjik.

Pista e fluturimit të aeroplanëve ndodhet në fushën e fshatit Lumalas në Komunën Bulgarec të rrethit të Korçës, pranë rrugës nacionale, në largësi 5 km nga qyteti i Korçës. Ajo shtrihet në një lartësi 830 m mbi nivelin e detit. Ka një sipërfaqe prej 343.200 m². Pista e fluturimit ka përmasa 2500 x 100 metra me kurs ulje dhe ngritje 191 -11 °. Planimetria e fushës jepet në hartën e mëposhtme. Kjo pistë ka pasur një gjatësi prej 3.745m. (sipas hartës bashkëlidhur, ku me ngjyrë kafe paraqitet sipërfaqja ekzistuese dhe me ngjyrë të verdhë pjesa e dhënë në pronësi) por aktualisht gjatësia e saj është 2500m pasi pjesa tjetër u është ndarë në pronësi me Ligjin nr.7501 datë..... banorëve të fshatit Porodinë. Kjo pistë është ndërtuar gjatë viteve 1960.

Fusha Lumalas Korçë. Ndodhet 0.8 km në perëndim të qytetit, rreth 8 km. nga qendra e qytetit, në një lartësi prej 830 m mbi nivelin e detit. Ka një sipërfaqe prej 343.200 m². Pista fluturimit ka përmasa 2500 x 100 m me kurs ulje dhe ngritje 191 -11 gradë.

Perspektivat e periudhës së zhvillimit 2010–2030 sipas parashikimit të zhvillimit të tregtisë, biznesit, turizmit, lëvizjes së emigracionit, dhe sistemeve intermodale të transportit. Trafiku i operimit i brendshëm dhe ndërkombëtar, konfigurimi Rrugëve ajrore dhe inresketimeve intermodale të transportit si dhe fluksi i mundshëm i pasagjereve në skemat pesimiste - normale dhe optimiste

Nga analiza e realizuara, në kushtet e vendit tone, një baze nisje në kufijtë e 3-6 përqind të transportit të udhëtarëve dhe 0.08–0.15 % e mallrave që lëvizin me transport rrugor në linjat, për të cilat do të parashikohet transporti ajror i brendshëm, është trafik plotësisht i arritshëm në këtë fazë.

Me rritjen e mirëqenies së popullsisë, pra të të ardhurave, si rezultat i GDP-se do të rriten edhe lëvizja e qytetareve dhe e mallrave. Mbështetur në ritmet e rritjes së GDP-se , ritmi i rritjes së trafikut të

udhëtarëve në transportin e brendshëm ajror do të jetë në kufijtë e 2,6-3,2 % në transportin e udhëtarëve dhe 3,5-7,5 % i mallrave.

Mbështetur në sa thamë me lart dhe disponimit të disa aeroporteve dhe fushave të fluturimit së aeroplanëve, do të japim një përcaktim dhe vlerësim të linjave ajrore që duhen të funksionojnë në vendin tone, 21% e udhëtarëve nga totali (që udhëtojnë në një drejtim, me lloje të ndryshme transporti), preferojnë të udhëtojnë me transportin ajror, në distance 80-320 km, nënkuptohet që edhe në vendin tonë ku distancat janë në këto kufij, do të preferohet ky lloj shërbimi

Perspektiva e zhvillimit të aeroportit të Korçës si pjese e infrastrukturës aeroportuale të vendit është mbështetur në metodologjinë e dokumentacioneve ekzistuese të Studimit të zhvillimit të Transporteve të brendshme të Republikës së Shqipërisë i përgatitur nga Instituti i Studimeve të Transportit , nga dokumenti baze i zhvillimit të tendencës së infrastrukturës së aviacionit të master Planit të Trafikut Ajror



Figura19



Figura 20



Figura 21

Transportit Ajror të përgatitur në vitin 2005 është synuar të jepet konfigurimi në nivel nacional të infrastrukturës së transportit të brendshëm dhe tendencat e zhvillimit të tij duke u mbështetur në boshtet kryesore :

- *Kuptimi i qarte i infrastrukturës në tërësi të aeroporteve të brendshme dhe inpaktit të tij në sistemin e integruar të transportit nacional dhe i kombinuar me ate internacional.*
- *Rëndësia e këtij lloj transporti në plotësimin e kërkesave të pasagjerëve dhe të individëve potenciale të menaxhimit të bizneseve parësore dhe turizmit selektiv të bazuar në principet e pilotimit të PPL.*

- **Projektimi i strukturës baze të një aeroporti të brendshëm mbështetur në kërkesat e aneksit 14 të ICAO dhe metodologjinë e projektimit të terminalit të funksionimit të tij të IATA.**
- **Vlerësimi i treguesve të kostos , impaktit në mjedis , integritit me infrastrukturën shumëllojshme të transportit.**
- **Ndikimi i transportit të brendshëm në degët e industrisë dhe inputet pozitive që jep për zhvillimin .**
- **Lehtësitë që kontribuojnë në zhvillimin e bizneseve dhe në tërheqjen e investimeve të vendit dhe të huaja.**
- **Krijimi i vendeve të reja të punës**
- **Menaxhimi e riskut duke e identifikuar ate dhe e vlerësuar ate , duke bere analizën SËOT(Strength , Ëeekness , Opportunities, Threats).**

HARTA E REPUBLIKES SE SHQIPERISE




Figura 22

Studim për zonën e Korçës në fushën e Lumalasit, sipas termave të referencës

- *Studimi plan vendosjes në tërësinë e elementeve gjeodezik të tij*
- *Alokimin e zonës në përputhje me shtrirjen e pistës sipas sistemit koordinativ EGS-84 të gjashtë pikave referuese kryesore përfshire dhe alokimin mbi nivelin e detit .*

- *Studimi në site i zonës së pengesave për të vlerësuar procedurat që do të përdoren në funksion të studimit urban dhe të sistemeve ndërrurbane.*
- *Krijimi i një qendre aktivitetesh të ndryshme që shumë shpejt do të përqendrohen përreth aeroportit ose në aeroport si aeroklube , parashutizëm , gliders etj*
- *Koordinimi i sistemeve intermode të infrastrukturës së transporteve lokale të koordinuar me atë kombëtare dhe ndërkombëtare .*
- *Ndryshimet që kërkohen për efektet e sigurimit të sipërfaqeve efektive të zonës së aeroportit dhe të peizazhit të tij.*
- *Aspektet teknike, arkitektura e sistemeve të ATC/TER , sistemeve të komunikimit , navigimit , burimeve të furnizimit me energji nga rrjeti publik , mundësitë e komunikimit me ATC Tirana si dhe infrastrukturën e nevojshme për safety dhe security përfshirë dhe shërbimet në toke ndaj avionëve me një motor apo shumë motorë në vartësi të klasës së aeroportit dhe shërbimeve të trafikut ajror që do të klasifikohen.*

Konfigurimi i planit të emergjencës dhe mjeteve mbështetëse të tij

Terminali i pasagjereve



Figura 23

- **Me shtrirje paralel me gjatësinë e VQA-se, dhe me vendosje në skajin jugor të saj, (ose në mes) është pranuar pozicionimi i Ndërtesës së Terminalit të Pasagjereve. Për përpunimin e pasagjereve me një fluks vjetor rreth 50.000 vete është parashikuar ndërtese me përmasa: 100*36 m e sipërfaqe të mbuluar 3.000 m², me 15 m distance nga vija fundore e VQA-se. Rekomandohet me konstruksion i lehte metalik.**
- **Kjo ndërtese do të kryejë edhe funksionet për ambientet e administratës e të shërbimit për punonjësit e Aeroportit e të Institucioneve të tjera publike operuese. në distancën 15 m janë konsideruar: përmasa 7.5 m e krahut të avionit që del jashtë vijës, hapësira e lire minimale 4.5**

m dhe 3 m plus. Kjo hapësire shërben për rrugë kalimet e pasagjereve e të mallrave, e shoqëruar me lulishte në të gjithë gjatësinë e VQA-se.

- Ndërtesa e Terminalit të Pasagjereve do të shërbeje për përpunimin e pasagjereve që do të nisen e që do të mbërrijnë në Aeroport. Nga studimi i fluksit të pasagjereve duhet të përcaktohet numri vjetor i tyre, shpërndarja sipas sezoneve (verore apo dimërore), shpërndarja ditore e orare, si dhe parashikimet për llojin e rrugës (e gjate apo e shkurtër), si dhe numri maksimal i pasagjereve për avionin me të madh të parashikuar
- Sipas destinacionit të Aeroportit përcaktohen dhe llojet e shërbimeve që do të kryhen në terminal. Studimi është realizuar duke u mbështetur vetëm në të dhënat për një aeroport të brendshëm, por meqenëse në perspektive mundet të aktivizohet edhe si aeroport ndërkombëtar duhet të sigurohen shërbime e sipërfaqe shtes:
 - *ambiente*
 - *sipërfaqe funksionale*
 - *poste e vajsje*

Planifikimi dhe projektimi i Aeroportit

Koncepte të përgjithshme.

Për shërbimin e udhëtimeve në linjat ajrore është e domosdoshme ndërtimi i kompleksit ndërtimor "Aeroport" i cili përbehet nga

Ndërtesa e Terminalit që shërben për kryerjen e të gjitha shërbimeve të duhura për nisje dhe zbritje të udhëtarëve

Pista me të gjitha elementet e saj që shërben për ngritjen, uljen, përpunimin, manovrimet dhe qëndrimet e avionëve që operojnë në linjat ajrore të rregullta dhe charter.

Aerodromi mbi toke, normalisht i quajtur "Aeroport", krijohet për të lejuar ekzekutimin me siguri, të manovrave ulje-ngritje të mjeteve fluturuese dhe për parkimin, furnizimin, mirëmbajtjen si dhe hipje – zbritjen e pasagjereve etj. Ajo pjese e aerodromit (sipas ICAO-s) që ka formën e një drejtkëndëshi (gjatësor) dhe shërben për ulje-ngritjen e avionit quhet PISTA (runway) dhe është pjesa kryesore e aeroportit.

"Kodi i Referimit të Aerodromit" i bazuar në karakteristikat (dimensionet) e avionëve që do operojnë mbi aerodrom, ku pikënisja e projektimit është ARFL (Aerodrome Reference Field Length) gjatësia e fushës reference të avionit, e cila është e përcaktuar në dokumentet certifikuese të avionit.

Te dhënat e marra nga studimi

a. për fluksin e lëvizjeve:

- fluksi i pasagjerëve në vit(i rrumbullakosur) 50,000 pax./vit
- numri mesatar i fluturimeve në dite 2 flut./dite
- - numri pik orar i pasagjereve 80 pax./ore
- *b. për tip-avionët që do operojnë:*

Është parashikuar që të operojnë për qëllime civile avionë Rajonale e avionë të biznesit, dhe për qëllime ushtarake avionë transporti të madhësisë ekuivalente me avionët civile. Për avionët civile dhe ushtarake është përpunuar një liste me 15 tipe, deri në peshe-ngritje maksimale MTOE = 40 ton

- **Analiza dhe vlersimi i kapaciteteve egzistuese te qarkullimit,**

Duke ju referuar shkallës aktuale të motorizimit (numrit të automjeteve për 1000 banor),treguesve të kërkesës për mobilitet urban të motorizuar kundrejt përmasave të shtrirjes dhe forms dhe përmasave të qytetit , shpërndarjes të vëndeve të punsimit , çerdheve , kopsteve dhe shkollave kapacitetet qarkulluese të qytetit nuk përbëjnë problem , ndërkoh që duhet të shikohet me kujdes problem i parkimeve , sidomos në perjudhën e sezonit turistik dhe fundjavës edhe gjatë gjith vitit , kuduhet të riorganizohet përdorimi i parkimeve me pages . sepse kjo mënyrë njifet në literaturën bashkohore si një nga **“përvojat më të mira Europiane”** për rregullimin e problemit të parkimeve . Po ashtu është e domosdoshme të rivendoset **“Transporti Publik Urban”** sidomos tani kur bashkia ka në teritorin e saj te gjithë bregun liqenor , keshtu këto linja transporti mund të studjohen për ti shërbyer një teritori dhe një numri përdoruesish më të madh , Këto dy element duhet te studjohen në fazën e dytë të projektit si rrugë dhe mundësi për rritjen e kapaciteteve egzistuese te qarkullimit Bashkin e Korçë .




Figura 24 Infrastrukt Rrugore për Bashkin Korçë sipas ndarjes të Re administrative

Në hartën e mësipërme ndonjë nominohet “Rrugët sipas Kategorive” është e qartë se edhe në legjend asnjë emërtes e rrugëve nuk është në përputhje me kërkesat e KRR dhe rregulloret dhe udhëzimet e MIT që janë nxjerë në funksion të tij.

- Parashikimi i nevojave konkrete të bashkive të reja bazuar në modelet dhe standartet bashkohore të planifikimit të transportit të cilat përmbushin nevojat për qarkullim në sistemet lokale , rajonale dhe kombëtare .

Ligjet baze të cilave I referohemi për hartimin e PPV në problemet e Mobilitetit dhe Transportit janë :

- **KODI Rrugor (KRR) të Republikës të Shqipërisë (Ligji nr 8378 date 22.7.1998)**
- **LIGJI 107/2014 “PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT”**
- **LIGJI Nr. 30/2015 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 8652, DATË 31.7.2000, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Duke filluar nga ky i fundit ne duhet të referohemi ndryshimeve që ka sjell ligji, të cilat kanë të bëjnë me ndryshimet në kompetencat e pushtetit vendor me organizimin e ri administrative të vëndit në 61 bashki , një nga të cilat është dhe **Bashkia e Pogradecit** . Në këtë rast ne na duhet të përcaktojmë se si përshtaten këto kompetenca me klasifikimet dhe kërkesat e Kodit Rrugor në lidhje me infrastrukturën e “Rrjetit Rrugor Urban” që janë pazgjidhsmerisht të lidhura në Projektet Urbane .

“Urbanistika” dhe “Mobiliteti Urban” sot janë lidhur në një “mënyrë” të përvokueshme dhe duhet të zgjidhin në harmoni të plote ndërmjet tyre, gjatë hartimit të Planeve Zhvillimore Urbane, problematiken komplekse që reflektohet në situatën e sotme të zhvillimit urban në të gjithë botën e në veçanti në vëndin tonë në kuadrin e Reformës Administrative , dhe kjo padyshim lidhet dhe me problemet që do të trajtojmë edhe për Bashkinë e Pogradecit .

Neni 1

Kudo në ligj, fjalët “komunë”, “kryetar komune” e “këshilli i komunës” hiqen. (*padyshim që dhe në KRR duhet hiqen rrugët e komunës*)

1. **Bashkitë** me popullsi më të madhe se 20 000 banorë janë të detyruara që brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij Kodi, të hartojnë planin urban të trafikut dhe sinjalizimit rrugor, detyrim për Bashkinë Korçë

2. Ministria që mbulon veprimtarinë përkatëse, brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij Kodi, të miratojë planin interurban të trafikut të mjeteve për aksin kryesor kombëtar të hartuar nga Instituti i Studimeve të Transportit.

3. Planet urbane dhe interurbane të trafikut azhurnohen çdo dy vjet.

(Siç ka rezultuar nga vrojtimet tona , ndonjë KRR ka hyrë në fuqi që nga viti 1998 deri më sot Bashkia Korçë nuk ka bërë asnjë “PUT” dhe për pasoj nuk ka patur deri më sot asnjë Inventarizim dhe klasifikim të rrjetit rrugor urban mbi kriteret e KRR)

Neni 11

Në nenin 44 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

3. Pas shkronjës “h” shtohen shkronjat “i” dhe “j” me këtë përmbajtje:

“i) miraton strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;

(Pikërisht ky nen i jep mundësi Bashis Korçë të krijoj një “Department të Mobilitetit dhe Transportit” per të siguruar kapacitetet dhe mundësit per të studjuar dhe vënë në zbatim PUT në një hapësirë tashmë të shumëfishuar gjeografike të shtrirjes të Bashkis dhe me nje rrjet rrugor shumë më të zgjatur , të pa klasifikuar , të pa mire reflektuar në harta dhe të pa kontrolluar saktësisht përsa i përket qëndjes në mirmbajtje dhe të paisjes me sinjalistik vertikale dhe horizontale , për të cilin Bashkia tashme është pronar.)

Neni 75/2

Deri në datën 31 dhjetor 2017, në çdo njësi administrative funksionon administrata e njësisë administrative. Nga 1 janari 2018, këshilli i bashkisë ka kompetencën të vendosë për riorganizimin e administratave të njësive administrative, të cilat mund të mbulojnë territorin e një ose më shumë njësive administrative brenda bashkisë, sipas nevojave të komuniteteve vendore dhe efektshmërisë administrative.”.

Miraturar në datën 2.4.2015

Autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit në nivel bashkie janë:

- a) këshilli bashkiak;
- b) kryetari i bashkisë

Objektivi që buronë nga Ligji 107/2014 “PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT” I lidhur drejtpërsëdrejti me transportin është krijimit të infrastrukturës fizike të përshtatshme për nxitjen e investimit në ushtrimin e veprimtarive ekonomike, sociale e kulturore, lehtësimit të përdorimit të sigurt të shërbimeve e komoditeteve publike, të transportit, komunikimit dhe infrastructures.

Politikat e PPK ne fushen e transportit sigurojne :

- **Zhvillimi i infrastrukturës lidhëse me koridoret e transportit Paneuropian**
- **Rritje e zgjuar e Sistemit Urban**
- **Promovimi dhe Akses i zonave me karakteristika natyrore, peisazhistike, kulturore e historike.**
- **Zhvillimi i Sistemit të Transportit Multimodal dhe miqësor ndaj ambientit.**
- **Planifikimi dhe zhvillimi i integruar i komunikimit, transportit, ushqimit dhe energjisë**

Bashkia e Korçë në Kontekstin European , rajonal dhe kombëtar përfshihet në :

- **Korridori VIII {Pogradec, Korçë} Rrugor dhe Hekurudhor**
- **Via Egnatia {Pogradec}**
- **Rrugët ujore ne ligenin e Ohrit**

Materialet që kemi mundur të sigurojm nga Bashkia Pogradec për të realizuar vlersimin e analizës të kërkuar në fushën e transportit kane qënë :

- “set” hartash për ish Bashkin Pogradec
- “set” hartash Bashkin sipas ndarjes te re administrative ,
- Detyra e proektimit per Planit e Pergjithshem rregullues të qytetit Pogradec ,

- Takimet në Bashki me Kryetarin e Bashkisë, me shefat e sektoreve , takimi I vecante me shefin e urbanistikes , te sherbimeve dhe te transportit të Bashkis ,
- Informacionet e këmbjera me sektorin e transportit në Bashki , për rrjetin rrugor urban dhe regjistrimin e automjeteve në zyrën rajonale në Korçë
- Të dhëna nga DPSHTRr për regjistrimin në vite të automjeteve
-

19.3.11. Burimet

Materiale të tjera që kemi shfrytëzuar për analizën janë:

- ANEKS III/3 Shërbimet utilitare dhe infrastrukturore në Njësitë e Qeverisjes Vendore
Funksionet ligjore të NJQV lidhur me utilitetet dhe infrastrukturën Prill 2014
- Strategjia Territoriale Bashkia Durrës 2015-2030 Dekument Pune Shkurt 2016
- Studimi i Fizibilitetit të Lidhjes Hekurudhore Shqipëri Maqedoni
- Hierarkia e Qëndrave PPK
- INSTAT – Census 2011
- Ligji Nr. 107/2014 Për Planifikimin Dhe Zhvillimin E Territorit
- Transport Infrastructure Priority Projects 2014 MTI
- Meiodika e hartimit te PUT MTI 2012
- Kartelat e rrugeve , rrugeve lidhese , shesheve dhe blloqeve per qytetin e pogradecit
- TERMAT E REFERENCËS SHËRBIM KONSULENCE, PËR HARTIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE, PËR 26 BASHKI, NË SHQIPËRI
- Allegato Idee per i Piani di Mobilita Urbana Sostenibile
- Piano Strategico per la Mobilità Sostenibile Dipartimento Mobilità - a tutti loro va il ringraziamento del Comune di Roma – 2009
- Aggiornamento del Piano Urbano del Traffico del Comune di Bergamo 2013

Të gjithë këto materiale do I paraqesim në një aneks të vecantë bashkangjitur këtij materiali. Ndonse të pakta , këto material na kanë ndihmuar për të bërë një analize të gjëndjes të transportit në këtë Bashki për të vlersuar pikat e forta , dobsit , risqet dhe mundësit , për të vazhduar në hartimin e një “Plani Struktural” sipas kërkesave që duhet të realizohet Plani Zhvillimor Vendor .

Objektivat

Ne Planin Struktural te qytetit te **Korçës** «Klasifikim i Rrjetit Rrugor » duhet te mbeshtet ne Kodin Rrugor te Republikes te Shqiperise (Ligji nr 8378 date 22.7.1998) ne perputhje me destinacionin e rrugeve urbane dhe me rritjen e pritshme urbane dhe territorial. Kjo nuk mund te kufizohet brenda afatit kohor te Projektit (2025) por duhe bazuar ne projeksione te nje periudhe prespektive 50 vjecare, sepse investimet qe kerkohen per te realizuar pershtatjen e klasifikimit te rrjetit rrugor sipas destinacionit te rrugeve me parametrat gjeometrik te trafikut jane te larta. Ato duhet te shperndahen ne nje kohe relativisht te gjate me qellim qe planifikimi të jetëreal dhe i mundshem per tu zbatuar. Dimensionet e seksioneve te planifikuara per secilen kategori te rrugeve te qytetit do te paraqitura qarte ne harten e zhvillimit te qytetit. Mbi kete baze, Bashkia do te percaktoj

qarte kufijte e rrjetit te ardhshem te rrugeve te Pogradecit, kufij te cilet nuk duhet te preken pavarisht nga koha kur do te mund te ndertohen keto Rrugë me seksionet e dhena sipas standartit .

19.3.12. Disa përcaktime bazë për Planin Urban te Bashkis Korçë me te gjitha kategorite e rrugeve.

Nje plan i tille duhet te realizohet per te siguruar ne menyre te veçante:

- **Permiresimin e kushteve te qarkullimit (levizjen dhe parkimet)**
- **Reduktimin e aksidenteve rrugore**
- **Reduktimin e ndotjes atmosferike dhe zhurmave**
- **Respektimin e vlerave ambjentale**
- **Zvogelimin e shpenzimeve publike dhe private**

Eshte e qarte se “Kodi Rrugor te Republikes te Shqiperise” dhe “Rregullorja e zbatimit te Kodi Rrugor”, edhe ne ditet tona nuk eshte plotesuar me normat dhe standartet e duhura shqiptare qe duhet te perdoren ne zbatim te tij ne fushen e ndertimit te rrugeve ne pergjithesi dhe rrugeve urbane ne veçanti . Ne kushtet e nje boshlleku te tille duke patur parasysh se ky Kod Rrugor eshte mbeshtetur ne “Kodin e ri Rrugor” te Republikes Italjane (1992) dhe se te gjitha aktet normative te projektimit te tij bazohen ne Normat CNR , te cilat jane bashkohore me ato te normave Europiane , IST ka rekomanduar perdorimin e ketyre standarteve ne ndertimin e rrugeve te reja urbane duke pershtatur disa udhezues qe jane miratuar nga Ministria e transportit ose dhe nga Keshilli i Ministrave te Republikes te Shqiperise .

Rrugët ekzistuese


Nga analiza e bere nga materialet që kemi disponuar , bazuar ne inventarizimet apo vrojtimet e pjeseshme te bera ne studime te tjera me pare del qe rrugët egzistuese në qytetin e **Korçës**, nuk i pergjigjen parametrave gjeometrike të trafikut aktual dhe atij të prespektives . Kështu mund të përmendim se:

- rrugët egzistuese ne qytet kane ne te njejtën rrugë gjersi te ndryshme të karexhatës .
- rrugët nuk kanë trotuare ne gjithë jatësin e tyre , ose kanë trotuare vetëm në njërin krah të karexhatës ,
- trotuaret në vijushmëri të gjatësis të tyre ndryshojn nga ndërtimi struktorore ,
- karexhata ndryshon në gjatësi të saj nga ndërtimi strukturor në të njëjtën rrugë në gjatësi të saj ,
- gjendja e mbulesës të rrugës në rrjetin rrugor ne pjesën më të madhe është në gjëndje të dobët ose të keqe,
- mungon në përgjithësi sinjalistika vertikale dhe horizontale në rrjetin rrugor ,
- ka mangësi të theksuara në përcaktimin e vënd parkimeve në rrjetin rrugor dhe jasht tij,
- gjëndja e rrjetit rrugor që lidh njësit e reja administrative (ish komunat) me qëndrën është në gjëndje shumë të keqe ,po ashtu mungon plotësisht sinjalistika vertikale dhe horizontale .

- nuk është i qartë inventari i rrjetit rrugor të bashkis të re , si për ato rrugë që kalojnë nga ish komunat , qarku apo edhe nga AKRr
- duhet të ndërhyhet edhe në Kodin Rrugor për ndryshime në emërtesën e klasifikimit të pronësis të rrugëve

Kriteret Teknike të Rregullimit të Qarkullimit në Qendrat e Banuara përcaktojnë drejtimit dhe kushtet nga të cilat duhet të orientohen projektuesit e PUT-it . **Synimi është** për të siguruar një organizim sa më fluid dhe me


siguri të lartë në zonat urbane, në përputhje me Kodin Rrugor dhe Rregullores së tij në zonën urbane. Në këtë kuptim Kriteret Teknike luajnë rolin e Kushteve Teknike dhe janë të detyrueshme për të gjithë projektuesit e



ZONE RRUGORE


kësaj fushe. Planet urbane të Trafikut duhet të përshkruajnë plotësisht me treguesit më të fundit të planifikimit urban, si plane në proces, në përmirësim të vazhdueshëm sipas kërkesës dhe ofertës të transportit.

Kufi Rrugor perkufizohet si fundi i pronësisë rrugore, i cili rezulton nga aktet e blerjes ose nga brezat e shpronësimit të projektit të miratuar. Në mungesë të tyre, kufiri formohet nga buza e jashtme e hendekut të sigurimit apo kanalit, kur ai ekziston, ose nga këmba e skarpatës, nëse rruga është në lartësi, ose nga buza e sipërme e skarpatës, nëse rruga është në thellësi. Këto kufi nuk mund të përcaktohen nëse nuk kemi bërë paraprakisht klasifikimin e rrjetit rrugor nga ku varen këto kufij sic përcaktohet në vijim




Prospekti i aplikimit te distancave te ndaluara per ndertim ne aferesi te gjithe kategorive te rrugeve


Vendndodhja	Lloji i ndertimit	Rrugë e tipit Autostrade A	Tipi B Extra urbane kryesore	Tipi c Extraurbane Sekondare	Tipi D Urbane te pershpejtimit	Tipi E Urbane te lagjeve	Tipi F Lokale te fqinjëve
Ex. Urb	Ndertime te reja dhe rikonstruksione ne zona te lira	60	40	30	-	-	10- 20
Ex. Urb	Ndrtime te reja , rikonstruksione	30	20	10	-	-	-
Ex. Urb	Kanale te reja	3	3	3	-	-	3
Ex. Urb	Ndertime muresh rrethuese	5	5	3	-	-	3
Ex. Urb	Mbjellje pemesh	6	6	6	-	-	6
Ex. Urb	Stalla te gjes te gjalle (bagetive)	30	30	30	-	-	-
Ex. Urb	Plantacione	1	1	1	-	-	1
Urbane	Ndertime te reja te integruara me shtrirje drejt rruges	30	-	-	20	-	-
Urbane	Ndertime rikonstruksioni ne drejtim te rruges	30	-	-	20	20	10



PRIMARY 1. (ARTERIAL or URBAN MOTORWAY)




PRIMARY 2. (COLLECTOR ROAD)



SECONDARY (ACCESS ROAD)

CATEGORY A2


URBAN HIGHWAY



BYPASS SECTION

CATEGORY A1


PRIMARY ROADS



Road Section 3-3

This solution proposes : four driving lanes,two for each sense of movement


**SECONDARY ROADS
(Close to the city center)**



Road Section 1-1

This solution proposes : two driving lanes including two parking areas per each.

**SECONDARY ROADS
(Far from the city center)**



Road Section 2-2

This solution proposes : two driving lanes, one for each sense of movement

Ç. Zhvillimi Social dhe Ekonomik

20. Demografia

Popullsia dhe sipërfaqja e zonave urbane të Bashkisë Korçë

Emërtimi	Nr.	Sipërfaqja e njësive administrative	
		iNr. i familjeve	në zonave urbane në
Korçë	86 894	28 727	456
Drenovë	10 698	2 620	326
Lekas	1 100	327	50
Mollaj		1 401	109
Bulgarec	13 980	3 241	465
Pop. Vithkuq dhe Mollaj	9 135	741	90
Voskop	6 024	1 626	160
Voskopojë	2 700	722	48
TOTALI	130 531	80 600	1 704 (2%)

Për periudhën 01.01.2014 deri më datën 31.12.2014, në qytetin e Korçës janë evidentuar:

469 akte lindje

602 akte vdekje

365 akte martesore

Numri i të ardhurve në qytet gjatë 2014 rezulton në 135 persona, shumica e të cilëve janë të ardhur prej fshatrave rreth qytetit të Korçës (59%) dhe qarkut të Tiranës (16%). Pjesa tjetër e të ardhurve iu përket qarqeve të Durrësit, Elbasanit, Përmetit, Fierit, Vlorës, Lezhës, Beratit, Shkodrës, Sarandës, Laçit, Gramshit, Lushnjës dhe Kukësit. Të ardhurit banojnë në lagje të ndryshme të qytetit, dhe shpërndarja e tyre në përqindje sipas lagjeve jepet në tabelën e mëposhtme:

Lagjja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
%	3	1	0	13	3	4	6	4	5	16	1	1	1	5	6	10	10	9

Sipas të dhënave të mësipërme, përqindja më e madhe e të ardhurve janë vendosur në lagjet 10 (16%) dhe 4 (13%). Të dyja zonat e këtyre lagjeve karakterizohen nga ndërtime të reja të pas viteve '93, e para me pallate shumëkatëshe dhe e dyta me shtëpi private 2-3 kate. Bazuar në faktin se përqindja më e lartë e të ardhurve është nga fshatrat rreth qytetit të Korçës, është e nevojshme të theksohet se lagjja 10 ndodhet më afër fshatrave të Barçit dhe Dishnicës, kurse lagjja 4 më afër fshatrave Mborje e Drenovë. Nga ana tjetër përqindjet më të vogla të të ardhurve janë në lagjen 1 (3%), lagjen 2 (1%), lagjen 3 (0%), lagjen 11 (1%) dhe

lagjen 12 (1%). Duhet theksuar se këto lagje përbëjnë bërthamën tradicionale të qytetit, me popullsi të konsoliduar prej shumë vitesh. Fakt tjetër është përqindja 9-10%, e vendosur në lagjet 16, 17 dhe 18. Zonat e të treja këtyre lagjeve karakterizohen nga pallate të ndërtuara para vitit '93, ku dhe kostoja e blerjes apo e marrjes me qera të një apartamenti është më e ulët. Numri i të larguarve gjatë vitit 2014 është 32 persona. Destinacioni i largimit të tyre pasqyrohet si më poshtë:

Elbasan	22%
Berat	6%
Vlorë	3%
Fier	6%
Tiranë	56%
Qarku Korçë	3%

Popullsia e qarkut Korçë për vitet 2011-2014, krahasuar me popullsinë e përgjithshme

Viti	Qarku Korçë			Shqipëri		
	Gjithsej	Rurale	Urbane	Gjithsej	Rurale	Urbane
2010	232.041		140.996	2.913.018		1.371.710
	91.074			1.541.308		
2011	228.794		138.848	2.904.776		1.340.638
	89.945			1.564.138		
2012	226.805		137.545	2.900.486		1.304.787
	89.259			1.595.699		
2013	226.174		137.311	2.897.365		1.263.748
	88.863			1.633.617		
2014	225.116		136.446	2.894.476		1.241.376
	88.670			1.653.100		

Qarqet	Dendësia
Shqipëria	100,7
Berat	80,0
Dibër	53,1

Durrës	359,9
Elbasan	94,4
Fier	167,4
Gjirokastrë	25,3
Korçë	60,7
Kukës	36,2
Lezhë	84,9
Shkodër	61,7
Tiranë	481,0
Vlorë	67,6

Dendësia e popullsisë, banorë për km², 2014, Burimi: Instat, Vjetari

Projeksionet e popullsisë, në vitet 2011-2031⁷

Lindshmëria		Vdekshmëria	
Qarku Korçë	Shqipëri	Qarku Korçë	Shqipëri
11/1000 banorë	12/1000 banorë	10/1000 banorë	7/1000 banorë

Norma
bruto e
lindsh
mërisë

dhe vdekshmërisë në vitin 2014

Popullsia e Shqipërisë ka ardhur duke u zvogëluar pas vitit 1990. Ritmi i rënies së popullsisë ka qenë më i lartë gjatë viteve 2001- 2010, ndërkohë që pas vitit 2010 ritmi i rënies së popullsisë është zvogëluar. Në këtë

Viti	Qarku Korçë	Shqipëri
2011	230.261	2.907.362
2016	224.872	2.888.996
2021	217.996	2.863.311
2026	210.114	2.827.569
2031	201.976	2.782.309

rënie të popullsisë një ndikim të konsiderueshëm ka migracioni neto dhe më pak shtesa natyrore e popullsisë. Ndërkohë që komponenti i parë vazhdon të mbetet negativ, i dyti edhe pse është pozitiv, ka pësuar rënie gjatë periudhës në fjalë.

⁷ Të dhëna të marra nga Relacioni i PPV Korçë dhe Instat, Vjetari 2015. Komentet janë të autorit

Ndryshimet demografike në Shqipëri do të sjellin ndryshime të konsiderueshme në dekadën e ardhshme. Ashtu siç parashikojnë projeksionet e popullsisë (2011- 2031), popullsia e Shqipërisë do të përfundojë ulje të numrit të lindjeve dhe shtesa e saj natyrore do të barazohet me zero – pra lindjet do të barazohen me numrin e vdekjeve, në vitin 2027.

Gjithashtu migracioni nga ana tjetër luan një rol shumë të rëndësishëm në dinamikën e popullsisë, ku Shqipëria vazhdon dhe do të vazhdojë të përfundojë flukse dalëse të popullsisë. Këto flukse do të kompensohen sado pak nga migracioni i kthimit edhe në vitet në vazhdim ashtu sikurse sugjerojnë projeksionet e popullsisë.

Në këtë mënyrë popullsia e Shqipërisë po shkon drejt procesit të plakjes si pasojë e uljes së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë dhe për më tepër emigracionit i cili vazhdon të mbetet veprues dhe që përfshin një popullsi relativisht të re. Pavarësisht rënies së popullsisë, ky fakt nuk mund të përgjithësohet për të gjitha qarqet.

Ka qarqe të cilat gjatë pesë viteve të fundit kanë pësuar rritje të numrit të popullsisë ku mund të përmendim qarkun e Tiranës, qark i cili gjatë periudhës në fjalë është karakterizuar nga norma rritjeje pozitive të popullsisë, i ndjekur nga Durrësi, për të cilin përjashtim bën viti 2013 ku shënon rënie të numrit të popullsisë. Rritja e popullsisë në këto dy qarqe i dedikohet kryesisht lëvizjeve të brendshme, të cilat kanë patur destinacion këto dy qarqe. Ndërkohë që qarqet e tjera të vendit kanë pësuar një rënie në numrin e popullsisë.

20.1. Struktura e popullsisë

Pesha që zënë të moshuarit (65+) në popullsi gjatë këtyre pesë viteve ka tendencë në rritje. Në vitin 2014, në totalin e popullsisë mesatare të Shqipërisë, të rinjtë (0-14vjeç) zënë 18.9% të popullsisë gjithsej, ndërsa popullsia në moshë pune (15-64vjeç) llogaritet rreth dy të tretat (68.9%) e popullsisë gjithsej, duke lënë kështu vetëm 12.2% të popullsisë gjithsej për popullsinë në moshë 65 vjeç e lart.

Qarku	Gjithsej			Meshkuj			Femra		
Shqipëri	0-14	15-64	65+	15-64	15-64	65+	65+	15-64	65+
	546 473	1 993 770	354 232	284 766	1 005 921	170 298	267 708	987 850	183 935
Korçë	0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+
	43 326	154 123	27 667	22 499	78 687	13 407	20 827	75 435	14 261
Tiranë	0-14	15-64	65+	15-64	15-64	65+	65+	15-64	65+
	146 791	551 046	96 821	76 514	273 249	45 956	70 278	277 797	50 865

Vjetari Statistikor 2015: Instat

20.2. Lëvizjet e popullsisë

Sipas statistikave, nga 1 Janari 2010 deri në 1 Janar të 2015 popullsia e vendit tonë është zvogëluar me rreth 26 mijë banorë, ekuivalente kjo me një normë rritjeje prej -0,2 % në çdo vit, gjithmone sipas Instat, ndryshimet në popullsi kanë ardhur si rezultat i dy komponentëve: shtesës natyrore të popullsisë dhe migracionit neto.


Gjatë këtyre pesë viteve të fundit, Shqipëria ka përjetuar ndryshime të dukshme. Jo vetëm që popullsia banuese ka pësuar ulje nga 2.913.017 në vitin 2010 në 2.894.476 në vitin 2014, por një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ka lëvizur brenda Shqipërisë.

Shpjegimi sipas instat i referohet më së shumti fenomenit të urbanizimit. Sipas të dhënave pjesa më e madhe e njerëzve që ka ndryshuar vendbanimin në pesë vitet e fundit kanë lëvizur në qendrat urbane, që në shumicën e rasteve, përfshijnë kryeqytetin, Tiranën, ose zonat përreth tij.

Sipas të dhënave të Instat, duket qarte se qarku i Tiranës është ai që tërheq pjesën më të madhe të migrantëve të brendshëm, po ashtu dhe qarku i Durrësit, duke qenë kështu qarqet dominant për migracionin e brendshëm.


Norma bruto e migracionit të brendshëm: Vjetari Statistikor 2015

Qarku	Norma e migracionit
Tirana	9,1
Korça	-4,7



Lëvizjet e brendshme të popullsisë: Vjetari Statistikor 2015

DEMOGRAFIA
Migrantët e kthyer 2011
Shkalla 1: 120000




BASHKIA KORÇE
BURIMI: CENSUS 2011
PERPUNIMI: IDRA


Migrantët e kthyer: Grafik IDRA

NDRYSHIMI I POPULLSISE

1989-2011



Grafik IDRA



21. Aspektet Sociale

21.1. Strategjitë e mbrojtjes sociale


Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015–2020, adreson çështjet në fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), në lidhje me:

skemën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar;

ii) shërbimet e kujdesit shoqëror ekzistuese dhe ato të propozuara; dhe


iii) çdo çështje tjetër në fushën e mbrojtjes sociale.

Figura 1: Varfëria sipas rajoneve, 2008-2012 (%)



Burimi: INSTAT "Treguesit e varfërisë sipas rajoneve"

Figura 2: Numri përfituesve dhe shpenzimet për skemën NE dhe Pagesat për Aftësinë e Kufizuar (PAK), 2005-2014



Qeveria është duke zbatuar një reforme të gjerë të skemave të NE-së dhe PAK-ut me mbështetjen e Projektit për Modernizimin e Asistencës Sociale (PMAS) të Bankës Botërore. PMAS-i mbështet zbatimin e reformave në Shqipëri për të rritur efikasitetin dhe barazinë në akses dhe transparencën e skemave të NE-së dhe PAK-ut.

Sfidat lidhur me skemën e Ndhmës Ekonomike.

Sfidat e mëtejshme të politikës lidhen me rritjen e eficiencës së skemës së ndihmës ekonomike duke e kthyer nga një skemë pasive në një skemë aktive nëpërmjet programeve të ri-integrimit dhe alternimit të tyre me skemat e punësimit.

21.2. Aftësia e kufizuar

“Pagesa e Aftësisë së Kufizuar” (PAK) është pjesë e programit të Mbrojtjes Sociale dhe shërben për të mbështetur njerëzit me aftësi të kufizuara dhe përmirësuar cilësinë e jetesës. Aktualisht PAK është mekanizmi i vetëm për mbështetjen e tyre, pasi vlerësohen për nivelin e aftësisë së kufizuar nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë (KMCAP).

Shpenzimet për pagesat e aftësisë së kufizuar janë rritur ndjeshëm në vitet e fundit dhe tashmë përbëjnë pjesën kryesore në shpenzimet e Mbrojtjes Sociale. Kjo është shkaktuar nga indeksimi i lartë i përfitimit dhe mbulimi i zgjeruar. Masa e pagesës për aftësinë e kufizuar është shumë më i lartë se masa e NE-së. Për shembull, shuma e pagesës për aftësinë e kufizuar për një person me aftësi të kufizuara fizike ose mendore është 9900 lekë në muaj (në krahasim me një pagesë mesatare familjare të vetëm 3,800 lekë si NE).

Sfidat lidhur për aftësinë e kufizuar

Sfidat e mëtejshme të politikës lidhen me vlerësimin e kriterëve të aftësisë së kufizuar, rishikimin e masës së pagesave të aftësisë së kufizuar në përputhje me standardet bashkëkohore evropiane dhe riintegrimin e PAK-ut me shërbimet sociale dhe shëndetësore.

21.3. Shërbimet e Kujdesit Shoqëror. Shërbimet

e Kujdesit Shoqëror janë pjesë e Programit të Mbrojtjes Sociale, të financuara nga buxheti i shtetit. Aktualisht ka mangësi në mbulimin e të gjithë nevojave për shërbime të grupeve vulnerabël në nivel kombëtar. Shërbimet të kujdesit shoqëror të specializuara janë siguruar nga organizatat jofitimprurëse e financuara në baza vullnetare ose nga partnerët. Shërbimet mund të gjenden kryesisht në zonat e mëdha urbane (90% janë në zonat urbane) dhe 75% e tyre përqendrohen në zonat perëndimore dhe qendrore të vendit. Ndryshe nga skemat e pagesave të NE dhe PAK, sfida këtu është ngritja e një sistemi shërbimesh të përkujdesit shoqëror që të mund mbulojë më gjerë nevojat e grupeve në nevojë për shërbime shoqërore të integruara dhe efikase.

Shërbimet e kujdesit social përbëjnë një përqindje të vogël (më pak se 5%) të shpenzimeve totale të MMSR-së për mbrojtjen sociale (fig. 3), ku pjesën më të madhe të shpenzimeve vjetore e zënë Ndihma Ekonomike dhe PAK. Edhe pse shpenzimet e MMSR-së për kujdesin shoqëror janë gati dyfishuar nga viti 2005, nuk ka pasur rritje të shpenzimeve të tyre në krahasim me shpenzimet në total, por një ulje gjatë dekadës së fundit.

Sfidat e lidhura me shërbimet e kujdesitshoqëror.

Sfidat e mëtejshme të politikës lidhen me krijimin e një sistemi funksional dhe efektiv të kujdesit shoqëror të bazuar në parimin e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale. Për këtë gjë nevojitet të strukturohet një rrjet në territor dhe të përcaktohen paketat e shërbimeve dhe integrimi i tyre, ashtu si dhe masat e financimit të nevojshëm. Financimi i shërbimeve mbetet një tjetër çështje që duhet adresuar, pasi aktualisht zënë një pjesë të vogël të shpenzimeve të programit të mbrojtjes sociale. Shërbimet e përkujdesit shoqëror duhet të shenjëstrojnë kategoritë më të rrezikuara, duke synuar mbulimin e tyre me shërbime dhe në varësi të mundësisë së financimit, të vazhdojë mbulimin progresiv të popullsisë.

Sfidë mbetet administrimi i procesit të licencimit dhe kontrollit/inspektimit të institucioneve të përkujdesit shëndetësor. Këto procese dhe procedura punë duhet të sigurojnë cilësi dhe standarde të shërbimeve. Edhe vetë standardet janë objekt përmirësimi i vazhdueshëm. Përtej strukturimit të proceseve të punës, ashtu si dhe vetë strukturave përgjegjëse, sfida mbetet rritja e kapaciteteve të personelit, përfshirë këtu edhe ato që japin shërbimet.

Qasjet e reja siç është qasja e *ciklit të jetës* kërkojnë fuqizim të aktiviteteve të planifikimit, organizimit, administrimit dhe kontrollit të shërbimeve të përkujdesit në të gjitha nivelet.

Modelet e shpërndarjes dhe strukturimit të rrjetit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror janë të shumta dhe ndërvarësitë e tyre nga qeverisja vendore dhe qendrore mund të jenë të ndryshme. Për këtë arsye, sfida mbetet analiza dhe gjetja e modelit më të përshtatshëm të decentralizimit të shërbimeve, e harmonizuar kjo me reformën territoriale që po zbatohet në vend.

Qeveria shqiptare mbështet ofrimin e kujdesit social në komunitet në masën më të madhe të mundshme dhe një reduktim në kujdesin institucional deinstitutionalizimi mbetet një sfida, pasi kërkon krijimin e një rrjeti shërbimesh në territor, strukturim të proceseve dhe procedurave për menaxhimin e rasteve dhe rritje kapacitetesh të profesionistëve.

Një çështje tjetër që paraqet sfida është prania e hapësirave të pambuluara me shërbime nga institucionet publike dhe që mund të mbulohej nga institucionet private apo të sektorit të tretë. Kështu në rastet kur

mungojnë shërbimet nga institucionet publike shërbimet duhet të kontrahohen nga organizatat jofitimprurëse apo ofrues të tjerë të shërbimeve. Kjo do të zvogëlonte kostot e ngritjes (*set-up*) (dhe kohën) dhe të lejonte fleksibilitet më të madh në ofrimin e shërbimit (p.sh. vetëm shteti do të ishte i kufizuar në ofrimin e llojeve të veçanta të shërbimeve). Prandaj duhet të merren masa për të analizuar më mirë llojet e aktiviteteve dhe kostimi i tyre për të gjitha institucionet në bazë të tipologjisë së shërbimeve.

Vizioni, politikat dhe qëllimet strategjike

E drejta për mbrojtjen sociale është reflektuar në Kushtetutën e Shqipërisë. Neni 9 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore njih të drejtën e secilit për të pasur mbrojtje sociale. Në mënyrë të ngjashme, në Konventat e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara njohin, gjithashtu, të drejtat e veçanta për mbrojtjen sociale. Zbatimi i suksesshëm i kësaj strategjie do të kontribuojë në përfundimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri. Parimet janë:

Të drejtat civile, barazia dhe mosdiskriminimi: Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara etj.

Mbrojtja: Grupe të veçanta, duke përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.

E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit: Një mjedis i përshtatshëm duhet të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve.

Pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikëpamjeve: Individët janë përgjegjës për jetën e tyre. Ata duhet të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre brenda normave që shoqëria ka vendosur.

21.4. Përfshirja dhe integrimi.

Respektimi i të drejtave dhe nevojave.

Partneriteti: koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.

Cilësia e shërbimeve.

Standardet Kombëtare udhëheqin vendimmarrjen në nivel vendor. Strategjia ka gjithashtu, synimin të shërbejë si bazë për dialog të mëtejshëm të strukturuar me Bashkimin Evropian (BE), agjencitë ndërkombëtare dhe partnerët socialë mbi çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes sociale. Një qëllim i rëndësishëm është përputhja me Agjendën Sociale të BE-së 2020, duke ndihmuar vendin në arritjen e synimeve të saj për integrimin në BE.

Programet Parandaluese dhe të Riintegritit Social të alternuar me skemat e punësimit do të konvergojnë me konceptet të cilat po përshtaten aktualisht nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Në vitin 2020 mirëqenia e përgjithshme e popullsisë do të jetë përmirësuar, varfëria dhe përjashtimi social do të jenë zbutur, nëpërmjet realizimit të qëllimeve dhe objektivave strategjike të shtjelluar në këtë strategji ndërsektoriale.

Vizioni

Ndërtimi i një sistemi mbrojtjeje sociale që të luftojë

pabarazitë social-ekonomike, parashikimi i një sistemi që ka politikat dhe mekanizmat për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë, ose të përjashtuar nëpërmjet programeve parandaluese dhe riintegritit social alternuar me skemat e punësimit.

Politikat

- A. Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë
- B. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara
- C. Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social,

22. Mbrojtja shoqërore dhe varfëria

Ndihma Ekonomike përbën një nga programet e Mbrojtjes Sociale, që jepet në formën e një pagese mujore në para për familjet dhe individët që kanë më shumë nevojë për mbështetje nga shteti. Shpërndarja e numrit të përfituesve të ndihmës ekonomike në Bashkinë Korçë, është:

Familjet me ndihmë ekonomike

NJËSIA ADMINISTRATIVE	FAMILJE N/E	NR. FRYMËVE	NR. FAMILJE KOMPENSIM ENERGJIE	FONDI ENERGJI	SHUMA NË LEK
Qyteti	945	2444	218	281784	3658294
Njësitë	235	836	84	108192	730659
Shuma	1180	3280	302	389976	4388953



Fondi mesatar i ndihmës ekonomike: Vjetari statistikor 2015: Instat

Qarku	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	334 437	362 579	360 921	387 987	297 447
Tirana	36 149	45 894	49 172	64 670	34 282
Korça	25 930	29 877	28 319	28 398	25 503

Bashkia Korçë: Vjetari statistikor 2015: Instat

Ndihma ekonomike	Total
Korçë	1073
Drenovë	59
Lekas	40
Mollaj	51
Bulgarec	10
Vithkuq	25
Voskop	26
Voskopjë	25

Familje me ndihmë sociale dhe përfitimet e tjera⁸



Vjetari statistikor 2015: Instat

Qarku | Treguesit e varfërisë

⁸ Grafiku IDRA,

	Përqindja	Hendeku	Ashpërsia
Shqipëria	14,3	3,0	1,0
Tirana	13,9	2,7	0,8
Korça	12,4	2,5	0,7

22.1. Personat me aftësi të kufizuara

Plani i Veprimit u hartua në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjin “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”:

Mosdiskriminimi, i cili garanton që personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;

Barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta;

Autonomia e personave me aftësi të kufizuara dhe respektimi i pavarësisë së vendimmarrjes së personave me aftësi të kufizuara;

Garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimi të pengesave të të gjitha llojeve;

Përfshirja, nëpërmjet së cilës mundësohet pjesëmarrja e duhur dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës;

Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara;

Qasja në dy drejtime, për të integruar në maksimum të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin e zakonshëm dhe për t'i kufizuar në minimum çështjet që duhen trajtuar më vete;

Realizimi progresiv, sipas të cilit qeveria ndërmerr masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejojnë burimet e disponueshme, pa cenuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara⁹.

Aksesueshmëria (përfshirë aksesueshmërinë në informacion dhe fizike),

Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike (përfshirë aktivitetet kulturore dhe sportive),

Barazia,

Punësimi dhe Arsimi e Formimi Profesional (AFP),

Arsimimi,

Kujdesi social,

Kujdesi shëndetësor, dhe

Nxitja e bashkëpunimit, koordinimit dhe Monitorimit e Vlerësimit.

⁹ Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020, f. 6-7

23. Aksesueshmëria

Aksesueshmëria, e përkufizuar si mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve¹⁰, përfshin disa aspekte të ndryshme:

Aksesi fizik në objektet shtetërore, qendrat e shërbimit, hapësira të tjera publike (qendra tregtare, parkingje, plazhe publike dhe terrene sportive, qendra kulturore etj.) në rrugë dhe trotuare.

Aksesi në informacion, përmes formateve të aksesueshme ose përmes ofrimit të shërbimeve online/në faqe interneti të aksesueshme.

Lëvizja e pavarur në rrugë dhe në trotuare, qendrat e reja spitalore/të kujdesit shëndetësor duhet të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara dhe është duke akorduar fonde për përmirësimin e aksesueshmërisë së mjediseve që janë në rikonstrukcion.

Aspektet kryesore të së drejtës për strehim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara përfshijnë aksesueshmërinë fizike të banesës, banesën me shërbime mbështetëse, strehimin social dhe subvencionet.

Nevojitet një transport i aksesueshëm, i përballueshëm dhe efikas për të bërë të mundur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, për të lehtësuar lirinë e lëvizjes dhe për të nxitur pjesëmarrjen në punësim, arsimim dhe aktivitete të tjera.

23.1. Aksesi në informacion

Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara parashikon garantimin e jetesës së pavarur nëpërmjet politikave të komunikimit dhe informacionit dhe formateve të aksesueshme.

"Pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara". I njëjti ligj përcakton gjithashtu edhe grupet e ndryshme të aktorëve që duhet të përfshihen në konsultime, përkatësisht:

- a) individët me aftësi të kufizuara;
- b) organizatat e personave me aftësi të kufizuara (ku personat me aftësi të kufizuar ose prindërit e tyre gëzojnë shumicë të cilësuar në vendimmarrje);
- c) organizatat për persona me aftësi të kufizuara;
- d) organizatat e përfaqësuara në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

Deri më sot, aksesi në sistemin e drejtësisë për të gjithë qytetarët shqiptarë, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, është përmirësuar nëpërmjet **forcimit të kapaciteteve të gjyqësorit dhe të inspektimit**, si dhe krijimit të institucioneve të reja të pavarura, të afta për t'iu përgjigjur shkeljeve. Në raste diskriminimi, personat me aftësi të kufizuara mund të drejtohen te një prej organeve të mëposhtme:

¹⁰ Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, neni 3.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, një institucion shtetëror i pavarur që shqyrton dhe vendos mbi bazën e ankesave individuale në këtë fushë. Komisioneri mund të përfshihet në hetime *ex officio* për çdo trajtim diskriminues të pretenduar dhe të vendosë sanksione për shkeljet.

Avokati i Popullit, një institucion kushtetues i pavarur që mbron të drejtat, lirinë dhe interesat e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme apo të parregullta të organeve të administratës publike. Ky institucion është promotor i standardeve më të larta të të drejtave të njeriut në vend. Ai kryen inspektime të institucioneve të kujdesit social për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e të drejtave ligjore të përfituesve. Përmes Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin Çnjerëzor dhe Poshtërujes, Avokati i Popullit monitoron respektimin e të drejtave dhe të standardeve në spitalet e shëndetit mendor, burgje dhe në sistemin e paraburgimit. Avokati i Popullit gjithashtu formulon rekomandime për institucionet shtetërore. Një nga komisionerët e Avokatit të Popullit është person me aftësi të kufizuara.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, një organ shtetëror mbikëqyrës i pavarur, përgjegjës për të mbikëqyruar ligjshmërinë e veprimtarive të përpunimit të të dhënave personale.

Gjykatat mund të ofrojnë kompensim për personat që vuajnë nga diskriminimi për shkak të aftësive të kufizuara¹¹, përfshirë edhe mohimin e një përshtatjeje të arsyeshme.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore kryen inspektime periodike të kushteve të jetesës në institucione¹² dhe standardeve të zbatueshme për kujdesin social¹³.

Drejtoria e Monitorimit të Standardeve të Shërbimit Social Shtetëror monitoron gjithashtu standardet e shërbimit.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi siguron të drejtën e ankimit për çdo viktimë diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar apo arsye të tjera, dhe gjithashtu fut edhe konceptin e "përshtatjes së arsyeshme".

Ligji për nxitjen e punësimit parashikon kuota punësimi për personat me aftësi të kufizuara për punëdhënësit e sektorit privat dhe publik.

24. Arsimi

Nuk ka asnjë qasje që fokusohet në regjistrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në ciklin (para)shkollor. Në harmoni me nismën "Çdo fëmijë në shkollë" duhet përforcuar bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ka pasur një rritje prej 33% të numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin e zakonshëm (shih tabelën 1).

Tabela 1: Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në nivele të ndryshme të arsimit

Të dhënat	Viti akademik 2013-2014¹⁴	Viti akademik 2014-2015¹⁵
------------------	---	---

¹¹ Ligji nr.10221, datë 4 shkurt 2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", neni 33.

¹² Bazuar në VKM nr.658, datë 17 tetor 2005 "Për standardet e shërbimeve sociale".

¹³ Përcaktuar me VKM nr.822, datë 6 dhjetor 2012, "Për standardet e shërbimeve të kujdesit social për personat me aftësi të kufizuara".

¹⁴ UNICEF, Analiza për situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara, 2014.

Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në kopshte dhe arsim fillor	1652 fëmijë, përfshirë 302 në ciklin parashkollor dhe 1350 në ciklin e ulët	1947 fëmijë, përfshirë 421 në ciklin parashkollor dhe 1526 në ciklin e ulët
Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin e lartë	758 nxënës (570 në arsimin e mesëm të ulët dhe 188 në arsimin e mesëm të lartë)	1254 nxënës (915 në arsimin e mesëm të ulët dhe 339 në arsimin e mesëm të lartë)
Numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat speciale	702 (222 vajza dhe 480 djem)	700

Ministria e Arsimit dhe Sporteve, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, prindërit dhe Drejtoritë/Zyrat Arsimore përpiqen të sigurojnë që çdo fëmijë të regjistrohet në një shkollë të përgjithshme apo speciale.

Përdorimi i mësuesve mbështetës në arsimin bazë përcaktohet në një udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Sporteve, por ende nuk është zbatuar¹⁶.

Librat shkollorë për arsimin e zakonshëm nuk janë të disponueshme në formate të aksesueshme (p.sh, në braille ose format dixhital).

Çdo drejtori arsimor duhet të ketë (por ende nuk ka) komisione multidisiplinore përgjegjëse për vlerësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Infrastruktura dhe ambientet fizike në shkolla në përgjithësi nuk janë të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Programi mësimor për edukimin e mësuesve të përgjithshëm nuk ka përmbajtje të mjaftueshme për mësimdhënien për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Tabela 2: Përdorimi i kuotave për nxitjen e aksesit në arsimin e lartë

Niveli Bachelor		Niveli Master	
Kuotat	Regjistrimi aktual (2014-2015)	Kuotat	Regjistrimi aktual (2014-2015)
15 kuota të rezervuara për persona me probleme shikimi	42 për studentët me aftësi të kufizuara (23 meshkuj dhe 19 femra)	15 kuota për persona me probleme shikimi	12 studentë (gjashtë meshkuj dhe gjashtë femra), duke përfshirë vetëm dy studentë me aftësi të kufizuara
15 për paraplegjikët dhe tetraplegjikët	në lëndë si drejtësi, histori, psikologji, punë sociale, menaxhim, kontabilitet dhe financë,	15 për paraplegjikët dhe tetraplegjikët	
20 për romët dhe		15 për romët dhe egjiptianët	
		15 për jetimët	

¹⁵ Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Rishikimi i raporteve të dorëzuar nga shtetet palë bazuar në nenin 35 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, draft raporti i parë, 2015, f. 41.

¹⁶ Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sporteve nr. 38, datë 7 tetor 2014, "Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar".

egjiptianët 15 për jetimët	menaxhim biznesi, arkitekturë dhe IT		
65 vende në total	42 studentë të regjistruar në total	60 vende në total	12 studentë të regjistruar në total

25. Kujdesi Social

Përfitime shtesë janë përcaktuar për grupe të veçanta personash me aftësi të kufizuara nëpërmjet legjislacionit të specializuar (shpesh referuar si ligje-statuse)¹⁷. Për ta përmbledhur, këto ligje parashikojnë: Ndhimë financiare¹⁸ (nga 10,030 lekë deri në 11,390 lekë në muaj, si dhe shuma të ngjashme për kujdestarët e tyre),

Kompensim financiar për disa fatura mujore të shërbimeve utilitare,

Ndhimë financiare shtesë për personat me aftësi të kufizuara që ndjekin studimet (vetëm të verbrit, paraplegjikët, tetraplegjikët, personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike),

Akses me përparësi në programet e strehimit dhe nxitjes së punësimit (*po aty*),

Rimbursimi i barnave dhe sigurimi shëndetësor falas,

Ndhimë financiare të veçantë për personat me aftësi të kufizuara të cilët humbën vendin e tyre të punës pas vitit 1991 (vetëm të verbrit),

Karrige me rrota, paterica, paketa higjieniko-sanitare falas (vetëm për paraplegjikët dhe tetraplegjikët), edhe pse karriget me rrota apo mjetet e tjera ndihmëse deri tani janë ofruar në disa raste nga donatorë të ndryshëm.

Përjashtimin nga taksat direkte (*po aty*),

Përjashtime tatimore dhe doganore për pajisje rehabilitimi dhe automjetet (vetëm për paraplegjikët, tetraplegjikët dhe invalidët e punës); rimbursim të karburantit në vlerën 7000 lekë/muaj (vetëm invalidët e punës).

Çdo ndihmë financiare e lartpërmendur jepet edhe 24 muaj të tjerë pasi përfituesi gjen punë. Përfitimet e marra nga personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike gjithashtu nuk përfshihen në llogaritjen e të ardhurave të familjes kur bëhet vlerësimi i të drejtës për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike. Megjithatë, personat që marrin një pagesë për aftësinë e kufizuar nuk përfshihen në numrin e anëtarëve të familjes për llogaritjen e përfitimeve nga ndihma ekonomike.

Kur shikojmë tendencat e mbulimit, mund të vihet re se numri i personave me aftësi të kufizuara që marrin pagesa është rritur me 28% nga viti 2009 deri në vitin 2014, ndërsa buxheti i shtetit në total është rritur 62% për të njëjtën periudhë (tabela 4, figura 2).

¹⁷ Ligji “Për statusin e të verbrit”, ligji “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” dhe ligji “Për statusin e invalidit të punës”.

¹⁸ Ndhimja financiare mujore indeksohet çdo vit në bazë të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK).

Tabela 4: Numri i përfituesve me aftësi të kufizuara dhe buxheti i shtetit për pagesat e aftësisë së kufizuar 2009 dhe 2013

Përfituesit me aftësi të kufizuara	2009	2014	Ndryshimi në %
<i>Numri total</i>	127,473	164,015	28%
Persona të verbër	11,129	12,330	11%
Paraplegjikë dhe tetraplegjikë	4,560	6,472	42%
Aftësi të kufizuara mendore dhe fizike	44,230	55,416	25%
Invalidë Pune	52,277	74,114	41%
Kujdestarë	15,193	15,683	3 %
Buxheti i shtetit (Lek)	2009	2014	Ndryshimi në %
<i>Buxheti total</i>	10,273,000	16,682,000	62%

Përveç ndihmës financiare, personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të përfitojnë edhe nga **shërbimet e kujdesit social**. Ekzistojnë 28 ofrues shërbimi, ku përfshihen 12 qendra rezidenciale (gjashtë publike dhe gjashtë jopublike), 14 qendra të kujdesit ditor (shtatë publike dhe shtatë jopublike) dhe dy qendra komunitare jopublike¹⁹. Qendrat rezidenciale (referuar edhe si qendra të zhvillimit) ekzistojnë në Tiranë, Durrës, Shkodër, Berat, Vlorë, Korçë dhe Poliçan²⁰. Ata ofrojnë rehabilitim, vetëshërbim dhe arsimim për integrimin e personave me aftësi të kufizuara nën 25 vjeç, në jetën e komunitetit. Nevojitet një model i ri , veçanërisht për të rritur (+25 vjeç) me AK, në mënyrë që këto qendra të mund të promovojnë jetesën e pavarur nëpërmjet aftësimin për jetën dhe aftësimin për punësim.

Deri në maj të vitit 2015, 1437 të rritur dhe fëmijë përdorin qendrat rezidenciale dhe të kujdesit ditor (ndarja e përfituesve tregohet në tabelën 5 më poshtë). Pjesa më e madhe e përfituesve përdorin shërbimet e kujdesit

¹⁹ Të gjitha statistikat për shërbimet e kujdesit social mundësohen nga raporti i parë i progresit i qeverisë shqiptare mbi zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, maj 2015, f. 51.

²⁰ Qendra polivalente në Poliçan administrohet nga Shërbimi Social Shtetëror, ndërsa të tjerat janë përgjegjësi e organeve të qeverisjes vendore. Për momentin, qendra në Poliçan nuk strehon persona me aftësi të kufizuara, por të moshuar.

ditor (1050 persona, në krahasim me 387 persona që përdorin kujdesin rezidencial, shih figurën 3). Megjithatë, mbulimi gjeografik dhe numri i këtyre qendrave është i pamjaftueshëm.

Tabela 5: Numri i përfituesve në qendrat publike dhe jopublike rezidenciale dhe të kujdesit ditor (maj 2015)

	Qendra publike rezidenciale dhe të kujdesit ditor	Qendra jopublike rezidenciale dhe të kujdesit ditor	Totali i përfituesve në qendrat publike dhe jopublike
Përfitues	461	976	1,437
Nga të cilët: fëmijë	218	209	427

Hendeku më i madh në ofrimin e shërbimeve në Shqipëri qëndron në shërbimet me bazë komunitetin, çka do t'u mundësonin personave me aftësi të kufizuara të bënin një jetë të pavarur në komunitetet e tyre. Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara ofrohen në strehat ose në qendrat e kujdesit ditor, të cilat mbështeten kryesisht nga shoqëria civile dhe programet vullnetare. Legjislacioni nuk lejon prokurimin e shërbimeve nga organizatat e shoqërisë civile, edhe pse rishikimi i tanishëm i Ligjit për Shërbimet Shoqërore mund ta bëjë të mundur këtë dhe të ngrejë një mekanizëm financimi. Gjithashtu, po përcaktohet një shportë e shërbimeve bazë nëpërmjet ligjit të ri “Për organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore”. Për momentin, mungesa e shërbimeve të bazuara në komunitet bën që personat me aftësi të kufizuara t'i drejtohen ofruesve privatë kur ata mund t'i përballojnë këto shërbime dhe kontribuon për institucionalizimin dhe ndarjen e personave me aftësi të kufizuara nga familjet e tyre.

26. Kujdesi shëndetësor

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta për akses në kujdesin shëndetësor cilësor njëloj si pjesa tjetër e popullsisë dhe në programe rehabilitimi falas në komunitetin e tyre. Ata gëzojnë të drejtën për rimbursim të barnave dhe për sigurim shëndetësor falas (edhe pse kjo është e kufizuar vetëm për sigurimin mjekësor për invalidët e punës)²¹.

Një nga nismat reformuese më të rëndësishme është kalimi nga përcaktimi mjekësor i aftësive të kufizuara te **modeli bio-psiko-social**, që përfshin rishkrimin e kriterëve për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar²², prezantimin e një qasjeje multidisiplinore, krijimin e strukturave të nevojshme, reformimin e përfitimeve dhe të së drejtës për të përfituar nga skemat pa kontributin e punëmarrësit, si dhe dixhitalizimin e informacionit dhe të komunikimit. Përbërja e komisioneve parësore dhe atyre eprorë për vlerësimin e aftësisë së kufizuar po reformohen për t'i bërë ato multidisiplinore. Numri i diagnozave të mundshme është rritur nga rreth 200 në 400 me qëllimin për të përcaktuar në mënyrë më të përshtatshme shkaqet e mundshme të aftësisë së kufizuar. Kjo punë filloi në vitin 2014 me mbështetjen e Projektit të Bankës Botërore për

²¹ Raporti i parë i progresit i qeverisë shqiptare mbi zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, maj 2015, f. 20.

²² Bazuar në modelin konceptual të OBSH-së për klasifikimin ndërkombëtar të funksionimit, aftësive të kufizuara dhe shëndetit.

Modernizimin e Ndhmës Sociale²³. Në vitin 2016, sistemi i ri do të zbatohet si pilot në 2 qarqe, duke përfshirë strukturat e reja në nivel vendor.

Gjatë periudhës së mëparshme, ka patur një fokus në **parandalimin dhe vlerësimin e hershëm të aftësisë së kufizuar**. Në disa lokalitete (sidomos në zonat rurale), ekziston një mungesë instrumentesh dhe specialistësh të nevojshëm për vlerësimin e hershëm. Materialet informative dhe fushata për parandalimin e aftësive të kufizuara duhet të vazhdojnë.

Shërbimet për personat me çrregullime të shëndetit mendor synojnë të parandalojnë institucionalizimin dhe të ofrojnë aktivitete të përqendruara në parandalim, trajtim dhe rehabilitim në komunitetin lokal²⁴. Ministria e Shëndetësisë dhe OBSH-ja kanë trajnuar në mënyrë aktive mjekët dhe infermieret për kuadrin rregullator dhe të drejtat e personave me çrregullime të shëndetit mendor. Qendrat e shëndetit mendor funksionojnë vetëm nëpër qytete të mëdha, megjithëse Plani i Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri (2013-2022) ofron një sistem të integruar të shërbimeve të kujdesit shëndetësor në të gjitha rajonet. Edhe mjekët e familjes kanë rëndësi thelbësore në identifikimin e hershëm, referimin dhe trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor.

Lidhur me **ofrimin e kujdesit shëndetësor për personat me aftësi të kufizuara në burgje**, në vitin 2014, qeveria ka siguruar mbulimin me sigurim shëndetësor falas përmes miratimit të ligjit "Për trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve". Edhe problemi i furnizimit me medikamente dhe i konsultimeve mjekësore dhe psikiatrike është trajtuar në një udhëzim të veçantë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe në një Memorandum Bashkëpunimi mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Megjithatë, nuk ka një psikiatër në çdo burg ku menaxhohet dhe administrohet mjekim. Nuk ka objekte për trajtimin e shëndetit mendor të urdhëruar nga gjykata, si rrjedhim, njerëzit nën këtë regjim vendosen në burg.

Ministria e Shëndetësisë po punon për të përmirësuar **aksesueshmërinë në qendrat e kujdesit shëndetësor dhe në spitale**. Ajo ka kryer një kontroll për aksesueshmërinë dhe do të miratojë një plan për investime. Gjithashtu, ministria në buxhet ka përcaktuar fonde për të përmirësuar aksesueshmërinë dhe nuk do të miratojë asnjë plan për rinovim që nuk pajtohet me standardet e kësaj fushe.

Shërbimet e rehabilitimit dhe të trajtimit të ofruara në Shqipëri janë të kufizuara në numër dhe llojshmëri, të paaksesueshme për shumicën e personave me aftësi të kufizuara dhe/ose jofunksionale, sidomos për fëmijët me aftësi të kufizuara. Shumica e personave me aftësi të kufizuara duhet t'u drejtohen ofruesve të shërbimeve private. Personat me çrregullime të shëndetit mendor mund të kenë akses në shërbimet e rehabilitimit dhe të trajtimit në Qendrat e Shëndetit Mendor në Komunitet (QSHMK), të cilat ofrojnë shërbim ambulator. Nuk ekziston asnjë Qendër Kombëtare për Rehabilitim.

Kategoritë e personave me paaftësi të cilët marrin shërbime pranë bashkisë Korçë.

Shuma e pagesave për të gjitha kategoritë e paaftësive, rreth 40 600 000 Lekë

Kategoritë	Nr. i Personave
Invalidë	3073

²³ Më shumë detaje në lidhje me këtë projekt gjenden në faqen e internetit të Bankës Botërore në: <http://www.worldbank.org/projects/P122233/social-assistance-modernization-project?lang=en>.

²⁴ Neni 13 i ligjit nr. 44/122 "Për shëndetin mendor".

PAK	1983
Kujdestarë	178
Të verbër	247
Kujdestarë	91
Paraplegjikë/Tetraplegjikë	159
Kujdestarë	152
TOTALI	5883

Shpërndarja e personave me aftësi të kufizuar dhe e

kujdestarëve në Bashkinë Korçë²⁵:

Ndihma sociale	Persona me aftësi	Të verbër të	Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë	Invalidë Total pune	
Drenovë	98	21	11		148
Kujdestarë	13	6	11		0
Lekas	12	4	0		8
Kujdestarë	1	1	0		0
Mollaj	77	7	12		71
Kujdestarë	13	4	6		0
Bulgarec	158	14	18		219
Kujdestarë	21	8	18		0
Vithkuq	33	5	2		34
Kujdestarë	4	1	2		0
Voskop	79	11	5		66
Kujdestarë	2	3	5		0
Voskopojë	30	3	0		33
Kujdestarë	5	1	0		0
Total	487	65	48		579
Kujdestarë	59	24	42	0	125

26. Strehimi

Në qytetin e Korçës ka aktualisht disa objekte të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave, ndër të cilat janë pallatet në: rrugën “Viktor Eftimiu”; Bllokun e Ri; rrugën “Gaço Avrazi” dhe në Bashtën e Ushtrisë. Numri total i apartamenteve është 284.

Ligji 9232/2004 “Për Programet Sociale për Strehimin e Banorëve të Zonave Urbane”, ka si objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, të administrimit dhe të planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë pagese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit.

"Programe sociale strehimi" janë programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lire të banesave ose atë të kredive hipotekare.

²⁵ PPV Korçë, faqe. 70

Klasifikimi i programeve sociale te strehimit

Programet sociale te strehimit klasifikohen si me poshtë:

1. Programe te banesave sociale me qira, ne te cilat përfshihen:

- a) banesat, qe ndërtohen apo blihen nga tregu i lire nga bashkite ose organizatat jofitimprurëse, te cilat jepen me kontrate qiraje sociale;
- b) banesat ekzistuese, ne pronësi te personave fizike ose juridike, te cilat janë klasifikuar nga organet e qeverisjes vendore apo nga organizatat jofitimprurëse si banesa sociale, qe mund te jepen me qira për familjet qe përfitojnë bonus strehimi;
- c) objektet e dala jashtë funksionit, si rezultat i mbylljes se një veprimtarie, te cilat kane kaluar ne pronësi te bashkive dhe janë miratuar për t'u kaluar ne fond banesash sociale me qira, ne përputhje me planin rregullues urbanistik.

2. Programe te banesave me kosto te ulet.

3. Programe te pajisjes se truallit me infrastrukture.

Familjet, qe klasifikohen për t'u trajtuar me programe sociale te strehimit, miratohen me vendim te këshillit bashkiak, sipas kriterëve te mëposhtme:

- a) nuk kane ne pronësi një banese;
- b) zotërojnë sipërfaqe banimi nen normat e strehi mit te përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjese këto familje;

Ndërtimi i banesave sociale

Çdo bashki parashikon ne territorin nen juridiksionin e vet sipërfaqen e truallit për ndërtimin e një numri te mjaftueshëm banesash sociale me qira, bazuar ne numrin e popullsisë dhe ne përbërjen, sipas grupeve sociale te përcaktuara ne nenin 5 te këtij ligji.

Blerja e banesave sociale ne treg

Ne rastet kur vlera e banesave ne tregun e lire është me e ulet se vlera e ndërtimit te banesave te reja, mbi bazën e vendimit te këshillit bashkiak, entet menaxhuese blejnë banesa nga tregu i lire, për t'i dhënë me pas me kontrate qiraje sociale. Kushtet, normat dhe standardet, qe duhet te plotësojnë banesat sociale me qira, përcaktohen me vendim te Këshillit te Ministrave.

Banesat me kosto te ulet ndërtohen me fondet e Buxhetit te Shtetit, me fondet e bashkise dhe nga donacionet private. Çmimi i shitjes se banesave me kosto te ulet përcaktohet ne baze te vlerës se objektit qe ndërtohet. Vlera e objektit përcaktohet ne baze te kostos se ndërtimit te banesës, çmimit te tokës, kostos se infrastrukturës, vlerës se projektit dhe shpenzimeve për administrimin e procesit dhe te shpërndarjes. Normat dhe standardet e banesave me kosto te ulet miratohen me vendim te Këshillit te Ministrave.

Subvencionimi i qirasë-

1. Për familjet, te cilat nuk kane mundësi financiare për te kryer pagesën e qirasë dhe qe nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar ne shkronjat "b" dhe "e" te nenit 6 te këtij ligji, shteti subvencionon deri ne 50 për qind te masës se qirasë qe duhet te paguaje familja. Subvencionimi jepet vetëm pas verifikimit te gjendjes ekonomike te familjes, sipas nenit 28 te këtij ligji.

2. Për rastet e përcaktuara ne shkronjat "d" dhe "f" te nenit 5 te këtij ligji dhe qe nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar ne shkronjën "e" te nenit 6 te këtij ligji, masa e subvencionit mund te jete jo me shume se 75 për qind.

3. Subvencionimi i qirasë, qe përfiton çdo familje, behet nga te ardhurat e vete bashkive dhe me miratimin e këshillit bashkiak. Bashkite e nivelit jo te pare, qe nuk arrijnë te realizojnë te ardhura te mjaftueshme, financohen nga Buxheti i Shtetit.

Subvencionimi i interesave te kredive-

Familjet qe përfitojnë banese me kosto te ulet kane te drejtën e marrjes se një kredie hipotekare, me kushte lehtësuese, nga një institucion financiar qe ka lidhur kontrate me Ministrinë e Financave për menaxhimin e kredive. Kushtet e dhënies nga bankat te kredisë për familjet përcaktohen me marrëveshje te përbashkët te Ministrit te Financave, ministrit qe mbulon fushën e strehimit dhe institucionit qe jep dhe menaxhon kredinë.

Programet sociale te strehimit financohen nga:

a) fondet buxhetore, qe jepen çdo vit për programe strehimi nëpërmjet ministrisë qe mbulon fushën e strehimit;

b) kontributet nga donatore te ndryshëm;

c) te ardhurat qe krijohen nga taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme;

ç) te ardhurat nga veprimtaritë fitimprurëse te bashkive, sipas pikës 1 te nenit 22 te këtij ligji.

Zyrat përkatëse te bashkive hartojnë programe 10-vjeçare te strehimit për popullsinë nen juridiksionin e tyre, duke u mbështetur ne analizën e nevojave për strehim, sipas parashikimeve te këtij ligji, te cilat miratohen nga këshillat bashkiake.

Këto programe përmbajnë:

a) burimet e financimit, qe zotërohen nga Buxheti i Shtetit, brenda një viti financiar, fondet e siguruar nga vete bashkia, si dhe fonde nga burime te tjera, duke përcaktuar origjinën e tyre;

b) nevojat për strehim, sipas parashikimeve te këtij ligji, duke përcaktuar grupet e familjeve, sipas te ardhurave dhe gjendjes se tyre sociale;

c) lidhjet e këtij programi me programe te tjera te bashkise dhe mënyrën e ndikimit te tyre te njëra-tjetra;

ç) numrin dhe kategoritë e familjeve qe do te përfitojnë banesa sociale me qira;

d) numrin e familjeve qe do te përfitojnë banesa me kosto te ulet dhe mënyrat e bashkëpunimit me sektorin privat;

dh) pajisjen e truallit me infrastrukture për ndërtim banesash, numrin dhe llojin e banesave qe do te ndërtohen, familjet qe do te përfitojnë, formën e bashkëpunimit me sektorin privat, si dhe masën e përqindjen e kontribuuesve.

Bazuar ne planet 10-vjeçare te bashkive, behet planifikimi vjetor i Buxhetit te Shtetit, ne zbatim te programeve te hartuara ne baze te këtij ligji. Për hartimin e planit te buxhetit merren parasysh këta faktorë:

a) përqendrimi i popullsisë ne shkalle vendi;

b) përqendrimi i familjeve ne nevoje për strehim;

c) përqendrimi i familjeve te varfra;

ç) përparësitë e zhvillimit ekonomik t e vendit

Fondet e Buxhetit të Shtetit, për çdo program, ndahen në:

1. Fonde për banesa sociale me qira, që përfshijnë:

a) fonde për investime;

b) subvencion për mbulimin e qirave, sipas nenit 24 të këtij ligji.

2. Fonde për banesa me kosto të ulët, që përfshijnë:

a) fonde për investime;

b) fonde për subvencione për mbulimin e interesave të kredisë, sipas nenit 25 të këtij ligji.

3. Fonde për blerje të truallit për programe strehimi në ndihmë të bashkive të nivelit jo të parë.

4. Fonde për asistencë teknike të paracaktuara për organizimin e studimeve, trajnimeve të administratës së bashkive, si dhe për asistencë teknike për familjet që kërkojnë ta ndërtojnë vetë banesën, sipas nenit 26 të këtij ligji.

Bashkive, për menaxhimin e programeve të strehimit, sipas këtij ligji, kryejnë funksionet e mëposhtme:

a) identifikojnë nevojat për strehim, sipas programeve të hartuara në baze të këtij ligji për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre;

b) hartojnë programe 10-vjeçare për strehimin dhe projekte trevjeçare, bazuar në burimet financiare që zotërojnë;

c) sigurojnë sheshet e ndërtimit dhe pajisjen e truallit me infrastrukture, në zbatim të programeve të strehimit, të hartuara në baze të këtij ligji;

ç) paraqesin kërkesat pranë ministrit që mbulon fushën e strehimit, për financime, investime dhe subvencione, sipas këtij ligji;

d) krijojnë dhe administrojnë, në nivel vendor, bazën e të dhënave për familjet që përfitojnë strehim, sipas këtij ligji;

dh) përcaktojnë kostot maksimale të lejueshme, brenda kufijve të përcaktuar nga ministri që mbulon fushën e strehimit, për ndërtimin e banesave, sipas këtij ligji;

e) sigurojnë ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira;

ë) njoftojnë çdo vit ministrin që mbulon fushën e strehimit, për ecurinë e programeve të strehimit, sipas këtij ligji;

f) kryejnë të gjitha funksionet e tjera të parashikuara në këtë ligj.

27. Gjetjet për Korçën

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, të regjistruara si kërkesa për strehim figurojnë rreth 2400 kërkesa, por kjo shifër gjithmonë sipas sektorit të strehimit mund të mos jetë e saktë plotësisht. Për këtë arsye kjo drejtori po verifikon këtë listë kërkesash, pasi mendohet të ketë dhe regjistrime fiktive për efekt dokumentash etj. Sipas drejtorisë mendohet se numri i saktë është rreth 700. Gjithsesi duke iu referuar dhe Ligjit të Strehimit, kompetencave dhe decentralizimit gjithmonë e më të madh që po marrin Bashkitë për

funkcionin Social, iu takon Bashkive të bëjnë planet 10-vjeçare të strehimit duke përdorur të gjithë burimet e mundshme financiare. Përdorimi i aseteve të bashkise për ndërtimin e banesave me kosto të ulët, do të ishte një mjet shumë i mirë për të plotësuar kërkesat për strehim në një afat të shkurtër të Bashkisë Korçë, duke pasur tokën, do të ishte më e lehtë të gjenden burimet financiare nga shteti apo donatorë të ndryshëm

Nr	Numri i familjeve që kanë aplikuar për strehim që nga muaji Janar i vitit 2005	Banesa sociale me qira	Banesa me kosto të ulët	Truall të pajisur infrastrukturë	Bonus të strehimi	Total
	Nga këto kategoritë sipas nenit 5. të liqit nr. 9232/2004					
1	Apl. L. 9232, dt 13.05.2004	1255	1202			2457
2	Kryefamiljare grua e divorcuar	492				492
3	Fam. një prind ngark. fëmijë	425				425
4	Invalidë gjithsej	466	140			606
	Të verbër	7				7
	Paraplegjikë	36				36
	Invalidë pune	423	140			563
5	Jetimë	31				31
6	Familje me shumë fëmijë	202	49			251
7	Çifte të reja deri 55 vjeç	15	51			66
8	Të moshuar në pension vetë	13				13
9	Emigrantë të kthyer	38	35			73
10	Emigrantë jashtë shtetit	19	50			69

Burimi: PPV Korça

Enti Kombëtar i Banesave është duke proceduar me projektin e një banese ekologjike me kosto të ulët (rreth 70 apartamente) në qytetin e Korçës. Deri tani:

- Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit midis Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Korçë.
- Është zhvilluar procedura e prokurimit “konkurs projektimi” me objekt “Shërbime projektimi për realizimin e një banese me kosto të ulët dhe eficientë energjie në Korçë”.
- Është në fazën e shpalljes së fituesit për lidhjen e kontratës dhe vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Numri total i familjeve që janë trajtuar me një nga programet sociale të strehimit (ligji nr. 9232/2004)

Burimi:
PPV
Korça

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Total		20	80							96
Banesa sociale me qera										96
Banesa me kosto të ulët		20	80							
Truall të paisur me										
Bonus strehimi										
Tjetër										

28. KRIMINALITETI

28.1. Veprat penale

Ky seksion flet për situatën e kriminalitetit në rang qarku në vitin 2014 pasqyrë kjo e paraqitur qartë në tabelën më poshtë. Kjo tabelë ilustron numrin e krimeve të evidentuara për disa grupvepra penale, të dhëna këto të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Nga tabela shohim që numrin më të madh të krimeve për këtë vit e zënë grupveprat “Krimet kundër rendit dhe standardeve të sjelljes”, ndjekur më pas me “Krimet ekonomike- financiare”. “Krimet kundër pronës” përbën grupveprën me numrin më të ulët të krimeve të evidentuara në të gjitha qarqet.

Në grupveprën “Krimet kundër personit” përfshihen krimet kundër jetës, kundër shëndetit dhe lirisë. Kjo grupvepër është shumë e rëndësishme dhe rëndësi shumë e madhe i kushtohet edhe zbulimit të tyre. Këto krime çënojnë të drejtën e jetës, e drejtë kjo e pacënueshme, e patjetërsueshme dhe askush nuk ka të drejtë të na e privojë këtë të drejtë. Në Shqipëri në vitin 2010 nëse do shpreheshim në terma absolut janë evidentuar 769 “Krimet kundër personit”, ndërkohë në vitin 2014 kemi 485 vepra. Në nivel rajonal, Korça ka një statistikë prej 39 krime kundër personit, e cila krahasuar me nivelin e përgjithshëm të Shqipërisë është në një normë mesatare si raport me qarqet e tjerë. Numrin më të lartë të kriminalitetit qarku i Korçës kap me krimet në sferën ekonomike ku përfshihen plot 175 të tilla brenda vitit 2014.

Veprat penale, 2014

Qarku	Kundër Personit	Kundër Pronës	Krime për Trafiqet e Paligjshme	Krime në fushën e drogës	Krime ekonomike financiare	Krime në fushën e korrupsionit	Krime në fushën e pastrimit të parasë	Akte kundër rendit dhe standardeve të sjelljes
Tiranë	95	34	171	565	616	299	108	6706
Korçë	39	4	49	120	175	44	26	1231

Burimi: Vjetari statistikor 2015 Instat

28.2. Dhuna në familje

Dhuna në familje haset jo vetëm në shoqërinë shqiptare, por është një fenomen shqetësues që i kapërcen të gjithë kufijtë dhe gjendet në të gjitha kulturat. Ky abuzim është edhe një problem shëndetësor që shkakton plagë madje dhe vdekje, ndikon negativisht në intergritetin fizik, psikosocial dhe ekonomik të personit ndaj të cilit ushtrohet dhunë. Ky fenomen shkaktohet nga faktorë të ndryshëm, si: ndikimi kulturor me rrënjë të thella në traditat e vjetra patriarkale, situatat jetësore jo të shëndosha, diskriminimi gjinor, papunësia, kontrolli ndërbreznor në familje etj.

Dhuna në familje është ende abuzimi më i shpeshtë me të drejtat e njeriut, por ende më pak i njohuri dhe i pranuari në botë. Studime të ndryshme nxjerrin në pah se është e vështirë të masësh nivelin dhe përhapjen e dhunës në familje, pasi ky fenomen zhvillohet brenda familjes dhe konsiderohet si çështje familjare. Si rrjedhojë, ndër faktorët që mund të ndikojnë në raportimin e ulët të dhunës në familje, mund të përmendim p.sh.: turpin, frikën nga ndëshkimi, normat kulturore, stereotipet që ekzistojnë për dhunën në familje etj, ndaj faktet dhe shifrat duhen parë me kujdes, pasi ato jo detyrimisht japin një pasqyrë të qartë lidhur me përhapjen në vend të dhunës në familje.

Pavarësisht vështirësisë së matjes së këtij fenomeni, të dhënat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, tregojnë se gjatë viteve 2010-2014 ka një rritje të numrit të raportimeve për dhunën në familje nga 1998 raportime në vitin 2010 në 4121 raportime në vitin 2014, thënë ndryshe rreth 2 herë më shumë raportime se sa në vitin 2010.

Si në të gjithë Shqipërinë edhe qarku i Korçës ka pasur një rritje të ndjeshme përsa i përket dhunës në familje, referuar kjo viteve nga 2010-2014. Siç edhe sipërcitohet, dhuna në familje ka faktorë të shumtë, megjithatë nga më të përhapurit në Shqipëri sidomos në zonat rurale gjejmë kulturën e prapambetur, por edhe stereotipet që kanë mbetur në shoqëri.

Përkatesisht po të flasim në gjuhën e shifrave, dhuna në familje në qarkun e Korçës është si më poshtë:

Viti	Dhuna në familje %
2010	9.3%
2011	13.7%
2012	16.5%
2013	22%
2014	38.4%

Vjetari statistikor 2015 Instat

28.3. Të burgosurit

Të dhënat për të burgosurit përfshijnë personat e mitur, të rritur dhe shtetasit e huaj të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë në të gjitha llojet e qendrave të burgimit, siç paraqiten në tabelën më poshtë. Nga tabela shihet se në vitin 2014 në total kemi 5453 të burgosur, ndërsa në vitin 2010

numëroheshin 4603, duke treguar në këtë rast një rritje prej 18,5 % në numrin e të burgosurve. Kjo është një matje në rang vendi, ndërsa sa i takon qarkut të Korçës, shohim qartë një rritje të të burgosurve përgjatë viteve 2010-2014. Faktorët mund të jenë të shumtë, megjithatë shqetësuese mbetet norma e rritjes prej afro 32%.

Të burgosurit sipas dy ndarjeve të mëdha moshore dhe qarqeve, 2010-2014

Viti	Shqipëri		Qarku Korçë		Qarku Tiranë	
	nën 18 vjeç	mbi 18 vjeç	nën 18 vjeç vjeç	mbi 18	nën 18 vjeç	mbi 18 vjeç
2010	102 4501		0 333		7 785	
2011	121 4469		4 338		9 762	
2012	97 4453		3 331		7 751	
2013	107 4807		5 367		5 799	
2014	101 5352		2 461		17 842	

Vjetari statistikor 2015 Instat

Vizioni i Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale (DPPS) është që të garantojë një sistem transparent, të përgjegjshëm dhe të rregullt për vlerësimin e përfshirjes sociale në të gjitha fushat e politikave të varfërisë financiare dhe mbrojtjes sociale, punësimit dhe aftësive, shëndetit, arsimit, strehimit dhe privimit të nevojave bazë, si dhe të pjesëmarrjes sociale dhe të drejtave të njeriut. Objektivi i përgjithshëm i DPPS-së është të krijojë një kuadër të balancuar dhe të qëndrueshëm për të siguruar që përfshirja sociale të matet, monitorohet dhe raportohet në Shqipëri përmes një grupi treguesish të shëndoshë, duke përmirësuar kështu rrugët e

lidhjes së përfshirjes sociale me përmirësimin e politikave të qeverisë dhe përparimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE²⁶.

Numri i familjeve rome dhe egjiptiane në qytetin e Korçës dhe shpërndarja e tyre në territor, jepet në tabelën e mëposhtme:

	Rajoni 1	Rajoni 2	Rajoni 3	Gjithsej
Egjiptianë	95	128	320	543
Romë	6	24	52	82

Tabelë e marrë nga Relacioni i Bashkisë Korçë

²⁶ Dokument Politik i Përfshirjes Sociale 2016-2020, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, f. 4

28.4. Arsimi

Ne Bashkine Korce funksionon vetem 1 (nje) Cerdhe publike, ndersa ka dy te tilla ne sektorin privat. Mosha e femijeve te rregjistruar 1-3 vjec. Nevojat per cerdhe te reja jane te shumta. Cerdhja ekzistuese nevojitet rikonstruksion te plote, me nje rikonceptim te ri, pasi eshte ndertim i viteve '70. Emergjente eshte instalimi i ngrohjes qendrore dhe nje sistemi klimatizimi. Qyteti ka nevoje per te pakten 2 (dy) cerdhe te reja nje ne Jug dhe nje ne veri te qytetit. Gjithashtu mund te hapen edhe 4 cerdhe ne qendrat e Njesive Administrative Bulgarec, Drenove, Voskop, Mollaj. Problem tjetër për cerdhen eshte kuota e ulet ushqimore qe paguhet dhe konsumohet ne te. Prinderit paguajne 97 (nentedhjete e shtate) leke/dite, per tre vakte ushqimore. Nuk ka bashkefinansim ne pjesen e ushqimit.

Kopshtet: Ne qytet funksionojne 13 te tille prej te cileve 8 me ushqim dhe 5 pa ushqim, si edhe 5 klasa parashkollore prane shkollave 9-vjecare. Kuota financiare per ushqim e ulet 97 (nentedhjete e shtate) leke per tre vakte ushqimore dhe paguhet teresisht prej prinderve. 4(kater) kopshte jane me ngrohje qendrore, prej te cileve 2 me gaz, 1 me ngrohje gjeotermike dhe 1 me kaldaje me dru . 8 te tjere ngrohen me stufa druri ndersa 1 tjetër me ngrohje elektrike. Ne dhjete vitet e fundit eshte ndertuar vetem nje kopesht i ri (kopshti nr.1), ne 2013 u krye rikonstuksioni i plote i kopshtit nr.5. Te tjeret jane ndertime te viteve '70-85. Eshte nderhyre ne thujtje te gjitha godinat e kopshteve (pervec kopshteve 12 dhe 10, qe jane ne gjendje shume te veshtire) . Kopshtet nr.3 dhe nr.5 jane te mbipopulluar dhe kane nevoje per kat te dyte. Kopshtet e tjera (pervec kopshtit nr1) kane nevoje per rikonstruksione te plote dhe rikonceptime. Ne oborret e kopshteve ka vetem 1 kend lojrash nevojiten kende lojrash ne kopshtet e tjera. Ne njesite administrative, pervec fshatit Kamenice (kopshti funksionon ne klase me qera) , Voskopoje (ne ish-kopshti, e transferuam ne kete vit shkollor pasi u mbyll godina), Turan (dy klasa kopshti ne godine me vete), Dishnice (2 klasa godine me vete), Damianec (1 klase ne godina e ish-muzeut), ne fshatrat e tjere klasat e kopshteve jane ne godinat e shkollave te fshatrave. Ne Nj.A. nuk ka asnje kopesht me ushqim. Per vitin 2016, me fondet e bashkise do te hapim nje klase kopshti (prane godines se shkolles) ne fshatin Panarit.

Arsimi 9-vjecar; Ne qytet funksionojne 11 institucione te arsimit 9-vjecar + shkolla speciale dhe Shkolla e Muzikes -Tefta Tashko Koco- e cila eshte me cikël te plote nga klasa e I-XII Nder to 6 jane me ngrohje qendrore, ndersa te tjerat me soba druri. Shkolla -Pandeli Cale- e ndertuar e re ne 12 vitet e fundit, po ashtu edhe shkolla speciale. Ndertesar e tjera te viteve 60-80. Shkollat -Mesenjtore-, -Stavri themeli-, -Sotir Gurra-, -Sevasti Qiriaz- u jane nenshtruar rikonstruksioneve te plota rishtazi. Te tjerat nevojiten rikonstruksione te plota. Ne Nj.A. ka patur rikonstruksione, ku te kryera me efikasitet ku tjetër me probleme. Nga te gjitha objektet mesimore te Nj.A. vetem shkollat Floq, Pulahe dhe shkolla e Bashkuar Voskop kane me kaldaja me dru, ndersa gjithë te tjerat jane me ngrohje me soba druri. Nevoje emergjente shkolla 9-vjecare Voskopoje, ku u mbyll per vitin shkollor 2015-2016 nga Komisioni Rrezik Shembje i Bashkise, pasi paraqeste rrezik shembje. Mesimi provizorisht kryhet ne ambientet e zyrave te njesise. Per vete traditen e arsimimit, kulturen, vlerat, qe ka ky fshat eshte e papranueshme qe te jete pa institucion arsimor. Perparesi kryesore ndertimi i nje


shkolle te re, e cila pas diskutimesh dhe me aktore te tjere, mund te sherbeje edhe si shkolle rajonale edhe per fshatrat Gjonmadh dhe Lavdar, te cilet kane nje trend ne renie te numrit te femijeve, godina arsimore tejet te amortizuara dhe me siperfaqe tejet te medha, per te cilat mendimi yne eshte se nuk eshte me efektivitet rikonstruksioni. Me fondet e Bashkise per kete viti shkollor do te rikonstruojme shkollen e fshatit Gjonbabas dhe te ndertojme te re shkollen e fshatit Marjan, Nj.A. Lekas, pasi terreni i veshtire malor dhe situata rrugore e ben shume te veshtire levizjen e nxenesve per ne fshatra te tjere. Sipas perparise, gjendjes fizike, numrit te femijeve nevojat per rikonstruksione te plota jane si me poshte: shkolla Kamenice, Shkolla Vithkuq, Shkolla Vinçan, Shkolla Mborje, Barc, Shkolla Polenë, Belorta, Shkolla Lumalas, Melcan, Biranj, Ciflik, Dishnice, Shkolla Leshnje (e cila mund te mbyllet ne se rikonstruktohet Vithkuqi).

Terrenet sportive dhe palestrat ne institucionet 9-vjecare, lene per te deshiruar. Kemi terrene perfekte te ndertuara rishtaz per shkollat "Nuci Naci", "Demokracia", "Sotir Gurra", ne gjendje te kenaqeshme per Shkollat "Pandeli Cale", "Naim Frasheri" "Sevasti Qiriazhi", palestra shume te mira, ne shkollat "Sotir Gurra", "Pandeli Cale", "Mesenjtoria", "Stavri Themeli", ne gjendje te mire shkolla "Naum Veqilharxhi". Ne institucionet e tjera terrenet sportive jane te degraduara, palestra nuk ekzistojne, por pozitiv eshte fakti qe ne teresine e tyre ambientet ekzistojne (mund te ndertohen qofte palestra, qofte terrene te hapura) dhe thujse nuk jane prekur nga nderhyrjet private.

Arsimi i Mesem i Pergjithshem dhe Profesional : Ne qytetin e Korces ka 3 shkolla te mesme te pergjithshme "Themistokli Germenji", "Raqi Qirinxhi", "Ymer Dishnica", 5 profesionale, shkolla mekanike "Demir Progri", shkolla e Ndertimit, Agrobiznesi "Irakli Terova", TIK "Fan Noli", Teknologjika "Isuf Gjata" dhe 2 te mesme te , e gjuheve te huaja "Faik Konica" dhe e muzikes "Tefta T. Koco". Te gjitha institucionet e arsimit te mesem ne qytet jane me ngrohje qendrore me nafte, pervec "Irakli Teroves" dhe "Isuf Gjata" te cilat jane me kaldaja me gaz. Nga institucionet e arsimit te mesem shkolla e gjuheve te huaja dhe ajo e ndertimit jane ndertime te reja te 15 vjecarit te fundit, te tjerat jane ndertime te viteve '60 -'80, ne to jane kryer nderhyrje te pjesshme por kane nevojte akoma, sidomos rrjeti i ngrohjes se tre gjimnazeve. Shkolla e muzikes nevojitet rikonstruksion i plote dhe rikonceptim. Duhet menduar te plotesohet si cikel arsimor me hapjen edhe te akademise se arteve, me interes do te ishte edhe çelja e deges se poçarise ne kete institucion. 4 prej ketyre institucioneve "Themistokli Germenji", "Raqi Qirinxhi", "Fan Noli", "Faik Konica" kane palestra shume te mira. Terene sportive teper moderne prane shkollave "Raqi Qirinxhi", Ndertimit, "Irakli Terova", "Isuf Gjata". Mund te ndertohet terren prane shkolles "Faik Konica" dhe "Ymer Dishnica" pasi kane ambiente te mjaftueshme. Ne Nj.A. ka vetem 2 institucione te arsimit te bashkuar ne fshatin Voskop, Nj.A. Voskop, e cila eshte ndertese bashkekohore e perfunduar me 2015, me ngrohje qendrore me kaldaje druri, si edhe ne fshatin Mollaj (Dvoran), Nj.A. Mollaj, ndertese e rikonstruktuar rishtaz ne gjendje te

kenaqeshme, me ngrohje me stufa druri. Te dyja keto institucione kane nevoje per terrene sportive apo palestra. Kane ambjente te mjaftueshme per to. Per institucionet arsimore te bashkise Korce jane te domosdoshme zhvillime projektesh per eficencen e energjise. Per shkollat profesionale duhet pare hapja e degeve te reja qe kane kerkesa ne tregun e punes, tej atyre tradicionale.

Ekzistojne edhe 3 konvikte te shkollave profesionale, konvikti i shkolles se Gjuheve te Huaja, Konvikti i Shkolles Mekanike si dhe ai i Agrobiznesit. Konviktet jane ne gjendje relativisht te mire, ai i shkolles Mekanike ka nevoje per ndrim tjegullash, ndersa ai i Gjuheve te Huaja, ka nevoje per kaldaje. Meqenese ka rene ndjeshem numri i nxenesve ne konvikte, kemi ne pune (me 1/3 e kapacitetit) vetem konviktin e shkolles se Gjuheve te Huaja. Me transferimin e funksioneve te reja, ne kuadrin e reformes se decentralizimit, ndermarrja ka sot nje strukture te miratuar prej 395 punonjesish nga 62 punonjes qe kishte para saj.



Statistikat e arsimit mbledhen nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit që është burimi kryesor i të dhënave për të gjitha nivelet e arsimit zyrtar që kryhet në vend.

Në mbledhjen dhe përpunimin e statistikave të arsimit shqiptar përdoret klasifikimi ndërkombëtar standard i arsimit ISCED, aplikuar fillimisht varianti i vitit 1997, sipas rekomandimeve edhe të Eurostat dhe UNESCO-s.

Në bazë të këtyre të dhënave llogariten treguesit sipas niveleve për arsimin parashkollor, arsimin e detyruar në të dy ciklet, arsimin e mesëm gjimnaz dhe profesional, arsimin e lartë bachelor dhe master etj. Treguesit llogariten për vit shkollor/akademik, në nivel vendi ose qarku. Ky publikim paraqet të dhëna dhe tregues kryesorë në të cilin tabelat dhe grafikët japin një pamje të qartë të arsimit parauniversitar në të gjitha qarqet dhe vendin.

Arsimi Parauniversitar përfshin arsimin e organizuar në kopshte, shkolla 9 vjeçare dhe të mesme. Arsimi i detyruar i cili që nga viti 2004-2005 kaloi nga 8 në 9 vjeçar me dy ciklet përkatësisht 5 dhe 4 vjeçar, ndërsa arsimi i mesëm përfshin gjimnazin dhe arsimin profesional i cili ndahet në të ulët, teknik dhe të lartë. Tabelat në botim i referohen arsimit të mesëm të lartë i cili përbën gjithashtu pjesën kryesore të tij. Nxënësit që përfundojnë arsimin e mesëm të ulët ose teknik kanë të drejtë të vazhdojnë nivelin me të lartë, atë profesional për të përfituar një diplomë të arsimit të mesëm të vlefshëm për të vazhduar studimet e larta.

Nxënësit e arsimit të detyruar përfunduan për herë të parë në vitin 2009 arsimin 9 vjeçar nga 8 vjet që ishte më parë. Raporti nxënës për mësues i llogaritur për qark në arsimin 9 vjeçar tregon nivelin mesatar të nxënësve të regjistruar në atë qark që i takojnë një mësuesi të qarkut llogaritur sipas cikleve të veçanta.

Në arsimin e mesëm mbizotërojnë të regjistruarit në gjimnaze për të gjitha vitet. Vetëm 18 % e të regjistruarve në arsimin e mesëm në vitin 2013-2014 i përkasin arsimit profesional. Kjo përqindje është edhe më e larta ndër 5 vitet e fundit. Ndërsa në arsimin publik, të regjistruarit e arsimit profesional përbëjnë 19,3 % të totalit të tyre dhe me tendencë rritëse vit pas viti.

Në arsimin e mesëm publik vazhdojnë studimet në sistemin me kohë të plotë 87-90 % e nxënësve, duke filluar nga viti më i hershëm e deri në vitin e fundit. Por janë diplomuar vetëm 9.5% në arsimin e mesëm profesional në vitin shkollor 2013-2014 përkundrajt 90,5 % të diplomuar në gjimnaz, megjithëse të shpërndarë sipas qarqeve këto përqindje marrin vlera të ndryshme.

Duke u nisur nga dy vitet e fundit vendin e parë për arsimin profesional e zenë përkatësisht qarqet Shkodër e Durrës. Gjithmonë 50-55 % e atyre që përfundojnë arsimin e mesëm janë femrat, me trend rritës në vite. Kjo është pothuajse e njëjtë si në shkollat publike edhe private. Gjithashtu në vitin e fundit raporti i diplomimit faktik krahasuar me numrin e atyre që duhet të përfundojnë është i ndryshëm në qytet dhe në fshat. Në arsimin e mesëm publik me kohë të plotë përfunduan me sukses studimet 80,4 % e të regjistruarve në shtator të vitit akademik 2013-2014, ndërsa për fshatin kjo përqindje është 69, pra kuptohet që interesi për përfundim është më i lartë në qytet. Dallime ekzistojnë edhe ndërmjet qarqeve.

Në arsimin e mesëm publik raporti i mësueve për nxënës është i ndryshëm për qarqe të ndryshme. Në vitin e fundit raportin më të lartë e mbajnë përkatësisht qarqet Durrës, Kukës, Tiranë; kjo renditje ndryshon kur krahasojmë raportin për qytet ose fshat. Kështu raporti është më i lartë përkatësisht për qytetet e qarqeve Kukës, Durrës, Dibër dhe për fshatrat e qarqeve Durrës, Tiranë e Shkodër. Ndonëse ky raport është shumë më i ulët në arsimin privat gjithashtu edhe këtu ekzistojnë dallime ndërmjet qarqeve.

Në arsimin 9 vjeçar marrin pjesë afërsisht në të gjitha vitet 52-53 % djem përkundrejt 47- 48 % vajza. Në vlera absolute ka ardhur duke u ulur në mënyrë të vazhdueshme numri i nxënësve në 9 vjeçare sikurse edhe lindshmëria. Vihet re se të regjistruarit në qytete janë lehtësisht më të shumtë se në fshat, por kur krahasimi bëhet me qarqe ka diferenca akoma më të theksuara. Kjo ndodh sidomos me Tiranën (rreth 72%) e Vlorën (rreth 65- 66 %) që mbajnë vendin e parë për regjistrimet e qytetit, por edhe me Dibrën e Kukësin për regjistrimet e fshatit. Tirana dhe Durrësi janë qarqet me raportin më të lartë mësues për nxënës në fillore publik dhe akoma më të lartë e kanë në qytetet përkatëse. Përkundrazi vlerat më të ulta i mban Gjirokastra sidomos në fshat.

29. Strategjia e punësimit profesional

Gjatë dekadës së parë të shekullit 21, Shqipëria ishte një nga ekonomitë në rritje në Europë. Rritja ka ardhur si rezultat i transformimeve strukturore, të mbështetura kryesisht në lëvizjen e punës nga profesionet në bujqësi me prodhimtari të ulët të shërbimeve, ndërtimi dhe në një masë më të vogël prodhimi. Gjatë periudhës 2001-2013, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për frymë u rrit dyfish (deri në 4,799 \$) ose e barasvlershme kjo me 14 për qind të mesatares së Bashkimit Europian. Kjo rritje ekonomike u shoqërua me politika të qëndrueshme makroekonomike dhe fiskale, me reforma strukturore që përmirësuan mjedisin e biznesit dhe investimet në infrastrukturë, teknologji e burime njerëzore. Si rezultat, produktiviteti i punës u rrit me një mesatare prej 6.4 për qind në vit²⁷. Megjithatë, në vitin 2009 aktiviteti ekonomik filloi të ngadalësohej (3.4 për qind në vit), si pasojë e shterimit të faktorëve të rritjes, e ndërthurur kjo edhe me krizën globale ekonomike dhe financiare (Tabela 1). Në vitin 2012, rritja e prodhimit ishte ende pozitive, megjithëse nën potencialin e saj (1.6 për qind në vit), kurse gjatë vitit 2013 rritja pësoi rënie të mëtejshme. Rritja me ritme më të ngadalta përshkoi pothuajse të gjithë sektorët ekonomikë, duke qenë më e dukshme në sektorin e shërbimeve, të industrisë përpunuese dhe atë të ndërtimit. Aktualisht, ka një numër të madh kredish të këqija në dosjet e bankave, të cilat përbëjnë një pengesë të konsiderueshme për

Tabela 1: Treguesit kryesorë makroekonomikë, Shqipëri (2007-2013), duke përfshirë projeksionet për vitin 2014


	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Rritja reale e PBB-së	5.9	7.5	3.4	3.7	2.5	1.6	1.4	2.1
Inflacioni (ndryshimi në %)								

²⁷ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, viti 2014, nr. 188, f. 10314-10315

Formimi bruto i kapitalit fikse								
Të ardhurat totale	26.0	26.9	26.1	26.2	25.4	24.7	24.0	26.1
Shpenzimet totale	29.5	32.5	33.2	29.3	28.9	28.2	28.9	32.4
Bilanci i përgjithshëm fiskal								
Borxhi i përgjithshëm (% e PBB)	53.4	55.1	59.7	57.7	59.4	62.0	70.1	72.2
Eksportet (% e PBB)	10.1	10.3	8.6	13.2	15.4	16.0	17.8	19.1
Importet (% e PBB-së)	37.0	37.7	35.0	36.7	40.0	36.9	34.8	35.9
Investimet e huaja direkte, neto (%)	5.9	6.9	7.9	8.9	7.8	7.6	8.8	8.0
Bilanci aktual i llogarive rrjedhëse	-10.6	-15.6	-15.2	-11.5	-13.0	-10.7	-10.0	-8.3
Dërgesat e punëtorëve	12.2	9.4	9.0	7.8	7.3	7.1	5.6	--

Burimi: Ministria e Financave e Shqipërisë (2013)

Punësimi në sektorin e shërbimeve përbënte 37.9 për qind të punësimit gjithsej, ndërkohë që të punësuarit në industri përbënin 9.8 për qind të të gjithë punëtorëve, rrjedhimisht, meshkujt kanë më shumë se dy herë të ngjarë të punësohen në industri krahasuar me femrat. Në sektorin privat mbizotërojnë ndërmarrjet (bizneset) e vogla dhe të mesme. Kështu, 90 për qind e ndërmarrjeve aktive në vitin 2013, kishin të punësuar deri në 4 punëtorë, ndërsa pjesa më e madhe e tyre, 69 për qind, kishin vetëm një të vetëpunësuar. Ndërmarrjet që kanë punësuar 50 ose më shumë punëtorë përbëjnë vetëm 1.3 për qind të të gjitha ndërmarrjeve aktive, por njëkohësisht edhe 26.7 për qind të punësimit në tërësi. Ndërmarrjet e degëve që merren me prodhimin e mallrave (domethënë, industria, bujqësia dhe ndërtimi) përbëjnë 13.9 për qind të të gjitha ndërmarrjeve aktive, ndërsa gati 41.8 për qind e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorët e tregtisë, hotelarisë dhe restoranteve. Në vitin 2013, shkalla e krijimit të ndërmarrjeve ishte 10.9 për qind, nga 12.2 për qind që ishte shifra e ndërmarrjeve, të cilat ishin regjistruar një vit më parë.



Burimi: Forumi Ekonomik Botëror "Raporti mbi konkurrueshmërinë globale 2008-2012"

Vizioni i Strategjisë për punësim dhe aftësi 2014-2020, i frymëzuar nga objektivi i përgjithshëm i Europa 2020 për realizimin e një rritjeje të shpejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, është që

brenda vitit 2020 të kemi një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që mbështetet tek:

“Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për gjithë femrat dhe meshkujt”

Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë është *të nxisë vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi për gjithë femrat dhe meshkujt shqiptarë gjatë gjithë ciklit të jetës*. Ky qëllim do të arrihet me veprimtari politike koherente dhe të bashkërenduara, të cilat njëkohësisht i përgjigjen kërkesës dhe ofertës për punë, si dhe sjellin mënjanimin e hendeqeve të përfshirjes sociale. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi përqendrohet në katër përparësitë e mëposhtme strategjike:

Nxitja e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës

Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit

Nxitja e përfshirjes sociale dhe e kohezionit territorial

Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimeve

Objektivi kryesor i politikës ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës së ardhshme politike është ruajtja e stabilitetit makroekonomik dhe konsolidimi i mëtejshëm i financave publike.

Përparësia Strategjike

A: Nxitja e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave aktive të tregut të punës

A1 Modernizimi i Shërbimit Kombëtar të Punësimin, duke përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme dhe zyrat rajonale e vendore të punësimin

A1.2 Përcaktimi dhe zbatimi i një plani për zhvillimin dhe rekrutimin e stafit të SHKP-së.

A1.3 Modernizimi i infrastrukturës dhe sistemeve të TI në SHKP.

A1.4 Vendosja e modaliteteve të reja të bashkëpunimit me të tretët.

A2. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe institucional në përputhje me standardet e ratifikuara ndërkombëtare të punës.

A2.1 Rregullimi i agjencive private të punësimin dhe fuqizimi i bashkëpunimit me shërbimet publike të punësimin.

A2.2 Zgjerimi i njohjes dhe përmirësimi i shërbimeve të inspektimit për të pakësuar numrin e shkeljeve të ligjit të punës, veçanërisht

A3. Zgjerimi i gamës dhe shtrirjes së shërbimeve dhe programeve të punësimin (politikat aktive të tregut të punës).

A3.1 Vlerësimi dhe hartimi i politikave të përshtatshme dhe me ndjeshmëri për çështjet gjinore në tregun e punës.

A3.2 Regjistrimi, profilizimi dhe këshillimi i punëkërkuesve duke pasur parasysh faktorin gjinor.

A4. Përmirësimi i monitorimit dhe i vlerësimin të masave të punësimin, me ndjeshmëri për çështjet gjinore.

A4.1 Ngritja e një sistemi të qëndrueshëm dhe me ndjeshmëri për çështjet gjinore për monitorimin dhe vlerësimin, përfshirë

B. Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit

Përparësia Strategjike B. Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit

B1. Optimizimi i rrjetit të ofruesve të AFP-së për të siguruar një ofertë më të larmishme (duke përfshirë përcaktimin e kompetencave

sipas sektorëve)

B2. Sigurimi i cilësisë së ofruesve të AFP-së, dhe përmirësimi i cilësisë dhe përshtatshmërisë së inputeve të AFP-së (laboratorë, pajisje,

kurrikula, materiale mësimore) dhe proceseve të saj.

B3. Rritja e imazhit të AFP-së dhe informimi në lidhje me ofruesit, kualifikimet dhe ofertën e AFP-së.

B4. Forcimi i lidhjeve midis të nxënësve dhe punës si edhe lehtësimi i kalimit në punë

B5. Përmirësimi i emërimit dhe i kompetencave të mësuesve të AFP-së, si dhe i trajnerëve të mësuesve (trajnimi fillestar dhe i

vazhdueshëm profesional), të aktorëve të ngarkuar për menaxhimin rajonal, drejtuesve të shkollave ose qendrave profesionale.

C. Nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial

Përparësia strategjike C. Nxitja e përfshirjes sociale dhe e kohezionit territorial

Tregues rezultati: Të gjithë femrat dhe meshkujt kanë akses në formim profesional dhe shërbimet mbështetëse duke mundësuar kontributin e tyre dhe përfitimin nga zhvillimi social-ekonomik në rajone, veçanërisht te popullsia rurale

C1. Shtrirja e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional në zonat rurale

C2. Nxitja e sipërmarrjes sociale (ekonomia sociale dhe vendet e punës në sektorin e tretë) dhe fuqizimit ekonomik të femrave

C3. Paraqitja e strategjisë së aktivizimit për të minimizuar pasivitetin dhe grackat e ndihmës sociale

D. Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe sistemeve të kualifikimit

Përparësia Strategjike D. Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimit

D1. Reformimi i financimit dhe qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të AFP-së

D2. Përpunimi dhe zbatimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve

D3. Përmirësimi i cilësisë dhe i ndjeshmërisë gjinore, kur flitet për informacionin në tregun e punës dhe sigurimi i përdorimit të tij për një qeverisje më të barabartë dhe më efektive, duke përfshirë edhe financimet

D4. Modernizimi i kuadrit ligjor për AFP-në (mbi formimin bazë në AFP dhe për të rriturit)

D5. Legjislacioni kombëtar që rregullon lëvizjen dhe qeverisjen e tregut të punës është në përputhje me synimet e vendit për zhvillim social dhe ekonomik, si dhe me direktivat e Bashkimit Europian.

30. Të dhëna kulturore

Në qytetin e Korçës ka gjashtë muzeume:

1. Muzeu Kombëtar i Arsimit
2. Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar
3. Muzeu Oriental "Bratko"
4. Muzeu Arkeologjik Kombëtar
5. Shtëpia muze e piktorit "Vangjush Mio"
6. Muzeu "Gjon Mili"

Muzeu Kombëtar i Arsimit: Ky muze është ngritur në mesin të vitit 1887 u hap e para shkollë shqipe, ose siç njihet nga të gjithë "Mësonjëtorja". Godina ishte dhuruar për shkollë nga patrioti korçar Diamanti Tërpo. Në stendat e muzeut ekziston fotokopja e abetares së parë shqipe e shkruar nga patrioti Naum Veqilharxhi, si dhe abetarja e dytë e patriotit Kostandin Kristoforidhi. Fotot e atdhetarëve të shquar që dhanë kontributin e tyre në çeljen e kësaj shkolle si Pandeli Sotiri, Nini Luarasi, Nuçi Naçi, apo figura të shquara të arsimit si motrat Qiriazi etj, janë gjithashtu të ekspozuara në këtë muze.

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar: Muzeu është çelur në vitin 1980. Ekspozitat dhe fondet e pasura të tij përbëhen nga objekte historike, kulturore e artistike të periudhës mesjetare që lidhen kryesisht me trashëgiminë e krishtere bizantine dhe pas bizantine. Ikonat, objektet prej guri, koleksioni prej metalesh të çmuara, druri të gdhendur, tekstili, letre etj., janë shembuj të një larmie vlerash të paçmuara. Muzeu ka në sallën e ekspozitës permanente rreth 200 objekte arti. Në muze ndodhen disa laboratorë ekzaminimi e konservimi, mjediset e fondeve si dhe një infrastrukturë modeste mikroklimaterike. Në ekspozitë paraqiten një pjesë e veprave më të mira mesjetare nga periudha e autorë anonimë, apo të paidentifikuar. Midis tyre dallohen ikonat e shek. XIII-XIV, duke vijuar më pas me kryeveprat e kryemjeshtrave si Onufri, Nikolla, vëllezërit Zografi e bijtë e tyre, mësues Kostandini, Onufër Qiprioti, Simoni i Adrenicës si dhe të tjera vepra e autorë që kanë punuar në viset shqiptare e jashtë tyre. Në mes të këtij koleksioni janë rreth 150 autorë ikonografë shqiptarë dhe të huaj të zbuluar deri sot. Vepra më e njohur është "Monaliza e Ballkanit", një ikonë e periudhës bizantine e kryeëngjëllit Mihail. Drejtimet kryesore të aktivitetit të muzeut janë ekspozimi dhe promovimi publik, mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i objekteve, studimi e puna shkencore si dhe aktiviteti ndërkombëtar.

Duke parë rëndësinë e madhe që ka aktiviteti i këtij muzeu, gjatë vitit 2015, Bashkia Korçë po punon për ndërtimin e Muzeut të ri të Artit Mesjetar, i cili do të ofrojë një ambient më tërheqës dhe më bashkëkohor, jo vetëm për ekspozimin e vlerave të tij por dhe për të siguruar infrastrukturën e nevojshme laboratorike për mirëmbajtjen dhe restaurimin e tyre.

Muzeu Oriental "Bratko": Muzeu Oriental "Bratko", u çel në qershor të viti 2003, duke përmbushur ëndrrën e Dhimitër Borjes (1903-1990), artist, fotograf dhe koleksionist i artit aziatik dhe antikuareve. Borja ka lindur në Korçë, ndonëse ai udhëtoi shumë nëpër botë dhe jetoi në Amerikë gjatë pjesës më të madhe të jetës së tij. Në këtë muze ekspozohen 432 objekte si: piano, altar kinez, veshje për gra japoneze, funde e rripa kineze, shpatë indoneziane, medalje evropiane, piktura japoneze, fotografi të ndryshme, të cilat Borja i ka realizuar kur shërbente në Ballkan me mision të OKB-së. Pamjet

fotografike janë krejt të veçanta. Ato tregojnë historinë shoqërore e kulturore menjëherë pas luftës si dhe rolin e rëndësishëm që luajti gjeneral Macarthur në rindërtimin ekonomik dhe institucional të

Japonisë. Arkivisti Zobel për Borian thotë: “Ai ishte një gjeni. Ai erdhi në këtë vend pa asgjë dhe me punën e tij arriti të bëhej i famshëm. Kjo mjafton për të treguar karakterin e tij të fortë”

Muzeu Arkeologjik Kombëtar: Muzeu u krijua në vitin 1985 dhe mori formë më të gjerë e më të plotë pas riorganizimit të tij në vitin 1990. Ky muze është vendosur në dy banesa karakteristike korçare të fillimit të shekullit të XIX, të cilat për vlerat arkitektonike të tyre janë shpallur monumente kulture. Muzeu Arkeologjik Kombëtar është i veçantë në llojin e vet pasi ai është përqendruar në prehistorinë e zonës juglindore, e fillon nga periudha neolitike dhe deri në fazën e zhvilluar të epokës së hekurit. Në këtë muze janë përfaqësuar disa vendbanime të rëndësishme prehistorike si, Maliqi, Potgoria, Dunavec, Trajani e përmbillet me një sezon të vogël të periudhave pas prehistorike. Në Muzeun Arkeologjik Kombëtar ka rreth 1200 objekte të ekspozuara, shumica me përkatësi nga epokat neo-eneolitike, bronzit dhe epokës së hekurit.

Shtëpia muze e piktorit Vangjush Mio: Shtëpia muze e piktorit impresionist korçar Vangjush Mio, është shpallur monument kulture dhe përmban rreth 40 piktura në vaj, peisazhe, natyra të qeta si dhe shumë vizatime, të cilat janë të njohura për stilin e tyre tepër të veçantë. Vangjush Mio dallohet si piktor peisazhist shqiptar dhe është i pari piktor shqiptar që hapi ekspozitën e parë në Tiranë në vitin 1920, ndërsa në vitin 1942 hapi ekspozitën vetjake në Bari.

Muzeu “Gjon Mili”: Fotografi amerikan me origjinë shqiptare Gjon Mili, tani ka një kënd muzeal në qytetin e origjinës së tij, Korçë. 15 fotografi të realizuara nga fotografi me famë botërore janë ekspozuar në ambientet e brendshme të Qendrës Kulturore “Vangjush Mio”, në një sallë të veçantë. Gjon Mili njihet si fotografi që përdori për herë të parë flashin elektronik dhe fotografimin e lëvizjes. Gjon Mili lindi më 24 nëntor 1904 në Korçë. Në moshën 5 vjeçare familja e tij emigroi në Rumani. Atje Milipërfundoi shkollën e mesme dhe në moshën 19 vjeçare u largua në Amerikë. U diplomua në Institutin e Teknologjisë së Masaçusetit si inxhinier ndriçimi. Gjatë kësaj kohe u mor me artin e fotografisë.

Qendra kulturore

Qendrat kulturore në qytetin e Korçës janë Biblioteka “Thimi Mitko”, Teatri “Andon Zako Çajupi”, Qendra Kulturore “Vangjush Mio”, Biblioteka e Fëmijëve “Thoma Turtulli”.

Objekte kulti

Disa nga objektet e kultit, në territorin e Bashkisë Korçë, janë:

- | | | |
|----|--|---------|
| 1. | Kisha Ngallja e Krishtit | – Korçë |
| 2. | Selia Mitropolitane dhe Kisha e Burimit Jetëdhënës | – Korçë |
| 3. | Kisha e Shën Thodrit | – Korçë |
| 4. | Kisha e Shën Triadhës | – Korçë |
| 5. | Kisha e Shën Mërisë | – Korçë |

6. Kisha e Shën Athanasit	– Korçë
7. Kisha Shën Ana	– Korçë
8. Kisha e Shën Harallambit	– Korçë
9. Kisha Metamorfoza e Shpëtimtarit	– Korçë
10. Kisha ungjillore	– Korçë
11. Kisha katolike	– Korçë
12. Xhamia e Iljaz Bej Mirahorit	– Korçë
13. Medreseja	– Korçë
14. Kisha e Porfetit Ilia	– Moravë
15. Kisha e Shën Elenës	– Drenovë
16. Kisha e Shën Kostandinit	– Drenovë
17. Kisha e Profetit Ilia	– Drenovë
18. Kisha e Fjetjes së Hyjëllindëses Mari	– Drenovë
19. Kisha e Shën Kollit	– Polenë
20. Kisha Shën e Premte	– Polenë
21. Kisha Metamorfoza e Shpëtimtarit	– Polenë
22. Kisha e Shën Sotirit	– Polenë
23. Kisha e Shën Nikodhimit	– Vithkuq
24. Kisha e Taksiarkëve	– Vithkuq
25. Kisha e Shën Kozmait	– Vithkuq
26. Kisha e Shën Mëhillit	– Vithkuq
27. Kisha e Shën Marisë	– Vithkuq
28. Kisha e Shën Pjetrit	– Vithkuq
29. Kisha e Shën Nikollës	– Voskopoje
30. Kisha e Profetit Ilia	– Voskopoje
31. Bazilika e Shën Pjetrit	– Voskopoje
32. Kisha Kryeëngjëjt Mikael dhe Gabriel	– Voskopoje
33. Kisha Shën Ilia	– Voskopoje
34. Kisha Shën Athanasi	– Voskopoje
35. Kisha Shën Maria	– Voskopoje
36. Manastiri i Shën Prodhromit	– Voskopoje
37. Kisha e anargjendeve Kozma e Damian	– Boboshticë
38. Kisha e Shën Dhimitrit	– Boboshticë
39. Kisha e Shën Joanit	– Boboshticë
40. Kisha Shën Kozma dhe Damian (Satrivaç)	– Dishnicë
41. Kisha Shën Matrona	– Dishnicë

42. Kisha Shën Mëhilli	– Dishnicë
43. Kisha Shën Nikolla	– Dishnicë
44. Kisha Shën e Premte	– Dishnicë
45. Kisha Shën Dhimitër	– Dishnicë
46. Kisha e Shën Stefanit	– Malavec
47. Kisha Shën Nikolla	– Barç
48. Kisha Shën Anastas Persiani	– Çiflig
49. Kisha Shën Thomai	– Çiflig
50. Kisha Shën e Premte	– Ravonik
51. Manastiri i Shën Mërisë	– Trebickë
52. Manastiri i Shën Nikoll	– Kamenicë
53. Teqeja e Turanit	– Turan
54. Teqeja e Melcanit	– Melçan
55. Xhamia – Mborje	– Mborje
56. Xhamia – Dishnicë	– Dishnicë
57. Xhamia – Bulgarec	– Bulgarec

Festa/aktivitete kulturore

Qyteti i Korçës njihet dhe për panairët e veçanta të organizuara në periudha të ndryshme të vitit. Ndër to mund të përmendim Panairin e Poçerisë, i cili zhvillohet javën e Pashkëve Ortodokse dhe Panairin e Krishtlindjeve. Gjithashtu në qytet organizohen dhe festa të ndryshme si, Karnavalet, Festa e Lakrorit, Festivali i Ushqimit, Festa e Birrës. Ndër aktivitetet kulturore mund të përmendim Koloninë Ndërkombëtare të Piktoreve dhe Simpoziumin Ndërkombëtar të Skulptoreve.

Zonat me rëndësi kulturore dhe historike/të mbrojtura

Në territorin e Bashkisë Korçë ka disa site arkeologjike të mbrojtura, me rëndësi kulturore dhe historike, të cilat janë:

1. Kalaja e Dishnicës
2. Kalaja e Kuçit të Zi
3. Kalaja e Mborjes
4. Mozaiku i Polenës
5. Tuma e Kamenicës
6. Vendbanimi prehistorik i Barçit

Në territorin e Bashkisë Korçë ka disa objekte kulti të mbrojtura, me rëndësi kulturore dhe historike, të cila janë:

1. Bazilika e Shën Pjetrit – Voskopojë
2. Kisha Kryeëngjëjt Mikael dhe Gabriel – Voskopojë
3. Kisha Shën Ilia – Voskopojë
4. Kisha Shën Athanasi – Voskopojë
5. Kisha Shën Gjergji – Shipskë
6. Kisha Shën Maria – Voskopojë
7. Kisha Shën Nikolla – Voskopojë
8. Kisha Shën Triadha (Tudas) – Lekas
9. Kulla e Turanit
10. Manastiri i Shën Prodhromit - Voskopojë
11. Ikonostasi i Kishës së Shën Gjergjit – Dardhë
12. Kulla e Dishnicës
13. Kulla e Malavecit
14. Kisha e Ristozit – Mborje
15. Kisha e Shën Dhimitrit – Boboshticë
16. Kisha e Shën Joanit – Boboshticë
17. Kisha e Shën Kozmait – Vithkuq
18. Kisha e Shën Mëhillit – Vithkuq
19. Kisha e Shën Marisë – Lubonjë
20. Kisha e Shën Marisë – Vithkuq
21. Kisha e Shën Pjetrit – Vithkuq
22. Kisha e Shën Pjetrit – Voskopojë

Në territorin e Bashkisë Korçë ka disa objekte të mbrojtura, me rëndësi kulturore dhe historike, të cila janë:

1. Kulla e Turanit
2. Kulla e Dishnicës
3. Kulla e Malavecit
4. Ura e Voskopojës, Shën Prodhromi
5. Ura e Shipskës
6. Ura e Zotos Vithkuq

7. Banesa e Ristanëve – Vithkuq
8. Banesa e Safet Llapanjit – Xerje
9. Banesa e Ollga Pazes – Dardhë

10. Banesa e Ilo Kuneshkës – Boboshticë
11. Banesa e Syrja Hoxhollarit – Gjonbabas, Lekas
12. Qendra Historike – Voskopojë

Ndërsa, në qytetin e Korçës ka shumë monumente kulture të mbrojtura , të cilat janë të kategorisë së parë dhe të dytë. Monumentet e kategorisë së parë janë:

1. Xhamia e Iljaz Bej Mirahorit
2. Hani i Elbasanit
3. Hani i Manastirit
4. Pazari i vjetër i qytetit
5. Banesa e Elpiqini Nices
6. Banesa pasuri shtet (Ish Vaskë Xengo)
7. Banesa e Polikseni Theodhorit
8. Banesa pasuri shtet (Ish Xhaferr Zpi)
9. Banesa e Aleksandër Avramit
10. Banesa e vjetër e Sokrat Mios
11. Banesa e Ilo e Vangjel Budos
12. Banesa e Anastas Dhimitrit
13. Banesa e Lipi e Vaskë Kotes
14. Banesa e Vllazërisë Frashëri
15. Banesa e Margarita Gramenos
16. Banesa e Ngjelina Nastasit
17. Banesa e Andromaqi Melkos
18. Banesa e Filip Çekanit
19. Banesa pasuri shtet
20. Banesa e Afroviti Dusharit
21. Banesa e Ollga Mingës
22. Banesa e Marika Stratobërdha

23. Banesa e Ollga Xhamballos
24. Banesa e Koçi Demirit
25. Banesa e Vllazërisë Lubonja
26. Banesa e Klani Marjanit
27. Misafirhanë e Vangjush Mios
28. Godina e vjetër e Liceut
29. Banesa ku u ngrit flamuri i Republikës së Korçës
30. Mësonjëtorja e Parë Shqipe (Muzeu i Arsimit)
31. Monumenti i Luftëtarit Kombëtar
32. Monumenti i Themistokli Gërmenjit

33. Studio e Fotografit Kristaq Sotiri (muze)

34. Zona Muze dhe Zona e Mbrojtur

35. Zgjerimi i Qendrës Historike

36. Vila Polena

37. Qendra Historike e qytetit të Korçës dhe Rregullorja për Administrimin e saj

Në qytetin e Korçës ka dhe objekte të shpallura në mbrojtje paraprake. Statusi i tyre është 6-mujor dhe gjatë kësaj periudhe ndalohet çdo ndërhyrje në gjendjen fizike të objekteve. Numri i objekteve të mbrojtura (kategoria II), në muajin shkurt 2015 ka qenë 128.

31. Aspektet ekonomike

Plani i Përgjithshëm Kombëtar është një nga dokumentat strategjik me të rëndësishëm që do të ofrojë një vizion për zhvillim afatgjatë e cilësor të territorit të Republikës së Shqipërisë për 15 vitet e ardhëshme për të siguruar

Zhvillim të balancuar ekonomik e social të vendit në të gjithë territorin

Menaxhimin të përgjegjshëm të burimeve natyrore në të gjithë territorin

Mbrojtjen e mjedisit, ndërkohë që siguron përdorimin racional të tokës

Ky plan do të sigurojë gjithashtu harmonizim e të gjithë politikave sektoriale e ndërsektoriale për të gjithë territorin prej 28 248 km², duke i shërbyer zhvillimit në tërësi të shoqërisë Shqiptare dhe individëve të saj. Ky plan është plan 15 vjeçar dhe do të shërbejë për një zhvillim afatgjatë dhe cilësor duke u bazuar në një planifikim më të mirë të territorit.

Vizioni

Vizioni për Shqipërinë 2030 është të jetë një qëndër e integruar në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor Europian, një ekonomi e shumëllojshme dhe konkurruese në hapsirën Ballkanike, një shtet që synon barazinë në akses, në infrastrukturë dhe ekonomi.

Sipas këtij plani Integrimi në kontekstin europian, do të jetë shumëdimensional, duke e pare Shqipërinë si faktor stabiliteti dhe si qëndër ndërlidhëse të rajonit të Ballkanit .

Mungesa e planifikimit strategjik kombëtar, mos shfrytëzimi i të gjithë potencialeve që ka Shqipëria në kontinentin Europian si dhe i pozicionit i saj kyë për shume projekte strategjike ekonomike e ka penalizuar atë të maksimizojë avantazhet e saj për tu pozicionuar dhe fuqizuar me mirë pozitat e saj në rajon.

Rrjedhimisht dhe ndarjet administrative brenda territorit Shqipëtar e kanë pasur edhe më të pamundur përveç shumë arsyeve të tjera të maximizojnë përfitimet e tyre ekonomike e sociale nga ky pozicion.

Prioritetet i Planit Kombëtar mbetet realizimi dhe finalizimi i lidhjeve strategjike të vendit me Europën :

- *Korridori gjelbërt (Shkodër Han i Hotit- Gjirokastër Kakavijë)*
- *Korridori blu (rrugë bregdetare turistike me impakt të ulët mjedisor që lidh lokalitetet e bregdetit)*
- *Korridori VII (Via Egnatia) lidhja nga deti Mesdhe me Detin e Zi*
- *Boshti qëndror (Elbasan- Berat - Gjirokastër)*

- *Rruga e Arbërit*

Objektivi për realizimin e këtyre lidhjeve strategjike mbetet “ Shqipëria Qendër Ndërlidhëse Infrastrukturore dhe Energjetike për Ballkanin”

Projektet prioritare sipas këtij Plani do të fokusohen në dy fusha Energjetikë dhe Transporti Portual:

Korridoret Energjetike:

- *Tashmë është konkretizuar gazsjellësi TAP*

- *Plani vendos si prioritet realizimin e gazsjellesit IAP që do të kalojë*

në pjesën perëndimore të Shqipërisë, nga Fieri në Shkodër për të furnizuar Malin i Zi e përtej.

- *Nga korridori i mësipërm IAP realizohet degëzimi i rëndësishëm*

që furnizon me gaz Kosovën nëpërmjet Kukësit.

- *Realizimi i Unazes Përendimore të Ballkanit Ëestern Ballkan*

Rings.

Transporti Portual

Zhvillimi i 4 porteve kryesore të Shqipërisë me kapacitete të 2- fishuara si pikënisje të autostradave detare dhe me funksione të veëëanta:

- *Porti i Durrësit (përpunim dhe transport mallrash dhe turistik)*

- *Porti i Vlorës (turistik dhe energjistik)*

- *Porti i Shëngjinit (turistik dhe peshkimi)*

- *Porti i Sarandës (turistik)*

Përfshirja e Shqipërisë në disa programe Europiane si Ipa Adriatik

Ionian, Med Program, Ipa Crossborder, kërkon krijimin e strukturave të përshtatshme territoriale dhe administrative të afta për të aksesuar fondet e këtyre programeve, për të bërë të mundur pozicionimin e Shqipërisë këto lidhje të rëndësishme.

Plani Kombëtar ka në fokus 5 Sistemet territoriale kombëtare:

- *Sistemin Urban*

- *Sistemin Ujor*

- *Sistemin Bujqësor*

- *Sistemin Natyror*


- *Sistemin Infrastrukturor*

Keto sisteme jane te organizuar në marredhenie mes qëndrave korridoreve dhe zonave mbi bazën e të cilave do të detajohen dokumentet e planifikimit të hierarkive më të ulëta.


Plani Kombëtar është për një sektor bujqësor *Konkurues*.

Sipas planit, 40 % e sipërfaqës së përgjithshme të Shqipërisë klasifikohet si tokë bujqësore (24 % tokë arë dhe 15 % kullota), ndërsa pjesa tjetër e ndarë ndërmjet pyjeve (36 %) dhe funksioneve të tjera. 43 % e tokës bujqësore gati gjysma e saj, është përqëndruar në pjesën më të populluar të ultësirës perëndimore bregdetare. Rreth 34 % e tokës bujqësore shtrihet në lugina lumenjsh, dhe 23 % në zonën malore. 20% të PBB-së vjen si Kontribut i sektorit Bujqësor por kontributi më i madh i këtij sektori vjen nga numri i të punësuarëve në të, afro 50 %.

Harta e fondit të pronave bujqësore Bashkia Korçë, Vjetari statistikor Instat



Harta e Fondit të Agrikulturës të Bashkisë Korçë, Vjetari statistikor Instat



Rëndësia e sektorit duket qartë nga statistikat e mësipërme, për këtë arsye Plani do të mbështesë këto politika

Ruajtje, Konsolidim, Modernizim

Sfidat më të larta të këtij sektori sipas Planit, janë:

- *ulja e disbalancës tregëtare në raportin midis Importit të produkteve agroushqimore*
- *Ruajtje, maksimale e Fondit të Tokës Bujqësore me anë të politikave të densifikimit të Zhvillimit urban. Me miratimin e Planit Kombëtar 2030 nuk do të lejohet asnjë ndërtim i ri që nuk i shërben Bujqësisë.*
- *Vendosja e një Rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor Prodhim- Grumbullim- Përpunim- Eksportim që con në rritje të vlerës së produktit. Ulja e kostos dhe rritje e cilësisë nëpërmjet investimeve në Teknologjinë e prodhimit për Modernizimin e tij. Investime në infrastrukturën e mirëmbajtjes, kanale ujitëse, vaditëse, hidrovore.*
- *Integrim dhe bashkepunim me Sektorët e tjerë të Ekonomisë si Bujqësi-turizëm, ku vecantia e sektorit turistik shqipëtar identifikohet edhe nga produktet bujqësore karakteristike në shije e cilësi. Bujqësi- Transport, infrastruktura e transportit i shërben rrjetit eficient të shpërndarjes dhe grumbullimit të prodhimeve Bujqësore. Krijimi i Poleve Bujqësore dhe Profilizimi i Tyre sipas karakteristikave të prodhimit bujqësor. Krijimi i Markave të produkteve karakteristike Bujqësore Made in Albania.*
- *Bime mjekesore-Peme frutore arrore-Ullinj dhe Vreshta- Përime karakteristike të vendit, Produkteve të përpunuar.*

Industria e konfeksioneve

Kjo industri përbën një faktor të rëndësishëm në ekonominë rajonale. Është dega më e madhe në kuptimin e numrit të ndërmarrjeve, me të punësuar kryesisht gra. Në shumicën e rasteve shoqëri të përbashkëta Shqiptaro – Greke, kompanitë punojnë në sektorin e konfeksioneve. Gjithë lënda e parë vjen nga jashtë dhe produktet eksportohen totalisht gjithashtu.

Perspektiva afat mesme e sektorit Për shkak të rritjes së kostos së krahut të punës në Shqipëri **ky sektor nuk do të mbetet shumë atraktiv për kohë të gjatë.** Kompanitë e huaja porositesë priren drejt tregjeve ku fuqia punëtore është më e lirë. Për shkak dhe të krizës greke, perspektiva e këtij sektori është duke u ulur nga viti në vit. Vetëm ato kompani që do mund të krijojnë lidhje direkte biznesi me klientë (të mëdhenj) dhe furnizues, që do mund të eliminojnë partnerët ndërmjetës grekë, kanë shansin të mbijetojnë. Një mundësi tjetër për këtë sektor mund të jetë dhe prodhimi (relativisht i vogël) për tregun vendas. Por kjo do mund të sigurojë vetëm një numër të limituar kompanish/ të punësuarish.

Spektori Agropërpunues

Rajoni i Korçës është një nga prodhuesit e e mëdhenj të mishit dhe sallameve, bulmeteve, pijeve alkolike dhe jo alkolike, përpunimit të kërmillit e më tej. Biznesi i agroperpunimit është rritur vazhdimisht vitet e fundit. Sektori i industrisë ushqimore është bërë një faktor i rëndësishëm i punësimit për Rajonin e Korçës. Përpunimi i frutave dhe zarzavateve, përpunimi i qumështit, prodhimi i verës, prodhimi i vajit, miellit etj., kanë regjistruar rritje. Shumica e kompanive që operojnë në këtë

sektor janë klasifikuar të vogla ose të mesme. Aktualisht, firmat që punësojnë deri në pesë punonjës përbëjnë rreth 87% të numrit total të ndërmarrjeve, ndërsa numri i bizneseve me 6 – 10 të punësuar ka tendencë të rritet.

Perspektiva afat mesme e sektorit: *Sektori i agropërpunimit do të jetë një nga prioritetet në strategjinë afat mesme të zhvillimit për rajonin, për arsye të egzistencës së burimeve natyrale. Duke u bazuar dhe në lidhjet me zhvillimin e sektorit të bujqësisë, sektori i agropërpunimit ka shansin real të bëhet një aktor kryesor në shkallë vendi dhe transrajonale (Ballkan).*

Sektori i Ndërtimit

Në rajonin e Korçës ka disa kompani ndërtimi, që kryesisht veprojnë në fushën e ndërtimeve private dhe ndërtimeve tregetare, shërbime ndërtimi për projekte publike dhe në prodhimin e materialeve të ndryshme të ndërtimit. Disa nga ndërmarrjet e ndërtimit kanë krijuar struktura të mirëorganizuara dhe përpiqen të krijojnë marrëdhënie kooperimi internacionale. Ndërtimi ka paraqitur një dinamikë të lartë ekonomike dhe përbën një potencial të madh për rritjen e ekonomisë dhe punësimit.

Perspektiva afat mesme e sektorit: *Bazuar në kërkesën e emigrantëve për tu kthyer në Korçë, por dhe në lëvizjet demografike të popullsisë drejt kryeqendrave të urbanizuara, tregu i shtëpive për banim do të mbetet i qëndrueshëm në perspektivën afat mesme. Sektori i ndërtimit, për shkak të ndryshimeve në legjislacion dhe për shkak të mungesës së një Plani të Përgjithshëm Vendor deri në vitin 2014, është përqendruar më tepër në investimet publike. Kompanitë lokale të ndërtimit që janë në gjendje të rinovojnë teknologjinë e tyre, standartet e cilësisë, burimet njerëzore dhe të krijojnë partneritete me kompani të huaja me eksperience do të kenë shanse të mira në perspektivën afatmesme.*

Të dhëna për numrin e bizneseve të liçensuara në sektorë të ndryshëm të industrisë:

Industria	Korçë	Drenovë	Lekas	Mollaj	Bulgarec	Vithkuq	Voskop	Voskopojë
Industria	5	0	0	0	1	0	0	1
ndihmëse								
Ndërtim	40	10	0	2	6	0	2	2
Inform.	46	2	0	0	0	0	2	0
Komun.								
Energjia	4	0	0	1	2	1	0	0
elektrike,								
Industria	298	20	0	8	16	6	1	0
nëpunuese								
Furnizimi me2		0	0	0	0	0	0	0
ujë dhe								
menaxhimi								
mbatjeve								
Total	394	32	0	11	25	7	5	3

Emërtimi	Transport	Transport mallrash	Të tjera	Total
Korçë	58	18	207	283
Drenovë	5	3	20	28
Lekas	0	0	0	0
Mollaj	1	2	12	15
Bulgarec	8	6	17	31
Vithkuq	1	0	3	4
Voskop	0	1	8	9
Voskopojë	0	0	1	1


32. Analizë e financave vendore

BUXHETI I BASHKISE DHE INSTITUCIONEVE TE VARTESISE PER VITIN 2015


Planifikimi

Planifikimi

Burimet e financimit:	Shuma '000 leke	%
-transferta e pakushtëzuar	248.008	25%
-të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	445.684	45%
-të ardhurat e institucioneve	16.189	2%
-të ardhurat e trashëguara	46.593	5%
-të ardhura nga fondi i zhvillimit të rajoneve	52.117	5%
-huamarrja vendore (kredia)	176.693	18%
Total	985.284	100%
Shpenzimet:		
-shpenzimet për personelin (paga + sig shoqërore)	202.804	21%
-shpenzime korrente (shp. Op., subv, transferta)	446.460	45%
-shpenzime për investime	307.934	31%
-shpenzime për interesa dhe principal	28.086	3%
Total	985.284	100%



Shpenzimet




■ Shpenzimet:

- -shpenzimet për personelin (paga + sig shoqërore)
- -shpenzime korrente (shp. Op., subv, transfert)
- -shpenzime për investime

Shpenzimet sipas programeve	Viti 2010	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2015
Administrim i përgjithshëm	152.686,00	26%	149.065,00	27%	204.346,00	28%	197.902,00	39%	204.169	28%	215.340	23%
Sherbimet Publike	241.188,00	41%	243.564,00	43%	155.087,00	43%	140.514,00	28%	304.102	40%	475.310	51%
Arsimi parauniversitar	89.085,00	15%	71.490,00	13%	71.876,00	13%	78.204,00	15%	107.791	15%	113.264	12%
Kulture dhe sport	96.470,00	17%	87.353,00	16%	86.688,00	15%	88.522,00	17%	115.684	16%	118.844	13%
Transporti urban	3.500,00	1%	3.588,00	1%	4.588,00	1%	5.456,00	1%	6.500	1%	7.000	1%
Totali	582.929,00	100%	555.060,00	100%	522.585,00	100%	510.598,00	100%	738.246	100%	929.758	100%

**Shpenzimet
sipas
ndarjes
ekonomike**

	Viti 2010		Viti 2011		Viti 2012		Viti 2013		Viti 2014		Viti 2015	
Paga dhe sigurime shoqerore	184.775,00	32%	192.897,00	35%	188.882	36%	186.856	37%	193.702	26%	201,8	22%
Shpenzime operative	268.462,00	45%	226.482,00	40%	224.190	43%	242.161	47%	369.157	51%	427.700	45%
Shpenzime te tjera	14.667,00	3%	15.932,00	3%	25.631	5%	44.323	9%	62.627	8%	43.438	5%
Investime	115.025,00	20%	119.749,00	22%	83.882	16%	37.258	7%	112.760	15%	255.817	28%
Totali	582.929,00	100%	555.060,00	100%	522.585,00	100%	510.598	100%	738.246	100%	929,76	100%



TARIFAT

Nr	Lloji i taksës ose										2015	
		2011	%	2012	%	2013	%	2014	%	Realizimi	Plani	%
A 3	Taksë vendore B.	93.875	28,6%	89.193	30,5%	82.770	29,1%	41.488	13,9%	55.949	100.000	22,4%
A 15	Tarifë pastrimi	40.345	12,3%	49.720	17,0%	58.843	20,7%	62.825	21,0%	70.972	80.000	17,9%
A 1	Tatim mbi ndërtesë	38.421	11,7%	43.777	15,0%	45.729	16,1%	67.425	22,5%	77.351	74.000	16,6%
A 6	Taksë për ndërtim	67.162	20,4%	4.930	1,7%	118	0,0%	1.695	0,6%	7.836	46.007	10,3%
A 26	Tarifë ndriçimi	11.179	3,4%	15.425	5,3%	17.775	6,2%	23.705	7,9%	26.458	31.000	7,0%
A 27	Tarifë gjelbërimi	7.270	2,2%	10.546	3,6%	12.084	4,2%	15.503	5,2%	17.215	20.000	4,5%
C 4	Taksë rregjistrimi e	15.501	4,7%	23.380	8,0%	21.498	7,6%	16.649	5,6%	20.649	17.000	3,8%
A 11	Taksë reklame	13.366	4,1%	13.103	4,5%	13.744	4,8%	18.552	6,2%	12.794	14.000	3,1%
A 17	Tarifë parkimi	2.780	0,8%	2.423	0,8%	1.943	0,7%	5.480	1,8%	13.465	11.700	2,6%
B 34	Të ardh nga qiratë	00	0,0%	00	0,0%	00	0,0%	3.588	1,2%	6.472	6.662	1,5%
A 16	Tarifë shërbimi, vë	3.237	1,0%	5.991	2,0%	5.926	2,1%	10.527	3,5%	8.736	6.000	1,3%
B 37	Qera nga banesat nga Enti Kombëtar	00	0,0%	00	0,0%	00	0,0%	4.679	1,6%	3.744	5.293	1,2%
A 29	Tarifë përdorimi i t	10.721	3,3%	5.317	1,8%	501	0,2%	4.263	1,4%	2.622	4.300	1,0%
C 2	Tatim shitjeje pasu	5.130	1,6%	3.828	1,3%	6.461	2,3%	5.663	1,9%	9.231	4.000	0,9%

B	5	Taksë rregjistrimi e	3.020	0,9%	2.747	0,9%	2.770	1,0%	3.165	1,1%	5.393	3.500	0,8%
A	7	Taksë ndikimi në ir	4.671	1,4%	4.564	1,6%	2.735	1,0%	449	0,2%	4.254	3.000	0,7%
A	14	Taksë tavoline	1.969	0,6%	2.741	0,9%	2.022	0,7%	2.595	0,9%	3.444	2.800	0,6%
B	20	Gjoha inspektoriati	150	0,0%	1.120	0,4%	2.030	0,7%	1.390	0,5%	730	2.500	0,56%
A	36	Taksë e përkohshre	00	0,0%	00	0,0%	00	0,0%	00	0,0%	00	2.496	0,6%
A	9	Taksë fjetje në hot	1.730	0,5%	1.886	0,6%	1.786	0,6%	1.667	0,6%	3.327	2.000	0,4%
B	22	Qera objekti	672	0,2%	1.550	0,5%	820	0,3%	1.305	0,4%	1.315	1.260	0,3%
A	31	Tarifë për ekspozir	843	0,3%	981	0,3%	715	0,3%	1.120	0,4%	1.461	1.200	0,3%
A	8	Tarifë rregjistrimi p	2.841	0,9%	853	0,3%	221	0,1%	494	0,2%	955	1.000	0,2%
A	30	Tarifë leje përdorin	949	0,3%	1.081	0,4%	824	0,3%	915	0,3%	788	874	0,2%
A	13	Tarifë mur perimet	846	0,3%	87	0,0%	00	0,0%	23	0,0%	149	809	0,2%
A	10	Taksë therrjeje baq	620	0,2%	761	0,3%	745	0,3%	755	0,3%	785	800	0,2%
A	33	Tatim mbi token bu	00	0,0%	3.761	1,3%	439	0,2%	949	0,3%	896	800	0,2%
A	28	Tarifë servituti	302	0,1%	377	0,1%	338	0,1%	679	0,2%	657	700	0,2%
A	32	Taksë zënie hapë	00	0,0%	283	0,1%	355	0,1%	448	0,1%	637	550	0,1%
B	23	Qera sipërmarrje	00	0,0%	864	0,3%	396	0,1%	432	0,1%	36	432	0,1%
B	18	Gjoha policia bash	65	0,0%	42	0,0%	19	0,0%	22	0,0%	208	300	0,07%
A	12	Taksë tabele	255	0,1%	261	0,1%	247	0,1%	251	0,1%	290	251	0,1%
B	19	Gjoha biznesi i vog	676	0,2%	620	0,2%	757	0,3%	447	0,1%	2.196	200	0,04%
B	21	Gjoha të drejtorisë	72	0,0%	125	0,0%	55	0,0%	33	0,0%	149	150	0,03%
A	25	Tarifë plan vendos	96	0,0%	00	0,0%	00	0,0%	192	0,1%	90	100	0,0%
B	24	Shitje troje	00	0,0%	00	0,0%	00	0,0%	00	0,0%		00	0,0%
B	35	Të ardh nga shitja	00	0,0%	00	0,0%	00	0,0%	00	0,0%		00	0,0%
		TOTALI	328.763	100%	292.339	100%	284.668	100%	299.373	100%	361.255	445.684	100%

A

Taksa - Tatime

B

Te ardhura jo tatimore

C Te ardhura nga institucione te tjera

GRANTET

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Transferta e pakushtëzuar (grandi)	171.127	167.287	171.421	177.165	230.960	248.008

	INVESTIMET	Detyrime 2014	Buxheti Real 2015	Buxheti 2015
1	Infrastruktura rrugore nga te ardhurat për vitin 2015	26.534	4.466	31.000

2	Administrimi i përgjithshëm (blerje pajisje zyre dhe pajisje kompjuterike)	96	1.000	1.096
3	Shërbimeve publike nga të ardhurat e bashkisë	16.065	-	16.065
4	Studime urbanistike	-	7.000	7.000
5	Infrastruktura rrugore nga fondi i zhvillimit të rajoneve	-	52.117	52.117
6	Infrastruktura rrugore nga huamarrja vendore	-	72.001	72.001
7	Shërbime publike nga huamarrja vendore	-	104.683	104.683
8	Arsimin parauniversitar	434.000	285.000	719.000
9	Investime në kulturë	1.563	-	1.563
10	Investimet për mbrojtjen dhe promovimin e kulturës	-	2.428	2.428
11	Investimet për rehabilitimin e banesave në bashkëpronësi	-	155.000	155.000
	Total	478.258	683.695	1.161.953

32.1. Çështje financiare

Zgjedhja e burimeve financiare për financimin e projekteve kapitale nuk është gjithmonë e lehtë. Ajo mund të varet nga një numër faktorësh si interesi mbi huanë, shuma e granteve për projekte kapitale, ndryshimet në paketën fiskale dhe nëse këto ndryshime janë të pranueshme për nga aftësia paguese e komunitetit etj.

Si rrjedhim fondet e veta nga taksat dhe tarifat janë një burim i rëndësishëm për Bashkinë dhe menaxhimi sa më me efikasitet i tyre është një domosdoshmëri. Për këtë qëllim krijimi, përditësimi dhe përdorimi i bazës së të dhënave nga departamenti i të ardhurave do të bënte të mundur rritjen e të ardhurave nga taksat vendore. Po ashtu procesi i faturimit dhe shtrirjes së pagesave në kohë do të ndihmonte për këtë qëllim.

Analiza e kapacitetit huamarrës dhe shërbimit të borxhit për investimet kapitale

Huaja duhet parë si një burim alternativ i financimit të shpenzimeve kapitale të parashikuara nga Bashkia.

Në bazë të ligjit nr. 9869, datë 4.2.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore” bashkia ka të drejtë të marrë hua për të financuar projektet e veta kapitale dhe në raste mungese likuiditeti.

Kjo formë financimi synon zgjerimin e autonomisë vendore nëpërmjet krijimit të hapësirës dhe rregullave të përshtatshme për të siguruar një proces transparent dhe në përputhje me politikat e zhvillimit rajonal në tërësi e atij vendor në veçanti. Në bazë të këtij ligji njësia vendore mund të marrë hua afatshkurtër për të përmbushur nevojën e përkohshme për likuiditete dhe hua afatgjatë për të financuar shpenzimet kapitale apo për të rfinansuar një hua afatgjatë ekzistuese.

Në përgjithësi njësitë vendore nuk kanë para të mjaftueshme për të financuar projektet kapitale, prandaj ato gjenden përpara një zgjedhje: të akumulojnë para deri sa të jenë në gjendje të paguajnë plotësisht për projektet kapitale, ose ato mund të marrin hua për të financuar një pjesë apo të gjithë projektin. Në parim, huaja sjell barazi midis brezave duke bërë që brezat që do përfitojnë nga projekti kapital të paguajnë për të. Si rregull, jetëgjatësia e huasë nuk duhet të shtrihet përtej jetës së dobishme të investimit kapital, duke lidhur kështu kostot me përfitimet. Kjo do të thotë: nëse jeta e dobishme e një projekti kapital është 20 vjet nuk mund të aplikohet për një hua përtej kësaj periudhe. Pagesat për shërbimin vjetor të huasë afatgjatë (shërbimi i borxhit) nuk mund të tejkalojnë 20% të mesatares aritmetike të të ardhurave gjithsej nga taksat e tarifave vendore, taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuar në tre vitet fiskale paraardhëse të vitit në të cilin parashikohet të merret huaja. Mirëpo, përveç këtij kufizimi ligji parashikon edhe dy kufizime të tjera: Raporti i tepricës operative të vitit fiskal paraardhës (të llogaritur si diferenca e të ardhurave operative, nga burimet e veta, taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuar me shpenzimet jo të kushtëzuara operative të njësisë së qeverisjes vendore) me shërbimin e borxhit, që duhet të paguhet çdo vit për borxhin afatgjatë, të jetë jo më pak se 1,4 : 1, dhe; Raporti i stokut të borxhit ndaj të ardhurave operative, gjithsej, nga burimet e veta, taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuar, të jetë jo më shumë se 1,3 : 1.

Analiza për transfertat e pakushtëzuara nga buxheti i shtetit

Transfertat e pakushtëzuara janë një tjetër burim kryesor i Bashkisë për sa i përket të ardhurave të veta. Të ardhurat nga kjo transfertë mund të përdoren për mbulimin e shpenzimeve operative ose kapitale. Këto të ardhura janë përfshirë në llogaritjen e tepricës neto operative që do të përdoret për financimin e shpenzimeve kapitale. Udhëzimi nr.7/1, datë 22.02.2010 “Për përgatitjen e buxhetit vendor” përcakton se sa do të jetë transfertat e pakushtëzuar për vitet 2011-2013 dhe konkretisht: transfertat e pakushtëzuar për vitin 2011, do të jetë 3 % më e madhe se transfertat e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit e vitit 2010, ajo e vitit 2012, 7% më lartë se ajo e vitit 2011 dhe transfertat e vitit 2013 do të jetë 9% më e lartë se ajo e vitit 2012. Ndërsa, në bazë të ligjit nr.

10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010” transfertat e pakushtëzuar për vitin 2010 është ulur në krahasim me atë të parashikuar në udhëzimin nr. 20/1, datë 26.02.2009.

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2012 për Bashkinë Korçë është në vlerën 171,421 mijë lekë. Për vitin 2012 ky fond krahasuar me vitin 2011 ka një rritje prej 4,134 mijë lekë ose 2.4% më shumë. Edhe për vitin 2012 në transfertën e pakushtëzuar janë përfshirë edhe fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit (punonjës dhe edukatorë) të konvikteve të arsimit parauniversitar. Në tabelën mëposhtme jepet e detajuar transfera e pakushtëzuar që nga viti 2006 deri në 2012.

Burimi i financimit	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Transferta e pakushtëzuar	111,490	124,657	166,785	186,488	171,127	167,287	171,421
Total	111,490	124,657	166,785	186,488	171,127	167,287	171,421

Analiza për fonde të mundshme kapitale nga grantet konkurruese

Për vitin 2010 parashikohet që skema e granteve konkurruese të shndërrohet në fondin e zhvillimit rajonal, që supozon që zhvillimi i njësive vendore të bëhet sipas konceptit të zhvillimit hapësinor. Në buxhetin e pushtetit vendor për vitin 2010 fondi i zhvillimit të rajoneve është një risi. Për të inkurajuar zhvillimin ekonomik është e nevojshme që politikat buxhetore kombëtare të harmonizohen me politikat buxhetore vendore. Në zbatim të ligjit nr. 10190 dt. 26.11.2009 "Për Buxhetin e vitit 2010" Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përdoret për financimin e projekteve të cilat ndodhen brenda territorit të njësive të qeverisjes vendore dhe zbatohen prej tyre.

Fondi për zhvillimin e rajoneve përbëhet nga:

- Granti konkurrues për infrastrukturën rrugore vendore
- Granti konkurrues për arsimin
- Granti konkurrues për shëndetësinë
- Granti konkurrues për objektet kulturore
- Granti konkurrues për ujësjellës kanalizime
- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimor dhe thertoresh
 - Granti konkurrues për ujitjen dhe kullimin
 - Granti konkurrues për pyllëzimin
- Granti konkurrues për objekte kulturore

Aplikimi për fonde bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, duke i dërguar projektet në:

- Ministrinë e Zhvillimit Urban për objektet e infrastrukturës vendore.
- Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për objektet arsimore dhe sportive.
- Ministrinë e Shëndetësisë për objektet shëndetësore.
- Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës për objektet e ujësjellës kanalizimeve.
- Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Ruraë dhe Asministrimit të Ujërave për objektet ndërtim tregjesh agro-ushqimorë, thertoresh dhe objekte për ujitje/kullim.

- Ministrinë e Kulturës për objektet kulturore.
- Ministria e Mjedisit për pyllëzime

Pëzgjedhja e projekteve kapitale bëhet në bazë të disa kritereve të paravendosura dhe pikëve përkatëse për çdo kriter, sipas udhëzimit nr.11 datë 1.4.2010 "Për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve".

Analiza për fonde nga donatorë

Donacionet janë mjete monetare pa kthim të cilat financojnë projekte kapitale të caktuara brenda vizionit të donatorit dhe nevojave të komunitetit. Për vitin 2010 Bashkia Korçë nuk ka fonde nga donatorët për mbulimin e investimeve kapitale. Projektet që financohen me fonde nga donatorë të ndryshëm, nuk kalojnë në buxhetin e Bashkisë dhe këto projekte administrohen nga vetë donatorët, pavarësisht faktit që këto investime merren në dorëzim nga Bashkia kur ato përfundojnë.

32.2. Analize e te ardhurave

Sipas të dhënave të Bashkisë, % me të madhe të te ardhurave Bashkia Korçë e ka nga taksat dhe tarifatat vendore, rreth 45 % , zeri i dytë në listë është nga transfertat e pakushtezuar, dhe me pas huamarrja vendore. Sipas analizës në tabelën e te ardhurave vendore taksat kryesore të cilat krijojnë dhe % me të madhe në buxhet janë

Taksa vendore e biznesit të vogël (e cila është një burim i rëndësishëm i te ardhurave. me uljen e tarifës që paguajnë bizneset, ajo ka pësuar një rënie, prandaj evidentimi i saktë i nr. të bizneseve dhe zh. ekonomik mund të bëjë të mundur rritjen e vlerës nga kjo taksa)

Tarifa e pastrimit (dhe kjo është një ardhur e rëndësishme për Bashkinë, dhe duhet planifikuar me mirë mbledhja e saj

Tatimi mbi ndertësitë (Bashkia nuk duhet të mbështetet në planin e një viti me parë, por duhet realisht të bëjë një verifikim sa më të saktë të të gjithë potencialit të mundshëm për të mbledhur)

Tatimi mbi ndertimet e reja (kjo ka qenë një taksa goxha dominante në vlerë, por duket qartë që pezullimi i lejeve të ndertimit e ka zvogëluar shumë vlerën në buxhet, me fillimin e lejeve kjo mund të rritet)

Tarife ndricimi dhe gjelberimi (dhe kjo duhet të jetë një taksa në rritje, dhe këtu vlen përsëri vlerësimi i saktë i potencialit për të mbledhur)

taksa e rregjistrimit të përvitshëm të automjetit (mbetet për të vlerësuar saktë potenciali i mundshëm i saj dhe pastaj mbi të të shikohet % e mbledhjes, së taksës. këto 6 taksa përbejnë rreth 82,6 % të të gjithë te ardhurave të Bashkisë, prandaj fokusi kryesor i Drejtorisë së mbledhjes së te ARdhurave duhet të jetë në saktësimin e potencialit të mundshëm, gjejtjen e problematikave për mbledhjen e tyre, dhe me pas forcimi i masave për të mbledhur ato.

Tarife për të stimuluar , Tarifa e perdorimit të tregut të lirë, Taksa e parkimit, Taksa e Tokës bujqësore Në pjesën e grantit të pakushtezuar, statistikën tregojnë se kjo vlerë ka ardhur duke u rritur sidomos në vitet e fundit. në lidhje me Shpenzimet e Bashkisë, është e rëndësishme të shihet që e njëjta shifër që Bashkia realizon nga te ardhurat e veta, është dhe shifra që mbulon shpenzimet operative. Kjo shifër

eshte relativisht e larte, rreth 46 % , dhe eshte nje shifer qe Bashkia duhet ta kete ne vemendje duke eleminuar kostot e tepërta.

32.3. Asetet

Çështje të pronësisë (pronat shtet) (Bashki+AKPT)

Bashkia duhet te procedoje me Rregjistrimin e ketyre pronave ne Zyrat Vendore te Pasurive. Duke qene se lista e asetëve eshte e gjate, e rendesishme per Bashkine eshte te planifikoje me lista pjesore sipas nje prioritizim, berjen e dokumentacionit gati per ta rregjistruar prane zyrave vendore. Ngritja e nje grupi pune eshte i domosdoshem per kete proces, per te pergatitur dokumentacionin. Problematike mbetet planifikimi i fondit per rregjistrim ne ZRPP, duke qene se ka nje kosto rregjistrimi, per kete ka mundesi te planifikohet vit pas viti ne buxhet, por dhe nje mareveshje me ZRPP vendore per te lehtesuar keto procedura duke qene asete shteterore eshte nje mundesi shume e mire, duke qene se keto zyra jane me vetefinancim.

Ne lidhje me Asetet nje ceshtje tjeter per tu zgjidhur eshte, ri- vleresimi i asetëve, ne baze te procedurave te vleresimit te pronave te paluajteshme, Bashkia duhet te marre masa per te rivleresuar pronat ne varesi te saj. Perseri mund te perdoren listat e pjeseshme dhe buxhetimi sipas prioriteteve, pasi ky proces ka koston e vet.

Ne lidhje me keto ceshtje kryesore per asetet vendore, ka dy perfitime te rendesishme Bashkia, se pari, rregjistrimi dhe rivleresimi i pronave, ben te mundur mos prekjekn e tyre nga cenime te ndryshme. Ato automatikisht shderrohen ne kapital per Bashkine per cdo lloj huamarrje etj. rregjistrimi i tyre dhe ri vleresimi rrit vleren kapitale te Bashkise.

Gjithashtu ato mund te te perdoren per ti dhene zgjidhje ceshtjeve te ndryshme te Bashkise si strehimi, zhvillim ekonomik, institucione aresimore te reja etj..pra pronesia mbi to rrit edhe mundesine e perdorimit te tyre.

Fondi i pronave bujqësore shtet paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Korcë			
Drenovë			
Lekas	Shtet	59.2	
Marjan	-		
Gjonbabas	Shtet	32.5	
Gurmujas	Shtet	53.3	
Shkozan	Shtet	559.7	
Xerje	Shtet	588.4	
Tudas	Shtet	566.0	
Gjergjevicë	-		
Lavdar	-		
Brozdovec	Shtet	28.7	0.77
Mazrek	Shtet	535.3	486.5
Poponivë	-		
Total		2423.1	487.27
Mollaj			
Bulgarec			
Vithkuq	-		
Leshnjë	Shtet	29.4	
Gjanç	-		
Lubonjë	-		
Rehovë	Shtet	959.2	
Roshanj	Shtet	985.5	
Trebickë	Shtet	51.9	


Grabockë	Shtet	30.6
Treskë	Shtet	839.9
Stratobërdh	-	

Lista e pronave

	Fusha e përdorimit të pronës
Administratë	13
Arsim	5
Bujqësi	4
Burime Natyrore	1
Energjitike	2
Infrastruktura dhe Shërbime	
Publike	13
Kulturë	4
Mbrojtje Kombëtare	2
Rendi Publik	2
Rezerva Shteti	1
Shëndetësi	3
Shërbime Sociale	6
Sigurimi I Kujdesit Shëndetsore	1
Sport	2
Strehim	2
Telekomunikacion	3
Vend - Strehime	1
Zhvillim Ekonomik	17

32.4. TREGU I PUNËS

Punesimi sipas sektoreve – Bashkia KORÇE



Tipologjia e te punesuarve – lidhja me “papunesine e regjistruar”



Statistikat e tregut të punës sigurojnë përshkrime të strukturës së tregut të punës bazuar në informacionin e të dhënave administrative dhe vlerësime të anketës së forcave të punës. Qëllimi kryesor i prodhimit të statistikave të tregut të punës është marrja e informacionit sa më të plotë mbi tregun e punës dhe dinamikën e tij, si dhe vënja e statistikave të duhura në dispozicion të politikë-bërësve për hartimin e politikave të tregut të punës.

Të dhënat për punësimin dhe papunësinë që publikohen nga INSTAT me periodicitet tremujor dhe vjetor bazohen në dy burime të veçanta:

1- Burimet administrative, të cilat sigurojnë të dhëna për: (a) numrin e të punësuarve në ndërmarrjet të cilat deklarohen tatimet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; (b) punësimin në sektorin shtetëror; (c) papunësinë e regjistruar.

2- Anketa e Forcave të Punës (AFP), e cila është një vërtetim statistikor që kryhet pranë familjeve dhe siguron informacion gjithëpërfshirës mbi situatën e tregut të punës në nivel kombëtar. Në vitet 2007 deri 2011 Anketa e Forcave të Punës është kryer çdo vit, ndërsa nga viti 2012 AFP është kryer si anketë e vazhduar.

Të dhënat administrative sipas qarqeve

Të dhënat administrative sipas qarqeve të përfshira në këtë kapitull, përfshijnë informacion mbi treguesit e tregut të punës bazuar në të dhënat administrative për punësimin dhe papunësinë në Shqipëri.

Të dhënat administrative mbi punësimin sipas qarqeve përmbajnë të dhëna mbi punësimin në sektorin privat jo- bujqësor, punësimin dhe pagat në sektorin shtetëror si dhe punësimin në administratën publike lokale.

Të dhënat administrative mbi papunësinë e regjistruar sipas qarqeve përmbajnë të dhëna mbi punëkërkuarit e papunë të regjistruar, me një detajim të veçantë të rinjve

15-24 vjeç, femrave dhe nivelit arsimor; punëkërkuarit e papunë të regjistruar afatgjatë dhe punëkërkuarit e papunë në pagesë papunësie.

Të dhënat administrative mbi ndihmën ekonomike sipas qarqeve përmbajnë të dhëna mbi numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe fondin mesatar mujor të shpërndarë për familjet në ndihmë ekonomike.

Për punësimin në sektorin shtetëror të dhënat bazohen në informacionin e grumbulluar nga INSTAT në përputhje me Programin e Statistikave Zyrtare 2012-2016. Punësimin në sektorin publik përbëhet nga qeveria qendrore, pushteti vendor dhe ndërmarrjet publike.

Për punësimin në sektorin privat jo-bujqësor burimi është informacioni i mbledhur nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, i cili i merr të dhënat nga Zyrat e Punësimit dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Për punësimin në sektorin privat bujqësor në Shqipëri nuk ka burim administrativ. Për këtë arsye burimi kryesor i përdorur për matjen e punësimit në këtë sektor janë anketat e kryera pranë familjeve. Nga viti 2007 e në vijim punësimi në sektorin e bujqësisë është vlerësuar nga Anketa e Forcave të Punës.

Të dhënat për papunësinë e regjistruar mbështeten në informacionin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Regjistrimi i të papunëve në zyrat e punësimit bëhet në bazë të VKM Nr. 70, datë 11.02.1999 "Për evidentimin e punëkërkuarve të papunë". Të dhënat për ndihmën ekonomike bazohen në informacionin e Shërbimit Social Shtetëror.

Të punësuar në administratën publike në rang qarku

Qarqet	2010		2011	2012
Shqipëria	165.100	164.400	163.900	163.885
Berat	8.409	8.413	8.347	8.295
Dibër	8.772	8.974	8.992	8.835
Durrës	12.995	12.473	11.754	11.700
Elbasan	14.035	13.783	13.703	13.599
Fier	13.658	14.561	13.636	13.596
Gjirokastrë	5.939	5.802	5.801	5.721
Korçë		9.773	9.823	9.682
Kukës	5.736	5.295	5.264	5.102
Lezhë	6.578	6.679	6.764	6.683
Shkodër	11.505	11.547	11.553	11.213
Tiranë	57.052	57.070	58.079	59.444
Vlorë	10.308	10.029	10.184	10.015

Burimi i informacionit: Të dhëna administrative

Të punësuar në sektorin privat jo-bujqësor në rang qarku

Qarqet	2010		2011		2012
Shqipëria	256.287	268.690	290.763	318.571	
Berat	6.853	7.827	8.275	8.828	
Dibër	3.578	3.634	3.293	4.190	
Durrës	31.414	33.680	36.825	38.000	
Elbasan	13.300	13.685	13.845	13.990	
Fier	16.002	16.150	16.424	17.671	
Gjirokastrë	6.315	3.500	4.030	4.936	
Korçë	12.422	12.790	12.650	12.685	
Kukës	2.095	1.968	2.076	2.040	
Lezhë	8.078	8.515	8.541	9.256	
Shkodër	13.727	13.665	13.764	13.882	
Tiranë	124.389	135.341	153.014	173.360	
Vlorë	17.924	17.928	18.024	19.732	

Burimi i informacionit:

Shërbimi

Kombëtar

i

Punësimi

Të punësuar në sektorin privat bujqësor në rang qarku

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	526.412	526.260	462.253	442.883	
Berat	41.202	40.424	42.022	33.957	30.670
Dibër	37.376	39.410	38.114	42.462	34.344
Durrës	27.776	25.017	17.540	11.847	32.820
Elbasan		78.609	81.568	83.971	89.489
Fier	92.609	80.191	84.588	81.194	77.373
Gjirokastrë	12.705	13.652	13.900	15.067	14.892
Korçë	63.446	58.164	61.435	46.664	39.838
Kukës	12.998	21.864	20.335	17.065	21.738
Lezhë		36.682	35.599	24.592	17.440
Shkodër		38.498	37.378	38.962	38.229
Tiranë		62.903	63.413	44.090	24.040
Vlorë	14.876	30.999	30.369	22.383	22.009

Burimi i informacionit: Vlerësime nga Anketa e Forcave të Punës 2010-2014

Të punësuar në administratën publike locale në rang qarku

Qarqet	2010	2011	2012	
Shqipëria	13 941	14 684	14 988	15 065
Berat	964	968	966	967
Dibër	704	678	682	688
Durrës	1.025	1.042	1.027	998
Elbasan	1.454	1.498	1.498	1.498
Fier	1.548	1.660	1.745	1.691
Gjirokastrë	709	709	717	679
Korçë				1.202
1.178	1.190	1.217	1.212	
Kukës	828	897	897	897
Lezhë	777	873	873	873
Shkodër	1 154	1 191	1 191	1 191
Tiranë	2 770	2 741	2 070	2 163
Vlorë	818	1.210	1.210	1.218

Burimi i

informacionit:

Të

dhëna

administrative

Numri i të punësuarve në nivel local për bashkinë Korçë

Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë	1 672
Bordi i Kullimit Korçë	34
Drejtoria e Bujqësisë Korçë	51
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë	25
Dega e Thesarit Korçë	10
Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë	22
Muzeu i Artit Mesjetar, Muzeu i Arsimit dhe Muzeu Arkeologjik Korçë	12
Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë	100
Drejtoria e Shërbimit Pyjor Korçë	33
Drejtoria rajonale e Mjedisit Korçë	6
Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Korçë	30
Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit Korçë	57
Prefekti i Qarkut Korçë	37
Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Korçë	114
Qendrat Shëndetësore të Rrethit Korçë	114
Spitali Rajonal Korçë	589
TOTAL	2 906

33. PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO (PBB)

Gjetjet kryesore

Në vitin 2012 PBB me çmime korrente ishte 1.335,5 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 1,6 % krahasuar me vitin 2011.

Sipas qarqeve vlera më e ulët në PBB paraqitet në qarkun e Kukësit me 27,9 miliardë lekë ose 2,1 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2011, PBB me çmime korrente për qarkun Kukës shënoi një rënie prej 4,3 %. Sipas qarqeve, pesha më e ulët ndaj totalit të PBB-së në rang vendi u shënuar në qarkun Kukës me 2,1 % dhe në qarkun Gjirokastrë me 2,2 %.

Ndërsa peshën më të madhe të PBB-së e shënoi qarku Tiranë me 38,2 % me një vlerë totale të PBB-së prej 510 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2011 PBB me çmime korrente në qarkun Tiranë shënoi një rritje prej 2,1 %.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur disa nga rezultatet më të rëndësishme të Llogarive Kombëtare Rajonale në Shqipëri.

Tab. 1 Treguesit kryesorë ekonomikë, viti 2012

Rritja ekonomike e PBB-së

Produkti i Brendshëm Bruto në vitin 2012, shënoi një rritje ekonomike reale në krahasim me vitin 2011 me 1,6 %.

PBB reale për vitin 2012 pati variacione në nivelet e rritjes sipas qarqeve. Niveli i rritjes në disa vite të veçanta dhe në disa qarqe të veçanta varet nga kontributi individual i secilit qark në totalin e PBB-së, nga struktura e degëve të ekonomisë, etj. Në tabelën numër 2 janë paraqitur ritmet e rritjes sipas qarqeve:

PBB për frymë

Në vitin 2012 niveli i PBB-së për frymë në rang vendi ishte rreth 460 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2011 PBB për frymë u rrit me 2,7 %.

Niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas qarqeve në vitin

2012 ishte Tirana me rreth 650 mijë lekë ose 41,1 % mbi mesataren e vendit dhe pati një rritje prej 0,8 % krahasuar me 2011. Më pas renditet qarku i Durrësit me rreth 481 mijë lekë ose 4,5 % mbi mesataren e vendit, me një rritje prej 0,7

% krahasuar me 2011. Më pas renditet qarku i Fierit me rreth

521 mijë lekë ose 13,1 % mbi mesataren, me një rritje prej

16,1 % krahasuar me 2011.

PBB për frymë për qarqet e tjera ishte nën mesataren e vendit ku më e ulta ishte ajo e qarkut të Dibrës me rreth

310 mijë lekë ose 32,7 % nën mesataren e vendit. Më tej, me

PBB-në për frymë më të ulët vijon qarku i Kukësit, me rreth

320 mijë lekë ose 30,5% nën mesataren e vendit. PBB-ja për frymë në qarkun Korçë, ishte rreth 322 mijë lekë, ose 30,1 % nën mesataren e vendit

Tab. 2 Rritja Reale e PBB-së

Fig.1 PBB për frymë sipas qarqeve krahasuar me mesataren e vendit

Tab. 5 Produkti i Brendshëm Bruto për frymë

Tab. 6 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto (VSHB) sipas degëve të ekonomisë dhe qarqeve, viti 2012*

D. Bujqesia dhe Blegtoaria

34. POZITA GJEOGRAFIKE, RELIEVI DHE KLIMA

Pozita Gjeografike (tiparet kryesore)

Rrethi i Korçës ndodhet në pjesën juglindore të Shqipërisë, midis gjerësisë gjeografike veriore $40^{\circ} 27'$ në Jugë të malit të Kaltajt (Trebickë) dhe $40^{\circ} 57'$, në veri të fshatit Kallamas (Liqeni i Prespës) si dhe ndërmjet gjatësive $20^{\circ} 19'$, mali i Korbejt (Zerec) dhe $20^{\circ} 54'$ (Cerje). Brenda kufijve administrativë rrethi i Korçës ka një sipërfaqe të përgjithshme 1752 km² duke zënë një nga vendet e para në Republikë me 6.1 për qind të territorit. Në këtë

territor shtrihet Bashkia e Korçës me _____km². Vendndodhja larg vijës bregdetare dhe aktivitetit të vrullshëm ekonomik që zhvillohet në të, balancohet deri në një farë mase nga afërsia me dy shtetet fqinje, Greqinë dhe Maqedoninë. Kjo bën që rajoni të konsiderohet dhe si portë hyrëse nga këto shtete.

Relievi (tiparet kryesore)

Relievi i një territori ndikon në një shkallë të madhe në zhvillimin ekonomik të tij. Relievi i zonës së Korçës karakterizohet nga një shumëllojshmëri tipash dhe formash. Në të gjenden të tre tipat e relievit: fushor, kodrinor dhe malor. Tipi mbizotërues është ai malor 59.7 për qind të territorit. Kjo duket jo vetëm nga lartësia mesatare mbi nivelin e detit (1145 m), por edhe mbizotërim i trajtave të relievit malor. Relievi fushor dhe kodrinor përbën përkatësisht 17.5 dhe 22.8 për qind të territorit . Shumëllojshmëria e relievit duket dhe nga format e ndryshme të tij, të cilat shfaqen në njësi të caktuara gjeomorfologjike. Njësitë më kryesore gjeomorfologjike janë: fushëgropa e Korçës ose siç quhet rëndom fusha e Korçës, malësia e Gorë - Oparit, Voskopojës, Vithkuqit, vargmalet Moravë (maja më e lartë 1808 m) dhe Mali i Thatë (maja më e lartë 2288 m).

Fushëgropa e Korçës është më e madhja, jo vetëm në serinë e gropave të vendit por edhe vetë Gadishullit Ballkanik. Ka një gjatësi veri-jugë 35 km dhe gjerësi lindje perëndim 16 km dhe një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 300 km² . Një pjesë e sipërfaqes së tokës së njësisive administrative të Bashkisë Korçë shtrihet në këtë fushë gropë (Drenovë, Voskop, Bulgarec). Në rajonin e Korçës është dhe Liqeni i Prespës.

Klima

Rrethi i Korçës bën pjesë në zonën e tretë klimatike të vendit: zona klimatike mesdhetare - para malore. Klima është e karakterit kontinental me dimër të ftohtë dhe me rritje të temperaturave në verë. Zona e Korçës dallohet për një origjinalitet klimatik, që shfaqet në një sërë treguesish sikurse mund të jenë minimumi dhe maksimumi absolut i temperaturave, temperaturat mesatare shumëvjeçare etj. Vlerat më të larta të temperaturave mesatare mujore janë në muajin Gusht për stacionin e Korçës dhe Voskopojës përkatësisht 20.1⁰C dhe 18.1⁰C . Vlerat më të ulëta të temperaturave mesatare shënohen në muajin Janar: Korçë 0.5⁰C, Sheqeras 0.0⁰C, Vithkuq 0.4⁰C.

Vlerat maksimale pozitive e temperaturës kanë qenë: Korçë 38.5⁰C, Voskopojë 34⁰C, Sheqeras 37⁰C dhe Vithkuq 33.4⁰C. Vlerat maksimale të temperaturave negative kanë qenë: Korçë ,

- 20.9⁰C,, Voskopojë, - 25.6⁰C, Sheqeras, -26.8⁰C dhe Vithkuq, -18.4⁰C. Temperaturat mesatare vjetore kanë qenë: Korçë, 10.4⁰C, Voskopojë 7.6⁰C, Sheqeras 7.5⁰C dhe Vithkuq 8.1⁰C. Fushëgropa e Korçës ka minimumin absolut të rreshjeve në shkallë vendi. Sasia mesatare e rreshjeve ka qenë: Korçë 635.1 mm. Voskopoja, 1009 mm., dhe Vithkuqi

1147.6 mm. Me ndryshimet globale të klimës këto kanë pësuar ndryshime rreth këtyre vlerave.

35. BUJQËSIA NË PERIUDHA HISTORIKE

Bujqësia e hershme

Kërkimet arkeologjike në vend kanë treguar se takimin e parë me bujqësinë parahistorike ato e kanë pasur në vitin 1948 në Maliq, në fushën e Korçës, kur punohej për bonifikimin e kënetës së Maliqit. Gjatë gërmimeve me dragë, në dhenë e hedhur u gjendën sende të lashta si copa enësh prej balte të pjekur, vegla pune prej briri, prerëse prej stralli. Ky material arkeologjik sipas arkeologëve ishte me një interes të madh shkencor për vendin tonë. Zbulimet çuan në gjurmët e një vendbanimi parahistorik dhe që ishte i pari i këtij lloji në vendin tonë. Studimet e më vonshme treguan se afër qytezës së Maliqit ishte i pranishëm një fshat parahistorik mjaft i madh ku jeta kishte vazhduar pa ndërprerje përreth 4000 vjet. Të tillë fshatra bile më të hershëm u zbuluan për gjatë brigjeve të lumit Dunavec. Me këto zbulime për arkeologët u bë e qartë se fusha e Korçës ka qenë e banuar dendur dhe pandërprere që në fillim të epokës së re të gurit-neolitit, mijëvjeçari i gjashtë para erës sonë, nga një popullsi qëndruese e cila kishte filluar të merrej që në atë kohë me bujqësi dhe blegtori. Zbulimet në fushën e Korçës treguan se bujqësia në vendin tonë filloi që në epokën e neolitit dhe kultura materiale që u zhvillua në vendbanimet neolitike ka qenë kryesisht bujqësore. Njerëzit në vend që të mblidhnin ushqim andej- këndeje, filluan të mbillnin qëllimisht fara të ndryshme bimore kryesisht drithra si dhe të mbanin kafshë shtëpiake. Kjo mund të konsiderohet si lindje e bujqësisë. Sipas Dr. Moikom Zeqo, zbulimi i kulturës parahistorike në Fushën e Korçës, që një ngjarje e madhe shkencore, jo vetëm për vendin tonë por edhe në shkallë evropiane. Në periudhën neolitike tokat e mbjella ndërroheshin shpesh. Kjo deri sa u mësua rrolli i plehut të kafshëve. Nga kafshët njerëzit merrnin plehun dhe forcën tërheqëse. Tokat e punuara jepnin dhe ushqim për kafshët e zbutura si lopë, dhen, dera, etj. Veglat që u përdorë në një periudhë të caktuar ishin shata, rrëmihës dhe çatalla prej druri, briri dhe guri etj. Kjo ishte “bujqësia me shatë”. Më vonë u përdor drapëri (prej guri), parmenda etj.

Në periudhën e bronzit u përdorën mjete pune metalike si sëpatat, drapërinjtë, rrëmihës prej bakri dhe bronxi. Kjo bëri të mundur edhe shkëlqimin e pemëve, prerjen e tyre për të zgjeruar sipërfaqen e tokës. Ky sistem i bujqësisë u quajt i “prerje - djegies”. Bimët që mbilleshin në këtë kohë ishin grurë, thekër, elb, urov, fasule etj.

Në periudhën e hekurit u përmirësuan ndjeshëm veglat e punës si parmenda me majë (plor) hekuri, kazma, sëpata, kosat, kosoret etj. Kjo u quajt “bujqësia me lërim”. Zgjerimi i tokës së mbjellë, punimi më i mirë, plehërimi organik, solli shtimin e prodhimit bile edhe furnizimin me grurë p.sh të Athinës. Zhvillimi i bujqësisë në trevën e Korçës u ngadalësua

gjatë luftrave me romakët si dhe pushtimi romak që vazhdoi për më se dy shekuj deri në shekullin e Parë para erës sonë. Për zhvillimin e bujqësisë në shekullin e tretë dhe IV të erës sonë flet zbulimi në Mokër, ku disa nga veglat e punës ngjajnë me ato që janë përdorur edhe në kohën tonë. Për një stad më të zhvilluar të bujqësisë në shekullin e V dhe VI tregojnë veglat prej hekuri të gjetura në gërmimet në fshatin Symiz si kmesa, çelikanë, lejlekë (ky i fundit është përdoret dhe në kohën tonë dhe është karakteristik për rajonin e Korçës), kazma, lopata, etj. Këto flasin se bujqit përveç bimëve të arave kultivonin edhe vreshta dhe pemë të ndryshme frutore. Gjatë fillimit të mesjetës zhvillimi i bujqësisë u karakterizua nga një gjendje amullie që lidhet me sistemin feudal dhe luftrat e vazhdueshme. Megjithatë gjatë mesjetës dhe deri në fillim të shekullit të XX bujqësia ishte mjeshhtëria dhe veprimtaria kryesore e pjesës dërmuese të popullsisë në trevën e Korçës që merreshin me kultivimin e bimëve të arave, pemëtari, vreshtari dhe blegtori. Sipas regjistrave të periudhës osmane të shekullit XV në zonën Përmet- Korçë kishte vreshta të tatueshme në masën 25 për qind të 350 fshatrave. Kjo tregon vreshtat janë kultivuar në sipërfaqe të mëdha. Në këtë periudhë bagëtitë e imta janë rritur në numër të konsiderueshëm.

Bujqësia para çlirimit të vendit (një vështrim i shpejtë)

Lufta kundër pushtuesve otomanë në fillim të shekullit të XX, si dhe lufta ballkanike më vonë i kushtoi mjaft ekonomisë së rajonit dhe sidomos bujqësisë. Sipas vendimeve të Kongresit të Lushnjës nënprefekturën e Korçës u ngritën qendrat e para të bujqësisë me synim që të ndihmohej ky sektor. Një numër studentësh u dërguan jashtë vendit për tu përgatitur si specialistë bujqësie. Megjithëse ekonomia e rajonit të Korçës deri në luftën e dytë botërore ka pasur karakter të theksuar bujqësor, niveli i zhvillimit dhe prodhimi ka qenë shumë i ulët. Në vitin 1927 në prefekturën e Korçës prodhoheshin 4187 tonë grurë, 3832 tonë misër, 192 tonë fasule, 30 tonë patate, 322 tonë rrush etj. Faktorët për një prodhim bujqësor të krahasueshëm me vendet e tjera të Europës, mungonin në mënyrë dramatike. Në të gjithë prefekturën e Korçës punonin 3 specialistë me arsim të lartë: një agronom, një zooteknik dhe një veteriner. Po kaq dhe specialistë me arsim të mesëm. Këta specialistë duhet të shërbenin për 141 fshatra që kishte prefektura e Korçës. Rrethi i Korçës (së bashku me Bilishtin) kishte 23867 ha tokë të punueshme nga e cila 22200 ha tokë arë, pemishte 200 ha dhe vreshta 1467 ha. Mungonin pothuajse tërësisht sistemet e kullimit dhe të ujitjes. Një pjesë e fushës së Korçës përmytej sistematikisht nga lumenjtë Devoll dhe Dunavec. Këneta e Maliqit plotësonte këtë peizazh. Prodhimi bujqësor dhe blegtoral bazohej në punën e krahut dhe të kafshëve. Mjetet më të përdorura ishin plugu dhe parmenda që tërhiqeshin me kafshë. Qetë e punës (7916 krerë) përbënin fuqinë kryesore tërheqëse për punimin e tokës dhe transport kryesisht me qerre. Ata përbënin 44-45 për qind të numrit të gjedhëve, çka nënkupton se gjedhi mbarështohej kryesisht për fuqi tërheqëse. Numri i përgjithshëm i gomerëve prej 2198 krerë ose 36 për qind ndaj totalit të

njëhundraçës tregon në një farë mase dhe prapambetjen e bujqësisë. Sipas të dhënave traktori i parë në Korçë është sjellë në vitin 1923. Në vitin 1925 në rajon u sollën makineritë e para bujqësore nga firma angleze "Ruston". Plehrat kimike u përdorën për herë të parë në vitin 1930. Struktura e mbjelljeve shprehte këtë nivel zhvillimi. Drithërat e bukës (17500 ha) përbënin 80 për qind të sipërfaqes së mbjellë, patate 85 ha, perime pa bostan, 162 ha. duhan 65 ha. Pjesa tjetër mbillej me tagjira etj. Produktiviteti i tokës ishte i ulët. Kështu prodhohej për çdo ha 11.5 kv. drithëra, 11.1 kv. grurë, 12.7 kv. misër, duhan 6.2 kv. Megjithëse të dhënat janë të kufizuara, në këtë periudhë edhe pemëtaria dhe vreshtaria ishin zhvilluar dobët. Numëroheshin rreth 100 mijë rrënjë pemë frutore kryesisht mollë. U bënë përpjekjet e para për mbjelljen e disa blloqeve si në Korçë, Zvirinë etj. Në vitin 1938 prodhoheshin rreth 7700 ton fruta me një produktivitet për rrënjë prej 11.1 kg. Në këtë kohë ishin 1467 ha vreshta (nga 4100 ha në shkallë vendi) nga të cilët 1300 ha në prodhim. Me një rendiment prej 35 kv/ha prodhoheshin 4614 tonë (nga 18650 tonë në shkallë vendi). Në vitin 1937 në rajonin e Korçës mbarështoheshin 18918 krerë gjedhë nga të cilët 5831 lopë, të leshta 43772 krerë, të dhirta 26301 krerë dhe derra 444 krerë. Produktiviteti për krerë ishte relativisht i ulët. Për çdo krerë lopë prodhohej 500 kg. qumësht, për çdo dele 38 kg dhe për çdo dhi 55 kg.. Në shkallë rrethi prodhohej 7662 tonë qumësht (1938). Në fshat mbizotëronin marrëdhëniet feudale, që ishin në të njëjtën kohë dhe pengesë për zhvillimin e bujqësisë. Hapat e para për zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste në bujqësi në rajonin e Korçës shfaqen në formën e përpjekjeve për të krijuar shoqëri dhe sipërmarrje kapitaliste bujqësore. Në vitin 1925 u krijua shoqëria aksionere "Maliqi". Në vitin 1927, pronarët e mëdhenj të tokave themeluan një shoqëri bujqësore për zhvillimin e pronave të tyre. Në vitin 1939 u krijua një tjetër organizatë bujqësore me pjesëmarrjen e çifligarëve, fshatarëve të pasur dhe disa të mesëm për të mbrojtur interesat e tyre. Gjatë kësaj periudhe u bënë përpjekje për kryerjen e dy reformave agrare përkatësisht nga qeveria e Fan S. Nolit dhe mbreti Zog por që nuk shkuan deri në fund.

Bujqësia mbas çlirimit të vendit deri në vitin 1990 (një vë shtrim i shpejtë)

Kjo periudhë mund të karakterizohet si periudha e ndryshimeve dramatike në jetën shoqërore dhe ekonomike të rajonit ashtu si në të gjithë vendin. Reforma agrare, kolektivizimi i bujqësisë dhe futja e bujqësisë në kuadrin e zhvillimit socialist, mund të konsiderohen ngjarjet më të mëdha mbas çlirimit, në fushën e bujqësisë. Ato përcaktuan trendet kryesore të zhvillimit ekonomik të fshatit dhe fatet e tij për më se 45 vjet.

2.3.1 Reforma e Tretë Agrare ose Reforma Radikale

U zhvillua në vitet 1945-1946. Konsiderohet rajoni ku reforma u zhvillua me shpejtësi. Ajo konsiderohet e përfunduar në 15 shtator të vitit 1946, një muaj e gjysmë para afatit. Në rrethin e Korçës u matën gjithsej 25327 ha tokë dhe u shpërndanë 25277 ha tokë, familjeve pa tokë ose me pak tokë, ndërsa 50 ha u lanë në dispozicion të zyrës së reformës agrare.

U ndanë gjithashtu 910 qe pune, 147 buaj, 820 kuaj, 182 plugje. Për blegtorinë u ndoq rruga e shtetëzimit dhe krijimi i ndërmarrjeve shtetërore blegtorale. Në rrethin e Korçës shtetëzuan 11636 krerë të imta dhe 93 krerë gjedhë. Me këto krerë u themelua Ndërmarrja Blegtorale Shtetërore Maliq.

Reforma e IV Agrare ose Kolektivizimi i Bujqësisë

Kolektivizimi i bujqësisë në tërësi u zhvillua me një herë mbas reformës agrare dhe u zhvillua në

tre faza dhe zgjati përreth 20 vjet. Ecuria e kolektivizimit në rrethin e Korçës tregohet në

Vitet	Numri i kooperativave	Familje të kooperuar	Sipërfaqja në ha e kolektivizuar
1947	8	240 (3 %)	1512 (4 %)
1955	74	4120 (28 %)	13826 (31 %)
1958	186	11647 (85 %)	32893 (83%)
1960	141	12436(92.3%)	36371 (87%)

tabelën 1.

Tabela 1. Ecuria e kolektivizimit në rrethin e Korçës.

Numri më i madh i kooperativave u arrit në vitin 1958. Mbas këtij viti filloi bashkimi i kooperativave prandaj dhe numri i tyre u pakësua. Më pas disa kooperativa të bashkuara u kaluan në një formë më të lartë të pronësisë KTL (Kooperativa të Tipit të Lartë), ku edhe shteti merrte pjesë me investime të pakthyeshme. Më vonë KTL Plasë kaloi në NB shtetërore.

Faktorët dhe zhvillimi i bujqësisë deri në vitin 1990

Në prodhimin bujqësor ka një sërë faktorësh materialë që ndikojnë krahas me faktorët natyrorë të cilët në këtë sektor ndikojnë fuqishëm në raport me sektorët e tjerë të ekonomisë. Po analizojmë shkurtimisht disa prej tyre.

Njerëzit faktor i rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë

Në vendet në zhvillim është karakteristikë prania e në përqindje të lartë të popullsisë që banon dhe punon në fshat. Në vendin tonë përqindja e popullsisë me banim në fshat ka qenë shumë e lartë, dhe e pa krahasueshme me asnjë vend evropian. Edhe në rrethin e Korçës vihej re i njëjti fenomen. (Tabela 2)

Vitet	Popullsia gjithsej (nr.)	Nga kjo:		
		Qytet	Fshat	Në %
1938	117400	23674	93726	79.8
1970	168900	53400	115500	68.4
1990	218219	75100	143110	65.6

Tabela 2. Popullsia në rrethin e Korçës në disa vite.

Sikurse shihet në fshat ka jetuar 65.6 deri 79.8 për qind e popullsisë së rrethit. Kjo reflektonte zhvillimin ekonomik relativisht të ulët ekonomik të vendit, shtesë natyrale më të lartë të popullsisë në fshat si dhe ndalimi i lëvizjes së lirë nga fshati në qytet. Numri i lartë i popullsisë në fshat shoqërohej nga një numër i lartë i kraheve të punës në bujqësi. Kështu në kooperativat bujqësore numri i kraheve të punës ka qenë si më poshtë. (Tabela 3)

Vitet	Krahë pune në kooperativat (nr.)	Kanë punuar (nr.)
1966	36284	34080
1990	43845	40202

Tabela 3. Krahet e punës në kooperativat bujqësore.

Arsimimit të moshave të reja në fshat iu kushtua një vëmendje e veçantë. Në vitin 1985 në fshat funksiononin 12 shkolla të mesme të gjitha profesionale, që ndiqeshin nga 2688 nxënës të rregullt, pa përfshirë shkollat e natës.

Gjatë kësaj periudhe bujqësia u fuqizua ndjeshëm me specialistë me arsim të lartë dhe të mesëm të profilit bujqësor. (Tabela 4)

Emërtimi	1966	1970	1985
Gjithsej:	90	136	794
- Agronomë	62	95	422
- Veterinerë	15	20	109
- Zooteknikë	13	19	105
- Ekonomistë agrarë	-	2	158

Tabela 4. Specialistë me arsim të lartë të profilit bujqësor.

Në vitin 1990 vetëm në kooperativa dhe ndërmarrjet bujqësore punonin 992 specialistë me arsim të lartë dhe 1136 me arsim të mesëm. Në fillim të viteve 1970 në Korçë filloi aktivitetin Instituti i Lartë Bujqësor.

2.3.3.2 Faktorët materialë të prodhimit bujqësor.

- Ujitja dhe kullimi

Në fillim të viteve 1990, Dr. Gunter Jaehne, nga Universiteti Giessen, Gjermani, që do të shkruante një material për tranzicionin e bujqësisë për një OCEDE, shkroi midis të tjerash se Shqipëria pa ujitje do të ngjante me Afrikën. Në sistemin ujitës u bënë investime të rëndësishme me synim shtimin e aftësisë ujitëse. Deri në vitin 1990 u ndërtuan dhe u vunë në përdorim 70 rezervuarë të madhësive të ndryshme dhe u ndërtuan 14 stacione pompimi. Kjo solli rritjen e aftësisë ujitëse. (Tabela 5)

Vitet	Aftësia ujitëse (ha)	Në % ndaj tokës arë gjithsej
1938	2300	10.4
1960	8000	17.5
1990	35429	62.6

Tabela 5. Aftësia ujitëse në rrethin e Korçës.

Në periudha të ndryshme janë përdorur mënyra të ndryshme të ujitjes si me përmytje, me brazda dhe në fund me sisteme në formë shiu.

- Mekanizimi

Mekanizimi i bujqësisë është konsideruar faktor i rëndësishëm i prodhimit bujqësor dhe është parë në raport me përdorimin e krahëve të punës. E gjithë mekanika ishte organizuar në SMT (Stacioni i Makinave dhe Traktorëve) që iu shërbenin kooperativave bujqësore. Ndërmarrjet Bujqësore pronë e shtetit kishin mekanikën e vet. SMT-ja në Korçë u krijua në vitin 1947 dhe kishte 13 traktorë fizikë së bashku me agregatët kryesorë dhe 23 makina shirëse. Në vitet në vazhdim parqet e makinave dhe traktorëve u fuqizuan. (Tabela 6)

Emërtimi	1960	1980	1990
1.Traktorë 15k.f	350.2	1277.0	1493.0
-SMT	271.9	910.6	962.5
2. Volumi i punës(000/ha.u)	152.0	947.3	1086.4
-SMT	114.0	621.8	630.6

Tabela 6. Mekanizimi i bujqësisë.

Pjesa më e madhe e punimeve kryheshin me mjete mekanike dhe një pjesë me kafshë dhe krahë pune. (Tabela 7)

	Ndërmarrjet Bujqësore	Kooperativat Bujqësore

Emërtimi	(%)	(%)
1. Lëvrime gjithsej	100.0	100.0
-Mekanikë	82.9	74.9
-Kafshë	10.0	11.5
-Krahë pune	7.1	14.6
2. Mbjellje gjithsej	100.0	100.0
-Mekanikë	76.6	66.8
-Kafshë	10.4	19.3
-Krahë pune	13.0	13.9
3. Prashitje, kultivime	100.0	100.0
-Mekanikë	23.7	14.3
-Kafshë	16.4	21.0
-Krahë pune	59.9	64.7

Tabela 7. Niveli i mekanizimit në proceset kryesore.

Prashitjet që përfaqësojnë dhe një volum të madh pune realizoheshin kryesisht me krahë pune. Në vitin 1990 në rrethin e Korçës ishin 54 autokombajna. Mekanika e rëndë ishte pronë e shtetit, dhe për punët që kryenin në kooperativat bujqësore paguheshin sipas tarifave të miratuara nga qeveria. Kooperativat mund të blinin pajisje të thjeshta dhe makina transporti. Në vitin 1990 ato dispononin makina mbjellëse të lashta që tërhiqeshin me kafshë 275, mbjellëse misri 13, makina shirëse 14 etj.

-Përdorimi i plehrave kimike

Plehrat kimike për bujqësinë tonë kanë qenë elementi më novator për rritjen e prodhimit. Megjithatë përdorimi i tyre ka filluar vonë, ndërtimi i dy uzinave në vend për prodhimin e plehrave azotike dhe fosforike rriti në mënyrë të ndjeshme përdorimin e tyre. (Tabela 8)

Emërtimi	Përdorimi i plehrave kimike (tonë)
Plehra gjithsej:	31620.6
-Ure	6951.0
-Nitrat amoni	8261.5
-Fosfatike	15107.7
-Potasike	1300.4

Tabela 8. Përdorimi i plehrave kimike në vitin 1990.

Në vitin 1990 për çdo ha tokë arë janë në kooperativat bujqësore janë përdorur 561 kg plehra kimike, nga 37.3 kg në vitin 1965.

2.3.4 Toka bujqësore si faktor bazë i zhvillimit të bujqësisë

Toka konsiderohet si një faktor natyror por edhe njerëzor i prodhimit bujqësor. Si rezultat i tharjes së kënetës së Maliqit dhe çeljes së tokave të reja në kodra dhe male fondi i tokës së punuar është rritur me ritme të shpejtë. (Tabela 9)

Viti	Tokë gjithsej e punuar (ha)	-Arë	-Pemishte	-Vreshta
1938	23867	22200	200	1467
1970	56820	53236	2257	1327
1990	63115	56560	5163	1392

Tabela 9. Fondi i tokës së punuar në disa vite.

Nga çelja e tokave të reja (që në shumë raste ishin të pa argumentuara ekonomikisht) u dëmtuan sipërfaqe të tëra me pyje dhe shkurre si dhe mijëra ha me kullota natyrore.

Bimët e arave

Kushtet klimaterike dhe tokësore të rrethit të Korçës si dhe kërkesat e ekonomisë së vendit në kushtet e izolimit, kanë përcaktuar prodhimin dhe strukturën e bimëve të arave.

a. Struktura e mbjelljeve

Emërtimi	1938	1980	1990
1.Drithra buke	17500	24914	22903
-Grurë	10508	21067	19587
-Misër	6100	2564	1218
2.Patate	85	4540	2059
3.Duhan	65	3127	2452
4.Panxhar sheqeri	-	7684	5553
5.Elë distik	-	3326	2862
6.Perime gjithsej	162	1013	1034
7.Fasule	-	890	2643
8.Tagjira,foragjere	3388	10220	15370

Tabela 9. Struktura e mbjelljeve në bimët e arave.

Sikurse shihet drithërat e bukës kanë zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes së tokës. Po ashtu vend të rëndësishëm kanë zënë bimët industriale si panxhar, duhan dhe elë distik.

b. Rendimentet e realizuara

Si rezultat i përmirësimit të teknikave dhe teknologjive të kultivimit të bimëve të arave produktivitetit për ha është rritur. (Tabela 10)

(kv/ha)

Emërtimi	1960	1970	1985	1990
1.Drithra buke	8.0	17.9	30.9	31.6
-Grurë	9.2	18.1	34.1	35.2
-Misër	6.9	20.6	19.7	15.9
2.Patate	111.8	87.8	65.8	92.2
3.Duhan	4.1	7.3	7.2	5.8
4.Panxhar sheqeri	126.2	236.4	273.1	255.6
5.Elë distik	12.8	16.4	11.5	14.6
6.Perime gjithsej	125.1	134.3	170.2	181.8

Tabela 10. Rendimentet në bimët e arave.

Rendimenti më i lartë si rreth në gjithë vitet është arritur në vitin 1990, 35.2 kv/ha. Në zonën fushore në vitin 1989 u realizua 54 kv/ha. Në panxhar rendimenti më i lartë është realizuar në vitin 1983, 417.9 kv/ha, në patate në vitin 1983, 128.8 kv/ha.

b/1 Rendimentet e disa bimëve në kooperativat që tani janë pjesë e Bashkisë Korçë

Për të siguruar vazhdimësinë e analizës që do të bëhet për komunat që janë pjesë e Bashkisë Korçë, menduam të trajtojmë rezultatet e arritura në rendimentet për bimët kryesore. **Në të gjitha rastet duhet të merren orientuese sepse nuk janë tërësisht të krahasueshme.**(Tabela 11)

-Grurë

Kooperativat	1980 (kv/ha)	1985 (kv/ha)	1990 (kv/ha)
1.Dishnicë (Komuna Bulgarec)	38.3	49.6	52.9
2.Lumalas (Komuna Bulgarec)	32.4	35.8	58.0
3.Vinçan (Komuna Voskop)	-	-	23.7
4.Drenovë (Komuna Drenovë)	30.0	35.9	37.2
5.Kamenicë (Komuna Drenovë)	23.9	27.5	28.0
6.Polenë (Komuna Voskop)	25.5	27.4	26.5
7.Voskopojë(Komuna Voskop)	9.7	9.8	13.6

Voskopojë)			
8.Vithkuq (Komuna Vithkuq)	13.4	18.1	18.0
9.Trebickë (Komuna Vithkuq)	22.8	23.3	17.5
10.Panarit (Komuna Vithkuq)	13.3	12.4	13.7
11. Lubonjë (Komuna Vithkuq)	-	-	16.0
12. Brozdovec (Komuna Lekas)	17.0	19.6	15.4
13. Lekas (Komuna Lekas)	11.3	13.6	15.1

Tabela 11. Rendimentet në kooperativat që tani janë pjesë e Bashkisë Korçë.

Duhet të theksohet se në vite të veçanta janë realizuar rendimente më të larta.

-Patate

(kv/ha)

Kooperativat	1980	1985	1990
1.Dishnicë (Komuna Bulgarec)	59.5	32.6	37.5
2.Lumalas (Komuna Bulgarec)	59.7	21.7	29.4
3.Vinçan (Komuna Voskop)	-	-	11.0
4.Drenovë (Komuna Drenovë)	46.1	14.9	12.5
5.Kamenicë (Komuna Drenovë)	34.6	8.8	-
6.Polenë (Komuna Voskop)	33.0	46.6	31.0
7.Voskopojë(Komuna Voskopojë)	14.6	19.3	28.0
8.Vithkuq (Komuna Vithkuq)	47.7	12.2	42.0
9.Trebickë (Komuna Vithkuq)	45.7	42.4	32.2
10.Panarit (Komuna Vithkuq)	19.0	5.0	7.0
11. Lubonjë (Komuna Vithkuq)	-	-	14.2
12. Brozdovec (Komuna Lekas)	40.0	24.0	15.0
13. Lekas (Koomuna Lekas)	8.2	7.6	-

Tabela 11. Rendimentet në patate në kooperativat që tani janë pjesë e Bashkisë Korçë.

Duhet të theksohet se në vite të veçanta janë realizuar rendimente më të larta.

-Panxhar sheqeri

Panxhari sheqerit është mbjellë kryesisht në ekonomitë e zonës fushore (Tabela 12)

Kooperativat	1980	1985	1990
1.Dishnicë (Komuna Bulgarec)	240.8	224.6	207.4
2.Lumalas (Komuna	354.7	347.0	368.5

Bulgarec)			
3.Vinçan (Komuna Voskop)	-	-	231.0
4.Drenovë (Komuna Drenovë)	184.1	10.5	145.0
5.Kamenicë (Komuna Drenovë)	200.0	139.0	170.0
6.Polenë (Komuna Voskop)	244.0	167.8	206.0

Tabela 12. Rendimentet në panxhar sheqeri në kooperativat që tani janë pjesë e Bashkisë Korçë.

Duhet të theksohet se në vite të veçanta janë realizuar rendimente më të larta.

-Duhan

Prodhimi i duhanit ishte përqendruar kryesisht në ekonomitë e zonën e fushës, duke i rezervuar kryesisht toka më pak pjellore. (Tabela 13) (kv/ha)

Kooperativat	1980	1985	1990
1.Dishnicë (Komuna Bulgarec)	6.1	10.5	6.7
2.Lumalas (Komuna Bulgarec)	4.6	8.1	4.0
3.Vinçan (Komuna Voskop)	-	-	2.8
4.Drenovë (Komuna Drenovë)	5.9	5.0	1.5
5.Kamenicë (Komuna Drenovë)	3.9	5.2	1.6
6.Polenë (Komuna Voskop)	5.3	6.7	3.0

Tabela 13. Rendimentet në duhan në kooperativat që tani janë pjesë e Bashkisë Korçë.

c.Prodhimet në bimët e arave

Prodhimi i bimëve të arave është funksion i të gjithë faktorëve të prodhimit: tokë, punë, kapital, dhe menaxhim.

-Drithra buke

Prodhimi i drithërave të bukës është konsideruar detyrë prioritare nga pikëpamja ekonomike por sidomos politike, duke e konsideruar si element të sigurimit të pavarësisë së vendit. Prodhimi i tyre ka pasur tendencë në rritje. (Tabela 14) (Tonë)

Emërtimi	1960	1970	1980	1990
1.Drithra buke	19777	47242	67673	72654
-Grurë	12065	32127	60370	69199
-Misër	6278	13221	6269	1940
2.Patate	12042	38833	32466	18983

3.Duhan	53	1033	1514	1423
4.Panxhar sheqeri	72461	116540	232659	141925
5.Elë distik	1108	4325	2773	4168
6.Perime gjithsej	6709	12515	17176	13822
7. Fasule gjithsej	985	1380	781	1393

Tabela 14. Prodhimet e bimëve të arave.

Prodhimi më i madh është realizuar: drithëra buke 80484 tonë në vitin 1976, grurë 69683 tonë në vitin 1988, patate 48016 në vitin 1976, duhan 2841 tonë në vitin 1986, panxhar sheqeri 292693 tonë në vitin 1983.

-Prodhimet e bimëve të arave në kooperativat pjesë e Bashkisë Korçë

Edhe në këtë rast do të ishte me interes në analizën e zhvillimit të bujqësisë, mbas vitit 1990, në njësitë që janë pjesë e Bashkisë Korçë. (Tabela 15)

-Drithëra buke, grurë

Kooperativat	Drithëra buke (Tonë)			Grurë (Tonë)	
	1983	1985	1990	1983	1985
1990					
1.Dishnicë (Bulgarec) 3996	3628	3964	4005	3569	3855
2.Lumalas (Bulgarec) 3714	4097	4371	3714	4110	4334
3.Vinçan (Voskop) 1236	-	-	1255	-	-
4.Drenovë (Drenovë) 3817	3222	3679	3907	3402	3589
5.Kamenicë(Drenovë) 1595	1540	1644	1630	1165	1566
6.Polenë (Voskop) 2692	2369	2687	2714	2364	2572
7.Voskopojë 408	548				
388	394		230		394
8. Vithkuq (Vithkuq) 589	1246	1164	632	719	1050
9.Trebickë (Vithkuq) 288	472	417	308	267	343

10.Panarit (Vithkuq) 123	178	163	131	93	125
11.Lubonjë (Vithkuq) 498	-	-	501	-	-
12.Lekas (Lekas) 468	536	450	524	320	422
13. Brozdovec (Lekas) 200	348	293	208	212	274

Tabela 15. Prodhimi i drithërave të bukës dhe grurit në kooperativat pjesë e Bashkisë Korçë.

Kooperativat e zonës fushore kanë mbajtur peshën kryesore në prodhimin e drithërave të bukës dhe të grurit, por sasi të konsiderueshme janë prodhuar dhe zonën malore. Prodhimin më të madh në drithëra buke kooperativat e kanë realizuar në vitet të ndryshëm, si: Dishnicë 4684 tonë në vitin 1976, Lumalas 4463 tonë në vitin 1979, Drenovë 4907 në vitin 1976, Polenë 3458 tonë në vitin 1976, Kamenicë 1998 tonë në vitin 1976, etj.

-Patate, perme

Rrethi i Korçës ka qenë rajoni më kryesor në prodhimin e patates.

(Tabela 16)

Kooperativat	Patate (Tonë)			Perime (Tonë)		
	1983	1985	1990	1983	1985	
1990						
1.Dishnicë (Bulgarec) 271	1313	408	75	730	395	
2.Lumalas (Bulgarec) 156	2029	517	29	508	477	
3.Vinçan (Voskop)	-	-	26	-	-	97
4.Drenovë (Drenovë) 109	1598	224	10	270	209	
5.Kamenicë(Drenovë) 73	555	83	-	88	102	
6.Polenë (Voskop) 183	1245	712	28	357	331	
7.Voskopojë 2		750	211	17		4 9
8. Vithkuq (Vithkuq)	345	49	42	68	59	2
9.Trebickë (Vithkuq)	62	21	13	10	8	5

10.Panarit (Vithkuq)	8	2	2	5	4	-
11.Lubonjë (Vithkuq)	-	-	6	-	-	8
12.Lekas (Lekas)	124	5	-	29	20	9
13. Brozdovec (Lekas)	32	7			9 14	9
-						

Tabela 16. Prodhimi i patateve dhe perimeve në kooperativat pjesë e Bashkisë Korçë.

Prodhim më i madh i patateve është realizuar në kryesisht në vitin 1976. Kështu, Dishnicë 1858 tonë, Lumalas 2420 tonë, Drenovë 2168 tonë. Ndërsa në vitin 1979, Polenë 1559 tonë, Kamenicë 763 tonë, Voskopojë 1317 tonë dhe Vithkuq 710 tonë. Ulja e prodhimit në vitin 1990 shpjegohet me faktin se kooperativave iu la në kompetencë të përcaktonin vetë prodhimin dhe se në këtë kohë anëtarëve iu dha e drejta e oborrit kooperativist ku për nevojat e tyre i prodhonin në këtë tokë. Edhe në perime prodhim më i lartë është realizuar në vitin 1979 ku: Dishnicë 1170 tonë, Lumalas 894 tonë, Drenovë 793 tonë, Polenë 664 tonë.

- Panxhar sheqeri dhe duhan

Kooperativat	Panxhar sheqeri (Tonë)			Duhan (Tonë)	
	1983	1985	1990	1983	1985
1990					
1.Dishnicë (Bulgarec) 240	22300 119	13698	10622	210	
2.Lumalas (Bulgarec) 17	28520	22046	16355	151	146
3.Vinçan (Voskop) 23	-	-	2442	-	-
4.Drenovë (Drenovë) 15	11620	4020	3042	112	88
5.Kamenicë(Drenovë) 14	6407	6127	3320	84	68
6.Polenë (Voskop) 41	12542	2579	6856	150	134

Tabela 16. Prodhimi i panxharit dhe duhani në kooperativat pjesë e Bashkisë Korçë.

Prodhimi i panxharit ishte lokalizuar kryesisht në rrethin e Korçës.

Pemëtaria dhe vreshtaria

Pemëtaria ka qenë një nga aktivitetet e rëndësishme të ekonomive bujqësore të rajonit të Korçës duke zënë vend të rëndësishëm në prodhimin e vendit.

-Sipërfaqet e mbjella.

Sipërfaqet e mbjella janë rritur vit pas viti. (Tabela 17)

Vitet	Pemëtore (ha)	Vreshta (ha)
1938	200	1467
1960	1487	1363
1965	1853	1340
1970	2257	1327
1975	4077	1300
1980	4910	1453
1985	5166	1390
1990	5163	1392

Tabela 17. Sipërfaqet me pemëtore dhe vreshta.

Pemëtoret dhe vreshtat zakonisht mbilleshin në toka më pak produktive për bimët e arave. Sipërfaqet me pemëtari dhe vreshtari në vitin 1990 në kooperativat bujqësore pjesë e Bashkisë Korçë ishte sikurse tregohet në tabelën 18.

Ekonomitë	Pemëtore (Ha)	Vreshta (Ha)
1.Dishnicë	90	53
2.Lumalas	54	69
3.Vinçan	84	119
4.Drenovë	157	43
5.Polenë	103	115
6.Kamenicë	82	16
7.Voskopojë	75	-
8.Vithkuq	46	-
9.Lubonjë	21	-
10.Trebickë	22	5
11.Panarit	29	2
12.Lekas	104	6
13.Brozdovec	67	7

Tabela 18. Sipërfaqet me pemë dhe vreshta.

Pemëtaria ka qenë aktivitet i rëndësishëm edhe në ekonomitë malore.

-Rrënjët e pemëve frutore

Numri gjithsej i drurëve frutorë tregohet në tabelën 19.

Viti	Rrënjë (000)
1947	123

1960	776
1970	814
1985	968
1990	876

Tabela 19. Drurë frutorë gjithsej.

Peshën kryesore në drurët frutorë e përbënin mollët dhe kumbullat.

Drurët frutorë sipas kooperativave pjesë e Bashkisë Korçë në vitin 1990 ka qenë sikurse tregohet në tabelën 20.

Kooperativat	Pemë gjithsej (rrënjë)	-Në prodhim	Kooperativat	Pemë gjithsej (rrënjë)	-Në prodhim
1.Dishnicë	15062	9544	8.Vithkuq	7723	5554
2.Lumalas	14807	9588	9.Lubonjë	2305	2133
3.Vinçan	21186	14482	10.Trebickë	5924	3509
4.Drenovë	16149	16149	12.Panarit	2775	245
5.Polenë	19167	6575	13.Lekas	8572	5560
6.Kamenicë	18527	8965	14.Brozdovec	10000	9091
7.Voskopojë	8018	4718			

Tabela 20. Drurët frutorë gjithsej dhe në prodhim.

-Prodhimi i frutave.

Prodhimi i frutave është rritur nga viti në vit. (Tabela 21)

Vitet	Prodhim fruta (tonë)
1960	2888
1965	5120
1970	12492
1983	25495
1990	11010

Tabela 21. Prodhimi i frutave.

Rrethi i Korçës ka qenë furnizuesi kryesor i vendit me fruta sidomos me mollë. Në prodhimin gjithsej në vitin 1990 prodhimi mollës përbënte 48.7 % dhe i kumbullave 29.4 %.

Prodhimi i rrushit gjithsej

Prodhimi i rrushit tregohet në tabelën 22.

Vitet	Prodhim gjithsej (Tonë)	-Nga pjergullat
1938	4614	----
1965	2998	288

1970	2265	273
1980	1775	186
1984	4367	2058
1985	3887	1812
1990	3134	1964

Tabela 22. Prodhimi i rrushit.

Blegtoria

Kushtet klimaterike dhe tokësore kanë ndikuar që popullsia e rajonit të Korçës të merrej me blegtori që në kohët më të hershme. Para çlirimit, pothuajse të gjitha fshatrat kanë mbarështuar blegtorinë në një numër relativisht të madh. Mbas çlirimit të vendit, në kuadrin e përgjithshëm të bujqësisë, edhe blegtorisë iu kushtua vëmendje dhe kujdes i veçantë, duke e kthyer në një degë të rëndësishme të ekonomisë bujqësore, që ka zënë mbi një të tretën në prodhimin e përgjithshëm të saj.

2.3.6.1 Zhvillimi numerik i blegtorisë

Mbas çlirimit të vendit dhe njëherazi me kolektivizimin e bujqësisë dhe krijimit të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, ndryshuan ekuilibrat shekullorë në rritjen e llojeve të ndryshme të kafshëve për prodhim. Ajo që konstatohet lehtë është shtimi me ritme më të shpejta i numrit të gjedhit në përgjithësi dhe i lopës në veçanti, në krahasim me bagëtitë e imëta (23).

(Mijëra

krerë)

Vitet	Gjedhë gjithsej	-Lopë	Të leshta	Të dhirta	Derra	-Dosa	Shpendë	Bletë zgjoj	Një thundrakë
1950	30.4	9.0	102.8	35.4	---	0.3	39.6	5.6	13.3
1960	38.3	14.5	103.9	56.6	16.2	2.3	121.4	5.5	15.5
1970	31.2	12.1	83.4	36.5	13.0	2.9	184.4	5.3	13.8
1980	53.6	20.4	103.2	40.8	20.5	2.0	192.1	7.2	13.6
1987	54.1	20.0	134.7	50.0	13.5	1.3	304.1	7.8	17.4

1990	49.4	22.4	144.3	57.9	9.8	0.9	286.1	7.4	19.7
------	------	------	-------	------	-----	-----	-------	-----	------

Tabela 23. Numri i krerëve të blegtorisë.

Edhe në rastin e blegtorisë paraqet interes numri i tyre në ekonomitë që janë pjesë e Bashkisë Korçë. (Tabela 24)

(Krerë)

Ekonomitë	1970	1975	1980	1981	1982	1985	1987	1990
1.Dishnicë	908	874	979	1736	1734	2106	2367	1412
2.Lumalas	1129	1342	1358	2181	2091	2461	3115	1841
3.Drenovë	742	947	987	1381	2245	1665	1900	732
4.Polenë	595	700	799	1109	1133	1237	1423	803
5.Kamenicë	262	369	423	712	758	757	918	502
6.Voskopojë	244	245	255	267	243	198	183	134
7.Vithkuq	499	487	566	569	553	499	453	366
8.Trebickë	117	69	84	90	97	95	139	91
9.Panarit	70	77	50	55	63	67	77	47
10.Brozdovec	144	158	154	129	121	100	112	67
11.Lekas	289	225	323	293	255	260	266	198

Tabela 24. Numri i krerëve në gjedhë sipas ekonomive pjesë e Bashkisë Korçë.

Numri i lopëve

(Krerë)

(Tabela 25)

Ekonomitë	1970	1980	1987	1990
1.Dishnicë	309	314	950	525
2.Lumalas	329	432	1126	318
3.Drenovë	231	302	810	330
4.Polenë	156	159	540	222
5.Kamenicë	67	118	369	184
6.Voskopojë	49	62	64	51
7.Vithkuq	98	95	146	112
8.Trebickë	20	4	18	12
9.Panarit	12	-	6	1
10.Brozdovec	25	14	16	-
11.Lekas	44	40	59	56

Tabela 25. Numri i krerëve në lopë në ekonomitë pjesë e Bashkisë Korçë.

Pakësimi i numrit të krerëve në lopë për ekonomitë ka ardhur dhe sepse një pjesë e tyre iu shpërndanë anëtarëve të kooperativës, sipas politikave të kohës.

-Të leshta (Krerë) (Tabela 26)

Ekonomitë	1970	1980	1987	1990
1.Dishnicë	1470	1823	4418	2243
2.Lumalas	1645	1610	3515	1658
3.Drenovë	2180	2461	4509	3923
4.Polenë	1826	1959	4985	2150
5.Kamenicë	1042	1798	3682	2406
6.Voskopojë	1344	1680	4171	3628
7.Vithkuq	3444	4028	7567	6720
8.Trebickë	1114	1580	2911	2036
9.Panarit	313	906	3055	2440
10.Brozdovec	1749	2965	4582	3981
11.Lekas	1464	2274	3944	6394

Tabela 26. Numri i të leshtave sipas ekonomive pjesë e Bashkisë Korçë.

-Të dhirta (Krerë) (Tabela 27)

Ekonomitë	1970	1980	1987	1990
1.Dishnicë	-	186	-	-
2.Lumalas	30	235	1312	797
3.Drenovë	-	3	900	30
4.Polenë	-	-	364	-
5.Kamenicë	-	255	1475	522
6.Voskopojë	17	348	567	360
7.Vithkuq	674	755	2391	1651
8.Trebickë	300	455	1241	1461
9.Panarit	-	-	332	351
10.Brozdovec	153	502	792	616
11.Lekas	218	406	1624	1267

Tabela 27. Numri i të dhirtave sipas ekonomive pjesë e Bashkisë Korçë.

-Derra (Krerë) (Tabela 28)

Ekonomitë	1970	1980	1987	1990
1.Dishnicë	152	1348	1527	518

2.Lumalas	187	-	-	65
3.Drenovë	140	679	386	229
4.Polenë	79	338	415	74
5.Kamenicë	74	-	-	-
6.Voskopojë	11	-	-	-
7.Vithkuq	124	-	-	-

Tabela 28. Numri i derrave sipas ekonomive pjesë e Bashkisë Korçë.

Prodhimet blegtorale

Edhe prodhimet blegtorale kanë pësuar rritje nga viti në vit me synim plotësimin më të mirë të nevojave. (Tabela 29)

(Tonë, vezët 000 /kokrra)

Emërtimi	1938	1960	1965	1970	1975	1980	1985	1987	1990
Qumësht	7662	15833	16511	18113	28593	35501	29878	31979	45576
Mish	2820	3564	3483	4063	5817	6455	6438	6222	7798
Lesh	----	----	197	221	254	238	292	305	313
Vezë	3861	5368	5004	6651	11493	10571	19390	25635	22899

Tabela 29. Prodhimet blegtorale në shkallë rrethi.

-Produktiviteti për krerë

Produktiviteti për krerë është rritur gjithashtu nga viti në vit. (Tabela 30)

Emërtimi	1938	1970	1980	1985	1990
Qumësht lope kg/kr.	500	1092	1561	1392	1907
Qumësht dele kg/kr.	38	32.7	33.5	35.7	37.2
Qumësht dhie kg/kr.	55	57.7	61.7	86.7	74.1

Tabela 30. Produktiviteti për krerë në shkallë rrethi.

Prodhimet kryesore blegtorale në ekonomitë që janë pjesë e Bashkisë Korçë do të krijojnë mundësi për ti analizuar ato në vitet pas vitit 1990.

-Qumësht gjithsej

(Tonë) (Tabela 31)

Ekonomitë	1971	1980	1985	1987	1990
1.Dishnicë	369	742	1190	1534	1400
2.Lumalas	697	1164	1795	1679	1654
3.Drenovë	381	567	853	1010	664
4.Polenë	141	357	805	782	655
5.Kamenicë	76	249	436	549	386
6.Voskopojë	59	106	198	176	153
7.Vithkuq	190	220	489	491	632

8.Trebickë	41	43	105	130	143
9.Panarit	8	13	78	67	75
10.Brozdovec	53	111	187	155	195
11.Lekas	59	106	310	360	482

Tabela 31. Prodhimi i qumështit në ekonomitë pjesë e Bashkisë Korçë.

-Prodhim mish

(Tabela 32) (Tonë)

Ekonomitë	1971	1980	1985	1987	1990
1.Dishnicë	66	107	194	150	145
2.Lumalas	97	80	179	146	149
3.Drenovë	75	102	145	246	114
4.Polenë	31	58	103	143	107
5.Kamenicë	18	35	75	82	59
6.Voskopojë	24	31	59	43	43
7.Vithkuq	50	53	91	85	146
8.Trebickë	16	20	32	41	48
9.Panarit	2	10	19	30	58
10.Brozdovec	21	47	62	49	74
11.Lekas	21	35	77	82	131

Tabela 32. Prodhimi i mishit në ekonomitë pjesë e Bashkisë Korçë.

Zhvillimi i bujqësisë në periudhën e tranzicionit në zonën rurale të Bashkisë Korçë.

Mbas vitit 1990, si rezultat i ndryshimeve politike dhe shoqërore, bujqësia pësoi një ndryshim të dukshëm si në pronësi, strukturën e prodhimit si dhe në gjerësinë dhe thellësinë e përdorimit të faktorëve të prodhimit.

Në fillim të viteve 1990 me një shpejtësi të madhe u krye reforma e pestë agrare ose dekollektivizimi i bujqësisë Sipas kësaj reforme toka e kooperativave iu shpërnda fshatarëve, toka e NB iu dha fillimisht në përdorim punëtorëve të tyre dhe më vonë në pronësi, u shpërndanë SMT, u riorganizuan Drejtoritë e Ujrave, Bazat e Furnizimit Materialo Teknik të bujqësisë, etj. Mbas të gjitha këtyre fotografia e bujqësisë ndryshoi. Me realizimin e Reformës Territoriale në vitin 2015, rrethi i Korçës është ndarë në dy njësi territoriale të mëdha: Bashkia e Korçës dhe Bashkia e Maliqit.

Në Bashkinë e Korçës janë përfshirë ish komunat: Bulgarec, Drenovë, Voskop, Voskopojë, Vithkuq dhe Lekas. Objekt i përshkrimit dhe analizës së zhvillimit të bujqësisë në periudhën mbas vitit 1990 do të jenë këto njësi administrative.

Popullsia, numri i familjeve dhe fshatrat

(Tabela 32) (viti 2015)

Emërtimi	Sasia
1. Familje gjithsej (nr)	10687
2. Popullsia (nr)	43491
3. Madhësia mesatare e familjes (nr)	4
4. Fshatra (nr)	58

Tabela 32. Popullsia në zonën rurale.

Popullsia më e madhe është përqendruar në njësitë fushore: Bulgarec, Voskop, Drenovë, Mollaj dhe më pak në ato malore.

2.4.2 Fondi i tokës së punuar (bujqësore)

Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas zërave për vitin 2015 tregohet në tabelën 33.

Emërtimi	Ha	Në %
1. Tokë bujqësore gjithsej e mbjellë:	11979	100
Nga kjo:		
-Arë	10524	87.8
-Pemtore	1093	9.2
-Vreshta	362	3.0

Tabela 33. Fondi i tokës bujqësore.

Sikurse shihet në njësitë e administrative sipërfaqja e tokës arë përbën rreth 88 për qind të tokës bujqësore, gjithsej dhe vetëm 12 për qind përbëhet nga pemëtari dhe vreshta. Kjo do të përcaktojë dhe strukturën e prodhimit bujqësor. Në qoftë se do të shohim tokën e ndarë sipas Ligjit 7501, rezulton se ajo është në një sipërfaqe prej **14811 ha**. Kështu që midis kësaj sipërfaqe dhe asaj të mbjellë në vitin 2015 rezulton një diferencë prej **2832 ha**, nga të cilat **544 ha** janë livadhe, ndërtime **23 ha**. Pjesa tjetër prej rreth **1815 ha ose 12.2 për qind** kundrejt sipërfaqes totale konsiderohet djerr. **Kjo është sipërfaqe e konsiderueshme.**

Zona rurale e Bashkisë Korçë për sa i takon tokës bujqësore shtrihet në tre relievet: fushë, kodër mal ose në pjerrësi të ndryshme. Tabela 34.

Eërtimi	Ha	Në %
1. Tokë gjithsej	18811	100

Nga kjo:		
Pjerrësi deri 5 %	9909	66.9
Pjerrësi 6-45 %	2760	18.6
Pjerrësi Mbi 46 %	2142	14.5

Tabela 34. Sipërfaqja e tokës sipas pjerrësisë.

Sipërfaqe e konsiderueshme rreth 67 për qind e tokës shtrihet në pjerrësinë deri 5 për qind, që konsiderohet fushë, rreth 19 për qind shtrihet në pjerrësinë 6-45 për qind që konsiderohet kodër dhe pjesa tjetër në pjerrësi mbi 45 për qind, që konsiderohet mal. ***Kjo influencon në mekanizim, ujitje, strukturën e mbjelljeve, prodhimtarinë etj.***

Aftësi ujitëse

Mbas vitit 1990 është faktori i prodhimit që pësoi dëmtimin më të madh. U dëmtuan deri në shkatërrim stacionet e pompimit, kanalet kryesorë ujitës, rezervuarë etj. Në këtë zonë deri në vitin 1990 funksiononin 21 rezervuarë me aftësi ujitëse 7461 ha, kryesisht me gravitacion. Me ndonjë përjashtim të rrallë p.sh Gjançi me aftësi ujitëse mbi 6000 ha të tjerët në pjesën më të madhe janë jashtë funksionit ose me funksion të kufizuar. Por edhe rrjeti ujitës kryesor i Gjançit u dëmtua pothuajse plotësisht në të dy krahët e fushës së Korçës (pjesa jugore). Sipas një studimi të kryer për riabilitimin e rrjetit ujitës të këtij rezervuari duhen 1-2 milion \$ investime. Për të parë se si ka ndryshuar aftësia ujitëse dhe ajo e vaditur mjafton të përmendim që tani aftësia ujitëse potenciale është **10935 ha**, ajo aktuale **9151 ha** ndërsa sipërfaqja e ujitur **7421 ha**. ***Mungesa e aftësisë ujitëse dhe mandej përdorimi i ujit për vaditje konsiderohet faktor kufizues në prodhimin bujqësor.***

Mekanika bujqësore dhe mekanizimi

Mos funksionimi i SMT-së solli që mjetet e mekanikës bujqësore të zotërohen nga individët. Nga mezi i viteve 1990 u bënë përpjekje sidomos në rrethin e Korçës që të krijoheshin njësi të mekanizimit pronë e disa fermerëve sipas modelit francez (KYMA). Por nuk patën rezultat. Në vitin 2015 ishin në inventar **159** traktorë me rrota, **176** mini traktorë, **21** autokombajna. Mundet që minimalisht për çdo ha të sigurohet 2-4 kf. motorike. Kur flitet për mekanizimin duhet të mbahet parasysh se fshat aktualisht banon dhe punon një numër relativisht i madh i njerëzve të aftë për punë, si dhe relievi i vendit. Shkalla e mekanizimit duke pasur parasysh punimet tregohet në tabelën 35.

<i>Emërtimi</i>	<i>Në %</i>
1. Gjithsej punime	100.0
-Me mekanikë	75.0
-Kafshë	13.2
-Krahë pune	11.8

Tabela 35. Mënyrat e punimeve.

Duhet thënë se pjesa dërmuese e prashitjeve, vjeljes së prodhimeve, që kërkojnë volume të mëdha pune kryhen kryesisht me dorë. Në këto drejtime mund të shtohet mekanizimi.

Përdorimi i plehrave

Përdorimi i plehrave kimike është faktor i rëndësishëm për shtimin e prodhimit në bimët bujqësore. Përdorimi i plehrave kimike për disa vite tregohet në tabelën 36.

Emërtimi	Përdorur plehra kimik (tonë)	Kg/ha, tokë e mbjellë me bimë e arave
Plehra gjithsej	2577	244.8
-Dap	1148	109.0
-Nitrat	825	78.4
-Ure	604	61.0

Tabela 36. Përdorimi i plehrave në vitin 2015.

Për çdo ha tokë të mbjellë janë përdorur rreth 245 kg/ha plehra kimike për çdo ha tokë të mbjellë. Kjo sasi duhet të konsiderohet e ulët, po të kemi parasysh që në vitin 1990 është përdorur mesatarisht për ish kooperativat bujqësore 561 kg/ha. Mungesa e përdorimit të plehrave në sasi më të mëdha është i lidhur me gjendjen financiare të fermerëve, mbasi plehurat kërkojnë shpenzime të larta.

Struktura e sipërfaqeve të mbjella me bimët e arave

Sipërfaqet e mbjella me bimët e arave, sipas bimëve kanë ndryshuar në krahasim me periudhën para vitit 1990. Kjo shpjegohet para së gjithash me kërkesat e tregut, plotësimi i nevojave për ushqimin e familjes fermere, mundësitë materiale dhe njerëzore për kultivimin e tyre etj. (Tabela 37)

Bimët	1985	2005	2013	2014	2015
1. Drithra buke	7109	4424	4506	4188	4304
-Grurë	6179	2851	3247	2953	3119
2. Patate	922	400	573	572	605
3. Fasule gjithsej	291	248	237	251	255
4. Perime, bostan	160	417	718	702	748
5. Duhan	914	27	11	7	20
6. Panxhar sheq.	2171	(452)	(275)	(307)	(308)
7. E lb distik	804	-	-	-	-
8. Bimë medicinale	-	-	17	14	11

9.Të tjera	131				
10.Foragjere,tagjira	4103	4990	4700	4690	4584
Gjithsej	16605	10506	10762	10424	10527

Tabela 37. Struktura e mbjelljeve në bimët e arave.

Sikurse shihet në krahasim me 1985, ka shumë tokë të pambjellë. Është shtuar sipërfaqja e mbjellë me foragjere dhe tagjira të para, është pakësuar në minimum deri në zhdukje e duhanit, po ashtu panxhar sheqeri mbillet vetëm për blegtorinë. Në vitet e tranzicionit është rritur gjithashtu sipërfaqja e mbjellë me perime. Ka një përshtatje më të mirë me tregun. S

Prodhimet në bimët e arave

Kufizimi i sipërfaqeve për bimët kryesore, mbjellja në tokat më të mira ka rezultuar me rritjen e rendimenteve në bimët bazë. Kjo është reflektuar në prodhimet e realizuar. (Tabela 38)

Emërtimi	2005 (tonë)	2013 tonë)	2014(tonë)	2015 (tonë)
1.Drith buke	16028	17390	16135	18066
-Grurë	11055	12481	11611	13519
2.Patate	8109	15804	15990	16867
3.Fasule	472	462	525	532
4.Perime,bostan	9407	18583	19318	20145
5.Duhan	27	13	10	47

Tabela 38. Prodhimet në bimët kryesore të arave.

Në përgjithësi prodhimi në bimët e ndryshme në vitet e fundit në tërësi është i stabilizuar me një rritje të lehtë në perime, patate. Në krahasim me vitin 2005 ka rritje të ndjeshme në patate dhe perime. Megjithatë në krahasim me vitin 1985 në vitin 2015 janë prodhuar më pak drithra buke **1174 tonë, patate 5172 tonë,dhe duhan 629 tonë.**

Pemëtaria dhe vreshtaria

Është aktivitet prodhues i shtrirë në të gjithë zonën rurale të Bashkisë Korçë. Në pemëtari konstatohet se në krahasim me vitet para 1990, është përmirësuar ndjeshëm teknologjia sidomos në format e krasitjes duke preferuar ato të ulëta për të lehtësuar shërbimet dhe vjeljen, është rritur po ashtu ndjeshëm numri i pemëve për ha. etj. Në vitin 2015 janë të mbjella me pemë frutore 1093 ha ose 9.2 për qind e sipërfaqes së tokës së mbjellë dhe 362 ha me vreshta ose 3 për qind të sipërfaqes së mbjellë.

Numri i pemëve dhe prodhimi

Numri i pemëve dhe prodhimi në disa vite tregohet në tabelën 39.

Emërtimi	2013	2014	2015

1.Pemë gjithsej (000/rr.	613.7	767	788.6
-Në prodhim	572	610.1	617
-Prodhimi (tonë)	20851	24521	28220

Tabela 39. Prodhimi i frutave.

Sikurse shihet prodhimi i frutave është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Në krahasim me vitin 1985 në shkallë rrethi, që është një nga vitet më të mirë, janë prodhuar afërsisht 3000 tonë më shumë fruta vetëm në këto ekonomi. Nga prodhimi gjithsej molla përbën 86 për qind, kumbullat 8.1 për qind dhe qershitë rreth 10 për qind. **Për të ardhmen kujdes duhet të përmirësohet struktura varietore e mollës duke synuar eksportin.**

Vreshtaria

Duhet thënë se në Bashkinë e Korçës, bën pjesë ndoshta zona më e favorshme mikroklimatike dhe tokësore për prodhimin e rrushit. Fjala është për zonën nga Polena në Melçan. Në këtë zonë krijohen mundësitë për një përmbajtje të lartë të sheqerit në kokërr. Prodhimi i rrushit tregohet në tabelën 40.

Emërtimi	2005	2013	2014	2015
1. Vreshta gjithsej (ha)	326	360	362	362
2. Prodhim rrush gjithsej (ton)	1071	1473	1656	1665
-Nga pjergullat	446	920	935	1034

Tabela 40. Prodhimi i rrushit.

Në vitin 2015 në krahasim me vitin 2005 prodhimi i rrushit është rritur mbi 55 për qind. Komuna Voskop dhe Mollaj kanë pasur peshën kryesore të prodhimit.

Zhvillimi i blegtorisë

Blegtoria me të gjithë llojet e saj, është zhvilluar në zonën rurale të Bashkisë Korçë. Kuptohet që zonën malore zhvillim më të madh kanë pasur blegtoria e imët.

Zhvillimi numerik

Numri i krerëve në njësitë vendore të zonës rurale tregohet në tabelën 41.(Krerë)

Emërtimi	1995	2014	2015
1.Gjedhë gjithsej	12762	7788	8303
-Lopë	8343	6139	6401
2.Të leshta	37923	71527	67734
-Dele	29206	55873	54818
3.Të dhirta	19669	14087	14164
-Dhi	15334	110621	10363
4.Derra	1735	2495	2924

-Dosa	27	339	212
5.Shpendë	29014	62487	78553
6.Bletë	----	9698	11552
7.Njëhundrakë	----	2909	3606
-Kuj	----	1361	1941

Tabela 41. Numri i krerëve.

Me përjashtim të gjedhit të dhirtave, numri i krerëve është rritur gjatë viteve të tranzicionit. Edhe në krahasim me vitin 1987 tani mbarështohen më të lehta dhe të dhirta. Duhet thënë se në këtë numër krerësh nuk janë përfshirë krerët e pularive (për shpendët) si dhe të banorëve të Korçës ish punonjës të NB Korçës. Në 2015 këta punonjës të ish NB-së, kishin 203 gjedhë, 180 lopë, 708 të lehta, etj.

Prodhimet blegtorale

Prodhimet blegtorale tregohen në tabelën 42. (tonë)

Emërtimi	1995	2011	2015
1. Qumësht gjithsej	22065	19910	21439
-Lope	18884	16571	17028
-Dele	1581	2362	3076
-Dhie	1600	707	1362
2. Mish gjithsej	2010	3448	3077
-Gjedhi	1133	1423	1193
-Të imtash	665	1507	1469
-Derri	192	439	196
-Shpendësh	20	79	219
3. Vezë (000/kokrra)	3457	6987	5746

Tabela 41. Prodhimet blegtorale.

Sasia e qumështit ka një rënie të lehtë ndërsa prodhimi i mishit dhe vezëve është rritur.

36. PROBLEME PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË NË BASHKINË E KORÇËS

Kalimi nga një bujqësi që zhvillohej sipas ligjeve të socializmit, në një ekonomi të tregut të lirë e gjeti bujkun tonë dhe pse jo dhe specialistët e bujqësisë të pa përgatitur. Të mësuar me ekonominë e centralizuar për më se 45 vjet, ku bujku ishte vetëm ai që punonte ndërsa vendimet merreshin nga të tjerët, kalimi në ekonominë ku vendimet do të merren nga individit për të drejtuar prodhimin, ishte sikur të gdhiehej në një planet tjetër. Edhe pse ishte vendosur prona private mbi tokën, ku vendimet për prodhimin duheshin të merreshin nga

individit, kërkohet që problemet t'i zgjidhte shteti. U desh kohë që njerëzit të formonin një mentalitet të ri, megjithëse i vjetri ekziston ende. Mënyra e ndarjes së tokës, e mjeteve të tjera të prodhimit, ekzistenca e një infrastrukture të prapambetur, një sistem marketingu i pa organizuar, mungesa e burimeve financiare etj. kanë sjellë probleme të vazhdueshme në zhvillimin e bujqësisë. Ne do të përmendim disa prej tyre. Problemi themelor që ka bujqësia është ai strukturor. Struktura e bujqësisë apo fermës është çështje e përhershme e zhvillimit të bujqësisë, si sektor i rëndësishëm për gjithë ekonominë e vendit. Ato mund të jenë nxitëse ose pengesë për zhvillimin e bujqësisë. Aktualisht tani ato konsiderohen pengesë e rëndësishme sidomos në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të këtij sektori. Por bujqësia ndeshet dhe me probleme të tjera. Zhvillimi ekonomik i vendit ndikon në zgjidhjen optimale të tyre.

Pronësia mbi tokën

Përgjithësisht është shkaktuar nga mënyra e ndarjes së tokës- **për frymë të popullsisë**. Megjithëse jemi i vetmi vend në Evropën Lindore që e zbatuam, ajo u gjykua si mënyra më e pranueshme përmendin tonë. Aktualisht ndeshen dy probleme:

- a. *Trajtimi i pronarëve historikë të tokës*
- b. *Legalizimi i pronësisë mbi tokën.*

Duhet thënë se në rrethin e Korçës janë më të zbutur se në rrethet e tjera. Janë probleme që lidhen me njëri tjetrin. Problemi i parë nuk është i lehtë. Zgjidhja duke abroguar Ligjin 7501, nuk është e racionalë për të mos thënë e mundur. Kthimi fizik i pronës është alternativë por jo me shumë mundësi. Kompensimi është alternativa që krijon mundësi por është e kushtueshme dhe kërkon kohë. Problemi i legalizimit (i dokumentacionit) është më i mprehtë në disa zona të Bashkisë Korçë, **sidomos në Mollaj, Dërsnik dhe Voskopojë**. Në këtë drejtim po punohet.

Madhësia e fermës

Njësitë vendore	Sipërfaqja mesatare e fermës (ha)	Numri i fermave me sipërfaqe të fermës:			
		>0.5ha mbi 2 ha	0.5-1 ha	1-1.5 ha	1.5-2 ha
1. Bulgarec	1.9	367 634	431	756	1053
2. Drenovë	1.7	183 23	874	632	118
3. Lekas	1.4	89	52	25	20
4. Mollaj	2	760 43	162	15	20
5. Vithkuq	1.5	115	304	89	40

			8			
6.	Voskop	2	0	164	509	694
			264			
7.	Voskopojë	1.7	7	171	353	175
			9			

Tabela 42. Madhësia e fermës.

Është një nga problemet më të mprehta dhe të vështira për tu zgjidhur i cili kërkon kohë, mentalitet të përparuar dhe zhvillim në tërësi të ekonomisë së vendit. Sipas të dhënave madhësia e fermës për sa i takon sipërfaqes së tokës është si më poshtë: (Tabela 42)

Sikurse shihet në tërësi fermat janë të vogla. Rreth 40 për qind e fermave kanë më pak se 1 ha tokë, rreth 50 për qind 1-2 ha dhe 10 për qind mbi 2 ha. Kjo situatë është e përgjithshme në vendin tonë ku madhësia e fermës është rreth 1.2 ha. Jemi vendi në Evropë me madhësi ferme më të vogël me përjashtim të Maltës (0.9 ha). (Kroacia 5.6 ha, Mali i Zi 3.2 ha, Serbia 4.55 ha,). Por njësitë rurale të Bashkisë Korçë, ashtu si në gjithë vendin, ndeshen me fenomenin e shumë parcelave të tokës që përbëjnë sipërfaqen e një ferme. E thënë ndryshe një fermë e ka tokën në 3-4 -5 parcela. Kjo e çon fragmentarizmin e fermës në mënyrë të skajshme. Një fermë e vogël ka një sori disavantazhe:

- Nuk siguron të ardhurat e nevojshme për familjen fermere.
- Pëngon mekanizimin dhe përdorimin efektiv të tij.
- Pëngon përdorimin racional të sistemit të ujitjes.
- Pëngon përdorimin e inputeve që rritin prodhimin për pamundësi financiare.
- Pëngon kreditimin nga sistemi financiar.
- Dobëson fuqinë e tregut për fermerët.
- Rezultantja e këtyre është : Pëngon rritjen e efikasitetit të fermës.

Çfarë mund të bëhet për rritjen e madhësisë së fermës?

Përvoja e vendeve të tjera ka treguar se zmadhimi i fermës mund të realizohet nga disa faktorë madhorë të kushtëzuar nga njëri - tjetri.

Së pari. Rritja e madhësisë së fermës normalisht lidhet me zhvillimin e sektorëve ekonomikë të vendit. Zhvillimi i industrisë, turizmit, industrisë përpunuese ushqimore etj. do të kërkonte një tërheqje të fuqisë punëtore nga fshati.

Së dyti. Zhvillimi i tregut të tokës në dy nivelet: me *qira* dhe *shitja*. Për shkak të faktorit të parë zhvillimi i tregut të tokës është tepër i ngadaltë, dhe në të shumtë e rasteve toka blihet për ndërtime ose biznes jashtë bujqësisë. Dhënia me qira e tokës është rritur, por ende është shumë i ulët në krahasim me vendet e zhvilluara ku mbi 60-70 për qind e tokës jepet me qira. Negativisht ndikon dhe mos zgjidhja e pronësisë mbi tokën në disa raste.

Së treti. Blerja e tokës është investim. Mungesa e kreditimit vështirëson procesin.

Së katërti. Pasiguria për të jetuar. Kjo tregohet nga fakti se edhe familjet e larguara nga fshati e ruajnë pronësinë mbi tokën. Arsyeja është e thjeshtë: Toka të pasur nuk të bën, por nuk të lë vdesësh urie.

Ne duhet të synojmë që madhësia e fermës të konsolidohet në nivelin 4-5 ha.

Së pesti. Nëpërmjet organizimit të prodhimit dhe shitjes në përmasa më të mëdha, nëpërmjet kooperimit.

Zgjidhjet për pakësimin e fragmentarizmit.

Kjo lidhet me konsolidimin e fermës. Është proces që ka zgjatur shumë. (Suedi rreth 150 vjet). Por përvoja tregon se mund të realizohet edhe më shpejt. Zgjidhjet janë disa:

Së pari. Ndërrimi i copave të tokave midis fermerëve brenda një parcele. Është rruga më e mirë. Në shkallë të kufizuar është përdorur dhe në zonën e Voskopit.etj. Mund të bëhet në sipërfaqe të barabartë por edhe me kompensim në sipërfaqe ose vlerë kur ngastrat kanë pjellori të ndryshme. Në këtë rast sikurse theksuam më sipër është regjistrimi i ndryshimeve në hipotekë.

Së dyti. Marrëveshje midis fermerëve për mbjelljen e bllokut me të njëjtën bimë.

Së treti. Puna me grupe. Punimet të kryhen së bashku në të gjithë bllokun.

Numri i fermave

Në zonën rurale të baskisë Korçë zhvillojnë aktivitetin 9167 ferma, një numër relativisht i madh në krahasim me sipërfaqen e tokës. Ky fenomen është në shkallë vendi me mbi 320 mijë ferma duke pasur numër më të madh se Anglia. *Numri i fermave në të ardhmen do të varet kryesisht nga zhvillimi ekonomik i vendit, kur njerëzit të kenë mundësi të punojnë aktivitete jashtë prodhimit bujqësor.*

Fuqia punëtore në bujqësi

Në shkallë vendi në bujqësi janë të zënë me punë në bujqësi e pyje rreth 44-45 për qind e krahëve të aftë. Kjo është shifër shumë e lartë edhe në krahasim me vendet e rajonit (Kroaci 13 %, Mali i Zi 5.6 %, Maqedonia 18.1 %, Serbia 21.2 %). Edhe në zonën rurale të Bashkisë Korçë, është në nivelin e republikës. Mendojmë se në këtë zonë numri i njerëzve të zenë me punë në bujqësi mund të jetë në kufijtë 25-30 për qind. Pakësimi i numrit të fuqisë punëtore në fshat është tregues i zhvillimit të vendit por kërkon kohë. Pakësimi i numrit por dhe përdorimi efektiv i fuqisë punëtore mund të arrihet nëpërmjet:

-Përmirësimi i strukturës së prodhimit, duke mbjellë kultura intensive, kjo edhe duke mbajtur parasysh mundësitë e tregimit.

-Zënia në punë jashtë fermës por në zonën rurale, sidomos në sektorë të tillë si prodhimi i materialeve të ndërtimit, përpunimi i produkteve bujqësore, shërbime si turizmi, hoteleria,etj.

- Tërheqja e popullsisë në punësim në zonat urbane.

Përmirësimi i formave të organizimit me synim rritjen e kooperimit

Pothuajse tërësisht fermat tona janë familjare. Kjo nuk është karakteristikë vetëm për vendin tonë. Por duhet theksuar se format e tjera të organizimit ose mungojnë ose janë fillimet e veta. Dhe këtu e kemi fjalën edhe për ato me bazë kooperimin. Eksperienca e keqe e kooperimit socialist si dhe mungesa e vizionit për të ardhmen lidhur me këtë organizim, u gjend rruga më e thjeshtë ajo radikale, zhdukja e gjurmëve të kooperimit, ndryshe nga vendet e tjera që përdorën rrugën e transformimit të tyre në kushtet e sistemit kapitalist. Gjatë kësaj ka shembuj të mirë si Sarandë, Lushnjë, Durrës etj. se kjo është një rrugë që duhet të zgjerohet sepse edhe në këtë drejtim vendet e rajonit janë më të avancuara. Kështu Serbia (superfuqia e bujqësisë në rajon) ka mbi 1246 ndërmarrje dhe kooperativa bujqësore dhe secila ka mesatarisht 335 dhe 170 ha tokë, në Kosovë janë rreth 1800 kooperativa dhe ferma komerciale, etj. Funkcionojnë forma të ndryshme të kooperimit, por mendoj se më e përshtatshme për kushtet tona do të ishte **ajo e marketingut me të drejtë kontrollit të prodhimit**. Kjo sepse tani fermerët po hasin vështirësi në shitjen e produkteve. Kooperativat mund të jenë në bazë fshati, njësi administrative, bashkie, ish rrethi i Korçës bile dhe kombëtare. Synimi final i këtyre kooperativave do të jetë rritja në afat të gjatë të të ardhurave të fermerëve, nëpërmjet kapërcimit të disa kufizimeve që kanë fermerët në treg dhe më gjerë. Kjo sepse:

-Krijohet mundësia për pakësimin e shpenzimeve për inpute nëpërmjet blerjes me çmime më të ulëta, për shkak të sasisë së blerjes në shkallë kooperative.

- Rritet kërkesa për produkte bujqësore duke rritur cilësinë, standardizimin, promocionin etj.

- Krijohet mundësia për të shitur produktet me çmime më të larta nëpërmjet dhe rritje së fuqisë negociuese të fermerit nëpërmjet kooperativës.

- Shtohet kontrolli i ofertës së produkteve bujqësore në raport me kërkesat e tregut.

- Mund të rritet kontrolli në kanalet e shpërndarjes.

-Sigurohet informacion më i mirë dhe me më pak shpenzime për tregjet.

Përveç këtyre puna në grupe e fermerëve do të ndikonte pozitivisht edhe:

-Në rritjen e koordinimit dhe orientimit të bujqësisë duke filluar nga ferma dhe deri në Ministri.

-Në krijimin e mundësive për të përfituar më shumë nga programet e qeverisë dhe BE-së.

-Krijohen mundësi për integrimin vertikal të prodhimit për të shtuar vlerën e prodhimeve të fermës.

E gjithë kjo të inspirohej nga slogani: **Pronarë individualë jemi të fortë, kur bashkohemi bëhemi më të fortë.**

Krijimi i kooperativave në forma të ndryshme, është problem vullnetar i fermerëve. Por shteti nuk mund të mënjanohet. Ndërhyrja nxitëse e qeverisë është e nevojshme në dy aspekte kryesore: **Ekspertizë** dhe **financiare**. Nxitja financiare mund të jetë në dy drejtime: E para **kushtëzuese** d.m.th për të fituar nga programet e qeverisë si subvencione etj. duhet të jesh në kooperativë dhe **direkt** duke ndihmuar financiarisht kooperativat sidomos

në infrastrukturë (depo, pajisje, makineri, etj.) si përqindje ndaj investimeve direkt. (Kjo është zbatuar në vitet 1970 në vende të BE-së).

Mbi mbështetjen e bujqësisë

Për këtë temë ka një diskutim të gjerë. Çështjet bazë kanë qenë dhe vazhdojnë, janë:

E para. A duhet mbështetur? Kjo është zgjidhur pozitivisht për arsye ekonomike, historike, sociale, etj.

E dyta. Përse duhet mbështetur? Për këtë ka modele të ndryshme por mund t'i grupojmë:

-Nxitës direkt. Synojnë të ndikojnë tregun në mënyrë direkt nëpërmjet reduktimit të kostove të prodhimit të produkteve bujqësore, duke siguruar kushte për të rritur furnizimin nga fermerët me produkte bujqësorë. Këto masa mund të përfaqësohen nga pagesa direkt për njësi: për ha, për krerë, për litër (qumësht), mbi vlerën e sasisë së shitur.

-Nxitës të tregut. Shpërndahen për aktivitete që synojnë të përmirësojnë vendosjen e produkteve të bujqësisë në tregjet ndërkombëtarë, stabilizimin e tregut të brendshëm për produkte bujqësorë dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e balancuar dhe të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor. Këto masa mund të zbatohen nëpërmjet nxitjes së prodhimit për eksport nëpërmjet tarifave doganore deri zero, pagesë për prodhimet për eksport, promocion në shkallë ndërkombëtar etj.

- Mbështetje për përmirësimin e teknologjive të kultivimit dhe mbrojtjes së bimëve (Lek për/ha), për mbarështimin e blegtorisë (lekë për krerë)

-Nxitje për investime e kreditime. Zbatohet në % të interesit, % ndaj vlerës së projektit, lekë/ha (sera).

Vlen të përmendet se në këtë vit , të gjitha këto forma përdoren në vendin tonë.

E treta. Sa duhet mbështetur në vlerë financiare? Kjo varet nga zhvillimi ekonomik i vendit, prioritetet e qeverisë, etj. E vërteta është se niveli i mbështetjes në vendin tonë është e ulët, krahasuar dhe me vendet e rajonit. (Maqedonia për 1 ha tokë të dobishme 116 Euro, viti 2012 , ndërkohë që vendi ynë 13.3 Euro për ha.) Maqedonia vetëm për grurin dhe misrin ka dhënë 17 milion Euro. Në vitin 2014 ka shpenzuar si mbështetje të bujqësisë 140 milion Euro. Ne shumë herë më pak.

Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit

Pothujse të gjithë komunat kanë probleme me ujitjen e bimëve. Komunitet kryesore si Mollaj, Drenovë, Voskop dhe një pjesë e komunës Bulgarec janë ujitur nga kompleksi i Gjançit, nëpërmjet dy krahëve kryesorë: nga Floqi dhe Pulahë. Një pjesë e Komunës Bulgarec ujitet me Kanalin e Ventrokut. Dy janë problemet kryesorë:

a. Mungesa e infrastrukturës së ujitjes si pasojë e shkatërrimit të saj në fillim të viteve 1990.

Për fat të mirë rezervuari i Gjançit nuk është dëmtuar. Por dëmtim kanë pësuar kanalet kryesorë nga 60 deri 100 % dhe të gjithë elektrostacionet. Probleme kanë dhe rezervuarët Gjonmadh, Lavadar etj.

b. Problemet e menaxhimit të ujitjes.

Zgjidhja e problemit të parë kërkon shumë investime. **Projekti më madhor është riabilitimi i kanaleve kryesorë në të dy anët në jugë të fushës së Korçës (që lidhen me rezervuarin e Gjançit me aftësi ujitëse 6050 ha.). Duhet riabilituar rreth 40 km kanale kryesorë, rreth 50 km kanale të dytë, rreth 30 vepra arti në kanalet kryesorë. Për këtë është mirë të bëhet një projekt kompleks dhe vit pas viti të kërkohen investime nga qeveria. Rrjeti i kanaleve të tjera të përballohen nga vetë fermerët. Riparim rezervuarësh, kanale etj. ka dhe në komunat malore.**

Aktualisht uji për ujitjen e bimëve administrohet nga Shoqatat e ujitjes në komuna që veprojnë dhe mbi bazë fshati. Janë të organizuara keq dhe funksionojnë përgjithësisht dobët. Kalimi i këtij aktiviteti në vartësi të baskisë do të përmirësojë të gjithë punën në këto drejtime.

Në komunën e Bulgarecit problem është edhe pastrimi i kanaleve të kullimit.

Tregtimi i produkteve bujqësorë

Është një problem që do të ekzistojë gjithmonë. Synimi do të jetë zbutja e përmasave të këtij fenomeni. Problemi shkaktohet nga disa faktorë, ku dhe do të kërkohen zgjidhjet.

Faktorët kryesorë janë:

a. Mungesa e përcaktimit relativisht me saktësi e ofertës së disa produkteve bujqësorë dhe kryesisht frutave, perimeve dhe patateve ku edhe problemet janë më shqetësuese. Kjo vjen për shkak të ndikimit të kushteve të motit dhe për shkak të mos koordinimit të sasisë prodhimit nga secili fermer.

b. Prodhimi në përmasa relativisht të vogla nga shumica e fermerëve. Kjo sjell dobësimin e fuqisë në treg të fermerit.

c. Disa produkte sidomos perimet e njoma, frutat prishen shpejt.

d. Largësia nga tregjet për komunat malore dhe ngandonjëherë mungesa e rrugëve.

e. Prodhimi jo në të gjitha rastet me cilësi të mirë. etj.(dëmtime, sëmundje).

Çfarë mund të bëhet për të përmirësuar tregtimin e produkteve bujqësorë?

- *Orientimi i fermerëve për sasinë më optimale të prodhimit për bimët kryesore.* Kjo sepse fermerët marrin vendim se **çfarë** të prodhojnë dhe **sa** kryesisht, nga çmimi në vitin faktik. Kur çmimi i një produkti p.sh patate në vitin 2015 është i lartë, për vitin 2016 fermerët vendosin të mbjellin e të prodhojnë sasi të mëdha, e cila sjell ofertë të madhe që shoqërohet me mos shitje ose shitje me çmim të ulët. *Orientimi është një praktikë e konsoliduar në vendet e BE-së, bile dhe midis vendeve.*

- *Ndarja e kohës së prodhimit me kohën e konsumit.* Prodhimi i frutave, disa perimeve, patateve etj. është sezonal. Tregu në kohën e vjeljes nuk mund të tërheqë të gjithë prodhimin. Kjo kërkon rritjen e kapaciteteve frigoriferike. *Shembull pozitiv është Mollaj me*

një kapacitet frigoriferik prej rreth 25-30 mijë kv. fruta. Ndërtimi i tyre duhet të bëhet mbi bazë grup fermerësh ose fshati, dhe shoqërohet me investime. Pjesëmarrja e shtetit me pjesë të investimit, me kreditim me interesa zero mund të ishin veprime pozitive.

- Krijimi i qendrave të grumbullimit të produkteve. (Mollaj për frutat) Bulgarec dhe Voskop për perimet dhe patatet. Këto qendra mund të jenë me kontribut privat por mund të ndihmojë dhe shteti.

- Rritja e cilësisë së prodhimeve. Edhe këtë vit mollët me cilësi dhe të llojeve të kërkuara nga tregu u shitë pa shumë vështirësi. Synimi të jetë dhe për eksport.

-Krijimi i kooperativave të marketingut. Sikurse u diskutua më sipër.

- Përpunimi i produkteve. Fermerët nëpërmjet kooperativave por edhe me ndihmën e shtetit, mund të rritnin mundësinë e përpunimit vetë të produkteve për të rritur vlerën dhe për mos lënë të dëmtohen.(Të mos shesin qumësht por djathë etj., të shesin verë, lëngje mollësh,etj.)

37. BUJQËSIA SIPA NJËSIVE ADMINISTRATIVE TË ZONËS RURALE

Sikurse dihet, në zonën rurale të Bashkisë Korçë, zhvillojnë aktivitetin bujqësor 7 njësi administrative: Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Vithkuq, Voskopojë dhe Lekas. Në këtë seksion do të trajtohet zhvillimi i bujqësisë në secilën njësi.

Njësia administrative Bulgarec

Për nga popullsia, sipërfaqja bujqësore, prodhimet që realizon është më e madhe . Ka një popullsi prej 14030 banorë dhe 3241 familje dhe po aq ferma.Madhësia e fermës 1.9 ha.

Faktorët e prodhimit

Fondi i tokës.

(Tabela 43)

Emërtimi	Ha
1.Territori gjithsej	6076
-Tokë bujqësore	4262
-Pyje	1780
-Kullota	34
2.Tokë e ndarë sipas ligjit	4262
3.Tokë bujqësore (2015)	4262
-Arë	3880
-Pemtore	242
-Vreshta	140

Tabela 43. Fondi i tokës gjithsej.

Kjo njësi administrative përbën 11.5 për qind të territorit gjithsej, 27.8 për qind të tokës bujqësore. Sipërfaqja e tokës nga pikëpamja e pjerrësisë është: (Tabela 44)

Emërtimi	Sipërfaqja (ha)	Në %
1. Tokë bujqësore	4262	100
0-5 %	3766	88.4
5-10 %	203	4.7
10-15 %	140	3.3
15-20 %	120	2.8
Mbi 20 %	33	0.8

Tabela 44. Sipërfaqja e tokës sipas pjerrësisë.

Kjo njësi shtrihet pothuajse në fushë.

Ujitja

Sipërfaqja potenciale 3256 ha. Sipërfaqja aktuale 3121 Ha. Sipërfaqja e ujitur 2929 ha. Problemi me ujitjen është rehabilitimi i plotë i kanalit të majtë që merr ujë nga rezervuari i Gjançit, rehabilitimi i elektro stacioneve të pompimit. Po ashtu përmirësimi i nfrastukturës së ujitjes nga lumi Dunavec.

Mekanizimi

Disponon traktorë me rrota gome 54, minitraktorë 42 dhe autokombajna 8.

Mënyrat e kryerjes së punimeve është: (Tabela 45)

Emërtimi	Sipërfaqja (ha)	Në %
1. Tokë bujqësore	4262	100
- Me mekanikë	3900	91.5
- Me kafshë	362	8.5

Tabela 45. Mekanizimi i punimeve.

Sikurse shihet shtrirja në fushë krijon mundësi për të kryer me mjete mekanike 92 për qind të punimeve.

Përdorimi i plehrave

Për vitin 2015 janë përdorur 516 ton plehra kimike ose 121 kg/ha tokë bujqësore, që konsiderohet nivel i ulët.

Struktura e mbjelljeve

Vendndodhja afër Korçës (0,5- 6 km) përcakton në një farë mase strukturën e mbjelljeve të njësisë administrative të Bulgarecit. (Tabela 46) (Ha)

	2005	2013	2014	2015
Emërtimi				

1.Drithra buke	1710	1820	1774	1840
-Grurë	1200	1500	1450	1480
2.Patate	280	300	288	300
3.Fasule gjithsej	50	50	48	50
4.Duhan	15	1.5	2	18
5.Perime bostan	210	264	260	260
6.Foragjere,tagjira	1829	1444	1484	1405
7.B.medicinale	-	-	6	6
Gjithsej	4093	3880	3862	3779

Tabela 47. Struktura e mbjelljeve.

Sikurse shihet drithërat e bukës përbëjnë 48-49 për qind të mbjelljeve, ku gruri e zë peshën kryesore. Sipërfaqe e konsiderueshme mbillet me patate dhe perime prodhimi i të cilave destinohet për treg mbasi plotësohen nevojat e familjes fermere. Peshë të konsiderueshme zënë dhe foragjeret dhe tagjirat, 37 për qind, e lidhur kjo me numrin e bagëtive. Pothuajse janë zhdukur mbjellja e bimëve industriale. Në vitin 1985 mbilleshin 1245 ha me panxhar sheqeri, 295 ha me elbi distik (birre), 409 ha duhan. Duhet thënë se panxhar mbillet edhe tani por për blegtorinë.

Prodhimet e bimëve të arave

Prodhimet nga bimët e arave tregohen në tabelën 48. (Tonë)

Emërtimi	2005	2013	2014	2015
1.Drithra buke	7196	7150	7028	8040
-Grurë	5400	6000	5801	6660
2.Patate	6440	9000	8640	9000
3.Fasule	90	115	110	115
4.Duhan	15	4	5	44
5.Perime e bostan	5574	7670	7360	7515

Tabela 48. Prodhimet nga bimët e arave.

Edhe në të ardhmen prodhimi i drithërave të reduktohet dhe të shtohet prodhimi i perimeve, patateve për të shfrytëzuar afërsinë me tregun, çka kërkon edhe shtimin e sipërfaqeve. Po ashtu mund të synohet për prodhime organike për të shtuar vlerën.

Pemtaria dhe vreshtaria

Zhvillimi i pemëtarisë tregohet në tabelën 49.

Emërtimi	2005	2013	2014	2015
1.Pemishte (ha)	----	240	241	242

2.Pemë gjithsej (000/rrënjë)	49.0	171.2	172.4	173.4
-Në prodhim	38.0	141.8	146.8	146.8
3.Rendimenti (kg/rr.)	16.5	28.2	37.6	42
4.Prodhimi (ton)	629	4000	5521	6172
5.Vreshta (ha)	85	140	140	140
6.Prodhim rrush gjithsej (ton)	350	35	173	97

Tabela 49. Prodhimi nga pemët dhe vreshtat.

Nga prodhimi i frutave prodhimi i mollës është kryesori me 5503 tonë ose 89 për qind (2015).

Në këtë njësi bën pjesë fshati Melçan dhe Biranj që mund të shtohet mbjellja e vreshtave dhe të shtohet kujdesi për ta, mbasi është një mikrozonë e përshtatshme.

Zhvillimi i blegtorisë

Mbarështohen pothuajse të gjithë llojet e kafshëve për prodhim. Numri i krerëve ka ndryshuar si

më poshtë, (Tabela 50)

(Krerë)

Emërtimi	1995	2014	2015
1.Gjedhë gjithsej	4499	2361	2361
-Lopë	2719	1840	1840
2.Të leshta	2730	11923	12083
-Dele	2395	10020	10020
3.Të dhirta	495	2481	2835
-Dhi	430	2019	2019
4.Derra	693	692	1542
-Dosa	14	142	100
5.Shpendë	7824	26973	26997
6.Njëthundrakë	-----	919	921
7.Bletë (zgjoje)	----	1190	1300

Tabela 50. Numri i krerëve të blegtorisë.

Në përgjithësi numri i krerëve është i stabilizuar, sidomos viteve të fundit. Tendencë e vendeve të zhvilluara është që gjedhi të mbarështohet më larg qendrave urbane mbasi kërkon shumë punë. Në Bulgarec, lopa përbën aktivitetin kryesor mbasi furnizon qytetin.

Prodhimet blegtorale

Në vartësi të numrit të krerëve dhe rendimenteve, prodhimi nga blegtoria tregohet në tabelën 51.

	1995	2015
--	-------------	-------------

Emërtimi		
1.Qumësht gjithsej j(tonë)	7744	6951
-Lope	7573	6039
-Dele	130	651
-Dhie	41	261
2.Mish gjithsej peshë e gjallë, (tonë)	324	785
-Gjedhi	159	351
-Të imtash	57	307
-Derri	104	84
-Shpendi	4	43
3.Vezë (000/kokrra)	3457	1952

Tabela 51. Prodhimet blegtorale.

Është rritur ndjeshëm prodhimi i mishit, ndërsa prodhimi i qumështit ka ndryshuar strukturën duke u rritur ai nga delet dhe dhitë. Prodhimet kryesore blegtorale në sasi janë më të mëdha se para vitit 1990. **Problem është prodhimi i mishit sidomos nga gjedhi dhe që lidhet me moshën e viçave. Përgjithësisht shiten për mish në moshë të vogël deri në një vit, dhe me peshë rëndom 70- 100 kg. Kjo shoqërohet me pakësim të prodhimit të mishit. Një veprim i tillë është për të ulur kostot e mbajtjes së viçave për mish. Janë prodhuar dhe 23 ton mjaltë.(2015)**

Tregtimi i produkteve

Sikurse theksuam kjo komunë shtrihet afër qytetit të Korçës deri 6 km. Për tregtimin e produkteve të prodhuara përdoren të gjithë mënyrat: *anës rrugës, direkt në shtëpi (kryesisht qumësht), në tregun e shumicës në qytet, nëpërmjet tregtarëve, përpunuesve.* Pothuajse të gjitha realizohen në mënyrë individuale. Tregtimi anës rrugës nuk kryhet sipas kërkesave të tregut lidhur me infrastrukturë, promocionit, etj.

Njësia administrative Drenovë

Ka një popullsi prej 9683 banorë dhe 2620 familje dhe 1830 ferma. Madhësia e fermës 1.7 ha. Diferenca midis familjeve dhe fermave vjen për shkak të ekzistencës së ish qytezës së minatorëve në Drenovë.

Faktorët e prodhimit

Fondi i tokës.

(Tabela 52)

Emërtimi	Ha
1.Territori gjithsej	6215
-Tokë bujqësore	2465
-Pyje	3000

-Kullota	750
2.Tokë e ndarë sipas ligjit	2465
3.Tokë bujqësore (2015)	2465
-Arë	2269.5
-Pemtore	190
-Vreshta	5.5

Tabela 52. Fondi i tokës gjithsej.

Kjo njësi administrative përbën 11.8 për qind të territorit gjithsej, dhe 16.6 për qind të tokës bujqësore. Sipërfaqja e tokës nga pikëpamja e pjerrësisë është: (Tabela 53)

Emërtimi	Sipërfaqja (ha)	Në %
2. Tokë bujqësore	2465	100
0-5 %	2364	96.0
5-10 %	37	1.5
10-15 %	26	1.0
15-20 %	19	0.75
Mbi 20 %	19	0.75

Tabela 53. Sipërfaqja e tokës sipas pjerrësisë.

Edhe kjo njësi shtrihet pothuajse në fushë.

Ujitja

Sipërfaqja potenciale 2403 ha. Sipërfaqja aktuale 1733 Ha. Sipërfaqja e ujitur 1103 ha. (2015). Kanë problem ujitjen e bimëve sidomos në pjesën mbi rrugën nacionale.

Mekanizimi

Disponon traktorë me rrota gome 14, minitraktorë 37 dhe autokombajna 5.

Mënyrat e kryerjes së punimeve është: (Tabela 54)

Emërtimi	Sipërfaqja (ha)	Në %
2. Tokë bujqësore	2465	100
- Me mekanikë	2000	81.1
- Me kafshë	265	10.7
- Me krahë	200	8.2

Tabela 54. Mekanizimi i punimeve.

Sikurse shihet shtrirja në fushë krijon mundësi për të kryer me mjete mekanike 81 për qind të punimeve, ndërsa pjesa tjetër me kafshë dhe krahë.

Përdorimi i plehrave

Për vitin 2015 janë përdorur 416 ton plehra kimike ose 168.8 kg/ha tokë bujqësore, që konsiderohet nivel i ulët.

Struktura e mbjelljeve

Vendndodhja afër Korçës (0,5- 5km) përcakton në një farë mase strukturën e mbjelljeve të njësisë administrative të Drenovës. (Tabela 55) (Ha)

Emërtimi	2005	2013	2014	2015
1.Drithra buke	755	690	645	673
-Grurë	525	500	470	510
2.Patate	9	32	33	34
3.Fasule gjithsej	34	25	20	22
4.Duhan	-	-	-	-
5.Perime bostan	19	85	90	97
6.Foragjere,tagjira	841	906	935	934
